

BULETINI I SHKENCAVE SHOQËRORE

2015

KËSHILLI SHKENCOR I “BULETINIT SHKENCOR”

- Prof. as. dr. Gjergji MERO, Universiteti i Korçës, Shqipëri (Kryetar)
- Prof. dr. Ion CUCUI, Universiteti i Targovishte, Rumani
- Prof. Dsci. Ivan PETKOV, Universiteti i Sofies, Bullgari
- Prof. Dr. Gjergji PENDAVINJI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Ali JASHARI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Gabriela TEODORESCU, Universiteti i Targovishte, Rumani
- Prof. Dr. Aleko MINGA, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Yllson MANOKU, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Dr. PhD Niko KACIROTI, Universiteti i Michigan, USA
- Prof. As. Dr. Aleksandra PILURI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Prof. Phd Gentian KOSTANDINI, Universiteti i Georgia, USA
- Prof. As. Dr. Irena KALLCO, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Prof. PhD Elton MYKEREZI, Universiteti i Minnesota, USA
- Prof. As. Dr. Lorenc EKONOMI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. As. Dr. Frederik ÇUÇLLARI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
-

Monika Thimo (Personi i kontaktit, Redaktore e gjuhës angleze)
Msc. Migena Riza (Redaktore letrare)

PUBLIKUAR NGA
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË
SHËTITORJA “RILINDASIT”
KORÇË, SHQIPËRI

SCIENTIFIC BOARD OF THE “SCIENCE BULLETIN”

- Prof. As. Dr. Gjergji MERO, University of Korça, Albania (Chief)
- Prof. Dr. Ion CUCUI, University of Targovishte, Romania
- Prof. Dsci. Ivan PETKOV, University of Sofia, Bulgaria
- Prof. Dr. Gjergji PENDAVINJI, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Ali JASHARI, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Gabriela TEODORESCU, University of Targovishte, Romania
- Prof. Dr. Aleko MINGA, University of Tirana, Albania
- Prof. Dr. Yllson MANOKU, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI, University of Korça, Albania
- Ass. Dr. PhD Niko KACIROTI, University of Michigan, USA
- Prof. As. Dr. Aleksandra PILURI, University of Korça, Albania
- Ass. Prof. Phd Gentian KOSTANDINI, University of Georgia, USA
- Prof. As. Dr. Irena KALLCO, University of Korça, Albania
- Ass. Prof. PhD Elton MYKEREZI, University of Minnesota, USA
- Prof. As. Dr. Lorenc EKONOMI, University of Korça, Albania
- Prof. As. Dr. Frederik ÇUÇLLARI, University of Korça, Albania

Monika Thimo (Contact person, English editor)
Msc. Migena Riza ((Editor)

PUBLISHED BY
UNIVERSITY “FAN S. NOLI” KORÇË
SHËTITORJA “RILINDASIT”
KORÇA, ALBANIA

PËRMBAJTJA

FILOZOFI

Arben Cici

RËNDËSIA MJEDISORE, BURIMET POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE

Ardian Matka

EPËRSIA MORALE TEK FILOZOFËT E ANTIKITETIT GREK

Eriseld Kalemaj, Suela Ibraimllari

THELBI I LIDHJES NJERI-HYJNI; NDIKIMI NË NATYRËN E MARRËDHËNIES SUBJEKT-PUSHTET POLITIK (Një diskurs midis T. Hobs dhe S. von Pufendorf)

Ferit Baça

E DJESHMJA DHE E SOTMJA E MENDIMIT FILOZOFIK MBI KONFLIKTIN DHE MENAXHIMIN E TIJ

Jak Simoni

DISKUTIMI FILOZOFIK MBI STADET KONTRADIKTORE MENDORE

GJUHËSI

Aida Kurani

MBI RENDIN E FJALIVE NË PERIUDHËN ME FJALI TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE NË PROZËN POPULLORE

Erta Spaho-Herri

STANDARDIZIMI I GJUHËS JURIDIKE DHE NXJERRJA NË PAH E DISA PROBLEMEVE GJUHËSORE NË PËRKTHIMIN JURIDIK

Evi Konjari

KUNDRINA E DREJTË NË GJUHËN GJERMANE NË PËRQASJE ME KUNDRINËN E DREJTË NË GJUHËN SHQIPE

Migena Riza

HUAZIMET QË I PËRKASIN SFERËS SË KUZHINËS NË "FJALORIN E GJUHËS SË SOTME SHQIPE" (1980)

Monika Hasani

TIPARE KONSERVATORE TË SISTEMIT FOLJOR NË ÇAMËRISHTË, PËRKIME ME TË FOLMET ARBËRESHE

Olger Brame

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI GJUHËN SI DISIPLINË SEMIOTIKE

Pavlo Cicko, Robert Stratobërdha

VËSHTRIM KRAHASUES I SEMANTIZMIT TË FOLJES "BËJ" NË SHQIP DHE "FAIRE" NË FRËNGJISHT

Suela Koça

TË KUPTUARIT E TOGFJALËSHVE TË QËNDRUESHËM NË ANGLISHTË DHE SHQIPE

HISTORI, GJEOGRAFI, SHKENCA JURIDIKE

Elona Kazazi

KRIJIMI I BANKËS KOMBËTARE DHE FUNKSIONIMI I SAJ

Engjëll Likmeta, Katrin Treska

RRETH LEGJISLACIONIT PENAL PER MBROJTJEN E ZGJEDHJEVE TE LIRA

Matilda Likaj Shaqiri

PERSPEKTIVA SOCIOLOGJIKE E HISTORISË SË EMIGRIMIT SHQIPTAR

Mine Balliu

TJETËRSIMI I KULTURËS SHQIPTARE GJATË REGJIMIT KOMUNIST

LETËRSI DHE PËRKTHIM

Alma Dema

PËRRALLA SI ELEMENT EDUKUES DHE SI NËNSHTRESIM I LETËRSISË

Anita Neziri

TENDENCAT PASMODERNE NË ROMANET E VONA TË XHOZEF HELLERIT

Bekim Vishaj

FOLKLORI BURIMOR NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT-TRASHËGIMI ETNO-KULTURORE

Dion Tushi

EPOSI HOMERIK DHE TË DHËNA TË TJERA PËR HOMERIN DHE VEPRËN E TIJ

Ediola Nase, Albina Pajo

PERIUDHA SHPREHËSE, MJET I FUQISHËM I RETORIKËS NË PROZËN SHQIPE

Erinda Papa

TRADITA REALISTE E SHEKULLIT XIX DHE DORIS LESINGU

Ervin Xhinaku, Olsa Pema

IRRACIONALITETI I TOTALITARIZMIT TE "1984" E GEORGE ORWELL-IT DHE "PALLATI I ËNDRRAVE" I ISMAIL KADARESE – VËSHTRIM KRAHASUES

Iris Klosi, Nejla Qafmolla

Përkthimi i veprave dramaturgjike dhe veçoritë e tij

Marsela Likaj

TIPARE TË TEORISË SË DRAMËS DHE TEATRIT BREHTIAN

Ornela Domi

DRANJA, "ORA" E DASHUR E CAMAJT

METODIKË, SOCIOLOGJI, PSIKOLOGJI

Anita Muho

NDARJA E OBJEKTIVAVE DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT ME NXËNËSIT: SI FAKTORË MOTIVUES NË PËRVETËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

Andi Petro

LUMTURIA, PSIKOLOGJIA DHE PSIKOTERAPIA POZITIVE PËR TRAJTIMIN E DEPRESIONIT

Anila Pango

FORMIMI I NDËRGJUHËS GJATË MËSIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA DHE RRUGËT PËR SHMANGIEN E INTERFERENCAVE GJUHËSORE

Denisa Titili, Maria Dojçe

PËRSIATJE RRETH NOCIONIT TË QYTETARISË, IDENTITETIT KOMBËTAR DHE MARRËDHËNIA NDËRMJET TYRE NË KUADRIN E GLOBALIZMIT

Donika Dardha, Mariela Burda

KUPTIMI I GJITHËPËRFSHIRJES SË NXËNËSVE NË KLASA NORMALE

Elda Tartari

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË MJEDISËT E SHKOLLAVE DHE SIGURIA E NXËNËSVE NË BOTËN VIRTUALE

Enila Cenko, Fatos Tarifa

SHKENCAT E SHOQËRISË DHE PROBLEMET SOCIALE

Ergys Prifti, Mihallaq Zilexhiu

HISTORIKU I MËSIMDHËNIES SË GJUHËS GJERMANE NË HAPËSIRAT SHQIPTARE

Irena Kallco, Eva Pjetri

VLERËSIMI I SISTEMIT ARSIMOR DHE MONITORIMI I STANDARTEVE ARSIMORE

Juliana Zaharia

ACCESS TO SCHOOL: A VIEW TO EDUCATIONAL AND INTELLECTUAL ENGAGEMENT OF RESISTANT YOUTH

Magdalini Vampa

DREJTIMI PËR NDRYSHIM DHE SFIDAT REFORMUESE TË SHKOLLËS SË DITËVE TË SOTME

Mariela Burda, Donika Dardha, Aleksandra Piluri

FITNESI FIZIK, ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE KONTROLLI I PUNËS NË INDIVIDËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE

Nikolin Gërmenji

THE IMPACT OF SCHOOL CONTEXTS ON STUDENT OUTCOMES AND ON CURRICULUM EVALUATION IN HIGH SCHOOLS OF KORÇA REGION (Comparative study of the State Matura results and the internal assessment of high school students in the region of Korça)

Paolo Martena

LA DIDATTICA PER COMPETENZE: UNA RIVOLUZIONE CULTURALE CHE PARTE DALLE BUONE PRATICHE

Valmira Skëndi, Çiljeta Simaku, Valbona Alikaj

PROBLEMET EMOCIONALE TEK FËMIJËT: FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN DHE RUAJTJEN E ANKTHIT

Vasilika Pojani

A JANË TEKSTET SHKOLLORE TË GJUHËS ANGLEZE NJË BURIM I MJAFTUESHËM PËR PËRVETËSIMIN E IDIOMAVE?

FILOZOFI

RËNDËSIA MJEDISORE, BURIMET POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE

ARBEN CICI

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Përmbledhje

Në ditët tona, mbrojtja e mjedisit është kthyer në sfidën nga më të rëndësishmet në debatin për të ardhmen e njerëzimit dhe të planetit tonë. Teoritë ideologjike mjedisore, ndërgjegjësuat shoqëritë dhe qeveritë të kthejnë vëmendjen drejt çështjeve mjedisore dhe debatit ekologjik. Megjithatë, ekologjistët janë kritikë duke i quajtur ideologjitë dhe doktrinat tradicionale politike "antropocentrike", të cilat kanë ushqyer "arrogancën e njerëzimit" (David Ehrenfeld, *The Arrogance of Humanism*, New York: Oxford University Press, 1978), ndaj mjedisit duke dëmtuar marrëdhënien mes njerëzimit dhe mjedisit të tij. Këndvështrimi i tyre shmang konceptimin për njerëzimin apo atë të nevojave njerëzore dhe përqendrohet në vizionin e natyrës si një rrjet i çmuar, por i brishtë marrëdhëniesh midis qenieve të gjalla, përfshi speciet njerëzore dhe mjedisin natyror. Për ekologjistët, njerëzit, të cilët janë të lidhur mënyrë të pandashme me natyrën, duhet të kujdesen për të dhe jo ta dëmtojnë duke përdorur shkencën dhe teknologjinë për të arritur qëllimet e tyre. Në këtë kontekst ata janë përpjekur të ofrojnë koncepte të reja në fushën e shkencës ose të ribulojnë ato të vjetra nga fushat e fesë dhe mitologjisë. Pavarësisht, përpjekjeve të tyre, temat si ekologjia, holizmi, qëndrueshmëria, etika mjedisore apo vetaktualizimi ashtu edhe platformat politike bashkëkohore si ekologjizmi i djathtë, ekosocializmi, ekoanarkizmi dhe ekofeminizmi mbeten vetëm platforma kritike dhe thirrje për ndërgjegjësim. Ato janë larg vëzhgimit realist të zhvillimeve politike, sociale, ekonomike, teknologjike dhe shkencore bashkëkohore. Njerëzimi dhe planeti jonë kanë shkuar shumë larg mundësisë për të përqaftuar tërësisht këto tema dhe për të zbatuar këto platforma politike. Pavarësisht se ndërgjegjësimi global mjedisor është në rritje të vazhdueshme trajtimi i këtij problemi nuk mund të jetë vetëm global, duke anashkaluar mozaikun e larmishëm të zhvillimit të vendeve të ndryshme. Në një këndvështrim tjetër këto platforma janë kthyer në teori mbështetëse për lëvizjet antiglobaliste dhe në teori anti rritjes, të papranueshme nga njerëzimi. Kështu, pavarësisht përpjekjeve të tyre për të kthyer platformat ekologjike në platforma qeverisë së, në rrafshin global dhe/ose lokal, këndvështrimi i tyre romantik ndaj realitetit i bën ato të jenë ende larg realizimit të qëllimit të tyre politik dhe social.

Fjalët çelës: mjedisi, ekologjizmi, ekologjia, holizmi, qëndrueshmëria, etika mjedisore, vetë-aktualizimi ekologjizmi i djathtë, ekosocializmi, ekoanarkizmi, ekofeminizmi.

Abstract

Today, the environmental protection became one of the most important challenges in the debate on the future of humanity and our planet. The ideological theories of environment make aware the companies and the governments to turn their attention to the environmental issues and to the ecological debate. However the Ecologists are still very critical, calling the traditional political ideologies and doctrines as "anthropocentric", which have fueled the "arrogance of humanism" (David Ehrenfeld, *The Arrogance of Humanism*, New York: Oxford University Press, 1978) towards the environment and have damaged the relationship between humanity and its environment. Their perspective avoids the conception for humanity and that of human needs, and it is focused on the nature's vision as a precious network, but fragile relationships between organism, including human species and the natural environment. For the ecologists, people, who are inseparably connected with the nature, must take care to not damage it, using science and technology to achieve their goals. In this context, they are trying to offer new concepts in science or rediscover the old ones from the fields of religion and mythology. Despite their efforts, topics such as ecology, holism, sustainability, environmental ethics and self-actualization as well as the contemporary political platforms such as ecologism of right, eco-socialism, eco-anarchism and ecofeminism, remain only critical platforms and call for awareness. They are far from a realistic observation of political, social, economic, technological and contemporary scientific developments. The humanity and our planet have gone far away from the opportunity to fully embrace these issues and to implement these political platforms. Despite the fact that global environmental awareness is growing continuously, the treatment of this problem can not be only a global one, avoiding the diversified mosaic of developing in different countries. On the other side, these platforms have been transformed in supporting theories for anti-globalization movements and anti-growth theory, unacceptable by the humanity in nowadays. Thus, despite their efforts to transform the ecological platforms into governmental one, on the global and/or on the local level, their romantic view of the reality makes them still far from achieving their political and social goal.

Key words: environment, ecologysm, ecology, holism, sustanaibility, environmental ethics, self-actualization ecologism of right, eco-socialism, eco-anarchism, ecofeminism.

Konteksti bashkëkohor

Bashkimi Evropian (BE) konsiderohet me të drejtë si institucioni me më shumë ligje mjedisore, sidomos nga pikëpamja e shtrirjes së tyre, se çdo organizatë tjetër ndërkombëtare. Politikat e mjedisit në BE

renditen dhe shpjegohen në një botim shumë të rëndësishëm dhe të vyer [Jordan, A.J. & C. Adelle, 2012, f. 18]. Politika mjedisore e BE-së është e ndërthurur në mënyrë të konsiderueshme me politikat e tjera ndërkombëtare dhe kombëtare të

mjedisit. Legjislacioni mjedisor i BE-së gjithashtu ka efekte të rëndësishme jo vetëm në ato të shteteve anëtare të saj, por edhe të atyre kandidatë siç është Shqipëria.

Legjislacioni mjedisor i BE-së adreson çështje të rëndësishme duke filluar nga shiu acid, shtresa e ozonit, cilësia e ajrit, zhurma, mbetjet, ndotja e ujit. Politika mjedisore është relativisht e re në BE: komisioneri i parë për mjedisin daton nga viti 1990. Akoma më e re është për Shqipërinë koncepti dhe politika mjedisore.

Në shekullin e njëzet e një, mbrojtja e mjedisit është bërë një çështje e rëndësishme, e imponuar sidomos nga degradimi i tij si në rrafshin globale ashtu edhe në atë kombëtar ose lokale për shkak të ndotëse aktivitetëve njerëzore. Ruajtja e mjedisit është bërë jetësore; ajo është një nga tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ka fituar statusin e një nga shtatë objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit.

Megjithatë, qëllimi i këtij studimi nuk është qartësimi i politikave mjedisore dhe trajtimi i tyre nga pikëpamja juridike por të thellohet në teorinë mjedisore nga pikëpamja ideologjike, temat bazë të ekologjizmit, shtrirja dhe zhvillimi i tyre, të cilat, në një kohë të caktuar, sipas vendit, ndërjegjësuat qeveritë t'i kthejnë sytë dhe vëmendjen drejt ndërtimit të politikave mjedisore.

Temat bazë të ekologjizmit

Ekologjistët janë të veçantë, ata gjithmonë i kanë kritikuar hamendësimet, mbi të cilat është bazuar mendimi politik. Për ta, ideologjitë dhe doktrinat tradicionale janë “antropocentrike”, ose të përqendruara te njeriu me besimin se qeniet njerëzore janë pjesë e vetë ekzistencës. David Ehrenfeldi (1978) i quan “arrogancë të njerëzimit” [Instituti për Politika Evropiane të Mjedisit, f. 24] mendimet tradicionale, sipas të cilave bota është e qenieve njerëzore dhe e grupeve të tyre – si individit, klasat sociale, gjinia, vendi dhe njerëzimi me vlerat e tij, të cilat reflektojnë nevoja dhe interesa, si liria, barazia, drejtësia dhe rregulli. Ekologjistët argumentojnë se konceptimet mbi qeniet njerëzore kanë dëmtuar marrëdhënien midis njerëzimit dhe mjedisit të tij. Në vend që të ruajnë dhe të respektojnë Tokën dhe speciet që jetojnë në të njerëzit janë përpjekur të bëhen, sipas Xhon Lokut [<http://www.biography.com/people/john-locke-9384544>] “mjeshtrit dhe zotëruesit e natyrës”. Në këtë spektër natyra duhet të “zaptohet”, “të ndeshet” dhe “të rilindë” [John Locke, 1689, f. 89-94].

Ekologjistët përfaqësojnë një grupim të ri politikanësh. Këndvështrimi i tyre anashkalon

konceptimin për njerëzimin apo të nevojave njerëzore dhe përqendrohet në vizionin e natyrës si një rrjet i çmuar, por i brishtë marrëdhëniesh midis qenieve të gjalla, duke përfshirë speciet njerëzore dhe mjedisit natyror. Për ta, njerëzit, që janë të lidhur mënyrë të pandashme me natyrën, e kanë dëmtuar atë me ëndrrën që shkencën dhe teknologjinë mund të zgjidhin gjithë problemet e tyre. Ekologjistët janë përpjekur të ofrojnë koncepte të reja në fushën e shkencës ose të rizbulojnë ato të vjetra nga fushat e fesë dhe mitologjisë. Temat kryesore të ekologjizmit janë:

Ekologjia

Holizmi

Qëndrueshmëria

Etika mjedisore

Vetëndërgjegjësimi

Ekologjia

Parimi kryesor i mendimeve të të gjelbërve është ekologjia. Ekologji do të thotë studim i organizmave “në shtëpi” ose “në banesat e tyre” dhe paraqitet si një sistem natyror vetë-rregullues i përbërë nga gjallesat dhe elementet jo të gjalla [Termi ekologji vjen nga greqishtja: οἶκος, "shtëpi"; -λογία]. Shfaqje të një ekosistemi janë një fushë, një pyll, një liqen madje një pellg. Në një liqen, për shembull, fundi i tij përmban ushqim që lejon llojshmëri të jetës bimore. Këto bimë sigurojnë oksigjen dhe ushqim, i cili mban jetën e kafshëve dhe të insekteve në liqen. Kur kafshët dhe bimët shpërbëhen trupi i tyre dekompozohet, duke çliruar ushqim në sedimentin në të cilin ndodh një proces i vazhdueshëm riciklimi. Të gjitha ekosistemet kanë prirje drejt një “shteti” të harmonizuar dhe të balancuar përmes një sistemi vetërregullues. Ushqimi dhe burimet janë të riciklueshëm, prandaj dhe masa e popullatës së kafshëve dhe bimëve përballon në mënyrë natyrore ushqimin. Megjithatë, të tilla ekosisteme të mbyllura nuk paraqiten plotësisht si vetërregulluese: secili ndërvepron me një tjetër ekosistem. Një liqen mund të përbëjë një ekosistem, por gjithashtu ai ka nevojë të ushqehet me ujë të freskët, të marrë nga toka dhe energji nga dielli. Vetë liqeni siguron ujë dhe ushqim për speciet e gjalla përgjatë brigjeve të tij duke përfshirë këtu dhe njerëzit. Bota anëmbanë është e përbërë nga një numër i madh ekosistemesh, nga të cilat më përmasori ndërmjet tyre është ai global ose siç thirret ndryshe “ekosfera” ose “biosfera” [The Columbia Encyclopedia, Sixth Edition. 2004].

Ekologjia është tërësisht kundër nocionit të njeriut si mjeshtrë i natyrës, me aftësitë e tij të nënshtrimit dhe shfrytëzimit të saj. Përkundrazi, në kërkimin e tij të apasionuar dhe drejt pasurimit me materiale, ai pothuajse ka prishur tërësisht balancën e natyrës

dhe ka rrezikuar ekosistemet, të cilat e bëjnë jetën e njeriut të mundur. Kjo ka ndodhur në shumë mënyra, si me rritjen e menjëhershme të popullatës së botës, boshatisja e pazëvendësueshme e resurseve të karburantit, si qymyri, nafta dhe gazi natyror, zhdukja e pyjeve tropikale, të cilat ndihmojnë të mbajnë pastër dhe të rregullojnë klimën e Tokës; ndotja e lumenjve liqeneve dhe pyjeve dhe ajrit të tyre, përdorimi i kimikateve, hormoneve ose shtuesit e tjerë në ushqimet, dhe cenimin e biodiversitetit [Biodiversity refers to the variety of life and its processes. It includes the variety of living organisms, the genetic differences among them, the communities and ecosystems in which they occur, and the ecological and evolutionary processes that keep them functioning, yet ever changing and adapting. Noss, R. F.; Allen Y. Cooperrider, 1994, f.443], çka ka rrezikuar zhdukjen e mijëra specieve të cilat farorizojnë mbizotërimin e specieve njerëzore.

Ekologjizmi parashikon një vizion të ri të natyrës dhe të vendit të njeriut në të, një vizion ekocentrik dhe joantropocentrik. Megjithatë, idetë ekologjike shprehen në mënyra të ndryshme dhe me konkluzione të ndryshme. Dallimi kryesor në lëvizjen mjedisore është ai midis asaj që filozofja norvegjeze Arne Naess e quan “ekologji e cekët” ose “sipërfaqësore” dhe “ekologji thelbësore” ose “e thellë” [Næss Arne, 1973, f. 95-100]. “Ekologjia e cekët” ka si alternativë ndërveprimin: në qoftë se ne ruajmë dhe mbajmë gjallë botën, bota do të vazhdojë të mbajë jetën e njerëzve. Ky vizion është reflektuar në një parim të veçantë, si kontrollimi i rritjes së popullsisë, ndërprerja e përdorimit të resurseve të pazëvendësueshme dhe ulja e ndotjes. Ekologjistët e “thellë” e anashkalojnë ekologjizmin e cekët duke argumentuar se qëllimi kryesor i tyre është të ruajnë jetën dhe prosperitetin e njerëzve që jetojnë në vendet e zhvilluara. Alternativa e të “thellëve” kundërshton çdo besim këmbëngulës se njeriu mund të jetë në një farë mënyre superior, ose më i rëndësishëm sesa çdo specie tjetër, duke përfshirë këtu edhe vetë natyrën. Ata i përmbahen mospranimit të idesë se qëllimi i njerëzve, është të mbajnë natyrën dhe jo vendet përreth. Ajo që Naess quan “ekozofi” përfaqëson një vizion tërësisht të ri mbi botën e bazuar mbi një filozofi ekologjike, si një moral i ri. Nga ana e tyre, ekologjistët “e cekët” kritikojnë ekologjinë “e thellë” të bazuar te irracionajla ose në doktrinat mitike dhe që përkrahin zgjidhje plotësisht të gabuara [A. Heywood, March 2012].

Ekologjizmi i “thellë”	Ekologjizmi i “cekët”
ekologjizëm	ambientalizëm

ekocentrizëm	antropocentrizëm i lehtë
misticizëm	shkencë
natyra	lloji njerëzor
holizëm i plotë	holizëm i pjesshëm
vlera të natyrës	vlera të dobishme
të drejtat e kafshëve	mirëqenie e kafshëve
kundër rritjes	pro rritjes
ndërgjegje ekologjike	zhvillim vetjak

Holizmi

Idetë politike tradicionale kanë pretenduar se njerëzit janë zotërues të natyrës, prandaj e kanë parë natyrën pak më shumë se një resurs ekonomik. Në këtë kuptim, ato kanë qenë pjesë e problemit dhe jo e zgjidhjes. Te “Pika e Kthimit” [Fritjof Capra, 1982], Fritjof Capra [Fritjof Capra është drejtori dhe krijuesi i “Center for Ecoliteracy” në Berkeley, California, dhe në fakultetin “Schumacher College”] i nisur nga origjina e disa ideve të filozofëve të mëdhenj, si: Rene Dekarti dhe Isak Njuton, nënvizon se në këto 17 shekuj filozofët e kanë portretizuar botën si një makineri, pjesët e së cilës mund të analizohen me anë të metodave të reja shkencore, si hipotezat dhe eksperimenteve kundër fakteve. Njerëzit kanë përparuar shumë në shkencë dhe kanë hedhur bazat për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë dhe teknologjisë moderne. Shumë të admirueshme kanë qenë frytet e shkencës saqë informacioni intelektual në botën moderne është i mbizotëruar nga shkenca, besimi që metodat shkencore parashikojnë mjetin më të sigurt të së vërtetës. Megjithatë, Kapra argumenton se shkenca ortodokse që i referohet “paradigmës karteziane – njutoniane” përbën bazën filozofike të krizës mjedisore të kohës. Shkenca e trajton natyrën si një makinë, duke lënë të kuptohet se si çdo makinë tjetër ajo mund të lyhet, rregullohet madje edhe të zëvendësohet. Nëse njerëzit mësohen se ata janë pjesë e natyrës dhe jo zotërues të saj, Kapra sugjeron që koncepti i Njutonit për natyrën si një makinë, duhet të zëvendësohet me një tjetër paradigmë [Jonathan Schell (1982), f. 25].

Në kërkim të kësaj paradigme të re ekologjistët janë tërhequr nga një sërë idesh dhe teorish bazuar në shkencën moderne dhe në mitet antike e feja. Megjithatë, i përbashkët midis këtyre ideve është nocioni për holizmin. Termi “holizëm” (Fritjof Capra, 1982, f.57-70) u përdor për herë të parë nga Jan Smuts, një boer në të njëjtën kohë kryeministër i Afrikës së Jugut, për të përshkruar idenë se natyra duhet kuptuar si një e tërë dhe jo nëpërmjet pjesëve individuale të saj. Smuts theksonte se shkenca bën gabimin e pakësimit: ajo redukton çdo gjë që studion, e ndan në pjesë dhe

përpiqet të kuptojë çdo gjë në vetvete. Ndërsa, holizmi bazohet në besimin se “e tëra” është më e rëndësishme se “pjesët” e saj të veçanta; në të vërtetë, ai pohon se çdo pjesë ka kuptim në lidhje me pjesët e tjera dhe me “të tërën”; në mjekësi, p.sh., sëmundjet zakonisht janë trajtuar si një çrregullim i një organi të veçantë ose qelizave specifike në trup dhe jo si një disbalancim i tërë jetës së pacientit. Prandaj, i është kushtuar një kujdes i madh trajtimit të simptomave fizike dhe psikologjike, ndërsa ato sociale dhe mjedisore janë shpërfillur.

Megjithëse, disa e shohin shkencën si fajtori që ka mësuar njeriun si të plaçkitë sa më shumë të mirat e natyrës, të tjerët mendojnë se shkencë moderne mund t’i ofrojë atij një paradigmë të re për mendimin njerëzor. Kështu, Kapra argumenton se vizioni Kartezian-Njutonian [Fritjof Capra, 1982, f. 51-55] për botën është braktisur nga shumë shkencëtarë, veçanërisht nga fizikanë si ai. Gjatë shek. XX me zhvillimin e “fizikës së re”, u kalua përtej ideve mekanike të Njutonit. Me zbulimin e teorisë së relativitetit, në fillim të shek. XX nga Albert Anjstajni (1879-1955); u kapërcyen konceptet tradicionale të kohës dhe hapësirës. Puna e nisur nga Anjstajni u çua përpara nga teoria e kuantit, e zhvilluar nga Nils Bohri (1885-1952) dhe Verner Heisenbergu (1901-1976). Fizikanët e rinj u përqendruan në kërkimet atomike, duke lënë mbrapa idenë e diturisë objektive dhe absolute. Në vend të saj Heisenbergu propozoi “parimin e paqartësisë” [Heisenberg, W. 1927, 172–198]. Bota fizike kuptohet tashmë jo si koleksion i molekulave të veçanta, atome ose pjesëza, por si një sistem ose më saktë një rrjet sistemesh. Një pikëpamje e sistemeve të botës përqendrohet mbi parimet e organizimit të të gjithë sistemit, prandaj ajo nënvizon marrëdhëniet e sistemit dhe integrimin e elementeve të ndryshme brenda së tërës. Sipas kësaj pikëpamjeje njohuria objektive është e pamundur, sepse veprimi i vërtetë i observimit ndryshon me atë çfarë observohet. Vetë shkencëtari nuk është i ndarë nga eksperimenti i tij, por është i lidhur ngushtë me të, prandaj subjekti dhe objekti janë një. Në mënyrë të ngjashme kërkohet që konceptet e shkakut dhe të pasojës të rishikohen, sepse ndryshime janë bërë për të zhvilluar brendësinë e një sistemi tej një vargu faktorësh, më tepër sesa një pasojë e vetme e një shkakut. Kapra [Fritjof Capra, 1982,] shton se sisteme të tilla të jetës kanë revolucionuar fizikën në procesin e ndryshimit të shkencave të tjera dhe ajo mund të aplikohet njëlloj në studime politike, sociale ose çështje mjedisore. Me pak fjalë, për të, fizika e re mund të

japë një shembull të aftë që të zëvendësojë një koncept të gabuar për botën.

Një burim për konceptet e reja ka qenë feja. Te “Fizika e Taos” [Fritjof Capra, 1975] i kushtohet rëndësi paralelizmit midis ideve të fizikës moderne dhe atyre mistike të Lindjes. Ai argumenton se fetë, si hinduizmi, taoizmi, budizmi, në veçanti Buda Zen, kanë predikuar gjatë gjithë kohës bashkim ose unitet të të gjitha gjërave, një zbulim që shkencë perëndimore e bëri vetëm në shek. XX. Disa pjesëtarë të lëvizjes së të gjelbërve janë tërhequr nga misticizmi lindor duke e parë në dy aspekte: një filozofi që i jep shprehje mençurisë ekologjike dhe një mënyrë jetese që nxit një keqardhje për shoqërinë njerëzore, speciet e tjera dhe natyrën. Studiues të tjerë besojnë se parimet ekologjike janë mishëruar në fetë monoteiste, si: krishterimi, judaizmi, islami, të cilat i shikojnë njerëzit dhe natyrën si një produkt hyjnor. Kështu, qeniet njerëzore janë parë si shërbëtorë të Zotit në Tokë me një detyrë për ta ruajtur dhe pasuruar atë.

Ndoshta, konceptet kryesore për të gjelbrit modernë janë zhvilluar duke u bazuar në idetë para shpirtërore të Krishterimit. Fetë primitive nuk bënin dallim midis njerëzve dhe formave të tjera të jetës dhe, mbi të gjitha, shprehnin dallime shumë të vogla midis të gjallëve dhe të vdekurve. Për to, të gjitha gjërat janë të gjalla, gurët, lumenjtë, malet, madje vetë Toka shpeshherë e konceptuar si “Nëna Natyrë”. Ideja e “Nënës Natyrë” ka qenë shumë e rëndësishme për ekologjistët, duke u përpjekur të vendosin një tjetër marrëdhënie midis natyrës dhe qenieve njerëzore. Te “Gaia - Një Vështrim i Ri mbi Jetën në Tokë” [Lovelock James, 1979], Xhejms Loveloku hodhi idenë se vetë planeti është i gjallë dhe e quajti atë Gaia sipas perëndeshës greke të tokës. Loveloku e përcaktoi Gaian si “ biosfera, atmosfera, oqeanet dhe tokën” dhe argumentoi se Gaia përbënte një organizëm të gjallë që lufton për të mbajtur veten. Loveloku pretendon se Toka ka bazat e duhura që të tregojë vetërregullimin, një sjellje që karakterizon qeniet e gjalla. Gaia parashtron homeostazë, një stad e një balancë dinamike, pavarësisht nga ndryshimet dramatike që kanë ndodhur në sistemin diellor. Fakti më dramatik është se meqë dielli është nxehur me më shumë se 25% që prej fillimit të jetës, temperatura e Tokës dhe përbërja e atmosferës së saj kanë qëndruar të pandryshueshme. Një ndryshim i vogël i sasisë së oksigjenit në atmosferë ose në temperaturën mesatare të Tokës do të rrezikonte të gjitha format e jetës në planet. Në esenë e tij “Njeriu dhe Gaia” [Lovelock James, 1988 & 1995]. Loveloku paralajmëroi se të shkatërrosh një pjesë të tillë të ekosistemit kur ne nuk kuptojmë si punon ai, është

njësoj sikur të hedhësh sistemin e kontrollit të një aeroplani në mes të fluturimit.

Ideja e Gaias u zhvillua në një “ideologji ekologjike”, e cila përçon mesazhin e fuqishëm që njerëzit duhet të respektojnë “shëndetin” e planetit dhe të ruajnë resurset dhe bukurinë e tij. Ajo përmban gjithashtu një vizion të ri midis botës së animuar dhe asaj të paanimuar. Loveloku pohon se Toka vetë është e gjallë dhe trajton si botën gjallë dhe atë jo të gjallë si një të tërë. Ai nxjerr në pah se shumica e tokës dhe e shkëmbinjve në planet është bërë nga riciklimi i bimëve, insekteve dhe formave të tjera të jetës, të cilat sigurojnë mbështetje për bimët dhe speciet sot. Megjithatë, filozofia Gaia nuk korrespondon gjithmonë me parimet e lëvizjes së të “gjelbërve”. Ekologjistët “e cekët” kanë dëshiruar të ndryshojnë politikën dhe sjelljet në mënyrë që të garantojnë mbijetesën e vazhdueshme të qenies njerëzore. Teoria e Gaias sugjeron se shëndeti i planetit është më i rëndësishëm se shëndeti i çfarëdolloj specieje individuale që jeton në të. Loveloku shton se këto specie që kanë përparuar kanë qenë të vetmet që kanë ndihmuar Gaian të kontrollojë ekzistencën e vet. [The Environmental Mandate: Activists and Electorate, Harvard University, 2003, f. 127]

Qëndrueshmëria

Ekologjistët sfidojnë bindjet e kredos politike tradicionale, të përdorura nga rrymat politike kryesore, që jeta ka mundësi të pakufizuara për rritjen dhe pronën. Është e vërtetë se njerëzit në disa vende të botës jetojnë me një standard i cili para pesëdhjetë ose njëqind vjet më parë do të ishte i paimagjinueshëm. Shkenca dhe teknologjia, tashmë, zgjidhin probleme të vjetra, si varfëria apo sëmundjet, ka krijuar mundësi të tjera, si televizioni dhe video, kompjuterët dhe robotët, përshkimi i ajrit dhe madje i hapësirës. Por, perspektiva ekocentrike i përmbahet premtimit se për një progres të vazhdueshëm dhe një bollëk të mirash materiale “mania e rritjes”, siç e quan Hernan Dali [1974], nuk është vetëm e drejtuar keq, por është edhe një nga shkaqet kryesore të katastrofës natyrore. Në të vërtetë, mendimtarët e gjelbër e kanë bashkuar kapitalizmin dhe komunizmin duke e portretizuar atë si “industrializim”. Si pasojë, ekonomistët e gjelbër kërkojnë që bindjet ortodokse rreth natyrës dhe pikësnyimi për aktivitetin ekonomik të rikonceptohen sërisht, sidomos në lidhje me vizionin tonë për Tokën dhe resurset e saj. Një metaforë e veçantë në lëvizjen e gjelbër ka qenë ideja e “anijes tokë”, që thekson idenë për pasuri të kufizuara dhe të shërueshme. Ideja që Toka duhet të mendohet si një anije u dha në fillim nga Keneth Bulding [1966]. Nga perspektiva e ekologjisë “së thellë” disavantazhi

i kësaj teorie është se ajo mishëron bindjet antropocentrike se planeti ekziston që t’i shërbejë nevojave njerëzore: Toka është një anije, anija jonë. Megjithatë, koncepti i një Toke si anije shërben që të korrigojë besimin mbi resurset dhe mundësitë e pakufizuara. Buldingu mendon se qeniet njerëzore kanë vepruar sadoqë jetojnë në një “ekonomi kouboi”, një ekonomi me mundësi të pakufizuara, si periudhën Western të Amerikës gjatë kohës së tokave të pashkelura. Bulding sugjeron se kjo nxit një sjellje shfrytëzuese të guximshme dhe të dhunshme. Sidoqoftë, një anije kozmike është si një kapsulë dhe resurset i ka të shërueshme. Në të ardhmen, me “ekonominë e astronautit”, qenieve njerëzore do t’u duhet të jetojnë brenda limiteve dhe t’i kushtojnë më shumë vëmendje anijes e cila po i çon drejt hapësirës.

Të jetuarit në një anije kozmike kërkon një mënyrë tjetër të kuptuarit të procesit ekologjik që siguron jetën. Më e rëndësishmja është se njerëzit duhet të njohin se anija Tokë është një sistem i mbyllur. Sistemet e hapura marrin energji nga jashtë, si ekosistemet në Tokë, pellgjet, pyjet, liqenet, detet sigurohen nga dielli. Sisteme të tilla paraqiten vetërregullues edhe kanë prirje të vendosin një balancë ose një gjendje të qëndrueshme. Megjithatë, sistemet e mbyllura, si Toka vetë, bëhen si një anije kozmike dhe tregojnë entropi. Entropia shpreh masën e shkallës së çrregullimit të një sistemi. Të gjithë sistemet e mbyllura priren drejt shkatërrimit, sepse ato nuk janë të siguruara nga inputet e jashtme. Ata mbështeten në resurset e tyre dhe këto të fundit dobësohen dhe nuk mund të zëvendësohen. Së fundi, pavarësisht mençurisë dhe kujdesit të njerëzve mendohet se toka, dielli, dhe të gjithë planetët dhe yjet do të dobësohen dhe do të vdesin. Për shembull, energjia nuk mund të riciklohet: sa herë që energjia transformohet një pjesë e saj humbet, derisa ajo humbet tërësisht. Kur ligji i entropisë aplikohet në çështje sociale dhe ekonomike paraqitet si një ligj shumë efikas [Kenneth Ewart Boulding, 1966].

Asnjë çështje tjetër më mirë se kriza e energjisë nuk e reflekton ligjin e entropisë. Industrializimi dhe begatia e madhe u arritën nga shfrytëzimi i qymyrgurit, gazit natyror dhe rezervat e naftës, të cilat siguruan lëndë djegëse për stacionet hapësinore, uzinat, motorët e makinave të aeroplanëve. Këto lëndë djegëse janë karburante fosile të formuara nga dekompozimi i organizmave parahistorikë. Ato janë gjithashtu të papërsëritshme, dhe nuk mund të zëvendësohen. Te vepra “E vogla është e bukur” [Ernst Friedrich "Fritz" Schumacher, 1973], Shumakeri tregon se

qeniet njerëzore kanë bërë gabim në lidhje me energjinë duke e parë atë si një të "ardhur" e cila rritet në mënyrë konstante dhe jo si një kapital natyror pa të cilin nuk mund të jetojnë. Ky gabim ka lejuar pakësimin e energjisë sidomos në Perëndimin e industrializuar, në një kohë kur resurset e naftës janë afër fundit dhe, për më tepër, në fund të këtij shekulli. Sa më tepër anija i afrohet "moshës së karburantit", aq më shumë ajo sjell një copëtim, sepse nuk ka resurse për të kompensuar humbjet e qymyrgurit, naftës dhe gazit. Të ruajmë atë çka ka mbetur nga karburanti i fosileve do të thotë të ngasim më pak makina, të përdorim më pak elektricitetin, pra të pranojmë një standard më të ulët jetese.

Ekonomia ekologjike

[\[http://www.economical-ecology.com/\]](http://www.economical-ecology.com/) paraqitet jo vetëm për të parandaluar rreziqet, por edhe për të dhënë zgjidhje. Entropia shtrohet si një proces i pashmangshëm: megjithatë efektet e saj mund të ngadalësohen ose të ulen në mënyrë të konsiderueshme nëse qeveritë dhe qytetarët respektojnë parimet ekologjike. Ekologjistët theksojnë se njerëzit do të mbijetojnë vetëm nëse do të njohin se ka vetëm një element në biosferë dhe vetëm një biosferë e balancuar dhe e shëndetshme do të sigurojë jetën njerëzore. Të gjitha aksionet e ndërmarra në natyrë duhet të gjykojnë nga parimi i "vazhdueshmërisë", aftësia për të ruajtur shëndetin e një sistemi, në këtë rast, biosfera vetë. Vazhdueshmëria vendos kufizime të qarta mbi ambiciet njerëzore dhe ëndrrat materiale, sepse ato kërkojnë atë produkt që bën më pak dëm në ekosistemin global. Për shembull, një energji e vazhdueshme mund të bazohet mbi pakësimin e përdorimit të karburantit të fosileve dhe një kërkim për një tjetër alternativë dhe burime energjish të përsëritshme, si energjia diellore, fuqia e erës dhe ajo e detit. Këto janë me natyrë të vazhdueshme dhe mund të trajtohen si të ardhura dhe jo kapitalet e natyrës. Të gjelbrit kanë këmbëngulur se era e karburanteve të fosileve duhet t'i hapë rrugë erës së diellit dhe ka nxitur qeveritë të bëjnë një hap para në kërkimet dhe zhvillimin e energjive të përsëritshme.

Megjithatë, vazhdueshmëria nuk shtrohet thjesht për të ruajtur shëndetin, përdorimin më efikas të resurseve natyrore, por dhe në një afrim me aktivitet natyror. Kjo saktësisht është ajo çfarë Shumakeri ka dashur të japë me idenë e tij me veprën "Ekonomia Budiste" [Fritz Schumacher, 1973]. Për Shumakerin, ekonomia budiste është bazuar mbi parimin e "jetesës së drejtë" dhe qëndron në kontrast të plotë me teorinë tradicionale të ekonomisë, të cilat nuk janë asgjë tjetër veçse

maksimilistë të dobishëm. Budistët mendojnë se në shtimin e të mirave materiale dhe të shërbimeve, prodhimi lehtësohet nga zhvillimi i talenteve dhe aftësive, dhe kjo gjë ndihmon për të mposhtur egocentrizmin, duke ofruar lidhje sociale dhe duke nxitur njerëzit për të punuar së bashku. Parimi më i rëndësishëm i Budizmit nuk është i papajtueshëm me përparimin. "Nuk ka pasuri e cila qëndron në rrugën e lirisë" nënvizon Shumaker, "por kapja në pasuri; jo shijimi i gjërave të këndshme, por dëshira për to". Megjithatë lëvizja e gjelbër shprehon që në të ardhmen ekonomistët t'i shërbejnë njerëzimit e jo të skllavërojnë natyrën.

Për këtë problem ka një debat jo pak të spikatur. Të ashtuquajturit "të gjelbrit e ndritur" duke iu referuar si Realos

[\[http://de.wikipedia.org/wiki/Realo\]](http://de.wikipedia.org/wiki/Realo) (realistë) në Gjermani miratojnë idenë për një rritje të vazhdueshme të pasurisë, por me një ritëm të ngadaltë. Kjo do të thotë që dëshira për të mira materiale do të balancohet me koston e saj natyrore. Një mënyrë për të arritur këtë është ndryshimi në sistemin e taksave, që të penalizojë dhe të pakësojë përdorimin e resurseve të limituara. Versioni i Shumakerit trondit tregun e teknologjisë njerëzore dhe përkrah një sistem të një shkalle të vogël, "shkallë njerëzore" prodhimi për të zëvendësuar atë çfarë ai besonte të ishte bota johumane e qyteteve të mëdha dhe prodhimit masiv. Megjithatë, "të gjelbrit e errët" në Gjermani si Fundis

[\[http://en.wikipedia.org/wiki/Fundi_\(politics\)\]](http://en.wikipedia.org/wiki/Fundi_(politics)) (fonda mentalistë), mendojnë se vështrime të tilla nuk janë thelbësore. Për "të gjelbrit e errët" origjina e krizës ekologjike është e lidhur me materializmin, konsumin dhe fiksimin në rritje ekonomike; prandaj dhe zgjidhja e tyre qëndron në "zero rritje" [Daly, Herman; Robert Costanza, 5 June 2009 dhe 17 August 2009] dhe ndërtimi i një ere pasindustriale në të cilën njerëzit do të jetonin në komunitete të vogla rurale dhe do të mbështeteshin në aftësitë e zanatit. Kjo do të thotë një zbrapsje thelbësore dhe e kuptueshme e industrisë dhe teknologjisë moderne, me një fjalë një "rikthim në natyrë" [Avor, 1982, f. 25].

Etika mjedisore

Politika ekologjike në të gjitha format e saj është konceptuar si një moral i shtrirë në shumë drejtime. Kjo për shkak se sistemi tradicional moral është tepër antropocentrik. Utilitarizmi, për shembull, vlerëson "të mirën" dhe "të keqen" si shprehje të kënaqësisë dhe dhimbjes. Si utilitaristë njerëzit duhet të veprojnë në çfarëdo mënyre që të fitojnë sa më shumë kënaqësi dhe sa më pak pakënaqësi. Nëse bota jonjerëzore - speciet e tjera,

si pusi, pemët, bimët, toka dhe shumë të tjera, të cilat kanë një vlerë, në fund të fundit, kanë një domethënie të kënaqësive njerëzore. Teoria e vlerësimit është zhvilluar nga teoricienë, si: Xhon Loku, David Rikardo dhe Karl Marksi. Sipas tyre, bota jonjerëzore është krijuar vetëm me vlerën e hapësirës e cila është përzier me punën njerëzore, ose sepse ndërveprimi midis qenieve njerëzore dhe natyrës përmes punës përkrah zhvillimit e aftësive e shqisave njerëzore.

Një problem që humanistët apo ekologjistët e cekët e kanë trajtuar gjerësisht është ai i moralit dhe detyrimeve tona kundrejt brezave të ardhshëm. Kjo çështje paraqitet në thelb të natyrës, në të cilën pasojat e disave nga veprimet tona nuk njihen dot derisa të kalojnë dekada dhe shekuj. Pse duhet të kujdesemi për zhdukjen e karburantit të fosileve kur ne nuk do të jemi kur ato të mbarojnë? Pse duhet të shqetësohemi mbi mbetjet nukleare kur brezat që do të ndeshen me këtë dukuri nuk kanë lindur ende? Prandaj, ekologjistët janë të detyruar të zgjerojnë konceptin e interesave të njerëzve që rrethojnë qenien njerëzore, të mos bëjnë dallime midis brezave të tanishëm dhe atyre të ardhëm. Kjo “e ardhme” justifikohet në disa mënyra. Ekokonservatorët, për shembull, e lidhin atë me traditën dhe vazhdueshmërinë, me idenë se brezi i sotëm është thjesht ruajtësi i këtij shëndeti që ka ardhur nga brezat e mëparshëm dhe kështu duhet të vazhdojnë ta ruajnë që brezat e ardhshëm të përfitojnë nga kjo gjë. Ekosocialistët, nga ana tjetër, mendojnë se një çështje për brezat e ardhshëm është se ata thjesht duhet të reflektojnë për dashurinë e shtrirë përtej kohës, ashtu siç kalojnë ata përtej kufijve shtetërorë, etnikë dhe gjinorë.

Një rrugë për moralin mjedisor përfshin aplikimin e standardeve të moralit dhe zhvillimit e vlerave ndërmjet njerëzve dhe specieve të tjera. Një përpjekje për të bërë këtë ka qenë zotimi për “të drejtat e kafshëve”. Çështja e ngritur nga Piter Singer [Peter Albert David Singer, New York Review, 1975] për mirëqenien e kafshëve pati një nxitje të konsiderueshme për rritjen e lëvizjes mbi lirinë e kafshëve. Singeri argumenton se ashtu si njerëzit që janë qenie të ndjeshme, ashtu edhe kafshët janë të afta të vuajnë. Si një utilitarist ai thekson se kafshët ashtu si njerëzit ndjejnë dhimbje fizike, prandaj kundërshton çdo përpjekje për të vendosur interesin njerëzor mbi atë të kafshëve, një paragjykim irracional dhe arbitrar jo si racizmi dhe seksualiteti.

Ideja thelbësore që njerëzit dhe kafshët mund gëzojnë një status moral të njëjtë u zhvillua nga filozofi amerikan Tom Regan te “Çështja për të Drejtat e Kafshëve” [1983, 1985, 2004], në bazë të së cilës të gjitha krijesat që janë “subjekt jete”

klasifikohen për të pasur të drejta. Një pozicion i tillë e bën të pamundur përcaktimin e dallimit midis kafshëve dhe botës njerëzore. Megjithatë, Regani pranon se disa të drejta i janë atribuar njeriut për faktin se ata janë të pajisur me mendim racional dhe moral të pavarur, dhe këto të drejta mund të aplikohen vetëm në kafshë të veçanta, si gjitarët mbi një vjeç. Trajtimi i të drejtave bazë si çështje e moralit mjedisor nuk i kënaq ekologjistët e thellë, të cilët prisnin të zhvillonin një vizion holistik më të mbyllur [Barry Commoner, 1993, f. 67],

Pozicioni moral i ekologjistëve të thellë shprehet me natyrën me vlera të brendshme. Nga kjo perspektivë, etika mjedisore nuk ka të bëjë me dobritë njerëzore nuk mund të lidhen përtej zgjerimit të vlerave njerëzore kundrejt botës njerëzore. Gudini, për shembull, zhvillon një “ teori vlerash të blertë”, në të cilën ai thekson se resurset duhet të vlerësohen saktësisht, sepse ato vijnë nga proceset natyrore me tepër sesa nga aktivitetet njerëzore çka nuk i kënaq ekologjistët e thellë. Një paraqitje klasike e pozicionit të tyre qartësohet te vepra e Aldo Leopoldit [1949] “Rëra e Almanakut” në formën e etikës së vendeve. Vetë natyra është portretizuar si një bashkësi moraliste, që do të thotë se njeriu nuk është më shumë se një “ qytetar i thjeshtë” dhe nuk ka më shumë të drejta, dhe nuk meriton më shumë respekt se një pjesëtar tjetër i komunitetit. Si një pozicion moralist shprehet “barazia biocentrike”, sipas së cilës, që të gjithë organizmat dhe qeniet në ekosferë janë të barabarta nga sasia e moralit duke qenë secila pjesë e një raporti të brendshëm. Megjithatë, kritika e ekologjistëve të thellë e paraqet këtë pozicion të bazuar në një të pavërtetë, e cila shpërfill, për shembull, zinxhirin ushqimor dhe luftën për mbijetesë dhe nuk njuh se morali është një shpikje njerëzore dhe kjo është ajo që e bën natyrën të karakterizuar me “imoralitet natyror”.

Vetaktualizimi

Derisa një nga temat kryesore të ekologjisë ka qenë një refuzim i interesave njerëzore si një lakmi për të mira materiale, ata kanë zhvilluar një filozofi alternative, e cila i vendos nevojat vetjake në balancë me natyrën. Rritja e shqetësimit për çështjet e natyrës që prej viteve 1960 është e lidhur me faktorin e ri pasmaterializëm dhe të vlerave pasmaterialiste. Pasmaterializmi e shpjegon natyrën si çështje politike dhe me terma të zhvillimit ekonomik. Abraham Maslou te “Hierarkia e nevojave” [New York, 1943] e vendos nevojën për vlerësim dhe vetaktualizim përpara nevojave ekonomike dhe të mirave materiale. Pasmaterializmi thekson se përderisa kushtet e pamjaftueshmërisë së materialeve shkaktojnë sjellje egoiste dhe

përvetësuese, atëherë kushtet e zgjerimit të progresit bëjnë që individualistët të shprehin më shumë interes te pasmaterializmi dhe çështjet e cilësisë së jetës. Këto të fundit kanë lidhje me moralin, drejtësinë politike, dhe shijet apo ndjesitë personale, duke përfshirë feminizmin, pacifizmin, barazinë raciale, ekologjinë dhe të drejtat e kafshëve. Në këtë kuptim, ekologjia mund të shihet si një nga lëvizjet sociale më të reja që lindi në gjysmën e dytë të shek. XX, e bindur për një çështje të mbetur pezull e cila refuzon hierarkistët, materialistët dhe vlerat patriarkale të një shoqërie tradicionale [Egerton, F. N. 2001, f. 93–97]. Megjithatë, për një zgjerim sa më të madh se çdo lëvizje tjetër sociale, ekologjizmi ka plotësuar mendimin thelbësor dhe rinovues rreth natyrës së ndjenjave të njeriut. Të gjithë ekologjistët, për shembull, do të shijonin pak kënaqësi që zhvillimi njerëzor po del jashtë kontrollit: qeniet njerëzore janë lumturuar me të mirat materiale dhe “të diturit-si” por jo “të diturit-pse”, njerëzit kanë fituar aftësinë të plotësojnë nevojat materiale pa kërkuar të pyesin nëse këto ambicie janë të arsyeshme apo jo [Benson, Keith R. 2000]. Ashtu siç ka paralajmëruar Shumakeri “Njeriu tashmë është aq i zgjuar sa të mbijetojë pa mençurinë”. Megjithatë, disa ekologjistë të cekët, janë mosbesues kur ky kërkim për mençuri të tërheqë ekologjistët në fushën e mistike të fesë ose në Erën e Re të ideve. Murei Bukçini, për shembull, i portretizon tendenca këto si një formë “antihumanizmi”, duke argumentuar se duke krijuar një natyrë mitologjike, shprehet një dështim i vetëbesimit njerëzor dhe pothuaj një mospërfillje totale e çështjeve sociale. Disa të gjelbër, veçanërisht ekologjistët e thellë, nuk i kanë përqaftuar këto pikëpamje, të cilat janë krejtësisht të ndryshme me ato që kanë mbizotëruar mendimin politik në Perëndimin e zhvilluar. Kjo, argumentojnë ata, është baza e “ modelit të ecjes” që ekologjistët kërkojnë të sjellin, dhe pa ato të cilat janë të destinuara të përsëritin gabimet e politikave të vjetra, sepse ato nuk mund të lëvizin përtej koncepteve dhe bindjeve të tyre.

Ekologjistët e thellë zakonisht entuziazohen kur pranojnë se kanë si një shqisë një përmasë shpirtërore për vizionet politike. Afërsia me natyrën nuk paraqitet thjesht si një pozicionim teorik apo një qëndrim moral; ajo është në zemër, një përvojë njerëzore, një arritje e “ ndërgjegjes mjedisore”. Filozofi australian Uarvik Foksi shkon përtej ekologjisë së thellë dhe paraqet “ekologjinë ndërpersonale”, thelbi i së cilës është që qeniet njerëzore dhe të gjitha ekzistenca e tjera janë pjesë e një realiteti të vetëm. Për Nesin vetërealizimi arrihet përmes një identifikimi të gjerë dhe të thellë

me tjetrin. Ide të tilla janë krijuar e shprehur nga fetë lindore sidomos nga budizmi, e cili është portretizuar si një filozofi ekologjike. Një nga tezat kyçe të doktrinës budiste është ideja e “jounit”, nocioni që egoja individuale është një mit dhe një zhgënjim dhe që zgjimi ose ndriçimi përfshin kalimin e unit dhe njohjen se çdo person është i lidhur me të gjitha gjërat e tjera të gjalla, pra me vetë universin.

Kjo pikëpamje mund të shprehet si një lloj individualizmi holistik, në të cilin liria barazohet me përvojën e të “qenit” dhe realizimin e tërësisë organike. Këto ide u zhvilluan nga psikoanalisti gjerman Erik Fromi me veprën “Të Kesh apo Të Jesh” [2005]. Fromi portretizon “të pasurit” si një sjellje e mendjes që reflektohet qartësisht në një shoqëri materialiste dhe konsumuese, në të kundërt “të ekzistuarit” sjell kënaqësi nga përvoja dhe ndarja, dhe drejtohet nga rritja vetjake dhe të zotëruarit e diturisë shpirtërore. Megjithatë, Fromi nënvizon një ekzistencë të orientuar, e cila kërkon jo vetëm ndryshime socialpolitike, por asgjë më pak se ndryshimi i njerëzimit.

Ekologjia dhe Politikat

Ekologjistët e thellë refuzojnë kredon politike tradicionale thjesht si një version i ndryshëm i antropocentrizmit, mishërimit të një paragjykimi antinatyror. Ata pretendojnë se kanë zhvilluar një shembull të ri ideologjik, nëpërmjet aplikimit të rreptë të parimeve ekologjike dhe holistike. Megjithatë, ekologjistët e tjerë ofrojnë një tjetër inspirim, për më shumë apo për më pak zgjerim nga traditat e politikave. Një pozicion i tillë është bazuar mbi argumentin se këto tradita përmbajnë vlera dhe doktrina të cilat janë të afta për të rregulluar një vizion pozitiv për natyrën jonjerëzore, duke evidentuar shkakun e krizës ekologjike dhe mënyrën për ta parandaluar. Në këtë vijë kuptimi, ekologjizmi, si nacionalizmi dhe feminizmi, mund të shihet si një udhëkryq idesh. Në kohë të ndryshme konservatorët, fashistët, anarkistët, feministët dhe liberalët kanë shfaqur një simpati të veçantë për mjedisin. Megjithatë, ata i shtrojnë idetë ekologjike në mbështetje të qëllimeve të ndryshme politike [Kingsland, S. 2004, f. 367–374]. Më domethënëset janë:

Ekologjizmi i djathtë

Ekosocializmi

Ekoanarkizmi

Ekofeminizmi

Ekologjizmi i Djathtë

Megjithëse politikat e reja të të gjelbërve janë të lidhura me qëllimet dhe përkatësitë që zakonisht janë parë si të majta, si ato të deqendërimit dhe veprimit të drejtpërdrejtë dhe në kundërshtimin e hierarkisë dhe të materializmit, shfaqjet e para të

ekologjisë politike kishin një orientim tërësisht të djathtë. Kjo u tregua më tepër nga një formë fashiste ekologjiste gjatë periudhës së nazizmit në Gjermani. EkspONENTI kryesor i saj ishte Walter Darre [http://en.wikipedia.org/wiki/Richard_Walther_Darr%C3%A9], i cili ishte Ministër i Bujqësisë dhe lider i nazistëve fshatarë.

Si kundërpërgjigje ndaj zhvillimit të shpejtë industrial, në fund të shek. XIX kishte krijuar një lëvizje të simbolizuar me kërkesën “prapa në tokë”. Anëtarë të kësaj ishin kryesisht të rinj dhe studentë. Lëvizja e të rinjve gjermanë krijoi Wandervoegel, banda studentësh të cilët rrinin pyjeve dhe maleve për t’i shpëtuar jetës urbane. Idetë e Darres ishin përzjerje e racizmit verior me idealizimin e jetës rurale të fshatarit, e të shkrirë në një filozofi agrare “Gjak dhe Tokë” [Richard Walther Darré, 1985], e cila përkonte me socializmin nacionalist. Vetë nazizmi ishte i lidhur me një formë vitalizmi, që vinte theksin në rolin e forcës së jetës shpirtërore dhe ishte shumë larg çdo forme materializmi. Si një udhëheqës i fshatarëve, Darre ishte përgjegjës për hartimin e ligjit të trashëgimisë për fermën, i cili u jepte pronarëve me ferma të përmasave të vogla dhe mesatare siguri të plotë dhe ofronte themelimin e “ndërtesës kombëtare të ushqimit” në tregun e prodhimit bujqësor me qëllimin që çmimet e ushqimit të mbaheshin të larta për të zhvilluar jetën rurale.

Pavarësisht, lidhjeve të tij me nazizmin, idetë e Darres përmbajnë pika të përbashkëta me lëvizjet moderne të gjelbra. Në radhë të parë, ai ishte i bindur se vetëm nëse jetohej pranë natyrës dhe në tokë mund të siguroheshin përfitime të vërteta, prandaj ai dëshironte të krijonte një Gjermani agrare. Ide të tilla u imituan nga ekologjistët e rinj, si Eduard Goldsmithi [The Ecologist, 1969]. Për më tepër, Darre u bë një avokat i bujqësisë organike, që përdorte pleh natyror si ai i kafshëve. Darre besonte në një cikël organik kafshë – tokë – ushqim – njerëz, të cilin ai e përvetësoi nga filozofi austriak Rudolf Shtaineri (1861-1925). Bujqësia organike pasqyron parimet ekologjike dhe paraqitet si një mjet shpëtimi i shprehur në idetë bujqësore mjedisore. Gjatë periudhës së Rajhut III ideologjia agrare e Darres u siguroi nazistëve një mbështetje në fshatrat gjermane. Megjithatë, sa do që ishte një shkencëtar racist, Darre vetë nuk ishte një nazist dhe publikisht e distancoi veten nga parimet e Fyhrerit dhe gjithashtu nga diskutimi mbi zgjerimin e perandorisë. Në realitet, regjimi nazist bëri pak për të plotësuar ëndrrat e një fshatari energjik. Pavarësisht dashurisë së Hitlerit për idenë “Gjak dhe Tokë”, këmbëngulja për zgjerim territorial me

anë të luftës intensifikoi procesin e industrializimit në Gjermani dhe solli varfëri në fshatrat e saj.

Të djathtët e moderuar konservatorë gjithashtu miratojnë çështjet mjedisore. Ekokonservatizmi [John Gray, Routledge, 1995] pasqyron një mbrojtje rurale për kërcënimin e jetës nga rritja e numrit të qyteteve. Ky është një reagim kundër industrializimit dhe idesë për “progres”. Kjo nuk përkufizon ndërtimin e një shoqërie pasindustriale, të bazuar në parimet e bashkëpunimit dhe ekologjisë, por një rikthim në epokën paraindustriale. Ndeshmëri të tilla ndaj mjedisit fokusohen mbi çështjet e ruajtjes dhe mbi sjelljet për të mbrojtur trashëgiminë natyrore, si pyjet dhe gjithçka tjetër më shumë se një trashëgimi arkitekturor. Ruajtja e natyrës është gjithashtu e lidhur me mbrojtjen e vlerave tradicionale dhe institucionale. Ekologjia paraqitet si një rikthim në të shkuarën feudale, me parimin e tokës në zotërim të një minoriteti dhe një kontrolli politik nga lart. Për shembull, Eduard Goldsmithi ambientalist anglez, ka argumentuar se një shoqëri ekologjike do të përfshinte një rilindje të rregullit të vjetër brenda familjes dhe komunitetit, që në të vërtetë do të thotë ndërtimin e një qeverie autoritare të fortë.

Ekosocializmi

Ka një dallim brenda lëvizjes së të gjelbërve që është shprehur veçanërisht midis të gjelbërve gjermanë, disa prej të cilëve kanë qenë pjesëtarë të grupeve të skajshme të majta. Ekosocializmi shpesh identifikohet me analizat marksiste dhe zakonisht ka kundërshtuar idetë fetare, të cilat po ndikojnë kudo në lëvizjet mjedisore [Kovel, J.; Löwy, M. 2001]. Për shembull, Rudolf Bahro [1984], një drejtues ekosocialist gjerman, argumenton se kapitalizmi është shkaku kryesor i problemeve mjedisore. Bota natyrore është plaçkitur nga industrializimi, si pasojë e kërkimit dhe përpjekjeve kapitaliste. Pra, kapitalizmi nuk është karakterizuar vetëm nga lufta e klasave, por edhe nga shkatërrimi i natyrës. Të dyja bashkë, si puna njerëzore, ashtu edhe natyra, janë shfrytëzuar, sepse ato janë trajtuar thjesht si resurse ekonomike. Çdo përpjekje për të përmirësuar mjedisin përfshin një proces ndryshimi themelor social, një lloj revolucioni social. Megjithatë, pozicioni i Marksit në lidhje me natyrën është produkt i disa debateve. Ndërsa disa e shohin bindjen e tij në zhvillimin progresiv dhe prodhues të forcave si një paraqitje të industrializimit, të tjerë kanë argumentuar që përshkrimi i punës në shkrimet e tij të para si një humanizim i natyrës dhe natyralizim i njeriut, ka një karakter të padyshueshëm ekologjik.

Në thelb të temës së ekosocializmit qëndron ideja se kapitalizmi është armiku kryesor i mjedisit,

ndërsa socializmi është miku i tij. Megjithatë, si me feminizmin socialist, një formulë e tillë mishëron një tension midis dy elementëve, kësaj here midis prioriteteve të “të kuqve” dhe “të gjelbërve”. Nëse katastrofa mjedisore nuk paraqitet më shumë se një produkt i blertë i kapitalizmit, problemet mjedisore shihen si mjetet më të mira për ta hequr kapitalizmin, ose të paktën ta zbusin atë. Prandaj, ekologjistët nuk ndajnë partitë e blerta ose themelojnë organizata mjedisore të kufizuara, por pranojnë të punojnë brenda lëvizjes socialiste dhe të drejtojnë çështjet e sistemit ekonomik. Në anën tjetër, socializmi është parë si një tjetër kredo politike “pro prodhimit”: ajo përfshin shfrytëzimin e pasurive të planetit me moton për të mirën e njerëzimit sesa thjesht për klasën kapitaliste. Partitë socialiste kanë qenë të ngathëta në adaptimin e politikave mjedisore sepse ato, si partitë e tjera, vazhdojnë të bazojnë programin elektorale mbi premtimin për rritjen ekonomike. Si rezultat, ekologjistët kanë qenë shpesh ngurrues të renditit të gjelbrit me të kuqtë, që prej thirrjes nga të gjelbri gjermanë “as majtas as djathtas” [Norberto Bobbio, 1996]. Në të vërtetë, ekosocialistët kanë arritur në përfundimin që kriza ekologjike është zhvilluar aq shumë, sa i duhet paraprirë përtej luftës së klasave.

Ekosocialistët mendojnë se socializmi është me natyrë ekologjike. Nëse pasuria do të ishte e përbashkët ajo do të përdorej në interes të së gjithëve, që do të thotë në të mirë të njerëzimit. Megjithatë, problemet ekologjike nuk mund të zgjidhen thjesht me një këmbim të pronarit të pasurisë. Kjo u tregua qartë nga përvoja e shteteve socialiste, si Bashkimi Sovjetik dhe Evropa Lindore, të cilët shkaktuan disa nga problemet më të vështira mjedisore. Në vitin 1960, për shembull, dy lumenjtë kryesorë që ushqenin detin Aral në Azinë Qendrore sovjetike u devijuan për të ujitur fushat me oriz dhe pambuk. Si rezultat, deti Aral, një nga katër liqenet më të mëdha në botë, ishte pakësuar dhe brigjet e tij ishin tërhequr në disa vende deri në 100 km, duke lënë një shkretëtirë kripe të ndotur. Një nga katastrofat më të mëdha ekologjike në Evropën Lindore ka qenë shpërthimi bërthamor i Çernobilit në Ukrainë në vitin 1986, shkalla e ndotjes e të cilit e detyroi regjimin sovjetik me një çiltërsi të shkëlqyer rreth problemeve mjedisore në përgjithësi. Në erën paskomuniste grupet ambientaliste kanë lindur në të gjitha shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik. Megjithatë, është e dukshme që ndryshe nga lëvizjet e gjelbra në Perëndim, këto grupe rrallë e përkrahin ekosocializmin dhe zakonisht janë të lidhura me doktrinat politike konservative dhe reaksionare.

Ekoanarkizmi

Ndoshta ideologjia, e cila ka pasur pretendimin më të mirë për ndjeshmërinë ndaj mjedisit, është anarkizmi [Corin Bruce, August 29, 2014]. Disa muaj para publikimit të veprës së Rashel Karsonit “Pranvera e Heshtur” [1962], Marrej Bukçini kishte nxjerrë punimin “Mjedisi ynë sintetik” [1962]. Bukçini ka sugjeruar se ka një përputhje midis idesë së anarkizmit dhe parimeve të ekologjisë, të shprehura në idenë e “ekologjisë sociale”, besimi se balanca ekologjike është organizimi më i sigurt për stabilitet social. Anarkistët besojnë në një shoqëri të shëndoshë, në të cilën ka harmoni dhe solidaritet social midis njerëzve. Pasuria e një shoqërie të tillë është bazuar mbi diversitetin dhe variacionin. Ekologjistët gjithashtu besojnë se balanca dhe harmonia spontane zhvillojnë gjithë natyrën në formën e ekosistemit dhe si e tillë si komunitet anarkist nuk kërkon kontroll të jashtëm nga qeveria brenda shoqërisë njerëzore. Prandaj, Bukçini e krahason një komunitet anarkist me një ekosistem, dhe sugjeron se të dyja dallohen nga parimet e diversitetit, balancës dhe harmonisë.

Anarkistët kanë mbrojtur gjithashtu idenë për ndërtimin e një shoqërie të dependëzuar, e organizuar si një zinxhir komunash ose fshatrash. Jeta në komunitete të tilla do të ishte afër natyrës; ato do të prodhonin ushqim dhe një rreze të gjerë të mirash dhe shërbimesh, që përfshijnë bujqësinë, punët e artizanatit dhe një shkallë të vogël të industrisë. Vetëmbeshtetja do të bënte çdo komunitet të varur nga mjedisi natyror, duke shfaqur spontanisht një lidhje të ngushtë me mjedisin. Në vizionin e Bukçinit dependëzimi do të çonte në një përdorim më të arsyeshëm dhe më të dashur të mjedisit. Një shoqëri e rregulluar nga simpatia spontane midis njerëzve është gjithashtu premtuese për të vendosur një balancë ekologjike midis njerëzve dhe natyrës.

Koncepti që kanë disa ekologjistë për shoqërinë paskomuniste ka qenë i ndikuar nga shkrimet e Kropotkin [Paris 1892] dhe Uilliams Morrisit. Lëvizja e gjelbër ka përshtatur gjithashtu idenë e dependëzimit, demokracisë pjesëmarrëse dhe veprimit të drejtpërdrejtë nga anarkistët. Megjithatë, edhe kur anarkizmi përkrahet si një vizion i sigurt ekologjik për të ardhmen, ai rrallë është pranuar si mjet. Anarkistët besojnë se progresi do bëhet i mundur vetëm kur qeveria dhe të gjitha format e tjera të autoritetit politik do të përmbysen. Në të kundërt, disa të tjerë në lëvizjen e gjelbër e shohin qeverinë si një agjenci nëpërmjet së cilës mund të organizohen veprime kolektive dhe gjithashtu si mjeti më i mirë nëpërmjet së cilës kriza mjedisore mund të menaxhohet. Ato shqetësohen se dobësimi i qeverive nuk do të mund të frenojë ato

forca, të cilat sollën industrializimin dhe dëmtuan mjedisin natyror në radhë të parë.

Ekofeminizmi

Ideja që feminizmi paraqet një afrim të dallueshëm në çështjen e gjelbër ka arritur deri në atë pikë sa ekofeminizmi është zhvilluar si një nga shkollat më të mëdha të mendimit mjedisor [MacGregor, Sherilyn, 2006, f. 286]. Përdorimi i këtij termi mendohet se i takon autores franceze Fransuaze d'Obonë në librin e saj "Feminizmi ose Vdekja" [1974] Tema kryesore është që shkatërrimi i natyrës i ka origjinat e tij në sistemi patriarkal: natyra është nën kërcënim jo nga specia njerëzore, por nga njeriu dhe institucionet e pushtetit mashkullor. Feministët, të cilët adaptojnë një vizion uniseks për natyrën njerëzore, argumentojnë që patriarkalizmi ka shtrembëruar instinktet dhe ndjeshmëritë e njeriut, duke e ndarë ata nga bota "private" e sjelljes dhe marrëdhënieve vetjake. Në këtë mënyrë, ndarja seksuale e punës priret t'i japë përparësi burrit që të urdhërojë si natyrën, ashtu dhe njeriun dhe duke e parë veten superior ndaj tyre. Nga kjo pikëpamje ekofeminizmi mund të klasifikohet si një formë e veçantë e ekologjisë sociale. Megjithatë disa ekofeministë pajtohen me esencializmin sepse teoritë e tyre janë bazuar mbi besimin që midis femrave dhe meshkujve nuk ka asnjë dallim,

Një këndvështrim i tillë është mbajtur nga Mari Dali te vepra "Ekologjia Gjinore" [1978]. Dali argumenton se femrat do ta lironin veten nga kultura patriarkale nëse do ta rreshtonin veten me "natyrën femërore". Nocioni i një lidhjeje të brendshme midis femrave dhe natyrës nuk është i ri. Fetë para-kristiane dhe të qytetërimeve të hershme shpesh e portretizonin botën si një perëndeshë, një ide e rilindur në hipotezat e Gaias [The Book People, Haydock, 1995, f. 215]. Ekofeministët modernë theksojnë bazën biologjike për afërsinë e femrave me natyrën, në veçanti faktin që ato lindin fëmijë dhe rritin foshnja. Fakti që femrat nuk mund të jetojnë të ndara nga ritmet e natyrës dhe të proceseve strukturojnë orientimin e tyre politik-kulturor. Vlerat tradicionale femërore përfshijnë reciprocitetin, bashkëpunimin dhe edukimin, vlera të cilat kanë një karakter të lehtë ekologjik. Ideja që natyra është një resurs që duhet shfrytëzuar është më e neveritshme për një grua se për një burrë, sepse ata e dinë që natyra vepron brenda dhe ndërmjet tyre dhe intuitivisht ndjen që përfitimi vetjak buron duke vepruar me natyrën sesa kundër saj. Përmbysja e patriarkalizmit shihet si një lidhje midis shoqërisë njerëzore dhe natyrës [Gender Across Borders, March 22, 2012].

Për ekofeministët nëse midis femrave dhe natyrës ka një lidhje natyrore, lidhja midis meshkujve dhe natyrës është krejt ndryshe. Për ta, femrat janë krijesa të natyrës, ndërsa meshkujt janë krijesa të kulturës: bota e tyre është artificiale, e bërë nga vet ata, një produkt i zgjuarsisë njerëzore sesa një krijim natyror. Në botën mashkullore intelektu vendoset para intuitës, materializmi vlerësohet para spiritualizmit dhe marrëdhëniet mekanike janë të theksuara më shumë se ato holistike. Patriarkalizmi në këtë vizion vendos superioritetin e kulturës mbi natyrën, qenia jo më shumë sesa një forcë që duhet ushtruar dhe shfrytëzuar. Shkatërrimi ekologjik dhe pabarazia gjinore janë pjesë i të njëjtit proces, në të cilin burrat e kulturuar qëndrojnë mbi femrat natyrore [Gaard, Greta, 2011, f. 23/2].

Ekologjia në shekullin XXI

Perspektiva për ekologjizmin në shek. XXI po shfaqet e lidhur ngushtë me gjendjen e krizës mjedisore dhe me një nivel të përgjithshëm kuptimi mbi çështjet dhe problemet mjedisore. Në fakt, me rritjen e dëmtimit të natyrës ndryshimi i motit si rezultat i ngrohjes globale ka ulur edhe nivelet e fertilitetit të femrat si pasojë e ndotjes, zhdukjes së kafshëve dhe specieve bimore në planet, ka nxjerrë nevojën për një alternativë. E ardhmja e partive të gjelbra dhe e grupeve mjedisore nuk mund të ndahen nga forcimi i ideve dhe vlerave ekologjike. Një nga problemet i cili i vë përballë partitë e gjelbra në ideologjinë e tyre është se shumë parti të tjera kanë kapur pozicionin e ekomiqësisë. Gjithashtu, është prezente që grupet mjedisore dhe aktivistët ekologjistë kanë dalë dukshëm brenda lëvizjes emergjente antiglobalizim. Nga kjo perspektivë, njerëzit nuk do të kenë mundësi zgjedhjeje në shek. XXI veçse të hedhin poshtë të gjitha praktikatat që kanë sjellë shkatërrimin natyror [The Green Rainbow, 1998, f. 75-81].

Objektivat programatike të Partisë së Gjelbër

Partia e Gjelbër është formalisht e organizuar nga pikëpamjet politike të mbështetura në parimet e politikave të gjelbra, si drejtësia shoqërore dhe jo dhunës. Të gjelbrit besojnë se këto parime janë trashëguar nga ideja për të ndërtuar një Botë në paqe. Platforma e PGJ përqafon politikat ekonomike socialdemokrate dhe formon koalicion veçanërisht me të majtët. Ka PGJ në rreth 90 vende të Botës dhe shumica e tyre janë anëtarë të të Gjelbërve Globalë [<http://www.globalgreens.org/>]. Në pjesën më të madhe të programit të tyre, politikat ekologjike kanë si objektiv kryesor mbrojtjen e mjedisit. Ato synojnë plotësimin e një sërë kërkesash, si: "kufizimi i shfrytëzimit të lëndëve të para minerare dhe të lëndëve djegëse", "çmontimin e pjesshëm dhe

konvertimin e sistemit industrial”, “pezullimin e ndërtimit të stacioneve bërthamore”, “shqendërzimin e prodhimit të energjisë”, “mbështetjen e drejtpërdrejtë të të ardhurave për fermerët, që i përmbaheshin prodhimeve ekologjike, si dhe subvencionimin e fermave të vogla e të mesme”, vendosjen e taksave mbi prodhimet ndotëse të mjedisit, të shfrytëzimit të burimeve energjetike dhe konsumit të ujit” [http://en.wikipedia.org/wiki/Global_Greens_Charter].

Politikat ekonomike, ndërsa pranojnë rëndësinë e mekanizmave të tregut i japin përparësi zhvillimit “të ekonomisë me përgjegjësi sociale”, çka për të gjelbrit nënkupton motivin e prodhimit, të nxitur jo nga “fitimet maksimale”, por nga “plotësimi i nevojave të popullit”. Për këtë, kërkohet zbatimi i “organizmave të rinj të vendministrimit”, krijimin e “fondeve vetadministruese për zhvillimin e metodave alternative të prodhimit ekonomik”, ndërmarrjen e “masave antitrust” për “shqendërzimin e drejtimit të njësive të prodhimit”, “shpërbërjen e konglomerateve të mëdhenj në njësi ekonomike të vogla” dhe “kalimin e burimeve natyrore, të tokës, të mjeteve të prodhimit dhe të bankave në forma të reja të pronësisë së shoqërizuar”.

Programi [http://www.globalgreens.org/statements/rio_planetary_meeting] thekson në mënyrë të veçantë të ashtuquajturin “partneritet aktiv si me mjedisin, ashtu edhe me qeniet humane, të realizuar sidomos nëpërmjet njësive ekonomike e administrative të vogla, vetërregulluese dhe vetëqeverisëse”.

Vend të rëndësishëm në politikat ekonomike zënë “marrëdhëniet industriale”. Të gjelbrit kërkojnë rivlerësimin e “co-determination”, me synimin që të forcohet “kontrolli demokratik i punëtorëve dhe i këshillave sociale e ekonomike mbi kompanitë në përgjithësi e sidomos në zgjidhjen e problemeve sociale, ekologjike dhe për zbatimin e teknologjive të reja”.

Vend edhe më të rëndësishëm zënë politikat sociale në kuadrin e Shtetit të Mirëqenies Sociale. Ato përmbajnë: “shtrirjen e mëtejshme të infrastrukturës sociale”, “rritjen e mundësive për vetëmbështetjen dhe nismat vetjake me mbështetje publike për to”, “pagesa për afatet e zgjatura të papunësisë”, “pagesa transfero për kujdesin shëndetësor dhe mirërritjen e fëmijëve”, “shtimin e të drejtave për pacientët dhe kontrollin e çmimeve në shëndetësi”.

Edhe më të veçanta janë politikat për “shpërndarjen e të ardhurave dhe të pasurisë”. Ato përmbajnë objektiva për “ndryshimin tërësor të

shpërndarjes së pabarabartë të të ardhurave dhe të pasurisë”, sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për të gjithë”, “shpërndarjen e re në krijimin e pasurive dhe në sistemin e taksave”, pjesëmarrjen e punëtorëve me aksione në kapitalin prodhues”, marrëveshjet për paga e garantimin e të ardhurave për grupet me të ardhura të ulëta”, “shpërndarjen shumë më të barabartë të të ardhurave”. Kërkesat e të gjelbërve nënkuptojnë një lloj rikthimi në “taksën negative mbi të ardhurat”, me të cilën synohet që të gjithë të jenë të garantuar me minimumin jetik, pavarësisht nga qenia i papunë, i moshuar ose i sëmurë.

Objektiva të tjerë kanë si synim rritjen e lirit të grave në shoqëri nëpërmjet ndërmarrjen së masave për “punësimin me përparësi të tyre dhe likuidimin e plotë të diskriminimit në punë”, “vendosjen e pagave dhe të pensioneve për shtëpiakët”, “kompensimin me pagën e plotë për rastet e kujdesit të tyre për fëmijët e sëmurë”.

Nëpërmjet një kapitulli të veçantë të programit paraqiten kërkesat e të gjelbërve për “liritë dhe të drejtat civile të individit”. Ato kundërshtojnë të gjitha format dhe metodat e mbikëqyrjes shtetërore”, “shfuqizimin e të gjithë ligjeve që kufizonin lirinë e shprehjes”, “çarmatosjen e forcave policore”, “zbatimin e legjislacionit antitrust për masmediat”, “zhdukjen e çdo diskriminimi ndaj homoseksualëve”, “legalizimin e abortit” dhe vendosjen e “barazisë sociale, juridike e politike për të huajt”.

Demokracia e drejtpërdrejtë në alternativën e të gjelbërve nënkupton, në radhë të parë, pjesëmarrjen e shqendërzuar të masave të gjera të popullsisë në vendimmarrjet politike. “Ne, thuhet në program, jemi aktivë në të gjithë arenën politike: në shkallë vendore, rajonale dh në zgjedhjet kombëtare. Ne shpresojmë të vendosim procesin vital të marrjes së vendimeve mbi bazën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të masave duke i dhënë të drejta sa më të mëdha vendimmarrëse atyre, që janë objekt i këtyre vendimeve”. Për këtë, të gjelbrit i përmbaheshin zbatimit të mekanizmave dhe organizimit të institucioneve të tilla, si: “këshillat sociale dhe ekonomike në të gjitha nivelet, që vendosnin për buxhetin dhe investimet publike”, “petitionet për referendume”, “shqendërzimi dhe thjeshtëzimi i strukturave administrative dhe vendosja e autonomisë sa më të madhe”, “demokratizimi i mëtejshëm i sindikatave” dhe “autonomia individuale sa më e madhe” [http://en.wikipedia.org/wiki/Global_Greens_Charter].

PËRFUNDIME

Megjithatë, një numër problemesh përballen me

teoritë ekologjike.

Në radhë të parë, mbetet e vështirë sesi ideja për të trajtuar problemet ekologjike mund të globalizohet. Edhe pse shtetet në zhvillim janë të shqetësuara, duket se për ato do të jetë shumë e largët dita që të arrijnë vendet e zhvilluara perëndimore, për të mos thënë e pamundur.

Këto shtete kanë zhvilluar në një shkallë të lartë industrializimin, rritën shfrytëzimin e resurseve të kufizuara pa ndalur ndotjen e mjedisit, praktika të cilat

sot ndalohen në botën e zhvilluar.

Megjithatë, Perëndimi i industrializuar ka mundësi të jetë më i gatshëm të adaptojë përparësitë ekologjike edhe se kjo do të thotë që ai është konsumatori më i madh i energjive dhe resurseve.

Së dyti, industrializimi dhe vlerat parandaluese të tij, si një individualizim dhe konsumim konkurrues, është bërë kryesisht si rezultat i globalizimit ekonomik. Globalizimi në këtë kuptim mund të shihet si një hiperglobalizim. Lidhja midis ekologjisë dhe lëvizjes antiglobaliste nuk është një rastësi.

Së treti, vështirësitë për politika mjedisore ofrojnë mesazhin kundër rritjes ekonomike, por politikat e kundërritjes mund të mos jenë tërheqëse për popullin dhe të pamundura nga ana elektorale.

Së katërti, lëvizja e gjelbër mund të jetë vetëm një sjellje urbane, një formë e postromantizmit. Kjo sugjeron se dija mbi mjedisin është thjesht një reagim i përkohshëm kundrejt përparimit industrial [Beck, Ulrich, 1995, f. 304].

Megjithatë, sfida më e madhe që ekologjizmi do të përballojë është shkalla e ndryshimit për të cilin ai bën thirrje. Në thelb ekologjizmi është më radikal se socializmi, feminizmi apo shumica e rrymave politike aktuale. Ai nuk kërkon thjesht ndryshimin e sistemit ekonomik apo riorganizimin e marrëdhënieve brenda sistemit politik. Ai kërkon të vendosë më shumë se një modë të re të jetuari, një mënyrë ndryshe të ekzistencës dhe të kuptimit për ekzistencën. Për më tepër, teoritë e tij, vlerat e tij janë të veçanta nga ato, të cilat kanë mbizotëruar deri tani shoqëritë e industrializuara.

BIBLIOGRAFI

Abraham Harold Maslow, (1943) Hierarchy of needs, Psychosomatic Medicine, 1943, 5, f. 85-92.

Abraham Harold, (1943). "A theory of human motivation". Psychological Review 50 (4): f.370–396.

Aldo Leopold, (1949) "A Sand County Almanac And Sketches Here and There", [Oxford University Press](#), 240 fq. ISBN 0-19-500777-8.

Amory B. Lovins (1979), "Soft Energy Paths: Toward a Durable Peace", Harper Colophon Books, f. 38.

Andrew Heywood (March 2012, 5th edition) "The Political Ideology" Palgrave Macmillan, United Kingdom, ISBN: 9780230367241.

[Andrew Heywood](#), "The Political Ideologies, An Introduction" / Edition 2, April 2002, Palgrave Macmillan, ISBN-13:9780333698877

Arne Naess & George Sessions (1984), "The Deep Ecology Platform" në

<http://www.deepecology.org/platform.htm>

Arne Næss, (1973) "The Shallow and the Deep, Long-Range Ecology Movement" Inquiry 16: 95-100

Barry Commoner, The Closing Circle: Conforting the Environmental Cries, New York: Beekman, 1993, f. 67

Biodiversity refers to the variety of life and its processes. It includes the variety of living organisms, the genetic differences among them, the communities and ecosystems in which they occur, and the ecological and evolutionary processes that keep them functioning, yet ever changing and adapting.

Corin Bruce, in Freedom "Green Anarchism: Towards the Abolition of Hierarchy", August 29, 2014.

Daly, Herman (Lead Author); Robert Costanza (Topic Editor), 2009. "From a Failed Growth Economy to a Steady-State Economy." në Encyclopedia of Earth. Eds. Cutler J. Cleveland (Washington, D.C.: Environmental Information Coalition, National Council for Science and the Environment. The Encyclopedia of Earth 5 June 2009; Retrieved 17 August 2009).

David Ehrenfeld, The Arrogance of Humanism, New York: Oxford University Press (1978).

Ecofeminism: Is the Movement Still Relevant?; Gender Across Borders, March 22, 2012.

Edward René David Goldsmith, (1969), The Ecologist, editors Robert Allen, [Jean Liedloff](#), and Peter Bunyard.

Egerton, F. N. "A history of the ecological sciences: early Greek origins". Bulletin of the Ecological Society of America 82 (1): 93–97, 2001.

Erich Fromm, (2005) To Have or to Be? The Nature of the Psyche, Bloomsbury Academic, ISBN 0826417388, 9780826417381

Ernst Friedrich "Fritz" Schumacher, (1973) "Small Is Beautiful: A Study of Economics As If People Mattered", Blond & Briggs collection.

Ernst Haeckel (1866): Termi ekologji vjen nga greqishtja: οἶκος, "shtëpi"; -λογία, "studimi i".

Françoise d' Eaubonne,(1974) "Le Féminisme ou la Mort", Paris, P. Horay.

Fritjof Capra, (1975) "The Tao of Physics": An Exploration of the Parallels Between Modern Physics and Eastern Mysticism, Shambhala Publications of Berkeley, California.

Fritjof Capra, (1984) "The Turning Point, Science, Society, and the Rising Culture", Paperback – August 1, 1984.

Gaard, Greta (2011). "Ecofeminism Revisited: Rejecting Essentialism and Re-Placing Species in a Material Feminist Environmentalism". *Feminist Formations* 23 (2).

Gaia njohet si Toka ose Toka Nënë (nga mitologjia greke). Larousse Desk Reference Encyclopedia, The Book People, Haydock, 1995, p. 215.

Gender Across Borders, March 22, 2012, "Ecofeminism: Is the Movement Still Relevant?".

Heisenberg, W. (1927), "Über den anschaulichen Inhalt der quantentheoretischen Kinematik und Mechanik", *Zeitschrift für Physik* (in German) 43 (3–4): f. 172–198.

Herman Daly, (1974), *Toward a Steady-State Economics*, Island Press, 1 edition.

<http://de.wikipedia.org/wiki/Realo>

[http://en.wikipedia.org/wiki/Fundi_\(politics\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Fundi_(politics))

http://en.wikipedia.org/wiki/Global_Greens_Charter

http://en.wikipedia.org/wiki/Global_Greens_Charter

<http://www.biography.com/people/john-locke-9384544>

<http://www.economical-ecology.com/>

<http://www.globalgreens.org/>

http://www.globalgreens.org/statements/rio_planetary_meeting

Instituti për Politika Evropiane të Mjedisit vlerëson se trupi i ligjit mjedisor të BE-së përbëhet edhe nga mbi 500 Direktiva, Rregullore dhe Vendime.

Joel Kovel & Michael Löwy Kovel, (2001), "An ecosocialist manifesto", *nw Green from below*.

John Gray, (1995) "Beyond the New Right", Routledge, ISBN 978-0-415-10706-8, ISBN 978-0-415-10706-8.

John Locke (1689), "Two Treatises of Government: In the Former, The False Principles, and Foundation of Sir Robert Filmer, and His Folloëers, Are Detected and Overthrown. The Latter Is an Essay Concerning The True Original, Extent, and End of Civil Government", *Awncsham Churchill*.

Jonathan Schell (1982) "The Fate of the Earth", New York, Knopf, f. 25

Jordan, A.J. and C. Adelle, (2012) "Environmental Policy in the European Union: Contexts, Actors and Policy Dynamics (3e), Earthscan: London and Sterling, VA.

Keith R. Benson, (2000)"The emergence of ecology from natural history", [Endeavour, Volume 24, Issue 2](#), 1 June 2000, Pages 59–62, Elsevier Science Ltd.

Kenneth Ewart Boulding, (1966), në "The Economics of the Coming Spaceship Earth", Baltimore, MD: Resources for the Future/Johns Hopkins University Press.

Lovelock, James (1995) dhe (1988). "Ages of Gaia", Oxford University Press. ISBN 0-393-31239-9.

Lovelock, James, (1979) "Gaia A new look at life on Earth", Oxford University Press, original from the University of Michigan, ISBN 019217665X, 9780192176653.

MacGregor, Sherilyn (2006), "Beyond mothering earth: ecological citizenship and the politics of care", Vancouver: UBC Press. f. 286. ISBN 0-7748-1201

Mary Daly, (1978), "Gyn/Ecology: The Metaethics of Radical Feminism", Beacon Press, ISBN 0-8070-1510-5.

Murray Bookchin (1962), "Our Synthetic Environment" New York: Knopf (published under the pseudonym "Lewis Herber").

Norberto Bobbio, (1996) *Droite et gauche: essai sur une distinction politique*, Édition française : Éditions du Seuil, Paris.

Peter Albert David Singer, "Animal Liberation: A New Ethics for our Treatment of Animals", New York Review/Random House, New York, 1975; Cape, London, 1976; Avon, New York, 1977; Paladin, London, 1977; Thorsons, London, 1983. Harper Perennial Modern Classics, New York, 2009.

Prince Pyotr Alexeyevich Kropotkin, (1892) "La conquete du pain", Tresse et Stock, Paris.

Rachel Louise Carson, (September 27, 1962) "Silent Spring", Houghton Mifflin.

Reed F. Noss & Allen Y. Cooperrider (1994), "Saving Nature's Legacy: Protecting and Restoring Biodiversity", Island Press. p. 443. ISBN 978-1-55963-248-5.

Richard Walther Darré: http://en.wikipedia.org/wiki/Richard_Walther_Darr%C3%A9

Rudolf Bahro, (1984) "From Red To Green", *New Left Review*, original from the University of Michigan.

Russell J. Dalton, (1994) "The Green Rainbow: Environmental Groups in Western Europe", Yale University Press, f. 75-81.

Sharon Kingsland, (2004). "Conveying the intellectual challenge of ecology: An historical perspective". *Frontiers in Ecology and the Environment* 2 (7): 367–374, The Ecological Society of America.

Smuts J.C. (1926) "Holism and Evolution", Macmillan and Co., Limited, London.

The Columbia Encyclopedia, Sixth Edition. Columbia University Press. 2004. Retrieved 2010-11-12.

The Environmental Mandate: Activists and Electorate, Harvard University, 2003, f. 127

Tom Regan, *The Case for Animal Rights*, University of California Press (1983, 1985, 2004).

Ulrich Beck, (1995) "Ecological Politics in an Age of Risk", Cambridge: Polity Press, f. 304.

Ulrich Beck, (1998) "World Risk Society", Cambridge: Polity Press.

[Walther Darré](#) & [Anna Bramwell](#), (1985) "Blood and Soil: Richard Walther Darré and Hitler's 'Green Party'", Kensal Press, ISBN13: 9780946041336

EPËRSIA MORALE TE FILOZOFËT E ANTIKËTIT GREQ

ARDIAN MATKA

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE SHKENCAVE HUMANE
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Përmbledhje

"Çdo njeri, cilido qoftë, edhe në më të diturit, në e shpalltë veten për këpucar edhe kur s'është i tillë, shteti nuk humbet gjë shumë - Athinasit do të ecin me këpucë të dobëta, por edukonjësit e rinisë, sikur të mos jenë edukonjësit të vërtetë, pra sikur të mos përmbushin detyrat e veta - pasojat do të jenë të mjerueshme, sa s'mund të numërohen", Platoni. "Pa etikën, çdo gjë do të ndodhte sikur ne të gjithë të ishim pesë miliard udhëtarë, të hipur në një makinë të madhe që nuk e drejton asnjë njeri. Ajo lëviz gjithnjë e më shpejt por ne nuk e dimë se ku shkon...", Jacques Cousteau. Virtyti konsiderohet si një veti e çmueshme e karakterit të mirë të njeriut, është prirja dhe aftësia e një njeriu të tejkalojë në diçka dhe mbi diçka, të kryejë një veprim të caktuar në mënyrën më të mirë.

Duke iu referuar antikitetit, pesë virtytet klasike, kryesore konsiderohen:

- Pjekuria e kuptuar, si: urtësi, mençuri, dituri;
- Drejtësia;
- Fuqia në kuptimin e guximit;
- Maturia;
- Morali.

Fjalët çelës: *morali, etika, filozofia, virtyti.*

Abstract

"Every man, whoever he is, even the most wiser, declares himself a shoemaker even when it is not, the State does not lose much - Athenians will walk with weak shoes, but if youth educators are not true educator, so as not to fulfil their duties - the consequences will be miserable and cannot be counted". Plato

"Without ethics, everything would happen if we all were five billion passengers travelling in a vehicle which is driven by anyone. It goes faster, but we do not know where it goes ..." JACQUES COUSTEAU

Virtue is considered as a valuable feature of human good character, it is the tendency and ability of a person to exceed something and above something, to perform a certain action in the best way.

According to Antiquity, five main classical virtues are:

- Maturity, understood as wisdom, intelligence, knowledge
- Justice
- Power, in terms of courage
- Caution and
- Morality

Key words: Moral, Ethics, Philosophy, Virtue

HYRJE

Për ne pedagogët, kolegët e mi këtë gjë e dimë mirë, sapo fillojmë të diskutojmë për konceptet filozofike, është bërë rutinë që, për të gjitha këto koncepte, qysh në fillim të gjejmë etimologjinë e fjalës dhe më vonë gjenezën, gjeneologjinë e saj.

Natyrshtëm, si dhe për çdo koncept tjetër, literaturat e shfletuara do të na çojnë te greqishtja e vjetër dhe latinishtja. Fjala *virtyt*, pa dashur të përsërit apo korrigoj të tjerët, vjen nga latinishtja – *virtus*, *vir* që në shqip përkthehet *burrë*, *burrëria*, ose është një fjalë që lidhet me aftësitë luftarake, të tilla si "*guximi*", "*trimëria*", kurse burimi i dytë është fjala e vjetër greke - *areti*, që në shqip përkthehet "*Epërsia morale e një personi*".

Virtyti konsiderohet si një veti e çmueshme e karakterit të mirë të njeriut, është prirja dhe aftësia

e një njeriu të tejkalojë në diçka dhe mbi diçka, të kryejë një veprim të caktuar në mënyrën më të mirë.

Duke iu referuar antikitetit, pesë virtytet klasike, kryesore konsiderohen:

Pjekuria e kuptuar, si: urtësi, mençuri, dituri;
Drejtësia;
Fuqia në kuptimin e guximit;
Maturia;
Morali.

Zhan Pjer Vernant tek "*Origjina e mendimit grek*", pikërisht këto virtyte ka dashur të theksojë kur analizon faktorët kryesorë që bënë të mundur kalimin nga sistemi pallator mikenas te universi shoqëror dhe shpirtëror i poliseve greke, kusht mjaft i rëndësishëm ky për lindjen e filozofisë. Por, le të kalojmë menjëherë te tema e sotme.

Po t'i referohemi historisë së filozofisë nga antikiteti dhe deri në ditët tona, patjetër që do të

dallojmë lehtësisht që virtyti është një nga ato koncepte filozofike që është trajtuar pothuaj nga të gjithë filozofët. Konkretisht:

Herakliti (540-480 p. l. K) Ai thekson se kontrasti midis të keqes dhe të mirës nuk ka vlerë absolute, por relative. Kjo duket tek shprehja e tij: *“Dhe e mira dhe e keqja janë e njëjta gjë”, “ato janë të lidhura pazgjdhshëmrisht midis tyre”*. Dihet mirë nga të gjithë se problematika e kohës së cilës po i referohemi ishte njohja e natyrës, e kozmosit dhe patjetër që edhe virtytet do të trajtoheshin në një fushë të tillë specifike siç ishte njohja njerëzore.

Njohja njerëzore është një gjë e vështirë që kërkon përpjekje të mëdha, sepse e vërteta nuk është në sipërfaqe dhe nuk mund të kapet menjëherë. Ja si e karakterizon *Herakliti* këtë moment: *“Natyra ka qejf të fshihet”, “harmonia e fshehtë është më e mirë se ajo që duket”, “shumë tokë gërmojnë kërkuesit e arit, por pak ar gjejnë”*. Siç shihet edhe nga fragmente të shkëputura nga *“i errëti”* Heraklit, jemi te prirjet e njeriut për të tejkaluar në diçka, mbi diçka, gjë e cila sipas tij arrihet nëpërmjet mendimit, mençurisë, së vërtetës, të vepruarit në përputhje me to. Shumë kohë më vonë këto teza do të vërtetohen nga puna e palodhur e shkencëtarëve dhe do të përcaktohen si norma, virtyte, apo ideale shkencore që duhet të udhëheqin punën kërkimore shkencore. Pse jo, e njëjta gjë ndodh edhe me ne pedagogët dhe me ju studentët gjatë përgatitjes së temave të diplomës.

Demokriti (460-370 p. l. K) Krahas pikëpamjeve të tij filozofike për të cilat ai ka edhe meritën kryesore (*teoria e atomeve*), një vend të rëndësishëm në arsyetimin e tij filozofik zënë edhe problemet e qëllimit dhe të misionit të njeriut në jetë, si dhe sjellja e njeriut në shoqëri.

Sipas tij *“qëllimi i njeriut në jetë është lumturia, është gjendja e mirë e shpirtit, i cili nuk di se ç’është frika dhe paragjykimi”*. *“Ndjenja e kënaqësisë te njeriu arrihet duke ruajtur masën sepse masa që duhet të ruhet në çdo gjë është e bukur”* dhe kjo arrihet nëpërmjet mençurisë dhe diturisë. Mençuria i lejon njeriut të arrijë tri rezultate:

1. Të mendojë mirë,
2. Të flasë mirë,
3. Të veprojë mirë.

“I mençuri vepron mirë, madje edhe të keqen mund ta mposhtë dhe ta kthejë në të mirë, kurse i padituri dhe të mirën e kthen në të keqe”. Jo më kot, falë këtij optimizmi, Demokriti është quajtur edhe si *“filozofi që qesh”*.

Sofistët (shek V-IV p. l. K)

Jemi në periudhën kur grekët sapo kishin përfunduar me sukses luftërat medike, ku spikati edhe njëherë guximi dhe trimëria për të mbrojtur

atdheun, dy virtyte këto me shumë vlerë. Në kushtet e reja të krijuara lindi nevoja për përgatitjen e njerëzve që do të drejtonin institucionet e reja politike, juridike dhe gjyqësore. Për këtë arsye, arti i bindjes, aftësia e debatimit, diskutimit, mjeshtëria e të folurit dolën në rend të ditës, pra kështu lindi një mënyrë e re e të filozofuarit.

Në qendër të vëmendjes dhe diskutimit dolën problemet që kishin të bënin me njeriun si qytetar, si anëtar i qytetit, problemi i vlerës së dijeve njerëzore, i sjelljeve morale që rregullojnë marrëdhëniet e njerëzve në shoqëri. Kështu Sofistët u bënë të parët mësues që morën përsipër përhapjen e diturive.

Përfaqësuesi më i shquar i sofistëve ishte *Protagora (480-410 p. l. K)*.

Sipas tij virtyti i njeriut varet:

1. Nga gjendja shoqërore (i liri-sklavi),
2. Nga moshja (i rrituri- fëmija),
3. Nga suksesi (burri-gruaja),

I vetmi kriter për të gjykuar një veprim të drejtë nga një veprim i padrejtë është *dobia*. *“Ajo që i duket çdo shteti e drejtë dhe e bukur, është e tillë për të, përderisa ai e quan këtë të tillë”*. Kënaqësia, fitimi, nderi janë ato që përcaktojnë sjelljen e njeriut në shoqëri. Duhet theksuar se duke mbivlerësuar suksesin, dobinë, sofistët morën një nam të keq, sepse ata nuk synuan më shumë zbulimin e së vërtetës se sa suksesin, gjë e cila binte ndesh me normat dhe vlerat e asaj kohe. Në këtë kuptim, Platoni i quajti sofistët *“tregtarë iluzionesh”*.

Sokrati (469-399 p. l. K)

Kundërshtar i hapur i sofistëve ndonëse përvetësoi nga ata mësimin në publik, bisedat dhe diskutimin, si mjete për të gjetur të vërtetën. Ai ishte i vetëdijshëm për paditurinë e tij dhe e deklaronte me shprehjen: *“Unë di një gjë më shumë se të tjerët atë që s’di asgjë”* dhe megjithatë këmbëngulte në kërkimin e së vërtetës, kujtoj për auditorin, këtë e njohim në filozofi me termin, *“kurajo sokratike”*. A nuk është ky një virtyt, një model që duhet ndjekur nga të gjithë?

Mbreti Arkelau i Maqedonisë i ofroi pasuri të madhe Sokratit që ta mbante në oborrin e tij. Sokrati iu përgjigj: - Mielli është më i lirë në Athinë, ndërsa uji kudo nuk kushton asgjë.

Njeriu sipas Sokratit duhet të njohë vetveten, gjë e cila do të thotë që, njeriu duhet të fitojë ndërgjegjen për vlerën e veprave që ai kryen, për normat dhe parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet. Sipas tij asnjë njeri nuk është i keq me dashje, e gjithë e keqja vjen nga padituria, sidomos nga padija e vetvetes. Veprimet e njeriut varen nga dituria e tij, nga konceptet që ai ka për virtytin, për të mirën dhe qëllimet që ai ka.

Lind pyetja: Cilat janë virtytet e përgjithshme që Sokrati zbulon te njeriu? Morali i vërtetë është të dish se ç'është e mirë dhe e bukur dhe në të njëjtën kohë e dobishme për njeriun. Këto virtyte janë:

1. *Moderimi ose vetëpërmbajtja* dhe me këtë Sokrati kupton dijet si të kapërcesh dhe frenosh pasionet,

2. *Trimëria*, dija si të kapërcesh rrezikun,

3. *Drejtësia*, dija si të respektosh ligjet njerëzore dhe hyjnore.

Është i njohur për këtë auditor bashkëbisedimi i Sokratit me njërin prej nxënësve të vet *Eftidenin*. Ai duke e ndihmuar *Eftidenin* që të kuptojë se ç'është e drejta dhe e padrejta, ç'është e mira dhe e keqja, ç'është guximi dhe frika, ç'është urtësia dhe marrëzia i propozon të ndërtojë dy kolona, A dhe B, ku në të parën të vendosë veprimet e drejta dhe në kolonën B, veprimet e padrejta.

Sokrati – Ku ta vëmë gënjeshtren, mashtrimin, vjedhjen, rrëmbimin e njerëzve?

Eftideni – Në kolonën e veprimeve të padrejta.

Sokrati – ku ta vëmë gënjeshtren, mashtrimin, grabitjen e armikut, shndërrimin e tyre në skllëvër?

Eftideni – Sigurisht në veprimet e drejta, por unë kur thashë se janë të padrejta kisha parasysh miqtë.

Sokrati – Ndaj miqve këto veprime janë të padrejta, ndaj armiqve janë veprime të drejta, por

edhe ky përcaktim duhet të zëvendësohet sepse në tezën *“se miqve duhet t’u thuash të vërtetën”*, ka kontradikta.

Sokrati – A bë mirë komandanti, i cili kur e sheh punën keq u thotë ushtarëve se po vijnë ndihma?

Eftideni – Një mashtrim i tillë duhet vënë në kolonën e veprimeve të mira dhe jo siç bëme në përcaktimin e parë.

Sokrati – Edhe babai kur i ve ilaçin fëmijës fshehurazi në ushqim, edhe kur i vjedhim armën shokut, i cili ka vendosur të vrasë veten.

Eftideni – Edhe këto veprime janë të drejta

Sokrati – Edhe me miqtë nuk duhet të jemi gjithmonë të vërtetë.

Në përfundim, për ta bërë sa më aktual Sokratin dhe tezën e tij të famshme; *“Njeri njih vetveten”* po e mbyll me një citim nga eseja me titull: *“Mos kërkohet jashtë vetes”*, e shkruar nga *Ralph Waldo Emerson*, i cili i është referuar *Epilogut “Fati i njeriut të ndershëm”*, (*Beaumont&Fletcher.*)

“Njeriu është ylli i vet; dhe shpirti që mund të ofrojë njeri të ndershëm dhe të përkryer, e komandon tërë dritën, tërë ndikimin, tërë fatin; atij asgjë nuk i bie herët apo tepër vonë.

Aktet tona engjëjt tanë janë, ose të mirë ose të këqij, Hijet tona fatale që ecin qetësisht krahas nesh”.

BIBLIOGRAFI

J. Hersh: *“Habia filozofike”* Shtëpia botuese Dituria, botim i vitit 1993.

Ralph Waldo Emerson, *Esse, “Mos kërkohet jashtë vetes”*

Samuel Enoch Stumpf: *Filozofia, “Historia & Problemet”*, Shtëpia botuese Toena.

Zija Xholi, *Dispenca, Historia e Filozofisë*, Tiranë 1989.

Zhan Pjer Vernant tek *“Origjina e mendimit grek”*, Dituria-CEU.

**THELBI I LIDHJES NJERI-HYJNI; NDIKIMI NË NATYRËN E MARRËDHËNIES SUBJEKT-PUSHTET POLITIK
(NJË DISKURS MIDIS T. HOBBS DHE S. VON PUFENDORF)**

**ERISELD KALEMAJ
SUELA IBRAIMLLARI**

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE HUMANE
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Marrëdhënia e njeriut me hyjnoren ka nisur që në kohët e hershme. Në një mënyrë apo në një tjetër, ajo ka influencuar në stilin e jetesës por edhe në natyrën e shprehjes së pushtetit. Nga forca e thelbit të kulturës së një shoqërie, siç është besimi fetar do të shohim ndikimin në relacionin subjekt – pushtet politik.

Si fillim, njohja e komunikimit njeri – providencë do të na krijojë hapësirën për të kuptuar formimin shpirtëror të subjektit. Si shprehet raporti midis vetes (si bindje) dhe një force apo pushteti suprem. Parë kjo në aspektin human (moral - ekzistencial). Që këtej, do të shohim lidhjen e subjektit me një realitet tjetër siç është pushteti politik.

Sintetizuar nga ky kontekst do të shohim raportin midis etikës (humanizmit) dhe natyrës së politikës. Tek e fundit do të shihet një dialog midis forcës së besimit dhe besimit tek arsyeja për të kuptuar në totalitet natyrën e pushtetit.

Nëpërmjet një refleksioni krahasues midis mendimit të T. Hobs dhe S. von Pufendorf, shprehur në terma universal do të bashkëbisedojmë mbi marrëdhënien religjion - politikë. Fokusuar tek filozofia e shekullit të XVII – XVIII por edhe me referenca nga mendimi teologjik, mitologjik apo literatura fetare, do të përpiqemi të njohim shfaqjen e këtij relacioni edhe në ditët e sotme.

Fjalët kyç: *Lidhja njeri – hyjni, Shpirt Hyjnor, Pushtet politik*

Abstract

Human relation with the divine has started since ancient times. In one way or another, it has influenced the style of living but also the way the power is expressed. The strength of the core of the culture of a society, such as religion will influence the impact of subject relation that is political power.

First, the recognition of human communication - providence will create the space for us to understand the spiritual formation of the subject. In human terms (moral - existential), it expresses the ratio between ourselves (as obedience) and a supreme power. Hence, we will see the connection of the subject with the reality as a political power.

In this context we will see the relationship between ethics (humanism) and the nature of politics. We will also see a dialogue between the force of faith and trust in reason to understand nature 'total power.

Through a comparative reflection between the opinion of T. Hobbs and S. von Pufendorf, expressed in universal terms we will discuss the relationship between religion and politics. Focused on the philosophy of the XVII – XVIII century, but also on references of theological thought, mythological or religious literature, we will try to recognize this relation nowadays.

Key words: *Relationship man - deity, the Divine Spirit, political power*

Hyrje

Studime të ndryshme kanë treguar se që në primitiveitetin e tij, njeriu e kishte të nevojshme që të krijonte apo t'i bindej një fuqie të mbinatyrshme. Paganizmi, politieizmi, monoteizmi historikisht kanë treguar se feja asnjehere nuk ka humbur apo të shuhet në shpirtat e popujve. Kjo tregon se ky realitet njerëzor ka një rëndësi të madhe. Po pse ka një rëndësi të tillë? Çfarë e bënë atë të marrë këtë rëndësi?

Veç këtij dimensionin njeriu është edhe një qenie konkrete, natyrore. Pragmatizmi i tij ka treguar se shumëçka e mbinatyrshmja nuk i realizon, njeriu ka marrë përsipër t'i arrijë vetë. Pra, një organizim dhe pushtet, ku mbështetet njeriu tokësor. Pushteti laik shqetësohej për jetën tokësore e diferencuar nga bota transcendentale. Gjithsesi, në pamje të parë pushteti fetar dhe ai politik janë qartësisht të ndara, me role dhe funksione krejt të ndryshme. Mirëpo

historia e njerëzimit na tregon se kjo marrëdhënie nuk është kaq qartësisht e thjeshtë, përkundrazi, tregon një raport të ndërlikuar.

Pikërisht, në këtë diskurs filozofik me fokus 'pushtetin' do të shihet raporti midis religjionit dhe politikës. Reacion që në vetvete ngre disa çështje që meritojnë të sillen brenda debatit si: Cila është marrëdhënia midis njeriut, hyjnores dhe politikës? A ka rivalitet midis pushtetit fetar dhe atij politik? Ku dallon bindja civile nga bindja hyjnore? Apo janë e njëjta gjë? A mund të flasim për laicitet të kulluar dhe nëse po, pse sovranët janë identifikuar me Zotin, hyjnoren?

Njeriu dhe feja

"Në të shkuarën dhe në të sotmen, do të gjenden shoqëri njerëzore që nuk kanë as shkencë, as art, as filozofi,

por nuk ka patur kurrë shoqëri pa fe” (Bergson, 2002, fq - 82). Kaq e rëndësishme është feja sa kudo dhe kurdo ajo ka qenë prezente. Në forma apo trajta të ndryshme, hyjnorja, nuk është braktisur asnjëherë. Në primitivitet apo në epokat më të sofistikuar sërish besimi tek e mbinatyrshmja nuk është zbehur. Po çfarë e bënë atë të jetë kaq e pandashme nga shoqëritë? Interes do të kishte se si natyra e hyjnore lidhet pashmagshmërisht me natyrën njerëzore?

E mbinatyrshmja është përtej intelektit human. Ajo manifeston misticizëm që në vetvete mbetet e pakapshme, e padeptueshme në esencë. Të reflektosh lidhur me relacionin njeri – hyjni, në fakt do të thotë të jesh i një-anshëm. Për të kuptuar hyjnoren nuk ka mënyrë tjetër për ne humanët, veçse ta sodisësh nga këndvështrimi i njerëzores. Pra, si e kupton njeriu hyjnoren?

Njeriu nuk mund ta kuptojë ndryshe nga natyra e tij. Njohja karakterizon njëherësh marrëdhënien midis njeriut dhe fesë (në kuptimin më të gjerë të fjalës). Qënia njerëzore është komplekse, tejet komplekse! Ajo përshkruhet si e determinuar dhe e lirë. Dy veti që kundërshtojnë njëra – tjetrën. Kurse tek njeriu janë të sintetizuara. Shkrirje që jo domosdoshmërisht duhet kuptuar si harmonike.

Determinizmi është shfaqja e njeriut si pjesë e pashmangëshme e habitatit natyror. Si një krijesë me një fillim dhe një fund. Trupi nuk e njuh këtë proces. Ai është krejtësisht pasiv. Subjekti vetëdijësohet, jo vetëm për fundin e trupit, por edhe të vetes sepse është mishëruar në këtë trup. Ky është një nga momentet më autentike të përjetimit ekzistencial. Gjithsesi, frika nga vdekja është forma perceptivë dhe më e drejtpërdrejtë e marrëdhënies njeri – hyjni. Rrjedhimisht, feja vjen së jashtmi.

Në një çast të kulluar, subjekti i lirë shprehet si dinamik dhe i papërcaktuar. Një shpirt i lirë që endet brenda vetes është i paidentitet. Këtu qëndron edhe fuqia e mistikës njerëzore. Përsëri një formë tjetër e ngjasimit me misticizmin e hyjnore. Brendësia nuk ka reference, e cila tregon se njeriu nuk është një qenie e përfunduar. Papërcaktueshmëria e tij krijon një gjendje konfuziteti dhe kaosi. Një farë zbrazëtie në përjetimin e vetes. Prirja është për gjetjen e një kuptimi për ekzitencën. Pezmatimi i subjektit (gjendjes ekzistenciale) shpreh kërkesën për themele ku do të ngrihet. Tek kjo kërkesë manifestohet krijimtaria e shpirtit. Pra, subjekti kërkon t’i shpëtojë gjendjes së vetë dhe orvatet të projektohet. Projekcioni që del jashtë vetes, shpaloset.

Hyjnorja hynë në ‘planet’ e subjektit. Ajo e organizon subjektin duke i treguar cilësitë më të mira, më të virtytshme (sensi moral i fesë). Dinamika e subjektit në këtë prizëm, shpreh një organizim që

nisur nga vetja synon ngritjen në nivelin më të lartë. Duke mos e lënë atë në gjendje kaosi, por duke i dhënë vlera asaj që është më e çmuara, jetës, duke i dhënë vlerë vetë njeriut “... ose më mirë të themi, janë vlerat më të larta njerëzore të cilat burojnë nga shpirti”(Tempull, 2015, fq- 100).

Subjekti i lirë në përpjekjet për të kapur më sublimen (hyjnoren) fillon të standartizohet gjatë këtij procesi. Rruga është ngritja e moralit si autoritet deri në nivelet më të shenjta. Ky do të ishte edhe ‘shpirti hyjnor’. Shprehje e ‘hyjnizuar’ e esencës njerëzore.

Brendësia njuh kapacitetin e vetë, e thënë ndryshe, njuh natyrën më të arrirë. Marrja e një identiteti që në thelb e njuh subjektin mbi dinjitetin. Pikërisht për raportin midis njeriut dhe fesë, Hegeli e shikon si relacion fenomenologjike: “Shpirti si fe është në lëvizje (ai kërkon të depërtoj në dijen e tij për veten) dhe këtu bëhet fjalë për faktin se figura shfaqet për ndërgjegjen e tij barazon në mënyrë të plotë thelbin e tij, kështu që ai kupton se si është ai”(Ludvig, 200, fq- 181). Pra, njohja e hyjnore është njëkohësisht edhe mënyra se si është subjekti njerëzor. Ndaj, e thënë në parim, besimet fetare nuk shuhet asnjë herë. Shpirti duke arritur njohjen e hyjnore njëherësh transedenton qenien e vetë. Vetia që njuh njeriun mbi konkretizimin e tij. Aftësia për ta tejkaluar prezencën.

Të reflektosh kështu duket sikur feja vjen si krijimtari e nevojës së njeriut. Duket më së tepërmi si shprehje e egoizmit që buron nga subjekti njerëzor. Ndoshta mund të jetë edhe kështu! Megjithatë, aftësia e subjektit për të njohur të vërtetën krejtësisht të kthjellët është mënyra më racionaliste që shumë teologë e filozofë janë përpjekur jo vetëm të argumentojnë ekzitencën e hyjnore, por edhe të përshkruajnë natyrën e saj.

Ndër shumë e shumë argumenta për këtë çështje le të mjaftohemi me refleksionin e René Dekatit. Të barazosh shpirtin me hyjnoren do të thotë të kthjellosh veten, të jesh i qartë dhe i vërtetë në mendimet e tua. Këto mund të jenë fjalët e R. Dekart-it, i cili me rrjedhshmërinë e tij filozofik duke e shtrirë argumentin nga e vërtetë e tij e para; “mendoj, pra jam”(Dekarti, 2005, fq-41) tek arsyetimi për ekzitencën e Zotit. E vërtetë e ekzitencës së vetes, mendimi që tejkalon prezencën konkrete dhe qëndron me veten. Mendimi mendon për mendimin. Kthimi tek vetja është një kthim në zanafillë, tek thelbi i kulluar i vetes është kaq e qartë, kaq e përsosur sa i gjithë subjekti që kthehet në origjinën e tij. Subjekti i kulluar nuk është gjë tjetër veç premisë që na çon tek ekzistenca e Hyjnore dhe përsosmërisë si një nga vetitë e natyrës së saj (pra, të Zotit). Subjekti njuh të

përsosurën, të vërteta të kulluara dhe të qarta (sidomos të vërtetat e gjeometrisë). Pikërisht ky racionalitet i kthjellët i subjektit nuk tregon gjë tjetër, veç eksitencën e hyjnore. “... gjërat që ne i konceptojmë shumë qartë dhe shumë shkoqur janë të gjithë të vërtetat, nuk është e vërtetuar veçse nga shkaku se Zoti është ose ekziston, dhe se është një qenie e përsosur, dhe se çdo gjë që kemi në vetvete vjen prej saj” (Dekarti, 2005, fq-48). Aftësia e intelektit për të vërteta të pastra është tregues i një ekzistence shumë herë më të përsosur se sa njeriu dhe ky është Zoti.

Hyjnorja është dhe ne jemi tepër të vegjël për ta kuptuar atë (B. Paskal). Ndaj, ajo shfaqet mistike tek natyra, tek universi i pafund. Komplexiteti i qenies njerëzore, si një qenie thelbësisht e pa realizuar, por që njih të përsosurën, të pakufijshmen tregon edhe njëherë pakënaqësinë e njeriut ndaj vetes sepse ai është i dobët dhe potencialisht i gabueshëm. I pakënaqur me veten sepse është një qenie e pa përsosur, por që ka idenë e përsosmërisë, njeriu tenton të shkojë drejt formave ideale.

Të kesh idenë e të kulluarës do të thotë të mendosh se ka një botë atje dhe një botë këtu. Mënyra se si ne shkojmë tek hyjnorja (bota atje) është formë e një organizimi të subjektit që jo vetëm shkon në kufijtë e intelektit, por njih edhe veten (sensi moral i fesë). Ku normalisht koncepti ‘organizim’ dhe ‘botë atje’ manifeston një varësi të njeriut ndaj fesë dhe një pushtet të fesë ndaj njeriut!

Diskursi në këtë kontekst qëndron tek çështja se; sa influencën gjithë kjo marrëdhënie (njeri – hyjni) në jetën sociale dhe së tepërmi në kuptimin e pushtetit? Fokusi mbetet tek influenca e besimeve fetare në jetën civile dhe politike. S. Pufendorf dhe T. Hobsi evidentojnë një marrëdhënie komplekse, por që ndajnë pikëpamje krejt të ndryshme. Disa dimensione njerëzor dhe një pushtet i vetëm.

Tek e fundit njeriu është edhe pragmatist. Duke menduar dhe jetuar në mënyrë konkrete. Mes të tjerëve ai, jo gjithmonë vepron mbi bazën e një shpirtit të hyjnizuar. Shqetësimi për të përditshmen shpesh ndahet, nuk lidhet me hyjnore. Për këtë ai ka bërë një organizim mes veti. Ky është socialiteti që shfaqet si formë e organizimit zakonor. Për një arsye më të shëndosh, njeriu shkëptet nga ky stad (kjo edhe si nevojë e sofistikimit të marrëdhënieve njerëzore) dhe shkon drejt krijimit të ligjit civil. E thënë ndryshe marrëdhënia e qytetarit me shtetin. Tashmë jemi ngritur në nivelin e politikës.

E thënë me fjalët e Pufendorf-it, detyrat e njeriut nisen nga tre dimensione të tij. Detyra e njeriut e cila vjen si burim i arsyes natyrore. Detyrën si qytetar (konteksti politik) e cila vjen në përputhje me arsyen e shëndosh (ligji civil) dhe detyra e besimtarit

që lidhet drejtpërdrejt me të ‘drejtën hyjnore’. Të treja këto dimensione konvergojnë në një pikë, tek ‘socialiteti’. Pra, qëllimi është socialiteti dhe konsolidimi i tij. Çështja jonë shqetësohet se ku konsiston marrëdhënia midis të drejtës (arsyes) natyrore dhe asaj hyjnore?

E drejta natyrore gjykon veprimet së jashtmi dhe jo ato që janë në subjektin e njeriut. Besimi fetar vjen si një frymëzim shpirtëror për një botë më ideale. Objektivi që ngrihet mbi një ‘skeleton’ etik, me rregullat, normat të një karakteri shenjtëruar. Kështu, feja ka një pushtet moral mbi subjektet. Bindja ndaj së cilës buron nga subjekti (ndërgjegjja morale). Subjekti në liri vendos t’i nënshtrohet një fuqie më superior. Konteksti ky që shkon si ngjshmëri me Sovranin politik. Ndaj, etiketimet që mund t’i vemë Zotit për ta specifikuar është edhe kuptimi i Sovranit. E kundërta ndodh në krijimin e shtetit, i cili gjykon dhe vepron vetëm së jashtmi. Burimi i së cilës është vetëm e drejta natyrore. Ai është një ndërtim racional (artificial) i cili shërben vetëm për të plotësuar disa nevoja të njeriut dhe shoqërisë.

Ligji civil, duke synuar socialitetin luan disa funksione brenda botës njerëzore. Mirëpo njeriu nuk është një qenie e përsosur. Ai është i gabueshëm. Rrjedhimisht ligji njerëzor nuk e ka gjithë kapacitetin për të shmangur të këqijat e një shoqërie. Racionaliteti nuk është tërësisht perfekt në gjykimin e situatave dinamike të jetës reale. Duke gjykuar dhe vepruar së jashtmi, ligji civil, nuk mund të ndërhyjë në mendimet dhe ndjenjat e njerëzve. E gjithë kjo krijon kushte manipulimi dhe abuzimi sepse ne mund të vëzhgojmë veprimin por jo qëllimin. Survejimi së brendshmi nuk është kompetencë e ligjit civil.

Pamja tregon për një ndarje të punëve të shtetit nga ato të Zotit. Në fakt, Pufendorfi është motivues ndaj një shoqërie besimtare sepse plotëson një nga hapësirat më problematike që ka natyra njerëzore (dashakeqësia) që thyen qëllimin, pikërisht socialitetin. Njeriu besimtar i kultivuar me ndërgjegje morale (si një urdhërues i brendshëm) shkon në ‘kurimin’ e ligjit civil. E thënë kështu, ‘e drejta hyjnore’ shkon në shërbim të konsolidimit të socialitetit.

Pushteti fetar dhe ai politik janë në sintezë dhe harmoni më njëra-tjetrën. ‘E drejta natyrore’ dhe ‘e drejta hyjnore’ edhe pse kanë role të ndryshme në shoqëri, pushteti i njërit plotëson tjetrën për një qëllim, siç është ‘socialiteti’. Me këtë argumentohet se pse disa Sovran në kohë të caktuara të historisë së njerzimit e kanë shfaqur veten edhe si hyjnor. Pushteti Sovran shkrin në një të vetëm sensin civil – politik me kuptimin moral.

Arritja e qëllimit (socialitetit) bëhet në mënyrën më sublime. Rëndësia e besimit në fuksion të socialiteit shprehet që në lidhjen e ngushtë që bëhet tek dashuria për Zotin e cila nënkuptohet si dashuria për tjetrin, për botën. Pushteti që shprehet si bindje (besim) i brendshëm vendos që organizmi i shoqërisë të shkojë në përputhje me gjendjen e subjektit hyjnor. Me të gjitha vetitë e një marrëdhënie humanë në kuptimin cilësor të fjalës. Kjo shpjegon edhe prirjen e njeriut drejt socialitetit.

Tek sa për Pufendorfin, pushteti merrë kuptime të ndryshme, për Hobsin ka një linjë dhe vetëm një përmbajtje për konceptin 'pushtet'. Diskutimi mbi këtë raport të pushtetit politik me natyrën e fesë kanë një dallim esencial në mënyrë dhe përmbajtjen se si e shikojnë këtë çështje.

Feja nuk është as më shumë e as më pak për Hobsin, veçse shprehje e një pushteti që imponohet së jashtmi. Frika, pasiguria për të ardhmen sjellin krijimin e besimit fetar që siguron qetësinë. Ashtu si shteti është një formimi natyror edhe feja ka si shkak natyror "...trembjen, shqetësimin e përhershëm për të ardhmen..." (Hobs, 2000, fq- 66). Vetëm forma, mënyra e shfaqjes ndryshon kurse përmbajtja është tërësisht e njëjtë. Kuptuar nën optikën hobsiane, feja më shumë se aspekt hyjnor është një formë e shprehjes së pushtetit. Ky është edhe qëllimi i saj.

'Hyjnorja' për Hobsin ose e 'drejta hyjnore' siç e quante Pufendorfi reduktohet vetëm tek 'arsyeja natyrore' (Ky është dallimi konceptual më thelbësor në kwtw diskutim. Ndërkohë tek Pufendorfi kemi një diferencim të këtyre koncepteve). Madje, hyjnorja kuptohet vetëm nga arsyeja natyrore. Atëherë, shohim se hyjnorja nuk është gjë tjetër veçse kuptimi i arsyes njerëzore. Racionalizmi (mekanik) i kuptimit real të pushtetit gjëjen si të vetmen pikë referencë arsyes natyrore, duke e bërë atë një koncept universal (themelor dhe gjithëpërfshirës)

Kështu, në interpretimin që Hobsi i bënë shkrimeve të shenjta gjëjen mjaftueshëm argumenta se feja, në thelb përmban ligje civile. Këtë Hobsi e shikon të shfaqet në disa forma.

E para lidhet me ngjarjet historike që e përshkruajnë kryesisht besimin e krishterë. Këtu ai nënkupton se njeriu e ka organizuar jetën në formën e hyjnore, por tek e fundit drejtimi dhe prirja për t'i udhëhequr është tregues i kuptimit të një pushteti Sovran laik. Shembulli më interesant është nga Dhiata e Vjetër, historia e Moisiut tregon shumë në këtë aspekt. Të mjaftohemi me momentin kur ai qëndron dyzetw ditë larg popullit të tij duke biseduar me Zotin. Mungesa e drejtimit dhe orientimit shkaktoi pasiguri dhe trazira tek shoqëria. Fakt që detyroi Aronin (vëllain e Moisiut) të

drejtonte popullin, duke ndërtuar viçin e artë (forma e idhujtarisë krejtësisht e papranueshme për besimin që predikonte Moisiu). Feja ka nevojë padiskutim për karizmën e drejtuesit të vetë. Frymëzimi hyjnor është shprehje e karizmës së drejtimit për Moisiun dhe për shumë Sovranë. Kjo i jep besueshmëri, siguri dhe rrjedhimisht një pushtet më solid. Karizma e Moisiut shfaqet me superioritetin e hyjnore. Ai ka një kauz nëpërmjet të cilës udhëheq popullin (popull që e ndjek atë e ka të nevojshme orjentimin). Tek e fundit mosdashja e asaj që ai predikon është mosdashje ndaj tij. Kjo tregon dallimin thelbësor midis sovranit drejtues dhe të drejtuarve. Shprehja e aftësive të tilla udhëheqëse e ngre Sovranin në një stad tjetër. Krejt i ndryshëm nga njeriu i zakonshëm.

E gjithë kjo shkon në favor të argumentit se feja në esencë ngjason me kuptimin që ne i japim çështjeve laike (civile dhe politike). Ndaj për Hobsin "...fjalët t'i kthesh shpinën Zotit, Perëndisë tënde' janë këtu të barazvlefshme me fjalët t'i kthesh shpinën mbretit tënd" (Hobs, 2000, fq-225). Interpretimi që bënë Hobsi është me një prirje për të gjetur tek parimet fetare, boshtin e një ligji civil që më së tepërmi synon drejtimin e një shoqërie mëse të zakonshme. Forma fetare dhe ajo laike nuk dallojnë shumë në ushtrimin e pushtetit. Mbreti – Zot kuptohet po njësoj si mbret ashtu dhe Zoti, nëpërmjet arsyes natyrore. Konteksti është i njëjtë, forma është e ndryshme. Duke mos u mjaftuar me kaq, Hobsi sjell disa referenca biblike të cilat tregojnë se përveç 'vellos' hyjore aty gjejmë manifestimin e pushtetit laik. Përshembull tek 'Letra e pare e Apostullit Pjetër 2:13' thuhet "Nënshtrohuni, pra, për hir të Zotit, çdo pushteti njerëzor, qoftë mbretit, si më të lartit, qoftë qeveritarit..." (Bibla, 1998, fq-481). Për ta përmbledhur me një fjalë gjithë thelbin e këtij qëndrimi të Hobsit do të mjaftohemi me frazën e R. Tuck se; "Sovrani është një Zot i vdekshëm" (Tuck, 2005, fq – 121).

Përfundime

Tek njeriu kur nuk është zbehur kurrë frymëzimi hyjnor. Ai ka krijuar një marrëdhënie të ngushtë me të. Kjo e shprehur në forma e trajta të ndryshme. Parë në shumë këndvështime feja është edhe një mënyrë e ushtrimit të pushtetit. Pushtet që pranohet së brendëshmi (gjendja ekzistenciale dhe morale e njeriut) ose vjen si formë e imponimit nga jashtë. Mënyra se si e njohim në hyjnore shpreh njëkohësisht edhe natyrën e relacionit midis njeriut dhe hyjnore.

Në këtë diskutim, Pufendorfi mban pozicionin moral të fesë e cila buron së brendëshmi. Ajo dallohet nga e drejta natyrore dhe shprehet si e

drejta hyjnore. Pushteti i njëjës dhe tjetrës sinkronizohen në funksion të arritjes së qëllimit (socialitetit). Pushteti i religjionit vjen si korigjuese morale (subjektive) e ligjit civil.

Ndryshe diskuton Hobsi! Feja në thelb shpreh po të njëjtin kuptim të pushtetit laik, veçse e ardhur në një formë tjetër. Ndaj për të ligjet fetare nuk janë as më shumë as më pak por ligje natyrore. Kjo sepse hyjnorja nuk kuptohet ndryshe nga ç'kupton arsyeja natyrore.

Nga mënyra se si vjen kjo marrëdhënie, Pufendorf shkron drejt krijimit të një shoqërie më humane, cilësore në kuptim moral, rrjedhimisht edhe pushteti Sovran tregohet më njerëzor. Për Hobsin, duke shmangur 'autonominë' e hyjnore dhe moralin si pasojë, pushteti është i akullt. Madje, vendos në plan të dytë gjendjen ekzistenciale të njeriut.

BIBLIOGRAFI

- Bergson. H, (2002), "Burimet e moralit dhe të fesë", Tiranë, Ideart
Bibla, (2002), Shoqëria biblike shqiptare, Tiranë
Dekart. R, (2005) "Bisedë për metodën", Tiranë, Elena Gjika
Hobs. T, (2000), "Leviatani", Tiranë, IPLS & Dita 2000"
Paskal. B, (2005), "Mendimet", Tiranë, Plejad
Pufendorf. S, (2000), "Detyrat e njeriut dhe qytetarit sipas ligjit natyror", Tiranë, ISP & Dita 2000,
Ludvig. R (2005), "Hegel, fenomenologjia e shpirtit", Tiranë, Ideart
Revista Tempulli, (2015) "Esse mbi raportin njeri – hyjni", fq, 99-102, Korçë
Tuck. R, (2005), "T. Hobs një hyrje e shkurtër", Tiranë, Ideart

E DJESHMJA DHE E SOTMJA E MENDIMIT FILOZOFIK MBI KONFLIKTIN DHE MENAXHIMIN E TIJ

FERIT BAÇA

DEPARTAMENTI I FILOZOFISË
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Duke qenë në thelb një fenomen social, luftërat mbeten bashkudhëtare e të gjitha fazave të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Ndonëse, shfaqen në jetë kundër dëshirës së popujve, peshë dhe roli i tyre ka përcaktuar kurdoherë rrjedhën e historisë dhe ka dominuar fatin e tyre. Dy luftërat e fundit botërore, përveç humbjeve të pasurisë materiale i shkaktuan njerëzimit një humbje prej 34 milion njerëz. Por problemi i luftërave shfaqet edhe më i mprehtë në rrethanat e përdorimit të energjisë atomike. Rreziku i një konflikti nuklear i qëndron mbi kokë njerëzimit si shpata e Demokleit dhe i jep konfliktit përmasat e një tragjedie botërore. Sikurse hapësira dhe koha edhe natyra e konfliktit është e pafundme. Në këtë këndvështrim edhe konfliktet, si pjesë përbërëse të botës që na rrethon, janë të ndryshëm dhe të pafund. E gjithë përvoja njerëzore, teoritë dhe filozofitë rreth konfliktit na mësojnë të vërtetën se, qëndrimi më frytdhënës, mbetet njohja e natyrës dhe e shkaqeve të lindjes së konfliktit dhe përcaktimi i mënyrave të menaxhimit për zgjidhjen e tij. Studimi synon të trajtojë kuptimin filozofik të konceptit të konfliktit nga mendimtarët e lashtësisë deri në ditët tona.

Fjalët çelës: konflikt, luftë, paqe, filozofi, politikë dhe menaxhim.

Abstract:

Being on a social phenomenon, wars still remain the fellows of all steps of human social development. Even though, wars appear against people's will, the force and its role have determined always the historical course by dominating the fortune of humanity. The last two world wars, except for the material wealth losses, caused to humanity a loss of 34 million people. In the circumstances of the discovery and use of atomic energy, human society threatens a fatal precedent, the use of nuclear weapons and bacteriological one, which threatens to eradicate once and for all life on earth. The risk of a nuclear conflict between two or more parties turns conflict to a global tragedy, because after all, leads to the extinction of life on earth.

Thus, as space and time, the nature of conflict is endless. However, based on this view, conflicts as part of the world are different and infinite. All human experience, theories and philosophies about conflict underlines to us the truth that the most fruitful attitude towards it, is to understand the nature and the root causes of conflict, as well as determining the ways to solve it. The paper aims to address philosophically the meaning of conflict based on ancient philosophers and ways of resolving it in modern times.

Keywords: Conflict, war, peace, philosophy, politics and management.

HYRJE

Duke qenë bashkudhëtare e jetës së shoqërisë njerëzore, konflikti nuk mund të mos ishte edhe objekt trajtimi dhe diskutimi i mendimit filozofik, veçanërisht, hulumtimi i shkaqeve dhe origjinës së konfliktit dhe raporti i tij me paqen. Në fillim këto pikëpamje u fokusuan rreth përbërjes së botës dhe ligjësive të saj dhe në vijim ngërthyen edhe hapësirat e jetës së shoqërisë njerëzore.

Një interes të veçantë në mendimin e djeshëm filozofik, por edhe për filozofinë moderne përbëjnë idetë e filozofëve të lashtë grek. Herakliti vinte në dukje se: *“çdo gjë ndryshon vazhdimisht. Ai besonte se bota ishte në ndryshim të përhershëm. Ishte e pamundur të futeshe dy herë në të njëjtin lum. Ai theksonte se i vetmi tipar i pandryshueshëm, i botës ishte fakti që çdo gjë ndryshonte. Zjarri, toka uji dhe ajri janë elementet që formojnë çdo gjë në gjithësinë e paraqitur në një sferë ku bashkimi dhe ndarja e elementeve vihet në lëvizje nga dy forca të vetme: Dashuria dhe urrejtja. E para është forcë bashkuese kurse e dyta forcë që sjell ndarje”* (Raeper. William dhe Smith Lindita. 1999. F. 9).

Ndërsa Demokriti, një filozof parasokratian formuloi kosmologjinë e vet. Sipas tij, *“Asgjë nuk vjen nga hiçi, dhe asgjë, pasi të jetë shkatërruar nuk i kthehet hiçit. Atomet lëvizin në gjithësi duke prodhuar vorbulla dhe nga kjo formohen komponimet; zjarri, uji, ajri dhe toka.”* *“Gjithçka që ekziston në gjithësi është fryt i rastit dhe i domosdoshmërisë. “Gjithësia është e pafund sepse nuk është vepër e asnjë krijuesi.”* (Raeper. William dhe Smith Lindita. 1999. F. 9).

Filozofi i lashtësisë, Gorgias, nxënës i Empedoklit mbronte tezën e të fortit. Për atë, drejtësia është shpikje e të dobëtëve që e përqafton një masë e madhe, e nxitur nga frika se mos vallë do ta pësojë nga më i forti. Edhe për sofistët drejtësia është forcë që lejohet të përdoret për të garantuar epërsinë.

Duke trajtuar pikëpamjet e Heraklitit, vërejmë hulumtimet e tij rreth materies dhe se si ai vlerëson si element kyç, tokën, ujin, ajrin dhe zjarrin. Për atë, në fillim bota ishte e gjitha e zjarrtë, por që pastaj, me dëshirën hyjnore u shndërrua në det nga gjysma e të cilës u krijua toka. Në qëndrimin e tij mbi

parimin e të njëjtës dhe të kundërtës në të njëjtën njësi, pason principi themelor i ndryshimit të vazhdueshëm dhe të përhershëm. Herakliti me idetë e veta, influenoi tek një numër i madh mendimtarësh nëpër shekuj, ndër ta edhe tek Platoni dhe stoikët e tjerë, si dhe më vonë te Hegeli që diti të integroi sistemin e tij në veprën e vet.

Menaxhimi dhe trajtimi i konfliktit

Meqenëse, rrethanat e lindjes së konfliktit kanë një pafundësi shkaqesh edhe mënyrat e menaxhimit dhe zgjidhjes së tij janë të ndryshme dhe të pafundme, ndonëse në jetën e përditshme statusin e preferencial e kanë fituar ato zgjidhje që, duke pasur një kosto të vogël, arrijnë të sigurojnë avantazhe dhe përfitime më të mira për palët e përfshira në konflikt. Kështu, për probleme të ndryshme kemi dhe reagime të ndryshme. Edhe në menaxhimin e konfliktit, krahas teorive rreth konfliktit, trashëgimia jetësore mbetet mësuesja më e rreptë dhe më e mirë. Shpeshherë, nga humbjet dhe përjetimi i disfatave mësohet shumë herë më mirë, në raport me arritjen e sukseseve të cilat ndonjëherë të vënë në gjumë duke të përgatitur situata të padëshiruara.

Çdo pjesë e procesit të menaxhimit të një konflikti vlerësohet si pjesë e një organizmi të gjallë, në të cilin bën majë komunikimi. Ai u jep palëve mundësi të tregohen të hapur, të sqartë dhe të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin. Por, komunikimi nuk është i vetmi “faktor magjik” në menaxhimin e konfliktit. Ai duhet të shoqërohet hapa pas hapi dhe të kombinohet me krijimin e një klime të besueshme të cilat përgatisin kushtet dhe lehtësojnë në tërësinë e tyre arritjen e marrëveshjeve dhe mirëkuptimit midis palëve konfliktuale. Çelësi i suksesit në zgjidhjen e një konflikti e ka burimin në parimin: “Mos lejo që një mospajtim ose mosmarrëveshje sado i vogël në fillim, të përshkallëzohet si ai orteku i dëborës.”

Meqenëse jeta e gjallë nuk është “kimi” por alkimi e për rrjedhojë, nuk ka formula të gatshme shkollareske, zgjidhja e konflikteve ka seleksionuar një radhë pune për menaxhimin e konflikteve. Qysh në krye të herës, pra të shfaqjes së shenjave të para të një konflikti është e udhës të përcaktohet natyra e problemit, dëgjimi i të dy palëve konfliktuese dhe krijimi i kontakteve për shkëmbimin e pikëpamjeve të ndryshme. Në tryezën e bisedimeve duhet të hidhen të gjitha alternativat për zgjedhjen e shqetësimeve që ushqejnë konfliktin. Shkëmbimi i mendimeve dhe pikëpamjeve zgjeron edhe me tej alternativat e përshtatshme në përputhje me realitetin e krijuar për shmangien e konfliktit midis palëve.

Gjatë procesit të menaxhimit për zgjidhjen e një konflikti është jetike vazhdimi i komunikimit dhe i dialogut midis palëve në konflikt, qëndrimi i kundërt, ndërprerja e komunikimit midis tyre do të përkeqësonte dhe përshkallëzonte marrëdhëniet midis tyre. Për të kuptuar rrezikun e ndërprerjes së komunikimit dhe rolin e besimit në komunikim, mund të marrim rastet kur fëmijët adoleshentë humbasin besimin e prindërve, për shkak se ata gjithnjë u kundërvihen dëshirave dhe mendimeve të tyre. Për këtë dhe për shkaqe të tjera ndërpritet komunikimi i vërtetë dhe adoleshenti, mungesën e besimit të prindërit e zëvendëson me besimin të shoqëria e cila jo rrallë mund ta shpjerë atë në një rrugë të gabuar. Është e dobishme që prindërit t’u japin hapësirë fëmijëve të tyre për t’u shprehur, t’i mirëkuptojnë dhe në asnjë mënyrë të mos e ndërpresin me ata komunikimin.

Në menaxhimin e konfliktit me sukses ose jo sukses, ndikon edhe mënyra se si komunikojnë palët, mënyra si ia shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre njëri-tjetrit. Kur kundërshtarët sqarojnë pozitat e tyre dhe marrin parasysh pikëpamjet e ndryshme, arrijnë të merren vesh dhe ta kuptojnë më shpejt njëri-tjetrin. Si rregull çiftet që bisedojnë hapur dhe drejtpërdrejt rreth shqetësimeve të tyre sigurojnë një martesë të lumtur dhe jetëgjatë. Për nga moria dhe natyra e pafund e problemeve që përmban, një konflikt ai duket se përbën në vetvete bërthamën e një shoqërie njerëzore në miniaturë. Mbi të gjitha mbeten probleme të diskutueshme çështjet e karakterit të drejtësisë; barazisë dhe pabarazisë, të cilat përbëjnë edhe tezat më të rëndësishme të shkencës politike, pra dhe të faktit se kush mund ta zgjidhë konfliktin.

Meqenëse, njerëzit nuk janë të bashkuar për arsyen e thjeshtë të mos përputhjeve të interesave dhe meqenëse njerëzit janë të pabarabartë, kush mund ta bëjë këtë më mirë se shteti ligjor i cili është faktori më i interesuar për të siguruar rregullin. Ai është faktori i mandatuar nga vullneti i shumicës për t’i detyruar njerëzit t’i binden sundimit të ligjit. Ja përse pjesa më e madhe e debateve politike përqendrohen rreth diskutimeve mbi rolin e shtetit ligjor dhe të ndikimit që ai ushtron mbi zbatimin e barazisë dhe pabarazisë në jetën shoqërore dhe në mënyrë të veçantë rreth anëve të veç që kanë ët bëjnë me menaxhimin dhe zgjidhjen e konfliktit.

Qeverisja mund të përdoret si për t’i ndarë ashtu edhe për t’i bashkuar njerëzit, siç e vërteton edhe politika e ndarjeve dhe e integritit racial në Amerikë. Ajo mund të mbështesë pabarazinë si në rastet kur të pasurit gëzojnë privilegje të veçanta tatimore, por ajo mund të mbështesë edhe barazinë siç ka treguar aplikimi i një sistem kombëtar

shëndetësor. Por nisur nga ekzistenca dhe natyra e konfliktit, ndoshta do të ishte e pamundur që qeverisja të ushtrohej në mënyrë të atillë që as të mos ndante e as të mos bashkonte, as të mos diskriminonte dhe as të mos barazonte. Një pjesë e problemeve themelore dhe më të vështira që lidhen me qeverisjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lindin nga karakteri i saj i diskutueshëm moral. Vetë demokracia përbën në thelb sundimin e shumicës absolute, por gjithmonë jo 100% të të gjithë popullit. Pra, sërish kemi fenomenin e nënshtrimit të një pjesë e të popullsisë ose “fenomenin e ushtrimit të diktaturës” së shumicës ndaj kësaj pakice. Nga ana tjetër duhet të pranojmë edhe faktin që natyra njerëzore nuk është e përsosur, ndaj ajo është e gatshme që në çdo moment të shpërthejë kur interesat bien ndesh me njëri-tjetrin.

Ashtu sikurse natyra edhe shoqëria njerëzore nuk ofrojnë përsosmëri. Është vetë shoqëria njerëzore e cila, nëpërmjet përpunimit të pikëpamjeve të veta filozofike për problemet më kardinale të saj, si: lirinë, barazinë, moralin, të drejtën, sistemin ligjor, rregullat e qeverisjes, kërkon gjithmonë e më shumë të ndërtojë një botë të drejtë dhe t’i afrohet më shumë përsosmërisë.

Teorikisht me zgjidhjen e konflikteve merren mjaft institucione të drejtësisë. Trajtimi i pakujdesshëm i konflikteve është i mbarsur me përplasje të përgjakshme, duke i hapur rrugë ligjit të triumfit të atij që është më i fortë.

Zgjidha e konfliktit sipas kësaj praktike është kurdoherë me kosto të lartë dhe afatshkurtër për palët në konflikt dhe vetë shoqërinë në tërësi. Konfliktet që prodhojnë përleshje të armatosura, në një moment të përshtatshëm, arrijnë t’i detyrojnë palët të arrijnë një marrëveshje. Nëse konfliktet nuk do të ndiqnin rrugën e konfrontimit, marrëveshjet do të arriheshin më lehtë. Llojet e konflikteve janë të panumërta, por rruga e vetme pushimit të një konflikti qëndron në mënyrën paqësore të zgjidhjes së tyre.

Zgjidhja e konfliktit

Në një proces konfliktual përcaktimi i “pikës kritike” është edhe çelësi i zgjidhjes së tij që i hap rrugë edhe realizimit të qëllimit tonë përfundimtar. Kjo “pikë kritike” është e lidhur ngushtë me vlerësimin nëse është i mjaftueshëm reduktimi i forcës dhe i ashpërsisë së një konfliktit, apo parandalimi dhe mënjanimi i tij, apo, zgjidhja e tij duhet të përfshijë ndryshimin e qëndrimeve dhe “shërimin” rrënjëve dhe të shkaqeve të konfliktit.

Rrethanat e krijuara, vështirësitë dhe avantazhet e qasjeve dhe kuptimeve të ndryshme kërkojnë prej edhe shqyrtime dhe këndvështrime të ndryshme. Synimi ynë kryesor në të gjitha fazat e

menaxhimit dhe zgjidhjes së një konflikti mbetet arritja e një zgjidhje të menjëhershme ose orientimi i procesit drejt një zgjidhjeje të favorshme dhe afatgjatë, me interes për palët e konfliktuara.

Parimi bazë i arritjes së një marrëveshjeje midis palëve në konflikt synon kurdoherë realizimin e një zgjidhjeje ose marrëveshjeje paqësore. Proces i zgjidhjes duhet të kalojë patjetër nga faza në të cilën palët të përfshira në konflikt ta njohin njëra tjetrën dhe të vendosin kontakte të drejtpërdrejta ose indirekte. Është e rëndësishme që në procesin e zgjidhjes së konfliktit të marrin pjesë së pari vetë palët në konflikt. Sepse janë pikërisht ato që do ti zbatojnë detyrimet reciproke si dhe avantazhet që sjell zgjidhja paqësore e tij.

Trajtimi realist i shkaqeve të konfliktit dhe përshkallëzimi i hapave drejt zgjidhjes paqësore të konfliktit është një faktor jetik në zgjidhjen e tij. Ka konflikte që zgjidhen brenda një kohe të caktuar, por ka edhe konflikte të tjera që kërkojnë një kohë të gjatë deri në sheshimin e shkaqeve që e ushqejnë dhe nxisin atë.

Një zgjidhje e pranueshme

Zgjidhje e pranueshme e një konflikti të kujton procesin e ndërrimit të pushtetit gjatë zgjedhjeve demokratike, kur ndonjëherë fituesi zgjedhjeve udhëhiqet nga deviza: Fituesi i fiton të gjitha, kurse humbësi i humbet të gjitha. Koncepti i një humbësi absolut, i cili gjatë një konflikti humbet gjithçka, sikurse koncepti i kundërt për fituesin në një konflikt, i cili fiton gjithçka, përbën një hendek të madh i cili, jo vetëm duhet të mbahet në kontroll, por edhe të kapërcehet gjatë zgjidhjes së një konflikti. Ky qëndrim dhe botëkuptimi i të menduarit, shpie në përfundime të pasakta. Kështu që, si qëndrimi që i referohet humbësit, i cili është më se i pakënaqur nga rezultati, ashtu edhe ai që i referohet vetëm fitimtarit, shpjen në qëndrime që ushqejnë sërish shpërthimin e konfliktit.

Gjetja e një rruge mirëkuptimi midis palëve në konflikt dhe i argumentimit të përfitimeve reciproke dhe afatgjatë në arritjen e një marrëveshjeje, pa dyshim që është edhe rruga më e mirë e zgjidhjes. Kjo rrugë përjashton sfidën dhe përplasjen midis një fitimtari dhe një humbësi, sepse, rruga e mirëkuptimit nuk ka më as palë “vetëm e humbur” dhe as palë “vetëm fituese”. Rruga e bashkëpunimit dhe e lëshimeve reciproke për arritjen e marrëveshjes ka nisur qysh me vendosjen e kontakteve dhe zhvillimin e diskutimeve midis tyre për probleme të veçanta të konfliktit ose për vetë konfliktin në tërësi.

Gjatë procesit të zgjidhjes së konfliktit palët ndërgjegjësohen për faktin se janë “udhëtarë të një anijeje” të cilët janë të detyruar ta nxjerrin atë

shëndoshë e mirë në breg, sepse humbja e njëjës palë është edhe humbje e palës tjetër dhe anasjelltas. Gjithashtu, gjatë zgjidhjes së një konflikti palët duhet të binden se ky proces kërkon një gjykim dhe vlerësim të drejtë dhe të barazpeshuar. Në një problem të caktuar mund të përfitojë më shumë njëra palë, sikurse në një tjetër pala tjetër. Kjo do të thotë se gjykimi i drejtë dhe barazimi nuk duhen kuptuar thjeshtë si nocione abstrakte dhe teorike, por si një aplikim i drejtë dhe racional në praktikë, sipas principit: secilit i është dhënë e drejta që i përket.

PËRFUNDIME

Me gjithë shpjegimet, hulumtimet dhe rekomandimet e mendimtarëve të shumtë të të gjitha kohërave, që kanë rrahur të shpjegojnë shkaqet e luftës dhe triumfin e paqes, sërish lufta ka shpërthyer dhe është shfaqur në jetën e shoqërisë njerëzore, si dje, në epokat e kaluara, ashtu edhe në ato modernet, me të njëjtën rol tragjik në jetën dhe fatet e popujve, duke i qëndruar kërcënueshëm mbi kokë shoqërisë njerëzore, si shpata e Demokleut. Një realiteti i hidhur nga i cili duket sikur njerëzimi, pavarësisht organizmave që ka krijuar, ligjeve që ka hartuar për ta frenuar, penguar apo për t'i shmangur e zgjidhur problemet që shkakton ajo, është zënë në kurthin e saj të kobshëm pa mundësi shpëtimi.

Mësimet universale të Kantit të parashtruar në veprën "Drejt paqes së përhershme" ruajnë edhe sot një vlerë aktuale. Në njërën prej tezave theksohet: "Shkalla e të drejtave dhe detyrave që kanë shtetet përballë qytetarëve të tyre, duhet të jenë në përputhje me të drejtat dhe detyrat e shteteve përballë njëri-tjetrit dhe përballë qytetarëve të njëri-tjetrit". Vetëm kështu, sipas Kantit duke patur një respekt të ndërsjelltë të të drejtave të njëri-tjetrit do të mund të realizohej ideja për një paqe të përhershme.

Këto raporte në marrëdhëniet ndërkombëtare midis shteteve europiane tashmë kanë gjetur zbatim dhe janë bërë kritere themelore. Një tregues mjaft i mirë i krijimit të këtyre raporteve është Bashkimi Europian (BE). Pra, duke përcaktuar norma të caktuara rreth respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat janë kusht për fillimin e bisedimeve për integrim në kuadrin e BE-së, ndërtimi i raporteve të fqinjësisë së mirë dhe aplikimi i një pakete të drejtash të qytetarit të shtetit tjetër, përbëjnë dhe bazën e institucionalizimit praktik e politik të idesë së Kantit në kuadrin e integritimeve europiane. Por, raportet e cituara më lart, mbeten në një shkallë ende të ulët në politikën aktuale ndërkombëtare të disa vendeve që aspirojnë integrimin europian. Cenimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut mbeten probleme të patolerueshme në një numër shtetesh si: Kina, Rusia, Irani, Kuba, etj., por edhe konfliktet politike janë të shumta dhe dëshojnë qartë për aktualitetin e idesë së Kantit mbi paqen e përhershme nga njëra anë dhe që, njëkohësisht, tregojnë rrugën e gjatë që duhet për realizimin e këtij ideali.

Në një vështrim kritik e ballafaques me mësimet e Kantit mund të themi se, politika ndërkombëtare karakterizohet ende nga një numër i madh konfliktesh të cilat përbëjnë një kërcënim të vërtetë për paqen në botë. Rekomandimet e Kantit mbeten "gardianë" të fuqishëm në ruajtjen e paqes së përhershme edhe në ditët e sotme. Edhe në kushtet e një zhvillimi të sofistikuar teknik e shkencor të industrisë së luftës dhe teknologjisë së armatimit bërthamor, idetë e Kantit për paqen e përhershme i kalojnë caqet e parashtruara si ide filozofike, duke u shndërruar në parakushte dhe detyrë praktike që përfshijnë fushat filozofike, politike, juridike, diplomatike, ekonomike dhe ushtarake.

BIBLIOGRAFI

- Dahrendorf, Ralf, "Konflikti Shoqëror". Modern. Përk. Gjergj Peçi. Tiranë: Shtëpia Botuese "Dituria" 2009.
- Filo, Llabro. At-al., "Qytetërimet Bashkëkohore Joperëndimore". Tiranë: ShBLU, 2006.
- Fukuyama, Francis. "Fillesat e rendit politik". Përk. Shpëtim Çuçka dhe Jorgji Qirjako. Tiranë: Shtëpia botuese "Ais". 2012.
- Galtung, Johan, "Transedencë dhe transformim, një hyrje në mënyrën e funksionimit të konfliktit". Përk. Valbona Nathanaili. Tiranë: UFO University Press. 2007
- Gallie, W. B., "Filozofët e Luftës dhe të Paqes". Përk. Mimoza Gjika. Tiranë: Shtëpia Botuese "Dituria". 1999.
- Kant, Imanuel, "Drejt Paqes së Përhershme". Përk. Vladimir Bako. Tiranë: Botimet Dritan. 2004.
- Samuel, Enoch Stuph, "Filozofia: Histori dhe Probleme". Përk. Kastriot Myftiu dhe Paqsor Shehu. Shtëpia botuese "Toena". Tiranë 2000.
- William Raeper dhe Lindita, Smith, "Një hyrje tek idetë". Shëtipia botuese "Dituria" Tiranë 1999.

DISKUTIMI FILOZOFIK MBI STADET KONTRADIKTORE MENDORE

JAK SIMONI

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"

DURRËS

Përmbledhje:

Rreth stadeve kontradiktore mendore e mënyrës se si shprehen këto stade ka pasur një diskutim të gjerë filozofik. Diskutimi ka përfshirë kryesisht fushën e psikologjisë, filozofisë dhe të logjikës dhe ka qenë mjaft i gjerë kryesisht mbi principet dhe objektet logjike. Në fundin e sh. XIX e fillimin e sh. XX tradita gjermane e polake ka qenë e shquar në këtë drejtim, saqë i ka paraprirë zbulimit të logjikës polivalente nga ana e logjicënit polak Jan Lucasiewicz dhe zhvillimit të mëtejshëm të saj. Rreth këtyre çështjeve do të fokusohet artikulli, por njëkohësisht nuk do të lihen mënjanë studimet bashkëkohore, përfshi dhe të shkencave kognitive, në këtë drejtim.

Artikulli do të ketë katër paragrafë:

1. Diskutimi rreth principit të mos-kontradiksionit.
2. Stadet kontradiktore mendore
3. Nevojshmeritë e brendshme të mendimit dhe përgjithësimi i eksperiencës.
4. Principi i mos-kontradiksionit dhe stadet përkatëse mendore korresponduese.

Fjalë kyç: objektet logjike, stade mendore, mos-kontradiksion, Shkolla polake

Abstract

There has been a broad discussion on conflicting mental stages and how these stages have been expressed. This discussion has involved mainly the field of psychology, philosophy and logic and has been quite broad mainly on the principles and logical objects. In the late nineteenth and early XX, German and Polish tradition has been outstanding in this regard, that preceded the discovery of logic polyvalent by Polish logician Jan Lucasiewicz and its further development. The article is focused on these issues, but at the same time will not be set aside contemporary studies, including cognitive science.

The article has four paragraphs:

1. Discussion about the principle of non-contradiction.
2. Contradictory mental stages
3. Necessity of inner thought and generalization of experience
4. The principle of non-contradiction and corresponding mental stages.

Keywords: logical objects, mental stages, contradiction, Polish School

1-Hyrje

Në historinë e logjikës evidentohen disa linja të zhvillimit të saj, por dy drejtimet kryesore janë ai i logjikës klasike dhe jo klasike. Në bazë të zhvillimeve të logjikës klasike janë tre principet logjike të formuluar nga Aristoteli, të cilët gjejnë vend në manuale të ndryshme të logjikës dhe të historisë së saj.

Një ndër principet bazë të çdo shkence që Aristoteli formulonte në *Metaph.*¹ 3 dhe që gjendet në manualë të ndryshëm të logjikës, është principi i *mos-kontradiksionit* të cilin e formulon në dy mënyra:

1. është e pamundur që e njëjta gjë të jetë dhe të mos jetë në të njëjtën kohë.
2. është e pamundur që e njëjta gjë të bëjë pjesë dhe të mos bëjë pjesë në të njëjtën kohë tek e njëjta gjë.

Dy principet tjerë janë principi i identitetit që formulohet në këtë mënyrë: *A është A dhe nuk mund të jetë jo A* dhe principi i së tretës së përjashtuar që formulohet si më poshtë: *P ose jo-P*. Këto principe sipas Aristotelit janë bazë e çdo vërtetimi. Sipas tij studimi i këtyre principeve të përgjithshëm të quajtur ndryshe dhe *aksioma* është

detyrë e filozofisë. Krahas këtyre, Aristoteli përcaktoi principet e veçantë të cilët bëjnë që çdo shkencë të përcaktojë fushën e vet të kompetencës dhe të dallojë prej të tjerave. Këto principe kanë shërbyer tek çdo shkencë për të vërtetuar teoremat e saj. P.sh. duke u bazuar tek aksiomat e gjeometrisë vërtetohen teoremat e saj.

Rreth principeve bazë ka pasur interpretime të vazhdueshme filozofike. Debati që ka shoqëruar kryesisht zhvillimin e filozofisë dhe të logjikës ka bërë që vlefshmëria e tyre shpesh herë të vihet në diskutim. Pa mohuar rëndësinë e tyre, jo vetëm për historinë e logjikës por dhe për filozofinë, ka pasur dhe konceptime skeptike rreth vlerës së padiskutueshme universale të tyre. Duke u bazuar në një këndvështrim historik filozofik, kontradiksioni pranohet nga disa filozofë shumë kohë para formulimit të këtyre principeve. Një prej tyre është Herakliti. Për të demonstruar bashkëprezencën e stadeve të kundërta, ky filozof shprehej se duke u futur në të njëjtin lum në çdo moment takojmë ujëra të ndryshëm.

Nga interpretimet e karakterit filozofik (apo më mirë të themi ontologjik) shpesh është kaluar në

interpretime të karakterit logjik dhe psikologjik. D.m.th. nga kontradiksioni “në realitet” në kontradiksionin e “objekteve” logjike apo të “objekteve” të mendimit. Me zhvillimet e mendimit filozofik, të logjikës dhe të psikologjisë ky debat është bërë sa kompleks aq dhe interesant.

Natyrisht se në tërë historinë e filozofisë mund të gjenden interpretime të ndryshme rreth këtyre çështjeve, por në këtë artikull do të zënë vend kryesisht interpretimet e disa autorëve të sh. XIX e fillimit të shekullit të XX. Çështjet e trajtuara në këtë artikull janë kryesisht rreth objekteve dhe principeve logjike. Debati filozofik rreth tyre i ka paraprirë zhvillimit të kësaj shkence, kryesisht drejtimeve jo klasike të saj.

Me këtë çështje është marrë gjerësisht një studiu bashkëkohorë italian i fushës së logjikës V. Raspa. Ai në një punimi të titulluar *In contraddizione*, trajton një serë autorësh që janë marrë me këtë problematikë. Këtij studiuesi historia e filozofisë i shërben si ndihmë në argumentimet e tij që kanë të bëjnë kryesisht me objektet logjike dhe me principin e mos-kontradiksionit.

2-Stadet kontradiktore mendore

Nga vetë titulli i këtij libri kuptohet se trajton kontradiksionin. Që në faqet e para të tij, Raspa pranon mundësinë e ekzistencës së stadeve kontradiktore në mendje, por vë në dyshim faktin e vërtetësisë së fjalive që i shprehin. Ja si shprehet ai për kontradiksionin në librin e lartpërmendur: “në një farë mënyre kontradiktoria bën pjesë në të përditshmen tonë”(Raspa,1999:18). Ky autor thekson faktin se megjithëse thëniet kontradiktore konsiderohen pa kuptim, gjithsesi pranon përdorimin e tyre në të folurën e përditshme. I referohet rasteve që dëgjohen shpesh si “urrej dhe dua” (Raspa,1999:18) d.m.th urrej për disa aspekte e dua për disa aspekte të tjera. Një interpretim interesant i bën, autori në fjalë, këtij stadi “urrejtje - dashurie”. E konsideron një stad unik, por për ta shprehur duhen dy fjali të kundërta. Pra lidhëzën “dhe” e konsideron vetëm në nivelin sintaktik (d.m.th si lidhëz e fjalive) sepse në nivelin semantik (d.m.th si kuptim) bëhet fjalë për një realitet të vetëm. Një realitet i vetëm dhe pse kompleks, që shprehet me dy pohime të kundërt. Për vetë faktin se një stad mendor shprehet me një akt gjuhësor, çështja që po trajtohet është e ndërthurur ndërmjet aspektit psikologjik, gjuhësor dhe logjik. Për rastin në fjalë është stadi mendor i shprehur me dy fjali të kundërta, dhe pse i zakonshëm në përdorim, që logjikisht është i papranueshëm. Kontradiksioni është i pranishëm dhe në mendimin filozofik dhe Raspa e lidh këtë me kompleksitetin e objektit të diskutimit dhe me paafhtësinë tonë për të shprehur

plotësisht dhe qartësisht stadet mendore “me instrumentet tanë shprehës” (Raspa,1999:20). Në këto rrethana ja pyetja që shtron Raspa: N.q.s fjalitë shprehin domethënie që u referohen gjërave ose stadeve të gjërave, atëherë kërkohet: a mos vallë eliminimi i kontradiksionit në gjuhë bazohet në pamundësinë e objektivit që të kenë kontradikta reale (Raspa,1999:21)? Thënë ndryshe: është apo s’është realiteti kontradiktor? Përsëri vazhdon me pyetje rreth këtij paralelizmi gjuhë ekzistencë: konsistencës së gjuhës i korrespondon konsistenca e ekzistencës? Ashtu si shumë autorë, e përmendim këtu më të spikaturin G. S. Mill, Raspa koherencën dhe uniformitetin e realitetit e konsideron si premisë të pakontestueshme që shkenca të arrijë në rregullsi dhe të formojë ligje të përgjithshme, por në disa raste, sipas këtij të fundit, shkenca do të bëjë llogaritë me mungesën e dukshme të rregullsive e, kështu, me pamundësinë për të formuar rregulla të përgjithshme. Në këtë kuadër, duke theksuar kompleksitetin e realitetit dhe problemit të shprehjes së tij në gjuhë, Raspa jep një panoramë historike të këtij problemi duke iu rikthyer historisë së filozofisë. Fillon me Heraklitin e përmend disa filozofë si Dionigi I Areopagita, Scoto Eriugene, Niccolò Cusano e arrin deri tek Hegel por autorët modern e bashkëkohor zënë një vend më të rëndësishëm në interpretimet e tij.

Raspa, krahas interpretimit të bazuar në kontradiktën e realitetit, klasifikon një linjë tjetër interpretuese të përfaqësuar nga Kanti që konsideron principin e mos-kontradiksionit si një prodhim të mendimit tonë ose të arsyes. Pikërisht për këtë linjë shkruan – “kjo do të thotë se (kjo linjë) konsideron principin e mos-kontradiksionit jo si ekzistonte në realitet, por si një shfaqje në të cilën arsyeja arrin çdo herë që kalon limitet e saj, o për faktin se limite të tilla e karakterizojnë” (Raspa,1999:22).

Raspa pranon se, megjithëse është interpretuar me mënyra të ndryshme dhe shpesh është venë në diskutim, vlera absolute e principit të mos-kontradiksionit është ruajtur gjatë gjithë historisë së filozofisë perëndimore. Megjithëse mos-kontradiksioni është i përfshirë në vetë natyrën e mendimit dhe të folurit domethënës e megjithëse koherenca është bërë një kriter i çdo akti shprehës apo komunikues nuk do të thotë se si çështje është zgjidhur një herë e përgjithmonë.

3-Konformiteti i fenomeneve dhe proceseve sipas Giovanni Stuart Mill

Autorë të shumtë kanë trajtuar konceptet dhe principet logjike, që përbëjnë objektin e këtij artikulli. Empirizmi padyshim që ka lënë gjurmë dhe në mënyrën e konceptimit të logjikës dhe të

objekteve të saj. Duke u nisur nga një bazë reale empirike e përfundimeve induktive, këto çështje janë trajtuar gjerësisht nga logjicieni Giovanni Stuart Mill. Megjithëse kishin filluar të trajtoreshin që me Aristotelin, do të jetë Mill që do të thellojë çështjet logjike duke kërkuar një paralelizëm ndërmjet strukturave logjike dhe rregullsisë së fenomeneve në botën natyrore. Kontributi i tij në logjikë është mjaft i madh dhe siç u tha, e trajton atë nga një këndvështrim që bazohet tek eksperiencia dhe është kundër shpjegimit metafizik. Giovanni Stuart Mill është dhe formuluesi i aksiomës së përgjithshme të induksionit të cilën do ta trajtojmë më poshtë. Para arsyetimit dhe demonstrimit, që përbëjnë objektin e vërtetë të logjikës, Mill në librin e parë të *Logjikës* trajton emrat dhe pohimet që i konsideron si elementë parësor. Ai është i mendimit, se përgjigjja e çdo çështje që shtrohet duhet të shprehet në pohime dhe të gjitha të vërtetat dhe gabimet konsistojnë në pohime. Krahas pohimeve ai trajton dhe emrat. Për Mill, emrat janë emrat e gjërave e jo të ideve tona mbi gjërat” (Dal Pra,1997:179). Sipas tij arsyetimi është dy llojesh: nga e veçanta tek e përgjithshmja dhe nga e përgjithshmja tek e veçanta. Ndërsa i pari quhet induksion, i dyti quhet argumentim ose silogjizëm. Induksioni është përgjithësimi, që lind nga eksperiencia e konsiston në kalimin nga verifikimi i disa rasteve të veçanta në verifikimin në të gjitha rastet e ngjashëm. Ky princip bazohet tek kursi i natyrës dhe rregulli i universit, d.m.th. në natyrë jepen raste paralele e diçka që ndodh një herë rikthehet në rrethana të ngjashme; uniformiteti i kursit të natyrës është principi ose aksioma e përgjithshme e induksionit (Dal Pra,1997:181). Uniformiteti kuptohet nga një numër i konsiderueshëm rastesh bazuar vetëm tek 2. eksperiencia për të arritur në përgjithësim empirike që shërbejnë si premisa të deduksioneve.

Sipas tij, principet logjike janë “nevojshmeri të brendshme” të mendimit, tek te cilat arrihet nëpërmjet një “përgjithësimi të eksperiencës”. Ai shpreh mendimin se principi i mos kontradiksionit bazohet mbi vetpërrjashtimin reciprok të dy akteve të kundërta besimi. Në mënyrë të veçantë këtë princip e shpreh në këtë mënyrë: “E njëjta fjali nuk mund të jetë në të njëjtën kohë e vërtetë dhe false”. Një propozicion që pohon një kontradiksion është i pamundur si akt mendor. Gjithashtu në bazë të principit të së tretës së përjashtuar është eksperiencia, sipas të cilës një stad mendor pozitiv shkatërron stadin mendor korrespondues negativ.

Logjikës se J. S Mill do ti referohen gjerësisht filozofë e logjicieni të mëvonshëm, duke mos kufizuar zhvillimin e logjikës vetëm në kuadrin formal por duke e integruar me çështje të karakterit

filozofik. Dhe Gadamer do t’i referohet në librin *Wahrheit und Methode*. Në kapitullin e parë të këtij libri Gadamer thekson se J. S Mill kërkon të aplikojë ligjet e logjikës induktive dhe *shkenca morale*. Sipas tij, për J. S. Mill dhe në këtë fushë e vetmja metodë e vlefshme është ajo induktive. Uniformiteti, rregulli e konformiteti i fenomeneve dhe proceseve bëjnë të mundur parashikimin e tyre. Megjithatë J. S. Mill kishte theksuar faktin se ky fenomen nuk arrihet në të njëjtën masë as në të gjitha fushat e fenomeneve natyrore. Si arsye të kësaj mosarritje është fakti se jo gjithmonë arrihen të dhënat e mjaftueshme. P.sh. kishte përmendur rastin e meteorologjisë ku parashikimet nuk janë gjithmonë të sigurt (Gadamer,1986: 33). Në fushën e fenomeneve morale e sociale J. S. Mill kishte pohuar se metoda induktive duhet të ishte e lirë nga presupozimet dhe nuk duhet të varej nga konceptimi i origjinës se fenomeneve. Gadamer thekson se nuk bëhej fjalë për zbulimin e shkaqeve të caktuara për fenomene të caktuar, por vetëm për qartësimin mbi rregullsi të caktuara. Gjithnjë duke iu referuar J. S. Mill, Gadamer shprehet, se më e rëndësishmja është se dhe në fushën e jetës shoqërore është e mundur që të arrihet në formulimin e parashikimeve. Arritja nga disa rregullsi në përfundime për parashikimin e fenomeneve të ardhshme nuk implikonte asnjë hipotezë të përgjithshme mbi natyrën e tërësisë, rregullsia e të cilës bënte të mundur parashikimin. Fakti se hyjnë në lojë vendime të lira – duke pranuar se ekzistojnë – nuk vë në rrezik rregullsinë e procesit, por janë vetë këto vendime të lira që bëjnë pjesë në atë rregullsi që zbulohet nëpërmjet induksionit(Gadamer,1986: 33).

4-Principi i mos kontradiksionit dhe stadet mendore korrisponduese

Gjithnjë, në diskutimin rreth principit të mos kontradiksionit, logjicienit e filozofit të lartpërmendur J. S. Mill i referohet Husserl në *Logische Untersuchungen*. Meqenëse Mill pohonte se ato çka mund të jenë të vërtetë ose false janë akte besimi, principi millian i mos kontradiksionit, sipas Husserli-it, mund të ishte i formuluar kështu: *Dy akte besimi kontradiktor nuk mund të bashkekzistojnë*. Kështu kemi një shpjegim të principit të mos-kontradiksionit duke u nisur nga një akt i mendjes.

Për sa i përket aktit të mendjes Husserl shtron këto pyetje: në çfarë rrethanash aktet e besimit janë kontradiktor? Çfarë ndodh n.q.s i pohojnë shumë subjekte? Është vërtetë e pamundur që njerëzit mos të konsiderojnë të vërtetë dy besime të kundërta? Janë bërë kërkime shkencore për të provuar se diçka e ngjashme nuk ndodh me

askënd? Çfarë ndodh në stadet e hipnozës, të delirimit etj.? Një rregull i tillë është i vlefshëm dhe për kafshët? Principi i mos kontradiksionit (në aspektin psikologjik) kërkon saktësime mbi stadin mendor të subjektit, mbi rrethanat në të cilat mendon (Husserl, 1968:99). Për Husserl, edhe duke pranuar një koshencë në përgjithësi siç pohonte Sigwart, do të ekzistonte dyshimi se ligjet logjike do të ishin të vlefshme në bazë të saj, apo përkundrazi, jemi ne që formojmë idenë e një koshence të përgjithshme në bazë të ligjeve logjike.

Një tjetër autor polak mjaft i rëndësishëm që do të trajtojë principet logjike do të jetë Jan Łukasiewicz. Këto probleme gjenden të trajtuar në librat *O zasadzie sprzeczności u Aristotelesa, 1910* (tr. it. *Del principio di contraddizione in Aristotele*), dhe shumë më vonë në *Aristotle's Syllogistic from the standpoint of modern formal logic, Oxford 1957*, perkth.it. *La Silogjistika di Aristotele*. Në librin *O zasadzie sprzeczności u Aristotelesa*, pas një studimi e një analize të shkrimeve të Aristotelit, dallon versionin ontologjik, logjik e psikologjik mbi principin e mos kontradiksionit. I pari është versioni ontologjik të cilin e kemi përmendur në fillim të këtij artikulli. Sipas këtij principi e njëjta veti nuk mund t'i përkasë dhe të mos i përkasë të njëjtit subjekt nën të njëjtin aspekt. Me fjalë të tjera, shpjegon Łukasiewicz, nuk ka objekt që të ketë dhe mos të ketë një veti të dhënë (Łukasiewicz,1957:27). Natyrisht se një objekt mund të jetë i ngrohtë dhe i ftohtë në kohë të ndryshme por jo në të njëjtën kohë. Versioni i dytë, që Łukasiewicz dallon tek Aristoteli, është ai logjik i principit të mos-kontradiksionit, sipas të cilit dy pohime, ku njëri është mohim i tjetrit, nuk mund të jenë në të njëjtën kohë të vërtetë(Łukasiewicz,1957:27). Së treti, Łukasiewicz tregon se Aristoteli ka formuluar principin e mos kontradiksionit në terma psikologjik e shprehet se asnjëri nuk mund të ketë dy bindje të cilave u korrespondojnë dy pohime të ndryshme. Sipas Aristotelit, është e pamundur për këdo të besojë se e njëjta gjë të jetë dhe të mos jetë në të njëjtën kohë. Sa herë që kemi një opinion, jemi të bindur për diçka. Në procesin e të besuarit formohet një opinion që ka të bëjë me ekzistencën ose mos - ekzistencën e një objekti në një vend e kohë të caktuar. Ky është formulimi në kuptimin psikologjik të principit të mos-kontradiksionit. Çdo bindjeje, në kuptimin e stadi psikik, i korrespondon ndonjë gjykim pohues o mohues i shprehur në fjalë. Aristoteli dallonte gjykimin nga bindja, duke konsideruar që opinionin, i cili ekziston në shpirt, ka një korrespondues e një shenjë në tingujt e gjuhës.

Gjytimeve të shprehura me zë u korrespondojnë në mendje opinionet, që mund të kuptojmë si attribute të mendjes në të cilën ato ekzistojnë. Opinion d.m.th akt psikik që ekziston në mendje, ose në shpirt, të cilit në fjali i korrespondon si simbol një pohim ose mohim.

Łukasiewicz trajton gjatë principin psikologjik të mos kontradiksionit e përqendrohet tek prova aristotelike e këtij principi. Sipas tij prova aristotelike e principit psikologjik të kontradiksionit do të ishte: n.q.s dy bindje, të cilave u korrespondojnë gjytime kontradiktore, do të ekzistonin në të njëjtën kohë në të njëjtën mendje, kjo mendje në të njëjtën kohë do të kishte veti të kundërta. Nga principi logjik rezulton se s'ka objekt që mund të ketë veti të kundërta në të njëjtën kohë. Kështu, dy bindje të cilave u korrespondojnë gjytime kontradiktore nuk mund të ekzistojnë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mendje. Aristoteli konsideron kështu principin psikologjik të mos kontradiksionit si rrjedhojë të principit logjik të mos kontradiksionit. Sipas Łukasiewicz, megjithëse Aristoteli dallonte gjykimin nga bindja, nuk dallonte thelbin psikik të bindjeve. Duke dashur të zgjidhë problemin e opozicioneve të kundërta të gjytimeve, d.m.th çështjen logjike, Aristoteli shqyrton problemin e kundërshtisë së bindjeve, që është një çështje psikologjike dhe konsideron relacionet ndërmjet gjytimeve si të njëjta me ato ndërmjet bindjeve.

Ashtu si Husserl, Łukasiewicz nuk pranon si të padiskutueshëm këtë princip. Sipas tij nuk mund të pranohet lehtësisht principi psikologjik i mos kontradiksionit si një ligj i mendimit. Të tilla argumente si këto që u trajtuan, logjicieni polak i përdori si bazë teorike të logjikës polivalente të zbuluar po nga ky autor.

5-Përfundime

Megjithëse ky artikull i shkurtër ishte i karakterit historik, doli në pah debati mbi logjikën dhe mbi principet logjike që do të çonte në zbulimin e logjikës polivalente nga logjicieni polak Łukasiewicz e të zhvilluar nga disa autorë të tjerë. Në bazë të kësaj logjike ka qenë një debat i gjerë metafizik në të cilin u përfshinë disa studiues të cilët u trajtuan shkurtimisht. Ky debat ka përbërë substraktin metafizik të logjikës polivalente, e cila përbën një drejtim të rëndësishëm të zhvillimit të logjikës dhe e bën më të larmishme këtë fushë studimi e gjithashtu hapi perspektiva të zhvillimeve të mëtejshme të kësaj shkence. Në botimet e fundit vendin e logjikës po e zënë logjikat në shumës. Zhvillimet e saj janë të hapura në drejtime të ndryshme, ndaj mendoj se interesi në këtë fushë do të shtohet.

BIBLIOGRAFI

Aristotele. (1988). *Opere*, Roma – Bari: La terza.

Dal Pra, Mario. (1997). *Sommario di storia della filozofia.III*, Firenze: La nuova Italia.

Gadamer, Hans-Georg. (1986). *Wahrheit und Methode*, Tübingen: J.C.B. Mohr.

Hegel, Georg. (1981). *Scienza della logica*, Roma – Bari: Laterza t. I.

Husserl, Edmund. (1986). *Ricerche logiche*, Milano, Il saggiatore t.I.

Lukasiewicz, Jan. (1910). *O zasadzie sprzeczności u Ariystotelesesa*, (tr. it. *Del principio di contraddizione in Aristotele*. Macerata: Quodlibet, 2003.

Łukasiewicz, Jan. (1957). *Aristotle's Syllogistic from the standpoint of modern formal logic*, perkth.it. *La Silogjistika di Aristotele*, Brescia: Morcelliana.

Raspa, Vincenzo. (1999). *In contraddizione*, Trieste: Edizioni Parnaso.

GJUHËSI

MBI RENDIN E FJALIVE NË PERIUdhËN ME FJALI TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE NË PROZËN POPULLORE

AIDA KURANI
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"
DURRËS

Përmbledhje

Rendi i fjalive të periudhës me nënrenditje ka rëndësi të madhe për strukturën dhe për vlerën e saj komunikuese. Disa tipa periudhash kanë rend të ngulitur të fjalive përbërëse, kurse tipa të tjera kanë rend të lirë, të kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm. Objekt të punimit tonë kemi bërë prozën tonë popullore, për rëndësinë e vlerat që ka ligjërimi popullor për gjuhën shqipe në përgjithësi dhe atë letrare në veçanti. Sidomos përshkrimi sintaksor i saj ndihmon për të kapur më mirë e për të nxjerrë në pah veçori e ligjësi të gjuhës shqipe, që përcaktojnë individualitetin e saj në një gjendje të qartë, më pak të errësuar nga interferencat e gjuhëve të tjera e nga lëshimet e gjuhës së shkujdesur të përditshme. Duke u mbështetur në një lëndë të pasur faktike të vjelë në të gjashtë vëllimet e prozës popullore të botuara nga Instituti i Folklorit, në punimin tonë jemi ndalur në rendin/topikën, që numërohet në radhën e mjeteve sintaksore të shprehjes së raporteve rrjedhimore.

Fjalët çelës: *prozë popullore, rendi i fjalive, fjalia rrjedhimore, sintaksë etj.*

Abstract

The order of the complex clauses has a great importance for its structure and communicative value. Complex clauses have primarily embedded constituent clauses, while some others have primarily free clauses, conditioned by various factors. The aim of our paper is the folklore fiction, the importance of the values of Albanian folklore discourse in general and in particular in the literature. Especially its syntactical description helps to capture the best of the highlight features of the Albanian monocracy that define its individuality in a clear, less obscured by the interference of other languages and the shortcomings of casual everyday language. Simple syntactic constructions of folklore discourse, in harmony with the nature of Albanian, keep it away from the unnecessary foreign construction, which aggravate and complicate its syntactic structure.

Basing on a rich factual material collected in an exhaustive way in the six volumes of folklore fiction published by the Institute of Folklore, we have tried to treat the order / topic, which are means of expressing syntactic consequential rapports.

Keywords: *folklore prose, order, consequential sentence, syntax etc.*

HYRJE

Dukuritë e sotme gjuhësore dhe faktorët historikë, shoqërorë e kulturorë kërkojnë që gjuha standarde shqipe të shënojë një periudhë të re pasurimi e zhvillimi, përsosjeje e modernizimi duke u mbështetur veçanërisht në strukturën dhe në mundësitë e veta reale.

Zhvillimi i saj i pandërprerë nxjerr në pah gjithnjë e më shumë që të studiohet sa më thellë gjuha e popullit, si një gjuhë në zhvillim që plotëson, përmirëson dhe i jep jetë edhe gjuhës standarde.

Në këtë periudhë, kur gjuha standarde është bërë më e drejtpërdrejtë, më e larmishme, më e qartë, më ekspresive, duke mënjanuar shprehjet anemike, të thata, të ngurta (Domi 1984:60) ligjërimi popullor ruan ende vlera të pashfrytëzuara, ndërtime e kuptime, mjete dhe mënyra të shprehjes së marrëdhënieve sintaksore që mund të shfrytëzohen për të studiuar në mënyrë më të thellë strukturën gramatikore të shqipes, veçoritë tipologjike të saj. Sikurse leksiku popullor, edhe sintaksa popullore luan rol të rëndësishëm në demokratizimin e gjuhës letrare.

Një pasuri të madhe ndërtimesh nga më të larmishmet, me aftësi shprehëse e me vlera të shumta origjinale përmban edhe proza popullore, të cilën e kemi marrë edhe për objekt studimi. Mbi bazën e kësaj lëndë gjuhësore të vjelë në të gjashtë vëllimet e prozës popullore të botuara nga Instituti i Folklorit në punimin tonë jemi rrekur të trajtojmë rendin e fjalive të periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore.

1. Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore jo të bashkëlidhur (jokorrelative) me lidhëzat *sa, aq sa, saqë, kështu që, që*.

Nga analiza e lëndës së shqyrtuar në prozën popullore, rendi i zakonshëm i fjalive të nënrenditura rrjedhimore është pas fjalisë kryesore; fjalia e nënrenditur ndjek fjalinë kryesore, shkaku i prin pasojës: *Erdh' i hyri ky dëshir sa zuri të shtrëngonjë të vëllazërit nat e ditë për të marrë një çupë. (Proza popullore I, f. 130)*

Masanej skilja shkoi në pyll, aty ku ishte mjalti ene u ngop mir' e mirë saqi nuk deshti ma ene u kthye prap erth te ujku. (Proza popullore I, f. 48)

Fjalitë rrjedhimore të tipit jo të bashkëlidhur (jokorrelative) me lidhëzat **sa, aq sa, saqë, kështu që, që** si në gjuhën standarde, ashtu dhe në prozën popullore dalin me rend të ngulitur, të prapavendosur.

Ay kish me vetëhe rrusht' e bardhë, të shtypur e të gatuar si të lym, sa të mos njiheshin ata seç ishin. (Proza popullore I, f. 174)

Në një kohë të shkurter jeta e princeshës u lidh ngusht me jetën e djalit, aq sa as ajo as s'mund të rronin larg njëri-tjetrit. (Proza popullore VI, f. 92)

Sapo e odhi këtë në det, filloi të bënte një dallgë dhe një furtunë e madhe, saqë vapori humbi drejtimin e nuk dinte nga t'ja mbante... (Proza popullore IV, f. 426)

Më në fund doli edhe mbreti t'i në griqë të graves; ndenji pak e i percolli gjilpinjte, kështu që u hamnë e muarre dunjane. (Proza popullore VI, f. 166)

Në at gjol jetonte një gërshetë, qi gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n'u pa mbi ftyrë të tokës. (Proza popullore II, f. 138)

Mbas do kohe po nis Katallani me vikatë në kupë të qiellit, që me tu dridhë shtati. (Proza popullore II, f. 250)

- More vllazën, u tha - sa herë qi i çoj delet në kullotë, kam për të parë në një gjol të madh një grua të hishme, qi kurrkuni shoqja nuk mund i gjendej. (Proza popullore II, f. 138)

E njëjta gjë mund të thuhet edhe lidhur me rendin e fjalive në periudhat me fjali të nënrenditur me përemrin lidhor **që**:

Ama kishte një kalë ç'i s'ja xhinje shokun (Proza popullore II, f. 21)

Djali dhe vajza ishen të bukur, që shokë s'kishin në faqe të dheut. (Proza popullore VI, f. 148)

2. Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore e tipit të bashkëlidhur (korrelativ) me lidhëzat **sa, aq sa, që**.

Në prozën popullore, ashtu si edhe në gjuhën standarde, fjalitë rrjedhimore të tipit të bashkëlidhur (korrelativ) me lidhëzat **sa, aq sa, që**, të cilat marrin fjalë korrelative, rëndom vijnë pas kryesores: **Aq shumë ish qepur nga pas, sa nuk dinej ku të futej e ku të fshihej. (Proza popullore VI, f. 34)**

Thirrë dhe të tre vëllazënit dhe iu afruan Lubisë që gërriste aq shumë sa të këlliste datkën. (Proza popullore VI, f. 67)

Siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 435) në periudhën rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën **që**, rendi i prapavendosur kushtëzohet nga marrëdhëniet kuptimore midis fjalive të periudhës. Në këtë rast rendi është i ngulitur dhe i kushtëzuar nga nevoja për të shprehur një marrëdhënie të

caktuar. Për shembull, me foljen-kallëzues në lidhore, fjalia e nënrenditur rrjedhimore me lidhëzën **që** mbart tipare të fjalisë qëllimore, për shkak se këto fjali kanë të njëjtën strukturë.

Kështu, me fjalitë qëllimore mund të krijohet dykuptimësi. Fjalia mund të marrë dy vlera të ndryshme, një vlerë qëllimore dhe një vlerë rrjedhimore sipas rendit të paravendosur a të prapavendosur që zë në periudhë. Në periudhën "*Del si laskënder pazarit, që të tallen bota me ty*", fjalia e prapavendosur nuk tregon qëllim, por të tallurit është një rrjedhim objektiv i faktit që ai ose ajo për të cilën bëhet fjalë del në pazar i/e veshur keq.

Në këtë rast fjalia e nënrenditur, e cila ndjek gjithmonë fjalinë kryesore, tregon rrjedhimin e sasisë së madhe të sendeve, të sasisë së madhe të cilësisë, të sasisë së madhe të tiparit të foljes, si korrelat + emër:

I thotë djali, "që unë jam një djal' i varfër, s'kam takat me zotërinë tënde, që të marr vajzën tënde". (Proza popullore I, f. 323)

Fjalia e nënrenditur i referohet tërë togfjalëshit, pra nuk lidhet drejtpërdrejt me këto ndajfolje.

Në më të shumtën e rasteve, fjalia e nënrenditur rrjedhimore ndodhet në periudha dykryegjymtyrëshe, domethënë në periudha që ndërtohen nga fjalia kryesore dhe fjalia e nënrenditur: *Filloi me u toundë dinjaja prej tërmetit, sa u hini linxhira të xhithëve. (Proza popullore II, f. 20)*

Në at gjol jetonte një gërshetë, qi gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n'u pa mbi ftyrë të tokës. (Proza popullore II, f. 138)

Krahas këtyre ndërtimeve, fjalia e nënrenditur rrjedhimore përdoret dendur edhe në periudha shumëgjymtyrëshe, ku, veç fjalisë së nënrenditur rrjedhimore, hyjnë në lidhje dhe marrëdhënie edhe fjali të tjera me të njëjtat raporte sintaksore apo dhe me raporte të tjera.

Aq e lumtur ishte e Bukura e Dheut, sa, kur u kthye plaka nesret, i flet kjo e para. (Proza popullore VI, f. 59)

Në rastin e mësipërm, fjalia e nënrenditur rrjedhimore vendoset në mes të një fjalie kohore.

Në mjaft raste në një periudhë mund të vijnë njëra pas tjetrës dy a më shumë fjali të nënrenditura rrjedhimore, që varen po nga ajo fjali kryesore dhe janë të bashkërenditura homogjene. Fjalitë e bashkë-nënrenditura nga e njëjta gjymtyrë e fjalisë kryesore vendosen njëra pas tjetrës:

Me këto të këqia pra i hyri një ah kaq i madh djalit, sa i u mërzi vetëheja atij, e s'e donte më të gjallët. (Proza popullore I, f. 173)

Aq shumë i ish qepur nga pas, sa nuk dinej ku të futej e ku të fshihej. (Proza popullore VI, f. 34)

Fjalitë e bashkë-nënrenditura janë të bashkuara midis tyre me lidhëza bashkë-nënrenditëse; lidhëza nënrenditëse e rrjedhimit përdoret vetëm një herë dhe nuk përsëritet përpara fjalive të tjera rrjedhimore:

Po en e ema e Kanberit qau aq shoumë, sa u qorouë seëjsh e nuk sheëjfte ma. (Proza popullore I, f. 124)

PËRFUNDIME

Nga sa u trajtua më sipër, mund të thuhet se rendi i zakonshëm i fjalive të nënrenditura rrjedhimore edhe në prozën popullore është pas fjalisë kryesore. Ky rend i ngulitur i fjalive në periudhë kushtëzohet nga rrjedha logjike e ngjarjeve. Dihet se çdo shkak ka një pasojë, rrjedhim, përfundim, i cili rrjedhimisht vjen pas shkakut. Fjalja e nënrenditur rrjedhimore del si rrjedhim, përfundim, përmbyllje e asaj që thuhet në fjalinë kryesore. Këtu rendi nuk mund të ndryshohet, sepse marrëdhëniet janë të renditura në rendin **shkak-rrjedhim**, kështu që rrjedhimi mund të realizohet vetëm nëse realizohet shkak. Fjalja e nënrenditur rrjedhimore vjen pas fjalisë kryesore.

a. *Ishte aq e bukur kjo Marua, sa mbretit i mbetën sytë. (Proza popullore III, f. 49)*

b. sa mbretit i mbetën sytë, aq e bukur ishte Marua.

Një kufizim i tillë shpjegohet duke zbatuar parimin ikonoiq, në bazë të të cilit fjalja e nënrenditur rrjedhimore do të pasqyroste në mënyrë ikonoiqe pasardhjen kronologjike të rrjedhjes. Pamundësia për t'ia paravendosur fjalitë e nënrenditura rrjedhimore fjalisë kryesore a drejtuese përcakton edhe *gjymtyrëzimin aktual të*

fjalisë, ku fjalitë e nënrenditura rrjedhimore janë **remë** e thënies, kështu që do të prireshin të vendoseshin pas **temës**, domethënë pas fjalisë kryesore a drejtuese.

Kësisoj, pamundësia për t'ia paravendosur fjalinë e nënrenditur rrjedhimore fjalisë kryesore lidhet me ndërtimin e veçantë "*diptik*" të fjalive të formësuara nga *fjali kryesore + fjali e nënrenditur rrjedhimore*. Fjalja e nënrenditur rrjedhimore është, në fakt, përbërësja e dytë e një ndërtimi korrelativ.

Në fjalitë jokorrelative rendi i anasjellë është i pamundur nga prania e një lidhëze (*kështu që* etj.) Ndaj, fjalja e nënrenditur rrjedhimore e tipit jo të bashkëlidhur (jokorrelativ) ka rend të ngulitur: fjalja e nënrenditur vjen pas fjalisë kryesore. Që pasvënia e detyrueshme e fjalive të nënrenditura rrjedhimore varet nga një faktor sintaksor, duket se provohet prej faktit që rastet e rralla të inversionit ndikojnë gjithnjë në fjalitë rrjedhimore jo korrelative me mbivendosjen, si në fjalinë që vijon:

Hanin si ujë dhe nuk ishte e mundur as t'u shërbeje sipas rregullit, aq shumë ishin të padurueshëm e trazues. Në fjalinë e mësipërme rrjedhimi i pararend shkakut, por mes dy përbërësve nuk përcaktohet ndërlidhja, që në vend të kësaj kundërdallon një fjali të nënrenditur rrjedhimore të veçantë:

(Ishin shumë të padurueshëm e trazues, sa nuk ishte e mundur as t'u shërbeje në rregull).

Në prozën popullore nuk kemi ndeshur ndonjë rast të paravendosjes së fjalisë së nënrenditur rrjedhimore. Po të kemi parasysht edhe faktin se rendi i paravendosur i fjalive të nënrenditura është më i zakonshëm edhe në gjuhën letrare, atëherë dalim në përfundimin se vendosja pas fjalisë kryesore është një dukuri e përgjithshme për gjuhën në tërësi.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1996). *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi II (Sintaksa)*. Tiranë.
- Floqi, S. (1969). *Mbi disa çështje të renditjes së fjalëve në shqipe*, Studime filologjike, nr. 2,.
- Floqi, S. (1976). *Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë*, Studime filologjike, nr. 3, Tiranë.
- Mansaku, S. (2002). *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë, nr. 1-2, Tiranë.
- Mita, J. (2008). *Rendi i fjalëve dhe gjymtyrëzimi aktual i fjalive të nënrenditura kohore dhe vendore*, Studime filologjike, nr. 1-2, Tiranë.
- Përnaska, R. (179) *Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, nr. 1, Tiranë.
- Përnaska, R. (1986). *Trajtat e shkurtra dhe gjymtyrëzimi aktual në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, nr. 2, Tiranë.
- Rushi, Th. (1983). *"Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe"*, Studime filologjike, nr. 4, Tiranë.
- Rushi, Th. (1985). *"Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e Sotme"*, Studime filologjike, nr. 1, Tiranë.
- Totoni, M. (1978). *"Çështje të studimit të sintaksës dialektore"*, Studime filologjike, nr. 4, Tiranë.

Totoni, M. (1997). *“Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes”*. Kumtesë e mbajtur në seminarin për gjuhën dhe kulturën shqiptare.

LITERATURË E VJELË

Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar. (1963). Proza popullore, vëllimi I, Tiranë.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar. (1966). Proza popullore, vëllimi II, Tiranë.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar. (1966). Proza popullore, vëllimi III, Tiranë.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar. (1966). Proza popullore, vëllimi IV, Tiranë.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar. (1972). Proza popullore, vëllimi V, Tiranë.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar. (1972). Proza popullore, vëllimi VI, Tiranë.

STANDARDIZIMI I GJUHËS JURIDIKE DHE NXJERRJA NË PAH E DISA PROBLEMEVE GJUHËSORE NË PËRKTHIMIN JURIDIK

ERTA SPAHO-HERRI
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE
TIRANË

Përmbledhje

Artikulli synon të shpjegojë nevojën që parashtrohet sot për harmonizimin dhe standardizimin e gjuhës shqipe parë kjo nga këndvështrimi i përkthyesit juridik, i cili ndeshet përditë në punën e tij me këtë pengesë ende të pa kapërcyer. Proceset integruese të Shqipërisë, zgjerimi i kontakteve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, bashkëpunimi më i afërt me shtetet e tjera parashtrojnë edhe për gjuhën shqipe dhe përdoruesit e saj në të gjitha trevat shumë detyra. Përmes rasteve tipike do të shtrojmë disa probleme që lidhen me përkthimin e terminologjisë juridike dhe do të shohim kapërcimin e interferencës leksikore e stilistikore.

Fjalë çelës: harmonizim, standardizim, gjuhë shqipe, përkthimi juridik, terminologji juridike, probleme gjuhësore.

Abstract

The article aims to explain the need for the harmonization and standardization of Albanian language from the perspective of a legal translator who daily encounters this insuperable obstacle. Albanian integration process, the expansion of international contacts and relations, closer cooperation with other states impose a number of tasks for the Albanian language and its users in all regions. By means of typical cases, we will describe several issues related to the translation of legal terminology and we will see the challenge of lexical and stylistic interference.

Keywords: harmonization, standardization, Albanian language, legal translation, legal terminology, language problems.

1. Proceset integruese dhe zgjerimi i kontakteve ndërkombëtare në fushën juridike

Në vitin 2009 profesor Emil Lafe në referatin e tij me temë "Terminologjia, si problem gjuhësor dhe kombëtar" shkruan: "*Rëndësi të veçantë merr në kohën e sotme terminologjia juridike. Siç është njoftuar, shqyrtimi i kërkesës së Shqipërisë për statusin e vendit kandidat për në BE tashmë varet nga përkthimi i legjislacionit të BE-së në shqip (rreth 100 mijë faqe) dhe i legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së. Puna ka filluar nga Drejtoria e Përkthimit, e ngritur pranë Ministrisë së Integritimit; një pjesë e kësaj pune kryhet nga Kosova dhe Maqedonia. Të tria shtetet së bashku do të përgatisin një version kombëtar në gjuhën shqipe të asaj që quhet *acquis communautaire*."* [Lafe, E (2009): *Terminologjia si problem gjuhësor dhe kombëtar, Standard, 20.06.2009, fq. 18, 19*].

Përkthimi i "*acquis communautaire*" në gjuhën shqipe është me bërë me qëllim jo vetëm përmbushjen e një nga kushteve vënë Shqipërisë për anëtarësimin në BE, por edhe në përafrimin e legjislacionit vendas. Procesi i përkthimit në këtë rast ecën paralelisht me përafrimin e legjislacionit, si kusht i domosdoshëm për anëtarësimin në BE. Ky përafrim legjislacioni nuk është gjë tjetër veçse një përshtatje e sistemit ligjor dhe institucional të vendit tonë me parimet në të cilat mbështetet BE-ja dhe sistemi juridik i vendeve tashmë anëtare.

Pikërisht, për këtë qëllim është krijuar para procesit të përkthimit një bazë e nevojshme

metodologjike dhe terminologjike si dhe fjalorë terminologjikë për fushat më të rëndësishme, të cilët kanë si qëllim t'u ofrojnë jo vetëm përkthyesve brenda vendit një bazë të njehsuar terminologjike, por edhe përkthyesve të trevave shqipfolëse. Kjo gjë do të çonte në një unifikim të gjuhës terminologjike të përdorur në legjislacion dhe në akte të caktuara ligjore e nënligjore.

Në këtë punë janë përfshirë jo vetëm përkthyesit, por ashtu siç do të ishte e logjikshme edhe ekspertë të legjislacionit dhe të gjuhës shqipe, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë kryer dhe vazhdojnë të kryejnë një punë të gjatë e voluminoze.

Sot, Shqipëria e ka marrë statusin e vendit kandidat, por puna për përkthyesit lidhur me përafrimin e ligjeve e direktivave nuk ka përfunduar ende. Shqipëria po hapet edhe ndaj vendeve të tjera dhe nuk po shkon vetëm drejt Bashkimit Evropian, pasi në të vërtetë është një botë e tërë, e cila po shkon drejt globalizimit dhe bashkëpunimit midis shteteve.

Pikërisht, ky rrugëtim, si një proces i ndërthurjes gjithmonë e më të gjerë në të gjitha fushat si ekonomi, politikë, kulturë, komunikim etj. kërkon që edhe fusha e së drejtës duke qenë në shërbim të fushave të mësipërme ta ndjekë atë. Për rrjedhojë edhe përkthimet në fushën juridike po bëhen gjithmonë e më të kërkuara. Jo vetëm në kuadrin e krahasimit dhe përqasjes së legjislacionit, siç e sqaruam më lart, po edhe në ndihmën e

ndërsjellë juridike që vendet e BE-së, por edhe vendet e tjera jashtë këtij bashkimi, i japin njëri-tjetrit.

2.Fushat e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe faktori gjuhësor

Nën ndikimin e një sërë faktorësh, si rritja e zhvillimi në vazhdimësi i lidhjeve ndërkombëtare në të dyja planet si në atë individual ashtu edhe në atë komunitar (tregtia ndërkombëtare, komunikimi, emigrimi, turizmi etj.) si dhe integrimi politik e ekonomik duke përfshirë edhe integrimin shkallë pas shkalle mes vetë sistemeve ligjore si p.sh. vendet e BE-së, vëmë re se sistemi juridik i një vendi ka të bëjë shumë më tepër me jetën e përditshme dhe mirëqenien e popullsisë, nga ndoshta ç'do të mund ta imagjinonim. E drejta është baza, ndër të tjera, edhe për transaksionet ekonomike si brenda vendit ashtu edhe për investimet e huaja. Kjo gjë është me e dukshme sidomos në vendet më pak të industrializuara siç ishte rasti i Shqipërisë pas viteve 1990. Në këto vende siguria ligjore është një faktor vendimtar për të vendosur mbi realizimin e një projekti.

Në raste të tilla e drejta e një vendi ka për detyrë të ofrojë një siguri sa më të madhe ligjore për investitorët. Kusht për këtë gjë është që e drejta të jetë e qartë dhe e kuptueshme, pra i duhet ofruar investitorit sipas kërkesës së tij edhe e përkthyer dhe kjo është një tjetër fushë, në të cilën kërkohet puna e palodhur dhe e vështirë e përkthyesit. Pra, pavarësisht faktit nëse ligje, konventa a marrëveshje të caktuara ekzistojnë apo jo, që ato të jenë të vlefshme në vende të ndryshme, duhet që këto vende t'i pranojnë duke i futur në legjislacionin e tyre, duke e thënë me një term juridik, duhet që vende të ndryshme t'i *ratifikojnë* këto marrëveshje a konventa ndërkombëtare, ndërkohë që duhet të paraqesin qartë e kuptueshëm edhe vetë legjislacionin e tyre.

Kështu, me ligjin nr. 8498 të datës 10.06.1999 Republika e Shqipërisë ka ratifikuar konventën e Këshillit Evropian "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale" të datës 20 prill, 1957, si dhe protokollin e saj shtesë të datës 17 mars, 1997, ndërsa me ligjin nr. 8883 të datës 18.04.2002 ka ratifikuar protokollin e dytë shtesë të po kësaj Konvente të datës 08.11.2001. Ndërkohë që në nenet 509 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikohet "*Dërgimi i letër porosive autoriteteve të huaja*" [Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Neni 509, fq. 257].

Ndërthurjet ndërkombëtare në tregtinë e jashtme, zgjerimi i turizmit masiv, por edhe numri i lartë i emigrantëve, azilkërkuesve dhe punëtorëve të

huaj nëpër vende të ndryshme, si edhe mundësitë e reja të një bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e luftës kundër krimit pasqyrohen në një numër të madh rastesh me pika lidhjeje në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale. Shumë shpesh dalin çështje të lidhura me ekstradimet, ndihmën juridike, urdhër-arrestet ndërkombëtare dhe ndihmën në ekzekutimin e vendimeve.

Ndihma e ndërsjellë juridike nuk jepet vetëm në fushën e çështjeve penale, por edhe në atë të çështjeve civile. Çdo ndihmë gjyqësore ose administrative në një proces civil që jepet në kuadër ose të një mbështetjeje të një procesi jashtë shtetit ose të një procedure të huaj që zhvillohet në vend është gjithashtu një ndihmë e ndërsjellë juridike e cila realizohet ashtu si në të gjitha rastet vetëm në sajë të faktorit gjuhësor dhe të përkthimeve përkatëse.

Shpesh institucione të tilla si Ministria e Drejtësisë apo Ministria e Punëve të Jashtme merren me çështje të ndihmës së ndërsjellë juridike në të dyja fushat, atë civile e penale, si dhe në të dyja vendet, si në Shqipëri, ashtu edhe në Gjermani.

Në Gjermani në bazë të raporteve të marra nga përfaqësitë e tyre jashtë shtetit, Ministria e Punëve të Jashtme ka krijuar një përmbledhje lidhur me mënyrën e komunikimit me çdo vend në rastet e ndihmës së ndërsjellë juridike, ndërsa në Shqipëri njihet ndihma e ndërsjellë juridike në çështjet civile e familjare, bazuar kjo në marrëveshjet me vendet përkatëse, porse nuk ekziston një përmbledhje e tillë si në Gjermani. Në të drejtën shqiptare ndihma e ndërsjellë juridike në çështjet civile gjendet e pasqyruar pjesërisht edhe në Kodin e Procedurës Civile, përkatësisht në nenet 393-399 "*Njohja e vendimeve të huaja*" [Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, fq. 143, Korrik 2007] të kreu IX në Titullin III "*Gjykimet e posaçme*" [Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, fq. 118, Korrik 2007].

Shumë shpesh ndihma e ndërsjellë juridike në çështje civile kërkohet në çështjet familjare, tregtare e ato administrative. Ajo miratohet bazuar në një kërkesë të gjykatës ose autoritetit përkatës që merret me çështjet juridike ose që sipas së drejtës së shtetit kërkues është autoriteti kompetent për paraqitjen e kësaj kërkesë.

Pjesë e ndihmës së ndërsjellë juridike janë paraqitja e kërkesave, padive, kundërpadive, thirrja e dëshmitarëve, por edhe dorëzimi dhe njohja e vendimeve, përgatitja e ekzekutimit të këtyre vendimeve etj. Në secilin prej rasteve duhet kontrolluar me kujdes nëse ekziston baza ligjore për një bashkëpunim të tillë, pra ratifikimi i traktateve, marrëveshje përkatëse për ndihmë të ndërsjellë

juridike etj. Në rast të ekzistencës së marrëveshjeve të tilla mes dy vendeve autoritetet përkatëse mund të ndërmarrin hapat përkatës për të kërkuar ndihmën e ndërsjellë juridike.

Të gjitha aktet që përmendëm më lart si dhe të gjitha hapat që ndërmerren për përmbushjen e tyre, qofshin ato në fushën e së drejtës civile a të asaj penale, duhet të jenë natyrisht të përkthyer në mënyrë që të mund të përmbushin në fund të fundit edhe qëllimin e tyre. E rëndësishme është që ky përkthim të jetë i mirë, pra jo vetëm i saktë, por edhe i shprehur qartë.

Pikërisht, për këtë qartësi ekzistojnë disa rregulla të përgjithshme, të cilat do të ishte mirë të merreshin parasysh e të zbatoheshin gjatë përkthimit, si gjuha dhe stili i përdorur, varësia nga forma e originalit, mbetja besnik ndaj tij, por në të njëjtën kohë edhe përdorimi i terminologjisë së duhur. Ruajtja e këtyre rregullave duhet t'u shërbejë në fakt të gjitha vendeve shqipfolëse dhe përkthyesit juridikë në këtë pikë duhet të përpiqen së bashku me gjuhëtarët dhe ekspertët e legjislacionit në përdorimin e një gjuhe dhe terminologjie standard.

3. Nevoja e harmonizimit dhe standardizimit të "gjuhës juridike"

"Saktësia e detajit dhe besnikëria ndaj origjinalit e nxjerrin dikë të pafajshëm ose e degdisin në burgim të përjetshëm ..." [Kumbaro, M. (2003): *Kur përkthimi të vë prangat, Shekulli Nr. 329, 28 nëntor 2003, fq. 15*], shkruante në 2003-shin, M. Kumbaro. Një konstatim ky, i vërtetë në të gjitha kohërat, pasi ne si përkthyes të teksteve juridike e dimë shumë mirë se pikërisht këto tekste kushtëzojnë mbi të gjitha kuptueshmëri të lartë, por jo gjithmonë ata formulohen në mënyrë të kuptueshme. Është e rëndësishme që jo vetëm në formulim, por edhe në përkthim të zgjidhet një gjuhë e thjeshtë, duke hequr dorë nga fjalët e huaja, si dhe të përdoret një strukturë e qartë e tekstit. Edhe nga pikëpamja juridike formulimet duhet të jenë të sakta.

Në këtë kuadër një nga detyrat kryesore të përkthyesit është që të përkthejë përmbajtjen e teksteve juridike në një gjuhë që është e pranueshme dhe e kuptueshme nga marrësi/lexuesi. Sfidë në këtë proces është gjetja e formulimeve, të cilat nga ana juridike janë të sakta, por edhe njëkohësisht të kuptueshme. Pikërisht, kjo sfidë kushtëzon edhe nevojën apo domosdoshmërinë për një gjuhë juridike standarde dhe një terminologji juridike të mirëpërcaktuar, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjitha trevat shqipfolëse.

E drejta në çdo vend ka si instrument të vetëm të saj in gjuhën, por që kjo gjuhë të jetë e

qartë dhe e kuptueshme, ajo duhet t'u përgjigjet disa rregullave e standardeve, të cilat kohët e fundit kanë filluar fatkeqësisht t'i mungojnë gjuhës sonë.

Kështu në këtë pikë mund të shtrojmë pyetjen shumë të rëndësishme, se ku jemi me kombëtarizimin, ose nëse duam, me përshtatjen a përkthimin dhe përvetësimin, futjen në fjalor të fjalëve që hyjnë në përdorimin tonë sot, me zhvillimin që ka marrë Shqipëria.

"Akademiku Esat Stavileci nga Kosova ... duke tërhequr vëmendjen në dinamikën e zhvillimit të gjuhës, shkon në të njëjtën arsye si kolegët e tij se, ka ardhur si kërkesë e kohës, unifikimi i terminologjisë dhe në një proces më të ngushtë tha se ka një shkallë të lartë të mosidentifikimit të termave në shqipe, ku përdoren gabimisht terma, nga mosnjohja ose nga njohja e sipërfaqshme." [V. M. (2009): *Ku jemi me kombëtarizimin e terminologjisë!, Standard, 20.06.2009, fq 18*]

Sigurisht që fenomene të tilla janë më se të njohura dhe shpesh të kushtëzuara edhe nga faktorë të jashtëm, si p.sh. ardhja e specialistëve të huaj, të cilët sigurisht sjellin me vete edhe terminologjinë në gjuhën e tyre, por shpesh edhe punësimi i përkthyesve të pa specializuar dhe që nuk bashkëpunojnë si duhet me specialistët e fushës përkatëse, mangësitë e këtyre të fundit në njohjen e gjuhës shqipe, siç është rasti i përdorimit të fjalës *sezonalitet* në një nga konferencat ndërkombëtare të organizuara nga MZHUT-ja, mungesa e korrektorëve dhe redaktorëve, duke u lënë kështu në dorë përkthyesve që të ushtrojnë njëkohësisht jo vetëm profesionin e tyre, por edhe atë të korrektorit e të redaktorit. Pikë kjo në të cilën jo gjithmonë kanë sukses dhe ku shpesh shqipja e tyre ndikohet nga shqipja e çalë e "asistentëve" që punojnë nëpër institucione dhe që me injorancën e tyre u kundërvihen në pafundësi rregullave të gjuhës shqipe duke e bastarduar atë. Mund të jap këtu si shembull pjesë të programit të konferencës së sipërpërmendur me temë "Menaxhimi i Sezonalitetit në Turizëm". Vetëm në temë kemi: një fjalë të përdorur nga gjuha e huaj dhe jo në shqip pra në vend të fjalës *menaxhim* do ishte mirë të përdornim fjalën *administrim*; përdorimin e një fjale që nuk ekziston fare në shqip siç është fjala *sajuar sezonalitet*, e ardhur nga përkthimi shkel e shko i fjalës *seasonality*; si dhe një fjalët të prejardhur që ka hyrë dhe përdoret sot normalisht në shqip, pra që ka bërë vend në fjalorin e gjuhës shqipe. Me dëshirën për ta thënë si në gjuhë të huaj, personat që janë marrë me përgatitjen dhe përkthimin e materialeve të konferencës nuk e kanë vrarë shumë mendjen për të thënë në shqip temën dhe njëkohësisht edhe qëllimin e konferencës, pra shtrirjen e turizmit jo

vetëm në sezone, por për gjatë gjithë vitit. Programi përmban edhe shumë e shumë probleme të tjera, si përdormi i emërtimeve të gjinisë mashkullore edhe për femra, në një kohë që gjuha shqipe i përmban këto emërtime edhe në gjininë femërore: *ministër* për ministre; ose përdorimin e formave të gabuara të emërtimeve si *drejtore* në vend të drejtoreshë; ose formulime të tilla si *profesor i merituar*, apo *tryezë ministrove*; pa shtuar këtu shembuj të shumtë të përdorimit të fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe.

Të gjitha këto na bëjnë të reflektojmë lidhur me gjendjen e gjuhës sonë sot dhe me nevojën e ekzistencës së një instituti dhe të një shoqërie aktive që duhet të kërkojnë respektimin e asaj që e dallon në të vërtetë një komb, pra të gjuhës.

Ndodhur në këto kushte sigurisht që është e domosdoshme që gjuha shqipe jo vetëm të ruhet me forcë, duke iu kundërvënë këtyre veprimeve, por edhe të gjenden mënyrat e bashkëpunimit e bashkëveprimit jo vetëm brenda për brenda Shqipërisë, por në të gjitha trevat shqipfolëse, në mënyrë që të arrihet një lloj standardizimi, i cili është i domosdoshëm sot, kur terminologjia e papërshtatshme dhe e më së shumti në gjuhë të huaj po hyn pikërisht edhe nga këto treva.

Në ditët e sotme bashkëpunimi në fushën e standardizimit të terminologjisë me qëllim realizimin e një gjuhe sa më të saktë, pa kufizime dhe përjashtime, por në të njëjtën kohë edhe me terma të qartë është kthyer në domosdoshmëri.

Puna e bërë për përkthimin e “*acquis communautaire*” e dëshmon këtë gjë, pasi fjalori terminologjik i ngritur në këtë kuadër për fushat më të rëndësishme si “*tregu i brendshëm, doganat dhe tregtia, bankat, shërbimet financiare*” [Vuksani, R.; Spahia, S. (2006): *Manual për përkthimin e legjislacionit komunitar, Prill 2006, fq. 5*] duhet t’i shërbejë të gjitha trevave shqipfolëse. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për modelet e akteve të përkthyer në shqipe, pasi edhe këto modele do duhet t’u shërbejnë jo vetëm përkthyesve në vend, por do të jenë edhe bazë shkëmbimesh me trevat shqipfolëse e do të ndihmojnë në unifikimin e terminologjisë së përdorur.

Standardizimi i terminologjisë nënkupton një punë të vazhdueshme bashkërenduese në fusha të ndryshme, por sigurisht edhe në atë juridike. Terminologjia është një fushë që zhvillohet në vazhdimësi, fenomen ky i kushtëzuar nga faktorët e përditshëm dhe natyrisht nga hapja ndaj vendeve të tjera, ndaj nuk mund të themi asnjëherë se kemi arritur një standardizim të plotë të saj.

4.Probleme që lidhen me përkthimin e

terminologjisë juridike dhe kapërcimin e interferencës leksikore e stilistikore

Standardizimi i terminologjisë është natyrisht një domosdoshmëri e pashmangshme për të gjithë përkthyesit, pasi e lehtëson punën e tyre, por nga ana tjetër ai nuk është mjeti i vetëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punës si përkthyes.

Në disa fusha të përkthimit pragmatik si shkenca, teknika apo ekonomia zhvillimi aktual i botës drejt globalizimit ka bërë që realitetet dhe fjalët të për afrohen. Një term teknik apo shkencor, në përgjithësi do të ketë të njëjtin referent universal e kështu edhe një ekuivalent të saktë në një gjuhë të caktuar. Detyra e përkthyesit në këto raste është relativisht e thjeshtë, pasi në këto raste kërkohet një njohje e mirë e terminologjisë, sintaksës dhe stilistikës së gjuhëve. Bota juridike është e ndryshme. Çdo sistem i së drejtës karakterizohet nga veçoritë e tij thelbësore, të cilat janë të kushtëzuara nga fakti se e drejta lind dhe zhvillohet në një kontekst të caktuar shoqëror për t’iu përgjigjur specifikave të një komuniteti. Në këtë mënyrë e drejta shpreh në një shkallë më të lartë të saj edhe kulturën pasi u referohet institucioneve të ndryshme njerëzore.

Gjuha është instrumenti i vetëm i së drejtës dhe mund të themi njëkohësisht edhe se përballë ligjëratave krejtësisht të ndryshme, përkthyesi është i detyruar të lidhë disa kompetenca, përveç atyre gjuhësore, ashtu siç i gjejmë në shumicën e rasteve tek përkthyesit letrarë, ose edhe tek përkthyesit e gjuhëve të specialiteteve, por shumë rrallë tek të dy. Them rrallë te të dy pasi të tjera kompetenca jashtëgjuhësore i duhet të ndërthurë përthyesit letrar e të tjera përkthyesit pragmatik.

Ky konstatim është natyrisht i vlefshëm edhe në rastin e përkthyesit të gjuhës juridike dhe na bën pra të reflektojmë mbi karakteristikat e së drejtës që në fakt, jo rrallë herë, janë edhe pengesa në përkthim.

Këtu duhet të sqarojmë se problemet në përkthim nuk janë vetëm problemet e përkthyesit. Ky i fundit mund të ketë boshllëqe në njohjen e gjuhëve me të cilat punon, me njohjen e subjektit që trajtohet në origjinal, ose në planin metodologjik. Supozohet se këto probleme individuale i zgjidh traduktologjia si dhe informacioni i plotë që një përkthyes i mirëfilltë merr lidhur me formimin e tij të përgjithshëm e me atë profesional. Përpara përkthyesit shtrihen ama edhe problemet tjera, brenda dhe jashtë gjuhësore, të cilat lindin së pari nga ndryshimi ndërmjet sistemeve të së drejtës. Kështu me përjashtim të faktit që kufiri ndërmjet së drejtës dhe sistemeve të tjera sociale nuk është i

mirëpërcaktuar, konstatojmë edhe se çdo shoqëri ka sistemin e saj të së drejtës.

Cilat do qofshin, pra gjuhët e pranishme, përkthyesit i duhet të kalojë pengesën e shkaktuar nga ndryshimet e sistemit gjuhësor dhe nga pengesat kulturore, duke i dhënë rëndësi ndryshimeve të sistemeve juridike, pasi çdo shoqëri përpunon një të drejtë, e bashkë me të një sistem juridik, që i përshtatet asaj të drejte, por edhe shoqërisë, prej së cilës buron.

Fakti që e drejta është e lidhur ngushtë me një sistem social shpjegon pra, edhe disa vështirësi specifike në përkthimin juridik, ndërkohë që vështirësi të tjera paraqiten në lidhjet që ekzistojnë ndërmjet teksteve juridike me disiplinat e tjera si p.sh. me ekonominë.

Gjuha juridike është qartësisht pjesë e gjuhëve të specialitetit (*Fachsprachen*) dhe nuk përcaktohet vetëm nga një pjesëmarrje e lartë në leksikon terminologjik të shkurtesave ose inicialeve në rrafshin mikrostrukturor, por edhe nga karakteristika që e kalojnë rrafshin e fjalës, si për shembull përdorimi i frazeologjizmave dhe fjalive stereotipe, si dhe nga cilësitë makrostrukurore, si për shembull një sintaksë komplekse dhe rregulla të caktuara të ndërtimit të tekstit.

Konvencionet përkatëse të gjuhës juridike burimore (*Ausgangssprache*) dhe të asaj përfundimtare (*Zielsprache*) luajnë një rol shumë të rëndësishëm gjatë përkthimit të teksteve juridike, po jo gjithmonë është e lehtë që pikërisht këtu të

gjejnë ekuivalentet dhe jo vetëm në rrafshin e fjalës, por edhe në rrafshet e tjera, si në atë të ekuivalencës së normës së tekstit dhe në atë pragmatike.

Përkthimi juridik paraqitet kështu si tejet kompleks jo vetëm për shkak të veçorive gjuhësore, por edhe të atyre jashtëgjuhësore. I diskutueshëm në këtë pikë është kreativiteti gjatë përkthimit juridik, i cili mbështetet kryesisht në rastet e përkthimit të bazës ligjore. Çështja bëhet më e ndërlikuar dhe kreativiteti i përkthyesit kërkohet ndoshta më tepër në rastet kur përveçse dy gjuhë të ndryshme në një vend ka edhe dy sisteme të ndryshme juridike. Siç është për shembull rasti i Kanadasë.

Sigurisht që në raste të tilla kreativiteti nuk duhet keqkuptuar, ai duhet t'i shërbejë vetëm dhe vetëm qartësisë së tekstit përfundimtar duke lehtësuar kështu kuptimin e tij. Kjo do të thotë që përkthyesi nuk duhet ta shohë veten si një krijues a ligjberës, porse në momentin që e sheh të arsyeshëm të ndërmarrë veprimin e duhur për ta bërë tekstin përfundimtar sa më të qartë.

Këtu mund të them se edhe dokumente të lëshuara pikërisht nga institucione shtetërore e vuajnë këtë gjë, si p.sh. Diplomat e Masterit të Mjekësisë, ku, veç problemeve të tjera, folja mungon dhe për ta përkthyer në gjermanisht, përkthyesit i duhet që ta gjejë, ta sajtojë, ta përshtatë foljen që duhet të përdorë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DIPLOMË

MASTER I SHKENCAVE NË MJEKËSI E PËRGJITHSHME

Z./Znj. _____ Lindur në _____, më _____

Regjistruar më _____

Me përfundimin e detyrimeve akademike të programit të studimeve me kohë të plotë dhe mbrojtjen e tezës së diplomës në datën _____.

Nr. i diplomës

Numër i matrikullimit

Data e lëshimit

DEKAN

REKTOR

Vetëkuptohet që edhe në rastet e lejuara apo të domosdoshme, kreativiteti nuk duhet të ndikojë në interpretimin dhe përdorimin e teksteve të përkthyer. Për më tepër ai mund të përdoret kur bëhet i domosdoshëm përdorimi i mjeteve inovative për të kapërcyer ndryshimet ndërmjet sistemeve juridike dhe gjuhëve të veçanta, për të rritur në këtë mënyrë kuptueshmërinë e tekstit burimor, veçse kjo gjë mund dhe duhet të përcaktohet rast pas rasti, gjithmonë bazuar në situatën komunikative.

Fakti që gjuha juridike si për nga zhvillimi historik, po ashtu edhe sot, është një gjuhë e lidhur me të drejtën kombëtare, e dallon atë nga gjuhët e tjera terminologjike të disiplinave të ndryshme të shkencave natyrore, objekti i të cilave është ndërkombëtar.

Ky fakt bën që pikërisht përkthimi të bëhet më i vështirë, sidomos për sa i përket përjasjes së elementeve kulturorë e kombëtarë, të cilët janë më të vështirë në pjesën e paraqitjes në tekstin përfundimtar. Për më tej përmbajtja e nocioneve

juridike ndjek përkufizimet përkatëse në bazën ligjore të çdo vendi dhe për këtë arsye paraqet kërkesa të veçanta për përkthimin terminologjik.

Këtu mund të themi se edhe në rastin kur disa shtete kanë të njëjtën gjuhë zyrtare, si p.sh. gjermanisht për Gjermaninë, Zvicrën dhe Austrinë ekziston një ndryshim i dukshëm në gjuhën e përdorur juridike. Ndërkohë që Gjermania shkon drejt një gjuhe më shkencore dhe më pak të kuptueshme për njerëzit e thjeshtë, Zvicra tenton të kundërtën. Gjuha juridike e përdorur është më e thjeshtë dhe më lehtësisht e kuptueshme jo vetëm për nga fjalori, por edhe për nga mënyra e ndërtimit të fjalisë, për nga stili i përdorur etj. gjë që u mundëson njerëzve të thjeshtë që të kuptojnë një pjesë të mirë të gjërave pa qenë nevoja t'i drejtohen avokatit apo juristit.

Vëmë re gjithashtu se përkthimi juridik, cilado qoftë gjuha burimore dhe ajo përfundimtare, paraqet vështirësi përkthimore të lidhura ngushtë jo vetëm me fjalën dhe me gjuhën e përdorur, por me vetë sistemin juridik dhe mënyrën e organizimit të tij që ndryshon jo vetëm nga njëri vend në tjetrin, por edhe në ato vende që flasin të njëjtën gjuhë. Sigurisht që vështirësia e përkthimit nuk shtrohet pra në këto raste vetëm në gjetjen e fjalës ekuivalente, por edhe të institucionit ekuivalent, të veprës ekuivalente e kështu me radhë.

Kësaj problematike nga ana tjetër i shtohet edhe problematika e gjetjes dhe përdorimit të strukturës së duhur sintaksore e stilistikore, në mënyrë që përmes kombinimit sa më të mirë të rrafshëve si: kuptimor, leksikor, gramatikor e

stilistikor të mund të realizojmë një përkthim sa më të denjë. I denjë do të thotë mbi të gjitha i saktë për nga ana informative dhe i kuptueshëm për marrësit.

Edhe mikro e makro struktura e një teksti përbëjnë një problem në përkthim, pasi shpesh përkthyesit i duhet të shtrojë pyetjen se si duhet ta përshtatë për nga ana strukturore përkthimin. A duhet të ruajë strukturën e tekstit burimor apo atë të tekstit përfundimtar.

Të gjitha këto probleme sigurisht që e vështirësojnë punën e përkthyesit juridik, duke e kthyer atë në një sfidë, por sfidat janë, për shkak të natyrës së tyre, edhe të bukura.

5. PËRFUNDIME

Harmonizimi dhe standardizimi i gjuhës juridike del sot si një nevojë e domosdoshme për Shqipërinë. Harmonizim dhe standardizim i gjuhës së përdorur edhe në trevat e tjera shqipfolëse. Ky do të ishte një kusht për të mundësuar detyrat e së drejtës siç është p.sh. vendosja e paqes dhe stabilitetit, nxitja e investimeve të huaja, e cila mund kryhet vetëm duke krijuar një siguri të lartë juridike për investitorët e huaj, mënjanimi i formaliteteve dhe burokracisë, thithja e kapitaleve të huaja dhe mbajtja e tyre brenda vendit, kushtëzojnë dhe kërkojnë një transparencë të lartë të së drejtës dhe sigurisht kjo mund të arrihet për investitorët e huaj vetëm nëpërmjet një përkthimi të mirë, i cili lehtësohet kur gjuha juridike e vendit ka një standard të caktuar dhe ndjek po të njëjtat rregulla e norma.

6. BIBLIOGRAFI

- De Groot, G.-R., Schulze, R. (1999): *Recht und Übersetzen, Baden Baden, Nomos*
- Duro, A. (1997): *Terminologjia në ligjërimin e specializuar, Studime filologjike 1997, fq.71-78*
- Eco, U. (2001): *Disa mendime rreth përkthimit, Mehr Licht nr. 18, 2001, fq. 179-186*
- Fitzgerald, R. (1997): *Përkthimi, Mehr Licht Nr. 3, Maj 1997, fq. 183-194*
- Kokona, V. (1997): *Mbi përkthimin. Mehr Licht, Nr. 3, Maj 1997, fq. 48-63*
- Koller, W. (1992): *Einführung in die Übersetzungswissenschaft, Heidelberg, Quelle & Meyer*
- Kumbaro, M. (2002): *Përkthimi pedagogjik dhe Pedagogjia e përkthimit, Kurrikula dhe shkolla, Gjuhë e huaj, Nr. 1, 2002, fq 120-128*
- Kumbaro, M. (2003): *Kur përkthimi të vë prangat, Shekulli Nr. 329, 28 nëntor 2003 fq. 15*
- Kumbaro, M. (2004): *Përkthimi ndodh në zemër të kulturave, Shekulli, 11 qershor 2004, fq 18*
- Lafe, E (2009): *Terminologjia si problem gjuhësor dhe kombëtar, Standard, 20.06.2009, fq. 18, 19*
- Lampe, E.-J. (1970): *Juristische Semantik, Bad Homburg 1970*
- Lashöfer J. (1992): *Zum Stilwandel in richterlichen Entscheidungen. Über stilistische Veränderungen in englischen, französischen und deutschen zivilrechtlichen Urteilen und in Entscheidungen des Gerichtshofs der Europäischen Gemeinschaften, Münster, Waxmann*
- Reiss, K. (1993): *Texttyp und Übersetzungsmethode – Der operative Text. 3. Aufl. Heidelberg, Julius Groos Verlag.*
- Ristani, V. (2000): *Përkthimi dhe kritika e përkthimit në kuadrin e studimeve përkthimore, Studime albanologjike, Nr. 1, 2000, fq. 87-99*
- Sander, G. Gerald (2004): *Deutsche Rechtssprache, Ein Arbeitsbuch, Francke Verlag Tübingen und Basel, 2004*

Schmidt-König, Ch. (2005): *Die Problematik der Übersetzung juristischer Terminologie. Eine systematische Darstellung am Beispiel der deutschen und französischen Rechtssprache*, Münster/Hamburg/London
Vuksani, R.; Spahia, S. (2006): *Manual për përkthimin e legjislacionit komunitar*, Prill 2006, fq. 5
Weisflog, W. (1996): *Rechtsvergleichung und juristische Übersetzung: Eine interdisziplinäre Studie*, Zürich, Schulthess

INTERNETI

<http://www.konsularinfo.diplo.de>

<http://www.hjr-verlag.de>

<https://www.bundesjustizamt.de>

www.lg-frankfurt.justiz.hessen.de

<http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/PDF/Albanian/030-Albanian.pdf>

<http://dejure.org/gesetze/StGB>

<http://www.gesetze-im-internet.de>

<http://www.jura.uni-sb.de>

<http://www.juris.de/jportal/index/.jsp>

<http://www.online-recht.de>

<http://iate.europa.eu/SearchByQueryLoad.do?method=load>

KUNDRINA E DREJTË NË GJUHËN GJERMANE NË PËRQASJE ME KUNDRINËN E DREJTË NË GJUHËN SHQIPE

EVI KONJARI

DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Artikulli synon të vëre përballë njëri-tjetrit trajtimin kundrinës së drejtë në gjuhën gjermane me kundrinën e drejtë në gjuhën shqipe duke u bazuar në pothuaj të gjitha gramatikat tradicionale të dy gjuhëve. Pas një vështrimi të shkurtër të përgjithshëm, rreth kundrinave në të dy gjuhët, do të merret në shqyrtim kundrina e drejtë në gjuhën gjermane duke ilustruar veçoritë e saj me shembuj dhe më pas kundrina e drejtë në gjuhën shqipe. Në përfundim do të evidentohen dallimet kryesore mes kundrinave të drejta në të dy gjuhët.

Fjalë çelës: kundrina e drejtë, gjymtyrë të dyta, gramatika tradicionale, rasa kallëzore, trajta e shkurtër.

Abstract

This article aims to make a confrontation between the analyses of the direct object in the German language and the direct object in the Albanian language, based in almost all the elements of traditional grammar in both languages. After a concentrated overview of the objects in both languages, the article will analyze the direct object in the German language by illustrating its features with examples and subsequently the direct object in the Albanian language. As a conclusion the major differences between the direct objects in both languages will be highlighted.

Key words: direct object, secondary sentence parts, traditional grammar, accusative case, objects scrambling.

HYRJE

Kundrinat zënë një vend qendror për nga rëndësia në gramatikë përse i përket gjymtyrëve të dyta. Kundrinat janë gjymtyrë të dyta me të cilat shprehen raporte objektore në mes një veprimi a tipari dhe objektit të tij, zakonisht ndërmjet një emri a një fjale tjetër emërore, të lidhur me drejtim me një folje a mbiemër. Më së shumti ato shënojnë objektin e veprimit që shpreh folja. Si në gjuhën shqipe dhe në atë gjermane kundrinat ndahen në kundrina të drejta, të zhdrejta dhe me parafjalë. Në dallim nga gjuha shqipe në gjuhën gjermane kemi dhe një kundrinë të katërt, atë të rasës gjinore, e cila në ditët e sotme po zëvendësohet me atë më parafjalë, por që gjen ende përdorim në stilin letrar.

Kundrina e drejtë si dhe kundrina e zhdrejtë janë kundrinat që hasen më shpesh në të dyja gjuhët.

Pas një vështrimi të shkurtër të përgjithshëm rreth kundrinave në të dy gjuhët do shqyrtoj kundrinën e drejtë në të dy gjuhët duke nxjerrë në pah të përbashkëtat dhe veçoritë mes tyre.

1. Vështrim i përgjithshëm rreth klasifikimit dhe llojeve të kundrinave në të dy gjuhët

Në fillim dua të jap një vështrim të përgjithshëm të llojeve të kundrinave në gjuhën shqipe dhe atë gjermane si dhe mënyrës së klasifikimit të tyre.

Klasifikimi i kundrinës si në gjuhën gjermane ashtu dhe në atë shqipe varet nga faktorë morfologjikë dhe semantikë (i drejtë/ i zhdrejtë; direktës/indirektës objekt).

Një fenomen gramatikor karakteristik i gjuhës gjermane është ai i reksionit të foljeve, pra që folje të caktuara kërkojnë një rasë të caktuar. Foljet në

gjuhën gjermane kërkojnë rasën kallëzore, dhanore apo kallëzore dhe dhanore, si dhe një numër shumë të vogël foljesh kërkojnë rasën gjinore.

Në gjuhën gjermane dallohen 4 llojet e mëposhtme të kundrinave: Akkusativobjekt (kundrina e drejtë), Dativobjekt (kundrina e zhdrejtë), Genitivobjekt (kundrina e rasës gjinore) dhe Präpositionalobjekt (kundrina e zhdrejtë me parafjalë).

Në gjuhën shqipe dallohen tre lloje kundrinash: kundrina e drejtë, kundrina e zhdrejtë dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë.

Sipas valencës së një lekseme foljore një kundrinë si në gjuhën gjermane ashtu dhe në atë shqipe mund të shfaqet në fjali e vetme ose e shoqëruar me lloje të tjera kundrinash.

Kundrina e drejtë dhe kundrina e zhdrejtë janë kundrinat që hasen më shpesh në të dyja gjuhët.

Ndërmjet kundrinës së drejtë, të zhdrejtë dhe asaj me parafjalë në të dyja gjuhët ka vetëm disa ndryshime të vogla. Dy ndryshimet thelbësore janë kundrina e rasës gjinore (Genitivobjekt) në gjermanisht, e cila në gramatikën e gjuhës shqipe nuk ekziston dhe trajta e shkurtër (Objektverdoppelung) në shqip, e cila nuk haset në gramatikën e gjuhës gjermane. Trajta e shkurtër (Objektverdoppelung) është një dukuri sintaksore, e cila nga ana morfologjike shfaqet në vendosjen e një tipari të kundrinës pranë foljes, e cila e kërkon atë, (Buchholz, O; Fiedler, W, "Albanische Grammatik", Leipzig 1985).

2. Kundrina e drejtë në gjuhën gjermane (Akkusativobjekt)

Kundrina e drejtë është kundrina që haset më

shpesh jo vetëm në gjuhën gjermane, por edhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane. Në përgjithësi përcakton objektin, i cili pëson direkt veprimin e shprehur me anë të foljes. (Henschel/Weydt; 2003 Fq. 366)

Ashtu si në gjuhën shqipe dhe në atë gjermane kundrina e drejtë shprehet me anë të një gjymtyre në rasën kallëzore. (rasa gjendet me anë të lakimit, por kur kjo nuk është e mundur e gjejmë me anë të provës së zëvendësimit). Duke qenë një gjymtyrë në rasën kallëzore mund të gjendet me pyetjen “kë?” ose “çfarë?”. (Duden 4; 1984 Fq. 576)

Në një gramatikë të gjuhës gjermane (inhaltsbezogenegrammatik) ajo quhet si në gjuhën shqipe kundrinë e drejtë, duke qenë se përfaqëson objektin e prekur direkt nga një veprim ose një ndodhi. Një tipar i rëndësishme sintaksor i kundrinës së drejtë në gjuhën gjermane është se kur fjalia kthehet në pësore kundrina kthehet në kryefjalë. (Pittner/Berman; 2004 Fq. 36) P.sh.: *Sie öffnet das Fenster. Das Fenster wird geöffnet. Ajo hap dritaren. Dritarja u hap.*

Ashtu si në gjuhën shqipe, dhe në atë gjermane kundrinat e drejta shpesh hasen me folje të caktuara kalimtare. Në gjuhën gjermane ekziston një listë foljesh të cilat kërkojnë vetëm rasën kallëzore. Në numër i vogël foljesh i pranon të dyja rasat pra si atë dhanore dhe kallëzore. Ashtu si kryefjala edhe kundrinat e drejta nuk kanë kuptim të njehsuar. Kundrina e drejtë në gjuhën gjermane përcakton më shpesh një send sesa një frymor. Në kuptimin më të gjerë të saj ajo përcakton një “objekt”, domethënë një send që preket nga një veprim ose mbi të cilin bie veprimi, p.sh.:

Er repariert das Auto.

Ai rregullon makinën.

Në rastin e disa foljeve të veçanta kundrina e drejtë përcakton rezultatin e një veprimi, p.sh.: *Sie schreibt einen Brief.*

Ajo shkruan një letër.

Disa folje mund të qëndrojnë edhe vetëm me kundrinë të drejtë të shprehur me një përemër, p.sh.: *Das interessiert dich nicht.*

Kjo nuk të intereson ty.

Pra, në shembujt e mëparshëm kundrina e drejtë përcakton një frymor, për të cilin dëshmohet diçka rreth gjendjes së tij trupore dhe shpirtërore, (Duden 4; 1997, Fq. 347). Në gjuhën gjermane ashtu si dhe atë shqipe, në rrafshin semantik bëjmë dallimin ndërmjet kundrinës së drejtë të brendshme dhe asaj të jashtme.

Kundrina e brendshme përcaktohet së pari nga veprimi, p.sh.: *Er wäscht das Kind.*

Ai lan fëmijën.

Ndërsa kundrina e jashtme qëndron e pavarur nga veprimi, p.sh.: *Ich streiche die Tür. Unë lyej derën.*

Në aspektin morfologjik, të gjitha pjesët e ligjëratës dhe togfjalëshat që shfaqen si kryefjalë mund të kryejnë funksionin e kundrinës së drejtë, meqë pjesët e ligjëratës mund të kryejnë funksione të ndryshme në fjali. Kundrina e drejtë në gjuhën gjermane mund të shprehet me:

Emra dhe emra të zgjeruar nga përcaktorë, p.sh.:

Gestern habe ich Daniel getroffen. Dje takova Danielin

Ich kann deinen alten Schaukelstuhl nicht ausstehen. Unë nuk e pëlqej karrigen tënde të vjetër lëkundëse.

Përemra, numërorë dhe paskajore të zgjeruar, p.sh.:

Sie kennt ihn gut. Ajo e njeh mirë atë.

Von meinen neuen Kollegen kenne ich erst ein Drittel. Nga kolegu im i ri njoh vetëm çerekun.

Ich habe vor, ihm gründlich die Meinung zu sagen

E kam në plan t'ia them hapur mendimin tim.

Lidhëza “es”(që), p.sh.:

Ich hasse es, dass du ständig zu spät kommst.

E urrej faktin që vjen përherë me vonesë.

Lidhëzën “që” mund ta hasim në paskajoret e zgjeruar por dhe në fjalitë e nënrenditura.

Në të dyja rastet lidhëza është shumë e rrallë dhe e hasim në disa folje të veçanta që shprehin një gjendje emocionale, si p.sh: urrej, ndjej neveri, më vjen keq, dua, parapëlqej.

Mbiemra të emëruar dhe pjesore, p.sh.:

Ich trage am liebsten Rot.

Unë preferoj të kuqen.

Er wiederholte das bereits Gesagte.

Ai përsëriti të sapothënë.

Paskajore të emëruar me ose pa nyje dhe përcaktorë, p.sh.:

Sie verabscheut das ewige Kochen und Putzen.

Ajo e urren gatimin dhe pastrimin e përhershëm.

Fjali të nënrenditur, p.sh.:

Sie erfuhr, dass das Flugzeug verspätung hatte.

Ajo mori vesh se treni do të vonohej.

Për shkak të funksionit në fjali, këto fjali quhen **fjali kundrinore** (Objektsätze).

Ligjëratë të drejtë, p.sh.:

Sie sagte: Ich komme gleich

Ajo tha: Vij menjëherë.

Sipas valencës së leksemës së foljeve mundet që një kundrinë e drejtë të haset së bashku me një kundrinë të zhdrejtë apo një kundrinë të zhdrejtë me parafjalë, p.sh.:

Wir haben ihnen das beste Zeugnis ausgestellt.

I pregatitëm atyre dëftesën më të mirë të mundshme.

Man vermochte **ihn mit begütigen Wörtern** zu beruhigen.

U përpoqën **ta** qetësonin **me fjalë ngushëlluese**.

Gjithashtu një kundrinë e drejtë e rasës kallëzore mund të kombinohet edhe me një kundrinë të rasës gjinore, p.sh.:

Ich versichere **Sie meines uneingeschrenkten Vertrauens**.

I sigurova **ata** të kishin **besim** tek unë.

Në gjuhën gjermane ashtu si dhe në atë shqipe, ka gjithashtu raste ku në të njëjtën fjali mund të hasen dy kundrina të drejta. Në këtë rast bëhet fjalë për kundrina të drejta të dyfishta që hasen vetëm të shoqëruara nga disa folje të caktuara, si: fragen, kosten, lernen (pyes, kushtoj, mësoj), p.sh.: *Deine Unversichtigkeit* ëird **dich** doch **das Leben** kosten.

Pakujdesia jote do të **të** kushtojë **jetën**.

3. Kundrina e drejtë në gjuhën shqipe

Kundrina e rasës kallëzore, pra kundrina e drejtë ashtu si në gjermanisht përcakton një objekt, veprimi i të cilit shprehet nga folja. P.sh.: .

Er kauft ein Heft. Ai blen **një fletore**.

Në gjuhën shqipe kundrina e drejtë të gjendet me anë të pyetjes: “kë?”, “cilin?”, “cilën?”, “çfarë?”.

Kundrina e drejtë mund të shprehet vetëm me folje kalimtare veprorë. Karakteristikë e kundrinës së drejtë është kthimi i saj në kryefjalë, kur folja që plotëson ajo shndërrohet në pësore. (Gramatika e gjuhës shqipe; 2002 Fq. 253)

P.sh.: *Reforma e re arsimore ka hapur* **prespektiva të mëdha** për zhvillimin e arsimit.

Prespektiva të mëdha për zhvillimin e arsimit janë hapur nga reforma e re arsimore.

Nga ana semantike si në gjermanisht ashtu edhe në shqip, dallojmë dy lloje kundrinash të drejta: kundrina e drejtë e brendshme dhe kundrina e drejtë e jashtme.

Kundrina e drejtë e brendshme shfaqet veçanërisht përmes veprimit dhe tregon rezultatin e tij:

p.sh.: *prodhoj* **makineri**, *ndërtoj* **banesa**, *hap* **kanale**.

Në gjuhën e përditshme është i kufizuar numri i foljeve jokalimtare që kërkojnë këtë lloj kundrine të drejtë, p.sh: fle, jetoj, flas, veroj, luftoj, ëndërroj. Nganjëherë në gjuhën letrare përdoren edhe folje të tjera. (Gramatika e Gjuhës Shqipe; 2002 Fq. 254)

Kundrina e drejtë e jashtme qëndron e pavarur nga veprimi, p.sh.: *këmbej* **librat**, *tund* **kokën**, *pyes* **çupën**, *tall* **frikacakët**.

Kundrina e drejtë mund të shprehet me:

Grup emëror në rasën kallëzore, p.sh.: *Gjuhëtarët e hartuan* **fjalorin e ri**.

Fjali të nënrenditur ose kundrinore, p.sh.: *Na premtuan* **se do të botohet**.

Strukturë foljore, më së shumti përmes një foljeje në lidhore, p.sh: *Na premtuan* **ta botojnë**.

Emër në rasën kallëzore, p.sh.: *Djali i vogël mbaroi* **detyrat**.

Përemër të çdo lloji me përdorim emëror, p.sh.: **Këtë** s’ma ke thënë.

Mbiemër të emëruar, p.sh: *Të gjithë ia donin* **të mirën**.

Numëror me përdorim emëror, p.sh.: *Pesa e shumëzuar me dy jep* **dhjetë**.

Me një pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës, p.sh.: *Kish dëgjuar të vërteta e të rreme* për të.

Kundrina e drejtë mund të shoqërohet me trajtë të shkurtër në disa raste. Kjo do të thotë se mund të shprehet nga një tipar kundrinor në rasën kallëzore, gjë e cila nuk ndodh në gjermanisht, p.sh.:

Sot takova **Agimin**. (pa trajtë të shkurtër)

Sot e takova **Agimin**. (me trajtë të shkurtër) (Buchholz/Fiedler; 1987 Fq. 437).

Trajta e shkurtër e kallëzores përdoret kur :

Kundrina e drejtë i përket temës por nuk mban theksin kryesor të fjalisë.

Kur emri bërthamë i grupit emëror është një përemër dëftor i vetës së tretës që shpreh një frymor apo një send, të cilat janë të njohura për shkaqe konstitutive dhe kontekstuale.

Rrethanat e përdorimit të kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër varen më së shumti nga veçoritë gramatikore të kundrinës dhe nga kushtet e procesit të komunikimit, veçanërisht nga lidhjet me kontekstin. Këto vërehen mbi të gjitha në lidhjen e ngushtë ndërmjet kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër, ndarjes temë-remë dhe intonacionit. (Buchholz/Fiedler; 1987, Fq. 440)

Nga ana tjetër një veçori që nuk ndodh në gjermanisht është se kundrina e drejtë mund të mos përdoret fare, p.sh.:

Sot e takova **atë**. (kundrinë e drejtë dhe tipar kundrinor) *Sot e takova*. (tipar kundrinor)

Në këtë shembull kundrina e drejtë jepet vetëm me tipar kundrinor. (Buchholz/Fiedler; 1987 Fq. 437).

Kundrina e drejtë në gjuhën shqipe mund të hasen e vetme në fjali ose bashkë me një kundrinë të zhdrejtë apo me parafjalë, p.sh.:

Hansi s’ia honepste **emrin e tij**. *Mësuesit linin kokën për të*, *e thërrisnin në emër dhe e nxitnin* **me të gjitha mënyrat**.

Ç’është e vërteta, *thellë në vete ai s’u besonte edhe aq* **shpjegimeve të Hansit** dhe e ndiente mirëfilli që ky i kushtonte më pak se **gjysmën e rëndësisë** që i jepte ai vetë kësaj **shëtitjeje me shokun**.

4. PËRFUNDIME

Kundrina e drejtë është kundrina që haset më shpesh në të dy gjuhët.

Kundrina e drejtë si në gjuhën gjermane dhe në atë shqipe përcakton përgjithësisht një objekt, tek i cili kalon veprimi i shprehur nga folja, ose objektin që është rezultat i këtij veprimi.

Ashtu si në gjuhën shqipe dhe në atë gjermane kundrina e drejtë shprehet me anë të një gjymtyre në rasën kallëzore.

Në gjuhën gjermane duke qenë një gjymtyrë në rasën kallëzore mund të gjendet me pyetjen “kë?” ose “çfarë?“, ndërsa në gjuhën shqipe mund të bëjmë edhe pyetjen “cilin?” ose “cilën?”.

Kundrina e drejtë bëhet kryefjalë në rastin kur fjalia dëftore kthehet në pësore si në gjuhën shqipe dhe në atë gjermane. Në të dyja gjuhët ato mund të

hasen të shoqëruara nga një kundrinë tjetër e drejtë, e zhdrejtë apo me parafjalë.

Gjithashtu në të dyja gjuhët kundrinat e drejta hasen me folje kalimtare. Në gjuhën gjermane ekziston një listë foljesh të caktuara të cilat mund të shoqërohen me kundrinë të drejtë.

Në gjuhën gjermane kundrina e drejtë përcakton më shpesh një send sesa një frymor.

Në ndryshim nga gjuha gjermane kundrina e drejtë në gjuhën shqipe në raste të caktuara mund të shoqërohet apo dhe të shprehet me trajtë të shkurtër, tipar gramatikor, i cili nuk ekziston në gjuhën gjermane.

BIBLIOGRAFI

- 1.Akademia e Shkencave RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i Gramatikës dhe i Dialektologjisë (1989): *Fonetika dhe gramatika e Gjuhës së sotme letrare Shqipe*, botimi i 3: Sintaksa e fjalisë (maket), Tiranë: Shblu.
- 2.Altmann, Hans; Hahnemann, Suzan (2007): *Syntax fürs Examen, Studien Arbeitsbuch*, Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht.
- 3.Beci, Bahri (2004): *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë: EDFa.
- 4.Buchholz, Oda; Fiedler, Wilfried (1987): *Albanische Grammatik*, Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.
5. Çabej, Eqerem (2008): *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* (pjesa e parë), Tiranë: Dituria.
- 6.Çeliku, M.; Domi, M.; Floqi, S.; Mansaku, S.; Përnaska, R.; Prifti, S.; Totoni, M. (2002): *Gramatika e Gjuhës Shqipe II. Sintaksa*, Tiranë: Ilar
7. Çeliku, Mehmet. (2008). *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde*, Tiranë: Ilar.
- 8.Demiraj, Shaban. (1986). *Gramatikë e historisë së gjuhës shqipe*, Tiranë: Shblu.
- 9.Dreyer, Hilke; Schmitt, Richard. (1998). *Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik*, Ismaning: Hueber.
- 10.Duden 4. (1984). *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Manheim, Leipzig, Wien, Zürich: Meyers.
- 11.Engel, Ulrich. (1996). *Deutsche Grammatik*, Heidelberg: Julius Gross.
- 12.Eroms, Hans- Werner. (2000). *Syntax der deutschen Sprache*, Berlin/ New York: de Gruyter.
- 13.Goetze, Lutz; Hess- Luettich, Ernest W.B. (2002). *Grammatik der deutschen Sprache*, München: Bertelsmann.
- 14.Graffi, Giorgio. (2003). *Sintaksa, Strukturat e ligjërit*, Tiranë: Dituria.
- 15.Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. (2000). *Leitfaden der deutschen Grammatik*, Berlin/ München: Langenscheidt.
- 16.Hentschel, Elke, Weydt, Harald. (1990). *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter.
- 17.Kadzadej, Brikena. (2012). *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu.
- 18.Pittner, Karin; Berman, Judith. (2004). *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Tübingen: Narr.
- 19.Schulz, Dora; Griebach, Heinz. (1996). *Grammatik der deutschen Sprache*, München: Hueber

HUAZIMET QË I PËRKASIN SFERËS SË KUZHINËS NË “FJALORIN E GJUHËS SË SOTME SHQIPE” (1980)

MIGENA RIZA

UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË

Përmbledhje

Kumtesa trajton depërtimin e fjalëve nga gjuhët e Lindjes dhe Perëndimit në leksikon e kuzhinës në gjuhën shqipe. Vëmendja kryesore është përqendruar te huazimet e kësaj sfere të cilat janë të pasqyruara në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980). Kjo çështje përbën interes të veçantë sepse synon të nxjerrë në pah ndikimin që kanë pasur gjuhët e ndryshme mbi këtë pjesë të leksikut të gjuhës shqipe (kjo për shkak të marrëdhënieve shekullore midis popullit shqiptar dhe popujve të Lindjes dhe Perëndimit). Për ta parë më konkretisht këtë ndikim kemi bërë vjeljen e të gjitha fjalëve nga Fjalori (1980) që lidhen me sferën e kuzhinës. Hapi tjetër dhe më i rëndësishëm i punës sonë ka qenë klasifikimi i fjalëve sipas burimit të tyre. Kështu, nga klasifikimi i bërë kemi dalluar këto shtresime, të cilat janë: orientalizmat; huazimet nga greqishtja; huazimet nga gjuhët sllave; huazime të vjetra nga italishtja; huazimet modern kryesisht nga gjuhët perëndimore.

Fjalët çelës: *huazime, fjalor, sfera e kuzhinës, depërtim fjalësh.*

Abstract

The aim of this scientific work is to make a full and complete survey over the impact of lexical borrowings deriving from some of the modern Indo-European languages which have become part of the linguistic corpus related to the lexemes used in the sphere of culinary. The linguistic material is selected and noted down from the modern language Albanian dictionary (1980). For the sake of our focus study we have exploited the influence these languages have had over the centuries in enriching and replenishing Albanian language lexicon. The classification of words based on their source and origin has drawn some very fruitful and intriguing conclusions, of which we can disoint borrowings derived from Turkish, Greek, Slavic languages and Italian.

Key words: *borrowings, dictionary, field kitchen, insight words.*

HYRJE

shkëmbimeve të përhershme që popujt vendosin në “paktin e pashkruar” për të dhënë dhe marrë fjalë. Rrethana të caktuara historike kanë kushtëzuar faktin, që në gjuhën shqipe kanë depërtuar shumë fjalë nga gjuhë të ndryshme, dhe sidomos nga gjuhët fqinje. Fjala, duke qenë njësisia gjuhësore që mund të huazohet më lehtë dhe më shpejt, ka bërë që shtresa huazimesh të depërtojnë cipën e leksikut të shqipes, madje një pjesë e mirë e tyre kanë zënë një vend përfundimtar në gjuhën tonë dhe janë pasqyruar në fjalorë të ndryshëm.

Këto shkëmbime fjalësh kanë ndodhin në periudha të caktuara dhe kanë prekur sfera të veçanta të jetës. Andaj, te kjo kumtesë kemi trajtuar depërtimin e fjalëve nga gjuhët e Lindjes dhe Perëndimit në leksikon e përgjithshëm të kuzhinës (enë e orendi, emërtime gatesash, pijesh etj.) në gjuhën shqipe, por duke u ndaluar vetëm te huazimet që janë të pasqyruara në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980). Zgjedhëm pikërisht këtë Fjalor për arsye se ai bën pasqyrimin më të plotë të emërtimeve të kësaj sfere në krahasim me fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe.

Kështu, faza e parë e punës sonë ka qenë vjelja shteruese e lëndës nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980). Kemi vjelë të gjitha emërtimet që lidhen me sferën e kuzhinës, rreth 924 fjalë (këtu janë përfshirë dhe emërtimet e enëve), por kemi lënë mënjanë ato emërtime të cilat janë nga gurra e

Huazimet janë dëshmia më e qartë e shqipes ose janë formime të saj. Kujdes i veçantë i është kushtuar përcaktimit të burimit të këtyre emërtimeve, të cilat pas vjeljes nga Fjalori, i kemi klasifikuar sipas burimit të tyre dhe kemi dalluar pesë grupe:

Orientalizmat;

Huazimet nga greqishtja;

Huazimet nga gjuhët sllave;

Huazimet të vjetra nga italishtja;

Huazimet moderne kryesisht nga gjuhët perëndimore.

Kjo është një çështje me interes specifik, sepse synon të nxjerrë në pah ndikimin që kanë pasur gjuhët e ndryshme mbi këtë pjesë të leksikut të gjuhës shqipe, të pasqyruar në Fjalorin e '80-ës (kjo për shkak të marrëdhënieve shekullore midis popullit shqiptar dhe popujve të Lindjes dhe Perëndimit).

Orientalizmat

Të dhënat historike tregojnë që si kufi kohor për depërtimin e huazimeve turke në gjuhën shqipe merret shekulli XV. Pushtimi osman gati 500-vjeçar, deri me shpalljen e Pavarësisë nuk mund të kalonte pa lënë gjurmët e tij dhe në gjuhë (Çabej, 1989: 117). Ndikimet që turqishtja ka lënë mbi gjuhën shqipe, nuk u arritën të shmangeshin nga qëndresa aktive dhe e drejtpërdrejtë e popullit shqiptar.

Në kushtet historike-shoqërore, në të cilat ndodhej popull shqiptar si një popull i sunduar për një

periudhë shumë të gjatë, nuk mund të “izolohej” dhe as nuk mund të “burgosej” për të shpëtuar nga trysnia që ushtron populli pushtues, e në të tilla rrethana gjuha shqipe mbijetonte në gjirin e popullit që e fliste ende, andaj ajo mundi t’i shpëtojë asimilimit, por jo ndikimit të turqishtes që ishte edhe gjuha e administratës shtetërore. Ky ndikim ka prekur sfera të ndryshme të jetës, ka lënë gjurmë në një periudhë kohore krahasimisht të gjatë.

Gjuha dhe fjalorët i mbartin me vete këto gjurmë duke na i sjellë në kujtesë, si dëshmi e një marrëdhënieje të detyruar mes dy etnikumeve skajësisht të ndryshme. Ajo që dihet është fakti se fushat më të prekura nga turqizmat kanë qenë urbanizmi, veshja, administrata, kuzhina etj (Thomaj, 2006: 260). Interesi ynë është përqendruar te sfera e kuzhinës dhe leksiku që ka depërtuar në këtë sferë nga turqishtja. Kështu, në fushën e gjellëtarisë në gjuhët e Ballkanit kanë hyrë shumë emërtesa kryesisht nga turqishtja, si: akçiash, arapash, ashure, hardall, hasude, imambajalldi, qebap, qeshqek etj., kjo si pasojë e ndikimit të qytetërimit oriental të bazuar në fenë islame. Por, siç është vënë në dukje, vetë turqishtja, një pjesë të mirë të emërtimeve të kësaj fushe i ka marrë nga persishtja, pasi persët kanë pasur një traditë qytetërimi më të pasur e më të lashtë në krahasim me turqit osmanë, që kanë qenë popull nomad derisa u ngulën në Azinë e Vogël (Çabej 1989: 118).

Në klasifikimit që u kemi bërë fjalëve sipas burimit të tyre, është përdorur jo pa qëllim termi orientalizëm, sepse vetë turqishtja ka marrë persizma dhe arabizma, dhe me pas këto të fundit nëpërmjet turqishtes i kanë kaluar gjuhës shqipe. Persizmat dhe arabizmat i përkasin periudhës nga shekulli XVIII dhe më vonë, sepse para kësaj periudhe vetë turqishtja nuk i kishte bërë pronë të saj, pra nuk i kishte përvetësuar aq sa duhet as ajo vetë. Prandaj, gjatë grupimit që ne kemi dhënë më poshtë, termi orientalizëm është më i pranueshëm sesa koncepti huazime turke ose fjalët me burim nga turqishtja në leksikon e kuzhinës. Orientalizmat në përgjithësi, dhe gjithashtu persizmat si pjesë e tyre, kanë ardhur duke u rralluar në përdorim e duke u pakësuar.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” vëmë re se emërtimet nga fusha e kuzhinës dhe e gjellëtarisë, d.m.th. emërtime gatesash, ëmbëlsirash, pijesh, Dybek, ~u m. sh. Gjysleme, ~ja Ermik, ~u m. 1. Gjyveç, ~i Filxhan, ~i Hallvasi, ~a Gurabij/e, ~a Gjym, ~i Gjevrek, ~u Hanxhar, ~i Gjybekë, ~t Hardall, ~i Gjyłaç, ~i Hasud/e, ~ja Hallv/ë, ~a Havan, ~i

lëndësh ushqimore si dhe pajisje të kuzhinës, zënë vend të rëndësishëm. Ndër to po përmendim: burani, jahni, meze, paçe, pilaf, qofte, trahana, turshi; paluze, pelte, reçel, revani, bozë, pekmez, çini, ibrik, filxhan etj. Shumica e këtyre fjalëve i përkasin leksikut aktiv, d.m.th. janë fjalë që përdoren gjerësisht, janë emërtime të vetme për sendet që shënojnë. Pra, një pjesë e mirë e këtyre emërtimeve kanë një përdorim të gjerë në jetën e përditshme (kjo kuptohet nga fjalët e përmendura më lart).

Në sferën semantike të kuzhinës vërehet se orientalizmat janë prekur nga dukuria e vjetërimit të fjalëve ose të ndonjë kuptimi të tyre. Kjo lidhet me dukuri shoqërore, si p.sh. modernizimi i jetës, futja në përdorim e materialeve të reja, ndërrimi i zakoneve shoqërore etj. Kështu p.sh. emërtimi bakraç “kusi e vogël prej bakri” është vjetruar, sepse vetë enët prej bakri janë zëvendësuar me enë prej materialesh të tjera; po për këtë arsye është vjetruar edhe emërtimi stagon “tas i madh prej bakri”. Sot nuk matet më drithi me karroqe ose me mashtë dhe si rrjedhim këto fjalë janë tashmë të vjetruara. Po kështu përmendim kafjall “sillë, buka e mëngjesit”; apo koromane “bukë e hupët dhe e ngjeshur që u jepej ushtarëve; copë buke. 2. bukë e keqe, e gatuar me miell të përzier; buka e përditshme, buka e gojës (edhe fig.)” etj., të cilat po ashtu janë prekur nga kjo dukuri. Disa emërtime që lidhen me rituale fetare, si mblatë, oste, në FGjSSH 1980 kanë qenë cilësuar si të vjetruara, për shkak se në atë kohë ishte ndaluar ushtrimi i veprimtarive fetare, por në “Fjalorin e shqipes së sotme” të botuar më 2002, dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të botuar më 2006, ky shënim u është hequr. Nga orientalizmat e prekur prej kësaj dukurie po përmendim ato që kanë shënimin vjet., këto janë: çervish, ~i m. vjet. 1. gjell.; kafjall, ~i m. vjet.; koroman/e, ~ia f. sh. 1. vjet.; qas/e~ja f. sh. vjet.; somun/e, ~ia f. sh. vjet.; tabaka, ~ja f. sh. 1.; tahin, ~i bised., vjet.

Për përcaktimin e orientalizmave që gjenden në “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” kemi shfrytëzuar kryesisht “Fjalorin e orientalizmave në gjuhën shqipe” të Tahir N. Dizdarit, botuar në vitin 2005. Kështu, orientalizmat që kemi veçuar nga Fjalori janë dhënë më poshtë:

Hoshaf, ~i
Hoshmar, ~i
Ibrik, ~u
Iç, ~i
Imambajalldi, ~a
Jahni, ~ja
Jamak/e, ~ja
Japarak, ~u

Jufk/ë, ~a	Peksimet, ~ i	Sefertas, ~i
Kabash, ~i	Pelt/e~ja	Sergjen, ~i
Kabuni, ~a	Pelt/e~ja	Simit/e, ~ja
Kaçamak, ~u	Pestil, ~i	Sini, ~a
Kadaif, ~i	Pilaf, ~i	Sob/ë, ~a
Kaf/e, ~ja	Piper, ~i	Sof/ër, ~ra
Kafjall, ~i	Piperor/e, ja	Somun/e, ~ia
Kajmak, ~u	Pit/e, ~ja	Sqyre, ~ja
Kapama, ~ja	Prevede, ~ja	Susak, ~u
Kashtor/e, ~ja	Qahi, ~a	Suxhuk, ~u
Kaurma, ~ja	Qas/e~ja	Sytliaç, ~i
Kavanoz, ~i	Qebap, ~i	Sheqer, ~ri
Kazan, ~i	Qepgjir, ~i	Sheqerpar/e, ~ja
Kim/ë, ~a	Qeshqek, ~u.	Sherbet, ~i
Kokm/e, ~ja	Qilar, ~i	Shëllir/ë, ~a
Koroman/e, ~ia	Qoft/e, ~ja	Shish, ~i
Kukurec, ~i	Qoftor/e, ~ja	Shish/e, ~ja
Kusi, ~a	Qull, ~i	Shishqebap, ~i
Kuti, ~a	Qyfter, ~i	Tabaka, ~ja
Kuz/e, ~ja	Qyp, ~i	Tahin, ~i
Limontoz, ~i	Qyrek, ~u	Tarator, ~i
Llapa, ~ja	Qysqi, ~a	Tas, ~i
Llokum.~i	Raki, ~a f.	Tasqebap, ~i
Llull/ë, ~a	Reçel, ~i	Tespiç/e, ~ja
Mafish/e, ~ja	Rehani, ~a	Test/e, ~ja
Maja, ~ja	Rend/e, ~ja.	Tezgjah, ~u
Mashtrop/ë, ~a	Reshedi, ~a	Tigan, ~i
Matara, ~ja	Revani, ~a	Trahan, ~i.
Mez/e, ~ja	Rishte, ~t	Trahana, ~ja
Muhalebi, ~a	Saç, ~i	Tullumb/ë, ~a
Musaka, ~ja	Saf/ë, ~a	Turli, ~a
Narden, ~i	Sahan, ~i	Turshi, ~a
Okllai, ~a	Salep~i	Xham, ~i
Paçamur, ~i	Samsa, ~ja	Yshmer, ~i
Paç/e, ~ja	Sapllak, ~u	Zahire, ~ja
Paluz/e, ~ja	Sapllak, ~u	Zerde, ~ja
Pekmez, ~i	Sarma, ~ja	Zerva, ~ja
Peksimadh/e, ~ja	Saxhak, ~u	

Huazimet nga greqishtja

Ashtu si dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit dhe në gjuhën shqipe nuk mungojnë huazimet nga greqishtja. Kjo dukuri është më se e qartë për arsye se që në kohërat më të lashta greqishtja, duke qenë një gjuhë kulture, ka ushtruar ndikim të vazhdueshëm mbi gjuhët e Ballkanit. Kështu, pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në fund të shekullit IV të erës sonë, gjuha greke ishte gjuha zyrtare e Perandorisë Romake të Lindjes dhe si e tillë ajo do të ushtronte ndikimin e saj mbi gjuhët e popujve të Ballkanit që ishin në sundimin e kësaj Perandorie (Demiraj, 1994: 188). Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe faktin që shumë fjalë nga greqishtja në gjuhën shqipe kanë depërtuar që në kohën e themelimit të ngulimeve greke në trojet ilire dhe në këtë aspekt ndikimi do të ishte edhe më i

drejtpërdrejtë (Demiraj, 1994: 189). Duhet pasur parasysh që greqishtja dhe shqipja (së bashku me parashqipen) kanë pasur kontakte për një periudhë shumë të gjatë nisur dhe nga fakti që nga ana gjeografike, pra e afërsisë territoriale, këta dy popuj kanë qenë në kontakt të pandërprerë, si pasojë ata kanë pasur edhe marrëdhënie gjuhësore në lashtësi, në mesjetë dhe në kohët e reja. Kështu, greqishtja ka ushtruar ndikimin e saj të fuqishëm edhe mbi leksikun e gjuhës shqipe duke prekur sfera të ndryshme të jetës, përfshirë këtu dhe leksikun e kuzhinës.

Arti i të ushqyerit është ndoshta një nga aspektet tek i cili popujt të ndryshëm nuk i rezistojnë tundimit për të shkëmbyer mes njëri-tjetrit, shkëmbime të tilla natyrshëm që pasqyrohen dhe në “*Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*”. Kështu, shumë

fjalë që kanë hyrë nga greqishtja, kanë mbetur thjesht në kuadrin e krahinorizmeve, mund të përmendim: *aplladhe, honi*. Të bie në sy se, një pjesë e këtyre huazimeve kanë një përdorim të gjerë edhe sot, pra ato mund të klasifikohen si pjesë e leksikut aktiv, ku po përmendim: *fidhe, gliko, kritharaq, kuvare, uzo, skarë* etj.

Për klasifikim e fjalëve me burim nga greqishtja, gjuhët sllave e italishtja kemi shfrytëzuar kryesisht veprën “*Studime etimologjike në fushë të shqipes*” të prof. Eqrem Çabejt dhe “*Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe*” të Gustav Meyer-it.

Më poshtë kemi renditur të gjitha fjalët që janë klasifikuar si fjalë të burim grek të cilat janë

Aplladh/e, ~ja

Bakalaro, ~ja

Fidhe, ~të

Gliko, ~ja

Honi, ~a

Kritharaq, ~i

Ksist/ër, ~ra

Kuvare, ~t

Mostopit/e, ~ja

Potir, ~i

Skar/ë, ~a

Shpirto, ~ja

Uzo, ~ja

Huazimet nga gjuhët sllave fqinje

Vjelja e “Fjalorit të *gjuhës së sotme shqipe*” dhe klasifikimi i fjalëve të grumbulluara sipas burimit të tyre, na tregojnë se edhe sfera e kuzhinës në gjuhën shqipe është prekur nga shtresa e fjalëve me burim nga gjuhët sllave. Këto huazime, kanë depërtuar për shkak të dyndjeve të sllavëve në gadishullin Ballkanik pas shek. VI-VII të erës sonë. Theksojmë se në gjuhën shqipe huazimet nga gjuhët sllave kanë depërtuar më shumë sidomos gjatë pushtimeve të shtetit bullgar (815-1018) dhe të dinastisë serbe të Nemanjiqëve (shek. XII-XIV) (Demiraj, 1994: 122). Përveç depërtimeve që kanë ndodhur sidomos në periudhën e mesjetës, ajo që vihet re është fakti se zonat kufitare janë terriore në të cilët sllavizmat kanë depërtuar edhe më vonë nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me popullsinë sllave. Këto zona duke qenë në kontakt me popullsinë sllave kanë më tepër mundësi që të preken prej këtyre huazimeve.

Kështu, për shkak të përdorimit mjaft të dendur të këtyre emërtimeve në jetën e përditshme, si dhe për rrethanat e caktuara historike dhe afërsisë territoriale që populli ynë ka pasur dhe ka me popujt sllavë në këtë gadishull, kuptojmë se edhe kjo fushë semantike nuk mund të mos prekej prej ndikimit sllav. Elementët e nxjerrë nga Fjalori i '80-ës,

natyrisht që nuk mund të jenë rastet e vetme në gjuhën shqipe sa i takon kësaj sfere, ato janë vetëm një pasqyrë e shkurtër që kërkon një vëmendje të veçantë në një punim tjetër më të hollësishëm.

Nisur nga përdorimi i këtyre fjalëve me burim sllav mund të dallojmë dy shtresa, që janë: fjalë të cilat janë aktive në përdorim në mbarë gjuhën, dhe fjalë që nuk kanë një përdorim kaq të gjerë në jetën e përditshme ose janë të njohura në krahina të caktuara. Prandaj, nëse do të marrim si shembull fjalët: *Bims/ë, ~a f. sh.* Qilar, bodrum. *Bimsa e shtëpisë. Mbaj (mbyll) në bimsë.*; si dhe fjalën *Çarranik, ~u m. sh.* 1. Koçek i vogël prej thuprash ose prej dërrasash të holla, i ngritur lart mbi tokë zakonisht jashtë shtëpisë, për të mbajtur të freskët bulmetin ose për ushqimet, thark; qilar për bulmetin; dollap i posaçëm me rretë teli për të mbajtur bulmetin e ushqime të tjera. *Çarraniku i qumështit (i bulmetit). Vë (fut, ruaj, mbaj) në çarranik.* Të dyja fjalët janë fjalë të vjetruara që nuk përdoren sot, kjo sepse janë fjalë që në një etapë të caktuar historike, ekonomike ose kulturore kanë humbur përdorimin dhe vlerën që kanë pasur dikur, sendet që emërtojnë ato nuk janë sot, pra ato lidhen me një periudhë të caktuar, por që tashmë kanë dalë nga përdorimi.

Po këtu dallojmë edhe huazime, që janë pjesë e leksikut aktiv, ato janë pjesë e kulturës sonë të përditshme, të cilat lidhet me kulinarinë dhe kanë një përdorim aktiv në jetën e përditshme, të tilla si: *kovë, kulaç, mëmeligë* etj.

Fjalë me burim sllav që kemi nxjerrë nga Fjalori janë

Bims/ë, ~a

Çarranik, ~u

Drop, ~i

Kov/ë, ~a

Kul/aç, ~açi

Maz/ë, ~a

Mëmelig/ë, ~a

Sit/ë, ~a

Ved/ër, ~ra

Huazimet të vjetra nga italishtja

Ka kaluar tashmë një shekull që kur Gustav Meyer-i - indoeuropianisti dhe albanologu i shquar austriak, autori i të parit dhe, deri tani, i të vetmit fjalor etimologjik të gjuhës shqipe - konstatoi se ndikimi roman (d.m.th. ai latin dhe italian) është ndikimi i huaj më i fuqishëm mbi shqipen. Pohimi i tij siç dhe dihet ka qenë një pohim që ka mbivlerësuar ndikimin latin në gjuhën shqipe, pa harruar këtu faktin që ndikimi latin ndryshon në varësi të sferave, por dhe të periudhave kohore (Thomaj, 2006: 258). Në sferën e kuzhinës nga i gjithë materiali që ne kemi vjelë prej “Fjalorit të *gjuhës së sotme shqipe*”, ajo që tërheq vëmendjen është se nuk ka fjalë që

dalin me burim nga latinishtja. Siç dihet, latinishtja ka lënë gjurmë të shumta në emërtimin e pjesëve të trupit, të shtëpisë, në emrat e kafshëve, të drurëve etj. Pasi përfundoi periudha romake gjuha shqipe pati ndikim nga gjuhët romane që u zhvilluan nga latinishtja dhe veçanërisht nga italishtja. Në fushën e kuzhinës, duke u nisur nga ajo lëndë që është përfshirë në Fjalor, dalin si huazime të vjetra nga italishtja vetëm dy fjalë që janë: *putargë* “vezë qefulli të kripura dhe të thara zakonisht në tym” dhe *stufë* “sobë për ngrohje a për gatim”. Nisur nga ky fakt shohim se ndikimi nga italishtja në këtë sferë semantike deri nga fundi i shek. XIX ose nuk është shumë i madh ose këto emërtime nuk janë përfshirë aq sa duhet te FGJSSH (1980). Ajo që mund të pohojmë me siguri është fakti se ndikimi nga italishtja në gjuhën shqipe dhe në sferën e gastronomisë është më i fuqishëm në shek. XX pas Shpalljes së Pavarësisë, e sidomos pas viteve '90, kur nisin të hyjnë në përdorim të gjerë edhe fjalë si *makarona, makiato, rizoto, picë, taliateli* etj. Huazimet moderne kryesisht nga gjuhët perëndimore Një pikë e veçantë e punimit tonë janë edhe huazimet moderne nga gjuhët perëndimore në leksikon e kuzhinës, ndikim i cili doemos dhe është i ndjeshëm. Arsyeja e një ndikimi të tillë, që po e quajmë si një ndikim “të fuqishëm”, mund të lidhet :

Alkool, ~i
Amaret/ë, ~a
Arançat/ë, ~a
Beshamel, ~i
Bërxoll/ë, ~a
Bidon, ~i
Biftek, ~u
Birr/ë, ~a
Biskot/ë, ~a
Bonbon/e, ~ia
Buding, ~u
Bufe~ja
Çokollat/ë, ~a
Fërniet, ~i
Filet/ë, ~a
Franxholl/ë, ~a
Frut/ë, ~a.
Furnel/ë, ~a
Galet/ë, ~a
Garnitur/ë, ~a
Gavet/ë, ~a
Gazoz/ë, ~a
Kaçkavall, ~i

Kakao, ~ja
Kanape, ~ja
Karamel/e, ~ja
Kasat/ë, ~a
Koktej, ~i
Komposto, ~ja
Koncentrat, ~i
Konserv/ë, ~a
Konjak, ~u
Kotëlet/ë, ~a
Krem, ~i
Krik/ëll, ~lla
Liker, ~i
Majonez/ë, ~a
Makarona, ~t
Margarin/ë, ~a
Marmalat/ë, ~a
Mastik/ë, ~a
Ment/ë, ~a
Mustard/ë, ~a
Omëlet/ë, ~a
Ost/e, ~ja.
Past/ë, ~a

Pastiço, ~ja
Pendespanj/ë, ~a
Ponç, ~i
Porcelan, ~i
Proshut/ë, ~a
Pure, ~ja
Ragu, ~ja
Rum, ~i
Salc/ë, ~a
Salçiç/e, ~ja
Sallam, ~i
Sallat/ë, ~a
Samovar, ~i
Sup/ë, ~a
Shampanj/ë, ~a.
Shporet, ~i
Shurup, ~i
Termos, ~i
Tort/ë, ~a
Uiski
Vazo, ~ja
Vermut, ~i
Xhelatin/ë, ~a

me faktin se “arti i kuzhinës” në këta popuj ka pasur një traditë të hershme. Ky “art” është huazuar nga popuj të tjerë, konkretisht nga populli ynë, duke marrë bashkë me gatesat edhe emërtimet nga gjuhët burimore. Kjo dukuri ka ndodhur dhe me pijet e ndryshme, të cilat kanë sot një përdorim mjaft të madh te ne, duke përmendur: *alkool, birra, kakao, uiski, shampanjë, xin* etj. Përmendim se një pjesë e këtyre emërtimeve kanë hyrë në trajtat shkrimore të gjuhës nga janë huazuar, siç është rasti i fjalës *alkool*, që në normën drejtshkrimore të gjuhës shqipe po ashtu shkruhet me dy /o/. Huazimet moderne nga gjuhët perëndimore kanë një përdorim mjaft aktiv në gjuhën shqipe duke qenë se ato janë mjaft të përdorshme në jetën e përditshme. Për klasifikimin e mëposhtëm shfrytëzuam fjalorë të ndryshëm anglisht, frëngjisht, italisht – shqip dhe fjalorët e fjalëve të huaja të gjuhës shqipe të botuar në Prishtinë: *Fjalor i fjalëve të huaja*. Hartues: Dr. Murat Bejta (redaktor), Dr. Latif Mulaku, Mr. Mehdi Bardhi, Abdullah Zajmi, Mr. shefkije Islamaj, Mr. Ibrahim Goçi, Mr. Qemal Murati. Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1988, 667 f. Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*. “Rilindja”. Prishtinë, 1986, 748 f.

Më poshtë po shënojmë huazimet moderne nga gjuhët perëndimore, të cilat janë

PËRFUNDIME

Nga nxjerrja dhe klasifikimi i këtyre emërtimeve sipas “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” (1980),

shohim se ndikim më të madh në sferën e kuzhinës ka pasur elementi me burim turk dhe huazimet moderne kryesisht nga gjuhët perëndimore, ndërsa

një ndikim më të vogël ka pasur në këtë sferë elementi grek dhe sllav dhe po ashtu nga italishtja. Gjithmonë duke u mbështetur te Fjalori, nga vëzhgimi i materialit në tërësi mund të pohojmë se emërtimet e gatesave, pijeve dhe orendive të kuzhinës janë bërë pronë e leksikut të shqipes dhe

zëvendësimi i tyre me fjalë të tjera është jo rrallëherë i pamundur. Këto huazime janë bërë tashmë pronë e leksikut të shqipes dhe një pjesë e mirë e tyre kanë ende një përdorim mjaft të gjerë dhe aktiv në jetën e përditshme

BIBLIOGRAFI

Bejta M., Mulaku L., Bardhi M., Zajmi A., Islamaj Sh., Goçi I., Murati Q., *Fjalor i fjalëve të huaja*, Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1988.

Çabej E., *Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes*, SF, 1976, 1.

Çabej E., *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, SF, 1975, 1.

Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. vëll. I, II, III, IV, VI, VII. Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Demiraj Sh., *Gjuhësi ballkanike*, 1994

Dizdarit T., *"Fjalorin e orientalizmave në gjuhën shqipe"*, Tiranë, 2005.

Gjinari J., Shkurtaj Sh., *Dialektologjia shqiptare*, 2004

Kostallari A., *Rreth depërtimit të turqizimeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, GJA, SSHF, 1978.

Kostallari A., Thomaj J., Lloshi Xh., Samara M., Kole J., Daka P., Haxhillazi P., Shehu H., Leka F., Lafa E., Sima K., Feka Th., Keta B., Hidi A., *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.

Ndreca M., *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*. "Rilindja". Prishtinë, 1986.

Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 2005.

Thomai J., *Mbi mënyrën e pasqyrit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe*, SF, 1964, 4.

Xhuvani A., *Studime gjuhësore*, Tiranë, 1956.

TIPARE KONSERVATORE TË SISTEMIT FOLJOR NË ÇAMËRISHTË, PËRKIME ME TË FOLMET ARBËRESHË

MONIKA HASANI
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Përmbledhje

E folmja e çamërishtes dhe ligjërimet arbëreshe shfaqin ngjashmëri të shumta me njëra-tjetrën, si të tilla na japin mundësi vëzhgimi edhe në analizimit e elementëve arkaikë të sistemin foljor, që me kalimin e kohës janë zhdukur pjesërisht, ose plotësisht në të folmet e Shqipërisë. Të rrethuar nga popullsi me gjuhë dhe kulturë të ndryshme nga e tyrja, këto të folme dallohen për karakterin konservator të gjuhës. Në sistemin foljor tipare të përbashkëta konservatore dallohen në fonetikë, në gramatikorë dhe në leksik, ku dallohen veçanërisht arkaizma kuptimorë dhe historikë. Këto tipare të arbërishtes e çamërishtes që i përkasin një faze të vjetër të shqipes që arrin deri në fillimet e shekullit XIX, sipas dëshmimeve të shkruara që kemi për shqipen, na ndihmojnë të kuptojmë evolucionin e disa prej ndryshimeve fonetiko-morfologjike që janë zhvilluar në periudhat e mëvonshme të shqipes.

Fjalë çelës: *sistem foljor, tipare arkaike, ligjërimet arbëreshe, nëndialekt çam, shqipe e moçme.*

Abstract

The phraseology of “çamërisht” and “arbëresh” discourse exhibit many similarities with each other. Such observations enable us to analyze the elements of the archaic verbal system that over time have disappeared partially or fully in the Albanian dialects. Surrounded by people with different language and cultures from their own, these dialects are known for preserving the initial character of the language. In verbal system conservative features are distinguished in phonetics, grammar, and lexicon, in which we especially distinguish semantic and historical archaism. These features of çamërisht and arbëresh which belong to an old phase of the Albanian language until the beginning of the nineteenth century, from the written evidence that we have for the Albanian language, help us to understand the evolution of some of the morphological changes in phonetic development in the later periods of the Albanian language.

Key words: *verbal system, archaic features, arbëresh discourse, çam dialect, the ancient Albanian*

HYRJE

Nëndialekti i çamërishtes dhe ligjërimet arbëreshe kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të shqipes, duke i marrë këto të folme, veçanërisht si pika referimi të ndërmjetme në krahasim me shqipen e sotme, veçanërisht për të shpjeguar faza më të vjetra të shqipes.

E folmja e çamërishtes dhe ligjërimet arbëreshe shfaqin ngjashmëri të shumta me njëra-tjetrën, si të tilla na japin mundësi vëzhgimi edhe në mikrostrukturë. Nga korpusi i grumbulluar do të përqendrohemi veçanërisht në studimin e strukturës foljore, duke dalluar mes tyre tiparet arkaike që këto dy ligjërimet mbartin prej shqipes së moçme, duke i vlerësuar dhe krahasuar ato me njëra-tjetrën.

Për të realizimin e përshkrimit dhe analizimit të elementëve arkaikë në sistemin foljor të ligjërimëve arbëreshe jemi mbështetur në veprën e De Radës, veçanërisht në botimin origjinal të poemës “Canti Di Milosao, Figlio del Despota di Scutari”, botuar në Napoli 1836, në punim e tij në origjinal të “Grammatica della lingua albanese. Firenze 1870/1871”, si dhe fragmente nga revista “Flamuri i Arbrit”.

Për të folmet e çamërishtes si burim parësor për vjeljen e materialit kemi marrë përmbledhjen me këngë popullore nga Çamëria e z. Ibrahim Hoxha “Bilbila dhe thëllëza çame”, jemi mbështetur

gjithashtu në studimin e albanologut Qemal Haxhihasani, si dhe në disa dorëshkrime origjinale të mbledhësit të përkushtuar të fjalës çame Xhevdet Malo, i cili me gjithë vështirësitë e kohës ka arritur të mbledhë shumë materiale të çmuara nga kjo krahinë, veçanërisht nga fshatrat e Gumenicës, qendër e cila që në kohën para shpërnguljes së Çamërisë përfshinte 30 fshatra shqiptarë.

Nga një vështrim i përgjithshëm i këtyre dy ligjërimëve vërejmë se ato bashkohen në veçori të tilla, si:

- Izolim dhe shpërngulje nga gjuha mëmë;
- Të rrethuar nga popullsi me gjuhë dhe kulturë të ndryshme nga e tyrja;
- Karakteri konservues i gjuhës;
- Karakteri periferik;
- Afërsi në fushën e traditave popullore;
- Të folme të pambuluara duke u bazuar në atë që gjuha italiane dhe greke realizohet në të katër funksionet e saj, ndërsa arbërishtja dhe çamërishtja realizohen në shprehjen gojore;
- Folësit e arbërishtes dhe çamërishtes ruajnë të fortë përkatësinë e tyre të lashtë etnike e ndiejnë veten arbëreshë/shqiptarë. Këtë e shprehin në radhë të parë në përdorim e arbërishtes/shqipes, si gjuhë të parë, pra si gjuhë të zemrës, ndërkohë që për nevojën të ndryshme jetësore përdorin italishten/greqishten.

Tipare konservatore në sistemin foljor

Një prej tipareve më të veçanta që ruajnë si ligjërimet arbëreshe, ashtu edhe të folmet çame që është ruajtja e **tipareve arkaike** të gjuhës shqipe, që me kalimin e kohës janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë.

Tipare të përbashkëta konservatore në fonetikë

Një tipar fonologjik i shqipes së vjetër ka qenë gjatësia e zanoreve, një tipar që ekziston edhe sot në gegërisht. Këtë tipar e ruan si çamërishtja, ashtu edhe arbëreshët e Italisë.

1. Dyfishimi i zanoreve te foljet; *friiti, paa, u ljaa, kee, kaa, jee, keem, theet, ngriin* etj, për të cilën mendojmë se është një dukuri dialektore arkaike, që ka shërbyer për të realizuar zgjatjen e veprimit, një dukuri kjo që sot shfaqet ende në të folmen konservatore të çamërishtes. P.sh.: Era që *friiu* ka mali/era që *friinj* ka fusha (fq274). Zgjatimi i zanoreve mbart përmbajtje shprehëse ose emocionale. Te De Rada shfaqet shpesh. Përdorimi i zanoreve të gjata në vepër nga ana grafematike shfaqen me dyfishim zanorësh: Më *laan* të veshurat, *friin* asaj udhe, */theet/* "thot", */ngriin/*, */rii*. Gjatë përdorimit del qartë se zgjatimi i zanoreve mbart përmbajtje shprehëse ose emocionale

2. Veçori e përbashkët e shqipes së vjetër është edhe ekzistenca e zanores /-ë-/ të patheksuar. Kjo zanore është shumë e shpeshtë te Bogdani dhe te autorët e tjerë të vjetër dhe del në çamërishten e vjetër (1895) *kartëratë, dhëndërinë, të bukurinë*, ndërsa në të folmen e sotme çame /ë/-ja fundore në fjalët katërrrokëshe ka rënë. Te De Rada kjo zanore është shumë e shpeshtë në poemë dhe del edhe në pozicione deri tri rrokje para fundit, p.sh., *zëgjonem, shtëfrinej, reshëtiet*.

Një tipar i vjetër shqipes që shfaqet në veprën e De Radës është ruajtja e hundores qiellëzore *nj* që sot është spirantizuar në *j*, në grupin e foljeve të zgjedhimit të parë, të tilla, si: *gjëmonj pusho-nj, bë-nj, shko-nj* në kohën e tashme të formës veprare, veta e parë njëjës, veta e parë shumës *shko-njëm, shko-njëmi*. Veta e tretë *qeshë-njën, gjëmo-njën, mba-njën, rua-njën, ro-njën, fiuturo-njën, shko-njën etj*. Ky tipar i vjetër i shqipes nuk dëshmohet për foljet te punimi i Haxhihasani. Në përmbledhjen me këngë nga krahina e Çamërisë e Ibrahim. D .Hoxha (Bilbilat dhe thëllëza çame), përkundrazi hundorja qiellëzore *nj* shfaqet në të gjitha foljet, zgjedhimet, mënyrat dhe kohët, madje edhe në shfaqjen me zanoren mbështetëse *ë* p.sh.: *pinjë, bënë, të luanjë* (fq. 277) *ruanj, luanj, bredhinj, të vështronje, të ikinj, keshinj* (fq. 239), *do të vinj, do të shanj, do qëndronj, do më gjenjë zemërën* (fq. 284), *do thoshinje, do të martonjë, do të nisënjë* (fq. 387), *ngasnje, lanjë, shkonje, të vrasinj*, u *rrinjë* mënjane në porta (fq. 387), (fq.252, 247).

3. Për çamërishten është tipike ruajtja e grupeve të vjetra bashkëtingëllore /kl/ e /gl/, si në folje: *klaj, shkliej, shkluhem, klënë, gledh, zgledh* "zgjedh", *zglidh* "zgjidh", *glunjas*, p.sh; Çi keshe *glarë*, djeltë me zë *klajnë* (fq 243), më *zglidhe* gjuhënë (fq 311), më *zgate* dorën e ia dhe (fq 367), ndërkohë tek De Rada ky grup ka evoluar në /ki/ : *Kioftë* i butë dimri/ *Mos të kioft* përljipurith (Kënga 13).

4. Si në çamërisht edhe në arbërisht dallohet prishja e kundërvënies ndërmjet fonemave zanore /y/ -/i/, y-ja duke u delabializuar ka përfunduar në /i/: *friinj* "fryj", *ghiign*, "hyj".

5. Në **sistemin foljor** të shqipes së vjetër, në foljet me temë në bashkëtingëllore mbaresat e vjetra të së tashmes të vetës I e III shumës merrnin zanoren mbështetëse -ë- e cila është më e vjetër se zanorja mbështetëse -i- e shqipes së sotme. Në çamërishte ruhet ende në një numër të kufizuar përdorimesh: me baltë (fq. 255), shoh *këputurë* një ill (fq. 254), *veshurë* si gardhiqote (fq. 273), *hedhurë* mënjane (fq. 280), ku keshe *vaturë* (fq. 287), Në çamërishten e sotme përgjithsisht *ë*-ja fundore ka rënë, kështu që mbaresat dalin -ëm, -ën: *pjesëm, pjesën, presëm, presën, marrëm, marrën, ngasëm, ngasën, vrasëm, vrasën sjellën* dhëndër aganë (fq. 276),

Në çamërishte ruhen gjithashtu mbaresat -jim, -jit, -jin të së pakryerës: *bijim, bijit, bijin; lajim, lajit, lajin*. Edhe te De Rada hasen këto trajta të vjetra të shumës të së pakryerës së dëftores.

6. Në të dy të folmet dëshmohet kontraksioni që ka pësuar diftongu /oe/, i cili ka dhënë rezultate të ndryshme: në shqipen e përbashkët -o- kurse në çamërishte dhe tek De Rada -e-. lidhorja e foljes *them* në v. III del *thetë: të thetë, të thenë* dhe e foljes *dua: të detë, të denë*. Rada : *Çë të thetë/ n'ëng attire mos u thetë?*

7. Në çamërisht kemi asimilimin e grupit *ssh* në *ç* në mbaresa foljore . Kjo dukuri haset jo vetëm tek foljet e mënyrës lidhore, por edhe në dëftore veçanërisht në kohën e kryer të thjeshtë dhe të ardhmen e thjeshtë psh.: *të nglaç, të pjeç, të flaç.*, *të viç, të rriç, të keç, të shkoç, do bëneç, do shkoç, u bëç, raçë, u pojçë* me nja di mike (fq269), u *ngunjaç* (u plaka), ndërkohë që tek De Rada nuk shfaqet kjo dukuri.

8. Një tjetër karakteristikë e shqipes së moçme që vihet re në sistemin foljor të çamërishtes është asimilimi progresiv / /rn/:/rr/ , u *therrë, hëngërrë, muarrë*.

Tipare konservatore në gramatikë

• Në paradigmat që dalin si në arbërisht edhe në çamërisht për foljet *jam* dhe *kam*, për kohën e pakryer dallohen format arkaike të tyre, veçanërisht varianti i dytë i tyre: *ishënja/jesh, ishënje, ish, ishënjim/ jeshmë, ishënjit/ishënjin* dhe

chishënja/chesh, *chishënje/cheshnje,*
chishënjim/cheshëm, chishënjit.

• Realizimi i joveprores del mjaft specifik si në arbërisht edhe në çamërisht : Atje prannë *t'u kish passur rritur* i pagëzuari i arbëresh. Mun ne sheshi, mun ne porta/ *t'u kesh vrarë* Halil Gravonja(fq.226), Përdorime të tilla shfaqen si formula tipike letrare të prozës popullore. Në të folurën e çamërishtes kjo formë përdoret ende dendur në ligjërimin bisedor, për të shprehur edhe nuanca të habisë. Duhet thënë se këtu kemi një formë të mbipërbërë, e cila në fakt gjendet jo vetëm në eposet e veriut me vlera stilistike karakteristike, por dhe në gegërishten veriperëndimore të sotme. Ndryshon nga çamërishtja veç nga trajta e pjesores në fund (*T'u kish pasë rritë Muji.*)

• Shfaqja e foljes *them* përgjithësisht në përdorim me trajtat e shkurtra: *Kujt të m'i thet?*, *Thuam* ndë do gjë. *Thomnie* ju të dashurit e mi. Kjo folje dhe realizimi strukturor i gërshetuar me kuptimin qe del, mendojmë se nuk është studiuar, ose të paktën sqaruar si duhet. Ajo shfaqet mjaft e shpeshtë në çamërisht, me të cilin kemi parë ngjashmëritë më të mëdha, e shoqëruar dhe me një pasthirmë -o. Ky bashkëshoqërim krijon dhe në ligjërimin e shkujdesur një formulë deiktike, e cila i jep nuancat e këngës recitative edhe ligjërimin të thjeshtë bisedor.

• Mbaresa *-ej* në të pakryerën joveprore, veta e tretë njëjës, ndërtuar mbi bazën e kohës së tashme: *dërgo-nej*, *marto-nej*; *ro-nej*, *shtrushullo-nej*, *qia-nej*, *çamërisht psh* mali lulëzonej, fusha *gjelbëronej* prej meje *s'këjtonej*, *nej*; *bë-nej* Hasani flutur (fq. 439) , u *zbardho-nej* gusha (fq. 343), E njëjtë me atë të çamërishtes del trajta e vetës së tretë njëjës me mbaresën *-nej: ikënej, dëgjonej.*

BIBLIOGRAFI

- ÇABEJ E., *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, në "Dialektologjia shqiptare", II, Tiranë, 1974.
DE RADA J, " Poesie Albanesi nel Secolo XV". "Canti di Milosao, Filio del Despota di Scutari", Napoli 1836.
DE RADA. J, " *I Canti di Milosao*", Përgatiti për Botim Giuseppe Gradilone, Firenze, 1964
DE RADA. J, " Këngë të Milosaut", Përgatiti për Botim Jup Kastrati, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1965.
DE RADA. J, " Këngët e Milosaos", Përgatiti për Botim Gjergj Zhej, Alba Prim, Tiranë.
DEMIRAJ. Sh " *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*", 8 Nëntori, Tiranë 1986
GJINARI J., *Ndërtime me folje që tregojnë fillimin e veprimit në të folmet arbëreshe të Italisë*, në "St. fil.", 3, 1975, f. 121-134.
HOXHA Ibrahim " *Bilbila dhe thëllëza çame*" AIITC, Tiranë 2007
TOPALLI. K, " *Sistemi Foljor i Gjuhës Shqipe*", Plejad, Tiranë 2010.
Shembujt janë marrë edhe nga dorëshkrimet origjinale të studiuesit autodidakt dhe mbledhësit të folklorit te popullit çam Xhevdet Malaj, i datëlindjes 1925 nga fshati Sharrat , komuna e Gumenices, Çamëri.

• Grupi- *fsh* në të gjitha pozicionet del në /sh/: *shinj* "fshij", *qosha* "qofsha"si në çamërisht.

• Në çamërishte ruhen gjithashtu mbaresat - *jim, -jit, -jin* të së pakryerës: *bijim, bijit, bijin; lajim, lajit, lajin*. Edhe në dialektet arbëreshe hasen këto trajta të vjetra të shumësit të së pakryerës së dëftores, p.sh., *qajin, thojin, lodrojin* , siç i ka vënë re Gradilone, i cili i shënon edhe për të folmet arbëreshe të Kalabrisë *ikjin, qajin, shurbejin*.

• Çamërishtja e ruan trajtën e vjetër të pjesores me -t te folja *bie: i kishnë ratë dhëmbët*

• Te format e pashtjelluara në çamërisht dhe në arbërisht interesante shfaqet pjesorja e vjetër ; Sevdaja që *më ka rarë*; *Hëna rarë (De Rada)*.

Tipare arkaike në leksik

Të përbashkëta shfaqen :

• Arkaizma kuptimorë: *çonj* (gjej), *resht* (largoj), *rodhet* (dridhet); *shtiu* (hodhi) *përpiq* (ndal), *patën fjalë* (bënë fjalë) të *ndjeva* (dëgjova) zënë, *përquis* (shkel me këmbë) *zdrigj* (zbres), *qepem*(ngjitem) në mal

• Arkaizma historikë (greqizma dhe turqizma) si, p.sh. : *potis, pajgoris ,feks, timis, skotis,kumbis, firas, sëklldis, bitis (mbaroj), xhinos, farmakos, cimbis (pickoj), lefteris (liroj), lepe (urdhero), qepros (mbërthej)* etj.

Tiparet arkaike të arbërishtes e çamërishtes që vumë re sa më sipër i përkasin një faze të vjetër që arrin deri në fillimet e shekullit XIX, sipas dëshmimeve të shkruara që kemi për shqipen. Ato na ndihmojmë të kuptojmë evolucionin e disa prej ndryshimeve fonetiko-morfologjike që janë zhvilluar në periudhat e mëvonshme të shqipes deri në formimet e të folmeve të sotme në të dy dialektet e shqipes dhe në gjuhën e sotme letrare.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI GJUHËSINË SI DISIPLINË SEMIOTIKE

OLGER BRAME

DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Në këtë artikull kemi marrë përsipër të bëjmë një përsiatje rreth gjuhës si sistem semiotik, duke trajtuar fillimisht çështjen e gjuhësisë si disiplinë semiotike e duke vazhduar më pas me llojet e shenjave në semiotikë sipas veçorive e llojeve të tyre. Kuptimi i gjuhës si sistem shenjash na drejton vëmendjen në karakterin shenjor dhe sistemor të saj. Teoria shenjore nuk është e vetme dhe nuk kap gjithë vetitë thelbësore të gjuhës si mjeti më i rëndësishëm i komunikimit njerëzor, i shprehjes së mendimeve dhe i dhënies së informacionit. Lidhur me vendin që zë gjuhësia ndër shkencat shoqërore, sot mbizotëron konceptimi i saj si pjesë e disiplinës së semiotikës. Semiotika, si teoria e përgjithshme e shenjës, studion natyrën e shenjave dhe sistemeve shenjore, llojet e shenjave dhe situatave shenjore, operacionet bazë mbi shenja të ndryshme etj. Në punim bëhen përpjekje për të evidentuar disa prej karakteristikave të gjuhës si sistem shenjor, duke bërë dallimin me sistemet e tjera shenjore. Më pas, në mënyrë përgjithëse është bërë një vështrim i përgjithshëm mbi llojet e shenjave, të cilat gjuha i merr në studim si pjesë të rëndësishme në aspektin komunikues.

Fjalë kyçe: *gjuhësi, semiotikë, sistem shenjor, lloje shenjash, situatë shenjore.*

Abstract

The aim of this article is to reflect on language as a semiotic system, initially addressing the issue of linguistics as a semiotic discipline and later continuing with different types of signs in semiotics, classified according to the kinds and features. The meaning of language as a system of signs drives the attention to its signs and systemic character. The theory of signs is not the only one and it does not include all the essential features of language as the most important means of human communication, expression of thoughts and information. Regarding the place of linguistics in social sciences, nowadays its conception as part of semiotics prevails. Semiotics, as the general theory of the sign, studies the nature of signs and sign systems, types of signs and signs situations, basic operations on various signs etc. The aim of this article is to identify some of the characteristics of language as a system of signs, making the difference with other signs systems. Then, this analysis leads to a general overview on the types of signs considered as an important communicative aspect with linguistic perspective.

Key words: *linguistics, semiotics, signs system, types of signs, signs situation.*

I. HYRJE

Lidhur me vendin që zë gjuhësia ndër shkencat shoqërore, sot mbizotëron konceptimi i saj si pjesë e disiplinës së **semiotikës**. Duke u mbështetur në përcaktimin e Sosyrit për semiotikën si shkenca që *studion sistemet e shenjave që shërbejnë për komunikim në shoqërinë njerëzore*, gjuha bëhet pjesë e këtij sistemi dhe sistem i veçantë i kësaj shkence .

Në këto sisteme përfshihen gjuha dhe sistemet që zëvendësojnë gjuhën në rrethana të caktuara, si: shkrimi, alfabeti mors, alfabeti brajl (braille) i të verbërve, sinjalet zanore, sinjalet pamore etj. (Saussure, 2002).

Si sistemi më i rëndësishëm shenjor, gjuha dallohet nga sistemet e tjera ndihmëse (të specializuara) shenjore sepse:

Së pari, sistemet e tjera shenjore janë të paracaktuara për të dhënë një informacion të

kufizuar ose dhënien dhe rikodimin e një informacioni të njohur. Gjuha është mjeti universal, jo vetëm për dhënien dhe ruajtjen e informacionit, por edhe për lindjen dhe formësimin e mendimeve, po ashtu edhe të qëndrimeve emocionuese-psikike. Prandaj sistemi gjuhësor, shumëplanësh dhe i ndërlikuar, përfshin njësi të ndryshme, ndër të tjera, të ndërmjetme dhe joshenjore.

Së dyti, gjuha dallon nga sistemet e tjera shenjore, sepse sfera e përdorimit të tyre është e ngushtë, e kufizuar. Gjuha është mjet universal i komunikimit, ajo i shërben njeriut në të gjitha sferat e veprimtarisë.

Së treti, gjuha dallon nga mjetet e tjera ndihmëse dhe të specializuara të komunikimit, se këto janë marrëveshje të përkohshme, janë të shpikura dhe artificiale. Gjuha krijohet gradualisht dhe zhvillohet në procesin e funksionimit si fenomen historik, konkret dhe është krijim i një sërë epokash dhe

brezash. Shenja gjuhësore nuk është krijim i sistemit dhe e situatës shenjore, ajo vetë krijon një situatë të caktuar shenjore, karakteristike për një gjuhë konkrete. Gjuha, si sistem shenjor, është më i përgjithshëm se sistemet e tjera shenjore (Koduhov, 1974).

Kuptimi i gjuhës si sistem shenjor na drejton vëmendjen në karakterin shenjor dhe sistemor të gjuhës. Teoria shenjore nuk është e vetme dhe nuk kap gjithë vetitë thelbësore të gjuhës, si mjeti më i rëndësishëm i komunikimit njerëzor, i shprehjes së mendimeve dhe i dhënies së informacionit. Semiotika është teoria e përgjithshme e shenjës. Ajo studion natyrën e shenjave dhe sistemeve shenjore, llojet e shenjave dhe situatave shenjore, operacionet bazë mbi shenja të ndryshme (Halton, 1992).

II. Llojet e shenjave në semiotikë

Termi “shenjë” filloi të përdoret shumë gjerë, pa ndonjë specializim të mjaftueshëm kuptimor e terminologjik. Megjithatë, nuk është e vështirë të dallohen *shenjat natyrore nga shenjat njerëzore*. Prandaj, në semiotikë dallohen dy tipe shenjash: shenja natyrore ose shenja të shenjave (tipare) dhe shenja artificiale ose shenja të informacionit. Shenjat janë të rëndësishme, sepse ato tregojnë diçka tjetër nga vetja e tyre. Interpretimi i një shenje varet nga konteksti në të cilin përdoret, nga marrëdhëniet e saj me shenjat e tjera dhe nga mjedisi ku ndodhet. Prandaj, gjuha nuk është asgjë më shumë se sistemi i shenjave, i kombinuar në mënyrë konvencionale dhe sipas rregullave të caktuara, në mënyrë që të lejojnë komunikimin personal. Shenjat natyrore ndryshe emërtohen dhe shenja simptoma. Ato, në të vërtetë, nuk dallojnë prej shenjave në përgjithësi. Në dallim nga shenjat që ekzistojnë veçan nga sendet dhe dukuritë, simptomat janë pjesë e një sendi ose dukurie, të cilën njerëzit e perceptojnë dhe e studiojnë (temperatura e lartë- shenjë që tregon sëmundjen; dëborë –cilësi e dimrit). Këto cilësi mund të bëhen shenja, me anën e të cilave njerëzit paraqitin në ndërgjegjen e tyre sëmundjen dhe dimrin (Koduhov, 1974).

Shenjat ose tërësia e tyre dallojnë sende të ndryshme, karakterizojnë cilësitë dhe vetitë e tyre. Përdorimi shenjor nuk e kthen sendin në shenjë: shpjegimi semiotik i shenjave nuk i kthen dukuritë e natyrës dhe shoqërisë në sisteme shenjore, me gjithë rëndësinë që kanë ato për studim. Shenjat e kushtëzuara ose shenjat e vërteta, janë paracaktuar për formimin, ruajtjen dhe dhënien e informacionit, për përfaqësimin dhe zëvendësimin e sendeve dhe të dukurive, nocioneve dhe gjykimeve. Shenja nuk është pjesë thelbësore e asaj që përfaqëson,

zëvendëson e jep. Në këtë kuptim, ajo është artificiale. Shenjat konvencionale shërbejnë si mjet i komunikimit dhe dhënies së informacionit, prandaj ato i quajmë *shenja komunikative dhe informative*. Në qoftë se shenjat natyrore i quajmë simptoma, atëherë shenjat konvencionale (komunikative, informative) mund t'i quajmë shenja në përgjithësi.

III. Shenja gjuhësore

Shenja gjuhësore është lloji kryesor i shenjës komunikative dhe informative. Ajo ka dy anë të rëndësishme: është e perceptueshme dhe sjell informacion. Në konceptin e Sosyrit, ku shenja gjuhësore bashkon jo një gjë dhe një emër, por një koncept dhe një përfytyrim tingullor, shenja gjuhësore është kombinim i konceptit dhe përfytyrimit (Saussure, 2002). Shenja të vërteta komunikative dhe informative janë njësitë e gjuhës të tipit të fjalisë dhe të fjalës, sepse ato kanë funksion komunikativ dhe predikativ, lidhin gjuhën me mendimin dhe shoqërinë. Fjalët, si shenja, janë cilësi të të gjitha gjuhëve. Shenjë minimale e gjuhës është morfema. Ajo është njësi e dyanshme: ajo është njësi dhe shërben për ndërtimin e njësieve të tjera të gjuhës, që janë shenja të përbëra. Morfema nuk është njësi e pavarur gjuhësore, ajo veçohet nga fjala vetëm për të motivuar funksionet fjalëformuese dhe fjalëndryshuese, që janë mjete të shprehjes dhe të dhënies së përmbajtjes jashtëgjuhësore, por jo mjete komunikimi. Shenja bazë e gjuhës është fjala. Originaliteti i fjalës si shenjë themelore e gjuhës e dallon gjuhën nga sistemet më të thjeshta shenjore, që karakterizohen nga sasia e shenjave, ndërthurja e tyre dhe semantika diferencuese.

Semantika e fjalës pasqyron botën jashtëshenjore dhe është e drejtuar në këtë botë jo vetëm në vetvete. Në këtë kuptim, gjuha është institut shoqëror, veti e kolektivit njerëzor. Prandaj studimi i gjuhës si sistem shenjor, i veçuar nga shoqëria dhe përmbajtja e dhënë, nuk zbulon gjithë tërësinë e vetive të gjuhës. Njësitë gjuhësore kanë, po ashtu, shenja, si veti të pandashme të tyre (Saussure, 2002; Lyons, 2010).

IV. Shenjat sinjale

Shenja sinjal është shenjë tingullore, optike ose dhe shenjë tjetër konvencionale, që jep informacion. Të gjitha shenjat mund të veprojnë si sinjale kur ato shkaktojnë një veprim të veçantë nga ana e pranuesit, si p.sh., fjalët në gjuhën e njeriut apo cicërimat paralajmëruese të zogjve. Në dallim nga shenjat e tjera, sinjali është i pamotivuar, nuk ka në vetvete informacion: informacionin e përmban situata shenjore, kuptimi ndodhet jashtë shenjës.

Llojet e thjeshta të sinjaleve janë: sirena e trenit, zilja e shkollës etj. Zilja e shkollës, nuk dallon

nga zilet e tjera, të cilat mund t'i dëgjojmë në rrethana të tjera. Megjithatë, sinjali i ziles, ka kuptim tjetër: kur nxënësi ndodhet në mësim, atëherë zilja e sinjalizon për mbarimin e mësimi ose, kur është në pushim, e sinjalizon për mbarimin e pushimit. Kur dëgjojmë zilen në apartament, ky sinjal na fton që të hapim derën. Siç shihet, përmbajtja e sinjalit, si shenjë konvencionale, ndryshon në varësi të situatave, po ashtu edhe nga sasia dhe rendi i sinjaleve. P.sh.: shumë origjinal është sinjalizimi i transportit hekurudhor, detar, rrugor etj. Sinjalet janë shumë të zakonshme në komunikimin e kafshëve, por vetëm një pjesë e kufizuar e veprimtarisë gjuhësore të njeriut ka të bëjë me sinjalizimin (Koduhov, 1974; O'Grady et al, 2013).

V. Shenjat simbol dhe shenjat substitut

Pirsi dhe Sosyri e përdorën termin "simbol" në mënyra të ndryshme nga njëri-tjetri. Për Pirsin, simboli është "një shenjë e lidhur me objektin që ajo tregon në bazë të një ligjësie, zakonisht një lidhjeje të ideve të përgjithshme, e cila vepron për të krijuar simbole që interpretohen si referim për atë objekt".

Sosyri u shmanget shenjave gjuhësore si "simbole", duke këmbëngulur se shenja të tilla nuk janë kurrë tërësisht arbitrare. Ato nuk janë konfigurime boshë, por tregojnë të paktën një gjurmë të lidhjes natyrore midis shenjuesit dhe të shenjuarit; një lidhje së cilës ai më pas i referohet si "lidhje e arsyeshme" (Chandler, 1999).

Shenjat simbol kanë një përmbajtje të dukshme, që është e motivuar figurativisht. Simboli nuk është i kushtëzuar nga situata për dhënien e informacionit. P.sh., stema përfaqëson një vend, një qytet, një institucion duke u pasqyruar në vula, monedha, flamurë etj. Stema dhe flamuri janë shenja të ndërlukuara simbolesh. Simbole më të thjeshta janë shenjat luftarake, çmimet, medaljet etj. Në këtë mënyrë, simboli apo shenja simbolike është caktuar si marrëveshje shoqërore. Simboli është një shenjë në të cilën shenjuesit nuk ngajnë me të shenjuarin, por lidhen në mënyrë krejtësisht arbitrare ose thjesht konvencionale. Për shembull, shkronjat e alfabetit, sistemi i numërimit, shenjat matematikore, kodi kompjuterik, shenjat e pikësimit, shenjat e komunikacionit, flamujt kombëtarë dhe kështu me radhë, numrat, kodi Mors, semafori etj. (Atkin, 2012; 2013).

Një simbol, kuptimi i të cilit tejkalon fushën e prekshme vetëm të një marrëdhënieje të thjeshtë, përbën një gjysmë-simbol (metasimboli). Historia, kultura, dhe tradita, të gjithë luajnë një rol në krijimin e metasimboleve. Të tilla mund të përmendim pëllumbin me një degë ulliri si simbol për paqe etj. (O'Grady et al, 2013).

Në jetën e përditshme hasen shumë shenja të tjera simbolike. Forma tetëkëndore, si shenjë qarkullimi për të të ndaluar, është simbolike. Ajo nuk ka kurrfarë lidhje të brendshme me mesazhin, ajo na ndihmon për të komunikuar. Ngjyrat e përdorura në shenjat e trafikut janë simbolike. Kështu, ngjyra e kuqe, nuk ka ndonjë lidhje të natyrshme me aktin e ndalimit, krahasuar me ngjyrën e verdhë (Chandler, 1999).

Krahas shenjave gjuhësore, që njihen si shenja të para, ekzistojnë shenjat e dyta, karakteristike për gjuhët ndihmëse dhe artificiale. Shenja të tilla quhen *substitute*, të cilat zëvendësojnë jo sendet dhe nocionet, por shenjat e para. Kështu, në qoftë se fonema është shenjë, atëherë shkronja është substituti i saj; në qoftë se fjalia është shenjë komunikative, atëherë formula është substitut i modelit të fjalisë. Shenjat substitute janë përhapur gjerësisht sidomos në sistemet informative. Më të njohura janë shenjat matematike. Shenjat substitute, pasi lindin në bazë të shenjave gjuhësore, shpesh veçohen nga to, duke formuar sisteme të veçanta shenjore. Kështu lindin gjuhët artificiale ndërkombëtare (p.sh. esperanto), simbolika shkencore (algjebrike, kimike, gjuhësore etj.). Shenjat e "gjuhëve" të tilla janë edhe shenja substitute, edhe shenja simbole, sepse ato, nga njëra anë lindin mbi bazën e sistemeve alfabetike reale (sidomos në bazë të alfabetëve greke dhe latine) dhe, nga ana tjetër, ato shërbejnë për pasqyrimin e nocioneve dhe gjykimeve matematike, kimike etj. Shenjat substitute janë mjet i shprehjes së metagjuhës (Koduhov, 1974).

VI. Shenjat ikona

Te shenjat ikonike, shenjuesi perceptohet si diçka që i ngjan apo imiton të shenjuarin. Përfaqësimet ikonike mund të merren një fotografi, model arkitektonik i një ndërtese, një skicë, pikturë, një siluetë e stilizuar e një femre apo një maskulli në një derë tualeti etj. Të gjitha këto janë shenja ikona, sepse ato imitojnë aspekte ose janë kopje e referentit të tyre. Për shkak të kësaj ngjashmërie të qenësishme, këtyre shenjave ne iu referohemi me këtë emërtim dhe ato janë konsideruar si shenja joarbitrare (Saussure, 2002). Këto shenja janë të motivuara, pasi besnikëria ose saktësia e përfaqësimit, shkalla në të cilën i shenjuari është riparaqitur nga shenjuesi, është një masë e anasjelltë e asaj se sa është konvencionalizuar ai.

Një portret realist (pikturë), është shumë i konvencionalizuar: kjo do të thotë se për të nënkuptuar veprën, mbështetemi te përvoja jonë se si riparaqitet realiteti. Një fotografi e një skene në rrugë, komunikon lehtësisht për shkak të

familjaritetit tonë me realitetin që ajo riparaqet. Është e rëndësishme që të mbahet parasysh se te shenjat me motivim të lartë, i shenjuari përcaktohet nga ndikimi dhe në shenjat me motivim të ulët, marrëveshja përcakton formën e shenjuesit. Te shenjat e pamotivuara, shenjuesi dhe i shenjuari lidhen mes tyre vetëm nga një marrëveshje ndërmjet përdoruesve të këtyre shenjave (Seiler, 2001).

VII. Shenjat indeks

Te shenjat indeks shenjuesi është i lidhur drejtpërdrejt, në një farë mënyre (fizikisht apo rastësisht), me të shenjuarin. Kjo lidhje mund të vihet re ose të nxirret nga vetë ai që interpreton shenjën. Të tilla mund të përmenden: shenjat natyrore (tymi, thundra, gjurmët e këmbëve, shija), simptomat mjekësore (dhimbja, një skuqje e lëkurës, rrahja e pulsit), instrumentet matëse (flugerit, termometri, ora), sinjalet (trokitja në derë, zilja e telefonit), treguesit, etiketat, markat etj. Pra, një shenjë indeks përbush funksionin duke "vënë në dukje" referentin e saj në mënyrë tipike, duke qenë një shembull i pjesshëm ose përfaqësuesi i tij. Indekset nuk janë arbitrare, pasi prania e tyre në një kuptim është shkaktuar nga referenti i tyre. Shenjat simptomatike apo simptomat, janë shenjat më të rëndësishme të shenjës indeks. Shenjat simptomatike përcjellin në mënyrë rastësore gjendjen e brendshme apo emocionet e dërguesit, duke e paraqitur atë si indeks. Për shembull, fakti se temperatura e trupit tonë rritet kur jemi të sëmurë, është një reflektim spontan i gjendjes sonë të brendshme. Kur dikush na shkel në këmbë dhe ne bërtasim, thirrja është një pasqyrim rastësor i gjendjes sonë të brendshme. Këto janë shenja simptoma (O'Grady et al, 2013). Një shenjë mund të përbëhet nga lloje të ndryshme, p.sh.: shenja e

qarkullimit rrugor, e përbërë nga një trekëndësh i rrethuar me të kuq dhe me një kryq në mes. Trekëndëshi i kuq është një simbol. Sipas rregullave të komunikimit, ai paraqet paralajmërim. Kryqi në mes është simbol, por edhe ikonë. Në formën e tij është ikonik, sepse paraqet kryqëzim të rrugëve, por ai nuk mund të kuptohet si udhëkryq, po qe se nuk i njohim rregullat e qarkullimit rrugor.

VIII. PËRFUNDIME

Mund të thuhet se vetë historia e gjuhësisë tregon në mënyrë bindëse se problemi më i rëndësishëm i teorisë së gjuhës është përcaktimi i thelbit (natyrës) të gjuhës dhe saktësimi i objektit të gjuhësisë. Përcaktimi dhe saktësimi i këtij objekti, në një shkallë të rëndësishme, varet nga kuptimi i natyrës së gjuhës dhe i lidhjeve të saj me dukuri të tjera të realitetit objektiv. Vënia e konceptit të shenjës në thelb të natyrës së gjuhës, bëri të mundur që gjuhësia të quhet si një disiplinë semiotike. Karakteri shenjor i gjuhës mund të shihet në dy këndvështrime. Këndvështrimi i parë ka të bëjë me gjuhën si sistem shenjor, i cili lidhet edhe me sisteme të tjera shenjore jogjuhësore me të cilat bashkëvepron për të realizuar transmetimin e një domethënieje të caktuar, të një mesazhi të caktuar. Gjuha, si sistem shenjash, mund të zëvendësojë gjithë sistemet e tjera, duke e bërë sistemin shenjor gjuhësor universal. Nga këndvështrimi tjetër, sistemet e shenjave jogjuhësore vihen në shërbim të shenjave të gjuhës, për të realizuar, po ashtu, transmetimin e domethënies a të mesazhit. Kështu, gjuha del jashtë kuadrin sosyrian si sistem në vetvete dhe për vetveten dhe lidhet ngushtë me ligjërimin. Është pikërisht shenja, e cila bën këtë lidhje të dyfishtë me gjuhën, nga njëra anë, dhe ligjërimin, nga ana tjetër.

BIBLIOGRAFI

- Atkin, Albert (2012), *Peirce's Theory of Signs*, The Stanford Encyclopedia of Philosophy. Edward N. Zalta (ed.), December, 2012.
- Atkin, Albert (2013), *Peirce's Theory of Signs*, The Stanford Encyclopedia of Philosophy (Summer 2013 Edition).
- Chandler, Daniel (1999), *Semiotics for Beginners* në: <http://www.aber.ac.uk/media/Documents/S4B/semiotic.html>.
- Halton, Eugene (1992), *Charles Morris-A Brief Outline of His Philosophy with relations to semiotics, pragmatics, and linguistics*, University of Notre Dame, IN.
- Koduhov, Vitalij Ivanovič, (1974), *Obshçjeje jazykoznanie*, Moskva.
- Lyons John (2010), *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë.
- O'Grady William; Archibald, John; Aronoff, Mark and Rees-Miller, Janie (2013), *Contemporary Linguistics: An Introduction*, 5th edition, *Types of signs*, April 2013, Bedford/St. Martin's Publications.
- Saussure, Ferdinand de (2002), *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme (1917)*, Dituria, Tiranë, përkth. R. Ismajli, 2002.
- Seiler, Robert M. *Semiology // Semiotics*, (2001), Journal of Canadian Studies, Vol. 36, No. 1.

VËSHTRIM KRAHASUES I SEMANTIZMIT TË FOLJES “BËJ” NË SHQIP DHE “FAIRE” NË FRËNGJISHT

PAVLO CICKO

ROBERT STRATOBËRDHA

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË

Përmbledhje

Punimi synon të bëjë një përjasje të mikrosistemit të foljes “bëj” në shqip dhe asaj “faire” në gjuhën frënge. Zgjedhja e këtij çifti është bërë me qëllim sepse këto folje janë ndër më të përdorurat në gjuhët përkatëse, pra në shqip dhe në frëngjisht. Krahasimi do të ketë parasysh tiparet semantike dhe ato sintaksore që kanë të bëjnë me strukturën e ndërtimit dhe përdorimit të tyre në ligjërim. Analiza përjasëse e karakteristikave semantike dhe strukturore të foljeve në fjalë do të ndriçojë ndërtimet simetrike dhe ato josimetrike, përputhjet dhe ndryshimet e tyre. Të dy foljet përdoren dendur edhe në shprehje të ndryshme frazeologjike. Në këtë fushë delikate studentët mund të bëjnë gabime si pasojë e ndërhyrjes së gjuhës amtare shqipe. Analiza krahasuese që synojmë të bëjmë, do të nxjerrë në pah tipare të përbashkëta dhe dallime në strukturën e përdorimit të tyre. Ajo do të ndihmojë në reflektimin mbi gramatikën dhe gjuhën frënge si dhe në mësimdhënien më rezultative të saj për nxënësit dhe studentët shqipfolës. Në kushtet e studimit dhe përvetësimit më të mirë të gjuhës frënge nga nxënësit dhe studentët shqipfolës, ky trajtim do të ishte një ndihmesë e veçantë, duke realizuar një qasje të ndryshimeve dhe ngjashmërive ndër-gjuhësore të ndërtimeve sintaksore. Kjo njohje do të ndikonte për shmangjen e shprehjeve të gabuara që mund të krijoheshin nga ndërhyrja në gjuhën amtare shqipe.

Abstract

This paper aims to compare the microsystems of the verbs “bëj” in Albanian and “faire” in French language. This pair is purposely chosen because these verbs are among those most frequently used in relevant languages; Albanian and French. The comparison will consider semantic and syntactic features which are connected with their structure and use in speaking. Comparative analysis of semantic characteristics and the structure of these verbs will throw light on the symmetric and asymmetric composition, correspondence and their changes. Both verbs are frequently used in phraseological expressions, too. Being a subtle field of study, they might be difficult for students to be learned due to the Albanian language interference. The comparative analysis we aim to conduct, will highlight the common and different features in their structure and uses. This would help students to reflect on French grammar and language as well as on the effective teaching. In order to better study and master French language by the Albanian students, this study would be of special help by comparing and contrasting their syntactic structures. Such recognition would avoid the use of wrong expressions which might be created by the interference of mother tongue.

Hyrje

Ky artikull synon të bëjë një përjasje të mikrosistemit të foljes “bëj” në shqip dhe asaj “faire” në gjuhën frënge. Krahasimi do të ketë parasysh tiparet semantike dhe ato sintaksore që kanë të bëjnë me strukturën e ndërtimit dhe përdorimit të tyre në ligjërim. Analiza përjasëse e karakteristikave semantike dhe strukturore të foljeve në fjalë do të ndriçojë ndërtimet simetrike dhe ato josimetrike, përputhjet dhe ndryshimet e tyre.

Trajtimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve të ndërtimit të foljes “bëj” në shqip dhe asaj “faire” në frëngjisht do të mbështetet në korpusin e studimit i cili përbëhet nga kuptimet kryesore të këtyre foljeve. Ato bashkohen nga pikpamja semantike por kanë struktura të njëjta dhe të ndryshme sintaksore sipas karakteristikave të secilës gjuhë. Trajtimi synon gjithashtu që, në kuadrin e didaktikës së mësimdhënies, të ndihmojë në shmangjen e vështirësive së përdorimit të foljes “faire” për studentët shqipfolës. Pasuria e madhe e shprehjeve

dhe e semantikës që shpreh folja “faire” nga njëra anë dhe interferenca me gjuhën amtare shqipe nga ana tjetër krijon pengesa dhe vështirësi në mësimdhënien e për pasojë studentët shqipfolës mund të përdorin shprehje të gabuara me këtë folje në frëngjisht.

Korpusi i studimit përbëhet nga këto dy folje të shpalosura në disa fjalorë si: ata dygjuhësh *Dictionnaire Français Albanais* me rreth 35 mijë fjalë dhe Fjalori Shqip-Frëngjisht të V.Kokonës, *Le Dictionnaire Larousse de la langue française*, me 76 mijë fjalë, Fjalori i gjuhës shqipe botim i Akademisë së shkencave dhe Fjalori i shprehjeve frazeologjike frëngjisht-shqip-frëngjisht i D. Xhoxhaj.

Zgjedhja e këtij çifti është bërë me qëllim sepse këto folje janë ndër më të përdorurat në gjuhët përkatëse, pra në shqip dhe në frëngjisht. Analiza do të klasifikojë sipas parametrave semantikë dhe sintaksorë përkatësitë e këtyre foljeve, të cilat bëjnë pjesë në grupin e foljeve më të përdorura dhe me semantizëm mjaft të gjerë në të dy gjuhët. Ato përdoren dendur edhe në shprehje të ndryshme

frazologjike. Në këtë fushë delikate studentët mund të bëjnë gabime si pasojë e interferencës me gjuhën amtare shqipe. Analiza krahasuese që synojmë të bëjmë do të nxjerrë në pah tipare të përbashkëta dhe dallime në strukturën e përdorimit të tyre. Ajo do të ndihmojë në reflektimin mbi gramatikën dhe gjuhën frënge si dhe në mësimdhënien më rezultative të saj për nxënësit dhe studentët shqipfolës. Në kushtet e studimit dhe përvetësimit më të mirë të gjuhës frënge nga nxënësit dhe studentët shqipfolës, ky trajtim do të ishte një ndihmesë e veçantë, duke realizuar një qasje të ndryshimeve dhe ngjashmërive ndërgjuhësore të ndërtimeve sintaksore. Kjo njohje do të ndikonte për shmangjen e shprehjeve të gabuara që mund të krijoheshin nga interferenca me gjuhën amtare shqipe.

Vëzhgim rreth tërësisë së karakteristikave të foljeve “bëj” dhe “faire”. Grupet kryesore kuptimore dhe kombinimet e tyre.

Ndërlidhja semantike midis kuptimeve të ndryshme të foljes “bëj” në shqip dhe asaj “faire” në frëngjisht është e gjerë dhe komplekse.

Kuptimi më tipik i *faire* në frëngjisht është ai i realizimit, kryerjes së një veprimi. Gjatë studimit kemi vënë re se të dy foljet përdoren në kontekste të njëjta me kuptimin “veproj mbi diçka, e përgatit, e përfundoj a e kryej, e ndërtoj, e përpunoj, prodhoj” etj.

Folja “bëj” ka si kuptim kryesor realizimin e një veprimi. Ajo përdoret si kalimtare por edhe si jokalimtare. Kuptimet e saj kryesore janë 13 dhe lidhen ngushtë midis tyre.

1. Pikat e takimit dhe largimet semantike midis “bëj” dhe “faire”

Do të shqyrtojmë hap pas hapi kontekstet e ndryshme ku këto folje përdoren në disa prej kuptimeve të tyre kryesore.

Kuptimet kryesore të foljes “bëj” dhe strukturat përkatëse:

Kuptimi i **parë** i foljes “bëj”: veproj mbi diçka, e përgatit, e përfundoj a e kryej, e ndërtoj, e përpunoj, prodhoj etj. Folja përdoret me kundrinor të drejtë i cili mund të jetë: emër sendi konkret ose abstrakt ose përemër. Psh: *bëj shtëpi (mur); bëj një vjershë (një fjalor); bëj një letër (një lutje, një telegram); në frëngjisht: faire une maison, un mur, une poesie, une lettre, un télégramme.* Duke i përqasur me të njëjtin semantizëm të foljes “faire” në shembujt e analizuar dallojmë dy lloj strukturash: **përputhje gjuhësore dhe ndryshim gjuhësor.**

Struktura e dytë shprehet me anë të kryqëzimit strukturor të foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me foljen “faire”.

➤ **Përputhje strukturore e foljes “bëj” me foljen “faire”**

Në këtë rast shohim shprehjet: *bëj mësim, faire cours. bëj gjimnastikë; faire de la gymnastique, bëri fotografi; il a fait des photos, bëj dasmë (ditëlindjen); faire des noces, por thuhet: feter son anniversaire. s’ke ç’bën! > rien à faire; s’bën gjë pa pyetur > il ne fait rien sans demander. bëri një sy gjumë; > faire un somme; bëj çmos, bëj çështje e mundur > faire l’impossible. bën shumë për të nipin; il a fait beaucoup pour son neveu. Bëj bukën me gjalpë > faire une tartine de beurre. Bëri pasuri të madhe > il a fait une grande fortune. Të bësh një grusht shteti > faire un coup d’Etat.*

Kryqëzim strukturor i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me “faire”

Psh: *bën hile > tricher; ia bëri për inat > il l’a fait expres; bëri emër, u bë i njohur > il est devenu fameux.; e bëri bukën e vitit; il a produit le blé de l’année. Bëri murin me gëlqere > peindre le mur à la chaux, badigeonner.*

Karakteristikë e këtyre shprehjeve është ruajtja e semantizmit të njëjtë me foljen “bëj” duke përdorur strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes: bëj + emër ose bëj + emër + ndajfolje ose bëj + emër + emër me parafjalë. Psh: *bën hile > tricher; bëj këpucët me bojë > cirer les souliers; bëj lajka > chanter des louanges.*

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *ia bëri për inat > il l’a fait expres; bëri duart pis, > il a sali ses mains*

Është interesant konstatimi se si rezultat i semantizmit të gjerë të të dy foljeve respektive në të dy gjuhët ka shprehje tek të cilat nuk mund të përdoret folja “bëj” apo “faire” në gjuhën tjetër (frënge apo shqipe) me këtë kuptim, thjesht sepse ajo mënyrë të shprehuri nuk egziston, pra nuk është gramatikore. Kështu psh. në frëngjisht përdoret shprehja *faire une bise, ose donner une bise*, e cila ka gjegjësen e vet në shqip me foljen *jap*, > *të japësh një të puthur*. Problemi është se në shqip nuk mund të përdoret folja “bëj” me të njëjtin kuptim me *jap* në këtë përdorim, pra nuk mund të thuhet “*ti bësh një të puthur dikujt*”. Vërejmë se ka raste jo të pakta ku semantizmi i njëjës folje, qoftë kjo “bëj” apo “faire”, nuk përputhet me semantizmin e foljes tjetër. Pikërisht këto mospërputhje gjuhësore mund të sjellin përdorime të gabuara të shprehjeve me foljen “faire” në gjuhën frënge nga nxënësit dhe studentët shqipfolës.

Kuptimi i **dytë** i foljes “**bëj**”: i shkaktoj diçka, i le një shenjë, i sjell një pasojë, e kthej në një gjendje tjetër, e shndërroj, e ndryshoj, e vlerësoj ndryshe, e marr për..., ia jap a i gjej diçka, i rregulloj. Në përdorimet e foljes dallojmë dy situata të ndryshme gjuhësore: përputhje strukturore dhe ndryshim strukturor.

➤ **Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor kemi në rastet e mëposhtme:**

I bëri një të mirë (një padrejtësi) > faire du bien (du mal, une injustice.) a autrui; më bëri përshtypje > cela me fait de l'impression; faire rire, pleurer > e bën të qeshë, të qajë, i bëri flokët gërsheta > faire des tresses; bëj çmos bëj çështë e mundur > faire l'impossible.

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet duke përdorur strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes: bëj + emër ose bëj + emër + ndajfolje ose bëj + emër + emër me parafjalë. Psh: *bëj buzën në gaz > sourire; s'ia bën fjalën dysh; ne pas contredire qqu'un; e bëri qumështin kos > preparer le yauourt; e bën të bardhën të zezë (fig); > passer au noir.*

b. Ruhet struktura sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *e bëri të lumtur > il l'a rendu heureux; e bëj të bardhë; rendre blanc; ia bëri kokën tullë, ia qethi a ia rruajt; > raser la tete a q.q.un; couper ras; e bënë kryetar; > on l'a nommé président; i bëri një nuse (bised) i gjeti nuse > il lui a trouvé une épouse.*

Me këtë kuptim në frëngjisht përdoren shprehjet: *faire pitié, peur, honte*, që kanë gjegjëse në shqip: *ngjall mëshirë, frikësoj, turpëroj dhe faire plaisir > sjell kënaqësi.*

Siç vihet re, në shqipe përdoren shprehje me folje të tjera të cilat nuk afrohen me semantizmin e foljes “bëj”. Psh: *ia bëri koka > vetë e pati fajin > c'est de sa faute. bëj timen, e përvetësoj > mettre la main sur; e bëri dhëndër (bised) > il lui a donné sa fille en mariage. të bën për budalla; prendre quelqu'un pour un imbecile; e bëri zakon; ça devient une habitude pour lui; ia bëri fushë me lule (fig); faire paraître facile: bën keq një ushqim > être nuisible a la santé; u bë keq i sëmurë > l'état du malade a empire.* Duke analizuar shembujt në frëngjisht vërejmë se kemi shprehje dhe folje të ndryshme që i përgjigjen mesazhit me foljen “bëj” të shqipes, por këtu në asnjë rast nuk përdoret folja “faire”.

Kuptimi i **tretë** i foljes “**bëj**” është: lind, pjell, nxjerr, lëshoj, jap, them, prodhon

➤ **Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor kemi në rastet e mëposhtme:**

bëj veshin e shurdhët > faire la sourde oreille; bëri zhurmë, bujë, skandal > faire du bruit, de l'éclandre. bëj pyetje > faire, poser des questions. bëj thirje > faire appel.

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet duke përdorur strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes: bëj + emër ose bëj + emër + ndajfolje ose bëj + emër + emër me parafjalë. Psh: *i ka bërë kokën e ka lindur; e ka sjellë në jetë; elle l'a mis au monde; bën tym, dritë, shkëndija > fumer, éclairer, étinceller. bën ciu (zogu); l'oiseau chante; më bëri veshi piu > mes oreilles siffilent, bourdonnent; bën si gjel, > imiter le cocorico; të mos bësh zë > se taire; bëj fjalë me dikë > se disputer avec quelqu'un; s'bën fjalë nuk ankohet; > ne pas se plaindre, se résigner; i bëj zë e thërras dike > appeler quelqu'un*

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *bëri vajzë; (binjakë) elle a accouché d'une fille; bëri dy qengja > faire, mettre bas deux agneaux; pula bëri vezë; la poule a fait des oeufs, a pondu. bën qumësht, mjaltë; > donner du lait, du miel; kanë bërë ullinjë; nous avons une bonne recolte d'olives; i bëj të fala; envoyer ses amities a.*

Kuptimi i **katërt** i foljes “**bëj**”: përgatit diçka sipas porosisë, ndaj, peshoj; plotësoj a përmbush një kërkesë

➤ **Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor kemi në rastet e mëposhtme:**

bëri një palë pantallona tek robaqepësi: > faire coudre un pantalon; bëri flokët, u dha formë > il s'est fait coiffer.

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet duke përdorur strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes: bëj + emër ose bëj + emër + ndajfolje ose bëj + emër + emër me parafjalë. Psh: *ja bëj pasurinë dikujt > léguer ses biens à qqn.*

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *i bëri dy kile mollë, il lui a donné (pesé) deux kilos de pommes; pesë metra basmë; cinq metres de tissu; më bëj një akullorë! > Donne-moi une glace!*

Kuptimi i **pestë** i foljes **bëj**: edhe jokalimtare, sillem a veproj në një mënyrë të caktuar; v III është mirë, lejohet.

➤ **Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor**

e bëri pa dashje; il ne l'a pas fait expres; bëj si më thotë zemra; faire comme le coeur m'en dit; bëj si të duash!, fais comme tu veux! bën sipas kokës>en faire a sa tete; bën marrëzira; bën shaka des plaisanteries (naze) > faire des façons, des chichis; s'bën lëshime il ne fait pas de concessions; s'di ç'bën; il ne sait que faire; bën sikur nuk do, shtiret sikur nuk do; il fait semblant de; bëj si fëmijë, si i sëmurë (shtirem si) > faire l'enfant, faire le malade, l'idiot; bëj veshin e shurdhër> faire le mort. Në frëngjisht kemi në këtë rast një emër të përdorur në mënyrë të figurshme, në shqip një shprehje të figurshme jo me emrin vdekje por vesh i shurdhër pra, që nuk ka dëshirë të dëgjojë; do të bëjë të tijën, do të bëjë atë që do vetë; il fait ce qu'il veut

Kryqëzim i foljes "bëj" me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet duke përdorur strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes: bëj + emër ose bëj + emër + ndajfolje ose bëj + emër + emër me parafjalë. Psh: *si t'ia bëj hallit? Que faire? Aq më bën> peu m'importe, Ça m'est égal.*

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *nuk bën ashtu, nuk është mirë ashtu; ce n'est pas bien comme ça. bëj si të bësh! Débrouille-toi! a bën të hyj> je peux entrer? Bëj pa diçka> se passer de qqch; e bëj për vete dikë> gagner l'affection de qqn. S'më bën zemra (të bëj një gjë) > ne pas avoir le Coeur à faire qqch*

Kuptimi i **gjashtë** i foljes "bëj": edhe jokalimtare, lëviz, eci, ia mbaj nga..., udhëtoj, përshkoj një hapësirë, kryej një lëvizje, edhe fig me mohim s'lëviz dot, s'punoj; s'kam fuqi a dëshirë për të kryer diçka; dhe v III, merr një trajtë tjetër, ndryshon. Shembuj: bën kthesë (bërryl) rruga; ka bërë bark muri; bën dredha; bën rrudha

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor

bëri dy hapa>faire des pas; bën tetëdhjetë kilometra në orë; faire quatre vingt kilometres a l'heure; i bëri shenjë me dorë; ia bëri me kokë, me sy; faire de la main, de la tete, de l'oeil a... bën dredha> faire des zigzags; bën rrudha> faire des plis.

Kryqëzim i foljes "bëj" me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet me strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes: bëj + emër ose bëj + emër + ndajfolje ose bëj + emër + emër me parafjalë. Psh: *bëri mënjane; il a passé à coté, s'est éloigné; bëri drejt bregut; marcher (se diriger) vers;*

s'më bëjnë këmbët (gjunjët)> je ne peux marcher, j'ai mal aux pieds, aux genou; s'më bëjnë sytë > je ne regarde pas bien; ka bërë bark muri; le mur est déformé

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *s'më bëjnë duart të bëj një gjë, s'më bëjnë këmbët të shkoj gjëkund> n'avoir pas du tout envie de faire qqch, d'aller quelque part; bën kthesë (bërryl) rruga> la route fait un détour.*

Kuptimi i **shtatë** i foljes "bëj": formoj me të tjerët një të tërë; lidhem me dikë; v III përbën, jep, del, është baras:

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor

bën përjashtim, është rast i veçantë > faire exception; dy dhe dy bëjnë katër> deux et deux font quatre; bëj paqe> faire la paix

Kryqëzim i foljes bëj me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të.

Semantizmi i njëjtë me foljen bëj realizohet me strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes. Psh: *bënë një shoqatë>former une association; bëri benë> il a juré*

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *njëqind centimetra bëjnë një metër> cent centimetres sont égaux à un mètre. bëjnë shumicën>constituer la majorité; e bënë me fjalë > tomber d'accord.*

Kuptimi i **tetë** i foljes "bëj": kaloj, mbush a plotësoj një kohë të caktuar

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor

bëri vitin> Ça fait une année ; u bënë dy orë që ka ardhur> Ça fait deux heures qu'il est venu; bëri tre vjet me këtë kostum> Son costume lui a fait trois ans.

Kryqëzim i foljes "bëj" me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet vetëm me strukturën e mëposhtme:

a. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *s'e ka bërë muajin; un mois n'est pas encore passé; bëj lejen;> etre en vacances, passer les vacances; bëfshi natën e mirë! (urim)> passez une bonne nuit*

Kuptimi i **nëntë** i foljes "bëj": jokalimtare edhe figurative; vlen, kushton, hyn në punë, përdoret; është i përshtatshëm:

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor

sa lekë bën?> Ça fait combien?;

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet me strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes. Psh: *Kjo klimë s'bën për të> ce climat ne lui convient pas; bën shtrenjtë (diçka); c'est cher; s'bën dy para s'vlen> ca ne vaut rien, pas grand chose. s'bënte ai për atë vajzë> il ne méritait pas cette fille.*

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *Ky celular nuk bën më> Ce portable ne fonctionne plus. Ky stilolaps s'bën më> ce stylo n'écrit plus. Durimi ka të bëjë shumë në jetë> la patience compte pour beaucoup dans la vie. ai s'bën për zyrë> il n'est pas apte de travailler au bureau*

Kuptimi i **dhjetë** i foljes “bëj”: jokalimtare (me trajtë të shkurtër përemërore) më nxë, më vjen:

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor

Nuk ka përdorim të tillë.

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet vetëm me strukturën e mëposhtme:

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *s'më bëjnë këpucët; ces souliers sont trop petites (grandes) pour moi, ce n'est pas mon numéro; s'i bën ky çelës> cette clé ne convient pas*

Kuptimi i **njëmbëdhjetë** i foljes “bëj”: pavet është, ka, mban

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor

bën ftohtë> il fait froid; bën butë> il fait doux

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet vetëm me strukturën e mëposhtme:

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj. Psh: *ka bërë dimër> l'hiver a été dur*

Kuptimi i **dymbëdhjetë** i foljes “bëj”: nis, zë, filloj, përpiqem, matem

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor

Nuk ka asnjë rast

Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet vetëm me strukturën e mëposhtme:

b. Ruajtja e strukturës sintaksore por duke ndryshuar foljen e duke përdorur një sinonim të saj.

Psh: *bëj të ngrihem> s'efforcer de se lever; bëj ta hap> tacher d'ouvrir qqch*

Kuptimi i **trembëdhjetë** i foljes “bëj”: folja përdoret në togje të qëndrueshme me kuptimin e foljeve, që lidhen me gjymtyrët e dyta:

➤ Përputhje në dy nivelet, semantik dhe strukturor sintaksor kemi në rastet e mëposhtme:

bëj durim, duroj; faire patience por edhe patienter; bëj kursim, kursej> faire des économies, économiser; bëj not, notoj> faire de la nage por edhe nager; bëj përpjekje përpiqem; faire des efforts dhe s'efforcer; bëj shëtitje shëtit; faire une promenade dhe se promener; i bëj nder e nderoj; faire honneur, honorer

➤ Kryqëzim i foljes “bëj” me folje të tjera të frëngjishtes me semantizëm të njëjtë me të

Ky semantizëm realizohet me strukturat e mëposhtme:

a. Folje me kuptim leksikor të njëjtë me kuptimin e togfjalëshit të shqipes. Psh: *bëj be, betohem> jurer; bëj çudi, çuditëm;> s'étonner*

Shprehje të ndryshme frazeologjike me foljen “faire” në gjuhën frënge dhe ekuivalentet e tyre në shqip

Në këtë rast vërejmë se kemi dy lloj strukturash me foljen “bëj”:

a. shprehje frazeologjike e shqipes

- *Faire le mort> bëj veshin e shurdhër, nuk përgjigjem, as që luaj nga vendi*

- *Faire la bombe> bëj kokrën e qefit* Në shqip përdoret fjala “**qejf**” si fjalë bërthamë e shprehjes por në një shprehje të figurshme. Në frëngjishte kemi një emër “**bombe**” i cili përdoret me kuptim të figurshëm.

b. një folje e vetme ose një perifrazim i cili shpreh semantizëm të njëjtë me shprehjen në frëngjisht.

- *Faire pencher la balance> mbaj dikë me hatër*

- *Faire fiasco> dështoj*

- *Faire peur> tremb, frikësoj*

- *Faire fortune> bëhem i pasur*

- *Faire tort > dëmtoj*

- *Faire part de qqch> njoftoj*

- *Il ne fait pas son âge> ai duket më i ri se ç'është*

- *Il se fait vieux> po plaket*

- *On ne me la fait Pas > s'ma hedhin dot*

Përfundime

Analiza përqasëse e realizuar në këndvështrimin leksikor semantik si edhe në atë strukturor sintaksor e foljeve “bëj” dhe “faire” tregon se sa e rëndësishme është gjetja e fjalëve ose shprehjeve përkatëse të ndërtuara me këto dy folje që shprehin semantizëm të njëjtë në të dy gjuhët. Pa

pretenduar se ajo është shteruese, ne mendojmë që krahasimi i këtyre dy mikrosistemeve do ti ndërgjegjësojë të gjithë nxënësit dhe studentët shqipfolës për të shmangur ndërhyrjet dhe gabimet e ndryshme gjatë shprehjes në gjuhën frënge. Këndvështrimi leksikor, krahasimi i dy

mikrosistemeve të foljeve “bëj” dhe “faire” të shqipes e frëngjishtes, si edhe përcaktimi i tipareve semantike të tyre do të ndihmojë të gjithë personat që mësojnë gjuhën frënge si gjuhë e huaj për të pasur parasysh interferencat e ndryshme me të cilat mund të ndeshen gjatë ligjërimit në këtë gjuhë.

BIBLIOGRAFI

Gramatika e Gjuhës shqipe 1 dhe 2, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2002.

Kokona.V Dictionnaire Français Albanais, Botimet Kokona, Tiranë, 2008.

Kokona.V Fjalor Shqip-Frëngjisht, Shtëpia Botuese “8 nëntori” Tiranë, 1977.

Le Dictionnaire Larousse de la langue française,

Thomai. J, Samara.M, Haxhillazi.P, Shehu.H, Feka.TH, Memisha.V, Goga.A. Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

Xhoxhaj.D, Fjalori, frazeologjik Frëngjisht-shqip-frëngjisht, Botimet EDFA, Tiranë, 2010.

TË KUPTUARIT E TOGFJALËSHVE TË QËNDRUESHËM NË ANGLISHTE DHE SHQIPE

SUELA KOÇA

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "F. S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Të kuptuarit dhe përvetësimi i togfjalëshave të qëndrueshëm është mjaft i vështirë. Akoma më i vështirë bëhet përdorimi i tyre në kontekste apo situata të ndryshme si në gjuhën e parë (amtare) edhe në gjuhën e dytë (të huaj). Studiuesit nuk kanë mundur të arrijnë në një përfundim të përbashkët lidhur me këtë çështje. Sipas teorive të ndryshme sugjerohet se kush mëson një gjuhë të huaj përdor një sërë strategjish (si hamendësimi, përdorimi i njohurive pragmatike, dhe eksperimentimi) për të deshifruar kuptimin e një togu të panjohur. Kështu, problemi kryesor i këtij studimi është parë nga këndvështrimi i nxënësit. Ky studim synon: 1) të identifikojë strategjitë e përdorura nga nxënësit e një niveli mesatar në anglisht për të kuptuar togjet e përzgjedhura si në anglisht edhe në shqip, 2) të evidentojë nëse të kuptuarit varet nga kategoria e togut të qëndrueshëm (identik, i njëjtë ose jo me një tog në shqip, me kuptim të figurshëm ose jo) dhe cilat prej tyre kuptohen më lehtë, dhe 3) të zbulojë sfidat me të cilat pëballen nxënësit e anglishtes kur i hasin këto togje në tekste të llojeve të ndryshme (por edhe në ligjërimin e folur) si në anglisht dhe në shqip.

Fjalë çelës: *togfjalësh, i qëndrueshëm, anglisht, shqip, të kuptuarit*

Abstract

Comprehension and acquisition of fixed expressions is very difficult. Using them in the proper context or situation is also difficult in the first language (L1) and second language (L2). Researchers have not come to an agreement about either L1 or L2 comprehension. Different approaches suggest an L2 learner uses a variety of strategies (including guessing, using pragmatic knowledge, and experimentation) to decipher the meaning of an unknown phrase. Therefore, the problem addressed in this study is from the perspective of foreign language learners. The threefold purpose of the current study is: 1) identify comprehension strategies used by intermediate level proficiency English language learners to understand the selected expressions in English and Albanian; 2) determine whether comprehension depends on the category of an expression (identical, similar, dissimilar, or with a figurative meaning); and 3) discover challenges that English language learners encounter while reading texts of different genres (even in speaking) in English and Albanian.

Keywords: *expression, fixed, English, Albanian, comprehension*

Hyrje

Togfjalëshat e qëndrueshëm me kuptim të figurshëm gjithmonë kanë qënë të vështirë për t'u kuptuar nëse dëgjohen për herë të parë dhe sidomos jashtë kontekstit. Djali im shtatë vjeçar është ende shumë i vogël për t'i kuptuar këto togje. Një ditë teksa po luante, meqë disa ditë më parë kishte qënë i sëmurë, i thashë: "Të lutet mami, rri shtrirë se je pa qejf," por ai shumë shpejt m'u përgjigj: "Po jo me mami, unë më qejf jam, pse të rri shtrirë?" Si kjo situatë ka edhe shumë të tjera dhe jo vetëm me fëmijë, por edhe me të rritur. Akoma më i vështirë bëhet interpretimi i këtyre togjeve për ata që mësojnë një gjuhë të huaj. Kjo vështirësi lidhet me natyrën e veçantë të togfjalëshave të qëndrueshëm dhe sidomos me ato që kanë kuptim të figurshëm.

Ky punim synon të trajtojë probleme të ndryshme që lidhen me strukturën dhe të kuptuarit e togfjalëshave të qëndrueshëm në shqip dhe në anglisht. Problemet do të shihen nga këndvështrimi i nxënësve sepse kriteret e tyre për të kuptuar këto togje mund të jenë të ndryshme nga ato të studiuesve për faktin e thjeshtë se nxënësit duan

vetëm t'i kuptojnë dhe përdorin ato. (Liu, 2008: 4) Pjesa e parë e këtij punimi trajton disa nga karakteristikat kryesore të togjeve të qëndrueshme idiomatike në anglisht dhe shqip. Në pjesën e dytë do të përshkruajmë një studim të bërë me studentë persa i përket të kuptuarit dhe përdorimit të këtyre togfjalëshave në të dyja gjuhët dhe në pjesën e fundit do të paraqitim rezultatet dhe përfundimet tona duke u bazuar tek pyetësorët e realizuar.

Le të themi dy fjalë për terminologjinë, e cila në këtë fushë studimi gjithmonë ka qënë problematike në kuptimin që nuk ka një fjalor të përbashkët dhe unik. Fjala vjen, tek punimi i M. Çelikut "Togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme" togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë trajtohen si njësi gramatikore dhe si njësi leksikore. (Thomaj, 1981: 6) Edhe M. Samara në studimin e tij "Antonimia e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën e sotme shqipe" shprehet: "Me togfjalëshat e qëndrueshëm kemi parasysh ato njësi gjuhësore, që "janë leksikalizuar plotësisht" ose kanë "tendencë leksikalizimi"; këta togfjalëshat "janë ekuivalent kuptimisht me një fjalë të vetme; më drejt sinonime të fjalëve ekzistuese"; "ata nuk

formohen në çastin e ligjëritimit, po janë ndërtuar historikisht, janë bërë të pazbërthueshëm dhe përdoren si njësi të gatshme, njësoj si fjalë". Shumica e tyre janë frazeologji që përfaqesin me fjalët e përngjitura, sepse ata nuk formojnë modele formimi. (Samara, 1981: 47). Terma të tjera të përdorura janë "lokucione", "frazë", "togfjalësha apo njësi frazeologjike", apo edhe ndonjë tjetër. Për këtë arsye, është e rëndësishme të qartësojmë që në fillim termat që do të përdorim dhe njësitë që përfshijnë ato. "Togfjalësh i qëndrueshëm" është një term i përgjithshëm, por i volitshëm sepse mbulon lloje të ndryshme njësisht frazeologjike dhe njësi të tjera dy apo më shumë fjalëshe, shprehje popullore me kuptim të figurshëm apo idioma që po përdoren rëndom, së fundmi, si në anglishte dhe në shqipe.

Disa karakteristikë të përgjithshme

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme lidhur me terminologjinë apo përkufizimin e togfjalëshave të qëndrueshëm, shumica e studiuesve bien dakord për disa karakteristikë të përgjithshme të këtyre togfjalëshave, dhe ato janë pak a shumë të ngjashme si në shqipe edhe në anglishte:

Integriteti (ose transferimi) i kuptimit që do të thotë se asnjë nga pjesët përbërëse të togfjalëshit nuk mund të lidhet më vete me ndonjë referues të realitetit objektiv dhe, si pasojë, kuptimi i të gjithë togut nuk mund të nxirret nga kuptimet e veçanta të secilës pjesë. P.sh. *s'ra sheqeri në ujë*, kuptimet e fjalëve të këtij togu *sheqeri* apo *ujë* nuk na thonë asgjë për kuptimin në tërësi të tij që, në fakt, është *pret puna, mos u rrëmbe. Mos u ngut kështu se s'ra sheqeri në ujë*. Edhe në anglishte, p.sh. *to kick the bucket*, fjalët *kick (shqelmoj)* apo *bucket (kovë)* nuk na ndihmojnë aspak të nxjerrim kuptimin e togut që është *to die (të vdesësh)*. *His grandfather kicked the bucket three years ago*.

Qëndrueshmëria (leksikore dhe gramatikore) që do të thotë se asnjë zëvendësim leksikor nuk është i mundur në një togfjalësh të qëndrueshëm në krahasim me togjet e lira apo kombinimet e ndryshueshme të fjalëve (me përjashtim të disa rasteve kur këto zëvendësime bëhen nga autori vetë, me një qëllim të caktuar). P.sh. *I ka vënë synë diellit*, asnjë prej fjalëve *synë* apo *diellit* nuk mund të ndryshohet. Nuk mund të themi *i ka vënë veshin diellit* apo *i ka vënë synë hënës*, sepse nuk do të kishim aspak një togfjalësh të qëndrueshëm me kuptimin *se dikush ka bërë shumë shpenzime pa menduar për të nesërmen. I bëri paratë rrush e kumbulla dhe tani i ka vënë synë diellit*. Edhe nëse zëvendësimi do të ishte i mundur, f.v. *i ka vënë synë vajzës* do të kishim një shprehje të re me kuptim të ri. Po kështu në anglishte themi *to catch someone red-handed (ta kapësh me presh në*

duar). Në vend të fjalës *red (e kuqe)* nuk mund të përdorim një ngjyrë tjetër *green (e gjelbër)* apo *blue (blu)*, *to catch someone green-handed*.

Ndarje do të thotë që struktura e një togfjalëshi të qëndrueshëm nuk është diçka e pandashme, modifikime të ndryshme mund të bëhen, por vetëm brenda disa kufijve të caktuar dhe jo gjithmonë. P.sh. *Mos i qaj hallin atij, e ka xhepin kukurec*, tek ky togfjalësh nuk mund të ndryshojmë fjalët *xhepin* apo *kukurec*, por shumë mirë mund të ndryshojmë formën apo kohën e foljes; *e kishte xhepin kukurec* apo *e kanë xhepin kukurec*. Edhe në anglishte themi *to bite one's nails (të kafshosh thonjtë)*, këtu nuk mund të ndryshojmë fjalën *nails (thonjtë)*, por mund të ndryshojmë formën e foljes; *he is biting his nails. He always bites his nails. He bit his nails*.

Shprehimshmëria do të thotë se togjet e qëndrueshme shoqërohen nga ngjyrimi stilistikor. Me fjalë të tjera, kur ato përdoren, e bëjnë ligjëritimin (të shkruar apo të folur) më emocionues dhe shprehës.

Në përgjithësi, togfjalëshat e qëndrueshëm (apo frazeologjikë), megjithëse paraqesin një model të caktuar, nuk prodhojnë togje të reja. Ata janë unikë. (Arsentyeva, 2003).

Përshkrimi i studimit dhe rezultatet

Qëllimi i këtij studimi ishte që të identifikonte shkallën e njohjes së togfjalëshave të qëndrueshëm në shqipe edhe në anglishte, të evidentonte nëse të kuptuarit e tyre varet nga kategoria e togut (i njohur apo i panjohur, me kuptim të figurshëm ose jo, identik, i njëjtë ose jo me një tog në shqip [në rastin e togjeve në anglishte, për të parë se sa ndihmon gjuha amtare]), si edhe të zbulonte sfidat me të cilat përballen studentët e anglishtes kur u duhet që t'i përdorin këta togfjalësha dhe sa të saktë janë ata, kur i përdorin në fjali.

Studimi u bazua tek pyetësorët e plotësuar nga studentët. Pyetësori ishte i ndarë në dy pjesë, njëra përfshinte togje në gjuhën shqipe, dhe tjetra togje në gjuhën angleze (nga 40 për secilën gjuhë). Për të plotësuar pyetësorin u angazhuan 26 studentë të nivelit mesatar që aktualisht studiojnë anglishten si gjuhë të dytë në universitetin tonë dhe duhet theksuar se ata ishin mjaft të interesuar. Në fillim, studentëve iu dha një listë me togfjalësha për të parë shkallën e njohjes së tyre, nëse i kishin dëgjuar më parë apo jo (si në shqipe [kryesisht togje të rrethit të Korçës] edhe në anglishte). Përsa u përket togfjalëshave në anglishte studentëve iu kërkua që të bënin përjashtime me shqipen. Qëllimisht, togfjalëshat e përzgjedhur nuk ishin të gjithë barasvlerës me shqipen. Pasi plotësuan këtë listë të

parë, studentëve iu kërkua që të përshkruanin strategjitë e përdorura për të kuptuar togjet a panjohura për ta. Dy alternativat e dhëna ishin ose nëpërmjet përkufizimit ose nëpërmjet kontekstit, se cila prej tyre ishte më e vlefshme për ta, në kuptimin se cila prej tyre i ndihmoi më shumë për të kuptuar dhe përdorur drejt togfjalëshat në gjuhët respektive. Për të kuptuar më mirë sfidat me të cilat përballen studentët, atyre iu kërkua njëkohësisht të formonin fjali të thjeshta me togjet e panjohura. Problemet kryesore që vërejtëm lidhen me këto çështje:

Përkufizimi i kuptimit: studentët nuk e kanë të lehtë të japin përkufizimin e togut edhe kur e dinë kuptimin. Ata më shumë preferojnë të përdorin fjali për t'i përshkruar ato. Duhet theksuar se shumica e tyre i njihnin togfjalëshat në shqipe më shumë se ato në anglishte. Madje, për disa prej tyre studentët përdorën shprehje të tjera, po të figurshme për t'i shpjeguar, si: *godet me një çekan dikush (në një vrimë i bie fyellit dikush)* apo *sa ke kopsën, hap vrimën (shtriji këmbët sa ke jorganin)* dhe *(i ngeli këmba në gurë (i ngeci sharra në gozhdë)*. Por ka edhe ndonjë shprehje, si: *i ngriftë dhjamët e syrit* që studentët nuk e kuptojnë, edhe pasi është përdorur në fjali: *I ngriftë dhjamët e syrit, qenit se na plasi!* Ata e kuptojnë që kjo shprehje i referohet një mallkimi, por nuk arrijnë të nxjerrin kuptimin e saktë, që do të thotë t'i urosh vdekjen dikujt që të ka mërzitur shumë: *vdektë!*.

Dhënia e përkufizimit: duhet theksuar se dhënia e përkufizimit i ndihmon shumë për të kuptuar. Për togfjalëshat e panjohur si në anglishte edhe në shqipe, pas dhënies së përkufizimit, nuk e kanë aspak të vështirë të krijojnë fjali të sakta.

Konteksti: jo gjithmonë konteksti i ndihmon për të kuptuar togjet e panjohura, sidomos në anglishte. Në shumicën e rasteve, duket se studentët e kanë më të lehtë që pas dhënies së përkufizimit të krijojnë fjali sesa të japin përkufizimin e saktë pasi e kanë parë të përdorur në kontekst (përdorimi në fjali ndonjëherë i ngatërron duke dhënë përkufizim jo të saktë). Edhe kur përqipen të japin përkufizimin nuk janë shumë të saktë në formulimin e saktë të tyre. Nuk mungojnë edhe rastet kur e kanë më të lehtë, që pas një fjalie të dhënë, të krijojnë një fjali tjetër. Togfjalëshat e njohur dhe shumë të përdorur në anglishte, si: *take it easy, get the message* apo *by and large*, i njohin të gjithë studentët.

Përqaqja me shqipen: togfjalëshat e anglishtes që kanë forma gjegjëse në shqipe, studentët i kuptojnë më mirë e më lehtë dhe njëkohësisht nuk e kanë aspak të vështirë t'i përdorin drejt në fjali. Ja ku po japim disa shembuj: Crocodile tears – lotë krokodili

To kill two birds with one stone – me një gur të vrasësh dy zogj

On the tip of one's tongue – në majë të gjuhës

To lead someone by the nose – ta tërheqësh dikë prej hunde

A fish out of water – si peshku pa ujë

Lose one's temper – të humbësh toruan

Por ka edhe shprehje, si: *to put a spoke in someone's wheel*, që megjithëse ka barasvlerësen në shqipe *t'i futësh shkopinj në rrotë dikujt*, studentët nuk e kuptojnë, edhe pasi është dhënë përkufizimi. Edhe një shembull tjetër, si: *a skeleton in the cupboard*, studentët e kanë të vështirë ta kuptojnë, megjithëse ky togfjalësh po përdoret në shqipe në të njëjtën mënyrë *një skelet në dollap*. Kuptohet që togfjalëshat e tjerë të qëndrueshëm, që nuk janë aspak të ngjashëm me ato të shqipes, janë shumë herë më të vështirë për t'u kuptuar dhe përdorur nga studentët në mënyrë të saktë. Disa prej studentëve (por vetëm shumë pak) i kanë shpjeguar togfjalëshat në anglishte duke dhënë shprehje në shqipe, si: *to kick the bucket (i ktheu patkonjtë diellit)* apo *to spill the beans (e hapi thesin)*.

Përfundime

Nëpërmjet këtij studimi modest u përpoqëm të analizojmë disa nga problemet kryesore që lidhen me të kuptuarit dhe përdorimin e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën amtare dhe në gjuhë të huaj (në këtë rast anglishten). Sipas të dhënave të mbledhura nga pyetësorët mund të nxjerrim këto përfundime:

Së pari, studentët i njohin shprehjet në shqip (shumicën e tyre) që do të thotë se i kanë dëgjuar më shpesh. Për këtë arsye nuk e kanë të vështirë t'i përdorin në mënyrë të saktë, madje duke i perifrazuar po me shprehje të figurshme.

Së dyti, shprehjet në anglishte i njohin më pak, por edhe kur jepet përkufizimi apo konteksti, ndonjëherë nuk i kuptojnë si duhet. Kur këta togfjalëshat kanë barasvlerëse në shqipe, studentët e kanë shumë herë më të lehtë për t'i kuptuar dhe përdorur.

Së treti, vihet re prirja e studentëve për të kuptuar më lehtë togfjalëshat kur shpjegohen me anë të përkufizimit se sa kur përdoren në kontekst, si në shqipe edhe në anglishte.

Së fundmi, do të përfundonim duke thënë se të kuptuarit e togfjalëshave të qëndrueshëm është mjaft i vështirë për shkak të natyrës së tyre shumë të veçantë. Jashtë konteksti, ato janë të vështira si në gjuhën amtare edhe në gjuhë të huaj. Akoma më i vështirë bëhet përvetësimi dhe përdorimi i tyre në situatën e duhur. Ndoshta në ndonjë studim të mëvonshëm dhe më të thelluar do të mund të shohim sfidat me të cilat përballen

studentët për t'i kuptuar togfjalëshat e referuar përdorimit të tyre në zhanre të ndryshme qëndrueshëm në situata më konkrete, duke iu (letërsi artistike, publicistikë, gazetari etj.).

BIBLIOGRAFI

Arsentyeva, Elena, (2003), *Interlanguage Relations of English and Russian Phraseological Units*, TRANS, April, Nr. 14, <http://www.inst.at/trans/14Nr/arsentyeva14.htm>.

Çeliku, Mehmet, (1962), *Togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore.

Curry, N., (1994), *Illustrated American Idioms*, The Materials Branch English Language Programs Division US Information Agency, Washington, DC 20547.

Liu, Dilin, (2008), *Idioms; Description, Comprehension, Acquisition, and Pedagogy*. ESL & Applied Linguistics Professional Series.

Mustaka, Niko, (1984), *Shprehje popullore nga Rrethi i Korçës*, SF. Nr. 1.

Samara, Miço, (1981), *Antonimia e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën e sotme shqipe*, SF, Nr. 4.

Seidl, Jennifer, (1978), *English Idioms and How to Use Them*, Oxford: Oxford University Press.

Thomaj, Jani, (1981), *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë

HISTORI, GJEOGRAFI, SHKENCA JURIDIKE

KRIJIMI I BANKËS KOMBËTARE DHE FUNKSIONIMI I SAJ

ELONA KAZAZI
DEPARTAMENTI I HISTORISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Në rrethanat e krijimit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që ajo të futej në rrugën e zhvillimit dhe mbi të gjitha të ishte një shtet i qëndrueshëm në aspektin ekonomik dhe politik, Ahmet Zogut i duhej patjetër një ndihmë nga një shtet i huaj. Këtë ndihmë ai do ta marrë nga Italia dhe kjo jo pa interes. Me këtë punim kemi si qëllim të paraqesim rrethanat në të cilat u krijua Banka Kombëtare e Shqipërisë, funksionimin e saj, reagimin e opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar, kontradiktat që ajo kishte në vetvete dhe gjithashtu rëndësinë që pati krijimi i kësaj banke për shtetin shqiptar. Duke u mbështetur te burimet arkivore, literatura dhe periodikët e kohës, jam munduar të fokusohem më shumë tek anët pozitive të krijimit të kësaj banke.

Fjalët çelës: *Banka Kombëtare, aksionet, kapitali italian, monedhat.*

Abstract

In the circumstances of the creation of the Republic of Albania, and in order to find the best ways for development, especially to be a stable nation in economic and political terms, Ahmet Zog absolutely needed a support from a foreign country. He will get it from the Italy, and this support wouldn't be without self-interest.

In this paper I intended to present the circumstances in which it was created the National Bank of Albania, its function, and the reaction of the national and international opinion, the contradictions that it had, and also its importance for the Albanian Nation.

According to archival sources, literature and periodicals of the time, I tried to be more focused on the positive aspects of the creation of the bank.

Keywords: National Bank, shares, Italian capital, banknotes and coins

HYRJE

Për Bankën Kombëtare të Shqipërisë është folur shumë nga historianë dhe studiues të ndryshëm. Arsyeja përse unë kam zgjedhur të prezantoj këtë temë është sepse dëshiroja ta studioja atë mbi bazën e një këndvështrimi të ri.

Në këtë studim unë synoj të paraqes: rrethanat, të cilat e detyruan Ahmet Zogun të nënshkruante marrëveshjen mbi Bankën Kombëtare; klauzolat e kësaj marrëveshjeje; ndarjen e padrejtë të aksioneve; organet drejtuese të bankës; mënyrën se si ajo funksiononte dhe mbi të gjitha anët pozitive të krijimit të saj si dhe ndikimin që ajo pati në zhvillimin ekonomik të vendit.

Banka Kombëtare e Shqipërisë pati një rëndësi të madhe për vetë faktin se deri në atë kohë shteti shqiptar nuk kishte pasur një bankë të tijën. Ajo do të arrijë të vendosë rregull në qarkullimin monetar, duke hedhur në qarkullim një monedhë të vetme. Kjo bankë dha kredi të shumta për mbajtjen e aparatit shtetëror dhe ndikoi pozitivisht në ekonominë e kësaj periudhe.

Krijimi i Bankës Kombëtare dhe funksionimi i saj

Që para vitit 1925 për Zogun ishte më se e qartë se Shqipëria në këtë periudhë, duke qenë një shtet i brishtë dhe me shumë probleme, kishte nevojë urgjente që të finançohej në fushën

ekonomike nga një shtet i fuqishëm në mënyrë që t'i mbijetonte problemeve të saj. Pas përpjekjeve të kota për ndihmë drejtuar Lidhjes së Kombeve, presidentit nuk i mbetej rrugë tjetër veçse t'i kthente sytë nga ndonjë fuqi e huaj, e cila do ishte e gatshme, ndoshta edhe pa ndonjë përfitim ekonomik, të pranonte t'i vinte në ndihmë Shqipërisë (Fisher 2004, 93). Shtetet më të interesuara për zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri ishin ato fqinje, e para së gjithashtu Jugosllavia dhe Italia. Prapa tyre, për llogari e synime më të gjera, qëndronin Franca dhe Anglia. Nga kjo pikëpamje ishte më se e natyrshme që shteti shqiptar do ta hidhte vështrimin në radhë të parë në këto shtete (Milo 1992, 333). Pritej të ishte Jugosllavia ajo që do të kishte preferencën në politikën e jashtme të qeverisë shqiptare për shkak të kontributit të njohur, që ajo kishte dhënë për kthimin e Ahmet Zogut në pushtet. Megjithatë presidenti shqiptar nuk mund ta bënte një gabim të tillë. Ndonëse Jugosllavia mund ta ndihmonte Shqipërinë në aspektin financiar, në kërkesat që ajo kishte ndaj saj, Jugosllavia nuk dilte shumë hapur sepse i trembej reagimit të Italisë. Këtë gjë e tregoi edhe fakti se Jugosllavia nuk u ngut ta njihte qeverinë e Zogut, me qëllim që t'i provonte Italisë, sikurse kishte deklaruar edhe Ninçiqi se politika jugosllave në

Shqipëri do të zhvillohej në harmoni të plotë me politikën italiane (Cici 2002, 61).

Ndërkohë, Musolini nuk kishte ndërmend ta njëhte regjimin shqiptar, për sa kohë që Zogu nuk do të jepte prova të sigurta se nuk ishte i varur nga Beogradi dhe se garantonte pozitën dhe njohjen e interesave të Italisë në Shqipëri. Në këtë rast Zogu ishte i detyruar t'u drejtohej për ndihmë italianëve për disa arsye:

Së pari: Megjithëse, Zogu ishte borxhli ndaj Beogradit, ai nuk pranoi t'i njëhte atij të drejtën për të ndikuar mbi qeverinë e tij, pasi u druhej qëllimeve të Jugosllavisë. Ai do të ishte më i sigurt nëse do të hynte në marrëdhënie me shtete më të mëdha dhe që ishin larg gjeografikisht.

Së dyti : Beogradi kishte treguar se ishte i gatshëm për të ndërhyrë në politikën shqiptare. Nëse Zogut do t'i duhej të ndërmerrte një politikë irredentiste, ajo do të drejtohej kundër Jugosllavisë, në të cilën jetonte thuajse gjysma e krejt popullsisë shqiptare. Ndërkohë që, Italia ishte një prej shteteve kryesore evropiane që nuk kishte kufij të përbashkët me Shqipërinë. Gjithashtu deri tani Zogu nuk ishte kërcënuar ndonjëherë prej Italisë (Fisher 2004, 94-95).

Së treti: Italia ishte një shtet i fuqishëm ekonomikisht. Ajo ishte bërë partneri i dytë tregtar i vendit dhe kishte nevojë për mallrat shqiptare. Greqia dhe Jugosllavia, dy shtete të interesuara për Shqipërinë, prodhonin thuajse të njëjtat produkte bujqësore, dhe kishin pak nevojë për produktet shqiptare. Gjithashtu këto dy shtete nuk ishin në gjendje të bënin investime të mëdha në Shqipëri ose të fillonin një bashkëpunim ekonomik me Shqipërinë. Pra, Italia ishte shteti i duhur për të ndihmuar dhe mbështetur ekonominë shqiptare (Akademia e Shkencave të Shqipërisë 2007, 256).

Ndërkohë, mund të themi se kjo zgjedhje e Shqipërisë u përcaktua deri diku nga qëndrimi i Jugosllavisë. Kjo sepse, shteti jugosllav i pati të gjitha mundësitë për të vendosur mirëkuptimin e tij midis dy vendeve, por kjo do të nënkuptonte një përmirësim të fatit të shqiptarëve në Serbinë e Jugut, një lehtësim të trysnisë që ajo kishte ushtruar ndaj kufijve shqiptarë dhe fundin e çdo ndërhyrjeje politike në Shqipëri. Por ky çmim ishte shumë i lartë për të paguar miqësinë e Shqipërisë (Swire 2005, 361).

Problemin shqiptar Roma e gjykonte nga dy aspekte: të shmangte ndërhyrjen e një fuqie të huaj në bregun tjetër të Adriatikut dhe ta shfrytëzonte Shqipërinë si një bazë për të ushtruar politikën e Fuqisë së Madhe në Ballkan, veçanërisht kundër Jugosllavisë. Jugosllavia, duke parë rrezikun italian, i kishte kërkuar Italisë për të arritur në një

marrëveshje për ndarjen e Shqipërisë midis këtyre dy shteteve. Italia i refuzoi propozimet jugosllave, siç edhe mendohej, kjo sepse ajo synonte kontrollin e saj në të gjithë vendin dhe jo vetëm në një pjesë të tij (Duka 2007, 160).

Siç pritej, politika e jashtme e shtetit shqiptar në këtë periudhë do të karakterizohet fuqishëm nga rivaliteti italo-jugosllav. Ky rivalitet në Shqipëri e në Ballkan ishte aspekt i një konfrontimi më të gjerë, në shkallë evropiane midis Fuqive të Mëdha, të cilat po i kundërviheshin njëra-tjetrës për hegjemoni në kontinent. Në njërin anë, ishte rreshtuar Anglia, që kishte tërhequr me vete edhe Italinë, nga ana tjetër Franca, e cila, duke mos gjetur aleat tjetër midis Fuqive të Mëdha evropiane, u bashkua me shtetet e Evropës Qendrore e Juglindore, të cilat ishin për ruajtjen e statuskuosë dhe kufijtë e vendosur nga Sistemi i Versajës. Këto shtete ishin: Çekosllovakia, Rumania dhe Jugosllavia (Milo 1992, 354).

Në fillim të janarit 1924 Zogu, ndodhej në një gjendje të brendshme të vështirë dhe kishte nevojë për të holla për t'i bërë ballë opozitës. Për këtë arsye, Zogu i ofroi Italisë koncesione të rëndësishme në shkëmbim të një ndihme financiare. Më 20 janar midis dy shteteve u nënshkrua një pakt i fshehtë detaro-tregtar. Sipas tij:

✓ Italisë i njëhej statusi i kombit më të favorizuar në Shqipëri.

✓ Shqipëria do të ndalonte të gjithë shoqëritë e vendeve të tjera të ngrinin në Shqipëri monopole ose të kërkonin koncesione që dëmtonin interesat italiane.

✓ Përrjashtoheshin nga pagesa e taksave të tranzitit të gjitha anijet italiane.

✓ Parashikoheshin disa rregulla në lidhje me trafikun e udhëtarëve dhe të drejtat e peshkimit.

Në këtë kohë Zogu informoi Durazzon, ministrin italian në Shqipëri, se kishte si qëllim të njëhte interesat italiane në Shqipëri dhe caktoi më pas në postin e Ministrit të Jashtëm Myfit bej Libohovën (Fisher 2004, 99).

Në këtë kohë për depërtimin ekspansionist të Italisë në Shqipëri ishin bërë disa plane, ku përmendet plani i Lessona-s i cili kërkonte që Italia të përfundonte me Zogun dy traktate, një ekonomik dhe një politiko-ushtarak dhe plani i Salvatore Contarinit, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, i cili synonte realizimin vetëm të një traktati ekonomik me Shqipërinë, pa prekur fushën politike (Smirnova 2004, 85). Plan i Lessona-s ndryshonte nga ai i Contarinit sepse ky plan kërkonte të realizonte njëkohësisht afrimin ekonomik dhe atë politik me Shqipërinë. Mirëpo, duke qenë se nuk ishin krijuar akoma kushtet e

duhura, realizimi i këtij plani mund të ishte një veprim i nxituar, i cili do të sillte pasoja jo të mira në marrëdhëniet midis Romës dhe Beogradit. Ndërkohë, plani i Contarinis synonte që të arrihej objektivi ekonomik me Shqipërinë, por që edhe marrëdhëniet me Jugosllavinë të mos keqësoheshin. Contarini përmes këtij plani kërkonte të dobësonte epërsinë politike të Jugosllavisë në Shqipëri përmes forcimit të epërsisë ekonomike të Italisë, për të rifilluar nga pozita të forta, bisedimet me Beogradin për një sistem politik të çështjes shqiptare (Carocci 1969, 35). Sipas tij, që Shqipëria të mos kthehej në një shkak acarimi midis Italisë e Jugosllavisë, depërtimi italian në Shqipëri nuk duhej të prekte përkohësisht pavarësinë politike të vendit fqinjë. Për Contarinin ishte shumë e rëndësishme ruajtja e marrëdhënieve italo-jugosllave. Ai mendonte se prishja e tyre do të bënte të mundur që pavarësia e Shqipërisë të shndërrohej në një burim rreziqesh si pasojë e intrigave jugosllave dhe nuk përjashtohej mundësia, që Zogu të implikonte Italinë edhe ushtarakisht ndaj Jugosllavisë (Cici 2002, 66). Planin e Contarinis propozonte marrjen e këtyre masave:

- ✓ Ratifikimi i Traktatit të Tregtisë dhe të Lundrimit me Shqipërinë, firmosur në Romë në vitin 1924;
- ✓ Marrja nga ana e Italisë e terrave për kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës në Shqipëri;
- ✓ Pjesëmarrja e Italisë në ndërtimin e veprave publike në Shqipëri;
- ✓ Zgjidhja e problemeve lidhur me pyjet që mund të merrte Italia për shfrytëzim në Shqipëri;
- ✓ Zgjatja deri në 19 vjet e lejes për firmën Fabiano për shfrytëzimin e peshkut në liqenin e Shkodrës;
- ✓ Dhënia në shfrytëzim e minierës së Memaliajt shoqërisë Sigma;
- ✓ Rikonfirmimi i marrëveshjes që u jepte shoqërive italiane të drejtën për shfrytëzimin e minierave të Selenicës;
- ✓ Zgjidhja e kontraktave midis qeverisë shqiptare dhe shoqërisë Silba për çështjen e sharrave në Llogara;
- ✓ Themelimi i Bankës së Shtetit Shqiptar

Siç do të shihet edhe më vonë Italia do të marrë në Shqipëri koncesionet më të rëndësishme. Realizimi pothuajse i plotë i planit të përgatitur nga Contarini, përbën boshtin e politikës italiane të depërtimit ekonomik në Shqipëri. (Carocci 1969, 38)

Ndërkohë që Shqipëria po përpqej me çdo mënyrë që të gjente një rrugë për të përmirësuar

gjendjen e saj financiare, ndërmjet shteteve imperialiste dhe shteteve fqinjë të Shqipërisë u ndezën sërish kontradiktat për të ndërhyrë, ndër të tjera, në sistemin tonë të kreditit (Saraçi 2006, 85). Të ashpra qenë kontradiktat sidomos ndërmjet Romës e Londrës dhe Romës e Beogradit. Secila palë përpqej të kishte një ndërhyrje më të gjerë dhe depërtimin në sistemin e kreditit, që së bashku me ndërhyrjen në buxhetin, synonte ta përdorte si trampolinë për zgjerimin e ekspansionit në të gjitha çështjet e tjera të brendshme të Shqipërisë (Probleme Ekonomike 1975, 84).

Në kohën kur qeveria shqiptare kishte filluar bisedimet me italianët për krijimin e Bankës Kombëtare, Zogu filloi paralelisht bisedimet me një grup që përfaqësonte Midland Bank-un e Anglisë. Këtë veprim e bëri për t'i treguar Italisë se ai kishte edhe mundësi të tjera për sa i përket çështjes së bankës (Fisher 2004, 101). Ky grup i propozoi atij që të krijonte një bankë me një kapital prej 500.000 sterlinash, të garantuara nga të ardhurat e doganës shqiptare, si edhe prej monopoleve të tjera të shtetit shqiptar. Nga kapitali i bankës, 51% të aksioneve do t'i kishin anglezët, ndërsa 49% shqiptarët. Grupi kapitalist anglez, që do të merrte në koncesion krijimin e bankës, do t'i siguronte qeverisë shqiptare një hua prej 2 milionë lira sterlina. Nëse marrëveshja do të nënshkruhej, Zogu do të merrte një kështë paraprak prej 100.000 sterlinash.

Në këtë kohë u bënë përpjekje edhe nga kapitali grek për të ndërhyrë në Shqipëri. Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Athinës, i kishte propozuar qeverisë shqiptare që të formonte një bankë dhe t'i jepte një hua prej 1 milionë lira sterlina, gjoja pa kërkuar privilegje të veçanta në fushën e ekonomisë. Përpjekjet greke për marrjen e koncesionit të bankës dështuan (Probleme Ekonomike 1975, 88). Gjithsesi, në fillim të marsit të vitit 1925, qeveria e Zogut zhvilloi bisedime me firmën kapitaliste greke të Korfuzit, G.Aspiotis Frer (G. Aspiotis Freres) për shtypjen e monedhave, me të cilat do të përballoheshin disa vështirësi për financimin e shpenzimeve të bashkive të qyteteve kryesore të Shqipërisë. Më 9 mars Myfit Libohova përfundoi me firmën e mësipërme një marrëveshje në lidhje me këtë çështje (Fishta 1979, 59). Gjithsesi, Zogu nuk arriti dot të mënjanonte krejtësisht nga Shqipëria kapitalin e shtetit grek dhe të atij jugosllav. Kështu, ai aprovoi kërkesën e Bankës Serbo-Shqiptare, me qendër në Cetinë të Malit të Zi, që të zhvillonte veprimtari bankare në Shqipëri. Më 3 prill të vitit 1925 kjo bankë hapi një degë në qytetin e Shkodrës. Pak me vonë, qeveria e Zogut pranoi kërkesën e

Bankës së Athinës për të hapur dy degë në Shqipëri: në Durrës dhe në Korçë (Belegu 1964, 33).

Në periudhën e viteve 1925-1931, me përpjekjet e bëra për realizimin e synimeve të tyre ekspansioniste në Shqipëri, fuqitë e huaja, sidomos Italia, kanë përdorur si metodat e hapura, ashtu edhe ato të maskuara. Megjithatë, në këtë periudhë kohe janë më karakteristike metodat e maskuara të ndërhyrjes, përdorimi i demagogjisë për mashtrimin e opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar, përdorimi në shkallë të gjerë i korrupsionit dhe i prapaskenave etj., (Fishta 1979, 39). Ndërsa, ndër metodat e hapura përmendim presionet dhe frikësimet për nënshtrimin e klikës së Zogut dhe për arritjen e synimeve imperialiste në Shqipëri.

Italia pati sukses në Shqipëri jo vetëm sepse ajo duke qenë afër Shqipërisë si për çështjen ekonomike ashtu edhe për atë strategjike ishte e interesuar më tepër se fuqitë e tjera të mëdha, por edhe për dy faktorë të tjerë:

1. Italia si kundërshtarë të afërt në Shqipëri kishte Jugosllavinë, që ishte më e dobët se Italia në anën financiare dhe ekonomike.

2. Anglia duke dashur të largonte vëmendjen e fashistëve italianë nga kolonitë e saj në Afrikë e Lindjen e Mesme dhe sidomos duke dashur të kundër balancoje ndikimin dhe politikën e Francës në Ballkan, i vuri përballë Italinë. (Belegu 1964, 34) Për këtë arsye, pas marrjes së koncesionit të vajgurit nga shoqëria "Anglo-Persian", Anglia i la rrugë të lirë depërtimit të kapitalit italian në Shqipëri dhe i kërkoi qeverisë së Zogut, që kjo t'i jepte koncesione të tjera Italisë. Kjo politikë e Anglisë u pa sidomos me lëshimin që i bëri ajo Italisë për të marrë koncesionin e krijimit të Bankës Kombëtare dhe huanë SVEA. Përmes këtyre koncesioneve të rëndësishme, Italia kapi financat e Shqipërisë, çelësin e ekonomisë kombëtare shqiptare (Fisher 2004, 102). Në këtë aspekt, duket sikur Anglia pasi realizoi qëllimin e saj kryesor ndaj Shqipërisë, marrjen e koncesionit vajguror, ia la radhën Italisë për të zbatuar politikën e saj ekspansioniste në Shqipëri, ndërkohë që ajo si fuqia ekujlibruese e Evropës duhej të ndërhynte në favor të vendit, i cili kishte të drejtë. Gjithsesi këtë sjellje të Anglisë do ta shohim të përsëritet dhe në vitet në vazhdim ndaj shtetit shqiptar.

Shqipëria nuk kishte një bankë të vetën. Gjatë sundimit turk dhe pas pavarësisë ishin hapur degë të bankave të huaja, që nuk funksiononin rregullisht. Ndjehej mungesa e një banke kombëtare sepse: gjendja financiare e Shqipërisë ishte shumë e keqe dhe buxheti financiar ishte gjithmonë në deficit. Qeveria e Zogut kishte nevojë të ngutshme për ndihmë financiare të jashtme për mbajtjen e

apararit administrativ dhe për rregullimin e buxhetit të shtetit. Synimet e krijimit të Bankës Kombëtare për Zogun ishin:

➤ Banka do të ishte një burim ku qeveria e Zogut do "stabilizonte" gjendjen e keqe financiare.

➤ Me krijimin e bankës Zogu do të merrte me të mirë borgjezinë shqiptare duke i plotësuar një nga një kërkesat e saj ekonomike (Belegu 1964, 35).

➤ Zogu mendonte se duke përmirësuar gjendjen financiare me ndihmën e huaj, do të stabilizonte edhe gjendjen politike.

➤ Banka do të drejtonte veprimet financiare, do ndihmonte me kredi zhvillimin e industrisë dhe të tregtisë (Duka 2007, 161).

➤ Banka e emisionit do të vinte në qarkullim një monedhë të vetme sepse në atë kohë në Shqipëri qarkullonin monedha të ndryshme: korona, lireta, drahma, dinare, etj., (Fisher 2004, 103). Përveç monedhave prej ari, të tjerat prej metali dhe kartëmonedhat nuk ishin të qëndrueshme dhe të garantuara nga shteti shqiptar. Këto monedha përdorëshin në krahina të ndryshme dhe shkëmbimi i tyre nuk ishte i njëjlojtë.

Rëndësia që do të kishte për Italinë marrja e koncesionit për krijimin e Bankës Kombëtare dhe huaja SVEA ishte e madhe sepse ato do t'i siguronin Italisë supremacinë ekonomike mbi shtete e tjera në Shqipëri dhe gjithashtu përmes tyre Italia do të arrinte nënshtrimin e plotë të Shqipërisë në fushën ekonomike dhe politike. (Belegu 1964, 35)

Qeveria e Zogut me anë të Myfit bej Libohovës, i cili kishte interes të veçantë për italianët dhe Solas, regjenti i legatës italiane në Durrës, hyri në marrëveshje me grupin financiar Italian "Credito Italiano" për të krijuar Bankën Kombëtare Shqiptare. Koncesioni për krijimin e Bankës Kombëtare u nënshkrua nga dy përfaqësuesit në datën 11 mars të vitit 1925 (Fishta, Kareco 1996, 210). Marrëveshja për krijimin e Bankës Kombëtare u mbyll shumë shpejt, më 15 mars të vitit 1925. Sipas marrëveshjes së nënshkruar midis grupit financiar Italian "Credito Italiano" të përfaqësuar nga Mario Alberti dhe qeverisë shqiptare, të përfaqësuar nga ministri i Financave Myfit bej Libohova, krijohej Banka Kombëtare e Shqipërisë me një kapital prej 12.5 milionë franga ari. Më 2 shtator 1925 u krijua në Romë Banka Kombëtare e Shqipërisë me qendër në Romë dhe në Shqipëri me qendër në Tiranë. Në Romë do të ruhej edhe 33 % e rezervave të arit të bankës. Banka do të hapte degë të saj në: Vlorë, Shkodër etj. Nga nënshkrimi i marrëveshjes (mars) deri në formimin e bankës (shtator), kemi mosmarrëveshje për

nënshkrimin e aksioneve. Korrespondencën e saj në Shqipëri banka do ta mbante në italisht (Probleme ekonomike 1975, 106). Më 5 korrik 1925 marrëveshja për themelimin e bankës dhe huan SVEA bashkë me dokumentet e tjera, ishte aprovuar nga Senati shqiptar dhe më 12 korrik 1925 ajo u firmos nga Zogu. Ndërkohë më 2 shtator 1925 u zhvillua ceremonia solemne e themelimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Kjo ceremoni u bë në Romë dhe jo në Tiranë. Marrëveshjet për bankën dhe huan SVEA u vijuan nga përfundimi i disa marrëveshjeve me karakter politik e ushtarak (Pakti i parë dhe Pakti i dytë i Tiranës, në nëntor 1926 dhe në nëntor 1927) (Roselli 1988, 155).

Me themelimin e bankës u hartua edhe Ligji Organik i saj, i cili përmbante 60 artikuj. Në 3 artikujt e parë të tij deklarohet se aktiviteti i bankës rregullohet nga ky ligj dhe nga statutet e bankës. Kur ligji dhe statutet heshtnin, merrej parasysh legjislati Italian. Banka do e kishte Drejtorinë Qendrore në Tiranë dhe ajo mund të krijonte degë në Shqipëri dhe jashtë saj (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 87). Dy nga organet drejtuese të bankës ishin: Komiteti i Administrimit dhe Këshilli i Administrimit. Komiteti i Administratës merrej me drejtimin e bankës dhe me veprimet shoqërore. Ai mbledhej nga kryetari i tij, të paktën 2 herë në muaj (Art.45 i Ligjit Organik të Bankës Kombëtare Shqiptare). Në Këshillin e Administrimit, këshilltarët e mbanin postin për 6 vjet dhe mund të zgjidheshin sërish. (Art.38 i Ligjit Organik të bankës). Në këtë organ, një anëtar dhe një komisar zgjidheshin nga Ministria e Financave (Arkivi Qendror i Shtetit 1926, 30). Qendrimi i Këshillit dhe i Komitetit të Administratës do të ishte jashtë Shqipërisë. Kolegji i Sindakëve ishte një organ tjetër i bankës, i cili përbëhej nga: 3 sindakë efektiv dhe 2 zëvendës. Në këtë mënyrë banka përfaqësohej para gjyqit përmes kryetarit të saj. Banka do të ekzistonte për 50 vjet, por afati i saj mund të zgjatej 1 ose më shumë herë me vendim të kuvendit të përgjithshëm të aksionistëve me shumicë votash (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 87).

Në artikullin e 4-ërt thuhej se kapitali i Bankës ishte 12.500.000 franga ari dhe ishte i ndarë në 495.000 aksione ordinare me vleftë emnore 25 fr.ari secili dhe në 100.000 aksione themeluese me vleftë emnore 1.25 fr.ari secili. Këshilli i Administratës caktonte me autorizim të Kuvendit të përgjithshëm të aksionistëve, çmimin, formalitetet e emisionit etj., (Fishta, Kareco 1996, 210).

Në artikujt 12, 13, 14 dhe 15 deklarohet se çdo aksion ishte i pandashëm dhe se banka njihte vetëm 1 pronar për çdo aksion edhe në rast trashëgimie. Çdo aksion kishte të drejtën e votës. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis aksionistëve

e bankës, administratorëve, sindikatave, etj kompetenti ishte trupi gjykues i Këshillit të Administratës (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 88). Banka kishte të drejtë të nxirrte kartëmonedha. Ajo do të kishte një kurs ligjor dhe fuqi të patundshme për pagesat në Shqipëri dhe do të kryente çdo lloj operacioni financiar dhe bankar. Banka mund t'i jepte privatëve, shoqërive dhe enteve të ndryshme publike, paradhënie me afate të shkurtra. Gjithashtu ajo mund të bënte blerje dhe shitje të arit dhe argjendit, në shufra e në monedha dhe të jepte paradhënie mbi metale të çmueshme. Kjo bankë mund të merrte në depozitë fondet e shtetit dhe shërbimin e thesarit dhe mund të blinte aksionet e veta, vetëm nëse blerja ishte e autorizuar nga Kuvendi i Përgjithshëm (Fishta, Kareco 1996, 210).

Në artikullin 39, 40, 41, 42 dhe 43 deklarohet se Kuvendi i Përgjithshëm vendoste mbi interesat e bankës dhe mund të ndryshonte statutin. Administratori para se të merrte postin duhet të jepte garanci duke depozituar në 1 bankë të caktuar të paktën 1% të aksioneve të Bankës Kombëtare (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 93).

Drejtoria Qendrore e Bankës në Shqipëri kujdesej për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administratës e të Komitetit të Administratës. Ajo përbëhej nga 4 vetë: 2 ishin shqiptarë dhe 2 italianë, të cilët emëroheshin nga Komiteti i Administratës. 1 nga italianët do të merrte Kryesinë e Drejtorisë. Derisa banka të kishte zhvillimin e mjaftueshëm, ajo do të kishte 2 drejtues: 1 shqiptar dhe 1 italian (Fishta, Kareco 1996, 210).

Në lidhje me buxhetin e bankës, thuhej se ky buxhet duhej të paraqiste fitimet dhe humbjet e saj. Shteti shqiptar kishte të drejtë të merrte 10% të fitimit neto çdo vit. Në të vërtetë kjo përqindje nuk u mor sepse banka e fshihte në bilancet e saj sasinë e vërtetë të këtij fitimi.

Në nenin 2 të konventës thuhej se shtetasit shqiptarë kishin të drejtë të zotëronin 49% të aksioneve. Pra, që në fillim shqiptarët nuk mund të ishin aksionistët kryesorë në krijimin e bankës dhe kapitalet e huaja do të sundonin në të. Por, edhe këtë shifër shqiptarët nuk mund ta zotëronin sepse atyre nuk iu dha e drejta për të pasur aksione në bankë. Caktimi i afatit të derdhjes së pjesës së të hollave që u takonte shqiptarëve u shty disa herë deri më 15 gusht, kurse në të vërtetë afati i nënshkrimit mbaronte më 5 maj.

Në këtë kohë thuhej se Myfit Libohova kishte nënshkruar 1 nga aktet kryesore të themelimit të bankës që quhej "Accordo esecutivo" Nr.13 (Akordi Ekzekutiv Nr.13) që rregullonte aksionet që shqiptarët do kishin në bankë. Ai

caktonte dhe mënyrën e derdhjes së aksioneve në pjesë dhe afatin e nënshkrimit. Brenda datës 5 maj duhej të derdhej 2 % e vlerës së aksioneve që u takonin shqiptarëve, për t'u regjistruar si aksionistë. Akti nuk u botua në Fletoren Zyrtare dhe shqiptarët nuk e dinin kur mbaronte afati (Belegu 1964, 36). Flitej se Myfit Libohova e mbajti të fshehtë datën e mbarimit të afatit, fshehu aktin e mësipërm dhe e shtyu afatin disa herë. Kështu, meqenëse shqiptarët nuk kishin derdhur 2% të vlerës së aksioneve, aksionet e tyre quheshin të rëna. Aksionet e tyre u blenë nga grupet financiare italiane dhe sa për sy e faqe vetëm në vitin 1925 figuronin disa bejlerë çifligarë si aksionerë shqiptarë. Pas vitit 1925 ata u zhdukën fare dhe mbetën vetëm aksionerët e huaj, sidomos italianë. Përveç, italianëve kishte edhe aksionerë nga Jugosllavia, Zvicra dhe Belgjika, por ata kishin një % të vogël aksionesh në krahasim me Italinë. Megjithatë, Italia bindi edhe disa banka të huaja që të nënshkruanin në aksionet e bankës për llogari të grupit financiar italian. Si rrjedhim i dredhive që përdori, grupi financiar italian arriti të kishte në zotërim rreth 90 % të kapitalit aksioner të bankës (Fisher 2004, 102).

Lidhja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë me kapitalin financiar italian dhe me shtetin italian vërehet në tre drejtime kryesore:

- Në formimin e kapitalit shoqëror;
- Në përbërjen e Këshillit Administrativ;
- Në të gjithë veprimtarinë e saj ndërhyrëse në Shqipëri;

Grupet financiare italiane zotëronin gjithsej 404.116 aksione. Për të marrë një vendim të caktuar duhej të përfaqësohej $\frac{1}{4}$ e kapitalit të shoqërisë, që nënkupton se aksionet që kishin italianët ishin më se të mjaftueshme për të marrë çdo lloj vendimi. Mund të themi se, banka e emisionit të Shqipërisë nuk ishte një Bankë Kombëtare, megjithëse quhej e tillë, por ishte vetëm një degë e bankave italiane në Shqipëri, një degë e "Credito Italiano". Banka "Credito Italiano" përfaqësoonte një nga bankat më të mëdha të Italisë, që së bashku me "Banca Commerciale Italiana", "Banco di Roma" dhe industrinë e tjera, hodhën bazat e kapitalit financiar italian pas Luftës së Parë Botërore, të atij kapitali që në vitin 1922 solli në fuqi fashizmin (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 50-51). Presidenti i "Credito Italiano", Mario Alberti, ishte një personalitet politik i Italisë fashiste. Ai kishte përfaqësuar për një periudhë kohe shtetin italian në Lidhjen e Kombeve. Që përpara se të bëhej inaugurimi i Bankës në shtator të vitit 1925, grupi financiar italian kishte marrë në zotërim 90 % të kapitalit aksioner, nga i cili 45% drejtpërdrejtë, 30 %

përmes nënshkrimeve fiktive nga shtetas shqiptarë, prapa të cilëve fshihej kapitali italian, dhe 15 % të tjera përmes nënshkrimeve fiktive nga banka të huaja, prapa të cilave shtrihej përsëri kapitali italian (Ekonomia Popullore 1965, 78).

Në vitin 1925 me anë të Bankës Kombëtare të Shqipërisë u arrit për herë të parë rregullimi me ligj i qarkullimit monetar si një sistem unik. Metali valutor (metali i çmueshëm, i cili luan rolin e ekuivalentit të përgjithshëm) i sistemit monetar që u vendos në Shqipëri ishte ari. Këtë e dëshmon edhe ligji "Mbi rregullimin monetar" i datës 12 korrik 1925. Në Shqipëri politika monetare e ndjekur, i shërbeu interesave të Italisë. Kjo politikë në lëmin e qarkullimit monetar kishte si qëllim:

- Të pengonte zhvillimin e ekonomisë së Shqipërisë, me qëllim që të shtohet vartësia e saj ekonomike dhe politike.
- Të grumbullonte rezervat e metaleve të çmueshme (ar dhe argjend) në Shqipëri për nevojat e financimit të luftërave ekspansioniste të Italisë në Ballkan.
- Të krijonte kushtet e favorshme për eksportimet italiane në Shqipëri.
- Të kufizonte zhvillimin e tregut të brendshëm dhe të favorizonte shkëmbimin joekuivalent si një nga mjetet e shfrytëzimit kolonial.

Politika e deflacionit në lëmin e monedhës dhe politika e restriksionit në lëmin e kreditit, kanë qenë 2 hallka të së njëjtës politikë, të politikës koloniale që ka zbatuar ndaj vendit tonë Banka Kombëtare e Shqipërisë. Si rezultat i kësaj, arin dhe argjendin do ta blejnë shoqëri dhe ndërmarrje italiane në treg me çmim spekulativ. Politikën e restriksionit banka e zbatoi përmes 2 metodave: me anë të mbajtjes së %-ve të interesit bankar në një nivel të lartë dhe përmes kufizimit ose shkurtimeve të drejtpërdrejtë të madhësisë së kreditit (Haxhi 1964, 57-58).

Banka Kombëtare filloi të priste edhe monedha, por meqenëse Shqipëria nuk kishte dije rreth mënyrës së prodhimit të monedhave, specialistët italianë hodhën në qarkullim një monedhë 20 frangëshe që mbante në njërin anë kokën e Skënderbeut dhe në anën tjetër luanin e Shën Markut. Kjo monedhë u tërhoq nga qarkullimi vetëm pas protestave të forta të palës shqiptare (Arkivi Qendror i Shtetit 1926, 2).

Në lidhje me qarkullimin monetar mund të themi se grupi financiar italian i bankës mbajti një qarkullim monetar më të ulët nga nevojat e vendit dhe provokoi "urinë" monetare. Ai rriti artificialisht vlerën e bankënotave në krahasim me arin, duke shkaktuar një deflacion në ekonominë e Shqipërisë. Gjithashtu, ky grup ushtroi presion për uljen e

çmimeve me shumicë dhe me pakicë në tregun shqiptar në nivelin normal që duhej të ishte (Roselli 1988, 157). Në përgjithësi kreditë e dhëna nga banka, janë përdorur për qëllime joproduuese. Të vetmen formë kredie që ajo ka përdorur, ka qenë kredia me afat të shkurtër. Në këtë kohë u hartua edhe një ligj mbi rregulloren e monedhës së Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Disa nga artikujt kryesorë të saj janë:

Art. 1: Monedha ligjore e shtetit shqiptar është franga ari.

Art. 2: Banka Kombëtare ka të drejtë të presë monedha të tilla (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 93).

Art. 7: Arka e Shtetit dhe Banka Kombëtare e Shqipërisë mund të pranojnë monedha argjendi në masë të pakufizuar. Monedhat prej nikeli dhe tunxhi përdoren në pagesa vetëm në atë sasi sa të jetë nevoja e përmbushjes së pjesëve të frangut.

Art.8: Monedhat e prishura, në të cilat nuk duket shkrimi në të dy anët ose vetëm në një anë, nuk mund të përdoren (Haxhi 1964, 175).

Art.10: Dënohet me burg 3-12-vjet ai person që bën monedha të ngjashme me ato të shtetit shqiptar.

Art.13: Çdo person që bën vegla për përgatitjen ose ndryshimin e monedhave dënohet me 1-5 vjet burg.

Veprimtaria e shtetit italian në procesin e themelimit të bankës zbulon kryesisht synimin e tij për të zotëruar këtë bankë dhe më gjerë financat dhe ekonominë shqiptare. Kjo mbështetet te disa arsye, të cilat janë:

a) Pala shqiptare kishte një % të vogël aksionesh, duke mos i dhënë asaj rëndësinë e duhur.

b) Konventa kishte një afat 50-vjeçar, i cili ishte i gjatë dhe për më tepër mund të zgjatej akoma.

c)Banka mund të priste monedha, në: ar, argjend, nikel dhe tunxh. Aksionistëve të bankës, u jepej e drejta të përfitonin 50% të të ardhurave që do të rezultonin nga kjo veprimtari. Ndarja e fitimeve në përpjestim të barabartë me shtetin shqiptar ishte një padrejtësi e madhe (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 4).

d) Sipas marrëveshjes, qendra e bankës do të ishte në Tiranë. Në të vërtetë, as kur u themelua, as edhe më vonë, qendra e saj nuk ishte në Shqipëri. Komiteti i bankës që në fillim u vendos në Romë, ndërsa një qendër e vogël e saj ishte në Durrës (jo në Tiranë) me qëllim që të komunikohesh më shpejt me Legatën italiane, që e kishte selinë në këtë qytet (Probleme Ekonomike 1975, 94). Drejtori i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Durrës ishte

Giulio Gaudenzi. Shumë kohë më vonë, Drejtorja Qendrore e Bankës u shpërngul nga Durrësi në Tiranë, ashtu sikurse bëri edhe Legata italiane (Arkivi Qendror i Shtetit 1925, 5).

Disa nga monedhat dhe kartëmonedhat që u përdorën në këtë kohë ishin:



Figura 1. Kartëmonedha me vlerë 1 franga ari



Figura 2. Kartëmonedha me vlerë 100 franga ari



Figura 3. 2 anët e monedhës me vlerë 20 franga ari



Figura 4. 2 anët e monedhës me vlerë 100 franga ari

PËRFUNDIMET

Mund të themi se veprimtaria e Bankës Kombëtare Shqiptare ishte pak zhgënjyese për shtetin shqiptar sepse

prej saj pritej shumë më tepër nga ajo që u realizua. Kjo sepse ajo u dha kredi kryesisht shoqërive kapitaliste italiane. Kapitalit shqiptar, sidomos atij industrial, i dha fare pak kredi ndërsa pronarëve shqiptarë në fushën e bujqësisë nuk u dha pothuajse asnjë kredi duke penguar në këtë mënyrë zhvillimin

ekonomik të prodhuesve vendas. Gjithsesi, nuk kishte se si të ndodhte ndryshe kur Bankën Kombëtare Shqiptare e drejtonte shteti italian.

Megjithatë, është e rëndësishme të themi se krijimi i Bankës Kombëtare Shqiptare ishte një hap shumë i rëndësishëm i ndërmarrë prej presidentit shqiptar, Ahmet Zogut. Nëse nuk do të krijohej kjo bankë bërja e politikës monetare do të

ishte një detyrë shumë e vështirë, sidomos për një shtet të ri dhe pa eksperiencë në këtë fushë si Shqipëria. Kjo do të ndikonte negativisht jo vetëm në fushën ekonomike por do të cenonte edhe qëndrueshmërinë politike të shtetit shqiptar, i cili reflektonte probleme të shumta në këtë kohë.

BIBLIOGRAFI

I. BURIME ARKIVORE

AQSH, Fondi nr.115, Dosja 23, v. 1926.

AQSH, Fondi nr.146, Dosja 82, v. 1925.

AQSH, Fondi nr.113, Dosja 25, v. 1925.

AQSH, Fondi nr.123, Dosja 85, v.1926.

II. GAZETA DHE REVISTA

Ekonomia Popullore, 1965, nr.6, Tiranë: 78.

Probleme Ekonomike, 1975, Tiranë: 84, 88, 94, 106-107.

III. LITERATURA HISTORIOGRAFIKE

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2007, *Historia e popullit shqiptar vëll.III*, Tiranë: TOENA.

Belegu. Mentar, 1964, *Studime Historike*, "Politika zogiste e dyerve të hapura në v.1925-1926", Tiranë: Mihal Duri.

Carocci. Giampiero, 1969, *La politica esterna dell'Italia fascista 1925-1928*, Bari: Laterza editore.

Cici. Arben, 2002, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934*, Tiranë: Afërdita.

Duka. Valentina, 2007, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: SHBLU.

Fisher. Bernd J, 2004, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej.

Fishta. Iljaz, 1979, *Ndërrhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruese për Shqipërinë (1925-1931)*, Tiranë: Mihal Duri.

Fishta. Iljaz, Kareco. Theodor, 1996, *Prona private në Shqipëri 1924-1944*, Tiranë: Dituria.

Haxhi. Aleko, 1964, *Studime Historike*, "Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe politika e saj antikombëtare gjatë sundimit të Zogut", Tiranë. Mihal Duri.

Milo. Paskal, 1992, *Shqipëria dhe Jugosllavia (1918-1927)*, Tiranë: Tirana.

Roselli. Alessandro, 1988, *Studime Historike*, Nr.2, "Italia e Albania: Relazioni finanziarie nell ventennio fascista", Tiranë: Mihal Duri.

Saraçi. Çatin, 2006, *Zogu i Shqiptarëve*, Tiranë: 55.

Smirnova. Nina, 2004, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX*, Tiranë: IDEART.

Swire. Joseph, 2005, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: DITURIA.

RRETH LEGJISLACIONIT PENAL PER MBROJTJEN E ZGJEDHJEVE TE LIRA

ENGJËLL LIKMETA

DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PENALE

FAKULTETI I DREJTËSISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

KATRIN TRESKA

DREJTORIA E HARTIMIT DHE ANALIZËS SË LEGJISLACIONIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT

MINISTRIA E DREJTËSISË

Përmbledhje

Veprat penale kundër zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik të tyre janë një fenomen sa shqetësues aq edhe problematik për shoqërinë shqiptare në tranzicion. Në kuadër të luftimit të veprave penale në fushën elektorale, me qëllim parandalimin e tyre, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar njohjes së kornizës ligjore kombëtare dhe në veçanti asaj penale në këtë fushë. Qëllimi i këtij punimi është që të japë një tablo të përgjithshme të kuptimit të veprave penale me natyrë elektorale, llojeve të tyre, si dhe trajtimit të tyre në normat juridiko- penale kombëtare. Gjithashtu, në punim trajtohen dhe parimet e sanksionuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e procesit zgjedhor si dhe rëndësia e tyre.

Fjalët çelës: *vepër penale, zgjedhje, parim, mbrojtje.*

Abstract

Crimes against free elections and a democratic system are a disturbing phenomenon as well as a problem of the Albanian society in transition. In the context of combating electoral crimes in order to prevent them, special attention should be paid to the recognition of the national legal framework and in particular to the penal norms in this field. The purpose of this paper is to give an overall picture of the meaning of electoral crimes, as well as their treatment by the legal framework. In this paper there are also treated the principles embodied by the legislation for the protection of the electoral process and their importance.

Key words: Crimes, elections, principle, protection

HYRJE

Historia e së drejtës së votës tregon për një proces të ngadaltë përparimi dhe të ndarë në faza të çrregullta. Progresi sa i takon të drejtë së votës, u arrit me vështirësi. Kjo e drejtë e fituar duhet mbrojtur, ndërsa vizioni i një shoqërie më demokratike duhet të vazhdojë të frymëzojë shpresat dhe veprimet tona (Myers, 2002:30).

Zgjedhjet janë mjeti me anën e të cilit realizohet qeverisja përfaqësuese parlamentare dhe ajo vendore (Berhani, 2006:7). Zgjedhjet janë një mjet për drejtimin e shtetit. Në këtë kuadër, ato janë një fakt juridik me rëndësi të posaçme për qeverisjen (Berhani, 2006:8). Zgjedhjet e lira, të përgjithshme, të fshehta dhe të barabarta, sigurojnë një qeverisje përfaqësuese e cila garanton ushtrimin e sovranitetit të shtetasve (Berhani, 2006:8).

Parashikimi kushtetues dhe ligjor i normave të së drejtës për të votuar dhe për t'u zgjedhur në organet përfaqësuese është vetëm kushti formal juridik. Realizimi i së drejtës së zgjedhjes është një proces i ndërlikuar që parakupton një përcaktim të detajuar juridik të rregullave të zgjedhjeve për shtetasit dhe krijimin e infrastrukturës së duhur që

shërben për të mundësuar të drejtën efektive të zgjedhjeve në një shtet (Berhani, 2006:9).

1. Kuptimi dhe parimet e procesit zgjedhor

Zgjedhjet "mekanikisht" realizojnë delegimin e pushtetit nga populli (zgjedhësit) të përfaqësuesit e tij (anëtarë të parlamentit etj). Në fakt, në zgjedhje populli delegon sovranitetin te këta përfaqësues. Këta të fundit, të grupuar formojnë institucionin që është mbajtës i sovranitetit të popullit. Ky sovranitet shtrohet ose materializohet, të themi, nëpërmjet akteve juridike që ky institucion miraton. Ky delegim është i përkohshëm (çmohet sa është përkohshmëria) dhe, në periudha të caktuar, populli (zgjedhësi) ka të drejtën dhe mundësinë që të reflektojë nëpërmjet votimit për përfaqësuesit e tij (Celibashi, 2002:30).

E drejta e zgjedhjeve nënkupton në përmbajtjen e saj sistemin e normave të së drejtës që përcaktojnë dhe rregullojnë zgjedhjet. Njëherazi, ajo nënkupton të drejtën subjektive të çdo personi për të votuar për zgjedhjen e përfaqësuesve dhe për t'u zgjedhur në organet e zgjedhshme të shtetit (Berhani, 2006:11).

Në Shqipëri, e drejta e zgjedhjeve është ngritur në kuadrin e një të drejtë kushtetuese. Ajo,

në thelb, është një e drejtë individuale që sigurohet dhe garantohet vetëm nëpërmjet lirisë politike, që është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme (Rosen & Wolff:113). E drejta e zgjedhjeve është parashikuar si një e drejtë politike në nivelin e rregullimeve ligjore të përcaktuara nga standardet ndërkombëtare (Berhani, 2006:99).

Parimet kryesore të zgjedhjeve janë (Konrad-Adenauer-Stiftung, 2011: 19): parimi i zgjedhjeve periodike, parimi i zgjedhjeve të lira dhe të fshehta, parimi i personalitetit të votës (Berhani, 2006:19 - 65), parimi i zgjedhjeve të barabarta dhe të drejtpërdrejta (Zaganjori, 2002:33). Ndërsa, si nënparime të tyre, janë (Bogdani, 2011:27 - 36): -administrimi i zgjedhjeve në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale; administrimi i zgjedhjeve bazuar në barazinë e subjekteve zgjedhore dhe në krijimin e të gjitha kushteve optimale të barazisë; -krijimi i balancave gjinore dhe respektimi i tyre në përzgjedhjen e kandidatëve si dhe në autoritetet që administrojnë zgjedhjet në të gjitha nivelet; -elementi publik i procesit zgjedhor, informimi i publikut dhe transparenca e tij në të gjitha hallkat e procesit; -garantimi i mjeteve ankimore efektive në zgjidhjen e konflikteve zgjedhore; -monitorimi i vazhdueshëm dhe profesional i procesit në të gjitha hallkat e tij, etj.

2. Zhvillimi historik i sistemit të zgjedhjeve në vendin tonë

Sistemi juridik që rregullon zgjedhjet dhe të drejtën e zgjedhjeve në vendin tonë është prodhim i zhvillimit të shtetit dhe të së drejtës (Berhani, 2006:98).

Procesi zgjedhor ka kaluar në disa faza të rëndësishme. Ato janë (Berhani, 2006:98):

Etapa e parë, nga viti 1912 – 1939;

Etapa e dytë, nga viti 1945 – 1990;

Etapa e tretë, nga viti 1990 – 2015 (në vazhdim).

Zgjedhjet e vitit 1921 ishin zgjedhjet e para parlamentare që zhvilloheshin në Shqipërinë e pavarur (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007:177). Këto zgjedhje do të shënonin një hap në rrugën e ndërtimit të një shteti me institucione të zgjedhura (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007:177). Gjatë zgjedhjeve të para të zhvilluara në vendin tonë ishte karakteristikë fakti se mungonte një program elektorale që t'u përgjigjej kërkesave të popullit për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe shoqërore (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007:216). Një veçanti e tillë ishte shprehur dhe nga shtypi i kohës. Kështu, gazeta "Drita" e Gjirokastrës shkruante: "Në kohën e zgjedhjeve u formuan turli grupesh, me turli programesh dhe midis kësaj

anarkie elektorale nuk ishte e mundur të kuptonte njeriu se ku do të jepte votën, nuk dinte se me cilën parti ishte duke marrë pjesë" (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007:216). Gjithashtu, forma dhe procedura e votimit ishte një tjetër veçanti për kohën (Likmeta, 2012: 7). Kështu, votimi ishte i fshehtë dhe kryhej me shkrim, me anë të biletave (Anastasi, 1998:147).

Asambleja Kushtetuese e dalë nga zgjedhjet e gushtit të vitit 1928 institucionalizoi me vendimin e saj Mbretërinë Shqiptare me Ahmet Zogun si mbret me emrin Zog I (Dervishi, 2006: 277). Po ashtu, ligji për zgjedhjen e Dhomës së Deputetëve përbënte, pa dyshim, një përpjekje për përafrimin e legjislacionit zgjedhor shqiptar me atë perëndimor (Anastasi, 1998:147).

Pas Luftës së Dytë Botërore, në dhjetor të vitit 1945, u zhvilluan zgjedhjet për Asambleenë Kushtetuese që kishte për detyrë të përcaktonte formën e regjimit të shtetit shqiptar dhe kushtetutën e vendit (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007:175).

3. Rëndësia e mbrojtjes së sistemit zgjedhor

Mbrojtja e sistemit zgjedhor nga normat juridiko - penale ka një rëndësi të madhe. Kjo pasi, zgjedhjet janë të shenjta për demokracinë. Organizmi dhe zhvillimi i zgjedhjeve të rregullta dhe të lira është një moment i rëndësishëm për ndërtimin dhe ligjërimin e pushtetit politik. Vetëm përmes një procesi zgjedhor transparent, publik dhe të rregullt bëhet e mundur të përcillet drejtpërsëdrejti vullneti politik i popullit në pushtetin shtetëror (Zaganjori, 2002:29). Në këtë kuptim, zgjedhjet e lira dhe sistemi demokratik i tyre mbart një rëndësi të veçantë. E thënë kjo, ato i japin mundësi trupës elektorale të ushtrojë sovranitetin dhe të bëhet pjesëmarrëse në politikën shtetërore, përmes procesit të zgjedhjes së organeve përfaqësuese të shtetit (Berhani, 2006:9).

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë thelbësore në sigurimin e pëlqimit të të qeverisurve, çka përbën themelin e politikës demokratike. Zgjedhjet shërbejnë si mekanizëm kryesor për përkthimin e këtij pëlqimi në autoritet qeverisës (Cincotta & Zjednoczone, 1991:12).

4. Mekanizmat ligjorë në luftën kundër krimeve elektorale

Burimet kryesore që shërbejnë në luftën kundër veprave penale në fushën e zgjedhjeve janë: mekanizmat ligjorë kombëtarë dhe ato ndërkombëtarë.

Në mjetet ligjore kombëtare si më kryesorët mund të përmendim: Kushtetutën e vendit, Kodin Penal dhe atë Zgjedhor, ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve

dhe të disa nëpunësve publikë, ligjin për të drejtën e informimit, marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe institucioneve të ndryshme si midis KQZ – së dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive etj.

Gjatë monitorimeve të zgjedhjeve, në jo pak rasteve, vihet re se ka një lidhje mes financimit të subjekteve zgjedhore dhe korrupsionit. Financimet e subjekteve zgjedhore dhe përfitimet e padrejta, abuzive dhe korrupsioni (Bogdani, 2011: 128) konsiderohen si shkak për cenimin e demokracisë. Publiku duhet të jetë në dijeni se nga i gjejnë politikanët të ardhurat, në mënyrë që të vlerësojnë se çfarë lloj votash fitojnë ata dhe nga cilat grupe të interesave mbështeten (Public Affairs Office, 2000: 13). Vetëm kështu, do të mund të vlerësohet edhe puna e të zgjedhurve pas marrjes së mandatit, si dhe objektiviteti në ushtrimin e detyrave të marra, pa mbrojtur interesat e asnjë grupi në mënyrë të njëanshme, për shkak të financimeve të fushatave elektorale.

Një ndër mjetet ligjore që ndihmon në parandalimin e praktikave korruptive në procesin zgjedhor është edhe Rekomandimi 2003/4 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe të fushatave elektorale". Rekomandimi përcakton dhe vendos rregulla dhe kritere lidhur me mënyrën e financimit të partive politike dhe fushatave elektorale në mënyrë që procesi zgjedhor të jetë publik, transparent, i drejtë dhe i kontrollueshëm nga mekanizmat ligjorë, me qëllim luftën ndaj korrupsionit si një kërcënim real dhe serioz për demokracinë dhe shtetin e së drejtës (Bogdani, 2011:134). Po ashtu, rekomandimi i njeh të drejtën e partive politike të marrin financime si nga shteti edhe nga subjektet private (Bogdani, 2011:134).

5. Vështrimi historik i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve

Në Kodin Penal të Mbretit Zog, veprat penale kundër zgjedhjeve përcaktoheshin në kaptinën e dhjetë: "Mbi fajet elektorale". Në këtë pjesë të Kodit Penal përfshiheshin krime, të tilla si: regjistrimi në listat elektorale nga personat kompetentë me faj, hedhja në arkë e më shumë se një vote, rrëmbimi i arkës së votimit, votimi me emra të remë, etj. Dënimet për veprat kundër zgjedhjeve ishin: dënimi me gjobë dhe me burgim (Anastasi, 1998:147). Kodi Penal i Mbretërisë shqiptare, në nenin 154 të tij, parashikonte deliktet kundër lirisë politike. Norma penale shprehej se: "Kushdo që me violencë, frikësim ose me potere, ndalon tanësisht ose pjesërisht, ushtrimin e çdo lloj së drejtës publike,

ndëshkohet, kur faji nuk asht parapa me dispozita të posaçme prej ligjës, me burgim nga një deri në tridhjetë muej dhe me gjobë të rëndë nga njëqind deri në njëmijë franga ari. Në qoftë se fajtori asht nëpunës i shtetit dhe ka ba deliktin tue abuzue nëpunësin, burgimi asht deri në pesë vjet" (Kodi Penal,1929: 154).

Një veçanti e Kodit Penal të vitit 1952 dhe 1977 ishte fakti se si dënim plotësues parashikohej edhe humbja e së drejtës elektorale. Norma penale përcaktonte se: "me humbjen elektorale i dënuari humbet të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në Kuvendin Popullor, në Këshillat Popullore si dhe në gjykatat" (Kodi Penal, 1952:27- 28). Gjykata krahas funksionit për dhënien e drejtësisë kishte për qëllim edhe vendosjen e së drejtës elektorale kur për të dënuarin jepej një vendim me burgim ose internim për më shumë se dy vite. Kohëzgjatja e humbjes së të drejtës elektorale ishte nga një deri në pesë vite (Kodi Penal, 1952:28).

Kodi Penal i vitit 1977 në dallim nga ai i 1952, përcaktonte se: "[...] Heqja e së drejtës së zgjedhjes jepet vetëm për kryerjen e një krimi [...]" (Kodi Penal, 1977: 25).

Kodi Penal i vitit 1952 parashikonte në kapitullin e nëntë të tij krimet ndaj së drejtës elektorale. Në këtë kod parashikoheshin gjashtë kundërvajtje penale dhe një krim kundër zgjedhjeve dhe të drejtës për t'u zgjedhur.

Dënimet kryesore kundër autorëve të tyre ishin me: burgim, gjobë, punë korrektonjëse, si dhe qortim shoqëror (Kodi Penal, 1952: 218 - 224).

Format kryesore me anë të së cilës kryhej ndalimi i së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet shtetërore në pikëpamje të anës objektive ishin: me anë të shpërblimit, kanosjes, mashtrimit si dhe ushtrimit të dhunës. Falsifikimi i dokumentacionit electoral përbënte të vetmin krim electoral. Ai realizohej vetëm nga subjektet e posaçme që mund të ishin: personi i këshillit popullor dhe anëtar i komisionit të zgjedhjeve (Kodi Penal, 1952: 218 - 219). Këta të fundit, parashikoheshin nga Kodi si subjekte të veçantë që mund të cenonin edhe fshehtësinë e votimit (Kodi Penal, 1952: 223).

Kundërvajtjet penale të vënies, mosvënies apo përjashtimit pa të drejtë në listën e zgjedhjeve kryheshin vetëm me dashje të drejtpërdrejtë në pikëpamje të anës subjektive. Po ashtu, dënohej edhe votimi më tepër se një herë apo votimi nga ana e personave që nuk e gëzonin këtë të drejtë (Kodi Penal, 1952: 221 - 222). Njëkohësisht, normat penale siguronin edhe respektimin e kohës së caktuar për zhvillimin normal të procesit zgjedhor. Kështu, shkurtimi apo zgjatja e kohës së votimit nga

subjektet e caktuar me ligj përbënte kundërvajtje penale dhe dënohej me punë korrektonjëse. Fryma e kësaj norme ishte moszvarritja e procesit zgjedhor si dhe zhvillimi sa më i përpiktë i tij.

Kodi Penal i vitit 1977 parashikonte vetëm dy kundërvajtje penale lidhur me të drejtën e zgjedhjeve dhe asnjë krim elektoral. Ato ishin: ndalimi i ushtrimit të drejtës së zgjedhjes dhe falsifikimi i dokumenteve të zgjedhjeve.

Dënimet kryesore që zbatoheshin kundër fajtorëve ishin: qortimi shoqëror, riedukimi nëpërmjet punës si dhe heqja e lirisë.

Kundërvajtja penale e ndalimit të ushtrimit të drejtës së zgjedhjeve realizohej në pikëpamje të anës objektive me anë të vënies apo përjashtimit të zgjedhësve në listën e votimit pa të drejtë, shkeljes së fshehtësisë së votimit, si dhe nëpërmjet ndalimit të shtetasve që të ushtronin lirisht të drejtën të zgjidhin e të zgjidheshin në organet shtetërore (Kodi penal, 1977:200). Kundërvajtja penale e falsifikimit të dokumenteve të zgjedhjeve realizohej vetëm nga subjekti i posaçëm, personit që ishte i ngarkuar nga ligji për organizimin e zgjedhjeve (Kodi penal, 1977:201).

Veprat penale që prekin zgjedhjet dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve janë parashikuar në kreun e dhjetë të Kodit Penal të vitit 1995. Këto vepra penale ndahen në krime dhe kundërvajtje penale. Krimet elektorale përfshijnë tetë figura të veprave penale. Ato janë: pengimi i subjekteve për zgjedhjet në organet përfaqësuese, falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve, dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor, votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar, kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje, pengimi i zgjedhësit për të votuar, braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, shkelja e së drejtës së zgjedhjes. Ndërsa, në kundërvajtjet elektorale përfshihen: shkelja e fshehtësisë së votimit, dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve, detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike, kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrjes në zgjedhje, pengimi i zgjedhësit, braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, si dhe shpërdorimi i autoritetit ushtarak.

6. Vështrim analitik i veprave penale bashkëkohore që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të tyre

Krimet në fushën e zgjedhjeve janë akte të qëllimshme apo të paramenduara, të ndaluara nga shteti apo ligji penal, me qëllim shkaktimin e mospjesëmarrjes në procesin zgjedhor. Si të tilla, mund të përmendim përjashtimin nga procesi zgjedhor; votat e papërshtatshme për t'u numëruar në zgjedhje; mosnumërimin e votave të rregullta, si

dhe ndërhyrjet e tjera që ndikojnë në pavlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve (U.S. Election Assistance Commission, 2006:13).

Krimet e zgjedhjeve, në përgjithësi, përfshihen në një nga këto katër kategori: aktet e mashtrimit, aktet e detyrimit, aktet e dëmtimit apo shkatërrimit, si dhe dështimet ose refuzimet për të vepruar (U.S. Election Assistance Commission, 2006:13).

Terminologjia e tanishme ka një shumëllojshmëri të tillë të aplikacioneve dhe kuptimit të termave "mashtim në votim" dhe "votues i frikësuar", të cilat mund të përfshijnë pothuajse çdo veprim apo mosveprim kriminal lidhur me procesin zgjedhor. Sjelljet kriminale përcaktohen si të gatshme përmes normave juridiko penale dhe ndiqen nga organet ligjzbatuese (U.S. Election Assistance Commission, 2006: 12). Në këtë vështrim, normat juridiko - penale marrin në mbrojtje ushtrimin e rregullt të veprimtarive dhe aktiviteteve të ndryshme të subjekteve zgjedhore.

Në nenin 325 të Kodit Penal shqiptar mbrohet pikërisht e drejta e subjekteve zgjedhore për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore.


Në pikëpamje të anës objektive, e rëndësishme për efekt të cilësimit juridik të veprës penale në fjalë, është mënyra e kryerjes së saj. Këto mënyra janë: pengimi me anë të kanosjes apo me dhunë i subjekteve elektorale për të zhvilluar lirisht në përputhje me legjislacionin në fuqi fushatën zgjedhore, ose në çdo mënyrë tjetër. Thelbësore është edhe elementi tjetër i anës objektive, koha e kryerjes së veprimit kriminal. Kjo nënkupton faktin se për t'u ndodhur përpara veprës së pengimit të subjekteve zgjedhore për të ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese të zgjedhjeve në organet përfaqësuese duhet që veprimi/mosveprimi kriminal të ndodhë vetëm gjatë fushatës së zgjedhjeve. Fajtori mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Ndaj tij, mund të zbatohet dënimi me burgim. Kjo masë dënimi është parashikuar për të gjitha llojet e veprave penale kundër zgjedhjeve dhe sistemit demokratik të tyre.

Duhet theksuar se për të gjitha veprat penale të parashikuara në kreun e dhjetë të kodit penal bashkëkohor parashikohej si dënim kryesor edhe dënimi me gjobë krahas atij me burgim. Me ligjin nr. 144/2013 dënimi me gjobë është shfuqizuar pothuajse në të gjitha dispozitat e kreut në fjalë. Këtu, ka një përjashtim, që është ende i sanksionuar në nenin 332 të Kodit Penal.

Nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se, gjatë viteve 2007 - 2013 janë regjistruar 40 procedime penale për veprën

penale të parashikuar nga neni 325 i Kodit Penal “Pengimi i subjekteve zgjedhore në organet përfaqësuese” (Prokuroria e Përgjithshme, 2010: 209)

Tabela Nr. 1



Vepra penale e parashikuar nga neni 325 i Kodit Penal ka zënë dhe peshën më të madhe në vëllimin e veprave penale kundër zgjedhjeve dhe sistemit demokratik të tyre duke arritur të përbëjë deri në 50% të procedimeve penale për këtë grup veprash penale për vitin 2013 (Prokuroria e Përgjithshme, 2013: 183).


Në figurën e krimit të falsifikimit të materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve të parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal paraqesin rëndësi elementët e anës objektive, mënyra e kryerjes së veprës, vendi i realizimit të saj, si dhe elementët e anës subjektive. Kështu, sipas ligjvënësit, mënyrat e kryerjes së këtij krimi janë: falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, paraqitja në dokumentet dhe materialet zgjedhore të të dhënave, rrethanave, shifrave që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i dokumenteve të saktave me të rreme, si dhe nëpërmjet futjes në kutitë e votimit të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme. Subjekti i kësaj vepre penale është i përgjithshëm në paragrafin e parë të nenit 326 të Kodit Penal. Kur subjekt i këtij krimi janë personat e ngarkuar me administrimin e procesit zgjedhor, masa e dënimit për fajtorët është e sanksionuar nga tre deri në shtatë vjet burgim. Fajtori dënohet të njëjtën masë dënimi edhe në rastin kur nga kryerja e këtij krimi ka ardhur një pasojë e rëndë, është cenuar integriteti i rezultatit zgjedhor, si dhe kur veprimet kriminale kanë sjellë si pasojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve (Kodi Penal, 1995:326).

Nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se gjatë vitit 2009 është regjistruar një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve”. Për

këtë veprë penale ka pasur një të gjykuar dhe të dënuar (Prokuroria e Përgjithshme, 2010: 209).

Ndërsa, gjatë vitit 2010 janë regjistruar tri procedime penale për veprën penale të parashikuar nga Neni 326 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve”. Sipas të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme është dërguar në gjyq vetëm një procedim penal si dhe janë regjistruar 15 të pandehur të cilët janë dënuar nga organi i dhënies së drejtësisë (Prokuroria e Përgjithshme, 2010: 209). Për vitin 2011 janë regjistruar 25 procedime penale. Prej tyre, për veprën e parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal janë regjistruar 9 procedime penale (Prokuroria e Përgjithshme, 2011: 164).

Tabela Nr. 2



Kjo figurë krimi ka zënë rreth 36% të vëllimit të përgjithshëm të krimeve kundër zgjedhjeve dhe sistemit të tyre demokratik për vitin 2011 dhe 100% të vëllimit për vitin 2010, duke u renditur si një ndër dy veprat që zënë peshën më specifike në këtë grup veprash penale.

Në Kodin Penal është sanksionuar një tjetër krim elektoral, parashikuar nga neni 326/a “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor”. Kjo veprë penale është shtuar me ligjin nr. 23/2012. Ky krim elektoral ka për qëllim mbrojtjen e materialit zgjedhor, si vula, kode sigurie, pajisje zgjedhore nga dëmtimet, prishjet si dhe shkatërrimet me dashje. Po ashtu, është sanksionuar edhe mbrojtja e çdo materiali zgjedhor nga zëvendësimi i tyre me të tjera materiale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në pikëpamje të anës subjektive, kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje. Në pikëpamje të anës objektive, vepra penale e “Dëmtimit të materialit zgjedhor” paraqitet në rrethana rënduese kur ka sjellë pasojë të rënda apo pavlefshmërinë e procesit zgjedhor, është kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, si dhe kur është kryer nga subjekte të posaçëm sikurse mund të jenë: personat përgjegjës për administrimin e procesit elektoral. Fajtori në këtë rast dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet, në dallim nga paragrafi i parë i kësaj vepre që

sanksionon dënimin me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet (Kodi Penal, 1995: 326/a).

Po ashtu, normat penale dënojnë edhe subjektin e posaçëm, që është i ngarkuar me zgjedhjet, që cenon fshehtësinë e procesit të votimit. Një normim i tillë penal synon mbrojtjen efektive të parimit kushtetues të një procesi zgjedhor sa më të barabartë, të lirë dhe të ndershëm.

Në kuadër të masave të marra nga ana e legjislatorit tonë, për mbarëvajtjen sa më të rregullt të procesit zgjedhor, ligjbërësi ka parashikuar sanksionin penal për ushtrimin e të drejtës së votimit më shumë se njëherë ose pa u identifikuar në të njëjtat zgjedhje. Ky krim elektoral mund të kryhet nga cilido që për të votuar përdor dokumentacionin e zgjedhësve të tjerë apo të rremë. Po ashtu, ligjbërësi dënon edhe rastin kur subjekti i posaçëm (komisioneri zgjedhor) kryen krimin me mosveprim, duke mos identifikuar me dashje votuesin.

Praktikat korruptive në procesin zgjedhor dëmtojnë interesin publik në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasi ato ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve në mënyrë jodemokratike ose ndikojnë në marrjen e vendimeve politike që i përshtatet interesave të caktuara ose atyre private (Bogdani, 2011:130). Për pasojë, edhe masat e dënimeve të parashikuara nga Kodi Penal për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira janë relativisht të ashpra.

Kodi Penal dënon edhe dhënien e shpërblimeve apo ofrimin dhe pranimin e të mirave materiale që synojnë përcaktimin e votës elektorale, mos pjesëmarrjen në procesin zgjedhor etj. Sikundër shihet nga dispozita penale "Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve" e parashikuar në nenin 328 të Kodit Penal, ligji penal dënon për kryerjen e veprimeve dhe mosveprime kriminale si dhënësin/ofruesin ashtu edhe përfituesin gjatë procesit zgjedhor si p.sh., në dhurimet që kanë për qëllim apo janë të lidhura me zbatimin e reformave pas zgjedhore (Bogdani, 2011:128). Në këtë dispozitë, ligjvënësi ka ashpërsuar masën e dënimit për subjektet aktiv duke e ndryshuar masën e dënimit nga gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj sikurse ishte para ndryshime të vitit 2012 në burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet aktualisht. Ndërsa në lidhje me fajtorin (përfituesin e shpërblimeve) ligji penal ka mbajtur të njëjtin qëndrim, dënimin me gjobë.

Po ashtu, është i dënueshëm nga norma penale edhe shpërdorimi i burimeve administrative shtetërore dhe publike për qëllime elektorale nga kandidatët ose nga partitë politike, pagimi i

ryshfeteve ndaj votueseve ose zyrtarëve që merren me administrimin e zgjedhjeve (Bogdani, 2011:129 - 130). Në këtë kuptim, Kodi Penal është përmirësuar duke sanksionuar si kundërvajtje penale detyrimin për pjesëmarrje në veprimtari politike të punonjësve të administratës publike dhe të nxënësve të arsimit parauniversitar nga funksionarët publik apo nga çdo person që kryen detyrë apo funksion në sektorin dhe arsimin jo publik.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2012, neni 329 "Kanosja e zgjedhësit" ka pësuar një ndryshim pozitiv në kuadër të mbrojtjes së aktorëve kryesorë në procesin zgjedhor. Kështu, është zgjeruar gama e objektit të mbrojtur nga ligji penal. Më saktësisht, përveç mbrojtjes penale të zgjedhësit që ishte sanksionuar më parë, me përmisimet ligjore të bëra në vitin 2012 është ofruar një mbrojtje nga norma penale edhe për komisionerët, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtar tjetër të ngarkuar me procesin zgjedhor. Masa e dënimit për kryerjen e veprimeve të tilla kriminale si: kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje, në bashkëpunim ose më shumë se një herë është nga një deri në pesë vjet burgim (Kodi Penal, 1995: 329).

Njëkohësisht, ligji penal merr në mbrojtje edhe të drejtën kushtetuese të zgjedhjes. Kështu, pengimi që mund t'i bëhet individit për të mos votuar është i dënueshëm nga norma penale. Format e kryerjes së këtij krimi mund të përfshijnë veprime, të tilla si: cenimi i rregullave të votimit, marrja apo dëmtimi i mjetit të identifikimit etj. Subjekt i këtij krimi mund të jetë cilido individ. Në rastin kur është subjekti i posaçëm, masa e dënimit rritet me burgim nga një deri në pesë vjet burgim (Kodi Penal, 1995: 330).

Duke vënë re shpesh herë fenomenin negativ të braktisjes së detyrës nga e komisionerëve politikë në proceset zgjedhore, ligjbërësi ka sanksionuar si vepër penale braktisjen e detyrës nga anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Neni 330/a i Kodit Penal është shtuar me ligjin nr. 23/2012. Sipas kësaj norme penale, do të ndodhemi përpara krimin elektoral të braktisjes së detyrës nga komisionerët, në rast se ky i fundit, personi i ngarkuar nga ligji me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, refuzon apo braktis detyrën duke e shoqëruar këtë veprim të kundërligjshëm me marrjen apo zhdukjen e materialeve zgjedhore.

Sa më lart, në strukturën kriminale të mësipërme përfshihet edhe veprimi kriminal që ka sjellë pasojën e rëndë për procesin e votimit apo pavlefshmërinë e procesit të zgjedhjeve. Në një rast të tillë, fajtori dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet (Kodi Penal, 1995: 330/a). Ligjbërësi ka

rritur masën e dënimit penal për fajtorin që cenon të drejtën e zgjedhjes. Në këtë kuadër, si shkak i ndryshimeve në ligj, kundërvajtja penale e shkeljes së të drejtës së zgjedhjeve është sanksionuar tashmë si krim. Në këtë të fundit, subjekti aktiv dënohet me burgim nga një në pesë vjet dhe jo me burgim gjer në një vit sikurse ishte i parashikuar më parë (Kodi Penal, 1995: 331). Në paragrafin e dytë të po këtij neni, për efekt të cilësimit juridik, ka rëndësi pasoja e rëndë për interesat e zgjedhësve apo mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Gjithashtu, normat penale kanë sanksionuar edhe dënimin e kuadrove ushtarakë që shpërdorjnë detyrën për të ndikuar në procesin e votimit. Kjo kundërvajtje penale, në pikëpamje të anës objektive mund të konsumohet me dhënie urdhrash, këshillash, si dhe çdo lloj forme tjetër propogande tek ushtarakët e tjerë që autoriteti ushtarak ka në varësi.

Vëllimi dhe dinamika e procedimeve penale për veprime që lidhen me procesin elektorale janë një tregues që tregon mbi cilësinë dhe garancitë e parimeve të lirisë politike në një shtet (Mulaj, 2013:68). Në këtë aspekt, me interes paraqesin të dhënat analitike të Prokurorisë së Përgjithshme. Sipas saj, për procedimet e regjistruara për veprat penale kundër zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik të zgjedhjeve në lidhje me personalitetin e të pandehurve për vitin 2011 ka rezultuar se 56% e të pandehurve për këto vepra kishin arsimin e mesëm, 36 % gëzonin arsimin e lartë dhe vetëm 8% e tyre ishin me arsim 9–vjeçar (Prokuroria e Përgjithshme, 2011: 164).

Në lidhje me vendbanimin e të gjykuarve për vitin 2011 ka rezultuar se 52% e tyre ishin me banim në qytet dhe 48% me banim në fshat. Ndërsa në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve

mund të themi nga 25 të pandehur, vetëm njëri prej tyre ishte përsëritës për vepra penale të ndryshme ndërsa 24 të pandehurit e tjerë rezultojnë të padënuar më parë (Prokuroria e Përgjithshme, 2011: 164).

Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve ka rezultuar se 36% e tyre kanë qenë të punësuar në shtet si nëpunës të thjeshtë. Po kaq, ka rezultuar edhe përqindja e atyre të pandehurve që ishin të papunë. Ndërsa për 20% të të pandehurve nuk ka të dhëna lidhur me punësimin e tyre, ndërsa vetëm 8% e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin privat. Të pandehurit kanë qenë të rritur mbi 18 vjeç, një femër dhe 23 meshkuj. Ndërsa për një prej tyre nuk ka të dhëna (Prokuroria e Përgjithshme, 2011: 164).

PËRFUNDIME

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton një ndër fitoret e mëdha të demokracisë, të drejtën e shteteve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet përfaqësuese, në bazë të një sistemi demokratik të zgjedhjeve (Elezi, 2009:622).

Veprat penale në fushën e zgjedhjeve nuk janë diçka e re në procesin tonë zgjedhor. Tashmë, të drejtës kushtetuese të zgjedhjeve i rezervohet një mbrojtje më e plotë juridiko – penale.

Studimi i këtyre lloj veprash penale nuk duhet të jetë i kufizuar. Këto vepra meritojnë një shqyrtim dhe studim gjithëpërfshirës. Mbledhja dhe analiza e të dhënave mbi krimet e zgjedhjeve në të gjithë vendin tonë do të mundësojë kuptimin e faktorëve që ndikojnë në kryerjen e këtyre veprave penale, arsyet që nxisin personat të kryejnë këto vepra penale, si dhe do të mundësojë edhe parandalimin e tyre. Pasi, kur zgjedhjet bëhen të korruptuara, demokracia është ajo që vihet nën kërcënim (FBI: USA).

BIBLOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2007). Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi i tretë. Tiranë: Botimet Toena.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2008). Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi i katërt. Tiranë: Botimet Toena.
- Anastasi, A., (1998). Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri. Tiranë: Shtëpia Botuese Luarasi.
- Berhani, I., (2006). E drejta e zgjedhjeve si e drejtë kushtetuese. Përvoja shqiptare. Tiranë: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës. (Disertacion për marrjen e gradës shkencore: “Doktor i shkencave juridike).
- Bogdani, M., (2011). Administrimi i procesit zgjedhor. Tiranë: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës. (Disertacion për marrjen e gradës shkencore: “Doktor i shkencave juridike).
- Celibashi, I., (2002). Diskutim për zgjedhjen e sistemit zgjedhor. Tiranë: Revista E drejta parlamentare dhe politikat ligjore.
- Cincotta, H., & Zjednoczone, S., (1991). What is democracy ? USA: United States Information Agency.
- Dervishi, K., (2006). Historia e shtetit shqiptar. Tiranë: Shtëpia Botuese 55.
- Elezi, I., (2009). E drejta penale (Pjesa e posaçme). Tiranë: Botimet ERIK.
- <http://www.fbi.gov/about-us/investigate/corruption/election-crimes>
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, (1952). Tiranë: Ministrija e Drejtësisë.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, (1977). Tiranë: Shtëpia botuese "8 Nëntori".

Konrad-Adenauer-Stiftung, (2011). Concepts and principles of democratic governance and accountability. Kampala: Uganda Office of the Konrad- Adenauer-Stiftung.

Likmeta, E., (2012). Nga gurët në elektronikë, rrugëtim drejt konsolidimit. Tiranë: Konferenca shkencore e organizuar nga Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti Drejtësisë, Universiteti Tiranë.

Mbretëria Shqiptare, Kodi Penal, (1929). Tiranë: shtypëshkronja "Dielli".

Mulaj, V., (2013). Mbrojtja e të drejtavë të zgjedhjeve dhe sistemit demokratik të zgjedhjeve në aspektin krahasues. Tiranë: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës. (Disertacion për marrjen e gradës shkencore: "Doktor i shkencave juridike).

Myers, S., (2002). The Democracy Reader. New York: The international Debate Education Association.

Prokuroria e Përgjithshme, (2007). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2007. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, (2008). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2008. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, (2009). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2009. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, (2010). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2010. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, (2011). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2011. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, (2012). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2012. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme, (2013). Raportim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2013. Tiranë.

Public Affairs Office, Embassy of the United States of America (2000). USA, Elections 2000. USA, Regional Program Office, Vienna (RPO 2000306) Albanian.

Rosen, M., & Wolff, J., (2007). Mendimi Politik. Tiranë: Shtëpia Botuese UFO Press.

US. Election Assistance Commission, (2006). Election Crimes: An Initial Review and Recommendations for Future Study. New York.

Zaganjori, Xh., (2002). Demokracia dhe shteti i së drejtës. Tiranë: Shtëpia Botuese Luarasi.

PERSPEKTIVA SOCIOLOGJIKE E HISTORISË SË EMIGRIMIT SHQIPTAR

MATILDA LIKAJ-SHAQIRI

DEPARTMENTI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI BEDËR, TIRANË

Përmbledhje

Emigrimi është një fenomen tepër kompleks kur e analizon nën perspektivën socio-kulturore, ekonomike dhe atë politike dhe ai shqiptar është një oaz mundësish dhe sfidash jo vetëm për individin që emigron, për shoqërinë shqiptare, por dhe për shoqëritë pritëse. Përzgjedhja e destinacionit për të emigruar është e lidhur ngushtë me faktorët 'tërheqës' dhe 'shtytës' në situatën aktuale në shoqërinë ku individët jetojnë. Të tillë faktorë janë mungesa e punës në vendin e origjinës, pagat e mira në vendet e tjera, lehtësia e gjetjes së punës në vendin ku emigrojnë, reklamimi i vendit nga emigrantët që kanë shkuar më parë, etj. Pra, është e rëndësishme të theksojmë se këta faktorë të emigrimit shqiptar, kanë ndikuar në mënyrë dinamike në vetë strukturën e shoqërisë shqiptare. Në literaturën e sociologjisë së emigrimit në Shqipëri, vihet re një mungesë e analizimit të historisë së emigrimit shqiptar pas themelimit të regjimit komunist deri në ditët e sotme. Për këtë arsye u pa e domosdoshme të analizohej shkurtimisht kronologjia e emigrimit shqiptar gjatë periudhës së komunizmit, si dhe në periudhën postkomuniste të shoqërisë tonë nga një këndvështrim sociologjik.

Fjalët çelës: *emigrimi shqiptar; historia e emigrimit shqiptar; analizë sociologjike; shoqëria postkomuniste shqiptare.*

Abstract

During the sociological, cultural, political and economic analyses of emigration, it appears to be a very complex phenomenon not just for individuals but also for the society. Albanian emigration has a uniqueness form that is quite different from the emigration phenomena in other societies. It is a lack of opportunities and challenges not just for the individuals that migrate but also for Albanian society and the hosted societies. The selection of destination of individuals to emigrate is strongly related with 'push' and 'pull' factors of origin country. Some of these factors are lack of working opportunities; high wages at hosted countries, advertisement of hosted countries form emigrants, etc. So these factors influence Albanian society's dynamics by forming different ways of emigration toward Eastern and Western societies. Even that the emigration phenomena has influenced so much Albanian society, it is faced with the lack of studies, researches or literature reviews in Albanian sociological literature of emigration, emigration histories, analyses of Albanian emigration, from 1990 till now. This article is also focused on the sociological analyses of Albanian migration during the post-communist period.

Key words: *Albanian migration; History of Albanian migration; Sociological Analyze; Post-communist Albanian society*

HYRJE

Fenomeni i emigrimit dhe integrimi social i emigrantëve, e studiuar më tepër nën perspektivën ekonomike ose politike, duket sikur është një temë e cila është larg arenës së sociologjisë. Por, përkundrazi, të dyja këto fenomene më parë se në çdo fushë tjetër studimi ato kanë lidhje me fushën e sociologjisë. Ky fenomen që duket individual, në të vërtetë ka dimensione më të gjera, të cilat janë dimensionet sociale. Gjithashtu, po ta analizojmë edhe nga një këndvështrim tjetër, është e rëndësishme të themi se 'sociologjia e shekullit të 21' duke u nisur prej gjendjeve të ndryshme të individit, teorizohet me nxjerrjen në pah të lidhjeve të individit me grupin shoqëror, por edhe më gjerë me shoqërinë' (Aydemir; 2011: 100).

Edhe pse në fushën e sociologjisë, fenomeni i emigrimit ka qenë i studiuar kohët e fundit, shpeshherë gjejmë mangësi jo vetëm në formën teorike, por edhe në format analitike të saj. Një numër i vogël i studimeve të mirëfillta në këtë fushë më shtojnë dëshirën për të punuar dhe realizuar një

studim të tillë. Pra, është parë e nevojshme të studiohet kjo fushë si një kontribut, në nivel të studimeve të integruara në literaturën e sociologjisë. Gjithashtu, një analizim i mirëfilltë i historisë së emigrimit shqiptar gjatë periudhës së regjimit komunist, si dhe në shoqërinë shqiptare postkomuniste ka qenë gjithmonë i diskutueshëm. Për këtë arsye, është parë e rëndësishme analizimi sociologjik i historisë së emigrimit shqiptar gjatë, periudhës së regjimit komunist, periudhave të veçanta të fenomenit të emigrimit pas viteve 1990 deri në ditët e sotme, si dhe ndryshimi i strukturës së fenomenit të emigrimit pas liberalizimit të vizave në BE. Ky studim do të mundësojë një analizim të shkurtër sociologjik rreth nëntemave të sipërpërmendura.

1-PERSPEKTIVA SOCIOLOGJIKE E KRONOLOGJISË SË EMIGRIMIT SHQIPTAR (një paraqitje e shkurtër e historisë së emigrimit gjatë viteve 1945 deri në ditët e sotme)

1.1-Periudha 1945-1990

Pas Luftës së Dytë Botërore shoqëria shqiptare u rithemelua si një vend socialist dhe më vonë komunist, i rrethuar me ideologji politike të vetë udhëheqjes, nacionalizëm të fortë si edhe formimin e ristrukturimit të stratifikimit të strukturës sociale pa 'ndarje klasash socio-ekonomike'. Lëvizjet e brendshme gjatë dekadave të para të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore dhe luftën Çlirimtare, kanë qenë të pakta. Gjatë pesë viteve të para të sistemit politik socialist në Shqipëri, lëvizjet emigrimit të brendshme nga fshati në fshat kanë qenë dominante, ashtu siç tregohen edhe në të dhënat e censusit të viteve 1945 dhe 1950. Ndërsa, më vonë këto lëvizje migratore pothuajse minimizohen fare (Vullnetari; 2007: 23).

Rindërtimi i industrisë, dhe i ekonomisë së vendit, kontrollet strikte për urbanizimin, riorganizimi i strukturës sociale dhe kulturore, mundësoi një sistem të ri social në shoqërinë tonë. Në këtë sistem të ri social, lëvizjet demografike të brendshme ishin rreptësisht të kontrolluara, ndërsa lëvizjet demografike të jashtme ishin pothuajse aspak të dukshme. Mbajtja e popullsisë në zonat rurale, si dhe politikat për fuqizimin dhe rimëkëmbjen e fshatit mundësuan rritjen e popullsisë së fshatrave me popullsi prej zonave rurale më të vogla ose më të thella, pa përjashtuar edhe transferimet nga qyteti në këto zona. Edhe pse ekzistonte një hapësirë e madhe në dallimet e kushteve të mënyrës së jetesës ndërmjet zonave urbane dhe rurale, politikat e sistemit komunist nuk lejonin të ndryshohej trajektorja e emigrimit në strukturën shoqërore të Shqipërisë. Kjo trajektore ishte e fokusuar në politikën e 'planifikimit të përqendruar' të popullsisë, të cilat reflektoheshin me ideologjinë e fuqizimit dhe rimëkëmbjen e 'atdheut komunist'.

'Përgjatë periudhës socialiste/komuniste ndodhi një proces i ngjashëm që solli zhvendosje gjithashtu masive të popullsisë fshatare drejt qyteteve. Kjo ndodhi kryesisht që nga viti 1950-1960' (Fuga; 2000: 147). Ndërsa, prej 1950-1955 ka pasur një rritje të madhe të popullsisë në zonat urbane (50 %) duke e krahasuar me rritjen e popullsisë në zonat rurale (50 %). Kjo rritje mund të vlerësohet me rritjen e përqindjes së gjithë popullsisë urbane prej 20 % të popullsisë në 27 % (Bërxfholi, 2000: 27).

Sipas Bërxfholit, janë dy arsye pse ka ndodhur kjo rritje: migrimet intensive prej zonave rurale dhe urbane si dhe ndryshimet administrative të cilat formuan një numër të madh të qendrave urbane (nga 24 qendra urbane u bënë 37 prej 1945-1955). Sipas regjistrimeve të censusit të vitit 1960 ka

figuruar 31% rritje të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane. (Borchert; 1975: 177). Sipas Hall midis viteve 1950-1960 kanë emigruar rreth 130.000 persona ose 30% e popullsisë prej zonave rurale drejt atyre urbane (Hall; 1994: 68). Kjo rrymë e imigrimit të brendshëm ka ndodhur për shkak sepse në këtë periudhë kohe, janë aplikuar politika për hapjen e qendrave të tjera urbane. 'Megjithatë prej 1960 dhe në vitet në vazhdim, autoritetet shqiptare ndoqën politikat e *urbanizimit minimal* dhe *ruajtjen e fshatit*' (Vullnetari; 2007: 24). 'Këto kufizime administrative, formonin atë që quhej 'sistem anti-migrator'' (Sjoberg;1994: 28), të cilat nëpërmjet politikave strikte vetëm në raste shumë të veçanta (shëprngulje për shkak të detyrës ose persekutimve) nuk lejonin lëvizjet demografike.

Centralizimi i shoqërisë si nga ana socio-kulturore, ekonomike, por edhe politike mundësonte një kontroll edhe mbi lejet e shpërnguljes, lejet e banimit si dhe pasaportizimit të çdo familjeje dhe individi. Pra duke analizuar situatën e fenomenit të migrimit në periudhën komuniste do të shikojmë që migrimi i brendshëm realizohej vetëm nëpërmjet kurajimit ose ndalimit të politikave të sistemit politik komunist. 'Procesi i eksodit të brendshëm rural në kohën e komunizmit, pas viteve 1960 vazhdoi në mënyrë shumë të dobët sepse politika zyrtare kërkonte të pengonte administrativisht popullimin masiv të qyteteve shqiptare duke e penguar ardhjen e masave fshatare në to (Fuga; 2000: 147).

Gjithashtu, rryma migratore jashtë Shqipërisë pothuajse nuk realizoheshin aspak. 'Lëvizja ndërkombëtare gjatë epokës së socializmit ishte e ndaluar. Gjithsesi, kufijtë me ish- Jugosllavinë dhe me Greqinë ishin në njëfarë mase të kalueshme në fillimin dhe mesin e viteve '50 dhe në vitet '60. Ata që arritën të kalonin kufijtë u dërguan përkohësisht në kampe refugjatësh në Greqi, Itali dhe Jugosllavi dhe më vonë u zhvendosën në destinacionet përfundimtare në Evropën Perëndimore (si Francë, Belgjikë) dhe në Amerikën e Veriut (SHBA). Këto "incidente" sporadike u bënë gjithnjë e më të vështira dhe autoritetet shqiptare kontrollonin rreptësisht zonat kufitare duke e bërë kalimin e kufirit një veprim të vështirë dhe të rrezikshëm, që po të kapeshin akuzoheshin për tradhti ndaj atdheut dhe ndëshkoheshin në shumë mënyra, që nga internimi i brendshëm deri në burgim të përjetshëm'(Ikonimi; 2008: 15).

Por, edhe në qoftë se dikush emigronte jashtë Shqipërisë, ndodhte në mënyrë ilegale, ku pasojat e këtij emigrimi reflektonin në pjesëtarët e familjes ose të afërmve të vetë, nëpërmjet ndëshkimit, persekutimit ose edhe nëpërmjet internimit. Përtej

këtyre politikave, mungesa e aplikimit të fenomenit të migrimit ka reflektuar edhe në terminologji, e cila shpeshherë reflektohet edhe në ditët e sotme. 'Gjatë kësaj periudhe është përdorur termi 'lëvizje mekanike' (Vullnetari; 2007: 28). Termi lëvizje migratore ose imigrim nuk është përdorur pothuajse aspak në literature, ashtu edhe në gjuhën e përditshme të folur. Termi 'lëvizje mekanike' është përdorur nën kuptimin e migrimit jo si një rrymë lëvizjeje të individësh, por si një lëvizje e kontrolluar prej organeve përkatëse shtetërore. 'Veçanërisht përgjatë dekadave të fundit të periudhës socialiste, çdo kërkesë për tu zhvendosur në qytet e bërë nga cilido shtetas që banonte në zonën rurale të vendit, duke argumentuar disi me arsye apo pretekste pune apo bashkim familjar, duhej të shqyrtohej më parë rreptësisht nga administrata lokale apo komitetet e partisë së rretheve përpara se të jepej një përgjigje pozitive apo negative (Fuga; 2000: 147). Kjo situatë vazhdoi në të njëjtën mënyrë deri në fund të viteve 1988 dhe 1989, ku një numër i vogël individësh dhe familjesh filluan të lëviznin drejt qytetit. 'Kjo gjendje ndryshoi rrënjësisht pas hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor demokratik që përcaktoi edhe pamjen administrative të Shqipërisë së tranzicionit paskomunist (Fuga; 2000: 147). Pikërisht kjo periudhë u shoqërua me ndryshime të mëdha politike, me rënien e sistemit totalitar komunist dhe me ndryshime drastike në riorganizimin e strukturës sociale të shoqërisë sonë.

Lëvizjet migratore të brendshme dhe të jashtme u legalizuan shumë shpejt si e drejta njerëzore në fillimet e viteve 1990. Neni 22, i Ligjit për Ndryshime në Dispozitën Kushtetuese të vitit 1993, ku thekson se çdo shtetas shqiptar ka të drejtën të zgjedh vendin e tij të banimit dhe të lëviz i lirë brenda dhe jashtë territorit të shtetit shqiptar. Por këtu është e rëndësishme të theksojmë se në shoqërinë shqiptare tashmë kishte kohë që u shfaq fenomeni i emigrimit.

1.2-Periudha 1990-deri në ditët e sotme

Në këtë studim, kronologjia e emigrimit shqiptar pas rënies së regjimit komunist, është formuluar duke u marrë si referencë studiuesin e njohur në fushën e emigrimit shqiptar postkomunist, Russell King. Ai e formulon këtë kronologji sipas transformimeve politike, ekonomike dhe sociale që ndodhën si rezultat i rënies së regjimit komunist gjatë viteve 1990 dhe në vazhdim. 'Gjithashtu, një tjetër element i rëndësishëm që ndikoi në formulimin e kësaj kronologjie është edhe masat migratore që u shfaqën në këto periudha (King; 2005: 41). Ndërsa, për sa i përket periudhës së viteve 2000 deri në ditët e sotme të emigrimit, është realizuar një ndarje në bazë të numrit të

emigrantëve në këtë periudhë, por edhe në analizimin e këtij fenomeni dhe ndikimin e tij në shoqërinë shqiptare. Një vend të rëndësishëm këtu zë edhe analizimi i emigrimit shqiptar në shoqërinë turke, një fenomen ky që nuk është studiuar më parë në shkencat sociale në Shqipëri.

1.3-Rënia e regjimit komunist dhe emigrantët e 'ambasadave': 1990

Në dhjetor të vitit 1990, si pasojë e manifestimeve të organizuara kryesisht në Tiranë kundër pushtetit komunist, në Shqipëri u pranua pluralizmi politik (Fuga; 2000: 34). Pra, rënia e regjimit komunist në shoqërinë tonë u shoqërua me një varg të mëdha turbulencash politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të cilat më vonë reflektuan si trauma sociale. 'Shqipëria, po ashtu si vendet e tjera postkomuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore, ka qenë duke kaluar një proces tranzicioni të shumëfishtë: tranzicion politik nga një parti në shumë parti, tranzicion ekonomik nga një ekonomi e planifikuar në ekonominë e tregut dhe tranzicioni i sigurimit kombëtar në një regjim sigurimi ndërkombëtar që ishte i paparashikueshëm (Biberaj; 2001: 15).

Ndërsa, Fuga e identifikon rënien e regjimit komunist si një reflektim i një shoqërie të pa përgatitur për tu përballur me risi të tilla. 'Shoqëria shqiptare u ndodh përpara një sfide me shumë përmasa çka e bënte urgjente dhe të domosdoshme ndërmarrjen e transformimeve të thella shoqërore, politike dhe ekonomike. Opinioni publik i qyteteve kryesore të vendit i kishte ngulur sytë te një lloj modeli shoqëror imagjinar, i ngjashëm me atë që zbatohet në Evropën Perëndimore. Në të shumtën e rasteve, ky model imagjinar përfaqësonte një tërësi vlerash të përfytyruara në mënyrë abstrakte. Ndonjëherë ai merrte thjesht formën e një përzierjeje ëndrrash për tu realizuar apo edhe formën e një dëshire ikjeje nga sytë këmbët prej një realiteti shoqëror, të mbushur plotë me privime dhe dhimbje (Fuga; 2000: 31). 'Që prej kësaj periudhe, filloi lëvizja migruese e shqiptarëve, një lëvizje masive, në trajtën e eksodit brenda dhe jashtë Shqipërisë' (Dervishi; 2001: 34). 'Arritjet politike dhe ekonomike të kësaj periudhe janë të padiskutueshme. Në radhë të parë janë siguruar të drejtat politike individuale shumë të rëndësishme. Këtu mund të numërohen si kryesore e drejta e fjalës, e zgjedhjeve të lira dhe të fshehta, e zgjedhjes së lirë të profesionit, të zgjedhjes së lirë të vendbanimit, e lirisë së besimeve dhe të shprehjes së opinionëve, e qarkullimit të lirë brenda dhe jashtë vendit etj' (Fuga; 2000: 15-16). 'Që nga fillimi i viteve 1990 të shekullit të XX deri në ditët tona, shqiptarët mund të karakterizohen si një komb emigrantësh.

Gjatë këtyre viteve ikja e shqiptarëve drejt vendeve të tjera mori pamjen e eksodit' (Dervishi; 2008: 21).

Në qershor të 1990, me liberalizimin e pasaportave dhe pasaportizimit (Kuvendi Popullor i RPSSH (12/6/1990), Dekreti nr 7393) dhe vetëm pas pak ditësh filloi 'eksodi i parë' ose lëvizja e parë emigratore e cila u realizua nëpërmjet pushtimit të mureve, dyerve dhe në brendësi të ambasadave. Emigrantët e ambasadave, janë pranuar si hapi i parë i fillimit të mas-emigrimit shqiptar pas 45 vitesh dhe deri në ditët e sotme. 'Gjatë qershorit të këtij viti, rreth 5000 shqiptarë u kërkuan largimin ambasadave të shteteve perëndimore në Tiranë (Vullnetari; 2007: 31). Ndërsa, sipas Barjaba, rreth 20000 shqiptarë kanë lënë Shqipërinë gjatë vitit 1990 (Barjaba; 2003:13). Këta individë ishin persona të cilët dëshironin të largoheshin nga Shqipëria për një jetë me kushte sociale, ekonomike dhe kulturore më të mira, si dhe njohjen e të drejtave të tyre humane. Njëkohësisht 'bota jashtë' kufijve të Shqipërisë ishte tepër e dëshiruar për arsye për të ditur se 'çfarë ndodh jashtë?' si dhe mitizimi i vetë 'Evropës'. Kundrejt forcave rezistente të policisë, në korrik 1990 u realizua eksodi i parë i shqiptarëve drejt vendeve perëndimore, sidomos Itali, Gjermani, Francë etj. Njëkohësisht dobësimi i kontrollit të policisë kufitare mundësoi edhe emigrimin e shqiptarëve drejt Greqisë. 'Në dhjetor të 1990, më tepër se 800 shqiptarë (duke përfshirë edhe ata me etnicitet grek), kaluan në territorin grek brenda një nate të vetme' (Konidaris; 2005: 85). Me vonë këto vende u bënë bazat e vendeve për formimin e rrjeteve të emigrantëve në vitet në vijim. Edhe King shprehet se kjo ishte rryma e parë e emigrimit, e cila më vonë formoi bazën e rrjeteve të tërheqjes së emigrantëve shqiptarë në Evropën Perëndimore (King; 2005: 41).

Kjo rrymë emigrimi, u shfaq për herë të parë në historinë e shoqërisë shqiptare e cila jo vetëm që kishte ngjyrimet tronditëse, por përmbante edhe shpresë për ndryshimin e kësaj shoqërie.

1.4-Eksodi i anijeve në Itali dhe emigrimi masiv në Greqi: 1991

Kaosi i shkaktuar prej dobësimit të regjimit totalitar dhe zgjedhjet e para demokratike, shkaktuan një eksod masiv ku në mars të vitit 1991, 25000 persona emigruan drejt Italisë, ku dhe u pranuan prej autoriteteve dhe u shpërndanë nëpër vende të ndryshme të Italisë. (Vullnetari; 2005: 32). Përkeqësimi i situatës ekonomike, por edhe çorientimet politike kishin formuar jo vetëm situata anomike, por edhe nxitur dëshirën e individëve për tu larguar sa më parë, drejt një 'bote' më të mirë. Në këtë periudhë regjimi komunist ishte drejt fundit të tij, kështu që edhe vetë individët ndesheshin me

moskontrollin që ishte një element sa i dëshiruar, por edhe aq i panjohur për ta. Në gusht po të këtij viti, individë prej vende të ndryshme të Shqipërisë u fokusuan drejt porteve të Durrësit dhe Vlorës për të realizuar ëndrrën e tyre 'Evropa jonë, Evrope e re' me drejtim brigjet e Italisë, si dhe braktisjen e vendit për shkak të izolimit për më tepër se 45 vite. 'Ndërsa eksodi i dytë me anije ose i emërtuar si rryma e dytë e e refugjatëve kishte më tepër se 20000 emigrantësh (Vullnetari; 2007: 37). 'Në mars të vitit 1991, një numër i madh shtetasish shqiptarë hynë në portin e Durrësit, prej nga u larguan me anijet e flotës detare tregtare në portet e Italisë Jugore. E njëjta situatë u përsërit pak muaj më vonë, me largimin e 18.000 emigrantëve drejt brigjeve të Italisë. Këto ngjarje u pasuan me lëvizje të vazhdueshme emigrantësh, kryesisht të parregullt që përdornin rrugët tokësore drejt Greqisë apo ato detare drejt Italisë, për në vendet e tjera të BE-së' (Ikonomi; 2009: 11).

Megjithatë, emigrimet klandestine drejt Italisë, Greqisë dhe shteteve të tjera vazhdonin në masë. Megjithëse, numri i emigrantëve në këtë periudhë kohe ishte shumë i vështirë të përcaktohej me saktësi, sipas Barjaba, në mars të vitit 1991 më shumë se 25000 shqiptar emigruan drejt Italisë (Barjaba; 2003: 10). Ndërsa, sipas King, brenda katër muajve midis majit dhe qershorit të vitit 1991, më shumë se 100000 shqiptar kaluan kufirin, pre të cilëve 76 për qind u drejtuan drejt Greqisë dhe 24 për qind drejt Italisë (King; 2005: 42).

Këta emigrantë shqiptarë në fillim u pranuan si rryma migratore prej vendeve komuniste me statusin e refugjatit. Ky status u pranua lehtë prej politikave të vendeve të ndryshme të botës, ndërsa shteti grek i përcaktoi këta emigrantë si emigrant ilegalë. Kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së politikave liberale për emigrantët shqiptarë në vende të ndryshme, si mungesë e diplomacisë dhe bashkëpunimeve, si dhe përballja për herë të parë pas disa dekadash me një fenomen të tillë.

1.5- Emigrimi shqiptar gjatë periudhës 1993-1996

'Reformat politike dhe ekonomike në Shqipëri krijuan një gjendje shoqërore që nisi të nxisë emigracionin jashtë vendit sidomos drejt shteteve evropiane fqinje, Greqi dhe Itali. Dukuria e emigrimit jashtë vendit është një nga prirjet më të rëndësishme shoqërore që karakterizojnë tranzicionin paskomunist shqiptar (Fuga; 2000: 171).

Periudha midis viteve 1993-1996 është konsideruar si një periudhë e rritjes së ekonomisë dhe stabilitetit të shoqërisë shqiptare. Megjithatë rritjet ekonomike dhe stabiliteti, kishin përmasa shumë të vogla kur e krahason me tranzicionin që

vetë kjo shoqëri po kalonte. Sipas Vullnetarit, politikat dhe reformat neoliberalë të qeverisë së Berishës ishin 'terapi shokuese' për Shqipërinë (Vullnetari; 2007: 33). Këto reflektojnë edhe më vonë me tumorin ekonomik të shkaktuar prej firmave piramidale.

Në fund të vitit 1996 numri i shtetasve shqiptarë që jetonin jashtë vendit arriti në 350.000 vetë (Ikonimi; 2009; 14). Por, gjatë kësaj periudhe kohore, emigrimi po zhvillohej në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa, numri i papunësisë shtoej në shoqërinë tonë, për shkak të mbylljeve të fabrikave, fermave-kooperativave, të rrënimit të shumë vendeve pune shtetërore faktori gjendjen e rrënuar ekonomike. Kushtet e rrënuara sociale, kulturore, ekonomike, por edhe politike u bënë faktorët ndikues në vendimarrjen për të emigruar të individëve. Emigrimi në masë dhe i vazhdueshëm gjatë kësaj periudhe ishte fenomeni më i përhapur social. Gjithashtu, burimi kryesor i të ardhurave në Shqipëri, ishin remitanca financiare që dërgonin emigrantët. Këto remitanca financiare ishin ndikues kryesor në rimbëkëmbjen e ekonomisë së vendit.

1.6-Migrimi si pasojë e 'krizave piramidale': 1997-2000

'Firmat piramidale kishin filluar të vepronin që në fillim të viteve 1990, por në verën dhe vjeshtën e vitit 1996 veprimtaria e tyre u zgjerua në mënyrë dramatike. Mijëra individë depozitonin kursimet e veta në skemat piramidale, që premtonin fitime që nuk ishin parë ndonjëherë' (Biberaj; 2001; 479).

Emigrantët shqiptarë, dërgonin një pjesë të madhe të fitimeve për të përballuar nevojat që kishin familjet e tyre në Shqipëri. Një pjesë e madhe e të ardhurave u investuan në firmat piramidale private, të cilat u fuqizuan rreth viteve 1995-1996. Numri i këtyre firmave piramidale u rrit shumë për shkak të kërkesave të individëve, sepse politikat e tyre kishin të bënin me interesin e lartë që ato u ofronin huadhënësve. 'Në fund të vitit 1996, interesat e këtyre firmave piramidale që u ktheheshin huadhënësve u rrit deri në 50 për qind të shumës së dhënë. Një pjesë të madhe të fitimeve të emigrantëve, i arkëtuan në këto firma piramidale me idenë që të bëheshin sa më shpejt të pasur. Ky lloj mashtrimi ekonomik dhe dëshira për t'u bërë sa më shpejt i pasur shumë shpejt pësoi një tronditje dhe më vonë falimentim.

Falimentimi i firmave piramidale në vitin 1997, solli probleme ekonomike, politike dhe sociale të cilat u finalizuan me revolta të armatosura dhe luftë civile. Lufta civile dhe kaosi në shoqërinë shqiptare të vitit 1997, u pasua prej një tjetër eksodi emigrantësh të madh. 'Në fillim në brigjet Italiane u pranuan rreth 10,600 emigrantë të padokumentuar

(Vullnetari; 2007: 34). Këta emigrantë strehoheshin në kampet e emigrantëve në Itali, por më vonë kishin të drejtë të lëviznin drejt shteteve Evropiane si Francë, Belgjikë, Gjermani etj. Më vonë eksodi i vitit 1997 u ndalua nga politikat e emigracionit të shtetit italian. Megjithatë, individët vazhdonin të emigronin në mënyrë ilegale edhe pas tragjedisë së 'Otrantos ku 340 emigrantë shqiptarë humbën jetën nga fundosja e anijes në detin Adriatik' (UNDP-Albania 2000; 37). Edhe pas kësaj tragjedie emigrimi drejt Italisë (në mënyrë ilegale) ka vazhduar deri në periudhën e legalizimit të vizave drejt vendeve evropiane.

Ndërsa, sa i përket emigrimit drejt shtetit grek, në këtë periudhë nuk ka qenë aq e madhe sa në Itali. Shkak për këtë janë politikat diskriminuese, por edhe rreptësia të moslejimi i emigrantëve ilegalë të punojnë në këtë vend.

'Fluksi i lëvizjeve migratore ka vazhduar edhe pas viteve 1997, megjithëse ka njohur rënie të konsiderueshme. Në vitet e fundit ka pasur, veçanërisht, një rënie të vazhdueshme të emigracionit të paligjshëm për shkak të forcimit të kontrollit kufitar, intensifikimit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përmirësimit të kushteve social-ekonomike në Shqipëri dhe stabilitetit politik dhe rendit publik' (Ikonimi; 2009:15). Pra, siç e shikojmë kjo periudhë kohe ka reflektuar si një 'krizë' jo vetëm nga ana ekonomike, por edhe nga ana socio-kulturore e cila ka reflektuar edhe nëpërmjet numrit të madh të rrymave emigratore drejt vendeve të ndryshme të botës.

1.7- Emigrimi shqiptar prej viteve 1999 deri në ditët e sotme

Pas vitit 1999, së bashku me fillimin e stabilizimit e qeverisjes dhe politikës shqiptare, filloi edhe stabilizimi shoqëror. Stabilizimi shoqëror ka lidhje të drejtë për drejtë me rifillimin e një kontrolli social. Kjo situatë jo vetëm që nuk ishte më e njëjta me vitet e mëparshme, por gjithashtu filloi riperceptimi i vlerave sociale në një shoqëri, e cila vazhdon deri në ditët e sotme.

Sipas Ikonimit, edhe pas 21 vite të rënies së regjimit komunist, emigrantët (numri i emigrantëve jashtë Shqipërisë është afërsisht 860,485 ose rreth 27.5% të popullsisë (Ikonimi; 2009: 15) janë akoma duke u përballur me problemet e emigracionit, prej politikave të ndryshme të vendeve pritëse, prej kontrollit social (përfshirë këtu edhe opinionin e individëve të ndryshëm) të shoqërive ku kanë emigruar, prej mungesës së njohjes së të drejtave si dhe prej mungesës së gjetjes së një vendi të qëndrueshëm të punës. Ashtu, siç parashtron edhe Vullnetari, e cila është bazuar në të dhënat e MOLSAEO që janë afërsisht 750000 deri në 1.1

milion emigrantë Shqiptar që jetojnë prej vitit 1999 deri në vitin 2000 jashtë Shqipërisë. Një pjesë e madhe e tyre jetojnë në Greqi dhe Itali (Vullnetari; 2012: 15). Sipas raporteve të NID, numri i emigrantëve shqiptarë në vitin 2010 ka arritur numrin 1.7 milion. Pra, duke u referuar edhe te të dhënat do të vihet re se ekziston një diskutim rreth shifrave ekzakte të emigrantëve shqiptarë. Kjo ndodh si rezultat i mospasjes së një qendre të mirëinformuar me numrin e emigrantëve, por edhe me mungesën e studimeve kërkimore rreth kësaj teme. Megjithatë, sipas këtyre statistikave do të vëmë re se numri i emigrantëve shqiptarë është ndër më të lartët në arenën e Ballkanit.

‘Ndër shkaqet e lëvizjeve migratore të viteve të fundit renditen pagat më të larta, mbështetja financiare e familjes, kushte më të mira pune, kushte më të mira jetese, kushte më të mira arsimimi për vete apo për pjesëtarët e tjerë të familjes, si edhe në periudha të caktuara për shkak të nivelit të sigurisë dhe rendit në vend. Ndërsa, përzgjedhja e vendit të destinacionit ka të bëjë me faktorë, si: lehtësia për të gjetur punë, afërsia gjeografike, lehtësia e hyrjes në vendin pritës, të afërm që jetojnë në vendet ku ata emigrojnë, njohja me mundësitë për arsimim dhe përmirësimi i aftësive profesionale, mundësia për të punuar në profesionin e tyre dhe paga më të mira në krahasim me vende të tjera (Ikonimi; 2009;22). Në tabelën e mëposhtme (tabela numër 1) do të vërejmë disa statistika rreth numrit të emigrantëve shqiptarë nga viti 1990-2005 dhe vendeve që kanë emigruar në këtë periudhë kohe. Këto statistika kanë burim IOM, ku tregohet se numri më i madh i emigrantët shqiptarë janë fokusuar drejt vendeve fqinje siç janë Greqi dhe Itali.

Tabela 1: Të dhënat rreth numrit të emigrantëve shqiptarë prej vitit 1999 deri në vitin 2005 (IOM; 2007:7)

VENDI	1999	2005
Greqi	500,000	600,000
Itali	200,000	250,000
SHBA	12,000	150,000
Britania e Madhe	5,000	50,000
Gjermani	12,000	15,000
Kanada	5,000	11,500
Belgjika	2,500	5,000
Turqi	1,000	5,000
Franca	2,000	2,000
Holanda	2,000	2,000
Zvicër	1,000	1,500


Holanda	?	1,000
Gjithsej	742,500	1,093,000

Vende të tjera me një numër të madh emigrantësh janë edhe SHBA, Britani e Madhe, Kanada etj. Numri i shqiptarëve emigrantë është rritur në masë në periudhën kohore 1999-2002 në SHBA dhe në Kanada, për shkak të politikave për tërheqjen e emigrantëve nëpërmjet lotarive. Prej këtyre politikave numri i emigrantëve arriti 150000 në SHBA dhe 11500 në Kanada. ‘Vërehet gjithashtu, një rritje e emigrimit të rregullt për në Kanada e Shtetet e Bashkuara të Amerikës si rezultat i programeve specifike të këtyre shteteve, si edhe rritje e emigrimit sezonal në vendet fqinje’ (Ikonimi; 2009:11).

Përveç shteteve perëndimore të cilët emigrantët shqiptarë preferojnë të zgjedhin për të emigruar, është edhe Turqia. Ky shtet lindor (duke u referuar pozitës gjeografike të Turqisë, por edhe opinionit që shqiptarët kanë për këtë vend) ka tërhequr shumë emigrantë shqiptarë, numri i të cilëve ka arritur 5000 në vitin 2005. Fenomeni i emigrimit drejt vendit turk është pothuajse i panjohur për shoqërinë shqiptare, pra informacionet e emigrimit të shqiptarëve drejt këtij vendi janë shumë të pakta.

Studiues të tjerë të emigracionit shqiptar janë Azzati dhe Carleto, të cilët nëpërmjet punimeve të tyre kanë identifikuar disa të dhëna rreth numrit të emigrantëve shqiptarë duke filluar prej vitit 1991 deri në vitin 2005 (shih figurën numër 1)

Figura 1: Numri i emigrantëve shqiptarë dhe vitet që kanë emigruar (Azzari & Carleto; 2009: 16)



Pra, duke analizuar këto shifra të emigrimit shqiptar drejt vendeve të ndryshme të botës mund të themi se emigrimi gjatë viteve 1999-2000 numri i individëve që kanë emigruar është rritur në masë. ‘Ndërsa bashkë me stabilizimin politik, ekonomik dhe social do të vërejmë se pas vitit 2000 ka një rënie të largimit nga Shqipëria të individëve’ (Azzari & Carleto; 2009: 16).

Megjithatë, përsëri në statistikat e emigrimit ka përplasje. Sipas Vullnetarit shifrat e individëve që kanë emigruar pas vitit 2000 nuk kanë pësuar një ulje, por përkundrazi kanë pësuar një rritje (shiko tabelën numër 2). Sipas tabelës numër 1 në shtetin grek ku ka ndodhur një rritje të numrit të emigrantëve shqiptarë prej 500000 në vitin 1999 deri në 750000 në vitin 2010. Gjithashtu, po të analizojmë emigrimin shqiptar në Itali, në vitin 1999 numri i emigrantëve ishte 200000, në vitin 2005 ishte 2500000 dhe në vitin 2010 ishte 450000. Ndërsa, në SHBA numri i emigrantëve shqiptar në vitin 1999 ishte 12000, një rritje të madhe pësoi gjatë vitit 2005 me 150000 emigrantë dhe 400000 ishte numri i emigrantëve në vitin 2010. Interesante është numri i emigrantëve në shtetin turk, ku prej 1000 emigrantë që ishin në vitin 1999, numri i tyre u shtua në 5000 gjatë vitit 2005. Sipas statistikave ky numër nuk ka pasur rritje, por as ulje deri në vitin 2010. Edhe fenomeni i emigrimit drejt Turqisë ka pasur një vijëzim konstant. Për një analizim më të hollësishëm rreth këtij fenomenin do diskutohet në pjesën më poshtë të këtij kapitulli.

Tabela 2: Treguesit e numrit të shqiptarëve që jetojnë jashtë gjatë viteve 1999, 2005 dhe 2010 (Vullnetari; 2012: 25)

Vendi	1999	2005	2010
Greqi	500.000	600.000	750.000
Itali	200.000	250.000	450.000
SHBA	12.000	150.000	400.000
Britania e Madhe	5.000	50.000	50.000
Gjermani	12.000	15.000	15.000
Kanada	5.000	11.500	15.500
Belgjik	2.500	5.000	5.000
Turqi	1.000	5.000	5.000
Francë	2.000	2.000	10.000
Austri	2.000	1.500	2.500
Zvicër	1.000	1.000	1.500
Hollandë	?	1.000	1.000
TOTAL	742.500	1.093.000	1.705.500

1.8-Integrimi evropian si ndikues i rëndësishëm në historinë e emigrimit shqiptar

Pas mundësimit të liberalizimit të vizave për lëvizjen e lirë në vendet e Bashkimit Evropian, emigrimi shqiptar është kthyer në një oaz mundësish dhe sfidash jo vetëm për emigrantët, por edhe për shoqërinë shqiptare. Përzgjedhja e destinacionit për emigrim është e lidhur me faktorë nxitës dhe tërheqës të tillë si: lehtësia për të siguruar punë, afërsia gjeografike, lehtësia e hyrjes në vendin pritës, të afërmit që jetojnë në vendet ku

ato migrojnë, njohjen e mundësive për të punuar në profesionin e tyre dhe pagat më të mira në krahasim me vendet e tjera (Ikonimi; 2009: 13).

Strategjia Kombëtare e Migracionit ka analizuar ndikimin e migrimit në këto fusha kryesore:

1. Emigrimi dhe demografi;
2. Impakt në ekonomi;
3. Ndikimi në tregun e punës;
4. Ndikimi në politikës e brendshme
5. Ndikimi në politikën e jashtme (Ikonimi; 2009: 14-15).

Këto ndikime formojnë sfida të reja dhe mundësi të procesit të emigrimit. Është shumë e rëndësishme të thuhet se integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian formon rindërtimin e procesit të emigrimit shqiptar. Sipas Brody, procesi i integritit të emigrimit duhet të ndjekë një nga disa modelet. Secili prej këtyre modeleve të integritit të përballet me çështjet e gjuhës, kulturës dhe identitetit të shtetësisë në mënyra krejtësisht të ndryshme dhe mund të parashikonte një vazhdimësi me asimilim (Brody; 2009: 20). Por, aplikimet e emigrimit shqiptar nuk kanë pasur një, por shumëllojshmëri modelesh integrimi që ndonjëherë kanë reflektuar dhe me anomi sociale në shoqërinë tonë dhe pritëse.

Integrimi i emigrantëve brenda vendit pritës po përballet me “vazhdimësinë e integritit” i cili është procesi i asimilimit dhe akulturimit të shoqërisë. Ky proces sjell sfida për identitetin e emigrantit. Për këtë arsye, gjatë gjithë kohës emigrantët u sfiduan me stigmatizimin ose duke u optimizuar gjatë jetës së përditshme. Sfidat e tyre më të ballafaquara janë diskriminimi në etninë e tyre (siç janë emigrantët shqiptarë në shoqërinë greke, por edhe me përdorimin e fjalës ‘shqiptar’ me elemente negative në shoqërinë italiane). Një tjetër sfidë e emigrimit shqiptar është ndikimi në politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit tonë dhe vendit pritës. Në vendin tonë, ka mungesë të pjesëmarrjes së emigrantëve në procesin politik, për shembull pjesëmarrjes në procesin e votimit. Për këtë arsye vitet e fundit janë stimuluar politikën për riorganizim i politikave rreth tërheqjes së punonjësve migrantë shqiptarë për të marrë pjesë gjatë procesit të votimit.

Përveç, këtyre sfidave të realizuara prej migrimi duhet të thuhet se “ndër shkaqet e emigrimit gjatë viteve të fundit renditet paga e lartë, mbështetja financiare, kushte më të mira të jetesës, kushte më të mira për mundësimin e arsimimit, niveli i sigurisë dhe rendit në vend” (Ikonimi; 2009: 13). Pas kandidimit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian mënyra e të menduarit i një emigranti shqiptar ka ndryshuar. Janë formuar politika të reja

në drejtim për zvogëlimin të diskriminimit në vendet pritëse dhe në vendin e tonë janë formuar politika të forta për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë në vendet e ndryshme. Punëtorët emigrantë gëzojnë trajtim të barabartë me shtetasit e vendeve pritëse për kushtet e punës, pagesën e sigurimeve shoqërore, anëtarësimin në sindikata, pavarësisht racës, kombësisë, gjinisë dhe fesë (Ligj nr. 9668, Neni 17, datë 18.12.2006). Ekziston një lidhje e fortë midis procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe emigrimit shqiptar. Ky proces luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe prioriteteve në fushën e emigrimit. Kushtet e emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse kanë garantuar të drejtat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit dhe kanë lehtësuar procesin e aplikimit për vizë. Si pasojë ata janë konsideruar si detyrë prioritare e shërbimeve diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe qeverisë si një tërësi (Ikonomi;2009:15).

Pra, si konkluzion mund të thuhet se integrimi evropian është mbështetur në modeli kulturor pluralist për emigrantët shqiptarë, veçanërisht pas liberalizimit të vizave. Të inkurajuar, ata mundësojnë të përvetësojnë këtë model, por dhe do të mësojnë të gjuhën shqipe nëpërmjet qendrave dhe shoqatave kulturore shqiptare të hapura në Itali, Greqi etj, për të transmetuar fenë, kulturën, traditat dhe zakonet nga një brez në tjetrin. Politikat e implikimit bëjnë që identiteti i emigrantit shqiptar të jetë siguria. Ky riorganizim i politikave të emigrimit gjatë integrimit evropian jep mundësinë jo vetëm për emigrantët shqiptarë, por u jep mundësi të gjitha vendeve evropiane nëpërmjet politikave që duhen respektuar duke parandaluar rrjedhën e emigrimit të paligjshëm.

PËRFUNDIME

Një përmbledhje të kronologjisë së emigrimit shqiptar në vite, jep mundësinë e diskutimeve dhe

BIBLIOGRAFI

- Aydemir, M. A., 2011, *Sosyal Sermaye: Topluluk Duygusu ve Sosyal Sermaye Arastirmasi*; Konya: Cizgi kitap evi yayinlari.
- Fuga, A. 2000, *Shoqëria Periferike*, Tiranë: Botimet Ora.
- Brody, B. 2009. *Opening the Door, Immigration, Ethnicity and Globalization in Japan*, East Asia History, Politics, Sociology, Culture Institute.
- Borchert, J.G 1975, *Economic development and population distribution in Albania*; Geoforum, 6 (3-4): 177-86.
- Bërxfholi, A. 2000, *Regjistrimet e përgjithëshme të popullsisë në Shqipëri, vështrim historik*, Tirana: Akademia e shkencave, Qendra e Studimeve gjeografike.
- Azzarri, C. & Carleto, C., 2009, *Modeling Migration Dynamics in Albania*, Policy Research Working Paper 4945, The World Bank: Development Research Group, Poverty and Inequality Team.
- Ikonomi, L., 2009, *E Drejta Migratore*, Manual Trajnues, Tiranë: IOM.
- Biberaj, E. 2001, *Shqipëria në tranzicion: Rruga e vështirë drejt demokracisë*; Tiranë: Botimet Ora.
- Hall, D. 1994, *The Albania and Albanians*, London: Printer.

debateve jo vetëm për ndikimin e këtij fenomeni në shoqëri, por edhe për emërtimin e një trajektoreje shumë të çrregullt të këtij procesi. Vetë emigrimi shqiptar është një oaz mundësish, por që në vetvete përmban një numër të madh sfidash për strukturën e shoqërisë shqiptare, për vlerat, traditat, zakonet, por edhe për vetë dinamikën e shoqërisë.

Duke parë që kontrolli i lëvizjeve demografike brenda vendit kanë qenë rreptësisht të kontrolluara gjatë kohës së regjimit komunist, atëherë është shumë kontradiktore të flitet për lëvizje migratore jashtë Shqipërisë. Ky lloj kontrolli kishte mundësuar një formë ose trajektore të lëvizjeve demografike shumë të centralizuar, e cila reflektonte edhe në stabilitetin social dhe pranimin e obliguar të mënyrës së jetesës dhe vendbanimit. Prej këtij kontrolli të centralizuar dhe tepër totalitar gjatë viteve të regjimit komunist, shqiptarët u përballën me një realitet tepër të liberal dhe të pa kontrolluar për lëvizjet demografike.

Ashtu siç Fuga e thekson se shoqëria shqiptare u ndodh përpara një sfide me shumë përmasa çka e bënte urgjente dhe të domosdoshme ndërmarrjen e transformimeve të thella shoqërore, politike dhe ekonomike (Fuga; 2000: 31). Emigrimi ishte i fokusuar në një model imagjinar si 'arratisje prej Shqipërisë drejt vendeve 'parajsas''. Pikërisht ky model imagjinar mundësonte nxitjen e emigrimit shqiptar në masë, që prej vitit 1990 deri në ditët e sotme. Ndryshimet e forta të uljeve dhe ngritjeve të numrit të largimit të individëve për qëllime migratore formuan destabilitet demografik, por edhe social, të cilat reflektuan më vonë edhe me anomitë dhe turbulenca socio-kulturore të shoqërisë shqiptare.

IOM, 2008, Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer; Tiranë: IOM Albania.

IOM. (2007); The republic of Albania, Migration Profile; Slovenia: Ministry of the Interior of the Republic of Slovenia.

Vullnetari, J. 2005, Albania on the move: Links between Internal and International Migration; Amstredam University press.

Vullnetari, J. 2007, Albanian migration and Development: State of the Art Review, IMISCOE Working Paper No. 18.

Konidaris,J. 2005, Examining policy responses ti immigration in the light of interstate relations and foreign policy objectives: Greece and Albania, in King, R. Mai, N. and Schwandner-Sievers,S (eds) The New Albanian migration, Brighton: Sussex Academic Press.

Barjaba, K. 2003, Shqipëtarët këta ikës të mëdhenj, Tirana: Korbi

Kuvendi Popullor I RPSSH (12/6/1990), Për lëshimin e Pasaportave për Jashtë Shtetit dhe Dhënien e vizave, Dekreti nr 7393, Tirana: Qendra e Publikimeve Zyrtare..

Për Emigrimin E Shtetasve Shqiptarë Për Motive Punësimi, Ligj Nr.9668, Article 17, datë 18.12.2006).

King, R, 2005; Migration in post-1990 Albania, A Facilitator of socio Demographic Change Triggered by Post Communist Transformations.

Sjoberg, O, 1994, Rural retention in Albania: administrative restrictions on urban-bound migration, East European Quarterly, 28 (2).

UNDP, 2000, Albanian human development report 2000, Tirana: UNDP Albania.

Dervishi, Z. 2008, Lente të ndërveprimit Simbolik: Analizë sociologjike e rolit të simboleve kulturore, të komunikimit jo verbal; Tirana:Shtëpia Botuese Emal.

Dervishi, Z. 2001, Urbanizimi i Jetës së popullsisë fshatare apo ruralizimi i qyteteve? Rasti i Tiranës; Politika & Shoqwria, 1(8):33-42 pg. 34.

TJETËRSIMI I KULTURËS SHQIPTARE GJATË REGJIMIT KOMUNIST

MINE BALLIU

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Punimi ynë do të jetë i fokusuar mbi situatën e kulturës në Shqipëri, gjatë periudhës diktatoriale komuniste (1944-1990), në projektionin e filozofisë së Hannah Arendt, e cila studioi shoqëritë dhe regjimet totalitare, katastrofën që ato shkaktuan, si në dimensionin ekonomik, njerëzor e kulturor. Rasti i vendit tonë është rast tipik i shkatërrimit të kulturës dhe artit. Gjatë regjimit komunist gjithçka nisi nga e para, u mohua e kaluara, kultura, tradita, veçanërisht ajo fetare, mbi të gjitha kultura e tradita kishtarë. Regjimi komunist krijoi një kulturë e art të "ri", sipas një modelit të Realizmit Socialist, ku partishmëria proletare dhe heroi pozitiv, ishin tiparet e saj thelbësore. Arti dhe kultura u vunë në shërbim të vetë regjimit artistët, institucionet dhe njerëzit e kulturës u detyruan të bënin propagandën e Partisë. Ata që kundërshtuan, u dënuan, burgosën e u pushkatuan. Diktatura mohoi të kaluarën, ndryshoi tekste, përdoqi klerikët, shkatërroi objektet shekullore të kultit. U luftua çdo formë moderne e çdo ndikim i kulturës perëndimore dhe u zëvendësua me një kulturë të tipit "revolucionit kulturor". E gjithë kjo përpjekje, ky shkatërrim nuk mundi ta zhdukë e ta tjetërtojë trashëgiminë shpirtërore, sidomos folklorin, që ishte e mbetet ura lidhëse në çdo kohë e në çdo regjim e sipas Arendtit, kjo trashëgimi shpirtërore është një dimension themelor i kulturës evropiane.

Fjalët çelës: Hannah Arendt, Shqipëri, art, komunizëm, kulturë.

Abstract

This study is focused on the situation of culture in Albania during the communist dictatorship (1944-1990), as well as on the projection of the philosophy by Hannah Arendt, who studied societies and totalitarian regimes, the catastrophe they caused in the economic, cultural and human dimensions. The Albanian case is typical of the destruction of culture and art. During the communist regime everything started from the beginning, the culture and tradition were denied, especially religious culture. The communist regime created a "new" culture and art, according to a model of socialist realism, where proletariat and the positive hero were its essential features. Art and culture were put in the service of the regime itself. Artists, cultural institutions and people were forced to make propaganda of the Party. Those who opposed were convicted, imprisoned and executed. Dictatorship denied the past, changed the historical texts, persecuted the clergy, and destroyed the cult objects. Every modern form of any influence of Western culture was fought and was replaced with a culture of "cultural revolution" type. But, all this effort, this disaster, could not destroy and alienate the spiritual heritage, especially the folklore, which was and remains the linking bridge at any time in any regime. As Arendt says, this spiritual heritage is a fundamental dimension of European culture.

Key words: Hannah Arendt, Albania, arts, communism, culture

HYRJE

Hannah Arendt, përveç analizës së totalitarizmit nga pikëpamja e llojit të ushtrimit të pushtetit nëpërmjet terrorit masiv, do të tërheqë vëmendjen edhe për dominimin e këtij lloji pushteti edhe në një fushë tjetër, që nuk është më pak e rëndësishme, siç ishte kultura. Kjo gjë ndodhi në të gjitha shtetet totalitare në fillim të shekullit XX. Në Gjermani, në Itali, apo në Bashkimin Sovjetik, letërsia, kinemaja, teatri, filozofia apo artet në tërësi, gjithçka u vu në shërbim të sistemit, propagandës, për të përmbushur synimet politike. Në esetë politike të përmbledhura në librin "*Ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes*", filozofja i kushton një rëndësi të veçantë edhe përçudminimit që iu bë kulturës, duke arritur ta shndërrojë atë në një objekt konsumi imediat.

"*Kriza e kulturës*", eseja specifike ku Arendt analizon domethënien e kulturës, rëndësinë dhe degradimin që iu bë me futjen e masivizimit të saj,

tregon qartë pasojat e një sistemi politik, që arrin të shkatërrojë jo vetëm individin në thelb, por arrin të ndryshojë edhe identitetin e tij kulturor dhe rreket të orientohet drejt së ardhmes, duke mohuar kështu, rëndësinë thelbësore të traditës që për Arendt (por, edhe autorë të tjerë si p.sh., J. Herder), ajo është një nga pikat më të rëndësishme për të kuptuar të ardhmen. Në kundërshtim tërësor me këtë gjë vijnë totalitarizmat, ato shfarosin të kaluarën për të ngritur në pedestal bëmat e ditëve, viteve e dekadave që jetojnë vetë. Mendojnë se historia u përket vetëm atyre dhe se ajo mund dhe duhet të fillojë vetëm me ardhjen e tyre në pushtet. Duke e shtrirë më tej analizën e Arendt, duke u nisur nga idetë dhe konkluzionet e saj, rasti i Shqipërisë është rast tipik i një sistemi diktatorial, ku kultura dhe artet, në tërësi, kanë pësuar thuajse të njëjtat ndryshime, kanë përjetuar po atë krizë për të cilën flet Arendt.

Kriza e kulturës shqiptare në këtë punim është parë dhe analizuar në këtë prizëm, së pari si një propagandë e vënë në shërbim tërësisht të sistemit diktatorial, së dyti si tjetërsim i traditës, i shkatërrimit të vlerave më të mira të arritura në sa e sa breza për qindra vjet, së treti si një kulturë tërësisht e manipuluar, e tjetërsuar, thjesht një kulturë zbatimjeje për masat, për të mbuluar defektet e sistemit. Duke qenë se analizoj filozofinë e Hannah Arendt, ku edhe kultura ishte pjesë e totalitarizmit që trajton ajo në veprat e saj, ne e kemi më të lehtë të vërtetojmë atë që Arendt analizon, sepse mjafton të hedhim një vështrim në të kaluarën e afërt dhe filozofia e saj na vjen shumë reale. Ndryshe filozofia e saj mund t'i dukej një populli që nuk ka përjetuar diktatura e totalitarizma, pikërisht për këtë qëllim kam zgjedhur kulturën që duket sikur qëndron në hije, në momentin kur vepron dhuna e terrori por që në fakt sistemi e përdor si mburojë për të manipuluar dhe justifikuar faktet.

1. Kultura si propagandë

Nëse në Evropën Perëndimore e më gjerë intelektualët, njerëzit e shquar janë pjesëmarrës dhe përcaktues në shumë ngjarje të mëdha, në vendet ku ushtrohet një pushtet i dhunshëm, elita intelektuale, përjashtohet. E njëjta gjë ndodhi edhe në vendin tonë gjatë periudhës diktatoriale. Njerëzit e kulturës dhe artit, ata që realisht mund të japin shumë nga krijimi i tyre artistik, u mënjanuan nga pushteti, sepse gjithçka, ashtu si edhe kultura, u vu në shërbim të tij. Kështu, rrjedha e ndryshimit, manipulimit dhe shkatërrimit do të përfshinte edhe këtë aspekt të veçantë njerëzor. Regjimi i ri arriti të transformonte jo vetëm mënyrën e organizimit të qytetarëve, jetesën e tyre, por të hynte madje aq thellë sa të ndryshonte mënyrën e të menduarit, të përjetuarit dhe të shfaqurit. Këto të fundit përpos edukimit shkollor, mund të kultivohen edhe nëpërmjet kulturës, njohjes së saj dhe lidhjes me të. Në këtë periudhë hyn në përdorim edhe termi *kultura e masës*, i cili ishte një fenomen i ri, i ardhur bashkë me idetë marksiste. Meqenëse u projektua një shoqëri e masave, atëherë kjo lloj shoqërie kishte nevojë që edhe kultura të ishte pjesë e saj, të masivizohej dhe të arrinte atë nivel që masa ta kuptonte. "Gjithë puna kulturore, arsimore, e artistike, theksonte Partia, duhet të na vlejë, në radhë të parë, për të realizuar qëllimin themelor, edukimin e komunistëve dhe të gjithë punonjësve me frymën e lartë klasore, revolucionare marksist-leniniste" (*Dokumente kryesore të PPSH*, Vëll V, "8 Nëntori", Tiranë 1973, fq. 159).

Duke qenë se ideologjia ishte tipari thelbësor i totalitarizmit, sipas Hannah Arendt, në diktaturë nuk

kishte sesi arti të mos përfshihej apo të lihej jashtë saj. Që të ekzistonte ai duhej patjetër që të zhvillohej sipas ideologjisë, Partia e diktatori kujdeseshin direkt, e në mënyrë të veçantë për këtë. Madje, arri deri aty sa mendohej e shprehej se artistët e shkrimtarët i bëri Partia, udhëheqësi dhe për këtë ata duhej t'i ishin atij mirënjohës. Në këtë lloj sistemi Partia e quan veten pronare të jetës së secilit qytetar, por edhe përcaktues të vlerave të tij.

"Partia ishte ajo që të veçonte nga të tjerët, nga masa. Ishte Partia që të bënte shkencëtar apo artist, jo aftësia jote" (*Velo, Maks, "Ese për diktaturën", "55", Tiranë 2003, fq 42*). Kështu, komunizmi kishte krijuar një lloj barazie edhe në art, një lloj klase të privilegjuar që kishte tipare dhe arritje të njëjta. Askush më shumë e më pak sepse duke barazuar aftësitë, e mendimet e kishte më të lehtë të caktonte vlerësimet për vete dhe të tjerët. Është fakt se shkrimtarët dhe artistët e zakonshëm tërhiqen nga diktatura dhe diktatura e ka më të lehtë t'i përdorë. Ata krijojnë jo për vete, jo për artin, por për t'i thënë diktatorit se janë të aftë për t'i marrë në shërbim.

Metoda e realizmit socialist, duket sikur ka parësore të saj pasqyrimin me vërtetësi të realitetit, por që në fakt nuk është ashtu, arti dhe letërsia e krijuar në diktaturë, në Shqipëri dëshmoi të kundërtën. Artistët u bënë pasqyrues të një realiteti të propaganduar, të lustruar ndërkohë, që vetë realiteti dëshmonte tjetër gjë. Ishte "detyra" e artisteve e imponuar nga sistemi që të lustronin realitetin, të trumbetonin lirinë që nuk ishte, të justifikonin dhunën, terrorin, luftën e klasave, të glorifikonin udhëheqësin e madh dhe sistemin që mbante ai, të mashtronin masat për rrugën ku po ecnin. Arti dhe letërsia që lindi në këtë periudhë kishte në bazë të saj një ngarkesë banaliteti.

Periudha afër gjysmëshekullore në Shqipëri prodhoi një sërë artistësh që në themel të punës, nuk vlerësoheshin për atë se çfarë ofronin nga pikëpamja artistike, por punën që bënin në pasqyrimin e realitetit sipas udhëzimeve shtetërore. Ata u quajtën punonjës të letërsisë dhe arteve, pra thjesht punëtorë, jo krijues se i vetmi krijues ishte udhëheqësi i shtetit. "Nën udhëheqjen e Partisë, punonjësit e letërsisë dhe arteve të bëjnë atë punë të thellë ideologjike, politike, morale dhe etike që lypset për të luftuar ndikimet dhe helmet e botës së vjetër dhe asaj kapitaliste revizioniste aktuale... Ata të luajnë kurdoherë rolin e ndihmësit të Partisë për formimin e njeriut të ri." (*Hoxha, Enver "Për letërsinë dhe artet", "8 Nëntori", Tiranë 1975, fq. 477*). Kjo ishte porosia që vinte nga vetë diktatori dhe që bëri të krijohej një lloj arti i prapambetur, mediokër, që nuk u ballafaqua dot me Perëndimin e

nuk i kapërceu kurrë kufijtë e tij shtetërorë. Për fat të keq arti u bë një penelat që vetëm lustronte realitetin, himnizonte diktaturën, pushtetin, dhe diktatorin. Në këtë kurth ideologjik ranë, jo me dëshirë edhe disa artistë të shkolluar në Perëndim e që kishin një tjetër frymë. Disa prej tyre heshtën, u mënjanuan, apo u vetëcensuruan ishte minimumi i një lloj vetësakrificimi në kushtet e një diktature të dhunshme.

2. Shkëputja nga tradita

Në pamje të parë dukej sikur ky art i ri që kishte lindur, sipas modelit të njeriut të ri të Partisë shkonte në vijimësi të traditës, kulturës shekullore të këtij kombi. Madje edhe udhëzimet e diktatorit ishin në këtë linjë “as një njeri nuk ka të drejtë të pengojë novatorizmin, por njëkohësisht nuk duhet të hidhen poshtë traditat e mira të së kaluarës” (*Hoxha, Enver. 1975*). Arti popullor deklarohet si baza dhe frymëzimi i artistëve, por nga ana tjetër nuk lejohej fryma primitive dhe naive që barte ky art popullor. U bënë ndërhyrje e manipulime, në muzikë këngët popullore u deformuan, u hoqën vargje të tëra, u shtuan të tjera në interes të politikës, u falsifikuan heronj e ngjarje, u krijuan modele të tjera popullore me frymë të lartë partishmërie. Arti mori rolin e edukimit dhe të zbavitjes, dëgjohej muzike që të argëtonte e në të njëjtën kohë të edukonte për të qenë sa më pranë Partisë Për të “stimuluar” gjoja folklorin, zhvilloheshin çdo pesë vjet festivalet folklorike, ku më shumë se 2/3 e krijimeve ishin për partinë dhe udhëheqësin. “Por, nëse objektet janë modifikuar, natyra e tyre është ndryshuar: nuk kemi të bëjmë më me një shpërndarje të saj në masë, por kemi një shkatërrim të kulturës, i realizuar në radhë të parë vetëm për argëtim” (*Hoxha, Enver. 1975, fq. 477*).

Në fakt, problemi i konservatorizmit të traditës është edhe në perëndim, në shoqëritë e civilizuar. Por, diferenca më e rëndësishme mes një shoqërie të civilizuar dhe shoqërisë së masave, nënvizon Hannah Arendt në librin e saj “*Kriza e kulturës*”, është se e para e do kulturën, nuk i vlerëson apo i mbivlerëson objektet si elemente të mirësisë sociale, ato përdoren për qëllime vetjake, egoiste, pra nuk i “konsumon”. Ndërsa shoqëria e masave konsumon prodhime të industrializuara të propagandës, duke i bërë pjesë të kulturës.

Duke qenë edhe vendi ynë në llojin e sistemeve që analizon Arendt, theksueshëm një fenomen i tillë përfshiu edhe kulturën e vendit tonë, në periudhën 1945-1990. P.sh, në artet figurative u ndalua arti mesjetar i ikonave dhe çdo interpretimi apo publikim i tij. Me ligj u ndalua feja dhe çdo lloj propagande ndaj saj. “Në të gjithë vendin u mbyllën 2035 objekte fetare, nga të cilat 740 xhami, 608

kisha e manastire, 157 kisha katolike, 530 objekte bektashiane” (*Dervishi, Kastriot “Historia e shtetit shqiptar 1912-2005”. “55”, Tiranë 2006*). U ndaluan autorë dhe vepra të rëndësishme kishtarë. U hoqën vepra, krijime erotike, dashurie dhe u ndaluan dhe u cunguan kryevepra të letërsisë botërore që bartin këto “dekadencia” të artit borgjez. “Nuk shtrohet çështja që duhet të mbyllem dyert për krijimet e autorëve të huaj përparimtarë. Por, ne duhet të dimë se çfarë duhet të marrim e si ta marrim atë, sepse nuk duhet të harrojmë se në përgjithësi nuk u përgjigjen kërkesave dhe nevojave tona dhe në mjaft raste përshkohen nga ide të huaja për socializmin, propagandojnë individualizmin dhe humanizmin borgjez” (*Dokumente kryesore të PPSH”. 1973, fq. 587*).

Art do të quhej i përshtatshëm për t’u transmetuar te publiku kur të përmbushte kriteret e partisë. Jo çdo lloj krijimi është i denjë që t’i serviret publikut. Në këtë periudhë kultura do të humbte vlerat e saj reale për t’u bërë një vegël që kishte vlerë vetëm nëse arrinte të konsumohej masivisht, pra të përçonte ato vlera edukuese që të ishin të thjeshta për t’u kuptuar nga të gjithë.

“...Në këtë proces vlerat e kulturës nuk ishin të ndryshme nga çdo gjë tjetër, ishin ato që kanë qenë gjithmonë, pjesë e vlerave imediate, si monedhat që këmbehen dhe kalojnë nga njëra dorë në tjetrën... objektet e kulturës janë vlera që ekzistojnë për të qenë të përdorura e për t’u këmbyer. Janë disa nga të mirat e konsumit të destinuar për t’u konsumuar saktësisht si të tjerat. Ato nuk mund të gjykohen në bazë të të njëjtave kriteret.” (*Arendt, Hannah “Ndermjet të shkuarës dhe të ardhmes”, Garaznti, Itali 1991, faqe 275*). Modeli i jetesës që diktohej nga shteti ishte i njëjtë për të gjithë, këtij modeli nuk mund t’i shpëtonte as kultura, ajo do të diktohej po njëllor dhe populli do konsumonte ato krijime e objekte kulturore që i shërbenin edukimit dhe që këtë gjë askush nuk mund ta dinte më mirë sesa partia.

3. Tjetërsimi, kultura si zbavitje

“Shoqëria e masave nuk kërkon kulturën, por argëtimin, dhe kjo përbën një kërcënim të tmerrshëm për kulturën, një kërcënim të tipit filistin të shoqërisë” (*Arendt. 1991, faqe 275*). Filistini për Arend e zhvesh kulturën nga vlerat e vërteta dhe e kthen atë në një lloj objekti që mund ta posedosh ta konsumosh apo edhe ta flakesh kur nuk të duket në nivelin e duhur si pjesë argëtuese. Pra, problemi kryesor në kulturën e shoqërive të masave qëndron në faktin se për ta bërë një kulturë argëtuese, duhet ta përshtatësh dhe ta modifikosh atë në atë shkallë sa masa ta kuptojë, kështu nuk bëhen përpjekje që masa të rrisë nivelin që ta kuptojë kulturën, por

njerëzit e kulturës duhet të ulen në nivelin e masës, pra ta modifikosh me qëllim që ta konsumosh sa më lehtë. “Kultura e masave lind kur shoqëria e masave bëhet zotëron objektet kulturore” (Arendt. 1991, faqe 267).

Në veprat dhe artin e asaj periudhe kishte shumë rëndësi pasqyrimi i realitetit të ri socialist. Madje vetë metoda krijuese mori emrin “*realizëm socialist*”, që u bë modeli i gjithë artistëve e krijuesve, si e vetmja metodë e ligjshme krijuese. Krijimtaria artistike e asaj kohe duke ecur përmes kësaj metode të të përshkuarit të realitetit, që jo rrallëherë vinte e manipuluar, nuk ishte gjë tjetër veçse një portretizim i fytyrës së pushtetit të asaj kohe dhe për këtë arsye ky lloj arti, sot mund të ofrojë vetëm vlerat dokumentare të asaj kohe, sesa një krijimtari artistike kulturore të mirëfilltë. Nuk pranohej art surreal, absurd, sepse totalitarizmat kanë frikë nga surealizmat, nga ëndërrimet, sugjestionet. Nuk është rastësi që shumë artistë e krijues u dënuan pikërisht për këto lloj krijimesh “absurde”, “surreale” që binin ndesh me realitetin socialist. Sipas shkrimtarit dhe piktorit të dënuar në burgjet komuniste, Maks Velo “janë rreth 146 shkrimtarë dhe artistë të dënuar nga diktatura komuniste”.

Në fakt shekulli XX ishte një shekull “i pasur” me diktatorë, sa të majtë ashtu edhe të djathtë. Shqipëria ishte pjesë e kësaj bote, ku diktatorët vuanin nga mania për pushtet e delir. Deliri i diktatorit shkon aq lart sa që ai duke sunduar në një vend krejtësisht të izoluar, të varfër, kërkonte të sundonte botën me ideologjinë, aq sa e vuri artin tërësisht në këtë përpjekje të tij. Monumente, buste, portrete, tablo, kompozime, opera, balete, romane, poema, këngë, të gjithë artistët zyrtarë të të gjitha fushave, profesionistë e amatorë, u vunë në garë kush e kush t’i shërbejë sa më mirë diktatorit.

E përbashkëta e diktaturave në shekullin XX ishte frika nga arti modern, që me gjithë kushtet e egra, u zhvillua aq sa mundi në Shqipëri, në mjedise të fshehta e artistë të veçantë, që rrezikuan për hir të asaj që realisht për ta përbënte krijimtari artistike. Mohimi i të gjitha rrymave moderne në letërsi e arte ishte një fenomen i zakonshëm në shoqërinë e masave. Fakti që u zhvilluan më shumë artet me karkater zbavitës, gjithëpërfshirës, si estradat, teatrot amatore, vatrën e kulturës, festivalet dhe takimet folklorike, gati – gati në çdo kooperativë e lagje, filmat dhe muzika e lehtë, e kapshme për të gjithë, flet më së miri për frikën e sistemit nga arti modern.

Disa artistë e shkrimtarë u munduan që në kushtet e egra të diktaturës të shpëtonin veten dhe veprën e tyre, rasti i Ismail Kadaresë ishte ndër të

vetmit që vepra e tij botohej në Perëndim në vitet 70-80. Ai i mbijetoi kohës “... kurthet kundër shkrimtarëve përbëjnë një nga njollat më të zeza në historinë e komunizmit botëror. Në Shqipëri ato kanë arritur kulmin për vetë faktin që janë ende të pazbuluara. Sepse të tillë, të pazbuluar vazhdojnë të jenë spiunët, artizanët e kurtheve bashkë me mjeshtrit. Dhe jo vetëm të pazbuluar. Ata janë shpesh të preferuarit e instituteve shtetërorë, katedrave dhe ministrive” (Kadare, Ismail “*Letra tragjike e Dhora Lekës*”. “*Shqiptarja.com*”, Tiranë, 25 prill 2014).

Artistët e shkrimtarët e tjerë që shfaqën talentin e tyre, edhe pse në shumë raste arti i tyre u komprometua me pushtetin e fati tragjik i krijuesve modernë ishte i pashmangshëm në një sistem diktatorial (Edhe pse duhet quajtur totalitar, për hir të të gjitha ngjashmërive të elementeve që ky lloj sistemi ka pasur me sistemet totalitare të analizuara nga H. Arendt). Ata që tentuan apo u përpoqën publikisht, e pësuan. U pushkatuan poetë, shkrimtarë, artistë dhe dhjetëra të tjerë vuanin në kampet e burgjet e shumta të vendit.

Në botën e qytetëruar asnjë artist modern, surrealist nuk e mohoi veprën e vet, sepse ishte një vepër e vërtetë arti, ndërsa në artin e realizmit socialist, pas ardhjes së demokracisë shumë artistë i mohuan veprat e tyre, madje disa i shkatërruan e i dogjën. “Komunizmi në Shqipëri jetoi aq sa jeton një njeri. Sistemet sociale që jetojnë kohën e një njeriu, nuk duhen të merren në konsideratë”, (Velo, Maks “*Ese për diktaturën*”. 2003, fq 82). Ato krijime kulturore të asaj periudhe qenë të krijuara për të përmbushur ato kërkesa të vendosura nga lart dhe kjo bëri që vlera e tyre të kufizohej vetëm për atë kohë.

Tjetërsimin në art e në kulturë që bëri diktatura në Shqipëri, është po aq i madh sa dëmi njerëzor, ku humbën jetën me mijëra persona për shkak të refuzimit të sistemit. Arendt nuk e përmendi asnjëherë rastin e Shqipërisë për hir të izolimit që kishte vendi ynë, askush nuk dinte se çfarë behej brenda këtij territori të vogël. Megjithatë edhe kultura mbetet një nga pikat e përbashkëta, ku dora e pushtetit, në sistemet e terrorit, ndërhyr dhe shkatërron gjithçka. Në vitin 1991 “Shqipëria gjendej e izoluar nga bota e jashtme, si rezultat i politikës së ndjekur nga pushteti dhe dërgje në një prapambetje ekonomike, sociale dhe kulturore që rezolucioni teknik i fundshekullit të XX e nxori në pah në mënyrë dramatike.” (Lakër, Uollter “*Europa në kohën tonë*”, “*Dituria*», Tiranë 2003, fq. 442). Kjo tregoi qartë trumbetimin e manipuluar të fakteve reale në artin e realizmit socialist.

PËRFUNDIME

Gjithë ajo periudhë kohore, me pasojat që solli në aspektin kulturor, duhet njohur për të rikuperuar këto dëme në art e kulturë në vendin tonë. Kjo gjë mund të arrihet vetëm duke iu rikthyer edhe një herë kulturës para 1945, apo edhe shumë më herët, duke rivendosur lidhjet me të kaluarën, me traditën dhe vlerat kulturore që na identifikojnë si popull. Mbështetja te tradita është mënyra që problemet e krijuara nga diktatura të rishihen si një model i importuar dhe i zvarritur për një gjysmë shekulli, duke e izoluar vendin jo vetëm fizikisht, por edhe kulturalisht, duke e detyruar të “ zhvillohet” nën diktatin e dhunës dhe të dogmatizmit. Kultura e vendit i tejkalon zvarritjet gjysmëshekullore, historia ka treguar se kultura jonë i ka rezistuar edhe pushtimeve disa shekullore. Nëse kthehesh pas në kohë do gjenden fijet që bëjnë lidhjen e të kaluarës

me të tashmen, për të vazhduar në hapat e historisë drejt së ardhmes. Arendt e kërkon me këmbëngulje njohjen e së kaluarës, sepse vetëm duke njohur atë që kemi kaluar mund të drejtohem drejt një të ardhme, ndryshe pra, për të mos u përsëritur e njëjta katastrofë. Shqipëria, pavarësisht sistemit politik që importoi nga Lindja, është një vend evropian që vlerëson kulturën dhe e kupton rëndësinë e saj në identifikimin që na jep ne si komb. Duke ruajtur vlerat dhe duke i trashëguar të paprekura nga ndërhyrjet e politikave dhe sistemeve drejt brezave të rinj, do të mund të prezantohemi në botën e qytetëruar. “Vendi im nuk asht në fundin e botës a diku në skajin e saj, por në Europë, ku farkëtohen fatet e qytetërimit perëndimor”, (Pëllumi, At Zef “Rrno për me tregue”, “55”, Tiranë 2006, fq. 12).

BIBLIOGRAFI

- Arendt, Hannah, 2006, “Gjendja njerëzore”, Dita, Tiranë, 2002 “Origjinat e totalitarizmit”, Dija, Prishtinë.
- Arendt, Hannah, 1991, “Tra passato e futuro”, Garzanti, Italy.
- Bejko, Sadik, 2007, “Disidentët e rremë”, 55, Tiranë.
- Berlin, Izajah, 1996, “Katër ese për lirinë”, Onufri, Elbasan.
- Castellan, Georges, 2003, “Historia e Ballkanit”, Çabej”, Tiranë.
- Dervishi, Kastriot. 2006 “Historia e Shtetit shqiptar 1912- 2005”. “55”, Tiranë.
- “Dokumente kryesore të PPSH”, 1973, Vëll., V, Sh.b, 8 Nëntori, Tiranë.
- Guanda, Parma, 1996, “Sulla violenza”.
- Hoxha, Enver, 1975, “Për letërsinë dhe artet”, Sh.b, 8 Nëntori, Tiranë.
- Kadare, Ismail, “Letra tragjike e Dhora Lekës”, Shqiptarja.com, Tiranë, 25 prill 2014.
- Lakër, Uollter, 2003, “Europa në kohën tonë”, Sh.b, Dituria, Tiranë.
- Pëllumi, At Zef, 2006, “Rrno për me tregue”, 55, Tiranë.
- Poliakov Leon, 2000, "Totalitarizmat e shekullit XX", Përpjekja.
- Velo, Maks, 2003, “Ese për diktaturën”, 55, Tiranë.

LETËRSI,PËRKTHIM

PËRRALLA SI ELEMENT EDUKUES DHE SI NËNSHTRESIM I LETËRSISË

ALMA DEMA
FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Përmbledhje

Ndër shekuj, përralla, ka ekzistuar, si e tillë, edhe si element edukues. Duke qenë se ajo është treguar, ka luajtur funksion dhe ka qenë traditë, pikërisht në kohën kur teknologjia dhe emancipimi shoqëror ishin në nivele elementare, përralla ka luajtur edhe funksionin e lajmëtares, domethënë ka përcjellë nga njëra krahinë në tjetrën, por edhe nga njëri brez në tjetrin, porosi, momente, ngjarje e dukuri të jetës së përditshme, të cilat në kontekstin e tyre nënshtresonin mesazhe të përbotshme e të gjithmonshme. Këtë e dëshmon fakti, se porositë e dhëna në to, janë akoma të vlefshme edhe të qenësishme edhe në ditët tona. Përralla vazhdon edhe sot e kësaj dite të ekzistojë mes nesh e për ta përligjur këtë duhet të organizohen ekspedita më të shumta, të gjëra dhe më të organizuara, sepse përralla ekziston akoma, duke ruajtur funksionin e saj fillestar në të gjitha ato zona të thella ku "modernizmi" fatkeqësisht dhe fatmirësisht e ka pasur të vështirë të arrijë.

Fjalë kyçe: përralla, element edukues, tradita, bota e fëmijës, personazh.

Abstract

Among the centuries, tales existed as an educational element. They have played a special function and have been a tradition when technology and social emancipation were in elementary levels; tales has also played the role of the messenger, by communicating orders, moments, events and phenomena of everyday life from one region to another, and from one generation to another. This is proved by the fact that their messages are still valid and essential in our days. Tales exist even today, and this should stimulate the organization of numerous well arranged expeditions, because the tale still exists, by maintaining its original function in all remote areas where "modernity" unfortunately and fortunately has been difficult to achieve.

Key words: tales, educational element, tradition, the world of a child, character.

1-Përralla si element edukues

Ndër shekuj, përralla, ka ekzistuar, si e tillë, edhe si element edukues. Duke qenë se ajo është treguar, ka luajtur funksion dhe ka qenë traditë, pikërisht në kohën kur teknologjia dhe emancipimi shoqëror ishin në nivele elementare, përralla ka luajtur edhe funksionin e lajmëtares, domethënë ka përcjellë nga njëra krahinë në tjetrën, por edhe nga njëri brez në tjetrin, porosi, momente, ngjarje e dukuri të jetës së përditshme, të cilat në kontekstin e tyre nënshtresonin mesazhe të përbotshme e të gjithmonshme. Këtë e dëshmon fakti, se porositë e dhëna në to, janë akoma të vlefshme edhe të qenësishme edhe në ditët tona.

Madame d'Aulnoy te Précieuses, nënvizon traditën e shumë kohëve më përpara kur përrallat tregoheshin nga shërbëtorët ose nga gratë e shtresave të ulëta (Zipes, 2000:11-12), pra, ato, nuk konsideroheshin luks apo fisnikëri për shtresat e larta të shoqërisë.

Ky element tregon masivizimin e saj dhe mbështet atë që thuhet rreth motiveve baritore apo fshatareske apo rreth asaj që Perrault's, thotë: "Përrallat janë përdorur edhe si mjet për të "shfryrë" hallet e problemet e përditshme duke i ngritur ato në shkallën e dëshirës. Ishte pikërisht kjo

shtresë e popullsisë që jetonte në kushte minimale, që identifikonte vetveten në subjektet e përrallave e mbi të gjitha nuk kishte mënyrë tjetër argëtimi e edukimi për fëmijët." (cf. Zipes, 2000: 858)

Përralla është shumë e thjeshtë dhe e kuptueshme për fëmijën. Ai/ajo, nëpërmjet saj, mëson në një mënyrë më të shpejtë e për të thithur gjithçka që e rrethon. Përralla i thjeshton situatat e veprimet. Duke e përjetuar përrallën, si të këitillë, ai/ajo, identifikohet me gjithë atë që ngjet me të, me veprimet e personazheve, me sakrificat e me ngadhënjimin e tyre. Fëmija nëpërmjet përrallës, lojës, veprimeve, mendimeve dhe gjykimit të personazheve, pastrohet dhe përgatitet shpirtërisht për jetën.

Personazhet e përrallës janë të portretizuar dhe të krijuar qartë, ndërsa detajet janë krejtësisht të eliminuara, pos kur kanë ndonjë rëndësi të veçantë. Ata më parë janë tipikë, sesa të jashtëzakonshëm. Sipas B. Bettlheim (1977) personazhet nuk janë ambivalente – nuk janë në të njëjtën kohë të mirë e të këqij (cf. Mustafa, 2003: 14).

Kjo traditë e pasur gojore, që nuk përcaktohet me kufij e me moshë, buron kënaqësi e mirëqenie të pashtershme shpirtërore, lëvrin, ecën, qarkullon duke ndjekur zhvillimet shoqërore e duke i dhënë

atyre zë, jetë, forcë vitale dhe rol të rëndësishëm në të gjithë sferën shoqërore.

Përralla në poetikën e saj të veçantë e jo të zakonshme, përsa i përket letërsisë gojore në veçanti, dhe mbarë universit letrar në përgjithësi, ka tërhequr studiues në mbarë botën. Por duke mbetur tek përralla shqiptare, (kjo edhe nga studimet, kohëzgjatja, mënyra e trajtimit të këtij problemi) vëmendja është fokusuar më shumë në mbledhjen e tyre, sesa në hulumtimin, studimin, mënyrën e ndërtimit, funksionimit, fuqinë depërtuese tek ai që e rrëfen e që e dëgjon dhe ndikimin e saj, sidomos tek fëmijët. Përrallat janë gëzim i madh për fëmijët, por ato tërheqin edhe të rriturit, të cilët receptojnë kënaqësi estetike prej tyre, por veç kësaj thellohen më shumë në domethënien e saj për të hyrë më mirë në atë çka ajo trajton.

Çdo përrallë, në interpretimin e saj është një minidramatizim që i ofrohet më shumë nga të gjithë, moshave fëmijërore, sepse pikërisht kjo moshë, rrit dhe ushqen dëshirën, etjen dhe modelin që krijon përralla. Përrallat zgjojnë ndjenja të bukura në moshën e fëmijërisë; veprimet, personazhet, ngjarjet që ndeshim në to, fëmijët i marrin si të vërteta e, me kalimin e kohës, vihen në mendime e dalëngadalë kuptojnë mekanizmin dhe funksionin e tyre, por përsëri ndiejnë kënaqësi, sepse brenda tyre ekziston një e vërtetë emocionale njerëzore ku ndihen dëshirat dhe shpresat për lumturi, për një “mbretëri” të dritës dhe të kënaqësisë, që vjen pas shumë mundimesh, ndeshjesh me shtriga e kuçedra, mashtrues e shpirtligë, pas mposhtjes të së keqes dhe arritjes së të mirës.

Studiuesi **Bruno Bettelheim**, i cili ka studiuar elementin e dhunës nëpër përrallat e vjetra si tregues i konflikteve psikologjike, kritikon me forcë te madhe këtë pikë duke udhëzuar reduktimin ose fshirjen nga subjekti e pjesëve që dëmtojnë psiken e tyre duke edukuar dhunshëm (Drazen, 2002: 43-44).

Një pikë të tillë, me të njëjtën ndjeshmëri, e ka prekur edhe At Donat Kurti, në Prralla Kombtare, duke u shprehur se: “Kà prralla të gjata e të shkurtra, serioze e qesharake, të patë keqe e të flligjta, e sidomos këto të mbramet janë me shumicë” (At Kurti, 1942).

Përrallat shpalosin një mori tipash e karakteresh, një mori ngjyrash e idesh, kështu, nuk mund të gjendet përrallë, e cila të mos flasë për një vajzë aq të bukur sa edhe dielli, apo më të bukur sesa ai, për një pallat mbretëror të mahnitshëm, për veshje të arta e të argjendta, pëlhura të papara e aq të bukura aq sa fantazisë dhe dëshirës së fëmijës i zbulojnë fusha dëshirimi dhe emocione të aprovuara më parë.

E gjithë kjo na nxjerr në përfundimin se nuk mund të konceptohet një përrallë pa një djalë guximtar e të bukur, (shpesh një ndër tre djemtë) aq të pashëm [në përrallën Djali dhe vajza me yll në ballë dhe yll në ballë dhe hënëz në kraharor (1963: 189 – 190), kuçedra nuk e ha djalin vetëm se ishte i bukur shën.ynë] sa vajzat e mbretërve bien menjëherë në dashuri me të; për një kalë të mrekullueshëm e më të bukurin, jo vetëm në të gjithë mbretërinë, por edhe në të gjithë botën; pa një ekzemplar të botës njerëzore, shtazore, abstrakte dhe të sendeve, të cilat mënyra treguese, vendosja e ngjarjeve, zgjatimi i tyre në vite me një mjegullti që sa vjen e shtohet, të imponon idenë se këta personazhe edhe mund të kenë jetuar.

Këtë e dëshmon fakti se vetëm kur mbaron përralla, kur shqiptohet formulëzimi përfundimtar, jepet të kuptohet se personazhet e përrallës paskan jetuar shumë më parë, meqenëse “Ata banë darsëm të madhe që zgjati disa ditë...”, ose “Ata jetojnë të lumtur edhe sot e kësaj dite”.

Estetikja, e bukura, e mrekullueshmja dhe fakti që përgjithësisht përralla mbyllet me një Happy end, e bëjnë atë të jetë e kërkuar dhe gjithmonë e mirëpritur nga çdo moshë e në çdo vend. Shprehje të tilla si “princi im i kaltër”, “jetojnë si në përrallë”, “përralla me mbret”, “si në përrallë” apo të tjera syresh, përlligjin botën fantastike të përrallës, gjë e cila lë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën, perceptimet dhe organizimin mendor të fëmijës.

Veprimet më të guximshme, kapërcimet aventurore nga njëra situatë në tjetrën, nga njëra gjendje fizike në tjetrën apo nga njëra gjendje ekonomike në tjetrën, nuk kanë për qëllim, vetëm, të tregojnë zotësitë e aftësitë e heroit/heroinës, por edhe të na çojnë te një ide, të na kthellojnë mendimin se: njeriu edhe në një stad të tillë foshnjor, munda të ndërtonte vetë të ardhmen e tij, se ai ishte i prirur drejt të bukurës dhe plotësisht të jetës së tij. Edhe pse e panjohura e shoqëroi në çdo hap të jetës së tij, edhe pse ishte në ato kushte, ai e vendosi vetë lumturinë, aq të ëndërruar dhe të dëshiruar për të.

2-Përralla si nënshtresim i letërsisë

Përralla, gjatë jetës së saj, u ngjis në veprimtarinë shoqërore, kulturore artistike e letrare, duke u bërë pjesë e rëndësishme e veprave të shumë artistëve dhe shkrimtarëve.

Studiuesi me zë i folklorit shqiptar, **Anton Çetta**, në Nga Folklori ynë, Bleni I, shprehet se shkrimtarët, ashtu si edhe artistët e tjerë, do të mund të gjejnë ndër përrallat edhe një burim për frymëzimet dhe krijimet e tyre origjinale. Na janë të njohura sa e sa krijime artistike, - citon ai, - me vlerë të kompozitorëve, piktorëve e gjer të kreatorëve të

filmit të ditëve tona, të cilët kanë gjetur një burim të pasur ndër përrallat për veprat origjinale të një niveli të lartë artistik. Mjafton të kujtojmë emrat e disa kompozitorëve të mirënjohur siç janë: **Moxarti, Veberi, Vagneri, Çajkovski** (...) e sa e sa të tjerë, të cilët ndër disa nga krijimet e tyre shfrytëzuan motive të përrallave (Çetta,1983: 22).

Veprat e para moderne në prozë, si **Dekameroni, Don Kishoti**, disa nga romanet e **Dikensit** etj., janë ndërtuar mbi bazën e strukturës dhe të sistemit të saj kuptimor dhe artistik – realizues.

Geoffrey Chaucer u ndikua plotësisht nga përrallat, për të realizuar veprën e tij Canterbury Tales, po ashtu edhe **Edmund Spenser** nga The Faerie Queene. Edhe dramat e **Willam Shakespeare** kanë ndikim të fortë nga përrallat dhe folklori. Le të përmendim King Lean i cili mund të konsideohet si varianti letrar i përrallës Water and Salt dhe Cap O'Rushes. **Giovanni Francesco Straparola**, i cili boton në Itali gjatë viteve 1550 dhe 1553, në veprën e tij, përdor shumë subjekte përrallash.

Kjo ndodh edhe me Neapolitan tales të **Giambattista Basile-s**, i cili i ka botuar në rrjedhën e viteve 1634 – 1636 (për më tepër shih shtojcën Lista e përrallave).

Në letërsinë bashkëkohore, shumë autorë, formën e përrallave e shfrytëzojnë në shumë mënyra. Një ndër to, është hulumtimi i racës njerëzore nga skeletet e thjeshtë të gjurmëve të përrallave. Disa të tjerë mundohen të zërthejnë kuptimin e fantastikes të gërshetuar apo të nënshtresuar në shprehitë bashkëkohore. Por ekzistojnë edhe mendime të tjera që duke përdorur si subjekt dramat psikologjike të historive të mbledhura nga **Robin Mckidley** ritregohen në mënyra të tjera si Lëkura e gomarit, për të përdorur si përqsaje moderne, apo si novela Lëkura e Drerit, e cila vë theksin mbi abuzimin e babait mbi të bijën.

Përgjithësisht, në letërsinë për fëmijë, përrallat janë treguar me elemente të thjeshtëzuar dhe të modifikuar; kjo bëhet thjesht për të shkaktuar efekte të ndryshme emocionale, si në Burrit që vinte era djathë të John Scieszka-s etj.

2.1.-Autorët shqiptarë dhe raporti i tyre me përrallën

Edhe në letërsisë shqipe, shkrimtarët si: Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli, Faik Konica, Martin Camaj, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Kasëm Trebeshina, Anton Pashku, Rexhep Qosja etj, në bazë të disa veprave të tyre letrare gjendet e nënshtresuar përralla, qoftë kjo si fabul, si subjekt, apo si rrëfim.

Vetë Ernest Koliqi në lidhje më argumentin e sipërpërmendur thekson: “Vështirë që një njeri i letrave t'i shpëtojë tundimit të së vërtetës ndonëse

ka mësuar prej të tjerëve se ajo mund të jete vetëm një iluzion rrëfimtar” (cf, Shehri, 1996: 223). Në tregimet e **Koliqit** Nusja e mrekullueshme, Kur orët lajmërojnë, Zana e fundme dhe vëllimi Hija e maleve, miti ngërthehet nga struktura rrëfimtare, pra miti ose përralla tregohet duke u shndërruar në tregim brenda tregimit. Ernest Koliqi duke njohur mirë dialektikën e përrallës, e ka shfrytëzuar materialin e marrë nga ajo, jo vetëm në pjesët e sipërpërmendura, por edhe më gjerë në krijimtarinë e tij.

Ndërsa **Kuteli** pohon se bazën e vërtetë letrare ia kishin dhënë përrallat e gjyshes e të fqinjit, folklori ynë i pasur, që nisi ta njihte që nga vogëlia; librat e librarisë së vogël të babait, Valët e detit të Spiro Dines etj. Stilin modern të prozës së tij e kërkon pikërisht në modelin e prozës popullore, madje veprat në prozë ai vetë i quajti rrëfime ose rrëfenja, duke dëshmuar kështu mbështetjen në prozën popullore e pikërisht në përrallë. Të bie në sy, se në të gjithë krijimtarinë e tij ai nuk rrëfen ngjarjen, por rrëfen për ngjarjen, domethënë kryen funksionin e tregimtarit të përrallës. Aspekte të tjera të cilat mbështetin idenë se Mitrush Kuteli, është mbështetur në përrallën popullore gjatë krijimtarisë së tij janë: frazeologjia e ligjërimit popullor, mbylljet e natyrës morale, abstragimi që i bën kohës në ngjarje, pakufishmëria e kohës dhe të botës së të gjallëve me atë të të vdekurve (rrëfenja Rina Katerinëza), niveli tematik e mjedisi ku e vendos ngjarjen.

Martin Camaj, ndërton profilin e tij artistik me bazë tabanin folklorik shqiptar duke përdorur me mjeshtëri të rrallë koloritin përshkrues e përbërës të përrallës. E bardha dhe e zeza; ngjyrat më të hasura në përrallat tona, ndërthuren harmonishëm në personazhet, figurat dhe ngjarjet e krijimtarisë camjane. Orteku i dëborës, zija shpirtërore (Rrunga në Mars) si mallkim i pashmangshëm i humbjes, misticizmi që ndjell grija, shpeshherë të bëjnë të mendosh, se ai ka ndërtuar mbi përrallë.

Ndërsa për **Kasëm Trebeshinën**, do të thosha që interpretimi i jetës në sinkroni dhe diakroni, na lë shtegun hapur për të menduar rreth kufijve të përrallës (Çiraku, 2003: 128). Ajo lëviz në bashkohësi dhe në tejkohësi.

Shkrimtari kosovar **Anton Pashku**, veprën e tij e ndërton në mënyrë shumë interesante. Proza e tij ka strukturë “rrethore”, strukturë e cila të lë hapësirë përqsajeje me atë të përrallës. Është thënë që përralla mbaron aty ku fillon, pra ekziston, gjallon brenda një strukture rrethore, strukturë të cilën e hasim veçanërisht te Kulla e Pashkut. Një tjetër veçori e poetikës kuptimore e përrallës, gjendet tek

objekti i vendosjes së ngjarjeve kullë = prapambetje; kullë = ekzistencë e largët.

Por jo vetëm kaq. Shkrimtari shfrytëzon me mjeshtëri rrëfimin popullor, idomatikën dhe karakterin dimanik të tregimeve.

Elementet mitike në prozën e shkruar kanë qëllim të caktuar dhe shumë dimensional. Ato, sipas A. Zejnullahut (1968), në pjesën më të madhe të rasteve ngjeshen në vetë dimensionin kohor të papërcaktuar që bie në rrafshin retrospektiv, me theks të veçantë informativ, gnoseologjik, shoqëror, i cili realizohet nëpërmjet personazheve të ndryshëm mitikë, të cilët në fushën e artit orvaten të marrin ngjyrë të një realiteti jetësor e historik (1987: 169).

Shkrimtari kosovar **Rexhep Qosja**, në romanin *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, përdor pikërisht këto elemente mitike. Këto simbole në rrafshin semantik shprehin domethënie të caktuar, kuptim informativ dhe poetik, që aktivisht e fuqimisht inkuadrohen në strukturën organike tekstore (1987: 169).

“Dikur moti në kohën e babagjyshit tim, kur luftonin me kuçedrat, dragonjtë krahëshpejtë e kishin fshehur thesarin e nuseve të qytetit në shpellën e harapit - thoshte plaku i parë.

Shpella e harapit e ruan një kuçedër e madhe; thesari ia freskon lëkurën e djegur dhe çdonjëri që provon të ngjitet atje e helmon, – thoshte plaku i tretë” (Qosja 1980: 12).

Në veprat e shkruara në prozë, autorët shqiptarë kanë shfrytëzuar semantizimin e strukturës morfologjike të fjalëve dhe elementet e prozodisë së fjalisë, karakteristikë e krijimeve gojore në prozë e sidomos e përrallës, pastaj traditën, modelet, relevancën komunikative që ndikon dhe përcakton estetikën receptive të marrësit etj.,

BIBLIOGRAFI

- At Kurti, Donat, 1942, *Përralla Kombtare*, Mledhë prej gojës së popullit, Blë I, Botimi i Dytë, A. Gjergj Fishta, Shkodër, Parathënie.
- Çetta, Anton, 1983, *Nga folklori ynë*, Bleni I, Rilindja, Prishtinë.
- Çiraku, Ymer, 2003, *Gjurmime në letërsinë shqiptare*, Albas, Tiranë.
- Drazen, Patrick, 2002, *Anime Explosion!: The What? Why? & Wow! of Japanese Animation*, Stone Bridge Press.
- Folklor Shqiptar I, *Proza Popullore*, 1963, Instituti i Folklorit, Tiranë.
- Mustafa, Myzafere, 2003, *Përralla Shqiptare*, Poetika dhe Mitikja, Instituti Albanologjik i Prishinës
- Qosja, Rexhep, 1980, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Rilindja, Prishtinë.
- Shehri, Dhurata. 1996, *Përralla si tregim brenda tregimit*, në “Letërsia si e tillë, Probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë kulturore”, aktet e konf. Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Toena.
- Zejnullahu, Adem, 1987, *Aspekte të krijimtarisë gojore në prozën e shkruar*, në “Gjurmime albanologjike”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Folklor dhe Etnografi, 16 – 1968, Prishtinë.
- Zipes, Jack, 2000, *The Great Fairy Tale Tradition: From Straparola and Basile to the Brothers Grimm*, Norton Critical Editions, Paperback

mirëpo, do theksuar këtu se prozatorët tanë, këto elemente i kanë shkrirë në sistemin vetjak kreativ bashkë me elementet e tjera të krijimtarisë letrare artistike, qoftë nacionale, qoftë ndërnacionale, pra kanë krijuar kështu stilin e tyre dhe vepra origjinale (Qosja 1980: 12).

Studiuesit e ndryshëm janë shprehur se përralla e ka mbaruar tashmë misionin e saj. Nuk ka dyshim se ky pohim në esencë është i drejtë, por ajo vazhdon të jetojë në brendësi të zhanreve të tjera letrare, si tregimet, romanet (e prekëm më lart këtë argument), filmat, apo në format e tjera kinematografike. Kinematografia zhvillon e zgjeron truallin e saj duke përdorur përrallën si pikë mbështetëse të fuqishme dhe prodhimtare të pashtershme. Të gjithë jemi dëshmitarë të shumë e shumë filmave të arritur, të cilët nuk bëjnë gjë tjetër, veçse ndërtojnë, ekzistojnë dhe trajtojnë si në përrallë.

Shumë filma për fëmijë të cilët kanë pasur si subjekt përrallat, janë krijuar nga kompania Disney me Aleksander Rou – n, i cili duke marrë si shembull përrallën Vasilissa e bukur, krijoi filmin e parë sovjetik të mbështetur në folklorin rus. Filma të tjerë, suksesshëm, janë ndërtuar duke ripërdorur motivet e përrallave: *Labyrinth*, *My neighbor Totoro*, etj...

Përralla vazhdon edhe sot e kësaj dite të ekzistojë mes nesh e për sa përligjur këtë duhet të organizohen ekspedita më të shumta, të gjëra dhe më të organizuara, sepse përralla ekziston akoma, duke ruajtur funksionin e saj fillestar në të gjitha ato zona të thella ku “modernizmi” fatkeqësisht dhe fatmirësisht e ka pasur të vështirë të arrijë.

TENDENCAT PASModerne në Romanet e Vona të Xhozef Hellerit

ANITA NEZIRI

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TE HUAJA, ANGLISHT
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Përmbledhje

Në historinë e letërsisë amerikane emri i Xhozef Hellerit (1923 – 1999) qëndron në një radhë me emrat e shkrimtarëve më të njohur amerikanë të gjeneratës së Luftës së Dytë Botërore, të tillë, si: Xhejms Xhons, Irvin Shou, Norman Majler, Kurt Vonnegut, Xhozef Heller është autor i nëntë romaneve "Yçkla-22" (Catch-22), "Diç ndodhi", "Flori, ose jo më keq floririt"; "E paftë Zoti"; "Kjo s'është shaka" me bashkautorësinë e Spid Fogel-it; "Imagjino tablonë"; "Dyqani është mbyllur", "Kohë pas kohe" dhe "Portret artisti në pleqëri" roman ky, i botuar pas vdekjes së autorit. Padyshim, që përgjatë ngjizjes dhe formësimit të këtyre nëntë romaneve, Heller-i përshkoi një spirale ngjitjeje, duke zgjidhur disa detyra të vështira artistike, të cilave ai, si shkrimtar, krahas përvojës në rritje, u kushtoi edhe ethet e kërkimit dhe eksperimenti të drejtpeshuar duke e vënë theksin sa në aspektet formale e kompozicionale, aq edhe në përpunimin e një gjuhe dhe stili të përshtatshëm për secilën vepër të re.

Fjalët çelës: Xhozef Helli, Lufta e Dytë Botërore, Yçkla-22, strategjitë.

Abstract

In the history of American literature the name of Joseph Heller (1923-1999) is along the greatest other american writers of World War Two generation such as James Jones, Irvin Show, Norman Mailer, Kurt Vonnegut etc. Joseph Heller is the autor of nine novels: (*Catch-22*, 1961), (*Something Happened*, 1974); (*Good as Gold*, 1979); (*God Knows*, 1984); (*No Laughing Matter*, 1986), (*Picture This*, 1988); (*Closing Time*, 1994), (*Now and Then*, 1998) and (*Portrait of an Artist as an Old Man*, 2000), a novel which is published after his death. During all his writing Heller surely went through several difficult artistic duties, besides his professional growth, he paid attention to the balanced quest and experiment emphasising the formal and compositional aspect as well as establishing his own style of writing and a language bringing new elements to the narrative strategies.

Key words: Joseph Heller, World War Two, Catch-22, strategies

HYRJE

Objekt i studimit është forma artistike e Joseph Heller-it, raportet e saj me tendencat letrare të kohës së tij. *Material hulumtimi* na kanë shërbyer të gjitha romanet e Xhozef Hellerit. Bazë *teoriko-metodologjike* për studimin anë shërbyer punimet teorike të shkencëtarëve të letërsisë ruse të traditave të formalizmit dhe semiotikës (M. M. Bahtin, V. Shklovski, J. Tinjanov, V. J. Propp, J. Lotman, J. Borjev etj), dhe gjetjet teoricieneve amerikanë të «humorit të zi» (R. Skoullz, M. Shulc, Ç. Harris, R. Olderman, P. Hok). Bazë themelore në studimin tonë ka qenë koncepti i groteskut të M. M. Bahtin-it, i parashtruar në librin e tij studimor-teorik «Krijimtaria e Fransua Rabëlesë dhe kultura popullore e mesjetës dhe Renesancës». Të rëndësishme kanë qenë të gjitha ato punime që kanë prekur anë të ndryshme teorike mbi krijimtarinë letrare të komizmit, të qeshurës, absurdit, paradoksit, nonsensit, karnavalizmit, etj.

Ky punim përqëndrohet përgjithësisht në këto aspekte:

Joseph Heller-i, shkrimtar me një stil individual të spikatur, i dallueshëm në secilin prej tre romaneve të tij, nuk mbetet i lidhur njëherë e përgjithmonë me formën e tij të romanit debutues «Yçkla-22», që i solli atij njohjen e përboshme. Në

historinë e letërsisë amerikane emri i Xhozef Heller-it (1923 – 1999) qëndron në një radhë me emrat e shkrimtarëve më të njohur amerikanë të gjeneratës së Luftës së Dytë Botërore, të tillë si Xhejms Xhons, Irvin Shou, Norman Majler, Kurt Vonnegut. Xhozef Heller është autor i nëntë romaneve: «Yçkla-22» (*Catch-22*, 1961); «Diç ndodhi» (*Something Happened*, 1974); «Flori, ose jo më keq floririt» (*Good as Gold*, 1979); «E paftë Zoti» (*God Knows*, 1984); «Kjo s'është shaka» (*No Laughing Matter*, 1986), me bashkëautorësinë e Spid Fogel-it; «Imagjino tablonë» (*Picture This*, 1988); «Dyqani është mbyllur» (*Closing Time*, 1994); «Kohë pas kohe» *Now and Then*, 1998) dhe «Portret artisti në pleqëri» (*Portrait of an Artist as an Old Man*, 2000), roman ky, i botuar pas vdekjes së autorit. Padyshim, që përgjatë ngjizjes dhe formësimit të këtyre nëntë romaneve, Heller-i përshkoi një spirale ngjitjeje, duke zgjidhur disa detyra të vështira artistike, të cilave ai, si shkrimtar, krahas përvojës në rritje, u kushtoi edhe ethet e kërkimit dhe eksperimentit të drejtpeshuar, duke e vënë theksin sa në aspektet formale e kompozicionale, aq edhe në përpunimin e një gjuhe dhe stili të përshtatshëm për secilën vepër të re. Me kohë, në krijimtarinë e Xhozef Heller-it shohim se si shpërndërohen gradualisht elemente të tëra të narrativës, strategjia dhe regjistrat rrëfimit,

se si ndërlikohet struktura e ndërtimit duke iu përshtatur thelbit stilistik e semantik.

Ky evolucion romanësor shfaqet më demonstrativisht përgjatë ndryshimeve që pëson metoda e tij artistike. Për këto ndryshime të medotës së tij dëshmojnë riprodhimet e ndryshme të kategorive të komikes, të cilat zënë një vend qëndror në krijimtarinë e shkrimtarit, sikundër dhe pasuria e zhanreve të larmishme të romaneve të tij. Duke shqyrtuar evolucionin e një game elementesh komponentësh letrarë në prozën romanore të Heller-it, ne do të rrisim interesin, jo vetëm për krijimtarinë e këtij autori, por do të sqaronim sadopak rrethanat e kushtëzuara të procesit krijues fill pas Luftës së Dytë Botërore në SHBA, proces që ndikoi mjaft ndjeshëm në profilin e romanit amerikan të pas Luftës së Dytë, në veçanti, për atë linjë të trashëgimisë romanore të groteskut dhe humorit të zi në suazat e letërsisë amerikane.

Tendencat pasmoderne në romanet e vona të Heller-it («E paftë Zoti», «Imagino tablonë», «Dyqani mbyllet», «Portret artisti në pleqëri») i kushtohet hulumtimit të poetikës postmoderniste të romaneve të vona të Heller-it. Për çdo roman është shkruar një nga katër nënçështjet. Romani «E paftë Zoti» si një model i lojës letrare analizohet rikuptimësimi postmodernist që gjendet në shtratin e syzhetit (subjekt) të romanit me historitë biblike, i realizuar me ndihmën parimit ë lojës. Heroi i romanit, një personazh biblik shtatëdhjetëvjeçar, mbreti David, ndërmend jetën e tij, duke ritreguar ngjarjet sipas versionit të tij, të përshkuara në Testamentin e Vjetër. Interpretimi i lirë i syzhteve të Testamentit të Vjetër prej një rrëfimtari mendjemprehtë është, në llojin e vet, një "dekanonizim" postmodernist i kulturës, i bashkëshoqëruar me sheshpushime argëtuese, me anë të «karnavalizmit» (term i Mihaill Bahtinit, të cilin e shfrytëzojnë teoricienët e postmodernizmit).

Burimi kryesor i komizmit në roman është intertekstualiteti, shfaqjet e shumëllojshme të të cilit ne shqyrtojmë në këtë syth të punimit. Përderisa intertekstualiteti është një nocion tekstologjik, objekt i studimit bëhet teksti i romanit dhe në mënyra të ndryshme edhe tekstet e ndërsjellta paraardhëse të kulturës që e mbështjellin e bashkëveprojnë me të. Në cilësinë e tipave të pranishëm roman, që bashkëveprojnë në mënyrë të ndërsjelltë, ne veçojmë këto të mëposhtmit, të shenjuar në klasifikimin e Zherar Zhenet-it (Постмодернизм: Энциклопедия. – Мн.: Интерпрессервис: 2001). 1) «hipertekstualitet» – veprim i ndërsjelltë i tekstit me tekstin e profanuar (profanizuar) prej tij (me Biblën) 2) «autointertekstualitet» – citimi i ndërgjegjeshëm si

bashkëprani në tekst e disa teksteve të shumëllojshëm (tekstit autorial, teksteve të Testamentit të Vjetër, Shekspirit, Shellit). Efekti komik i «hipertekstualitetit» në roman lind si rezultat i interpretimit paradoksal prej rrëfimtari të syzhteve biblike.

Në kornizat e "autointertekstualitetit» ne nënvizojmë dy nivele të bashkëveprimit të ndërsjelltë të teksteve: stilistike dhe zhanrore, pasqyrim i të cilëve në roman del prania e zërave të ndryshëm stilistikë e zhanrorë, që shpien në efektin komik. Përkaj, ndërsjelltësisë direkte të teksteve, intertekstualiteti në roman shfaqet në trajtën bashkëveprimit të ndërsjelltë të në mjedisin sociokulturor si edhe trajtimi jolinear i kohës historike, që lejon të shkrihen në një tekstet bashkëkohore me tekstet e kulturave paraardhëse (së këndejmë dhe anakronizmat e shumta); fshirja e kufijve ndërmjet letërsisë si e tillë dhe refleksit të shkencës mbi letërsinë.

Pa marrë parasysh komizmin, romani është i shkruar me një psikologjizëm të thellë, aspak karakteristik për postmodernizmin. Psikologjizmi shfaqet në paraqitjen e madhështisë së Davidit në sfondin e vogëlsisë së tij, ambicieve, epshit. Me thellësi psikologjike janë paraqitur marrëdhëniet e ndërlikuara të Davidit me Zotin, dhimbja, dëshpërimi dhe fyerja e atit, që ka humbur bijtë e tij të dashur, vetmia e plakut të braktisur prej të gjithëve, pafuqia e një prijësi dikur të fuqishëm. Një kombinim i tillë i ironisë postmoderniste me realizmin psikologjik përcakton dhe origjinalitetin e formes artistike të shkrimtarit në këtë roman të tij.

Montazhi në romanin «Imagino tablonë» hulumtohet kompozicioni montazhor i romanit, në themel të të cilit gjendet koncepti postmodernist i përkohesisë që bën të mundur përzierjen e epokave, shpërpjesëtimin e kronotip-it. Në roman shkrihen në një personazhet historikë të epokave të ndryshme: Rembrandit, piktorit holandez të shekullit XVII, i rrin karshi filozofi i vjetër helen, Arsitoteli, i derdhur skulpturë, që ka jetuar në shekullin IV p.e.s. Arsitoteli mediton për Sokratin, i cili ndërroi jetë pesëmbëdhjetë vjet para se të lindte. Një prej personazheve të romanit është edhe Platoni, që sjell në "Dialogjet" e tij pikëpamjet e mësuesit, Sokratit. Në bazë të një syzheti të tillë "artificial", ku elementi lojacak nënvizon parësinë e trillit, u ngjiz dhe historia e një tabloje të një piktori të madh, që ekziston realisht, «Aristoteli, duke menduar pranë bustit të Homerit». Në sfondin e peripeive, që i ra për pjesë tablosë, gjatë kohës së shtegëtimit të saj ndër vite të gjata, nga njëri koleksion në tjetrin, autori ndriçon etapa të caktuara në historinë e zhvillimit të njerëzimit, duke analizuar natyrën

njerëzore, teksa tërheq vëmendjen drejt negativizmit në civilizimet e vjetra dhe bashkëkohore.

Kompozicioni zhanror e mundëson shkrimtarin të nxjerrë në plan të parë çështjet morale, që e interesojnë më shumë, duke u lënë një rol dytësor lidhjeve kohë-hapësinore të këtyre ngjarjeve. Çështjet e moralitetit përbëjnë temën tejprerë të romanit, e cila përfshin në një zinxhir elementët e kompozicionit montazhor. Një organizim i këtyre në roman na mundëson ta kualifikojmë atë si një vepër «akumulative, sipas përcaktimit që i ka bërë A. M. Zvjërjev, një dukuri ngrëthyesë në aspekte e pikëvështrime nga më të ndryshmet (Zvjërjev A. M : 2002).

Në dallim prej prozës psikologjike në paraqitjen e personazheve, në roman mungon karakteristika poliedrike e personalitetit; ata personazhet paraqesin në vetvete një portret të shterruar, që përmbush rolin e një diapazoni për vlerësimin e moralitetit të ngjarjeve. Një vëzhgim i tillë i përgjigjet asaj që ka nënvizuar tashmë kritiku rus Aleksej Matvjejeviç Zvjërjev (1939-2003), veçoritë e teknikës së montazhit, që kanë të bëjnë me theksimin e interesave të shkrimtarit «ndaj dukurive sociale dhe proceseve, që tretin në vetvete individualitetin»

Acarimi i skajshëm i mendimit të autorit, orientimi intelektual i romanit me fakte të dendura historike e gjeografike, përshkrimi i zbulimeve shkencore, përpos kompozicionit montazhor që gozhdon vëmendjen tek ideja autoriale dhe që aktivizon meditimim asociativ të lexuesit, të mundësojnë ta kualifikosh këtë vepër si një roman intelektual-filozofik.

Originaliteti i manierës artistike të shkrimtarit në këtë roman ndjehet qartë në përdorimin e kompozicionit-montazh, të bazuar në trajtimin postmodernist të kohës, për ndriçimin e problemeve morale, interesi ndaj të cilave është më shumë karakteritike e artit realist, se sa e atij postmodernist, me relativizmin e tij të vlerave.

Poetika pasmoderne në romanin «Dyqani mbyllet» hulumtohen elementët e shumëllojtë të poetikës, që përcjellin në tërësi botëndjesinë mjaft të ngrysur të autorit, atmosferën e entropisë dhe kaosit postmodernist. «Dyqani mbyllet» është një vazhdim i romanit «Yçkla-22» – në këtë vepër veprojnë po ata personazhë, vërtet, tashmë të plakur në pesëdhjet vjet kohë, të cilët ndërmendin herë pas herë episodet kyçe të «Yçkla-22». Rrëfimi në roman intrigohet në formën e farsës. Absurditeti i stuatave, që provokojnë luftën bërthamore, – janë të llojit travestin (travestire), kur një përmbajtje serioze përfshihet në një formë jogjegjëse, komike.

Presidenti i vendit me nofkën «Pispath» ("Little Prick") e kalon gjithë kohën e tij mbi videolojëra. Në zjarrin e lojës, duke shtypur butonin e kuq, ai ngrë rastësisht në ajër të gjithë bombarduesit dhe nuk di, se si t'i kthejë mbrapsht ata. Kështu, tragjedia na paraqitet në trajtën e shakasë. Në paraqitjen e ngjarjeve kyçe të romanit – të luajtur virtualisht në ekrane e kompjuterave me kërcimet e dasmave të familjeve të pasura, me funksionimin e botës së nëndheshme fantazmagorike të misterit Til-it, banorë të të cilës janë shkrimtarët e njohur, aktorët apo figura të shquara historike, - mbretëron elementi i lojës.

Tonaliteti i errët i romanit përforcohet më aluzione të shumta (me "Komedinë hyjnore » të Dantes, me oratorion «Apokalipsis» të Adrian Leverkyn-it, një personazh i Thomas Mann-it nga romani «Doktor Fausti», me njeriun flokëkuqerremtë me bastun dhe me çantë të gjelbër shpine nga novela e Thoma Mann-it «Vdekje në Venecia», me operën e Rihard Vagnerit «Vdekja e zotave»), e paramenduar për të qenë paralajmëruese e vdekjes së njerëzimit.

Intertekstualiteti i romanit «Portreti i artistit në pleqëri» hulumton forma lojacake, e bazuar në intertekstualitet, në të cilën përthithen përsiatje serioze filozofike mbi krijimtarinë letrare dhe vendin e shkrimtarit në shoqëri. Heroi i romanit, një shkrimtar që po plaket, dytësori vetë autorit, përpiket mundimshëm për të krijuar një kryevepër në perëndim të karrierës së tij krijuese. Intertekstualiteti në roman është i shumëllojshëm. Ai ndeshet që në titull, që është një huazim i Xhejms Xhojsit "Portreti i djaloshit artist" në emrin e shkrimtarit-personazh, Porha (Eugene Pota) – një akronim, i përbërë prej gërmave nistore të dy fjalëve të para të titullit të romanit: «Portret artisti» ("Portrait of an Artist") (në klasifikimin e Zh. Zhenet-it – «paratekstualiteti», kuptohet si «marrëdhënie e tekstit me pjesën e tij (epigrafin, nëntitullin, novelëm e montuar») Romani është intertekstual për nga tematika dhe kompozicioni.

Intertekstualiteti është kompozicional kur në roman shfaqet prania e dy llojeve të syzhetit – i jashtmi, që lidh kryefund fragmente të ndryshme tekstesh dhe i që jep atij proporcionalitet harmonik kompozicional, dhe teksteve të brendshme parodike, të huazuara. Duke përdorur përcaktimin e Zh. Zhenet-it, syzhetet e brendshme relatojnë me syzhetet e jashtme si hipotekstet (hypotext) me hipertekstet (hypertext). Përsiatjet e personazhit se, pas cilit roman ai ia vlen të kapet («libri mbi profesorin e zhgënjyer të universitetit, përjetësisht të pakënaqur me ambicet e papërmbushura letrare», për «mësuesen e shkollës së mesme, që ka

rënë në histori të dështuara dashurie me partnerë të dështuar», «një romancier me seksualitet të virtytshëm» etj.), dëshmojnë intertekstualitetin tematik të romanit. Intertekstualiteti realizohet po ashtu me anë të fshirjes së kufijve ndërmjet letërsisë si e tillë dhe refleksit letrar-kritik. Qendër tematike e romanit të Heller-it është shkrimtari dhe veprimtaria e tij profesionale, dhe përsiatjet e tij mbi letërsinë zënë një vend të konsiderueshëm.

Intertekstualiteti në roman fshin edhe një kufi tjetër – atë ndërmjet autorit dhe personazhit. Autori i romanit njëjtësohet me personazhin. Në roman ekzistojnë disa hamendësime për romanin «Yçkla-22» dhe të tjera vepra të Heller-it. Në roman janë të bashkëpranishëm elementë të zhanreve të ndryshme: mite, tekste të letërsisë masovike, përsiatje serioze filozofike, tekste letrar-kritike, të përthyerë me refleksione të karakterit stilistik të ditarit, që gjithaq përforcon edhe njëherë poetikën postmoderniste të romanit. Syzhetet, në të cilat heroi rend në cilësinë e varianteve të mundshme zbatimëse (variacionet në temën e Tom Sojerit, në temën e Kafkës, syzhetet mitologjike), ndërkaq, romani prek me eksperimente joargëtuese shkrimtarin-personazh, por kërkimet e tij të mundimshme krijuese, përsiatjet e tij për fatin e shkrimtarëve të mëdhenj, të cilat formatohen në leksione me një titull oratorik «Letërsia e dëshpërimit».

Marrëdhëniet e ndërlikuara në të gjitha kohët midis shkrimtarit serioz dhe shoqërisë, të konsideruarit e, talentit të tij shpesh, si diçka e panevojshme, përbëjnë kontekstin social të romanit. Përjetimet e heroit, lidhur me përpjekjet e tij të pasuksesshme për të realizuar idenë e tij krijuese, me vetëdijen e tij të varur nga frika prej shpërfilljes gjithnjë në rritje të kritikës dhe lexuesit, dëshmojnë për një psikologjizëm të romanit. Nga kjo bëhet e qartë, se poetika e dukshme postmoderniste e romanit bashkekziston njëkohshëm me tendencat realiste.

Romanet autobiografike «Kohë pas kohe», «Kjo nuk është shaka» i kushtohet prozës autobiografike të Heller-it dhe përbëhet prej tri ënçështjesh. «Kohë pas kohe» si model të faktit letrar shqyrtohen pecifikat karakteristike të zhanrit autobiografik në romanin e Hellerit. Bazë metodologjike këtu shërben teoria e Lidia Ginsburg-ut mbi prozën dokumentale artistike. (Гинзбург Л. Я. О психологической прозе:1976)

Specifika kryesore e saj është të qenët e ngulfatur në thelbin e zhanrit të asaj që Ginsburg e quan «fermenti i pabesueshmërisë», që shfaqet në faktin, se tej sinoreve të informacionit të kulluar (emrat, datat etj.) gjithëherë janë të pranishëm

«zgjedhja, vlerësimi, pikëvështrimi», të cilat janë edhe më interesante, se sa potenciali më i lartë krijues i shkrimtarit. Vlerësimi autorial i ngjarjeve të historisë së një të shkuare të afërt krijon mundësi për t'i parë ato me sytë depërtues, mendjemprehtë e paradoksalë të shkrimtarit. E pazakonta e qasjeve ndaj shqyrtimit të ngjarjeve të njohura, paradoksaliteti dhe ironizmi në vlerësime na lejojnë të arrijmë në përfundimin se potenciali krijues i shkrimtarit shfaqet në prozën dokumentale po aq mprehtë, sa në romanet e tij.

Paradoksi në romanin "Kjo nuk është shaka" shqyrtohet origjinaliteti artistik i manierës së Joseph Heller-it në një roman autobiografik, të shkruar me bashkautorësi me mikun e tij Spidom Fogel. Kapitujt e shkruar nga Heller-i dhe Fogel-i ndërëmbehen. Një bashkautorësi e tillë pazakontë (për S. Fogel-in ky eksperiment letrar – ka qenë provë e pënës), veçse ia shton reputacionin Joseph Heller-it si njeri, që shpërfill çdo lloj kushtëzimi. Syzheti i romani thuret rreth sëmundjes së papritur neurologjike të Heller-it, që e shpie atë në paralizë, e bën atë pacient të shtruar në spital, të vizituar prej miqve, mbështetja e të cilëve përshpejton dukshëm shërimin e tij të plotë. Romani përshkohet prej paradoksesh. Paradoksal është vetë fakti i sëmundjes së papritur – shkrimtari sëmuret, duke u gjendur në një formë të shkelqyer fizike. Paradoksalë është qasja e shkrimtarit ndaj sëmundjes së vet – ai tallet me një periudhe zezë në jetën e tij, duke e quajtur atë groteske. Tregues është, se në kapitujt e romanit, që i kushtohen periudhës më të rëndë të sëmundjes, shkrimtari bën shaka akoma më shumë se më parë, dhe efekti i shakave të tij, në masën e mospërkimit të situatave dhe mundësisë komike të pasqyrit të tyre janë akoma më të mprehta. Kështu, duke qenë një vepër realiste, çka ia kushtëzon këtë vetë zhanri, të qenët autobiografi, ka bërë të pasqyrohet në të reaksioni i shkrimtarit në përvojën e vet negative, të cilin kritikët letrarë e kanë pagëzuar një specifikë "humorit të zi", që gjen shpëtim tek e qeshura.

Romanet autobiografike si pasqyrim i relizimit grotesk të prozës së Heller-it shqyrton një matërial biografik, që shërben si pikënisje për shumë episode groteske të romaneve të tij. Përkimet e shumta ndërmjet prozës groteske dhe asaj artistiko-dokumentale na lejojnë të përmbylim, se, duke shtrembëruar në mënyrë groteske episodet reale, autori rrit shprehësinë në përcjelljen e atmosferës së ngjarjeve, pjesëmarrës apo dëshmitarë të së cilave ai është. Një mënyrë tillë artistike e shkrimtarit pasqyron atë çka ka vërejtur A. M. Zverjev-i: specifikën e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, e pikërisht: mbizotërimin e shprehshmërisë ndaj

vizualitetit. (Zverjev A. M. : 2002). Njëkohësisht, materiali autobiografik i paraqitur në prozën artistike të Heller-it pohon pikëpamjen e shprehur si nga kritikët rusë, ashtu dhe nga ata amerikanë, se Heller-i, në ndryshim prej "humorzinjve", e merr materialin për romanet e tij groteske nga jeta vetjake duke i pajisur ato me një kumbim të mprehtë satirik.

PËRFUNDIME

Në përfundim nxirret bilanci themelor i studimit. Përgjatë analizës romanore të krijimtarisë së Joseph Heller-it në kornizat e një hulumtimi të tillë u zbulua qartë një tipar i tij karakteristik: çdo roman i ri i shkrimtarit nuk ngjet me romanet e tij të tjerë paraardhës. Kjo veçanti vihet re në nivele të ndryshme. Në radhë të parë, kjo ka të bëjë me evolucionin e metodës artistike të shkrimtarit. Metoda artistike në tre romanet e para – është realiste/realistike: në to përmbahet tabloja satirike e realitetit; këto romane kanë një kumbim të mprehtë social, në to janë paraqitur personazhë tipikë në situata tipike. Katër romanet e mësipërm Heller-it demonstrojnë një poetikë postmoderniste të shprehur qartë. Njëkohësisht, në to mbivendosen tipare të metodës artistike realiste, që shfaqen përmes psikologjizmit, në thithjen e vëmendjes ndaj problemeve morale, në praninë e pozicionit atorial në vlerësimin e ngjarjeve. Tendencat bashkëkohore të letërsisë amerikane – multikulturalizmi dhe dokumentalizmi, që gjejnë pasqyrim në krijimtarinë e shkrimtarit, përforcojnë pozicionin e metodës realiste në romanet e tij. (Tema hebraike përforcon elementët realistë në romanet e tij hebreje; dokumentalizmi dëshmon për katastrofën e realitetit të kohës sonë).

Rritja e krijimtarisë së Joseph Heller-it shfaqet po ashtu në larmishmëria e llojeve zhanrore të romaneve të tij, të përfaqësuara me romanet e luftës («Yçkla-22»), me romanet social-psikologjike («Diçka ka ndodhur»), politike («Flori e shkuar floririt»), psikologjike («E paftë Zoti»), autobiografike («Kjo nuk është shaka», «Kohë pas kohë») me romanet filozofiko-intelektuale fantazmagorike («Imagjino tablonë, «Portret artisti në pleqëri»), me romanet e temës apokaliptike («Dyqani mbyllet»).

Dinamika e progresit të komizmit në romanet e Heller-it dëshmon gjithashtu për evolucionin e krijimtarisë së tij. Duke iu kthyer që në romanin e tij të parë një modeli dhe estetike të re – trajtimit të

realitetit si komedi, Joseph Heller-i i mbetet besnik këtij koncepti deri në veprën e tij të fundit. Komikja si dukuri jetësore, që shkakton të qeshura, riprodhohet artistikisht në tre romanet e para të Heller-it në satirë, e cila, nga ana e saj, shndërrohet në grotesk. Grotesku në romanet «Yçkla-22» dhe «Flori e shkuar floririt» – realist, sipas klasifikimit të M. M. Bahtinit, që zgjidhet me katarsisin grotesk, në romanin «Diçka ka ngjarë» – një model modernist – në të tragjikja dominon mbi komiken.

Në romanet postmoderniste të Heller-it komikje përfton trajtat e talljes ironike postmoderniste. Me një qartësi të veçantë ajo shfaqet në romanin «E paftë Zoti», ku parodizimit i nënshtrohet e shenjta e të shenjtave - Bibla. Komikja në «Përfytyro tablonë» krijohet në trajtën e ironisë së hidhur të artistit intelektual-quesëndisë, që paraqet veset morale të njerëzimit, që e shoqërojnë atë nga lashtësia e thellë deri në ditët tona. Jo më pak therëse është ironia mbi ambiciet e shkrimtarëve bashkëkohorë, e cila përpin krejt romanin «Portret artisti në pleqëri». Në romanin «Dyqani mbyllet» elementi komik u jep një nuancë farse edhe dikurive të tilla tragjike, si vdekja, dhuna, kataklizmat teknogjene. Evolucionin pasqyrohet dhe në raportet e tragjikes me komiken në romanet e Heller-it. Në romanet «Yçkla-22», «Flori e shkuar floririt», në romanet autobiografike «Kjo nuk është shaka», «Kohë pas kohë» mbizotëron tonaliteti optimist. Nuk mund të pohojmë, se kundërvënja e tragjikes me komiken zgjidhet njëmend në interes të komikes në romanet postmoderniste «E paftë Zoti» dhe «Përfytyro tablonë». Mirëpo, pa marrë parasysh çështjet e mprehta të ngritura në to, ata gjithësesi zgjidhen në një kyç pozitiv falë elegancës së formës së tyre – lojës letrare.

Në romanet «Dyqani mbyllet» dhe «Portret artisti në pleqëri» mbizotëron botëndjesia tragjike e shkrimtarit. Heroi i romanit «Portret artisti në pleqëri», është një shkrimtar i vjetër plak, – Dytëshori i vetë shkrimtarit. Romani, kësodore, rrëfen mbi pakënaqësinë tortutuese, krizën e krijimtarisë së vetë Joseph Heller-it. Duke qenë së është romani i fundit i Heller-it, ai mund të merret me të drejtë si akordi përmyllës në krijimtarinë e tij. Mirëpo e gjithë krijimtaria e tij përgënjeshtrohet atë që kumbon në roman, pranimin e hidhur të disfatës në përpjekjen për të qenë i pangjashëm me askënd, përfshij dhe vetevten në romanin e tij të parë "Yçkla-22".

BIBLIOGRAFI

Heller Joseph ,1961, "Catch-22", USA, New York. Simon and Schuster. p 426.
Krassner Paul. 1984, "An Impolite Interview with Joseph Heller" in The Best of the "Realist", USA, Running Press, p 75-81.

Solomon Jan. 2008 "The Structure of Joseph Heller Catch-22". Infobase Publishing USA, p 34-55.

Zverjev A. M. Shekulli XX si epokë letrare // orientimet artistike të letërsisë botërore në shekullin XX. – M.: IMLIN RAN, 2002. – fq.6-46.

Zvjerjev A. M. 2002, "Montazhi" // Orientimet artistike të letërsisë së huaj të shekullit XX: sp. fq. – M.: IMLI RAN,. – fq.507 – 523.

Гинзбург Л. Я. О психологической прозе. – 2-е изд. – Л.: «Худож. лит.», 1976. – 448с.

Постмодернизм: Энциклопедия. – Мн.: Интерпрессервис; Книжный Дом, 2001.– 1040 с.

FOLKLORI BURIMOR NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT, TRASHËGIMI ETNOKULTURORE

BEKIM VISHAJ

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim të bëjë një pasqyrim të trashëgimisë etnokulturore të folklorit burimor në Rrafshin e Dukagjinit të Kosovës, me gjendjen e folklorit burimor, dikur e deri në ditët e sotme, pra zhvillimin e folklorit burimor në këto anë, si pjesë e rëndësishme e kulturës popullore. Në punim trajtohen aspekte të trashëgimisë së etnokulturës, pra të folklorit burimor në këtë pjesë të Kosovës, përkatësisht në komunat: Pejë, Deçan, Junik e Gjakovë si dhe bartësit kryesorë të folklorit ndër vite. Rrafshi i Dukagjinit, në përgjithësi ruan elemente të pasura të trashëgimisë së etnokulturës, ku vërehet lehtë një veçanti e folklorit burimor e cila dallon nga regjionet tjera të Kosovës dhe të hapësirës gjithë shqiptare. Folklori burimor në Rrafshin e Dukagjinit ka karakteristikat e veta që e bëjnë të jetë i veçantë. Ka disa lloje (stile) të këngëve: këngë malësorçe, këngë vajtimi, këngë gëzimi, këngë trimërie etj. Rapsodët popullorë, me vokalin, tonalitetin dhe interpretimin e këngës burimore, kanë veçantitë dhe melosin e tyre popullor që e dallon nga rapsodët e viseve tjera shqiptare. Historia e trashëgimisë së etnokulturës për këtë regjion shumë të rëndësishëm (Rrafshin e Dukagjinit si një pjesë e Kosovës) nuk ka dhënë sa duhet, gjë që patjetër duhet studiuar në vazhdimësi.

Fjalët çelës: trashëgimi etnokulturë, folklori burimor, rapsod, SHKA.

Abstract

This paper aims to make a reflection of ethno-cultural heritage of folklore source in Dukagjini Region in Kosovo, recognizing the situation of folklore source and its development as an important part of culture. In this paper we have treated the aspects of ethno-cultural heritage that is the source folklore in a part of Kosovo, in Peja, Deçan, Junik and Gjakovë Communes.

Dukagjini Region in general retains rich elements of ethno-cultural heritage, where you can easily notice a special folklore that differs from other regions of Kosovo or Albanian territories. There are some types of songs: highlander songs, lamenting songs, joyful songs, bravery songs etc. Popular singers with their vocals, tone and interpretation of the folklore songs, have their features that differs from other singers of the Albanian territories.

Ethno-cultural heritage and history of this region shows a very important part of Dukagjini Region which must be studied in the future.

Key words: ethno-cultural heritage, folklore source, rhapsody and NGO.

HYRJE

Ky punim, në vete paraqet të dhëna për folklorin burimor në Rrafshin e Dukagjinit dhe për zhvillimin e muzikës burimore në këto anë. Do japim të dhëna për rapsodët e njohur, për SHKA-të dhe ansamblet e njohura nga këto komuna të Kosovës që ishin njohur me aktivitetet e tyre kulturore gjatë shek. XX. Disa nga arsyet për të paraqitur këtë punim shkencor janë:

a. Muzika burimore-folklorike është një trashëgimi e pasur e etnokulturës e bartur ndër shekuj për popullin tonë.

b. Folklori burimor në Rrafshin e Dukagjinit me karakteristikat e tij që e bëjnë të veçantë nga regjionet tjera shqiptare.

c. Nga ky regjion kanë dalë emra të njohur të muzikës burimore-folklorike si Dervish Shaqa, Qamili i Vogël, Ymer Riza etj.

d. Detyrat dhe obligimet që dalin në të ardhmen për të mbajtur gjallë këtë element të kulturës shpirtërore tek populli ynë.

Struktura e punimit është: Zhvillimi i muzikës burimore-folklorike në Rrafshin e Dukagjinit, rapsodët, SHKA-të dhe grupet folklorike më të njohura në Rrafshin e Dukagjinit, Dervish Shaqa, figura kryesore e folklorit burimor, përfundimi dhe referencat.

Në këtë punim janë nxjerrë të dhëna të rëndësishme për stilin (karakteristikë) e veçantë, bartësit dhe zhvillimet kryesore të folklorit burimor në Rrafshin e Dukagjinit.

Zhvillimi i muzikës burimore-folklorike në Rrafshin e Dukagjinit

Folklori burimor, kultura shpirtërore artistike e popullore në Kosovë e me theks të veçantë në pjesën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, regjion ky shumë e pasur, që përfshinë komunat: Pejë, Deçan, Junik dhe Gjakovë. Njëra ndër pasuritë e

mëdha shpirtërore dhe shumë e rëndësishme për identifikimin tonë kulturor është muzika folklorike burimore shqipe. Folklori ynë burimor përfshinë këngët popullore që lindën nga vet populli dhe nga rapsodët popullore. Në këto këngë, u këndohej trimave e trimërive të tyre, ngjarjeve të ndryshme historike, luftërave dhe betejave të ndryshme kundër pushtuesve dhe armiqve të popullit shqiptar. (Krasniqi, 1985:173). Folklori burimor e mbajti gjallë ndër shekuj me radhë shpirtin liridashës të popullit shqiptar. Disa nga llojet e këtyre këngëve janë: këngët malësorçe (pa instrumente) këngët folklorike-rapsodike, këngë trimërie (të shoqëruara me çifteli, sharki, kavall, lahutë etj.), këngët e vajtimit, këngët e gazmendeve, këngët e grave (vajzave), këngë konagjeqi, ninullat (këngë djepi), këngë fyti, zhdjergat (nga bjeshka) etj.

Kënga burimore folklorike kurrë nuk u ndal. Ajo u trashëgua ndër gjenerata. U bë burim i pashtershëm popullor ku përmes zërit dhe teksteve popullore u përcollën brezave lavdinë e popullit tonë. Kënga popullore (burimore) luajti një rol tepër të rëndësishëm në jetën kulturore të popullit shqiptar. Ajo jo vetëm që ishte formë argëtimi, por u bë edhe mjet edukimi ndër breza, pra u bë shoku më besnik i popullit, si në gëzime ashtu edhe në vuajtje. Çdo ngjarje, çdo fitore lufte, populli (rapsodët popullore) e kanë shprehur me këngë. Populli ka shëruar plagët e veta dhe ka ruajtur moralin në nivel të lartë. (Antoni,1977:5). Thënia popullore “Vaji i burrit është kënga”, tregon karakterin etnopsikologjik të shqiptarit, qoftë si individ qoftë si bashkësi kolektive të shqiptarët (Munishi,1997:45). Argëtimi me mjete të artit popullor ka qenë shkollë e edukimit atdhetar tek njerëzit (popujt) (Tirta,2006:471). Jeta e popullit shqiptar ishte e përmbushur me këngë e valle, pra me muzikë e cila lidhet me tërë jetën që nga lindja deri në vdekje (Munishi,1997:44). Muzika i përcolli të gjitha format e manifestimit të jetës: lindjen dhe vdekjen, fejesën dhe martesën, (si të djalit ashtu të vajzës), luftën, heroizmin dhe trimërinë e individëve dhe popullit, punën dhe të gjitha aktivitetet që lidhen me jetën e një populli.

Arti dhe muzika burimore kanë qenë një ushqim shpirtëror, me të cilin populli i ka shprehur më së miri ndjenjat e tij. Gjatë periudhave nën pushtimin serb, të merreshe më këngën ishte vështirë sepse këngëtari popullor, përveç presionit dhe dhunës, nuk sillte në familje ndonjë përfitim tjetër për të jetuar, edhe pse në dasma e ahengje atëherë rapsodët popullore këndonin pa ndonjë kompensim material. Ata, këngën jo vetëm që e kishin për zemër, jo vetëm që kënaqnin masat e gjëra popullore, por i kishin vënë vetës si obligim

moral e kombëtar, sepse përmes këngës së tyre ata shpalosnin faqe të ndritura të historisë, pa marrë parasysh mundin, sakrificat dhe rreziqet që ishin prezentë gjatë jetës së tyre artistike. Rapsodët në këngët e tyre shoqëruar nën tingujt e bukur të lahutës, apo të çiftelisë, sharkisë, kavallit e fyellit, vegla këto shoqëruese për ta dhe këngën e tyre, kishin porosi në ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe atdhetare. Ata kurrë se ndalën këngën. Këndonin edhe atëherë kur ishte e ndaluar të këndohej, këndonin edhe atëherë kur nuk u këndohej, këndonin edhe atëherë kur luftohej, sepse shpirti i tyre nuk mund të ndalej as nga presioni e dhuna e ushtruar mbi ta nga pushtetet e kohës. Rapsodët popullore ishin halë në sy për pushtetin. Ata shpesh i thërrisnin në biseda informative i maltretonin e shpesh i dënonin me burg apo edhe i detyronin të largoheshin nga vendlindja për t'i ikur likuidimit fizik. Ndër ta ishin edhe Dervish Shaqa e Demush Neziri, në vitin 1956 ku u detyruan të i lënë familjet në Kosovë dhe ikën për në Shqipëri.

Në kulturën tonë popullore, deri vonë dominonte plotësisht muzika tradicionale-burimore e bartur prej gojës në vesh e shtresuar nga kultura më e hershme (Munishi,1997:44). Në vitet e shtatëdhjeta të shek. XX, krahas këngëve tjera lindi një zhanër i ri, në mbështetje të traditës sonë muzikore popullore folklorike. Këngët e kompozuar, në frymën e melosit popullor, filluan të përcillen me orkestër instrumentesh të fabrikuar. Këngë me çifteli, këngëtarë me shoqëritë e tyre u popullarizuan shumë (Munishi,1993:82). Në Kosovë, para viteve '90 përveç organizimit të dasmave familjare (organizime private) dhe koncerteve të ndryshme, vlen të përmendet organizimi i Revistës së Folklorit Burimor që mbahej në Glllogoc (Drenas) prej 4 korrikut të vitit 1961. Aty kërkoheshin të paraqiteshin krijime tipike tradicionale. (Munishi,1993:92). Në Glllogoc-Drenas, me programin e tyre artistik merrnin pjesë shumë grupe rapsodësh, SHKA, ansamble të ndryshme folklorike nga e tërë Kosova dhe viset tjera shqiptare.

Instrumentet që shoqëronin këngët folklorike kryesisht kanë qenë popullore. Këngët dikur përcilleshin vetëm me një vegël muzikore siç ishte me lahuta,e më vonë edhe me dy a më shumë siç ishin, çiftelia e sharkia, duke kaluar gradualisht në ansamble e orkestrina tjera (Syla,1990:307). Por folklori burimor në Regjionin e Dukagjinit ka veçoritë e veta dalluese nga viset e tjera shqiptare. Disa ndër karakteristikat më kryesore të folklorit burimor të kësaj treve mund ti përmendim: këngët burimore nga epika dhe lirika popullore që shoqëroheshin me lahutë, çifteli, sharki, e më vonë përcjellë edhe me instrumente tjera, si dhe këngët malësorçe-maje

krahut (këngë që këndoheshin solo dhe në duet, pa vegla muzikore). Vija melodike dallonte për nga përsosmëria dhe niveli artistik nga trevat tjera shqiptare. Tonaliteti i veglave ishte në nota të larta, këngëtarët (rapsodët) popullorë këndonin solo, duete, e më vonë edhe në këngë grupi rapsodësh, si "Grupi i Gramaçelit". Karakteristikë të rapsodët është se ata përveç këngës solo, kanë përcjellë veten gjatë këngës me instrumente popullore, çifteli e sharki, pra kanë luajtur dy role si këngëtarë-solistë, por edhe si instrumentistë .

Rapsodët, SHKA-të dhe grupet folklorike më të njohura në Rrafshin e Dukagjinit

Rrafshi i Dukagjinit dallohet për trashëgiminë etnokulturore dhe folklorin burimor që është edhe thesar i kulturës sonë shpirtërore kombëtare. Për vlerat e folklorit burimor të këtij regjioni flasin aktivitetet e shumta, dëshmojnë çmimet e marra nëpër festivalet anë e kënd trojeve shqiptare nga shoqëritë dhe grupet e rapsodëve të këtyre anëve para dhe pas luftës së fundit (1998/99), vlerësuar gjithmonë nga juritë profesionale. Nga Rrafshi i Dukagjinit, përkatësisht nga Peja, Deçani, Juniku dhe Gjakova kanë dalë emra të mëdhenj të muzikës burimore. Rapsodët më të mirënjohur nga këto anë janë: Sadik Meta, Zenel Ademi, Dervish Shaqa, Demush Neziri, Demë Ali Taraku, Qamili i vogël, Lan Dobra, Bajrush Doda, Zenun Gashi, Shaqë Avdia, Smajl dhe Brahim Aliqkaj, Haxhi Zhuti, Hysen Uka, Musë Alia, Bilall Arifi, Marash Krasniqi, Mon Sokoli, Rrahmon Imeri, Agustin Uka, Idriz Luma etj. Kjo gjeneratë e "artë" e këtyre rapsodëve nuk përfundon këtu, mbetet për të vazhduar më vonë gjenerata më e re e rapsodëve popullorë, e përbërë nga emra tjerë të dalluar të muzikës folklorike-burimore në Kosovë e më gjerë në viset tjera shqiptare. Muzika folklorike, ruajtja dhe kultivimi i saj në këto anë, gjatë fundshekullit XX, ishte organizuar në SHKA dhe ansamble të ndryshme folklorike e popullore. Grupet muzikore më të njohura në komunën e Pejës janë: Ansambli Autokton "RUGOVA", SHKA "Ramiz Sadiku", SHKA "Dardania", "Xhemail Kada" etj. Në komunën e Deçanit janë: SHKA "Shpresa", SHKA "Jusuf Gërvalla", SHKA "Vëllazëria", SHKA "Mehmet Riza", SHKA "Përparimi". Në Junik SHKA "Tafë Gaxherri". Në komunën e Gjakovës, Grupi i Ymer Rizës, SHKA "Hajdar Dushi", SHKA "Jahë Salihu", Ansambli "Shqiponja e Dukagjinit" etj.

Dervish Shaqa, figura kryesore e folklorit burimor

(1912-11.4.1985)

I lindur në fshatin Llukë e Epërme të Deçanit. Dervish Shaqa me këngë kishte filluar të merrej qysh në jetën e hershme të tij. Ai, së bashku me Demush

Nezirin, kishin filluar të këndonin duke u bërë rapsodë me emër. Dervish Shaqa me zërin e tij të ëmbël, me këngën dhe melodinë aq sa origjinale edhe të bukur e artistike, me tekstet e këngëve që ishin me motive patriotike u këndonte trimave e ngjarjeve të ndryshme historike, i këndonte edhe jetës, por me shije dhe me një mjeshtri të rrallë i këndonte edhe këngët lirike. Ai ishte instrumentist me çifteli, sharki dhe fyell, ishte edhe mjeshër i veglave popullore. Ai bëri emër në këto anë ,por jo vetëm si rapsod e instrumentist e valltar por u bë një simbol i virtyteve burrërore apo lirisht mund të quhet "*Orife i dukagjinit*" (Mehmetaj,2007:20).

Nuk kaluan shumë kohë dhe Dervishi me këngën e tij, me qëndrimin e tij burrëror, u bë halë në sy për pushtetin komunal në Deçan. Organet sekrete serbe të UDB-së filluan t'i bënin presion, ta maltretonin në forma të ndryshme. Ishin kohë të liga për shqiptarët, aksioni i armëve gjatë vitit 1955-56, shumë shqiptarë keqtrajtoheshin, dënoheshin, shpërnguleshin e vriteshin. Nga ky presion u detyrua të linte familjen, të linte Kosovën, e të kalonte në Shqipëri. Më 8 mars 1956, pa rënë në duart e UDB-së së bashku me Demush Nezirin, Adem Ramën dhe nipin e tij Isë Hoxha nga Botusha nisën rrugëtimin për në Shqipëri (Hysenaj,2003:18).

Dervish Shaqa ,pas vendosjes në Rrashbull të Durrësit në Shqipëri e rifilloi jetën artistike së bashku me Demush Nezirin, e me grupin kosovar të folklorit nga Rrashbulli. Ai u bë bërthama e këtij grupi folklorik. Dervishi, si këngëtar me vlera shumë të veçanta artistike, tërhiqte vëmendjen nëpër skenat e vendit. Në festivalet e organizuara në Gjirokastrë, në vitet 1968, 1973, 1978, 1983 (Bogdani,2011:591)Ai ka qenë një subjekt interesant i vlerësuar shumë nga Instituti i Kulturës Popullore të Shqipërisë, sidomos nga studiuesi Qemal Haxhihasani (Bogdani,2011:591). Për Dervish Shaqën, Ramazan Bogdani do të shprehej: "është thesar i kulturës popullore shqiptare". Përveç këngës Dervishi ishte edhe valltar popullor shumë i dalluar. Së bashku me Demush Nezirin janë paraqitur edhe në skenën e festivalit në Gjirokastrë në vitin 1968, si valltarë në duet me vallen "Loja me jataganë" (Bogdani,2011:604) .

Dervish Shaqa është njëri ndër këngëtarët legjendarë të shekullit (shek. XX), të epikës historike të shqiptarëve. Me aftësinë magjike të artit, gjegjësisht këngës, për gjashtëdhjetë vite me radhë e ktheu lotin në këngë, dhimbjen në forcë, e heshtjen në kushtrim (Mehmetaj, 2007:20). Këngët dhe zëri i tij përhapeshin në Kosovë përmes valëve të Radio Tiranës, Radio Kukësit etj.

Këngët më të njohura të Dervish Shaqës janë: "Moj Shqipni mos thuj marova", "Pyt Kosova për një

çikë", "Kamer Loshi", "Ahmet Delisë", "Halil Mehmeti", "n'Kaçanik deri n'Boletin", "Bajram Currit", "Isa Boletinit", "Te shtatë krajlrat rrehin telin", "Azem Bejtës", "Isuf Idrizit", "Nak Berishs", disa nga këngët lirike: "N'drrasë të vekut kush po kanë/hajde more bylbyl qe po.../moj e mira n'derë të stanit" etj. Shumica e këngëve të tij ishin origjinale nga Dervish Shaqa si për nga vija melodike ashtu edhe teksti i tyre. Në Arkivin e Institutit të Kulturës Popullore dhe të Radio Tiranës, gjenden një sërë këngësh të regjistruara. Dervish Shaqës për talentin që kishte, angazhimin dhe kontributin në fushën e folklorit burimor në vitin 1980 nga shteti shqiptar ju akordua titulli "Artist i Merituar". Shteti shqiptar e nderoi me këtë titull artistik ku deri në fund të jetës së tij e mbajti me dashuri e përkushtim (Bogdani, 2011:605). Dervish Shaqa ishte urë lidhëse nga gjenerata në gjeneratë. Rapsodi i mirënjohur shqiptar, ishte sinonim i mirëfilltë i këngës shqipe, i folklorit shqiptar, por ishte edhe sinonim i vuajtjeve dhe i persekutimit të shqiptarëve nën zgjedhën jugosllave. Këngët e tij, përveç melodisë, dhe energjisë së tij si këngëtar ato kanë edhe porosinë për brezat (Bekolli, 2002:17).

Pjesa më e madhe e rapsodëve të Dukagjinit, frymëzimet e para i morën nga Dervish Shaqa (Mehmetaj, 2007:21). Për folklorin, për rapsodët është një legjendë e pavdekshme. Ai është përjetësuar nga rapsodët tjerë popullorë në këngë, me respekt e dashuri. Rapsodi popullor sot këndon "Hajde këndojmë qysh ka këndua baca, shtylla e këngës Dervish Shaqa". Sipas dëshmimeve të familjes, Dervishi disa herë ishte futur fshehtas nga Shqipëria, në Kosovë kujtonte i biri i Dervishit, Aliu. Ai kujton disa momente të veçanta e prekëse për jetën, mallin për babanë, kujton vuajtjet e tij dhe të familjes së tij në Llukë të Epërme nga pushteti i kohës. Ishin çdo herë në shënjestër të organeve të pushtetit (Selmanaj, 2008:139). Shpesh keqtrajtoheshin, arrestoheshin, burgoseshin nga UDB-jugosllave. Dervish Shaqa vdiq më dt.11.4.1985, me mall për familjen, për vendlindjen dhe për Kosovën.

BIBLIOGRAFI

- Antoni Lorenc, (1997), *Folklori muzikor shqiptar*, Bleni shtatë, Prishtinë: Rilindja.
- Bogdani Ramzan, (2011), *Etnokoreografi IV*, Tiranë: Toena.
- Faton Mehmetaj, *Një jetë kushtuar këngës Dervish Shaqa*, "Fokusi", Prishtinë, 29.6.2007.20
- Haki Hysenaj, Bekim Vishaj, *Gjurmëve të rapsodëve Dukagjinas 2*, "24 orë", Prishtinë, 25.7.2002, fq. 18.
- Krasniqi Mark, (1985), *Lugu i Baranit*, Prishtinë: Rilindja.
- Munishi Rexhep, "Mbi fenomenin e këngëve të reja", IAP, Gjurmime Albanologjike, Folklor dhe etnologji, nr. 21, Prishtinë, 1993, fq. 82.
- Munishi Rexhep, "Mitet mbi kultet mbi muzikën përmes frazeologjive popullore", IAP, Gjurmime Albanologjike, Folklor dhe etnologji, nr. 27, Prishtinë, 1998, fq. 45.
- Selmanaj Rasim, (2008), *Hijet e Thyera*, Prishtinë: Fokusi.



PËRFUNDIME

Jemi përpjekur të japim të dhëna për zhvillimin e folklorit në këtë rajon të Kosovës. Kemi përmbledhur të dhënat për karakteristikat e folklorit në Rrafshin e Dukagjinit, për personalitetet (rapsodët), SHKA-të dhe ansamblet me të njohura në këto komuna (Pejë, Deçan, Junik e Gjakovë). Duke paraqitur zhvillimet kryesore, aktivitetet kryesore, bartësit kryesorë të zhvillimit të etnokulturës, folklorit burimor. Sigurisht që ka shumë për t'u bërë, për të ndriçuar këtë fushë të etnokulturës, folklorin burimor. Nga kjo që paraqitëm në këtë punim, vërtetua se folklori burimor në Rrafshin e Dukagjinit ka karakteristikat e veta që e bëjnë të veçantë nga regjionet tjera shqiptare. Njëkohësisht vërtetua se, nga ky regjion kanë dalë emra të njohur të muzikës burimore-folklorike, si: Dervish Shaqa, Qamili i Vogël, Ymer Riza etj., po ashtu identifikua shumë grupe dhe shoqëri kulturo-artistike, të cilat kanë qenë prezentë me aktivitetet e tyre kulturo-artistike dhe që lanë gjurmë në ruajtjen dhe zhvillimin e folklorit burimor në këto anë.

Mund të themi lirisht se brezat e kaluar e kanë kryer obligimin e tyre moral e kombëtar, kanë ruajtur vlera shpirtërore të mirëfillta autoktone, por që mbetet obligim dhe detyrim për të ardhmen nga institucionet kompetente, për të punuar me fanatizëm për të mbajtur gjallë folklorin burimor si njërin ndër elementet më të rëndësishme të kulturës shpirtërore të populli ynë.

Syla Fazli, *“Burimorja dhe transformimi i traditës në festivale krahinore”*, IAP, Studimi etnografik i ndryshimeve Bashkëkohore në Kulturën popullore Shqiptare, Prishtinë, 1990, fq. 307.
Tirta Mark, (2006), *Etnologjia e Shqiptarëve*, Tiranë: Geer.
Zeqir Bekolli, *Dervish Shaqa një zë i bukur i shqiptarisë, “24 orë”*, Prishtinë, 27.7.2002, fq. 17.

EPOSI HOMERIK" DHE TË DHËNA TË TJERA PËR HOMERIN DHE VEPRËN E TIJ

DION TUSHI

DEPARTMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Pavarësisht futjes dhe konsolidimit të këtij emri në fillesat e letërsisë antike greke, me dy kryeveprat e para të kësaj letërsie, përkatësisht me Iliadën dhe Odisenë, shpesh prej disa studiuesve është vënë në dyshim ekzistenca e një personi që lidhet me këtë emër. Por, pavarësisht këtyre dyshimeve, mendohet se ka ekzistuar një Homer, i cili mendohet të ketë lindur aty nga fundi i shekullit VIII para Krishtit. Që nga skeptikët si Aristoteli, deri tek autorët më pak skeptikë si Herodoti, e dinin se në një farë mënyre, ka ekzistuar dikur një Homer. Të bën përshtypje shprehja e studiuesit Radguard Kipling, i cili thotë se kur Homeri i binte lirës, të gjithë e dinin se ai vargjet i kishte vjedhur diku; dhe se ai vetë e dinte se të tjerët e dinin këtë gjë. Samuel Butler, në veprën e tij "Shkrimtarja e Odisesë" (1897), hedh idenë se Homeri ka qenë gjysmë grua. Mendimet e studiuesve të ndryshëm në kohë të ndryshme kanë qenë të ndryshme në lidhje me ekzistencën dhe përkatësinë e Homerit.

Fjalë çelës: *Homeri, epos, Margiti.*

Abstract

Despite the introduction and consolidation of this name in ancient Greek literature, with the first two masterpieces, respectively Iliad and Odyssey, often several researchers questioned the existence of a person related to this name. But despite these doubts, it is thought that there was a Homer, who is believed to have been born around the end of the eighth century - BC. Different authors, sceptics as Aristotle, or less sceptical authors like Herodotus, they knew that somehow, there was a Homer. The researcher Radguard Kipling says that when Homer plays the lyre, everyone knew that he had stolen some verses; and that he is conscious that others knew about it. Samuel Butler, in his work "The writer of the Odyssey" (1897), gives the idea that Homer was half woman. The opinions of different researchers in different times were different about the existence and gender of Homer.

Key words: *Homer, epic, Margiti.*

Hyrje

Për shumë kohë katedrat helenistike dhe studiues të ndryshëm të letërsisë antike greke, në punimet dhe tezat e tyre hedhin dritë gjithmonë e më shumë mbi këtë letërsi. Në këtë artikull jemi përpjekur të sjellim të dhëna të reja në lidhje me eposin homerik, për Homerin dhe veprat e tjera të panjohura të tij. Pavarësisht futjes dhe konsolidimit të këtij emri në fillesat e letërsisë antike greke, me dy kryeveprat e para të kësaj letërsie, përkatësisht me Iliadën dhe Odisenë, shpesh prej disa studiuesve është vënë në dyshim ekzistenca e një personi që lidhet me këtë emër. Por pavarësisht këtyre dyshimeve, mendohet se ka ekzistuar një Homer, i cili mendohet të ketë lindur aty nga fundi i shekullit VIII para Krishtit. Që nga skeptikët si Aristoteli, deri tek autorët më pak skeptikë si Herodoti, e dinin se në një farë mënyre, ka ekzistuar dikur një Homer. Të bën përshtypje shprehja e studiuesit Radguard Kipling, i cili thotë se kur Homeri i binte lirës, të gjithë e dinin se ai vargjet i kishte vjedhur diku; dhe se ai vetë e dinte se të tjerët e dinin këtë gjë. Samuel Butler, në veprën e tij "Shkrimtarja e Odisesë" (1897), hedh idenë se Homeri ka qenë gjysmë grua. Mendimet e studiuesve të ndryshëm në kohë të ndryshme kanë qenë të ndryshme në lidhje me ekzistencën dhe përkatësinë e Homerit.

Letërsia greke fillon me eposet homerikë, d.m.th. me vepra të pjekura dhe perfekte. Studimet e bëra gjysmë shekulli më parë, të cilave iu hapën rrugën zbulimet e Shlimanit (Schliemann), na treguan mbas dritës rrezatuese të këtyre poemave një mijëvjeçar të historisë greke brenda kuadreve të turbullta (H. Bengston, Griech, Geschichte, Mynih 1960).

Nuk jemi akoma në gjendje të përcaktojmë ekzakhtësisht, kohën kur fiset helene mësyjnë nga veriu për në jug të Ballkanit, megjithatë përafërsisht mund ta vendosim këtë ndodhi në fillim të mijëvjeçarit të dytë (O. F. Hampl, Die Chronologie der Einänderung der griech..., Mus. Helv, 17, 1960). Ata që u futën në jug, gjetën një vend, në të cilin zhvillimet e ndryshme në një epokë të vonët të historisë së tokës kishin krijuar një strukturë tepër të pasur (A. Philipson, Beitrage zur Morphologie Griechenlandes, Stuttgart 1930). Deti hynte kudo brenda tokës dhe ftonte drejt horizonteve të largëta, të cilat pengoheshin në brendësi të gadishullit prej vargmaleve të lartë. Kjo strukturë është e pasur në mënyrë të veçantë në bregun lindor, prej së cilës ura ishullore të shumta drejtohen për nga ana tjetër, në bregun perëndimor të Azisë së Vogël, e cila hapet po në të njëjtën mënyrë drejt detit. Këto udhë të komunikimit kanë qenë të

hapura qysh më parë dhe kanë qenë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës greke.

Grekët nuk kane qenë të parë që janë vendosur në këtë tokë. Gjetjet arkeologjike të kësaj toke, na informojnë se të ardhurit takuan qytetërime më të hershme, të cilët kishin patur një zhvillim të madh. Shkenca përpiket që të dallojë shtresëzimet e tyre dhe të evidentojë ndikimet që ato patën në qytetërimin helen. Vetë grekët dhanë informacione për popuj të huaj, si: pellazgët, karet dhe lelekët. Studiuesit flasin për një shtresëzim egjeik. Përzjerja e të ardhurve indoevropianë dhe popullatat që gjetën, ndikoi në gjenezën e popullit grek. Ky takim i dyfishtë krijoi kushtet paraprake për zhvillimin e qytetërimit perëndimor. Pikërisht, këtu kuptojmë dhe tërësinë e prirjeve kontradikore, të cilat kanë ndikuar jetën shpirtërore të grekëve. Kjo kundërvënie e gjatë në kohë, duhet të jetë zhvilluar me mënyra ta ndryshme, paqësore dhe luftarake, pasi edhe ardhja e popullatave shtrihet në intervale të gjata kohore.

Që nga shekulli XVI, shfaqet një qytetërim, të cilin e quajmë "Qytetërimi Mikenas" dhe që evidentohet me kështjellat e fuqishme të Argolidhës, të Peloponezit Perëndimor dhe të gjirit të Biotisë. Gjetjet tregojnë se sa fort ky helenizëm nismëtar ndodhej në ndikimin e qytetërimit të pasur të huaj, i cili rrezatonte në mënyrë të përgjithshme, gjatë gjysmës së parë të mijëvjeçarit të dytë nga ishulli i Kretës. Rreth viteve 1400, fuqia e Qytetërimit mikenas shkon drejt fundit, ndërkohë që qysh më përpara popullatat greke kishin fituar pozicione të forta në këtë ishull, mbas dyqind vjetësh, këtij qytetërimi i erdhi fundi. Pra, shumë kohë dorët u konsideruan si shkaktarë të kësaj tragjedie, bile disa studiues mendojnë se ishin dorët ata që erdhën në Jug të Ballkanit. Gjithmonë e më tepër sot, në rrethet e studiuesve historianë, po mbizotëron mendimi se dorët depërtuan në vendet e tyre të mëvonëshme si shoqërues të fiseve barbare që aty rreth vitit 1200 mësynë nga Veriu në Mesdheun Lindor dhe sollën një shkatërrim të madh në kufijtë e Egjiptit dhe Mesopotamisë (P. Kretschmer, *Die phrygische episode in der Geschichte von Hellas, Miscellanea Acad. Berolinensia* 1950). Është e vështirë të përcaktohet përkatësia etnike e këtyre turmave, por ka mundësi që një rol të rëndësishëm në mes të tyre të kenë luajtur elementët ilirë dhe frigë. Këta popuj veriorë dhe detarë, të cilëve ju nënshtrua dhe shteti i Keteonit në Lindje, ka mundësi që të kenë parapërgatitur edhe fundin e këtyre qendrave në mijëvjeçarin e dytë. Kaq i dhunshëm ishte shkatërrimi që zhduku qytetërimin mikenas, sa më pas pasojnë të ashtuquajturit shekujt e errët, për të

cilët studiuesit nuk dinë pothuajse asgjë, përsa i përket jetës helene gjatë kësaj periudhe. Por, kjo dyndje e re e fiseve helenike krijoi ndërkohë edhe mundësinë për një shtysë të re që solli në shekullin VIII, fundin e ritmit gjeometrik dhe zhvillimin e poezisë epike.

Bashkimi fisnor, apo më mirë të themi dialektologjik i disa formave filologjike greke, na bën që ti hedhim një sy strukturimit të popujve grekë. Në vija të trasha themi se një vijë e gjatë e ngulimeve jonike, shtrihet nga Evja, duke kaluar nga Qikladhet, deri në bregun qendror dhe jugperëndimor të Azisë së Vogël, një seksion i kësaj vije është edhe Atika, që më pas do të bëhet qendra e qytetërimit grek. Fiset eolike u instaluan përgjithësisht në veri të kësaj vije të gjatë. Me Biotinë dhe Thesalinë, bregun perëndimor të Azisë së Vogël në pjesën e saj veriore dhe ishulli i Lesbos, caktojnë përfundimisht zonën eolike. Në kuadrin e dyndjeve të mëdha të popujve rreth viteve 1200, dorët veriperëndimorë, u vendosën në vende të reja. Kështu, dorët zunë Peloponezin jugor dhe lindor, por u instaluan edhe nëpër ishuj, kryesisht në Kretë dhe Rodhos, si dhe në seksionin jugperëndimor të bregut të Azisë së Vogël. Grekët veriperëndimorë e morën emrin e tyre nga zona ku jetonin, por kontribuan si element përzjerës edhe në formëzimin e popullatës së Thesalisë dhe Biotisë. Në Peloponezin verior dhe perëndimor morën në zotërimin e tyre zonat e Ahaiës dhe Ilidas. Kështu, grekët veriperëndimorë dhe dorët rrethuan nga të gjitha anët Arkadinë e larguar nga deti, e cila mbeti zona e largimit të popullatës paradorike. Nga mbetjet e kufizuara dhe problematike në këtë vend, evidentohet një dialekt i hershëm, i cili afrohet me dialektin që njihet të Qipros dhe tregon afinitet me gjuhën Pamfilës në jug të Azisë së Vogël.

Ndarja e dialekteve në epokën historike është përgjithësisht e qartë dhe mund të planimetrohët pa vështirësi në një hartë, siç është harta e gramatikës së Schëyzer (1,83), ndërkohë që shtresëzimet dhe shmangiet që erdhën si rezultat i emigrimit dorik, mund të evidentohen pa ndonjë vështirësi të madhe në kushtet e mëvonshme, për historinë fillestare të dialekteve greke krijohet një tërësi problemesh, të cilat po hulumtohen nga studiues të ndryshëm. Problemet kryesore që lindin natyrshëm janë këto: Që kur mund të flasim për grupe fisnore dialektologjike të përcaktuara, ashtu siç do nënkuptoheshin më vonë? Cila është lidhja midis gjuhës helenike mikenase të tabelave të shkrimit B, për të cilën do të flasim, me dialektet që dimë? Si do ta gjykojmë lidhjen e dialektit arkado qipriot me to?

Shumë studiues mendojnë se duhet të flasim për dy prurje të mëdha emigrimi në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë, dhe se me to erdhën grupe

fisnore me përbërje të ndryshme në Jug të gadishullit të Ballkanit. Sot, kjo teori vihet në dyshim, dhe kjo, dhe kjo falë teorisë dhe shpjegimeve që dha Paul Kretschmer, sipas së cilës, një dyndje të vjetër jonike e pasoi një dyndje tjetër më e re eolike (P. Kretschmer, Gercke – Norden, *Einleitung in die Altertumsëissenschaft*, Leipzig 1927).

Së pari, duhet thënë se teoria e pemës gjeneologjike të fiseve, e cila mbizotëroi për shumë kohë, në vitet e mëvonshme u vu në dyshim. As gjuhët me radhë nuk mund të lindnin drejtpërdrejt nga një njësi fillestare indogjermanike, por as nuk mund të përdoret një kompozitë analoge për lidhjet e dialekteve me një gjuhë të përbashkët parahelenike. Në vend të një njësie të supozuar shfaqet një shumëllojshmëri formash nga gjuhë të barabarta, ku zonat e shtrirjes së tyre shprehin ndryshime të mëdha. Kjo për më tepër ka vlerë për gjuhën greke, ashtu siç tregojnë edhe studimet e Ernst Risch, i cili mundi të tregonte se fenomenet në fjalë shtriheshin dikur tërësisht përtej kufijve të ndryshëm dialektologjikë. Pra ajo që u shfaq fillimisht nuk është uniteti por moria e dialekteve të ndryshme. Në përputhje me këto Risch, gjen tipa të rinj gjuhësorë bë dy dialektet e rëndësishme greke, në atë jonik dhe dorik, të cilat morën formën e tyre të veçantë vetëm me dyndjet dhe lëvizjet që pasuan epokën mikenase. Këtu duhet ndërkohë të shënojmë se kur Kretschmeri i konsideronte jonët si shtresa më e parë, nuk kishte parasysh bonët e Azisë së Vogël, por format më të hershme të tyre.

Inkuadrimi i gjuhës greke, i cili u bë i njohur me shkrimin e tabelës B rezultoi i vështirë. Kjo konsiston nga njëra anë me natyrën e këtyre monumenteve shkrimore, dhe nga ana tjetër se paralelisht me lidhjet e dukshme me dialektin arkado – qipriot, mund të evidendohen edhe lidhje me dialekte të tjerë. Këtu përballëvihen dy shpjegime. Risch (E. Risch, *Fruhgeschichte der griech. Sprache*. Helv. 1969), bazuar në teorinë e tij për lindjen e dialekteve, shikon tek gjuha mikenase një pjesë të prohistorisë së gjuhës greke, që përtaqet pasurisë fonetike dhe rasave nuk ka arritur akoma në kompleksin karakteristik të tij, ndërsa përkundrazi Georgievi e konsideron formën gjuhësore për të cilën po flasim si përfundim i mbishtresimit të dialektit eolik më të ri mbi elementët jonikë. Këto situata janë akoma objekt studimi për specialistët.

Duhet thënë se dy ngjarje para Homerit, krijuan kushte të favorshme për letërsinë greke, këto janë lindja e shkrimit grek dhe krijimi i mitit.

Për shkrimin e mijëvjeçarit të dytë, mund të themi se në Knosso të Kretës dhe në kështjellat

epirote të Pilos dhe Mikenës, janë zbuluar disa qindra tabela balte, të shkruara me shkrimin silabik (e vargëzuar), që quhen me emrin e përbashkët Shkrimi B dhe vijnë nga një epokë e viteve 1400 – 1200 (M. P. Nilsson. *The Mycenaean Origin of Greek Mythology*, Berkeley 1932), si rezultat i një studimi të suksesshëm të Michael Ventris, dimë se këtu është përdorur një sistem simbolesh vargëzuese, e cila u zhvillua nga shkrimi i vjetër kretan, shkrimi A, për një dhënie më të ashpër të fjalëve greke. Përfitimi që pati letërsia greke nga sistemi shoqëror dhe gjendja ekonomike e botës mikenase nuk është akoma e mundur të përcaktohet. Gjetjet arkeologjike vërtetojnë për momentin se kemi të bëjmë me një klasë shkruarësh në shërbim të administrimit, ndërkohë që nuk mund të thuhet nëse zotërinjtë e tyre dinin të shkruanin. Gjithsesi në lidhje me këto tabela me gërma greke të mijëvjeçarit të dytë mund të thuhet se kanë vlerë të pallogaritshme për historinë e gjuhës greke, studimi dhe vlerësimi i të cilave është akoma shumë i vështirë dhe siç u theksua edhe më lart problematik. Funksionimi i këtij sistemi shkrimi, që realisht nuk ishte eficient për nevojat që mbartte gjuha greke nuk dihet akoma, ai do të ketë humbur me shkatërrimin që solli dyndja dorike (D. Sterling Minoan *Ériting*, *Am. Journ. Arch.* 58, 1954). Mbas këtij shkrimi, monumenti më i lashtë i shkrimit grek na paraqitet në një verëmbajtëse atike të gjysmës së parë të shekullit VIII. Për arsye se këtu kemi të bëjmë me një tip shkrimi të arritur dhe të rrjedhshëm, zbulimi shkrimit të gërmave vendoset të paktën 100 vjet më parë, nga epoka e kësaj ene.

Nilsson është i mendimit se formëzimi i mitit grek filloi nga epoka mikenase. Megjithatë, e dyshimtë është që shumë nga mitet e njohura të jenë krijuar qysh atëherë. Më e mundur është që baladat heroike greke të jenë formëzuar, ashtu siç i njohim, gjatë shekujve të quajtur të errët, d.m.th. midis shekujve XII dhe VIII . Natyrisht që këto mite lidheshin, ashtu siç e tregoi në mënyrë të pakontestueshme edhe Nilsoni, me qendrat e mëdha të kulturës mikenase, pasi ato nga njëra anë me traditën e tyre të ndryshme dhe nga ana tjetër si gërmadha imponante që ishin, flisnin shumë qartë për shekujt që pasuan rënien. Kështu, në një këndvështrim, legjenda nënkupton gërmadha. Grekët si popull, ashtu si edhe mitet e tyre janë produkt i bashkimit të elementëve evropianë dhe mesdhetarë. Një numër i madh perëndish dhe heronjsh në mitet greke kanë emra jo grekë, kjo gjë lidhet me problemin që evidentuam për sa i përket gjuhës dhe na bën që të llogaritim edhe një koeficient të tretë, ndikimin e kulturave të lashta të Lindjes. Këtë gjë duhet që ta kemi mirë parasysh, për

periudhën kur Fenikasit, mbas katastrofës kretase dhe më pas shkatërrimit mikenas, zotëronin në tregti dhe ishin ndërmjetësit më të përshtatshëm.

Nëse biem dakord që të mos flasim për letërsi, në kuptimin e fjalës së shkruar përpara Homerit, kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur poezi. Mund të supozohet se miti kalonte gojë më gojë si një tregim i thjeshtë prozaik, por jeta e tij e vërtetë gjendej në eposin heroik, ushtrimi i të cilit arrinte pa dyshim mbrapa në periudhën mikenase. Kur flitet për Homerin jepet mundësia që të detajohemi më tepër për këtë. Është Homeri që na dëshmon se në martesë dhe vdekje, nëpër festa dhe në valle, në adhurimin e perëndive, por edhe në jetën e përditshme, këndoheshin këngë si ato që dimë për periudhën e mëvonshme (W. Schadeealdt, Von Homers welt und werk, Stuttgart 1989). Të gjitha këto kanë humbur. Gjërat ndryshuan kur disa grupime fetare donin që të lartësonin primatët e tyre, si p.sh., Orfean dhe Museon, duke kërkuar që t'i vendosnin ata në kohë para Homerit.

Të dhëna mbi Homerin

Pavarësisht futjes dhe konsolidimit të këtij emri në fillesat e letërsisë antike greke, me dy kryeveprat e para të kësaj letërsie, përkatësisht me Iliadën dhe Odisenë, shpesh prej disa studiuesve është venë në dyshim ekzistenca e një personi që lidhet me këtë emër. Por pavarësisht këtyre dyshimeve, mendohet se ka ekzistuar një Homer, i cili mendohet të ketë lindur aty nga fundi i shekullit VIII para Krishtit. Që nga skeptikët si Aristoteli, deri tek autorët më pak skeptikë si Herodoti, e dinin se në një farë mënyre, ka ekzistuar dikur një Homer. Të bën përshtypje shprehja e studiuesit Radguard Kipling, i cili thotë se kur Homeri i binte lirës, të gjithë e dinin se ai vargjet i kishte vjedhur diku; dhe se ai vetë e dinte se të tjerët e dinin këtë gjë. Samuel Batler, në veprën e tij "Shkrimtarja e Odisesë" (1897), hedh idenë se Homeri ka qenë gjysmë grua. Mendimet e studiuesve të ndryshëm në kohë të ndryshme kanë qenë të ndryshme në lidhje me ekzistencën dhe përkatësinë e Homerit.

Megjithatë le ta gjykojmë ekzistencën e tij në lidhje me dy veprat, Iliada dhe Odiseja, të cilat u konsideruan nga grekët e vjetër si maja e arritjeve letrare të tyre, çka u vërtetua gjatë shekujve që pasuan nga e gjithë bota. Pasazhet e teksteve që u gjetën në papiruset egjiptiane nga këto vepra ja u kalojnë në numër të gjithë shkrimtarëve të tjerë dhe veprave të tyre të marra së bashku, përbëjnë bazën e shumë tragjediave dhe bëhen objekt referimi i të gjithë studiuesve, krijuesve dhe historianëve. Është vërtet intriguese të nxjerrësh të dhëna për Homerin dhe poezinë e tij, siç kanë bërë shumë autorë, studiues dhe arkeologë, prej të cilëve mund të

përmendim Tomas Balguel, apo Shlimanin, porse përsëri Homeri me shumë profesionalizëm i humbet përsëri gjurmët.

Mospërkimet që lindin dyshime.

Kështu, duke ju referuar traditës, armët e bronxta janë kudo të përmendura në Iliada, ndërkohë që hekuri është i rrallë, fakt që të bën të mendosh se poema përshkruan një betejë të Epokës Mikenase të Bronxit. Megjithatë të vdekurit siç del nga kjo poemë, digjeshin dhe asnjëherë nuk varroseshin, një praktikë kjo që lidhet me Epokën mbas Mikeniane të Hekurit. Shigjeta dhe përdorimi i saj janë historikisht të parakordueshme. Po ashtu edhe gjuha është tregues i një mospërkimi. Për sa i përket gjuhës mbizotëruese këtu kemi dialektin jonik, por ka gjithashtu edhe elementë të dialektit eolik, si dhe gjurmë të dialektit arkado – qipriot. Me të drejtë lind pyetja, nëse këto janë shtresime gjuhësore, që me kalimin e kohës i janë ngjitur origjinalit të dhënë në formë gojore? Apo mos ndoshta karakteristikat e ndyra të miteve anonime të cilat u mbyllën në një cikël, ju përngajnë, bie fjala, tullave të një teatri romak, të cilat u përdorën më pas në një tempull gotik?

Gjithsesi për grekët e vjetër, Iliada dhe Odiseja nuk ishin vepra të një poeti, por vetë poeti. Qytetarët e Argosit, ishin kaq të impresionuar nga përmendja e tyre në Iliadë, saqë bënë një shtatore bronxi të Homerit dhe në mënyrë të përditshme bënin sakrificë për nder të tij.

Shtatë qytete greke, si: Argosi, Athina, Hiosi, Kolofona, Rodhosi, Salamina dhe Smirni (Izmiri), pretendojnë se janë vendlindja e Homerit, megjithëse duhet thënë se ky pretendim u ngrit mbas vdekjes së tij. Pavarësisht se më lart ne kemi vendosur një cak kohor përse i përket lindjes së Homerit, koha se kur ai ka lindur vihet në dyshim. Kështu Eratostheni e vendos lindjen e tij rreth vitit 1159 para Krishtit, kohë kjo kur kujtimi i Luftës së Trojës ka qenë akoma i gjallë, megjithëse ka një mori datash të tjera lindjeje të Homerit, që arrin deri në vitin 685 para Krishtit. Studiuesit më të shumtë kanë arritur në një marrëveshje dhe e vendosin lindjen e tij për nga fundi i shekullit IX para Krishtit. Babai i tij quhej Meon, për disa studiues të tjerë ai quhej Melis, Mnisagoras, Demon, Thamir, ose Menemah, dhe mund të ketë qenë shitës, ushtar, apo mësues i fesë, ndërsa përse i përket nënës së tij, mendohet se ajo mund të jetë quajtur Mitis, Krithis, Themisto, Evgnetho apo edhe Melis, njësoj si babai i tij. Një gjenealogji që ka qarkulluar për të që në antikitet, e nxjerr Homerin, si pasardhës të perëndisë Apolon, duke futur këtu dhe poetin mitik Orfean dhe gruan e tij musën Kaliopi, megjithëse thuhet se kjo ka qenë edhe nëna e tij. Perandori Adrian u përpoq që të

hidhte dritë mbi biografinë e Homerit, thuhet se ai pyeti orakullen Sivilla për këtë gjë, dhe ajo ju përgjigj se Itaka ka qenë atdheu i tij, Telemaku i ati i tij dhe Epikasti, e bija e Nestorit, nëna që e solli në jetë, dhe se ka qenë një njeri më i ditur se të gjithë të tjerët. Nëse orakullja ka thënë të vërtetën, dhe Telemaku, i biri i Odisesë, ka qenë i ati i Homerit, atëherë poema e tij Odiseja është biografia e gjyshit të tij dhe ndërkohë një epos.

Homeristët dhe të dhëna për Homerin

Në ishullin Hios, një grup rapsodësh të mëvonshëm, të cilët vetëquheshin homeristë apo bij, paraardhës të Homerit, studionin thellësisht, recitonin dhe ruanin veprat e poetit. Këtu me të drejtë lind pyetja, nëse ka pasur pasardhës të Homerit në kuptim të drejtpërdrejtë, apo metaforik? Joan Xexis (1110 – 1180) një studiues bizantin, që ishte ndërkohë poet dhe komentues i poetëve antikë, thotë se një poemë të titulluar Epose Qipriote, e cila përshkruan Luftën e Trojës dhe mendohet se i takon dikujt të quajtur Stasino, është në pjesën më të madhe e shkruar prej Homerit dhe i është dhënë poetit Stasino së bashku me një shumë monetare, si prikë. Çka të shtyn të mendosh se Homeri ka pasur një vajzë. Eposet Qipriote lidhen gjithashtu me emrin e Igjisias nga Trizinia. Një pjesë e vogël e tyre ka mbërritur deri në ditët tona, për pasojë të gjitha këto janë hipoteza dhe nuk është e mundur që të flasim me siguri nëse ka ekzistuar apo jo vajza e Homerit. Me gjithë kundërshtimet, tregimet mbi Homerin vijnë në një pikë të përbashkët kur bëhet fjalë për një karakteristikë të rëndësishme të tij. Poeti ka qenë i verbër. Pretendimi i disa studiuesve se Smirni është vendlindja e Homerit, përforcohet nga argumenti se në dialektin e këtij vendi omiros, do të thotë i verbër. Një prej himneve kushtuar Apolonit të Dilos, konsiderohet nga një burim jo shumë i sigurt si vetëpërshkrim i Homerit, apo Melisigjenit, siç quhej poeti para se banorët e Smirnit ta pagëzonin me emrin “Omios” d.m.th. i verbër. Ja si përshkruhet ai në këtë himn: “Cili mendoni ju vajza, se është këngëtar i më i ëmbël që vjen këtu dhe ju dëfren? – Është i verbëri nga Hioja shkëmbore. Këngët e tij gjithmonë të mrekullueshme do të jenë”

Mendohet se Homeri nuk duhet të ketë lindur i verbër, ndoshta ai e ka humbur më pas dritën e syve, për shkak të rrethanave të panjohura. Nëse do t'i referoheshim traditës poetike antike, do mësojmë se një poet i mëvonshëm i quajtur Stisikori u verbua sipas legjendës sepse përgojoj Helenën, por më pas i erdhi shikimi në formën e një mrekullie, kur e rishkroi veprën e tij, ku theksonte faktin se Helena nuk kishte ikur në Trojë me dëshirën e vet. Ai shkroi më pas se Helena u largua në mënyrë të magjishme

në Egjipt, ndërsa vendin e saj e zuri një idhull i saj. Stisihori siç thuhet, fajësoi Homerin dhe variantin homerik të të dhënave dhe fakteve për verbimin e tij personal. Kështu, verbimi i Homerit mendohet se mund të jetë shkaktuar nga ndonjë shkelje e ngjashme e rregullave. Nëse ai është verbuar mbasi shkroi Iliadën, mund të supozojmë se skena e verbimit të ciklopit Polifem tek Odiseja, mund të ketë qenë e frymëzuar nga ndonjë përvojë personale.

Të dhëna mbi fundin e poetit dhe redaktimeve që pësoi me kalimin e shekujve vepra e tij

Vendi i vdekjes së Homerit nuk përbën objekt debatesh midis studiuesve dhe historianëve, ai është ishulli i los – ë. Sipas një tradite, vetë poeti u vu në dijeni nga një orakulle e quajtur Sivilla se do të vdiste në lo, pasi të dëgjonte një gjëgjëzë feminare. Ka shumë mundësi që Homeri të ketë shkruar në ishullin lo, për t'u takuar me Kreofilin. Se çfarë talenti dhe të dhënash do të kishte ky person i quajtur Kreofil, aq sa ta detyronte poetin që të shkonte në atë vend, pavarësisht paralajmërimit se me të shkruar atje do të vdiste, ne nuk mund ta themi dot, ajo që është e udhës të thuhet në këtë rast lidhet me destinin, me fatin dhe të shkruarën, që sipas grekëve të vjetër ishte e pamundur që t'i shmangeshe, ndoshta kjo është arsyeja pse poeti nuk u merakos shumë dhe e bëri këtë udhëtim, gjithmonë nëse varianti i kësaj tradite mund të ketë pasur baza reale. Historia thotë se në breg të detit, Homeri takoi disa fëmijë që peshkonin. Kur i pyeti nëse kishin zënë gjë, ata ju përgjigjën: “Ato që zëmë i lëshuam dhe ato që nuk zëmë i mbartim me vete”. Thuhet se poeti i befasuar kërkoi shpjegime, ndërkohë që fëmijët iu përgjigjën se gjëgjëza bënte fjalë për morrat e tyre.

Homeri menjëherë kujtohet për paralajmërimin dhe gjëgjëzën feminare dhe thur epitafin e varrit të tij dhe mbas tre ditësh vdes. Prej tij mbetën 27.803 vargje, por kjo e dhënë mbetet gjithmonë relative, pasi ekziston përbindja e gabimit, për arsye se pavarësisht përpjekjeve të mëdha të homeristëve, tekstet ishin të pasigurta përse i përket autenticitetit burimor, gjysmë të harruar dhe të deformuar. Kanë qenë bibliotekarët e Aleksandrisë Zinodhoti, Aristofan Bizantini dhe Aristarku, ata të cilët shumë më vonë se koha e Homerit, gjatë periudhës aleksandriane u përpoqën të ndërtonin një tekst të qëndrueshëm dhe të ndalonin humbjen e vargjeve të tij. Kështu, të dyja poemat u ndanë në libra, çdo poemë përmbante 24 libra, aq sa ishin edhe gërmat e alfabetit grek. Asnjë epos tjetër nuk ka një numerologji të tillë nazike. Më përpara se gramatologët aleksandrianë, vetë

Aristoteli ka përgatitur një variant të Iliadës për Aleksandrin e Maqedonisë, të cilën ai e vendosi në një kuti artistike ari, plaçkë lufte e marrë nga Dariosi, mbreti i Egjiptit, mbas betejës së Arvilës, me këto fjalë të gdhendura mbi kuti: “Vetëm një gjë në botë ja vlen që të ruhet në një vend kaq të çmuar”. Por, as kutitë e rënda të arit, nuk mundën që të shmangnin zhbërjen dhe deformimin e tekstit. Para se dorëshkrimet e Iliadës dhe Odisesë të binin në duart e këtyre njerëzve të ditur, kishin rënë më parë në duar më pak të devotshme.

Pisistrati, tirani i Athinës gjatë shekullit VI para Krishtit, konsiderohej si një njeri i kulturuar, për të dihet nga historia se ai përparoi në reformat fiskale dhe zhvilloi sistemet juridike të Solonit. Gjithashtu ky qeveritar i Athinës ka qenë mbrojtës i arteve dhe themeluesi i festave dionisiane. Gjatë kësaj kohe Pisistrati u mor edhe me regjistrimin e veprave të Homerit. Për këtë qëllim ai vuri edhe një shkruar, Onomakritin, i cili mori përsipër këtë ndërmarrje.

Në pamje të parë, Onomakriti dukej se ishte zgjidhja më ideale, ai veç të tjerash kishte mbledhur poemat dhe profecitë e Muzeut, pra kishte një përvojë paraprake. Por, siç na informon Herodoti, Onomakriti kishte edhe një anë më pak profesionale. Lasos Ermioneasi, i cili konsiderohej si mësues i poetit lirik Pindarit, kishte akuzuar Onomakritin për dhënie të gabuar, bile dhe për falsifikime të teksteve të Muzeut, gjë që sipas tij e kishte bërë me shtimin e paturpshëm të fjalëve të tij.

Ka arsye të mendohet se Onomakriti mund të ketë vepruar nën një diktat të drejtpërdrejtë politik, për deformimin e qëllimshëm të teksteve të Homerit. Në këtë kohe Pisistrati kishte nisur një inkursion ushtarak dhe ju kishte rrëmbyer qytetarëve të Megarës, portin e Salaminës. Ndërkohë shteti i Spartës vendosi që të luante rolin e gjyqtarit të drejtë në këtë konflikt midis Athinës dhe Megarës, për të vendosur se kush e kishte të drejtën e zotërimit të Salaminës. Athinasit mbështetnin pretendimin e tyre për zotërimin e Salaminës, duke paraqitur si argument vargun 588 të rapsodisë së dytë, B, të Homerit, ku Salamina përshkruhej si zotërim tradicional i Athinës. Megaritet, të ofenduar, akuzuan më pas athinasit për deformimin dhe falsifikimin të eposeve homerike.

Kështu, ruajtja dhe konservimi i poemave, të cilat përbëjnë majën e arritjeve letrare të Evropës, iu besuan një individi me integritet të dyshimtë, nga një tiran me interesa të mprehta për sa i përket çështjeve territoriale. Këtyre sa thamë, u shtojmë edhe një ndodhi tjetër, vrasjen e një mendimtari athinas Zoilosit, i cili u hodh nga një shkëmb prej athinasve të ndërkryer, të cilët reagon në këtë formë për shkak të kritikës së tij për fjalët e

stërzgjatura dhe detajet hiperbolike të figurave të Homerit hyjnor.

Krijimtaria e Homerit

Përveç Iliadës dhe Odisesë, pasazheve të Eposeve Qipriote, Homerit ka shkruar edhe shumë epose të tjerë, midis të cilëve rendisim edhe Eposin e Tebës (të Thivës), e cila bënte fjalë për fatin e Edipit (Idhipodhit) dhe të shtatë komandatëve të Tebës, për të vazhduar më pas me historitë e shtatë bijve të shtatë komandatëve të Tebës, me të cilën mbyllet vepra. Kjo poemë ka pasur 7000 vargje dhe fillonte me fjalët: “Tani muza le t’u këndojmë burrave të ditëve tona...”. Homerit është gjithashtu autori i veprës Margiti, e cila nuk ka arritur të shpëtojë. Informacionin për ekzistencën e kësaj vepre na e jep edhe Aristoteli në kapitullin e katërt të Poetikës së tij ku shkruan: “Homerit ka qenë poeti më i shquar i temave të rëndësishme, dhe ka qenë ai i pari që tregoi formën e komedisë... Margiti të çon me të vërtetë te komedia, ashtu si Iliada dhe Odiseja të çojnë te tragjedia”.

Mendime për komedinë homerike dhe në përgjithësi në antikitet.

Margiti, konsiderohet si vepra e parë e Homerit, të cilën ai e filloi sipas disa të dhënave kur ai ishte mësues në Kolofonë. Titulli Margitis që lidhet me emrin e heroit protagonist vjen nga fjala Margos, që në greqishten e vjetër do të thotë i çmendur, pra titulli i kësaj komedie i shqipëruar do të ishte i Çmenduri, apo edhe Budallai. Kështu, vepra e parë e poetit ka qenë portreti i një të çmenduri. Shkrimtari dhe studiuesi Aleksandër Pooup shkruan në lidhje me këtë fenomen: “Margiti ishte emri i një personi të cilin antikiteti e shfaqti si idiotin e parë. Sigurisht ato që mësojmë për të, ja vlen që të konsiderohen si rrënja e një trungu të madh, i cili ka qenë shumë pinjollë. Për pasojë poema që e himnizon ka qenë plotësisht një llihiadë (Debiljadë), që fatkeqësisht nuk ruhet, por karakteri i tij është mjaft i njohur nga ato pak të dhëna të pagabueshme që kanë shpëtuar. Kështu, pra, Debiliada ka qenë eposi i parë epik, i shkruar nga vetë Homerit para Iliadës dhe Odisesë”. Për këtë arsye Pooup shkroi Debiljadën e tij, nga prologu i së cilës shkëputëm edhe pasazhin e mësipërm. Ajo që ka mbetur nga ky epos komik i Homerit janë disa vargje të pakta. Skoliasti, duke shkruar për Eskinin, na jep një përshkrim të shkurtër, që i korrespondon etimologjikisht këtij emri: “Margiti ka qenë një njeri, i cili megjithëse ishte në moshë të pjekur, nuk e dinte nëse e kishte lindur e ëma apo i ati i tij, dhe që nuk flinte me gruan e tij, nga frika se mos kjo i tregonte të ëmës së tij”. Në këtë kontekst Margiti duket se korrespondon me përshkrimin e Niçes për komedinë e ashpërsisë si Schadenfreude. Pra,

qeshim, sepse jemi më të zgjuar se Margiti i gjerë, për të cilin zogjtë dhe bletët përbëjnë një mister të panjohur.

Platoni dhe Aristoteli shkruajnë secili, nga një pasazh nga kjo vepër. Nga vepra Alkiviadhi i Platonit mësojmë se Margiti dinte mjaft gjëra, por të gjitha në mënyrë të gabuar. Kështu, ai paraqitet si një tip i leshtë. Prej nga konkludohet gjithashtu se nuk është naiviteti i tij brenda një bote kaotike ajo që krijon komedinë, por kaosi i teorive të tij të cekëta dhe i ideve të tij gjysmë të mangëta. Aristoteli, në Etika e Nikomahut, shfaq për Margitin një mendim të ndryshëm: “Përnditë nuk i mësuan as të mbillte as të lëronte, por as ndonjë profesion tjetër, nuk ishte i aftë për asgjë”. Siç duket Margiti i Aristotelit ishte një idiot, i cili nuk kishte asnjë mision dhe për pasojë asnjë arsye për të ekzistuar në shoqëri. Brenda kësaj figure të paditur, sipas përshkrimit që jep Aristoteli të krijohet një fizionomi e paqartë e dembelizmit. Zinovioi jep një përshkrim tjetër mbi këtë temë: “Dhelpra di shumë marifete, por marifeti i vetëm i iriqit i mund të gjitha”. Me të drejtë lind pyetja nëse Margiti është një dhelpër apo një iriq? Në asnjë pjesë të gjetur nuk thuhet se Margiti ishte mashtrues apo i djallëzuar. Zinovioi propozon diçka tjetër, njeriun e urtë, Çaplinin, Forest Gambin, Kandidin, Ushtarin e Mirë Shvejk.

Margiti nuk është eposi i vetëm komik që ka ekzistuar. Arktinosi nga Milesi, shkrimtar i Titanomahisë, vepër që nuk ruhet, si dhe një vazhdimi të Iliadës, mund të jetë edhe shkrimtari i Kekropëve (njerëzve majmunë). Suda, emërtimi i një

fjalori të shkruar rreth shekullit X pas Krishtit, i cili përmban të dhëna të rëndësishme për letërsinë antike greke dhe historinë, thotë: “Ishin dy vëllezër të cilët kryenin çdo lloj mashtrimi. Këta njiheshin me emrin Kekropë (Njerëz majmunë), për shkak se bënëin mashtrime. Njëri quhej Pasalos dhe tjetri Akmon. Nëna e tyre, e bija e Memnonit, duke parë bëmat e tyre, i paralajmëroi që t’i qëndronin larg Herkulit. Kekropët ishin bij të Thias dhe Oqeanit, thuhet se ata u shndërruan në gurë, për arsye se u përpoqën të mashtronin Zeusin. Gënjeshtarë dhe mashtrues, vërtiteshin kudo dhe gënjenin vazhdimisht njerëzit”.

Kjo lloj komedie, siç e pamë edhe nga të dhënat e Sudas, ndryshon prej Margitit. Në një pikurë të antikitetit tregohet Herkuli (Irakliu) me këta dy mashtruesit të lidhur, të cilët i ka varur kokëposhtë. Me Kekropët auditori ndjen në mënyrë të dyfishtë, dëfren me farsat e mashtruesve dhe kënaqet me ndërshkimin e drejtë dhe të pashmangshëm që iu bëhet atyre. Ndërkohë që simpatitë për Margitin janë më pak të evidentueshme. Heronjtë e Iliadës dhe Odisesë janë larg së përkryerës. Akili është inatçor dhe çnjerëzor, Odiseja dinak dhe hakmarrës. Por, një hero me kusure, apo e thënë ndryshe skarco nuk është më pak hero, ndërsa budallai skarco është diçka e pakuptueshme. Sa shumë gjëra do kishim mësuar nëse Margjiti nuk do të kishte humbur. Ekzistenca e tij do të na bënte që ta kuptonim më mirë se me çfarë qeshnin grekët e vjetër.

BIBLIOGRAFI

- A. Philipson, Beitrage zur Morphologie Griechenlandes, Stuttgart 1930.
- D. Sterling Minoan Ęriting, Am. Journ. Arch. 58, 1954.
- E. Risch, Fruhgeschichte der griech. Sprache. Helv. 1969.
- H. Bengston, Griech, Geschichte, Mynih 1960.
- M.P. Nillson. The Mycenaean Origin of Greek Mythology, Berkeley 1932.
- O. F. Hampl, Die Chronologie der Einänderung der griech...., Mus. Helv, 17, 1960.
- P. Kretschmer, Die phrygische episode in der Geschichte von Hellas, Miscellanea Acad. Berolinensia 1950.

PERIUDHA SHPREHËSE, MJET I FUQISHËM I RETORIKËS NË PROZËN SHQIPE

EDIOLA NASE,

ALBINA PAJO

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Kur shohin një tekst të shkruar, njerëzit e kuptojnë nëse është shkruar mirë ose jo. Sigurisht, ka mënyra të ndryshme të të shkruarit mirë, por brenda kufijve të gjerë, shumica prej nesh e kuptojnë kur një paragraf ose trajtesë e shkruar ia arrin qëllimit për të cilën është shkruar.

Kjo ia vlen të theksohet, sepse, po të besojmë që gjykimet për një shkrim janë gjithmonë opinione personale, kjo do të thotë të ushqesh frymën e dështimit vetjak. Po të mos kishte standarde të prozës së mirë, asgjë nuk do t'ia vlente të mësohej. Por, standardet faktikisht ekzistojnë: ka proza që ia vlen t'i lexosh madje t'i rilexosh; në sajë të një retorike mbresëlënëse që tërheq lexuesit. Në këtë kuptim, të shkruarit na detyron të hulumtojmë, dhe si pasojë, të zgjerojmë aftësinë tonë për të menduar, ndier dhe përceptuar. Në një periudhë të shkruar mirë fjalët, togfjalëshat dhe fjalitë kanë gjetur vendin dhe lidhjet e tyre jo vetëm sipas rregullave të bashkërenditjes e të nënrenditjes gramatikore, por edhe në përshtatje me disa parime stilistike. Kështu, në këtë punim synojmë të paraqesim një tablo të vërtetë të asaj që mund të quajmë retorikë në emër të një "prozë të mirë", në të cilën një vend të rëndësishëm zë përdorimi i periudhave shprehëse, të tilla si: shpallja, baraspesha, kiazma, periudha periodike, vargëzimet stilistike, fragmentimi, periudha periodike, periudha e ndërprerë etj. Asnjëherë nuk mund të themi se një tip ndërtimi gjuhësor është më i mirë se tjetri. Përkundrazi, ndodh që një tip ndërtimi del më i përshtatshëm për disa qëllime të caktuara dhe shfaqet i pagoditur për disa të tjera. Autori që i njeh të fshehtat e mjeshtërisë, i përdor sipas kërkesës konkrete të tekstit, duke e rrokur se kur është njëri më i frytshëm e kur është tjetri.

Fjalë çelës: *retorikë, periudhë shprehëse, baraspeshë, shpallje, fragmentim.*

Abstract

Every time we deal with a specific written text we can immediately make an assumption about its qualitative values. We are aware of the fact that there are obviously distinct ways of defining a well-written text but there is always a way to find it out if a paragraph or a text clearly fulfills the basic required needs regarding its specific aim. If we strongly believe that the critical views towards a written work are subjective, this would make us nourish a sense of personal inevitable failure. If faced with a complete lack of good and qualitative writing standards, nothing would be worth studying, but on the contrary practically standards do exist, there are prose texts that based on a general judgment and consideration transmit merely relevant distinctive qualities as far as the rhetorical values which attract the reader's attention are concerned. In this context writing entails our efforts towards a perfect investigation for the sake of enlarging and enriching our thinking, feeling and perceptive competence. While analyzing a standartized syntactically written sentence we become aware of the well-arranged sequence of the words and syntagms according to grammatical coordination and subordination rules, as well as the stylistical principle accomplishments. The aim of this article is to make an overall concrete overview of the so-called term rhetorical "good writing" which presupposes the use of some figurative devices such as proclamation, balanced constructions, chiasma, periodichal sentence, stylistical concatenation, fragmentation, loose sentences etc. We should absolutely not hold the firm conviction that some structural types are better than the others. On the contrary sometimes a specific type seems to be more adequate if related to some specifically defined aims. In most of the cases the author knows best how to adopt his/her techniques based on the contextual requirements, trying to grasp the most fruitful device.

Key words: *rhetorics, figurative devices, balanced constructions, chiasma, periodichal sentence.*

Hyrje

Hartimi i periudhave shprehëse apo ndërthurja e tyre me anë përfitesash shprehëse i përkasin ndërtimit të përgjithshëm të tekstit. Shprehësi do të thotë që gjuha e përdorur të bëjë përshtypje, të ndikojë me efekt, të tërheqë vëmendjen, të përçojë diçka me forcë. Kjo shprehësi mund të arrihet nëpërmjet përdorimit të periudhave shprehëse dhe rritjes së shprehësisë brenda periudhës (Kane, 2010, 417).

Periudhat shprehëse i përforcojnë dhe i pasurojnë disa kuptime. Paraqitja e tyre e përpunuar e hijshme dhe e arsyetuar i bën mjete të pazëvendësueshme kur vjen puna për të dhënë drejtpërdrejt diçka nga përvoja ose nga ndjenja e fortë.

Autori ka nevojë që ligjërata e tij të përcjellë shprehësi; shpesh ai që shkruan e ndien të nevojshme të nxjerrë më në pah një pjesë brenda periudhës, apo të drejtojë ndjeshmërinë e lexuesit te një fjalë apo një togfjalësh i veçantë. Ka rëndësi të

kuptohet se dallimet ndërmjet këtyre periudhave përbëhen nga mënyra se si organizohen mendimet, perceptimet apo ndjenjat.

Disa prej llojeve të periudhave shprehëse të shoqëruara me shembuj nga proza të autorëve vendas, po i paraqesim më poshtë:

Shpallja, është ajo periudhë shprehëse, e cila i jep rëndësi një kumtimi, duke bërë një pohim paraprak, në të cilin lexuesit i vihet në dukje se më pas do të vijojë diçka e rëndësishme (po aty). Për shembull:

Dëgjoni këtu, or burra, - tha kryetari i ekipit, i cili vendosi t'u flasë haptazi, - ne kemi ardhur në fshatin tuaj, që t'ju shpërngulim nga këta shkrepë e t'ju shpiem në fushë, në toka të pasura, të bëni jetë si njerëz të socializimit e jo si njerëz të përrallave. Për këtë kemi ardhur dhe jo t'u ndërtojmë kisha (Agolli, 2006, 166).

Babai im i përbotur tha vetëm dy fjalë: Komnenë të nderuar, mirë se erdhët në ëndrrën time! (Blushi, 2008, 68).

Voskopojarë, tregtarë, priftërinj dhe zanatçinj, shkrimtarë, nxënës dhe mësues, burra dhe gra. Të gjithë ju mund të flini të qetë. Edhe sikur qyteti ynë tani të digjet dhe të harrohet, kjo shtypshkronjë do t'u tregojë brezave lavdinë tonë (po aty, 212).

Dua të bëj një udhëtim në të ardhmen tonë politike. Të Shqipërisë (Blushi, 2014, 5).

Vargëzimet stilistike apo ndërtimet paralele të periudhave karakterizohen nga një ndërtim i njëjtë, domethënë renditje e përafërt e gjymtyrëve dhe pothuaj me të njëjtin numër të tyre. Me anë të vargëzimit autorët sjellin një varg ngjarjesh, përshtypjesh, mendimesh, ndjenjash, me një vijueshmëri logjike, që zëvendësohet nga asosacioni duke u përsëritur më shpesh fjalët e togfjalëshat nistorë. (Kane, 2010, 371). Për shembull:

Po të ishe ishe ti skenariste, do të mund të shkruaje një skenar filmi. Po të ishe ti dramaturge, do të mund të shkruaje një dramë. Po të ishe psikologe do të mund të shkruaje një sprovë interesante për psikologjinë e njerëzve të asaj kohe dhe për psikologjinë e të burgosurit (Dema, 2012, 86).

Aty kishte çdo gjë. Kishte ditë, kishte natë, kishte diell, kishte hënë, kishte qetësi, kishte fllad, kishte lule, kishte livadhe, kishte ketra, kishte lepuj, kishte zjarr, kishte vjeshtë, kishte pranverë, kishte pyll, kishte yll, kishte eklips, kishte zogj, kishte dashuri, kishte paqe, kishte nder, kishte falje, kishte ëmbëlsi, kishte jetë, kishte muzikë...(Blushi, 2008, 204-205).

Ne nuk kemi folur dhe prandaj nuk jemi dëgjuar. Ne nuk kemi mbirë dhe prandaj nuk jemi ushqyer. Ne nuk kemi pirë dhe prandaj nuk na kanë

dhënë ujë. Ne nuk kemi ngritur dhe prandaj nuk kemi ecur. Ne nuk kemi ecur dhe prandaj kemi mbetur në vend. Ne nuk kemi qarë dhe prandaj nuk kemi lot. Ne nuk kemi luftuar dhe prandaj nuk kemi armë. Ne nuk kemi falur dhe prandaj nuk kemi xhami. Ne jemi të huaj dhe prandaj mëhalla jonë quhet mëhalla e të huajve (po aty, 265).

Desh Zoti që unë të jem këtu dhe unë ja ku ju kam për të prishur vetminë tuaj, për t'u dhënë ujë buzëve të etura, për t'u dhënë dritë syve të mbyllur, për t'u dhënë frymë zemrave të dobëta, për t'u dhënë qumësht gjinjve të tharë, për t'u dhënë gjak muskujeve të lodhur, për t'u dhënë zë veshëve të shurdhët, për t'u dhënë bukë gojëve të uritura, për t'i dhënë nënë dhe baba jetimëve, për t'u dhënë shpirt të gjallëve, për t'u dhënë varr të vdekurve, për t'u dhënë duar të pambrojturve, për t'u dhënë armë të sulmuarve, për t'u dhënë tokë endacakëve, për t'u dhënë forcë luftëtarëve, për t'u dhënë dije të paditurve, për t'u dhënë një qytet myslimanëve, për t'i dhënë një Zot Voskopjës (po aty, 267).

Baraspesha është ndarja e periudhës afërsisht në dy pjesë të barabarta me një pushim kryesor në mes; ndarja mund të bëhet me shenjë pikësimi ose me lidhëz bashkërenditëse. Baraspesha rrokët kur të dy anët janë afërsisht njësoj të gjata dhe kanë përmbajtje të krahasueshme, ndonëse nuk është e domosdoshme që të jenë paralele (Kane, 2010, 420).

Ajo që duhet të theksojmë është se periudha e baraspeshuar e arrin shprehësinë posaçërisht kur bën kundërvënien e dy fjalëve kryesore në secilën anë. Për shembull:

Ujë që mungon, ujë që tepron. Ujë i duhur, ujë i gabuar (Kadare, V17, 2009, 95).

Rrebeshit të fortë i qëndrova vetëm, por bukurisë së fortë nuk po i qëndroja dot vetëm (Dema, 2012, 13).

Në syrin e tyre të majtë shihja pikëçuditësen e cila në "zum" shndërrohej në një heshtë me majë fort të mprehtë, kurse në syrin e tyre të djathtë shihja një pyetje e cila në "zum" shndërrohej në një litar varjeje...(po aty, 106).

Ky ishull ka më shumë dritë se ç'i duhet një njeriu për të parë Zotin dhe ka më shumë qiell nga ç'i duhet Zotit për të fluturuar drejt nesh (Blushi, 2011, 234).

Zemra ime ka më shumë uri se stomaku im dhe mendja ime ka më shumë lot sesa sytë e mi (Blushi, 2008, 265).

Një përdorim të dendur, baraspesha gjen në ndërtimet e fjalëve të urta, disa shembuj të të cilave nga krijmtaria folklorike e popullit shqiptar po i sjellim më poshtë:

Dora ime - mëma ime, dorë e botës - mortja ime (Fjalë të urta të popullit shqiptar, 1983, 54).

Dita pa punë, nata pa gjumë (po aty, 120).
Trupi shëndoshet më të punuar, mendja ndritohet me të mësuar (po aty, 146).

Zanati të hap derën, puna të rrit vlerën (po aty, 147).

Sytë për të parë, mendja për të ndarë (po aty, 458).

E mira çalon, e keqja fluturon (po aty, 519).

Fjalët janë gra, punët janë burra (po aty, 986).

Ajo që bie në sy gjatë këtyre ndërtimeve është aftësia shprehëse që mbart baraspesha, kundërvënia që ajo thekson, por edhe prirja që ka për të ndihmuar në mbajtjen mend përmendësh të fjalëve të urta.

Kiazma, me prejardhje nga gr. *chiasmós*, është vendosja e diçkaje në trajtën e shenjës X, pra e kryqëzuar (Fjalor i fjalëve të huaja, 1988).

Kiazma është përmbysja e rendit në periudhën e baraspeshuar, e cila përbën një lojë gjuhësore me shumë efekt (Kane, 2010, 421). Për shembull:

Nëse do trupin, harroje shpirtin, nëse do shpirtin harroje trupin! (Dema, 2012, 127)

Dhe durimi shkakton mërzinë e mërzia të han shëndetin (po aty, 229).

Në Evropë, pushimi është ndërprerja e punës, ndërsa në Stamboll, puna është ndërprerja e pushimit (po aty, 76).

Shqipëria ishte bërë më e bukur dhe shumë më e ngathët, sepse ngathësia është një sëmundje që lind nga bukuria (Blushi, 2011, 395).

Megjithatë, peshkatarët dilnin në det sepse nuk mund të bënin ndryshe. Ata jetoni për të peshkuar dhe peshkonin për të jetuar (Blushi, 2008, 405).

Njësoj si baraspesha edhe kiazma gjen përdorim të dendur në ndërtimet e fjalëve të urta, disa shembuj të të cilave po i sjellim më poshtë:

Kush e ha mëngjesin në mulli, e ha drekën në shtëpi; kush ha mëngjesin në shtëpi, e ha drekën në mulli (Fjalë të urta të popullit shqiptar, 1983, 164).

Qan puna për të zotin dhe i zoti qan për punën (po aty, 177).

A e mira të bën të keqen a e keqja të bën të mirën (po aty, 289).

Nderi e ven gjanë, gjaja s'e ven nderin (po aty, 351).

Idhnimin e nadjes lene për mbrëmje e idhnimin e mbramjes lene për nadje (po aty, 570).

Kur ke miellin, s'ke thesin; kur ke thesin, s'ke miellin (po aty, 890).

Denduria dhe efekti i përdorimit të baraspeshës dhe kiazmës në sendërtimin e fjalëve të urta, tregojnë se përvoja e mendjes njerëzore arrin të shprehë në mënyrë të thukët vlera edukative jetësore sipas një gjuhe të kursyer që godet me anë të një retorike mbreslënëse.

Fragmentimi është ai ndërtim sintaksor, që mund të ndahet në pjesë më të vogla, në fund të të cilave vihet pikë (Kane, 2010, 421). Fragmentimi bie në sy, sepse e ndan rrjedhën e fjalëve aty ku gramatika do të kërkonte vazhdim të pandërprerë.

Pikërisht, sepse bie ndesh me ndjenjën e zakonshme gjuhësore, i përdorur me mjeshtëri, fragmentimi arrin një shprehësi të veçantë.

Fjalitë e shkurtra, të drejtpërdrejta, domethënë pa dhënë shpjegime me gjymtyrë të bashkërenditura e të nënrenditura, bëjnë përshtypje si copa të pranëvëna, pa lidhje gramatikore, por, gjithsesi, brenda së njëjtës tabloje kuptimore (po aty). Për shembull:

U ngrita disi në këmbë. Ishte zditur. Rrapëllima vazhdonte dhe ajo i afrohej dhomës sime. Vura vesh. Sikur një garuzhdë mbushej e zbrazej. Kur kazani u ndal para derës sime thashë se do të bëhej diçka. Por nuk u bë asgjë (Dema, 2012, 125).

Vrapojnë a-të, f-të, xh-të, y-të, k-të. Mblidhen, krijojnë kalin ose breshërin. Vrapojnë përsëri. Duhet kujtuar thika, nata, vrasja. Pastaj rruga, trokitja, heshtja. Vrapo. Vrapo vazhdimisht. Pa fund (Kadare, 2008, 57).

Midis të tjerash, u njohëm diçka me Shqipërinë. Vend i vogël. Popull i moçëm. Histori tragjike. Në fillim vend evropian. Pastaj sundim aziatik. Në shek. XX i riktheht Evropës. Gjysma e kombit jashtë kufijve shtetërorë (Kadare, 1999, 6).

Njëzet e një mars. Njëzet e tetë mars. Katër prill. Njëmbëdhjetë prill. Shtatëmbëdhjetë prill. Tetëmbëdhjetë ... prillmort. E kështu me radhë: prillmort, prillmort dhe maj asnjëherë. Askurrë maj (Kadare, V11, 2009, 37).

Ishte i lodhur. Ftohja... Përçarja... Çarja tragjike që pritej... E pabesueshmja... Bryma e Parë... E çara... Kafshimi i titanëve... Plasaritja... Shkëputja... Kriza... Acari... Requiem për unitetin (Kadare, 2012, 153).

Periudha urdhëruese, përveç forcës shprehëse që përcjell, ka një tjetër veti: ajo

vendos një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet autorit dhe lexuesit; rrjedhimisht, fjalitë urdhërore përmbushin një varg funksionesh, disa luajnë rolin e pohimeve të forta, disa bëjnë thirrje dhe të tjera përcjellin një paralajmërim ose kërcënim (Kane, 2010, 423). Për shembull:

Midis rënkimeve të Gurametos dëgjoheshin klithmat e torturuesve: Emri i shefit! Nofka! Fol! Nofka jote! Kodi i fshehtë! Fol! (Kadare, V17, 2009, 175).

Kërceni vallet e huaja! – u bërtiti . – Leni vallet tona për dasma. Bani valle tjera, djem, mos u bani shkatërtaqë të sendeve tueja! Ndani punët! Dasma dasmë dhe morti mort! (Camaj, 2010, 238).

*-Futeni plugun thellë dhe hapeni ullirin e parë!
Nisjani nga fillimi dhe krijoheni letërsisë tuaj në
gjuhën tuaj, por në frymën e patriotizmit socialist
jugosllav! (Dema, 2012, 97).*

Trajta urdhërore gjejmë gjithashtu edhe në ndërtimin e fjalëve të urta. Vemë re se shumica prej tyre ndërtohen në formën mohore në formën e një këshille. Disa prej tyre po i sjellim për ilustrim më poshtë:

Mos ec më kambë tueja e me mend të hueja (Fjalë të urta të popullit shqiptar, 1983, 62).

Mos kij turp nga kush s'ka turp (po aty, 89).

Mos shpejto gjuhën po shpejto punën (po aty, 169).

Mblidh që në rini që të kesh në pleqëri (po aty, 199).

Mos ia qaj hallin kalorësit se i tunden këmbët (po aty, 271).

Mos iu gëzo faljes se të kërkon dyfishin (po aty, 271).

Dëgjo pa gjyko (po aty, 325).

Mos e vështro për të zezë, po vështroje ç'tym do ndezë (po aty, 436).

Mos prit miell nga pyka në diell (po aty, 438).

Mos shiko kush të flet po shih se ç'të flet. (po aty, 438).

Periudha e ndërprerë përkon me ndërftjen e ndërtimeve të ndryshme mes gjymtyrëve kryesore. Ndërprerja e tërheq vëmendjen te fjalë ose togfjalësha të caktuar brenda periudhës. Ndërkaq, ndërprerja, si përftesë, shërben për ta bërë shprehëse të gjithë thënien (Kane, 2010, 424). Për shembull:

Me një fjalë, ashtu si më parë, dora e padukshme, ajo që kishte ruajtur dy doktorët nga pezmatimi, kishte bërë që nga ky lëmsh botëror ata të dilnin fifty- fifty, siç thoshin anglezët (Kadare, V17, 2009, 98).

Megjithatë, ujë të tillë të vjetër si veteranët e Seleksionimit, të cilët ishin në gjendje të parashikonin gëlimin apo shterpësinë e ëndrrave me po atë thjeshtësi që pleqtë e zakonshëm, nga dhimbjet e përdhësit, parashikonin keqësimin e motit, nuk mund të kishte në asnjë degë tjetër të Tabir Sarajit (Kadare, V11, 2009, 293).

Varri i porsaçelur, kryqet prej guri e prej druri, shumica të vithisur anash, tingujt e pikëllueshëm të këmbanës, të gjitha këto, kishin atë ditë një lidhje të drejtpërdrejtë me të (Kadare, 1999, 14).

Ndonëse rendi i gjymtyrëve dhe i fjalive në periudhën e shqipes është relativisht i lirë, përsëri ka një rend të zakonshëm asnjës, i cili është më i përdorshëm; kundrejt tij qëndron anasjella. (Kane, 2010, 424). Anasjella që është përmbysja e rendit asnjës, fiton një fuqi të madhe shprehëse, pikërisht sepse nuk është mënyra e zakonshme e të shprehurit. Kështu vëmendja përqendrohet në përgjithësi te gjymtyrët nistore, të cilat, sipas këtij

rendi të anasjelltë, tërheqin më shumë vëmendjen. Për shembull:

Ndërkaq, bashkë me tingujt e gramafonit, valë –valë shpërndahej tortura e shpjegimit të darkës (Kadare, V17, 2009, 19).

Si gjethet e verdha përpara stuhisë, vraponin, rrotulloheshin në erë, binin e ngriheshin përsëri fjalë, pandehma, parandjenja e lajme të pabesueshme (po aty, 112).

Gjithë udhës nga ikte, dukeshin gjurmët e hënës së plagosur (Kadare, V11, 2009, 302).

Kursime stinësh të tëra ishin grumbulluar atje, javë pas javë e muaj pas muajsh, në pritje të gjakmarrjes (po aty, 194).

Mes andrrës e zhgandrrës u la shteg përfytyrimeve vegimtare (po aty, 397).

Ndërimi (ndërkëmbimi) i mohimit me pohimin, rrit shprehësinë e ligjërit ngaqë një mendim mund të përforcohet duke thënë në fillim se si nuk është në të vërtetë dhe pastaj duke e rimarrë se si është në fakt.

Në këtë mënyrë ndërthurren shpallja, rimarrja dhe baraspesha me qëllim përforcimin e kontrastit (Kane, 2010, 426).

Në një periudhë të tillë nuk është e thënë që mohimi të vijojë gjithmonë para pohimit, mund të ndodhë edhe e anasjellta. Shprehësia lidhet pikërisht me ndërrimin që ndodh ndërmjet tyre. Për shembull:

Jezi! Mbylle gojën! Ky nuk është dorëzim, po besëlidhje! (Agolli, 2006, 17).

Pabarazia nuk i zhdok territoret, por i zbraz ato. Ajo nuk i zëvendëson të varfrit, por i shton. Pabarazia nuk i heq njeriut nevojën për të lindur fëmijë, por ia pakëson atë. Pabarazia nuk i eliminon brezat, por u shterron atyre forcën, vullnetin dhe mundësinë për të punuar dhe për të ndryshuar jetën e tyre (Blushi, 2014, 121).

Atëherë sëmundja e shoqërisë nuk është më fataliteti i pushtimit, etja e thatësisë ose ngushtica e izolimit, por pesimizmi (po aty, 132).

Unë nuk u besoj kombeve, as shteteve, as feve dhe as racave, por vetëm njerëzve (Blushi, 2011, 531).

Këtë nuk e kemi bërë me marrëveshje dhe prandaj perandoritë, përfshi edhe Turqinë nuk e kanë njohur nënshtrimin si praninë të arsyeshëm, por si detyrim të shkaktuar nga frika dhe varfëria (Blushi, 2008, 54).

Periudha periodike, fillon me ndërtime të nënrenditura dhe pason me fjalinë kryesore. Cilësimi periodik vjen nga retorët e lashtë, të cilët e përdornin për të emërtuar periudhën e organizuar të paktën prej dy pjesësh dhe që shpreh një mendim të ndërlkuar, i cili përmbushet vetëm në mbyllje të

saj (Kane, 2010, 398). Sot termi është përshtatur për periudhën, e cila plotëson mendimin thelbësor vetëm në fund të saj.

Periudha periodike, për nga shprehësia e detyron lexuesin të qëndrojë me vëmendje pezull, deri sa të vijë te pjesa, ku do të rrokë të plotë idenë e autorit, veti, të cilën autori mund ta shfrytëzojë me synime të ndryshme në tekst: te disa është kryefjala që ngarkohet me elemente derisa të arrihet te kallëzuesi i saj, por më shpesh vijnë fjalitë e varura më parë dhe gjithnjë është plotësimi i mendimit që ngelet në fund (Kane, 2010, 426).

Në shumë raste periudha periodike mund të përcjellë edhe një theksim, sepse duke e shtyrë për në fund mendimin kryesor, e nxit pritshmërinë e lexuesit, duke e bërë më të rëndësishëm, madje, në disa raste, duke e befasuar atë. Për shembull:

Mirëpo edhe pse e bardha dhe e zeza, e ëmbla dhe e hidhura, e mira dhe e keqja, trimëria e qyqarllëku, lindja e vdekja, që janë pjesë të pandashme të jetës, sa fort ato dallojnë njëra pas tjetrës (Dema, 2012, 110).

Të hapësh Shqipërinë për të huajt, të lejosh paranë, tregtinë dhe martesën, pa dyshim është një përpjekje, e cila mund të kthehet në torturë për njerëz si ne, që po plakemi. duke besur se, njerëzimi ka nevojë për të kundërtën (Blushi, 2011, 544).

Por Skënderbeu ishte edukuar si mysliman dhe unë nuk besoj se atë e ka vrarë ndërgjegjja, por është e vërtetë se, në qoftë se do t'ia kish mbajtur fjalën Arianit Komnenit, ne sot do të jetonim ndryshe (Blushi, 2008, 61).

Pyetjet retorike janë pikërisht ato fjali shprehëse, të cilat nuk pyesin për të marrë një përgjigje, por për të dhënë me një mënyrë më shprehëse një pohim. Madje përgjigjja mund të jetë dhënë edhe përpara se të dalë vetë pyetja retorike (Kane, 2010, 428).

Shpeshherë vihet re se pyetja retorike, mund të ketë kuptim edhe më të ndërlikuar: ndërthurret pranimi tërthorazi i një fakti me pakënaqësinë kundrejt tij, me ankimin ose qortimin. Në këtë mënyrë, nënkuptohet, që shprehet një qëndrim i autorit, por nëpërmjet një përftese për ta bërë më imponuese pikëpamjen e vet. Për shembull:

A nuk jam edhe vetë pjesë e gjithësisë kuantike? A nuk është edhe Dardha veçse një lëmsh kuantik sikundër jam edhe vetë? Çfarë na pengon që të dashurohemi nëse harrojmë që jemi qenie fizike? (Dema, 2012, 14).

Harrove krimet e tyre? Harrove krimin e Tivarit? Harrove krimet e Shalës të Ferizajt, të Gjilanit?! Harrove "strelishten" e Prishtinës? Harrove gjykimet e Ali Shukriut? Harrove gratë e reja, mocanikët e tu që u rritën jetimë? Harrove

shpërnguljen e dhunshme që s'u ndal kurrë?... (po aty, 106-107).

Pse o shqiptarë, e keni kaq të lehtë të mohoni fenë e parë? Mohoni për para, apo mohoni nga frika? Mohoni nga padija apo mohoni nga varfëria? A keni pyetur veten pse nuk keni pasur kurrë shtetin tuaj, pse nuk keni pasur kurrë shenjtorët tuaj, pse nuk keni akoma libra në gjuhën tuaj, pse nuk keni shkollat tuaja dhe pse nuk keni flamurin tuaj? (Blushi, 2008, 23).

Nocionet e ritmit dhe rimës të marra nga folklori, kur shfaqen në radhët e prozës, i japin periudhës një fuqi shprehëse plotësuese (Kane, 2010, 428).

Në prozë, prania e ritmit dhe rimës, shoqërohet me përmbajtjen përkatëse të tekstit dhe paraqitet në raste të veçanta, ndërkohë që denduria e përdorimit të ritmit dhe rimës në prozë as që mund të krahasohet me dendurinë e përdorimit të ritmit dhe rimës në poezi. Për shembull:

Si thotë ajo fjala popullore: "një pëllëmbë njeri e shtatë pëllëmbë seri" (Dema, 2012, 53)

Ata që i kuptojnë edhe i pranojnë këto paradokse si norm normale, ata janë të lumtur. Unë, më në fund i kuptova dhe i pranova, prandaj, më në fund, jam i lumtur... Vallë, do t'i mësosh, do t'i kuptosh e do t'i pranosh edhe ti? Sa fort kisha pasur dëshirë që edhe ti, t'i kuptosh e t'i pranosh! Sepse të dua fort e prandaj kasha pasur dëshirë që edhe ti të jeshë e lumtur... (po aty, 110).

Askush nuk di, se ka mundime e gjëmë, pa kaluar Shqipërinë këmbë (po aty, 174).

Çfarë ka në gushë, atë e qet përfushë! (po aty, 272).

Ku u larguan në një distancë që ai nuk mund t'i shquante, njëri prej tyre ndaloi dhe i thirri: Ibrahim o derr, Muhamedi të pret në ferr (Blushi, 2008, 33).

Atë natë, ata duket se kishin pirë, sepse qeshnin dhe shanin me të madhe dhe, duke bërë shenja në drejtim të shtëpisë këndonin me sa kishin në kokë: Ibrahim, o qafir, do të zhdukim me pahir, mysliman nga taksirati, nuk ka vend për ty fshati, Muhamedi është synet, Ibrahim është lanet (po aty, 35).

Periudha e shkurtër bie në sy për shprehësi në një tekst të shtjelluar me fjali të

gjata dhe të ndërlikuara. Ndërprerja me një fjali të shkurtër, jo vetëm bën përshtypje, por edhe sjell me vete një lloj kundërvënije të përmbajtjes (Kane, 2010, 431).

Periudha e shkurtër pas një periudhe më të gjatë mund të marrë natyrën e përgjithësimi të asaj çka është thënë më parë ose ta përsërisë në mënyrë të thukët. Në përgjithësi, në rast se ndërtohet mirë, ajo del e qartë dhe bindëse. Për shembull:

Diçka do të ketë mbetë pa prishë, mendoi ai, e për ta vërtetuar për po ose për jo, gati si për shkak, nisi t'i marrë erë secilës gja, njenës mbas tjetrës, dhe njënen mbas tjetrës e hodhi në mastelën e zhumbyleve e të fundërrive. Gjithçka ishte prishë (Camaj, 2010, 36).

Të shikonte një për një gjithçka, të kuvendonte gjatë, sidomos me shkoqitësit e kanunit, t'u kërkonte mendime, të hynte kullë më kullë, të kalohej pastaj me fullitarët, me oshënarët e vetmuar, të pyeste se a kishte mësues që pëshpëritnin kundër kanunit, të shënonte emrat e tyre, për t'i kërkuar princit dëbimin etj. Mendja e Mark Ukaçjerrës u gjallërua (Kadare, V11, 2009, 154).

Ky është një sentiment që ne sot nuk e njohim, sepse shumë të paktë janë ata, mes nesh, që mendojnë se jetohej më mirë në shekullin e kaluar, kur shumica e Evropës ishte e pushtuar gjatë gjithë kohës ose me kohë të pjesshme; kur nuk kishte trena, celularë, avionë pasagjerësh, televizorë shtëpiakë, internet, telefon, lavatriçe dhe qindra shpikje të tjera që ia kanë lehtësuar aq shumë jetën brezit tonë. Atëherë njerëzimi do të qajë për të ardhmen (Blushi, 2014, 4).

Disa breza do të besojnë se po jetojnë kohën e prindërve të tyre nga të cilët do trashëgojnë ose pasuritë e mjaftueshme, të cilat nuk kanë motiv t'i rrisin, ose varfërinë e trashëguar nga e cila nuk del sepse sistemi nuk ta lejon. Kjo është vdekja (po aty, 131).

Ne nuk kemi tokë dhe prandaj nuk kemi qiell, nuk kemi sy prandaj nuk kemi diell, nuk kemi gojë prandaj nuk kemi ujë, nuk kemi duar prandaj nuk kemi bukë, nuk kemi dritë dhe prandaj nuk kemi hije,

nuk kemi shpirt prandaj nuk kemi zjarr. Ne thjesht nuk jemi dhe prandaj nuk kemi qytet (Blushi, 2008, 265).

PËRFUNDIME

Periudhat shprehëse i pasurojnë dhe i përforcojnë kuptimet e fjalëve, të cilat, të vendosura në kontekste të caktuara, e zgjerojnë kuptimin, duke bërë që shuma e kuptimit të tyre të mos jetë thjesht një mbledhje logjike sintagmash të veçuara. Paraqitja e tyre e përpunuar, e hijshme dhe e arsyetuar i bën mjete të pazëvendësueshme, sidomos atëherë kur duhet dhënë një përjetim duke u nisur nga një ndjenjë e fortë.

Përvoja më e mirë që mund të marrë lexuesi nga njohja me stilin e baraspeshuar dhe me paralelizma është se në këtë mënyrë ai u jep vetëdije e formë mendimeve e ndjenjave, organizon përvojën e dijet; ndërsa autorët, nga ana tjetër, i shfrytëzojnë si mjete për të arritur theksimin dhe larminë e periudhave.

Gjithsesi, asnjëherë nuk mund të themi se një tip ndërtimi gjuhësor është më i mirë se tjetri. Përkundrazi, ndodh që një tip ndërtimi del më i përshtatshëm për disa qëllime të caktuara dhe shfaqet i pagoditur për disa të tjera. Autori që i njeh të fshehtat e mjeshtërisë, i përdor sipas kërkesës konkrete të tekstit, duke e rrokur se kur është njëri më i frytshëm e kur është tjetri.

Përgjithësisht, ndërrimi herë pas here i llojit të periudhave ose fjalive e gjallëron rrjedhën e tekstit. Ky puls i tekstit bën që elementi i ndryshëm të tërheqë vëmendjen e të përcillet me shprehësi në sfondin e tërësisë së veprës.

BIBLIOGRAFI

- Agolli D., (2006), *Zhurma e erërave të dikurshme*, Onufri, Tiranë.
ASHSH, (1983), *Fjalë të urta të popullit shqiptar*.
Bejta M., et al. (1988), *Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë.
Blushi B., (2008), *Të jetosh në ishull*, Botimet Toena, Tiranë.
Blushi B., (2011), *Shqipëria*, Mapo editions.
Blushi B., (2014), *Hëna e Shqipërisë*, UET Press.
Camaj M, (2010), *Rrathë gjaku*, Onufri, Tiranë.
Dema A., (2012), *Dashuria kuantike e Filanit*, LSHK, Prishtinë.
Kadare I., (1999), *Dosja H*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë.
Kadare I., (2008), *Kronikë në gur*, Onufri, Tiranë.
Kadare I., (2009), *Vepra 11*, Onufri, Tiranë.
Kadare I., (2009), *Vepra 17*, Onufri, Tiranë.
Kadare I., (2012), *Dimri i vetmisë së madhe*, Onufri, Tiranë.
Kane Thomas S., (1988), *The new Oxford guide to writing (Si të shkruajmë shqip)*, i përshtatur për shqipen nga Lloshi Xh., Nishku M., (2010), CDE, Tiranë.

TRADITA REALISTE E SHEKULLIT XIX DHE DORIS LESINGU

ERINDA PAPA

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Është e vërtetë se Lesingu është një shkrimtare e vështirë për t'u klasifikuar, spektri i gjinive dhe temave që ajo mbulon shtrihet që nga romani realist autobiografik, te romani socialpolitik, te proza joartistike, për të mbërritur te romani fantastiko-shkencor. Në prozën e saj të hershme Lesingu kërkonte ta vendoste veten në radhën e traditës realiste. Për të proza realiste është shprehje e besimit të njeriut te vetja, e cila mungon në format e tjera të letërsisë bashkëkohore. Ajo e pranon se disa nga elementet e prozës së saj janë huazuar me vetëdije nga gjigandët e realistëve të shekullit XIX, pasi herë pas here ajo u referohet me admirim duke nxjerrë në pah rëndësinë e këtyre shkrimtarëve në formimin e saj të mëvonshëm. Qëllimi i këtij punimi është të tregojë pikëtakimet e prozës së hershme të Lesingut me gjigandët e traditës realiste.

Fjalë çelës: *realizmi, traditë, angazhim, përballje.*

Abstract

It has frequently been assumed that a writer like Doris Lessing is difficult to be classified; the spectrum of genres and topics she covers ranges from realistic autobiographical novel, to socio-political novel, to nonfiction, arriving to the science fiction novel. In her early fiction D. Lessing sought to establish herself under the realistic tradition. According to her the realistic fiction is an expression of human confidence in themselves, which is absent in other forms of contemporary literature. She admits that some of her prose elements were borrowed from the distinguished giants of the nineteenth century realism, as occasionally she refers with admiration to them highlighting the importance of these writers in her subsequent formation. The purpose of this paper is to show the intersections of the early fiction of this writer with the realistic tradition of the nineteenth century.

Key words: *realism, tradition, commitment, social encounter*

E vlerësuar si një zë shumë i rëndësishëm në arenën letrare, Doris Lesingu, për rreth gjashtë dekada, ka qenë një ndër shkrimtarët e diskutueshme dhe shumë interesante për t'u klasifikuar nën tendenca të ndryshme. Roberta Rubinstaini shprehet se "ta klasifikosh Lesingun është njëllor si të hedhësh parimet e sufizmit në letër; sufizmi duhet të njihet prej përvojës, sepse thelbi i tij nuk mund të thithet nëpërmjet fjalës së shkruar"[Rubenstein, 1979]. Jeta dhe veprimtaria e Doris Lesingut ka qenë një proces rritjeje, ndryshimi, mospajtimi, dhe pjekurie nga i cili shpërtheu një personalitet dhe filozofi komplekse, që sfidon kufijtë e fjalës së shkruar. Studimet e bëra nxjerrin në pah copëza të formimit të shkrimtares, por përfundimet e këtyre studimeve të marra më vete, nuk ndërtojnë një tërësi koherente. Askush nuk mund të mëtojë se e ka trajtuar tërësisht dhe një herë e mirë përmbajtjen dhe formën artistike të veprës së saj. Nga ana tjetër, Lesingu të mahnit me kapërcimet e jashtëzakonshme të pikëvështrimit dhe orientimit të saj, saqë të krijohet përshtypja se aspekte të veçanta të personalitetit të shkrimtares bien shumë herë në kundërshti me njëri-tjetrin. Lesingu është e para që e njeht dhe e pranon këtë anë të natyrës së saj, kur shprehet: "Po përpiqem ta shkruaj sinqerisht këtë libër. Por, nëse do të më duhej ta shkruaja në

moshën tetëdhjetë e pesë vjeçare, sa i ndryshëm do të ishte ai?" [D. Lessing, 1994].

Në këtë punim, po përpiqemi ta shohim D. Lesingun si shkrimtaren që ngërthen realizmin e shekullit XIX me idealin e një të ardhmeje më të mirë, shqetësimi dhe rrugëtimi shumëdekadësh i së cilës i ofron njerëzimit shpresën dhe orientimin për t'i mbijetuar shekullit të ri.

Është e vërtetë se Lesingu është një shkrimtare e vështirë për t'u klasifikuar; spektri i gjinive dhe temave që ajo mbulon shtrihet që nga romani realist autobiografik, te romani socialpolitik, te proza joartistike, për të mbërritur te romani fantastiko-shkencor. Në prozën e saj të hershme Lesingu kërkonte ta vendoste veten në radhën e traditës realiste. Për të proza realiste është shprehje e besimit të njeriut te vetja, e cila mungon në format e tjera të letërsisë bashkëkohore. Ajo e pranon se disa nga elementet e prozës së saj janë huazuar me vetëdije nga gjigandët e realistëve të shekullit XIX, pasi herë pas here ajo u referohet me admirim duke nxjerrë në pah rëndësinë e këtyre shkrimtarëve në formimin e saj të mëvonshëm.

"Kulmi i letërsisë është romani i shekullit XIX, vepra e Tolstojt, Stendalit, Balzakut, Turgenjev, Çehovit; vepra e romancierëve të mëdhenj. Për mua realizmi përkufizohet si arti i cili buron natyrshëm

dhe plot gjallëri nga një vështrim i mbështetur fuqimisht dhe jo domosdoshmërisht intelektual mbi jetën. Unë mbështes gjykimin se romani realist, subjekti realist është forma më e lartë e prozës; më e lartë dhe e paarritshme edhe se ekspresionizmi, simbolizmi, natyralizmi apo ndonjë tjetër –izëm.” [D. Lessing, 1957]

Lesingu vëren se realistët e mëdhenj të shekullit XIX ndryshonin mjaft në qëndrimet e tyre në lidhje me fenë, politikën dhe parimet estetike. E përbashkëta e tyre ishte klima e gjykimit etik; vlerat e njerëzore; humanizmi i tyre. Është pikërisht ky fill etik dhe humanist që e përshkon gjithë prozën e Lesingut. Te “Një zë i vogël vetjak” (*A Small Personal Voice*), Lesingu shprehet se ajo do ta lexonte një vepër bashkëkohore që e tërheq – ndoshta për mprehtësinë e saj, inteligjencën apo guximin, por nuk do t’i rikthehej përsëri. Ndërsa, gjigandët e vjetër i lexon dhe i rilexon me ëndje pa u lodhur. Ajo beson se dëshira për t’i rilexuar disa shkrimtarë të shekullit XIX vjen jo nga nyja e përbashkët politike, fetare apo etike, por prej nevojës “për të ndriçuar mendjen, për të zgjeruar këndvështrimin mbi jetën” [D. Lessing, 1974]. Kur Lesingu shtron pyetjen se pse është e pakënaqur me thujtë të gjitha romanet bashkëkohore realiste, ajo arrin në përfundimin se:

“Nuk po kërkoj një rikthim të vlerave të vjetra etike, shumë prej të cilave unë nuk i pranoj. ...po kërkoj ngrohtësinë, dhembshurinë, të njerëzishmen, dashurinë për njeriun e cila ndriçonte letërsinë e shekullit XIX dhe i bënte këto romane shprehje të besimit të vetë njeriu. Këto, besoj, janë vlera që i mungojnë romanit sot.

Kjo është ajo që nënkuptoj kur them se letërsia duhet të shprehë angazhim. Janë këto vlera që unë kërkoj të cilat burojnë nga ky angazhim. Askush nuk mund të jetë i angazhuar pa pasur besim” [D. Lessing, 1974].

Angazhimi për të cilin flet shkrimtarja lidhet me përkushtimin ndaj njeriut. Për Lesingun, sapo shkrimtari ndihet përgjegjës ndaj të tjerëve, mbi të cilët ushtron ndikim, ai duhet të bëhet më njerëzor. Ai duhet ta shohë veten si mjet ndryshimi, për mirë a keq. Problemi me shkrimtarët sot, sipas Lesingut, është se gjatë aktit të komunikimit ata nuk i pranojnë përgjegjësitë që vijnë si rrjedhojë e këtij akti. Këtë qëndrim ajo e bën të qartë kur shprehet:

“Botimi i një tregimi apo romani është akt komunikimi, përpjekje për të përcjellë personalitetin dhe bindjet e tua te të tjerët. Nëse shkrimtari e pranon këtë përgjegjësi, ai duhet ta shohë veten, nëse do të përdorja një shprehje socialiste, si një arkitekt të shpirtit. Kjo është një shprehje prej së cilës asnjë nga shkrimtarët e shekullit XIX nuk do të turpërohej.” [D. Lessing, 1974].

Çelësi për të kuptuar shpjegimin e Lesingut mbi mungesën e përkushtimit të hasur të shkrimtarët bashkëkohorë, gjendet te fjala “fantazi”. Ërl Ingërsolli, duke komentuar mbi zhgënjimin e Lesingut nga kritikët, lexuesit, studiuesit a të tjerë, shprehet: “Ajo që dëgjoj vazhdimisht e kohë pas kohë ... është thirrja e dëshpëruar e Lesingut për të na detyruar ta shohim fantazinë si vlerën kyç për t’i mbijetuar shekullit të ri.” [Ingersoll, 1993]. Lesingu është e para që e pranon se idetë e saj kanë ndryshuar gjatë rrjedhës së kohës, duke vënë në dukje pikën e saj më të fortë – aftësinë për të shfrytëzuar fantazinë dhe për të ndryshuar. Prej kësaj shkrimtareje lexuesi pret të pamundurën. “Ajo nuk kthehet asnjëherë nga rruga për të sfiduar apo për t’u përballur me një botë, të cilën nuk mund ta sfidonin përgjigjet e djeshme.” [Sprague, 1987]. Ingërsolli vëren në një nga intervistat e Lesingut, pikëpamjen e saj në lidhje me natyrën e ndryshueshme të pikëpamjeve të veta:

“...këtë mendoj, ose së paku kështu mendoj tani. Nuk e di se çfarë do të mendoja pas dhjetë vjetësh. ... çfarë do të doja të mendoja, në këtë pikë, lidhet me dëshirën që kur dikush fillon të lexojë një nga tregimet apo romanet e mia, nxitet të shtrojë pyetje. Nuk po kërkoj ta bëj lexuesin të besojë si unë. Thjesht do të më pëlqente t’i kujtoja vetes se kam nxitur këshërinë e lexuesit. ai bën pyetje pavarësisht se çfarë pyetjesh janë ato.” [Ingersoll, 1993].

Për shkrimtaren nxitja e pyetjeve është e rëndësishme për të ecur para. Ajo të çon drejt përdorimit të fantazisë, e cila skicon të panjohurën. Ishte fantazia ajo që udhëhoqi shkrimtarët e shekullit XIX, ashtu siç udhëhoqi edhe D. Lesingun nëpër monopetet e kohës moderne drejt dyerve të shekullit XXI.

Kështu, shkrimtarja nuk beson se individ i kohës së sotme ka një përfytyrim të qartë për lirinë. Sipas saj, ta fantazosh njeriun e lirë kërkon të dalësh nga vetja, nga ajo që mendon dhe që je. Kjo nuk është e lehtë të arrihet gjithmonë, sepse njeriu është i lidhur ngushtë me nevojat e tij. Shkrimtarja është e bindur se ne të gjithë qëndrojmë përballë një dëre nga e cila do të dalë një njeri i ri. Është ky njeri i rilindur, i përgjegjshëm, i cili do të sjellë ndryshimin. Për Lesingun ne përballemi me dy rrugëdalje:

“...ta detyrojmë veten që me ndihmën e fantazisë të shndërrohemi në njeriun që kemi mundësi të jemi, ose t’i nënshtrohemi qeverisjes së burokratëve socialistë, të cilët kanë harruar se socializmi nënkupton dëshirën për mirësi dhe dhembshuri – dhe tekefundit nënshttrim do të thotë të humbasësh veten.” [D. Lessing, 1974].

Ëndrra e njeriut të lirë është një ëndërr e kahershme, por për shkrimtaren njeriu sot jeton “makthin e dhunës dhe shkatërrimit në një botë në të cilën, në çdo çast, një i çmendur mund të ndezë çelësin dhe të shfarosë njerëzimin” [Rubenstein, 1979]. E ky i çmendur mund të jetë cilido nga ne. Lesingu shprehet se asnjë individ nuk do të pranonte të ndizte vetë këtë “çelës”, por në kontekstin e një shoqërie a të një grupi gjithçka është e mundur:

“Të gjithë e dimë që ekziston një humnerë ndarëse ndërmjet vetëdijes personale dhe asaj kolektive. ... Pse ekziston kjo humnerë? Po shqetësohemi kaq shumë për vdekjen dhe ankthin e saj, sa që nuk po mundohemi të imagjinojmë se si do të ishte jeta pa trysinë e vuajtjes. Artsitët kanë qenë kaq të zënë me makthin e vdekjes, sa që nuk kanë pasur kohë të merren me utopitë e vjetra. ...Jemi zhytur në pafundësinë e vuajtjes dhe mund ta përfytyrojmë lumturinë vetëm si gogësimën e një pasditeje të diel.” [D. Lessing, 1974].

Përjekjet e artistëve për të mbushur këtë humnerë, për shkrimtaren janë shumë të rëndësishme. Por përballë trysisë së “makthit”, në botën moderne këto përjekje shpërfaqen thujse të papërfillshme. Ironikisht ajo shprehet se veprat më të mira të letërsisë perëndimore janë shprehje të anarkisë emocionale dhe jo të besimit të njeriu dhe tek e ardhmja. Lesingu vë përballë realistët e shekullit XIX me shkrimtarë të tillë si Kamy, Sartri, apo Beketi dhe sheh tek këta të fundit keqardhjen e lodhur për qeniet njerëzore.

Lesingu është optimiste se njerëzimi do të arrijë atë nivel ndërgjegjësimi të nevojshëm për t’u bërë ballë trysive të qytetërimit modern. E rëndësishme për shkrimtaren është të vendoset një drejtpeshim ndërmjet individit si një qenie e izoluar, e paaftë për të komunikuar, dhe si një qenie kolektive me një vetëdije kolektive. Pasqyrimi që shkrimtari duhet t’i bëjë njëriut si një individ i përgjegjshëm, i cili ia nënshtron vullnetin e tij vullnetit kolektiv, duke ruajtur njëherësh gjykimin personal, shënon qendrën e drejtpeshimit të cilin predikon vetë Lesingu.

Shqetësimi i shkrimtares humaniste për vlerat njerëzore përcillet fuqimisht të “Burgje brenda të cilave ne zgjedhim të jetojmë” (*Prisons We Choose to Live Inside*), ku Lesingu përqendrohet në marrëdhënien që individit vendos me shoqërinë.

Individët e epokës viktoriane ishin nën trysinë e vazhdueshme për t’iu nënshtruar dhe përshtatur normave të shoqërisë. Megjithatë, po të hedhësh sytë në shekullin XX e në vazhdim do të shohësh se shumë pak ka ndryshuar. Ne vazhdojmë të jemi pre e gjykimeve, normave dhe besimeve shoqërore. “Por, më të rrezikshme, më delikate dhe

kërcënuese, – thotë Lesingu, janë trysnitë e brendshme, të cilat kërkojnë të pajtohesh me grupin. Këto janë më të vështira për t’u vëzhguar dhe kontrolluar.” [D. Lessing, 1997]. Me fjalë të tjera, ne kemi një mekanizëm të brendshëm që na shtyn drejt qëndrimeve të papranuara ose bindjeve të kundërshtuara prej shumicës. Por, përballë trysive të jashtme, në mënyrë të pavetëdijshme, ne e censurojmë veten dhe bëhemi pre e mendimit dhe gjykitimit të shumicës, duke dalë kështu kundër bindjeve tona. Kjo lloj trysnie e brendshme është më e rrezikshme, sepse është e pandërgjegjshme.

Shpresa e vetme për të ardhmen mbetet të sigurohemi që brezat ta njohin problemin dhe duke shfrytëzuar informacionin që kanë, të përipien ta korrigojnë atë. Përjekja duhet të vijë nga individë, të cilët, në ndikimin e shkrimtarëve, do të mund të shtrojnë pyetje, të imagjinojnë dhe të veprojnë me përgjegjësi.

Ajo beson se individët mund të ndryshojnë shoqërinë, mund të nxitin ide të reja, si dhe “duke dalë kundër rrymës”, ata mund të sjellin ndryshimin. Jeta i mësoi Lesingut të vlerësojë individin, i cili kultivon dhe ruan mënyrën e tij të gjykitimit. Këta individë nuk pajtohen me trysnitë e shumicës dhe ruajnë mënyrën e tyre të vlerësimit. Këto cilësi gjenden edhe te një pjesë e shkrimtarëve të shekullit XIX, si: Çarls Dikensi, Xhorxh Elioti apo Tomas Hardi, por jehona e tyre ndihet edhe te D. Lesingu e kohëve moderne.

Lesingu jetoi në periudha të trazuara ndryshimesh. Ajo ishte dëshmitare e paragjykimeve racore apo shtypjeve socialpolitike. Në fund të jetës, në moshën nëntëdhjetë e gjashtë vjeçare, ajo e kuptoi se historikisht, problemet më të mëdha shoqërore e kanë pasur burimin të konflikti mes nevojave të individit dhe kërkesave të shumicës. Kjo është edhe arsyeja pse proza e saj shpreh shqetësimin për marrëdhënien që vendoset ndërmjet vetëdijes personale dhe asaj kolektive. Shkrimtarja pohon se individit duhet të jetojë brenda kornizës shoqërore, por kryesorja është drejtpeshimi që ai duhet të vendosë mes dy sferave, duke i qëndruar besnik vetëdijes personale, por duke repektuar edhe nevojat dhe vullnetin e shumicës.

Me interes është përjasja e Lesingut me shkrimtaren e shquar realiste të shekullit XIX, Xhorxh Eliot, që mund të përmbledhet kështu: dy shkrimtare mospajtuese, nga dy sfone të ndryshme historike, ndonëse të përballura me çështje të ndryshme morale, përjetuan, kohë pas kohe, shkallë të ngjashme izolimi shoqëror. Në një intervistë me shkrimtaren në prill 1980, Kristofer Bigsbi ngre pyetje në lidhje me moralin, si një element që i bashkon dy shkrimtaret.

Biggsby pyet në lidhje me një deklaratë të Lesingut, ku ajo shprehet se Xhorxh Elioti nuk kuptonte shumë gjëra, sepse ajo vetë ishte e moralshme. Tek Elioti ushtroheshin trysni të mëdha për shkak të marrëdhënies mëkatëre që ajo kishte me Xhorxh Luisin. Lesingu përgjigjet:

“Vura re të njëjtat trysni të ushtroheshin edhe tek unë kur shkrova “Blloku i artë”. Nuk jam paranojake, por nuk e merrni dot me mend se si u sulmova. Ishte me të vërtetë çnjerëzore. Më thoshin, sidomos amerikanët, se isha gruaja që urren burrat, që i tredh ata. Trysnia ishte e madhe tek unë për të qenë femërore, e mirë, e butë dhe e ëmbël. ...Por, për t’iu kthyer prapë Xhorxh Eliotit, nuk do të habitësia nëse ajo do të dorëzohej para trysnive të ushtruara. Dua të them se nuk ishte shaka të jetoje në atë shoqëri. Duhet të ketë qenë e frikshme.” [D. Lessing, 1997].

Ky pohim i shkrimtares i bërë gati njëqind vjet pas vdekjes së Xhorxh Eliotit, të habit me trysninë e shoqërisë së ushtruar mbi këto shkrimtare, për t’i detyruar të tregoheshin femërore, të mira, të buta dhe të ëmbla. Nga ana tjetër, Biggsby i kthehet esesë “Një zë i vogël vetjak”, ku Lesingu vlerëson letërsinë e shekullit XIX si kulmin e letërsisë, bazuar mbi komentin se këta shkrimtarë kishin një ndjenjë të fortë vetësigurie dhe ndanin një klimë gjykimi etik. Ai pyet nëse shkrimtarja mban një gjykim negativ ndaj Xh. Eliotit në deklaratën e saj dhe Lesingu përgjigjet:

“Te Xhorxh Elioti vihet re një lloj sigurie femërore të cilën nuk mund ta hasësh për shembull te Çehovi. Ka diçka të ngushtë në gjykim atje. Unë nuk po them se nuk e admiroj Eliotin; përkundrazi, e admiroj jashtëzakonisht. Megjithatë, në gjykimin e saj ka shumë vetësiguri.” [D. Lessing, 1974].

Mendoj se është e rëndësishme të dalë në pah dyanësia e marrëdhënies që Lesingu krijon me realistët e shekullit XIX, siç shihet edhe në qëndrimin që ajo mban ndaj Xh. Eliotit. Ajo e admiron Eliotin dhe thekson tensionin që krijohej te kjo shkrimtare prej shtypjeve të shoqërisë. Megjithatë, Lesingu e ka të vështirë të pranojë tonin e sigurisë në gjykim që përcillet në veprën e Eliotit. Është kjo lloj vetësigurie që e hasim edhe te një numër shkrimtarësh të tjerë të kësaj periudhe. Prandaj, me të drejtë mund të themi se Lesingu duket sikur largohet disi prej romanit realist të shekullit XIX. Vetë ajo shprehet:

“Kjo letërsi është shumë e ngushtë; kjo është arsyeja pse kemi ecur para. Le të marrim romanin

“Ana Karenina”. Ç’libër i mrekullueshëm! Ai flet për problemet shoqërore që lindin në një shoqëri fanatike, por tepër të ngushtë. ... Në të vërtetë, pjesa më e madhe e prozës viktoriane mund të klasifikohet si e tillë. Kur mbaron së lexuari romanin “Ana Karenina”, mendon: “O Zot!” Ja tek është kjo grua e rrënuar dhe e shkatërruar prej kësaj shoqërie marroqe. Kjo gjë ia ul vlerën romanit, mendoj... Në të vërtetë historia bazë është histori për hiçgjë, për një shoqëri të vogël, shumë të izoluar, për një sërë rrethanash shoqërore të përkohshme. Mendja jonë sot shtyhet drejt zbulimit të galaksive të reja, drejt kuazarëve, vrimave të zeza, universeve të tjera, e kështu me radhë, kështu që nuk mund të kënaqesh me përgjigjet *e sigurta* të dhëna më parë, sepse tani gjëra të reja po ndodhin. ... Deri pesëmbëdhjetë vjet më parë edhe unë i kisha idetë e qarta për dukuri të ndryshme, por sot e shoh se kam qenë e gabuar; bota po ndryshon, gjithçka është relative. E vërteta për një shoqëri është e gabuar për shoqërinë e një kohe tjetër. Çka është e vërtetë për një kohë, mund të mos jetë e tillë pas pesë vjetësh.” [D. Lessing, 1974].

Është e vërtetë që Lesingu u largua disi nga tradita e romanit realist të shekullit XIX kur shkroi “Blloku i artë”. Por, duhet theksuar se ajo u largua nga konteksti i romanit, si histori për një shoqëri të caktuar, në një kohë të caktuar. Fjala kyç për të kuptuar këtë ide është “shoqëria”. Shoqëria sot, me ideologjitë që ajo ndërthen, është shumë e ndryshme prej shoqërive më “të ngushta” dhe provinciale, të cilat shërbenin si sfondi i romaneve realiste të autorëve të shekullit XIX. Megjithatë, shpirti i këtyre shkrimtarëve, përkushtimi dhe përgjegjësia që marrin ndaj lexuesit dhe njeriut në tërësi, janë aspekte që e tërhiqin dhe e tërheqin ende Lesingun; që e kthejnë dhe e rikthejnë vazhdimisht drejt letërsisë realiste të shekullit XIX. Gjatë rrugëtimit shumëvjeçar të saj, gjatë rritjes dhe zhvillimit si shkrimtare, vihet re se Lesingu ruan të njëjtin shpirt që frymëzoi shkrimet e saj vite më pare.

Ndonëse, shpesh Lesingu nuk harron të tregojë se sa e çmon letërsinë realiste ruse të shekullit XIX, ajo përmend emra të përveçëm shkrimtarësh realistë anglezë, si: Çarls Dikens, Emili Brontë, Xhorxh Eliot, apo Tomas Hardi, të cilët kanë ndikuar fuqimisht jo vetëm në përmbajtjen, por edhe në formën që ajo i dha romanit të saj më vonë.

BIBLIOGRAFI

Ingersoll, Earl (1993), “The Doris Lessing Interviews”, *Doris Lessing Newsletter*, 15. no. 2.
Lessing, Doris, (1974), *A Small Personal Voice: Essays, Reviews, Interviews*, ed. Paul Schlueter, New York: Knopf.

Lessing, Doris, (1994), *Under my Skin: Volume I of My Autobiography to 1949*, London: HarperCollins Publishers.

Lessing, Doris, (1997), *Prisons We Choose to Live Inside*, New York: Harper.

Rubenstein, Roberta, (1979), *The Novelistic Vision of Doris Lessing: Breaking the Forms of Consciousness*, Urbana/Chicago/London: University of Illinois Press.

Sprague, Claire, (1987), *Rereading Doris Lessing: Narrative Patterns of Doubling and Repetition*, USA: The University of North Carolina Press.

IRRACIONALITETI I TOTALITARIZMIT TE “1984” E GEORGE ORWELL-IT DHE “PALLATI I ËNDRRAVE” I ISMAIL KADARESË -VËSHTRIM KRAHASUES

ERVIN XHINAKU*,

OLSA PEMA

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJIS
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË

Përmbledhje

Krahasimi i romaneve kundërtotalitare të Ismail Kadaresë me alegoritë politike të George Orwell-it është kthyer, tashmë, në një procedurë thujse standarde për ata kritikë që synojnë prezantimin fillestar të veprës së shkrimtarit shqiptar para publikut të vendeve anglisht folëse. Në funksion të hetimit nëse krahasimi në fjalë mbart vlera të njëmendta kritike apo përbën një klishe te thjeshtë promociionale, në këtë studim kemi ballafaquar veprën më përfaqësuese kundërtotalitare të Kadaresë, të mirënjohurin “Pallati i ëndrrave”, me klasikun antiutopik e kundërtotalitar të Orwell-it, romanin “1984”. Më specifikisht, vëzhgimi ynë analitik synon të zbulojë nëse një nga tiparet më themelore e më të komentuarat të antiutopisë oruelliane – irracionaliteti i sistemit politik e shoqëror që sundon në Oqeani – mund të shërbejë për të karakterizuar botën totalitare që paraqet Kadareja te “Pallati i ëndrrave”. Rezultatet e treguara përgjatë këtij studimi dëshmojnë pikërisht afërsinë themeltare mes vizionit të Orwell-it dhe atij të Kadaresë mbi totalitarizmin.

Fjalët çelës: *totalitar, irracional, pushtet, mit.*

Abstract

The comparison of Ismail Kadare’s antitotalitarian novels to George Orwell’s classical political allegories has become almost a standard procedure for critics who wish to introduce the work of the Albanian writer to the English-speaking world. It is the object of this study to give substance to this often-cited but never fully explained comparison. With this ultimate objective in view we have submitted Kadare’s most representative antitotalitarian allegory, “The Palace of Dreams”, to a detailed comparison with Orwell’s “1984”. More specifically, our analytical investigation has focused on whether what critics and readers alike have long recognized as one of the most fundamental features of Orwell’s totalitarian dystopia – its extreme irrationality – can be used to describe Kadare’s nightmarish vision in “The Palace of Dreams”. The results presented in this study, it is hoped, will provide a well-reasoned argument that demonstrates the kinship between the two writers’ literary conceptions of totalitarianism.

Key words: *totalitarian, irrational, power, myth.*

I. HYRJE

Një nga krahasimet më të shpeshta që kritika e huaj i bën veprës së Ismail Kadaresë është ai me romanet e njohura të shkrimtarit anglez George Orwell (Kuçuku, 2005). Megjithatë, krahasime të tilla deri më sot i kanë shërbyer një qëllimi të ngushtë ilustrues-promocional (i tregojnë lexuesit që nuk e njeh autorin shqiptar se çfarë të presë nga librat e tij), ndërsa mungon ndonjë studim i mirëfilltë, i shtjelluar e i argumentuar në thellësi me objekt nxjerrjen në pah dhe analizën përmbajtësore e gjenetike të të përbashkëtave e të veçantave në veprat e autorëve në fjalë. Puna studimore që ndjekim prej kohësh me romanet alegorike të Orwell-it dhe Kadaresë na ka bindur se një qasje krahasuese mes veprave të dy autorëve do të na ndihmonte të analizonim në mënyrë më të shumanshme botët totalitare që ndërtohen në to.

Tema e totalitarizmit trajtohet gjerësisht në një pjesë të mirë të shkrimeve të Orwell-it dhe Kadaresë. Orwell-i merret drejtpërdrejt me të jo vetëm në romanet e tij të famshme, “Animal Farm” (Ferma e kafshëve) dhe “1984”, por edhe në shumë

prej eseve e, madje, edhe në recensionet për vepra të autorëve të tjerë. Edhe Kadareja, ashtu si Orwell-i, i qaset kësaj teme nëpërmjet procedimeve të ndryshme ligjërimore (prozë artistike, poezi, ese, ditar, por edhe intervista të shumta apo biseda të menduara mirë me shkrimtarë e kritikë të njohur). Në plotësinë e vet integrale, megjithatë, tema e totalitarizmit realizohet nga Kadareja vetëm në vepra me karakter të theksuar alegorik.

Për këtë arsye mendojmë se, në parim, një paralele krahasuese mes alegorive kundërtotalitare të njohura të Orwell-it dhe veprave të Kadaresë duhet të përqendrohet në romanet me karakter alegorik të këtij të fundit, që e trajtojnë në mënyrë tërësore temën e totalitarizmit dhe ndërtojnë një univers të plotë totalitar të krahasueshëm me botën e njohur të shkrimtarit anglez. Gjithsesi, duke qenë se numri i këtyre veprave në krijimtarinë e përgjithshme të Kadaresë është jo i vogël, na duket me vend që analiza krahasuese me objektin e sipërpërmendur mes tij dhe Orwell-it, në funksion të një depërtimi sa më të thellë brenda kufijve që lejon një format si i yni, por edhe për të ruajtur një lloj

simetrie, jo vetëm formale, mes njësive të krahasuara, të përqendrohet në romanet më përfaqësuese të dy shkrimtarëve – konkretisht romani “1984” i Orwell-it dhe “Pallati i ëndrrave” i Kadarese. Më specifikisht, vëzhgimi ynë analitik synon të zbulojë nëse një nga tiparet më themelore e më të komentuar të antiutopisë oruelliane – irracionaliteti i totalitarizmit si sistem politik e shoqëror – mund të shërbejë për të karakterizuar botën totalitare që paraqet Kadareja te “Pallati i ëndrrave”.

II. Bota totalitare te “1984” dhe “Pallati i ëndrrave” – univers i ndërtuar mbi irracionalen

Orwell-i dhe Kadareja në veprat e tyre nuk kënaqen me paraqitjen e tipareve të veçanta të botës totalitare, as me pasqyrimin, sado të plotë, të një kuadri të caktuar hapësinor-kohor të realitetit. Me anë të alegorisë veprat e tyre i kapërcejnë kufijtë e vendosur nga referencat konkrete në tekst për të përfutur botë të plota – universe të vetëmjaftueshme – që, përveç morisë së pafund të fakteve, ngjarjeve dhe personazheve që i përbëjnë, kanë edhe ligjësitë e tyre të padukshme që vënë në lëvizje gjithçka. Emëruesi i përbashkët i këtyre ligjësisë themelore apo kolonave mbajtëse të ngrehinës së shtetit totalitar është karakteri thellësisht irracional i tyre. Bota totalitare, pra, është bota e materializimit të mosarsyes; ajo buron nga thellësitë e errëta të shpirtit njerëzor, shfrytëzon instinktet parake dhe prirjet kafshërore të njeriut, përdor gjerësisht manipulimin psikologjik, dhunën e verbër dhe frikën bestypte, mistifikon marrëdhëniet e individit me realitetin dhe me të tjerët, ngre mite të reja me një sistem të tërë idhujsh dhe tabush, shpërfill të vërtetën dhe zërin e arsyes në emër të absurdit dhe paradoksit.

Siç ka vërejtur shpesh kritika, irracionaliteti i botës totalitare të paraqitur te “1984” e Orwell-it është aq i shprehur saqë nuk mund të mos vihet re edhe prej një lexuesi krejt pasiv të veprës (Bloom, 2007). Në pjesë të caktuara të tekstit, madje, filozofia irracionale që përbën edhe ideologjinë udhëheqëse në Oqeani, artikulohet prej eksponentëve të saj si O’Brien-i nëpërmjet një ligjërimi të drejtpërdrejtë, gati shkollaresk, që nuk lë shumë vend për interpretime kritike prej lexuesit. Përtej shpjegimeve me karakter teorik, vetë të dhënat elementare rreth jetës në Oqeani tregojnë për shkallën e irracionalitetit që karakterizon botën totalitare. Kështu, në të është e tashmja që prodhon të shkuarën dhe jo anasjelltas; të vërtetat elementare të aritmetikës, ashtu si ligjet e natyrës, janë krejtësisht te përpunueshme – dy edhe dy bëjnë katër, por mund të bëjnë edhe tre, edhe pesë, sipas nevojës; njeriu (d.m.th. Partia) e ndërton vetë

realitetin sipas dëshirës, pasi asgjë nuk ekziston objektivisht jashtë tij – toka vetë nuk ka ekzistuar para njeriut; raportet objektive mes gjërave janë kthyer përmbys – nuk rrotullohet toka rreth diellit, por dielli dhe yjet rreth tokës; njeriu i ri totalitar, që ka përvetësuar si duhet parimet e “Mendimit të dyfishtë”, është i aftë të sfidojë ligjet më themelore të mendimit – ai mund “të tregojë gënjeshtër të qëllimshme duke i besuar ato me sinqeritet si të vërteta” (Orwell, 2003, f. 290) apo të përqafojë njëkohësisht dy opinione të kundërta rreth së njëjtës gjë, pa ndier asnjë lloj mospërputhjeje të brendshme.

Mund të themi madje se irracionaliteti i botës totalitare te “1984” shkon deri në ekstrem duke u kthyer në një antiracionalitet të vetëdijshëm e militant. Bota e Orwell-it, kjo antiutopi e së ardhmes, ka për ligj themelor të saj paradoksin, ndërsa për armik të drejtpërdrejtë, të cilin e lufton në mënyrë të pareshtur me të gjitha mjetet, arsyen e shëndoshë. “Herezia e herezive ishte arsyeja e shëndoshë” (Orwell, 2003, f. 162) reflekton në monologun e tij të brendshëm Winston-i. Mjafton ky përgjithësim aforistik për të kuptuar se konflikti thelbësor në universin e ri të totalitarizmit nuk zhvillohet, ashtu siç paraqitet në dukje, mes një doktrine dhe një doktrine tjetër apo mes grupimeve të ndryshme politike. Në qendër të gjithçkaje qëndron përplasja mes përpjekjeve të njeriut për të ruajtur të paprekura shtyllat mbajtëse të arsyes njerëzore, kujtesën vetjake, dëshmitë e shqisave, operacionet e logjikës dhe mëtimin të pushtetit për t’i rrëzuar të gjitha këto, për të fshirë çdo gjurmë racionaliteti nga mendja njerëzore me qëllim kthimin e saj në një *tabula rasa* që mund të mbushet më pas me çfarëdolloj gjepurash absurde.

Është e vetëkuptueshme se në një realitet të tillë të çmendur, tipari dallues i të cilit është “... lidhja së bashku e të kundërtave – e diturisë me injorancën, cinizmit me fanatizmin” (Orwell, 2003, f. 291) pozicioni i individit mendërisht të shëndoshë në raport me çmendurinë e përgjithshme përbën një paradoks më vete. Winston Smith-i trajtohet si një i çmendur që duhet kuruar prej O’Brien-it për arsye se vazhdon ende t’u ngelet besnik të vërtetave më bazike që kanë për burim perceptimin e drejtpërdrejtë shqisor dhe logjikën elementare. Pikërisht, kjo këmbëngulje e Winston-it për të ruajtur minimumin e tipareve dalluese të një *homo sapiens*-i, interpretohet si simptomë e çmendurisë së tij. Ironia më e madhe, megjithatë, qëndron në faktin se Winston-i vetë shpesh dyshon se mos është vërtet i çmendur, përderisa paradoksalisht çmenduria tashmë është kthyer në normë dhe shërben si standard matës për të dalluar “mendimin

devijant”. Me metrin e shoqërisë totalitare Winston-i, me besimin e tij tek arsyeja dhe e vërteta objektive, është i sëmuri antishoqëror që kapërcen caqet e asaj që shumica trushpëlarë e quan si gjendje normale mendore. Në fund, pas “terapisë” intensive në duart e O’Brien-it, edhe ai “shërohet”, pra, integrohet plotësisht në botën absurde të shoqërisë totalitare.

Te “Pallati i ëndrrave” irracionaliteti i universit totalitar më shumë sesa tregohet përmes tipareve të tij të veçanta, komunikohet nëpërmjet mënyrës së përgjithshme të vështrimit të gjërave, formës që merr trajtimi i tij në vepër. Si te 1984 edhe këtu është mjaft e dallueshme një përmasë irrealë, fantastike e realitetit që e afron atë me botën e çartur të ëndrrave. Te “Pallati i ëndrrave” shumëçka ndodh vërtet si nëpër ëndërr: rrëfimi është i mbushur me skena që konvencionalisht i përkasin jetës së vërtetë, por që ngjajnë si përshkrime të ndonjë makthi a kllapie; bota nuk shihet nga lexuesi në mënyrë objektivistë prej së jashtmi por e përthyer nëpër ndërgjegjen e trazuar të Mark Alemit, të cilit, në krahasim me ëndrrat, bota e zgjimit i duket “... e çngjyrosur dhe e zbehtë si pas një lëngate” (Kadare, 1999, f. 112); e gjithë atmosfera e veprës, në fakt, ka më shumë nga ëndrra sesa nga zgjimi. Ngjizja e realitetit me fantastiken te “Pallati i ëndrrave” bëhet edhe më e prekshme në disa episode narrative apo përshkrime të një lloji gati surreal, ku nuk dallohet qartë kufiri ndarës mes te dyjave. Në romanin e Kadaresë një episod i tillë është ai i përshkrimit të Luftës së Kosovës, që Mark Alemi e lexon në një nga dosjet e vjetra të Arkivit. Në të, personazhet dhe ndodhitë e vërteta të betejës së famshme ngatërrohen në mënyrë të pazgjidhshme me përfytyrime të çartura, ndërsa tabloja që përftohet ngjan si një shartim i pazakontë ndërmjet kronikës historike dhe transkriptimit në fjalë të një makthi (Kadare, 1999, f. 140-141).

Te “Pallati i ëndrrave” ndonëse ndryshe nga “1984” nuk flitet drejtpërdrejt, në stilin argumentues të një romani idesh, për çështje filozofike të konceptimit mbi natyrën dhe njeriun, pasqyra që përftohet në lidhje me këto, kur analizojmë tërësinë e simboleve dhe aluzioneve që gjenden në vepër, nuk është larg asaj që percjell Orwell-i. Si në Oqeaninë e Orwell-it, edhe në Perandorinë totalitare të Kadaresë, natyra konceptohet në mënyrë antropocentrike, sikur punon duke patur për pikësynim final të mirën e njeriut (d.m.th., të mirën e pushtetit) – vetë allahu nga lartësitë qiellore “siç hedh ylberin apo rrufenë” (Kadare, 1999, f. 17), hedh ëndrrat paralajmëruese për njerëzit. Ndërsa te “1984” bota e fabrikuar nga

Partia e zëvendëson tërësisht botën e vjetër të ligjeve të natyrës, te “Pallati i ëndrrave” kemi përsëri një realitet alternativ – atë të ëndrrave – gjithçka e të cilit, Mark Alemi i duket “... më e kërthnezte dhe më e gjallë” (Kadare, 1999, f. 112) se në botën e vërtetë. Një dikotomi e tillë te Kadareja, në rast se me botën e ëndrrave kuptojmë simbolikisht vizionin ideologjik që përpunon pushteti, është e njëjtë me atë që përcaktohet në terma më të drejtpërdrejta tek Orwell-i. Në të dyja rastet përcillet fakti se në sistemet totalitare vizioni ideologjik merr vlerë dhe përparësi absolute mbi realitetin empirik që shpesh nuk përputhet fare me të.

Në të dyja veprat irracionaliteti i botës totalitare nxirret në pah edhe prej vendosjes së një analogjie mes saj dhe shembujve të njohur historikë të mëtimit irracional për të pasur kontroll absolut mbi gjithçka. Tek “1984” gjejmë aluzione mbi kozmologjinë mesjetare apo krahasime mes sistemit oqeanik dhe atij teokratik të mbrojtur nga Inkuizicioni (për mendimin humanist-liberal të kohës së Orwell-it mesjeta dhe inkuizicioni ishin sinonim i errësirës dhe shtypjes), ndërsa te “Pallati i ëndrrave” jepet një gjenealogji historike e Tabirit që përfshin “gjithë orakujt e Delfit, apo kastat e profetëve e magëve të dikurshëm...” (Kadare, 1999, f. 17). Totalitarizmi modern, pra, rrënjët i ka në bestytnitë e vjetra të lashtësisë. Vetë projekti totalitar i parashikimit dhe kontrollit absolut të gjithçkaje, që paraqitet si një përsosje e ndërmarrjeve të ngjashme të së shkuarës, s’është gjë tjetër veçse pasojë e një *hubris*-i çmendurak që s’njeh asnjë lloj pengese para vullnetit për pushtet.

E afërt është bota e re e totalitarizmit edhe me botën arkaikë të parahistorisë njerëzore. Pas fasadës së qytetërimit modern (moderniteti i totalitarizmit theksohet më shumë tek Orwell-i) gjallon kaosi i instinkteve primitive që shfrytëzohen më së miri prej manipulatoreve profesionistë. Skenat e turmës te “1984” duken si të nxjerra prej ndonjë studimi antropologjik mbi ritualet dhe sjelljen e njerëzve të egër. Shembulli i spikatur i një përafrimi të tillë është ai përshkrimit të histerisë kolektive që kaplon punonjësit e Ministrisë së të Vërtetës gjatë “Dyminutëshit të urrejtjes”. Shkarkimi i pasioneve të forta gjatë këtij ceremoniali të përditshëm të organizuar nga Partia, kalon nëpër disa etapa, prej tërbimit kafshëror kur në ekran del fytyra e Goldstein-it, në një lloj ekzaltimi mistik kur shfaqet “Vëllai i madh” të cilit dikush fillon edhe t’i lutet duke e quajtur “Shpëtimtari im” (Orwell, 2003, f. 102). Vala e çlirimit të pasioneve është aq e fuqishme sa individit shkrihet me turmën dhe humb kontrollin mbi vetveten – në çaste të tilla, Winston-i, kundër mendimeve të veta në kohë të tjera, por pa

shtirje e hipokrizi, bëhet njësh me tribunë në britmat kundër Goldstein-it. Orgjia mbyllet me një këngë të mbytur, të ngadaltë, një lloj murmurime kolektive në përshkrimin e së cilës si "...çuditërisht e egër, me një sfond ku të bëhej se dëgjoje përplasjen e këmbëve lakuriqe dhe goditjen e tam-tameve" (Orwell, 2003, f. 103), ndihet kujtimi atavik i primitivitetit të racës njerëzore.

Te "Pallati i ëndrrave" evokimi i një bote parake dhe përngjasimi i saj me botën e totalitarizmit bëhet, kryesisht, përmes aluzioneve mbi mitet e vjetra. Kritika ka evidentuar jehona të disa prej këtyre miteve në veprën e Kadarese (Kuçuku, 2005, f. 284). Marrëdhënia me mitet, në fakt, përtej disa përkitjeve të veçanta, apo edhe përmendjes së hapur të disa figurave dhe bestytnive mitike, ndihet në gjithë mënyrën e paraqitjes së asaj që ndodh me Qyprillinjtë. Rënia dhe ringritja e tyre konceptohet në mënyrë fataliste si një lloj cikli i pashmangshëm që përsëritet prej shekujsh. Mallkimi i familjes së Qyprillinjve që i ndjek breznitë e njëpasnjëshme si një nëmë së cilës nuk mund t'i fshihesh – "pjesa e keqe e fatalitetit të Qyprillinjve" (Kadare, 1999, f. 54) – të kujton Shtëpinë e Atridëve dhe destinin e pinjollëve të saj. Përpyekjet e verbra të Mark Alemit për t'i shpëtuar Qyprillinjtë nga goditja që pritet janë po aq të paefektshme sa edhe përçapjet e Edipit për t'i bishtnuar fatin të parathënë (ndoshta për ko incidencë, momenti kyç i jetës së Mark Alemit, interpretimi i ëndrrës së perimeshitësit, është i të njëjtit lloj me momentin kyç të jetës së Edipit, zgjidhjen e enigmës së sfinksit). Në fakt, siç tregohet në roman, mëkati fillestar i Qyprillinjve është pjesëmarrja e patriarkut themelues të fisit të tyre, Gjonit, në vrasjen rituale të dikujt që murosset në themelet e një ure si blatim që ajo të mos bjerë. Shihet qartë, pra, se jemi tërësisht të zhytur në botën e përgjakur të miteve; se ashtu si Qyprillinjtë e sotëm rrjedhin prej stërgjyshit mitik Gjon, i gjithë realiteti i tyre (ky është pikërisht realiteti i politikës së lartë në shtetin totalitar) rrjedh prej realitetit të tmerrshëm të miteve.

Afërsia e botës që ndërton Kadareja te "Pallati i ëndrrave" me atë që paraqesin mitet përfshin jo vetëm konceptime dhe shfaqje të caktuara që i hasim në të dyja universet, por edhe ligjësitë e padukshme që shpjegojnë vetë ekzistencën e tyre. Në një farë kuptimi, i gjithë konstruksioni gjigant i totalitarizmit te "Pallati i ëndrrave" analizohet si i ndërtuar në përputhje me parimet e mitologjisë. Duke debatuar me kushëririn e tij për Tabir Sarajin, që sigurisht përfaqëson shtetin totalitar në tërësinë e vet, Kurti shprehet se: "... ai është ngreha e vetme në shtetin tonë,

nëpërmjet të cilit pjesa e errët e ndërgjegjes së gjithë shtetasve krijon një përkitje të drejtpërdrejtë me shtetin... Turmat e pafundme vërtet nuk qeverisin ... por kanë një vegël me anë të së cilës ndikojnë në të gjitha punët, aventurat dhe krimet e shtetit, dhe ky është Tabir Saraji" (Kadare, 1999, f. 58). Shteti totalitar, pra, qëndron si një lloj superstruktura mbi nëndërgjegjen e turmave. Një analizë e tillë nuk ka se si të mos sjellë ndërmend shpjegimin e famshëm të Jung-ut për mitet si projekttime të së pandërgjegjshmes kolektive të njerëzimit (Jung, 1970, f. 325). Ashtu si rrënjët e miteve edhe themelet e shtetit totalitar qëndrojnë në errësirën e padukshme të psikikës njerëzore, jo në të ashtuquajturat "parime të shenjta" që s'janë tjetër veçse parulla boshe mashtruese.

Në botën totalitare të Kadarese, jo vetëm të kuptuarit e përgjithshëm për gjërat por edhe sjellja e zakonshme e njerëzve, mënyra si ata i qasen realitetit, përmban një dozë mjaft të lartë irracionaliteti. Te "Pallati i ëndrrave", krejt Perandoria jeton si nën hipnozë – banorët e saj kanë humbur kontaktin me jetën e gjallë nën ndikimin sugjestiv të kultit të ëndrrës. Bota e pafund që ka nën hyqmin e tij sulltani sovran paraqitet si një botë e magjepsur ku arsyes njerëzore i ka zënë frymën supersticioni, mendimit racional, marrëzia e turmave. Aktiviteti i vetëm që tërheq banorët e humbur të provincave është çuarja e ëndrrave në mëngjes herët tek pikat e mbledhjes, që s'janë gjë tjetër veçse degëzimet fundore të "Pallatit të ëndrrave" të përhapura në çdo cep të Perandorisë. Nëpunësit e vetë pallatit, nga ana e tyre, para tryezave me dosjet sipër, nën efektin trulllosës të maktheve që duhet t'u japin kuptim duken "... si të bërë njësh me ndenjëset, të vënë si në gjumë nga dosjet që kishin përpara" (Kadare, 1999, f. 26).

Bota e "Pallatit të ëndrrave", ndonëse në pamje të parë ka një ngjyrim të theksuar ekzotik, çka ia jep edhe dekori larushan oriental, në një vështrim më të thellë, që arrin të depërtojë në simbolikën e veprës, është pikërisht dhe paradoksalisht bota e shpallur antifetare e komunizmit. Analizuar përmes prizmit të referencës ndaj bashkëkohësisë, kulti i ëndrrës, me të gjitha legjendat që e rrethojnë (legjendë mjaft e efektshme, që ndihmon popullarizimin e kultit, është ajo e provincialit të panjohur që ngrihet prej sulltanit në majat e shoqërisë për shkak të një ëndrre paralajmëruese) s'mund të jetë tjetër veçse simbol i ideologjisë totalitare dhe indoktrinimit të masave me të pavërtetat e saj. Me anë të tij shkrimtari ka arritur të përcjellë një nga dimensionet më të panjohura të komunizmit të vërtetë, që, madje, bie ndesh me parimet e shpallura teorike të filozofisë së tij

materialiste – misticizmin bestyt që përfshin gjithë organizmin shoqëror dhe lidh me fije të errëta masat me pushtetin (Kadare, 1996, f. 148-149). Në dritën e këtij njëjtësimi mes botës së ëndrrave dhe ndërgjegjes së gënjeshtërt që vjen si rezultat i manipulimit psikologjik në shoqëritë totalitare, kuptojmë se është pikërisht dehja nga avujt e opiumit ideologjik ajo që kultivon jetën pasive te mizëria e shtetasve-sklllevër anekënd Perandorisë (pasi çojnë ëndrrat tek nëpunësi i provincës ëndërrparësit nisen drejt pijetores ku kalojnë pjesën tjetër të kohës), dhe shkëputjen nga realiteti të nëpunësve të Tabir Sarajit (Mark Alemi ndihet tërësisht i huaj gjatë një shëtitjeje në rrugët e qytetit që e koncepton si një bujtje “në botën e të gjallëve”, ndaj mezi pret të kthehet në “botën e çuditshme” të ëndrrave – d.m.th., në vegimet imagjinare të ideologjisë – “... ku kahu i gjërave dhe gjithçka tjetër ecte krejtësisht ndryshe” (Kadare, 1999, f. 124).

Krahasimi mes botës së ëndrrave dhe asaj të zgjimit, që bën Mark Alemi ditën e pushimit kur del nëpër qytet, flet shumë për universin fantomatik të ideologjisë totalitare dhe nevojat psikologjike që plotëson përhumbja prej somnambuli në të. Mark Alemi, bota e vërtetë e krahasuar me arealin fantastik të ëndrrave i duket e ngrirë dhe e mërzitshme. Ditën e lejes dhe rikthimin e parë pas një shkëputjeje disa mujore në jetën e zakonshme ai e përjeton si një i dehur momentin e vështirë të daljes së pijes. Me sa duket bota e ëndrrave për të, tashmë, ka zëvendësuar botën e vërtetë. Duke qenë “aq e bukur dhe plot ndezulli” (Kadare, 1999, f. 112) ajo kënaq më së miri rendjen iluzive të njeriut pas përralloreve dhe së jashtëzakonshmes. Tani, në rast se me botën e ëndrrave do të kuptojmë ndërgjegjen e gënjeshtërt, produkt i indoktrinimit ideologjik në sistemet totalitare, kontrasti i mësipërm mes saj dhe botës së zakonshme mund të interpretohet simbolikisht si tregues i hendekut mes marrëzisë së utopizmit totalitar dhe kokëfortësisë së realitetit objektiv. Bëhet fjalë për universe tërësisht të ndryshme që përjashtojnë njëri-tjetrin në çdo aspekt (gjatë ditëve kur punon në Tabir Saraj, Mark Alemi niset në punë në mëngjes herët dhe kthehet në të ngrysur pa vënë re asgjë nga qyteti përreth). Statusi ekzistencial i tyre nuk mund të jetë i njëjtë pasi bota reale është ajo që është, ndërsa konstruktionet ideologjike janë vetëm një vegulli. E megjithatë forca tërheqëse e këtyre të fundit mund të jetë aq e madhe saqë njeriu të zgjedhë të mbyllë sytë para realitetit të kudondodhur për të jetuar si i magjepsur në një botë te paqenë.

Marrëzia e botës totalitare bëhet mjaft e dukshme, sidomos përmes cilësimeve të drejtpërdrejta të saj si një botë e marrë dhe

shpeshtisë në tekst të fjalëve që lidhen me çmendurinë. Një procedim të tillë e gjejmë në të dyja veprat, ndonëse tek “1984” çështja e çmendurisë së botës dhe kundërvënies së saj me psikikën e shëndoshë të individit kthehet në një motiv që trajtohet hapur dhe në mënyrë të përsëritur në të gjitha variacionet e mundshme – siç thamë më lart, Winston-it një herë i duket bota krejt e çmendur dhe vetja normal, një herë tjetër dyshon mos ai është i çmenduri ndërsa bota normale. Te “Pallati i ëndrrave” çmenduria e botës totalitare tregohet, gjithashtu, më se një herë, përmes përcaktimeve të drejtpërdrejta apo krahasimeve që evokojnë hapur botën e të çmendurve. Mund të përmendim këtu arsyetimin e Kurtit – personazhi më i iluminuar në roman, përfaqësuesi i mendimit dhe veprimit të lirë jo konformist – se kjo botë është aq e marrë sa në të edhe “Pallati i ëndrrave”, “...më i jashtarsyeshmi, më i verbri, më fatali...” ndër institucionet e shtetit, ngjan i zakonshëm (Kadare, 1999, f. 58), apo krahasimin e ngritjes së Tabir Sarajit gjatë periudhës së krizës me acarimin e të çmendurve gjatë hënës së plotë (Kadare, 1999, f. 120).

Vet gjakimi totalitar për pushtet absolut ngrihet mbi prirjet më të errëta të shpirtit të njeriut. Tek “1984” një gjë e tillë shpallet hapur kur O’Brien-i i shpjegon Winston-it, që deri atëhere e ka pasur të pamundur të kuptojë qëllimin e fundmë të asaj që bën Partia, se *pse*-ja e gjithë mekanizmit të pushtetit, leva që e vë atë në lëvizje nuk është as e mira e përgjithshme, as ndonjë koncept tjetër utopik, por dëshira për pushtet, për t’i shkelur të tjerët me këmbë. Te “Pallati i ëndrrave” çështja e motivimeve politike nuk analizohet kaq hapur – lihet të kuptohet, megjithatë, se këto nuk burojnë nga pjesa e ndriçuar e arsyes njerëzore, por nga thellësitë e errëta. Kështu, kur Mark Alemi pyet nëpunësin në tryezën fqinje “Pse ndodh kjo?” për zhvillimet në “Pallatin e ëndrrave”, përgjigja që merr është: “O Zot, si mund të bësh pyetjen ‘pse’ në këtë pallat... A mund të dihet kurrë ‘pse’-ja e gjërave këtu?” (Kadare, 1999, f. 146). Vetë veziri, që e njeh së brendshmi fiziologjinë e shtetit perandorak rri i shtangur para kufomave të rapsodëve shqiptarë duke u përpjekur të kuptojë arsyet e goditjes ndaj Qyprillinjve dhe atë që duhet bërë për t’u ndryshuar rrjedhën ngjarjeve, me vështrimin e hedhur larg, “... në kushedi ç’puse misterioze, prej nga vihej në lëvizje makina shtetërore që kishte prodhuar këtë fatkeqësi” (Kadare, 1999, f. 162). I vetmi atribut njerëzor që i vishet sulltanit të gjithëpushtetshëm dhe që, me sa duket, përbën shtysën kryesore prapa veprimeve të tij, është njëkohësisht edhe ai më i errëti, xhelozia. Depërtimi në këto thellësi të

fshehura të psikologjisë së pushtetit tregon se shpjegimet me karakter doktrinar që i bëhen rëndom aksionit politik nga regjimet totalitare nuk janë veçse mashtrime të qëllimta ose racionalizime të pasioneve irracionale.

Së fundi, duhet të themi se si tek Orwell-i si te Kadareja çmenduria e botës totalitare nuk është e vetvetishme. Ajo ushqehet në mënyrë të qëllimshme prej atyre që duan të përjetësojnë pushtetin përmes shpëlarjes së truve dhe trulllosjes së vetëdijeve. Manipulimi psikologjik përbën metodën kryesore krahas terrorit të drejtpërdrejtë, që i kthen njerëzit në Oqeani në dele të bindura të regjimit. Shembujt e transformimit të qenies njerëzore në një instrument pa arsye që i shërben verbërisht pushtetit mbushin faqet e romanit, duke kulmuar me metamorfozën e Winston-it nga njeri me ndërgjegje e vullnet vetjak në një lloj *zombie* të programuar për të qenë krejt i padëmshëm. Te Kadareja përsiatja e Vezirit për raportin mes botës së ëndrrave dhe asaj të zgjimit përçon simbolikisht të njëjtën ide. Prej shpjegimit të tij kuptojmë se mbi gjithë atmosferën halucinante që përhapet anë e qark Perandorisë qëndron një arsye perverse që manipulon deri edhe të pandërgjegjshmen kolektive për interes të saj (Kadare, 1999, f. 121).

III. PËRFUNDIME

Në këtë studim kemi ndërmarrë një krahasim kryesisht tematik mes romanit “1984” të Orwell-it dhe “Pallatit të ëndrrave” të Kadaresë. Dy romanet janë përzgjedhur nga moria e krijimtarisë së shkrimtarëve si veprat e tyre më përfaqësuese që në stil alegorik trajtojnë temën e gjerë të totalitarizmit. Në funksion të një përshkrimi që synon më shumë thellësinë analitike sesa gjithëpërfshirjen e morisë së aspekteve që karakterizojnë botët totalitare të paraqitura në dy veprat, vështrimin tonë krahasues e kemi përqendruar mbi vetëm njërin prej tipareve themeltare të totalitarizmit të përshkruar në to: karakterin e tij thellësisht irracional. Në fakt, irracionaliteti i totalitarizmit të Orwell-it, ashtu sic është vënë re nga kritika, përbën një nga tiparet e tij më të spikatura, ndaj edhe analiza e veprës së Kadaresë përmes këtij prizmi tematik është mjaft domethënëse në lidhje me legjitimitetin e krahasimit mes vizionit të tij për totalitarizmin dhe atij të Orwell-it.

Siç rezulton nga analiza e detajuar e paraqitur në këtë studim si bota totalitare e Orwell-it ashtu edhe ajo e Kadaresë kanë karakter thellësisht irracional. Te “1984” e Orwell-it, ndër të tjera, universi totalitar përshkruhet si një botë e çartur e ngritur mbi instinktët më të errëta. Vetë botëkuptimi që përcjell propaganda e parreshtur totalitare përbën në vetvete një lloj mohimi të

drejtpërdrejtë të gjithçkaje të arsyeshme që e dallon qenien njerëzore nga qeniet më të ulta. Njeriu trushpëlarë totalitar stërvitet prej ustallarëve në krye të vendit për të besuar gjithçka që i shërben pushtetit, sado absurde qoftë ajo. Ai arrin, madje, të pranojë njëkohësisht dy gjëra që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, pa ndier as më të voglën kontradiktë të brendshme. Edhe sjellja e tij e jashtme është krejt e kundërta e idealit të vjetër humanist, që qëndron prej shekujsh në themel të kulturës perëndimore – britmat hysterike dhe entuziazmi delirant i njeriut oruellian, të shkrirë tok me të tjerët në anonimatit depersonalizues të turmës, vijmë si jehona atavike prej një kohe të largët kur njeriu nuk kish gjetur ende forcën e arsyes për t’u shkëputur nga idhujtaria primitive dhe adhurimi i forcës bruto.

Jo më autentike dhe e arsyeshme se në Oqeaninë e Orwell-it është ekzistenca njerëzore në Perandorinë totalitare të Kadaresë. Anekënd Perandorisë së pamasë, njerëzit, të manipuluar nga legjendat që rrethojnë kultin e ëndrrave, kanë humbur kontaktin me realitetin konkret, aq sa vetë jeta e tyre është kthyer në një lloj ëndrre pa kuptim. Në krejt perandorinë, që nga kryeqyteti me institucionet qendrore, deri tek provincat më të humbura me zyrat-barakë, mbretëron mendimi bestyt që i zë frymën arsyes dhe paralizon vullnetet e njerëzve. Në formën e vet më të përqendruar, atmosfera e përgjithshme, klima shpirtërore e universit perandorak totalitar, ndihet pikërisht në epiqendrën e tij absolute, në zyrat dhe korridoret e “Pallatit të ëndrrave”, prej nga përhapen valët e frikës, terrorit dhe bestytnisë që kanë pllakosur mbi jetën shoqërore në Perandori. Brenda Pallatit, nëpunësit jetojnë në një realitet të ri në të cilin asgjë nuk është e njëjtë me botën e zakonshme që njohin njerëzit jashtë; aq e ndryshme është mënyra e re e ekzistencës në “Pallatin e ëndrrave”, sa që edhe kategoritë e saj më themelore – vetë rrjedhja përpara e kohës – duket sikur nuk janë më të njëjtat. Nëpunësit në këtë mjedis të ri politik-shoqëror jetojnë si të magjepsur. Në ndikimin hipnotizues të dosjeve, simbol i infektimit nga opiumi i ideologjisë totalitare, ata tjetërsohen nga natyra dhe jeta e gjallë – Mark Alemit, pas një periudhe jo shumë të gjatë pune në pallat, i zviridhet plotësisht jeta jashtë institucionit.

Duket qartë, pra, se shoqëritë totalitare të përshkruara te “1984” dhe “Pallati i ëndrrave” udhëhiqen prej një botëkuptimi thellësisht irracional, ndonëse format konkrete të shfaqjes së tij në to nuk janë identike. Gjithashtu, në të dyja këto botë duket se degradimi i arsyes njerëzore dhe kultivimi i irracionalitetit në të kuptuarit teorik të

gjërave dhe qasjen praktike ndaj realitetit fizik e sundimin mbi masën e shtypur të njerëzve. shoqëror i shërben kastës në fuqi për të përjetësuar

BIBLIOGRAFI

- Bassnett, S. (1993). *Comparative Literature – A Critical Introduction*. Oxford: Blackwell.
- Bloom, H. (Ed.). (2006). *1984, Modern Critical Interpretations*. London: Chelsea House Publications.
- Crick, B. (1980). *George Orwell: a Life*. Boston: Little Brown.
- Davison, P. (Ed.). (2001). *Orwell and Politics*. London: Penguin Classics.
- Fowler, R. (1995). *The language of George Orwell*. London: Macmillan.
- Jung, C. G. (1970). *The Structure and Dynamics of the Psyche*. (R. F. C. Hull, Trans.). Princeton, N. J: Princeton University Press.
- Kadare, I. (1996). *Dialog me Alain Bosquet*. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (1999). *Pallati i Ëndrrave*. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2000). *Kohë barbare*. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2004). *Ftesë në studio*. Tiranë: Onufri.
- Kuçuku, B. (2005). *Kadare në gjuhët e botës*. Tiranë: Onufri.
- Morgan, P. (2011). *Kadare: shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990*. (Iilir Shameti, Trans.). Tiranë: Shtëpia Botuese 55.
- Norris, C. (Ed.). (1987). *Inside the Myth - Orwell - Views from the Left*. London: Lawrence and Wishart Ltd.
- Orwell, G. (2000). *Essays*. London: Penguin Classics.
- Orwell, G. (2003). *Animal Farm and 1984*. Orlando: Harcourt Inc.
- Rodden, J. (Ed.). (2007). *The Cambridge Companion to George Orwell*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Sinani, S. (2005). *Një dosje për Kadarenë*. Tiranë: OMSCA-1.
- Sinani, S. (2011). *Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K"*. Tiranë: Naimi.

PËRKTHIMI I VEPRAVE DRAMATURGJIKE DHE VEÇORITË E TIJ

IRIS KLOSI*

NEJLA QAFMOLLA

DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Punimi trajton disa teori dhe praktika mbi përkthimin e veprave dramaturgjike. Pavarësisht se përkthimi i veprave dramaturgjike gjithmonë është konsideruar si pjesë e përkthimit letrar, praktika tregon se rregullat kanë ndryshuar dhe teoricienët dhe prakticienët sjellin shembuj të shumtë mbi kapërcimin e problemeve të përkthimit të veprave dramaturgjike. Meqenëse veprat dramaturgjike në vetvete janë të ndryshme, përkthyesit duhet të kenë parasysh elementë të ndryshëm përpara se të ulen dhe të nisin punën e përkthimit. Mund të mendohet se përkthyesit duhet të jenë gjithmonë besnikë ndaj tekstit origjinal, megjithatë shihet domosdoshmëri të përdoren shpesh edhe strategji të ndryshme për të kompensuar ndonjë humbje të mundshme. Përkthimi i veprave dramaturgjike duhet të bëhet gjithmonë duke pasur parasysh shfaqjen teatrale apo performancën. Veprat dramaturgjike shkruhen për t'u ndarë me spektatorin dhe në mënyrë që publiku ta pëlqejë performancën, përkthyesit punojnë fort dhe përfytyrojnë çdo skenë, imazh dhe bëhen pjesë e dramës. Sfidat janë të llojeve të ndryshme: përkthimi i zhargonit, i gjuhës së rrugës, dialektit, idiomave, titujve të veprave dramaturgjike, formave të adresimit, batutave, etj. Megjithatë, ka edhe zgjidhje ndaj këtyre problemeve. Studiues të ndryshëm sugjerojnë teknika të shumta dhe më i rëndësishëm është fakti që në ditët e sotme përkthyesit e veprave dramaturgjike kanë mundësinë të përfshihen në prova dhe të arrijnë të bëjnë ndryshimet e duhura përpara se vepra të vihet në skenë.

Fjalët çelës: përkthimi i veprave dramaturgjike, strategjitë e përkthimit, përkthimi i titullit/zhargonit/gjuhës së rrugës/idiomave, performanca skenike, spektatori, teoricienët, prakticienët, etj.

Abstract

The paper focuses on theories and practices of drama translation. Even though drama translation has always been considered as part of literary translation, practice shows that the rules have changed and theorists and practitioners provide different examples of overcoming translation difficulties posed by plays. Plays themselves vary in form and content and translators should consider various elements before sitting down and starting with the process of translation. One must infer that the translator should always be faithful to the source text but at times different strategies are used to compensate for any possible loss. Drama translation should always be considered as closely related with performance. Plays are written to be shared with the audience and in order that the public likes the performance translators work hard and visualise every scene, image and become part of the play. Challenges are of different types: translating the jargon, slang, dialect, idioms, play titles, forms of address, jokes, etc. There are still solutions to the problems. Different scholars suggest various procedures and the most important thing is that drama translators nowadays have the possibility to be involved in the rehearsals and make the necessary changes before the play is put on stage.

Key words: drama translation, translation strategies, translation of the title/jargon/slang/idioms, performance, audience, theorists, practitioners, etc.

Hyrje

Në fushën e gjuhës së dramës vazhdimisht ka pasur dhe do të ketë mendime të kundërta në lidhje me raportin ndërmjet domethënies së veprës dramaturgjike dhe interpretimit skenik, për vetë faktin se bota e teatrit po i zgjeron më tej kufijtë dhe potencialet e interpretimit skenik. Bota teatrale po e rivlerëson pozicionin e saj në lidhje me hierarkinë e produksionit. Në përgjithësi dihet se çfarë përfaqësojnë dramaturgët dhe çfarë krijojnë ata, por sfera e njohjes sonë në lidhje me regjisorët dhe veprën e tyre është më e kufizuar. Në aspektin historik marrëdhënia dramaturg - regjisor futej në kornizën klasike dhe ishte tepër e qartë, si rrjedhim autorë që nga Sofokliu deri tek Shekspiri kishin në kontroll të plotë tërë procesin e vënies në skenë të veprës dramatike. Por, në Evropë gjatë periudhës së

Neoklasicizmit, nuk ishte e detyrueshme që veprat e vëna në skenë t'i përmbaheshin tekstit origjinal të autorit. "Për spektatorët e shekullit XVIII në Angli, shumë prej dramave të Shekspirit ishin të papranueshme, prandaj edhe preferonin versione të përshtatura të tyre" (Brockett, 1982). Madje regjisorët arrinin deri aty sa të shndërronin subjektin dhe përgjithësonin skenografinë.

Në mesin e shekullit XIX, në Londër Çarls Kin kishte mundur të krijonte figurën e mirënjohur dhe kyçe të regjisorit në teatër (Brockett, 1982) duke ndërthurur veprën dramaturgjike me talentin e regjisorit. Figura të shquara të teatrit evropian si Sakse-Mainingen, Maks Rainhardt dhe Vsevelod Mejerhold i konsideronin regjisorët si krijues, të cilët mund dhe duhej ta përshtasin dhe ribënin përmbajtjen e veprës dramaturgjike në përputhje me kërkesat dhe shijet e tyre. Sidoqoftë, në fillim të

shekullit XX, ekzistonin edhe koncepte të kundërta në lidhje me rolet përkatëse të dramaturgut dhe regjisorit, duke argumentuar se autori duhet të kontrollojë plotësisht tekstin dhe nëntekstin e origjinalit. Në Francë, për shembull, regjisorët duhej të luanin të njëjtin rol si edhe përkthyesit duke e përcjellë mesazhin e veprës me besnikëri dhe përpikëri. Në sistemin ligjor amerikan është mbizotëruese mbështetja ligjore për të drejtën e autorit nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të ndryshme. Mbrojtja ligjore ekziston 50 vjet pas vdekjes së autorit.

Rreth vitit 1984, teoria e superioritetit të regjisorëve ndaj veprës dramaturgjike në kulturën amerikane kishte arritur në atë pikë sa që Robert Brustain, kryeregjisor i një kompanie teatrale deklaronte me bujë se "të drejtat normale të regjisorit në lidhje me interpretimin e veprës janë thelbësore në mënyrë që të çlirohen dhe shpalosen plotësisht energjia dhe nënteksti i veprës dramaturgjike" (Freedman, 1984). Ndërsa, në vitin 1988, në një tekst universitar, regjisor i përkufizohej si personi, i cili "shpaloste në skenë forcën jetësore të një historie frymëplotë dhe pulsuese" dhe ndihmon që spektatorët të mund të kapin "shpendin e egër tropikal të veprës dramaturgjike" (Hodge, 1988)

Materiali dhe metodat

Punimi përqëndrohet në materiale të ndryshme ku trajtohen teoritë dhe praktikët më të fundit mbi përkthimin e veprave dramaturgjike. Artikuj dhe libra të ndryshëm mbi teorinë dhe praktikën e përkthimit sjellin argumente të mjaftueshme për të qartësuar idetë mbi procesin e përkthimit të veprave dramaturgjike. Mbi bazën e këtyre qasjeve përkthyesit e ardhshëm të këtij lëmi, do të kenë mundësinë të drejtohen nga disa rregulla bazë mbi produktin e synuar.

Ka shumë të fshehta të cilat përkthyesit e teatrit i mësojnë përgjatë punës së tyre. Përkthyesit e teatrit punojnë ngushtë me profesionistët e teatrit. Ata duhet të njihen me terminologjinë dhe stilin mbi udhëzimet regjisoriale në gjuhën e përkthimit. Ata duhet të dallojnë 'termat mbi skenën dhe prapaskenën' (Zatlin, 2005). Kjo shërben shumë për qëllime aktrimi sepse regjisorët dhe aktorët duhet të dinë si të veprojnë në situata të caktuara. Më e lehtë për ta është bashkëpunimi, i cili përbën një rëndësi të madhe, sepse u vjen në ndihmë edhe skenografëve dhe mjeshtrave të skenës për të përgatitur dekorin.

Praktika dhe vështirësitë, paralajmërimet dhe marrja e masave të duhura, bëjnë që bota e teatrit të duket gjigande. Asgjë nuk duhet të dështojë. Gjithçka duhet të jetë e lidhur mirë. Bashkëpunimi

brenda grupit realizues është mjaft i domosdoshëm. Përkthyesve u jepet zemër që të mund të sugjerojnë ndryshime në rastin kur vihen në skenë tekste klasike. Shumë tekste klasike janë shkruar në vargje, por a mund të imagjinohet që përkthyesi skenik t'i përkthejë ato në vargje në gjuhën përkatëse dhe në periudhën përkatëse? Po kur bëhet fjalë për aktorët të cilët duhet të përsërisin çdo varg në një gjuhë të largët nga kohët moderne? Louis Nowra është kundër përkthimit në vargje të dramave në vargje: 'Nëse dikush nuk ka gjenialitet të lindur poetik të ngjashëm me Kleist, atëherë ajo me të cilën ai do të përfundojë do të jetë një poezi e dobët' (Nowra, 1984). Të përditësosh një tekst apo ta modernizosh atë nuk është gjithmonë zgjidhje ideale. Sipas Edney 'kënaqësia e transportimit në një kohë dhe vend tjetër në fakt përbën një nga tërheqjet më të mëdha të teatrit' (Edney, 1998).

Përkthimi i lojës së fjalëve është detyrë shumë e vështirë në teatër. 'Spektatori duhet të kapë kuptimin e dyfishtë në ajër' (Zatlin, 2005). Eaton nga ana e saj si përkthyes ka qenë 'udhëtare' në dramën e teatrit absurd të Pineras *Siempre se Olvida Algo*, dhe ka siguruar një përkthim teatror të saj të titulluar *You Always Forget Something*. Ajo shprehet se 'rikrijimi i saj anglez i 'gjuhës havaneze' plot me lojë fjalësh të Pinerës është kthyer në "gjuhën e djallosur britanike"... 'Si përkthyes dhe dramaturge unë ndërmjetësoj ndërmjet dy gjuhëve dhe dy kulturave; teksti im i përkthimit bëhet teksti i burimit për aktorët, ai tekst i burimit për mua bëhet teksti tjetër i përkthimit, e kështu *ad infinitum*. Aktorët dhe regjisorit më japin mua zërat e tyre, më japin mua idetë e tyre dhe më japin mua mishërimin fizik të tekstit.' (Eaton, 2008).

Sipas Chiaros, është mjaft e rëndësishme që përkthyesit e humorit, si edhe barasvlerësit e tyre teatrorë, të jenë të përditësuar në njohuritë e tyre mbi 'çështjet e përditshme' (Chiaro, 1992) të të dyja kulturave: asaj të burimit dhe asaj të përkthimit. Një element tjetër po aq i rëndësishëm për suksesin e një shakaje është stili. Ndërkohë që shpjegonte rëndësinë e zgjedhjes leksikore në përkthimin e një shakaje, Chiaro nënvizon lidhjen e pandashme ndërmjet tregimit në mënyrë të suksesshme të saj dhe përdorimit të stilit të duhur. Cristina Marinetti në esenë e saj mbi përkthimin e komedisë, na sjell tre versione përkthimi në anglisht të dramës italiane të Carlo Goldonit *Il Servitore di due padroni (Shërbëtori i dy Padronëve)*. Ajo ka bërë gjithashtu komentet e nevojshme mbi të tre përkthimet e bëra nga përkthyes të ndryshëm, por versioni i saj i parapëlqyer që i solli sukses skenës britanike, ishte versioni i tretë i përkthimit nga Hall dhe Pandolfi: 'Në procesin e tyre të regjistrimit përkthyesit nuk

morën parasysh vetëm elementët tekstorë, por edhe ata kontekstualë dhe teatralë.’ (Marinetti, 2005).

Përkthimi i titujve të dramave nuk është gjithmonë i lehtë. Sigurisht ka tituj të cilët nuk përbëjnë ndonjë problem për t’u përkthyer. Por ka raste kur titulli duhet të ndryshohet në gjuhën e përkthimit. Peter Newmark identifikon titujt deskriptivë, ata që ‘përshkruajnë tematikën e tekstit’, dhe tituj aludues, ata që ‘kanë një farë lidhje adresimi apo figurshmërie me tematikën’ (Newmark, 1988). Ndaj sugjerohet se përkthyesit duhet t’i kushtojnë vëmendje të madhe të gjithë elementëve kontekstualë dhe jashtë-kontekstualë të dramës, si edhe të njohin sfondin historiko-letrar, stilin e të shkruarit dhe jetën e autorit, përpara se të ndër marrin përkthimin e një kryevepre.

Zgjedhja e përdorimit të titullit aludues, nuk ndodh shumë shpesh, por gjithsesi, përdoret në ato raste kur përkthimi i titullit në origjinal është i vështirë të përkthehet me barasvlerës në gjuhën e kulturës së gjuhës së përkthimit. Arsytet e përdorimit të titullit aludues bëhen për shkaqe komerciale. Në këtë rast zgjidhet një titull që përshkruan kontekstin. Përkthyesi E. Fico nuk përdori asnjërën nga dy kuptimet e dhëna nga fjalori, duke mos i qëndruar besnik titullit origjinal të përdorur nga autori, sepse ndoshta këto dy kuptime në shqip nuk përbënin një titull tërheqës për lexuesin apo spektatorin. Fjala ‘shtrigat’ ishte më intriguese dhe nuk e shtrembëronte kontekstin e tërësisë së dramës, e cila trajton kryekëput një histori të tërë mbi gjuetinë e shtrigave dhe ekzekutimin e tyre, edhe pse brendia e nëntekstit është përvoja personale e vetë Milerit me sprovën e fortë që po kalonte gjatë periudhës së Makartit, në lidhje me kallëzimin e shokëve të tij si bashkëpunëtorë në komplete kundër shtetit amerikan.

Në fakt titulli ‘Shtrigat e Salemit’ është përdorur për herë të parë nga Sartri, i cili e përshtati skenarin e dramës për film më 1957 në një produksion të përbashkët Franko-Gjerman me titullin ‘*Les Sorcières de Salem*’ apo ‘*The Witches of Salem*’, i cili në shqip përkthehet ‘Shtrigat e Salemit’, nën regjinë e Raymond Rouleau. Kjo dramë është prodhuar më pas nga Hollivudi më 1992, ku protagonistë janë aktorët Daniel-Day Lewis dhe Winona Ryder, dhe përkthimi i filmit në spanjisht është nën titullin ‘*Las Brujas de Salem*’ apo ‘*El Crisol*’. Me interes është fakti se në italisht kjo dramë është përkthyer mjaft bukur si në origjinal nën titullin ‘*Il Cruogiolò*’, nga Luchino Visconti dhe Gino Bardi më 1959, por nëntitulli i saj në italisht është ‘*Preti Feroci e Caccia alle Streghe*’ (Priftërinj të Hekurt dhe Gjuetia e Shtrigave) Në fakt përkthimi i

titullit është temë mjaft e diskutueshme, por ‘Shtrigat e Salemit’ në shqip ka bërë mjaft bujë nën këtë titull dhe do të ishte tejet e pamundur që titulli të ndryshohej në rivënien e fundit skenike. Sipas teorisë së përkthimit, titulli aludues i mundëson publikut të gjerë shqiptar të perceptojë ngjarjen dramatike dhe histerizmin e komunitetit të Salemit.

Dramat përmbajnë dialekt rajonal, zhargon të gjuhës së folur dhe proverba. Linku këshillon se ‘drama duhet të përkthehet gjithmonë në dialektin që njihet nga publiku teksa përdoret nga grupi shoqëror përkatës në pjesën e tyre të vendit’ (Link, 1980). Patrice Pavis është kundër përkthimit në dialekt sepse ‘përshtatja e plotë në kulturën e synuar mund të tradhtojë një qëndrim superior në tekstin dhe kulturën e origjinalit’ (Pavis, 1989). Aaltonen bashkohet me idenë e përgjithësismit sa më të mundshëm të procesit të përkthimit se ‘përkthimi i plotë do të jetë gjithmonë pasqyrim i kulturës marrëse më tepër se sa teksti i saj i burimit’ (Aaltonen, 2000).

Përkthimi i zhargonit të përditshëm mund të përbëjë edhe më shumë vështirësi. Zatlën shpjegon se një nga dramat e saj të para të përkthyer ishte drama më e suksesshme e ekranizuar e Alonso de Santos ‘*Bajarse al moro*’ (*Going Down to Marrakesh*), një skenar në të cilin paraqiten personazhe të rinj që përdorin gjuhën e përditshme, duke filluar nga titulli kemi zhargonin e drogës. Në kohën kur ajo përktheu dramën ajo përdori zhargonin e gjuhës së zonës metropolitane të Nju Jorkut. Teksti origjinal në spanjisht përmban përdorimin e shpeshtë të zhargonit të Madridit në vitet ’80. Përkthimi i saj nuk u pranua në atë kohë, sepse ishte parakusht mospërdorimi i gjuhës banale. Kur drama synohej të vihej në skenë ishte mjaft e vështirë në atë kohë, për shkak se censura nuk mund të lejonte të tilla adresime mbi përdorimin e shpimeve të trupit për komunitete të cilët ishin besimtarë të kishës.

Në rastin e përkthimit të zhargonit ka vend për shumë ilustrime, por një shembull i jashtëzakonshëm silltet nga Zatlën mbi debutimin e dramës ‘*Auto*’ të Ernesto Caballeros në shtator të 2003 në një teatër të Bashkisë në Giessen for Aufgefahren në Gjermani. Gjëja më e keqe nga të gjitha ishte se autori ishte vetë i pranishëm në skenë. Zatlën komenton mbi përkthimin e fjalëpërfjalshëm të idiomës ‘*ha pasado un ángel*’. ‘Në kuptimin e parë fjalët do të thonë se kaloi një engjëll, por çdo folës i rrjedhshëm vendas i spanjishtes apo një fjalor i mirë dygjuhësh do ta përcaktonte shprehjen në kuptimin e një ndërprerjeje të komunikimit. Fatkeqësisht përkthyesi nuk arriti ta dallojë sfidën. Përkthimi i

fjalëpërfjalshëm në gjermanisht, si në anglisht, e humbet kuptimin bazë dhe duket se i referohet pranisë së vërtetë të një engjëlli.’ (Zatlin, 2005).

Përkthimi i idiomave është mjaft i vështirë. Përkthyesit duhet të tregohen mjaft të kujdesshëm. Zatlin vazhdon me sugjerimet e saj mbi përkthimin e idiomave me kuptimin e duhur të tyre duke u përpjekur të shmangët përkthimi fjalë për fjalë i tyre: ‘Sa herë që një shprehje e përkthyer në kuptimin literal është e pakuptimtë në kontekst, ndoshta ajo nuk do të thotë atë që përmban në sipërfaqe. Njësia leksikore do ta përfshijë idiomën në tërësinë e saj; fjalët nuk mund të përkthehen një nga një. Përkthyesit këshillohen që të blejnë fjalorin e zhargonit dhe idiomave dhe të konsultohen me folësit vendas të gjuhës së tyre të origjinalit të cilët e njohin më së miri gjuhën e përditshme. Mundësia e keqinterpretimit të shprehjeve të përditshme të izoluar është e vërtetë në të gjithë përkthimin dhe është një nga arsyet pse është gjithmonë e këshillueshme të bashkëpunosh me dikë, që zotëron ekspertizën e duhur, i cili mund të lexojë punën e tjetrit. Akoma më mirë do të ishte që atë lexim ta bënte në praninë e autorit, për të qartësuar çdo dyshim.’ (Zatlin, 2005). Le të vërejmë një rast të përkthimit të idiomave në dramën ‘Death of a Salesman’ (Vdekja e një Komisioneri):

BIFF: George and Sam and Frank, come out back! We’re hangin’ up the wash! Come on, Hap, on the double! ... (pg 34)	BIFI: Xhorxh, Sem e ti Frenk dilni, hajdeni këtu! Do të nderim menjëherë rrobat! Eja, Hep, e kapim të dy bashkë. ... (fq286)
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Përshtatja e fjalisë së fundit është e gabuar. Bëhet fjalë se veprimi duhet të kryhet shpejtë ‘on the double’ është idiomë e cila do të thotë ‘quickly, without delay’ (shpejt e pa vonesë) dhe jo që vëllezërit ta kryejnë së bashku. ‘Hë de Hep, luaj duart!’ mund të ishte më e përshtatshme.

Ka kaq shumë gjëra që duhet të merren parasysh. Dramat ndryshojnë shumë nga njëra tjetra. Dramaturgët i përkasin periudhave të ndryshme. Ata ndryshojnë shumë për nga stili. Kemi dramaturgë tradicionalë, realistë, ekzistencialistë, socialë, modernë, post-modernë, etj. Producentët e teatrit kërkojnë drama të suksesshme. Regjisorët e teatrit ndonjëherë detyrohen të eksperimentojnë dhe të kthejnë një dramë në komedi muzikore. Çfarë duhet të bëjë përkthyesi në këtë rast? Sigurisht, duhet të kihen parasysh elementët paragjuhësorë. ‘Këngët në përgjithësi duhet të ruhen dhe fjalët e këngës t’i përshtaten, si kuptimit ashtu edhe muzikës’ (Zatlin, 2005).

Format e adresimit për kortezi, si edhe emrat e përveçëm, mund të shkaktojnë probleme. Susan Bassnett citon një kritikë qesharake të Robert

Adamsit sesi Parisi duhet të jetë Paris dhe ‘heroi ynë duhet të jetë Pierre, jo Peter’, por do të ishte budallëllëk nëse ai do të thoshte, ‘Jam i magjepsur, Madame’ (Bassnett-McGuire, 1980). Edney sugjeron shmangien e “madame” dhe “monsieur”, sepse ato janë të vështira për t’u shqiptuar. Nëse e kërkon dialogu, ai rekomandon përdorimin e ‘zonjë’ dhe ‘zotëri’. Për dialogun ndërmjet shokëve të ngushtë, ai rekomandon heqjen e titujve dhe kalimin tek emrat e përveçëm (Edney, 1998).

Një nga praktikat interesante të përkthyesve të teatrit është ‘shkurtimi’. Kjo dukuri shfaqet kur tekstet e dramës së përkthyer janë më të gjatë se ata të gjuhës së origjinalit ‘...stilet e aktrimit në vendet mesdhetare (Spanjë, Itali, Greqi), ashtu si edhe gjuhët përkatëse, janë më pasionante se ato të Evropës Veriore apo të Shteteve të Bashkuara.’(Zatlin, 2005). Zuber në analizimet e saj të dramës “A Streetcar Named Desire” (Tramvaji me Emrin Dëshirë) në gjermanisht argumenton se: ‘Nëse ligjërimi në gjuhën e perkthimit është më i gjatë se drama e origjinalit, personat që merren me vënien e saj në skenë do të duhet të vendosin nëse duhet të ngadalësojnë veprimin përkatës, të ndërpusin gjeste apo lëvizje shtesë, apo të shkurtrojnë tekstin (Zuber, 1980).

Ka shumë debate për ndryshimin ndërmjet përkthimit të mirëfilltë apo një përshtatjeje. Ne të gjithë kemi parë versione të ndryshme të së njëjtës dramë të vënë në skenë apo të ekranizuar. Nevoja për përshtatje nuk i referohet vetëm dramave shekspiriane. Përshtatja është shqetësim i shumë përkthyesve të teatrit. Ndonjëherë ajo është domosdoshmëri edhe pse në përgjithësi ajo nuk dëshirohet. J. C. Santoyo ka përpunuar një gamë të gjerë të përkufizimeve të ‘përkthimit’ si kalimi besnik, letrar në një gjuhë tjetër, (Zatlin, 2005) ‘versioni’ si përkthim që merr parasysh kërkesat e debutimit skenik, (Zatlin, 2005) dhe ‘përshtatja’ si term i përdorur ‘për të mbuluar të gjitha llojet e manipulimeve të papranueshme tekstore dhe skenike’ (Zatlin, 2005). Përshtatjet, madje edhe ato që përfshijnë vetëm pak ndryshime tekstore, mund të ndryshojnë rrënjësisht kuptimin e nënkuptuar të dramës.

Praktika më interesante në përkthimin e teatrit është ajo e titujve komikë dhe që mund të kërkojnë përshtatje të mëdha. Norman R. Shapiro shquhet për përkthimet e tij në anglisht të farsave të Eugene Labiche (Landers, 2001). Titujt e sjellë në anglisht nga Shapiro janë përshtatur sipas kontekstit të farsave duke luajtur me fjalët dhe sipas Landersit titujt komikë të këtij përkthyesi shkaktojnë më shumë të qeshura se në origjinal pasi titulli ‘La Main leste’ bëhet ‘A Slap in the Farce’ dhe ‘La lettre

chargée' përkthehet 'A Matter of Wife and Death'. Në anglisht nëse do të analizojmë të dy titujt, vërejmë se luhet me shprehjet idiomatike të gjuhës angleze, të cilat janë 'a slap in the face' që në shqip do të përkthehej 'shuplakë fytyrës' dhe elementi komik i përkthyesit është se fjala 'face' zëvendësohet nga 'farce' që do të thotë farsë. Në shqip përkthimi i titullit nga frëngjishtja ndoshta do të kërkonte përshtatje tjetër duke njohur më gjerë përmbajtjen e komedisë. E njëjta situatë paraqitet edhe me titullin tjetër të sajuar nga shprehja idiomatike 'a matter of life and death', e cila në shqip do të përkthehej me përputhjen e plotë kuptimore 'çështje jete apo vdekjeje', ku në anglisht përkthyesi fjalën 'life' për nga rima e zëvendëson me 'wife' - 'grua'.

Rezultatet:

Në lidhje me përkthimin e veprave dramaturgjike, duke pasur parasysh se qëllimi kryesor i përkthimit të dramës është vënia e saj në skenë me sukses, rekomandohet që përkthimi i veprës dramaturgjike të jetë konciz dhe të mos ngarkohet me mbipërkthime (Meyer). Në krahasim me përkthyesin e romanit, përkthyesi i veprave dramaturgjike është i detyruar të kufizohet në mundësitë që i ofron natyra dramatike e tekstit, përdorimi në një masë të konsiderueshme i foljeve, se sa elementëve përshkrues dhe shpjegues, i nënshtrohet "detyrimit" për të punuar në kushtet e papërkthyeshmërisë së lojës së fjalëve, referencave kulturore specifike, si dhe pamundësisë për të shfrytëzuar shënimet në fund të faqes, etj. Për më tepër theksohet se "fjala e shkruar është pesë herë më e fuqishme se fjalia e shkruar, sepse mesazhin të cilin mund ta përcjellë romancieri me 30 rreshta, dramaturgu duhet ta përcjellë me vetëm 5 rreshta." (Newmark, 1988). Në këtë kontekst, sugjerimi ynë do të ishte që, në rastin më të mirë, të kishte një bashkëpunim ndërmjet autorit (në rast se është gjallë), përkthyesit dhe regjisorit. Në rast të kundërt, përkthyesi duhet të bëjë kujdes që të përcjellë në gjuhën e përkthimit versionin sa më pranë kërkesave dhe reagimit të spektatorëve të mundshëm në gjuhën dhe kulturën e përkthimit, nëntekstin e veprës dramaturgjike, jo thjesht atë që thuhet, por atë që nënkuptohet. Ajsbergu, ashtu si edhe në gjuhën e origjinalit, duhet të zbulohet nga spektatorët dhe jo nga vetë përkthyesi, sepse edhe vetë përcjellja e një drame nga kultura e gjuhës së origjinalit në kulturën e gjuhës së përkthimit përbën një shembull të përkryer të përshtatjeve, transpozimeve, modulimeve, etj., dhe jo thjesht një përkthim. Sidoqoftë, edhe në këtë drejtim nuk mund të jepen receta të gatshme për vetë faktin se, siç është vënë në dukje në shumë raste, "vepra

dramaturgjike duhet të përbëjë një tërësi koherente dhe të integruar në tërë aspektet e saj, duke filluar nga manipulimi i aktorëve deri tek manipulimi i hapësirës së skenës dhe tërë materialit të përdorur në të" (Hodge, 1988).

Megjithatë, pranohet se edhe koncepti regjisorial në këtë drejtim, krahas luhatjeve dhe qëndrimeve kontradiktore, ka evoluar me kalimin e kohës.

Ortrun Zuber sugjeron se 'shfaqja teatrorë varet nga shpejtësia e ndikimit mbi spektatorin' (Zuber, 1980). Përkthyesi e teatrit duhet të trajtohen njëllor me autorët e dramave. Ata nuk duhet të jenë të padukshëm. Patrice Pavis argumenton se 'përkthyesi është një dramaturg i cili pikësisht duhet të ndikojë tek një përkthim makro-tekstor, domethënë, një analizë dramaturgjike të pjesës letrare që përçohet nëpërmjet tekstit' (Pavis, 1989). Teoria e përkthimit shpesh mund të neglizhohet. Praktika e këtyre përkthyesve shpesh drejtohet nga instinkti i tyre profesionist.

Diskutime

Problemet e përkthimit janë të pranishme në çdo përpjekje për të përçarur mesazhin nga gjuha e burimit tek gjuha e synuar. Sfidat janë nga më të ndryshmet, por gjëja më e rëndësishme është se ato vijnë nga praktika dhe përvoja. Gjithsesi, sfidat dhe problemet me të cilat përballen përkthyesit gjejnë zgjidhjet e tyre të mundshme, sidomos kur prakticienët e përkthimit duhet të 'zbatojnë' rregullat e teorisë së përkthimit në punën e tyre. Veprat e shquara mbi përkthimin për skenën e teatrit, të shkruara nga teoricienët e përkthimit si p.sh. Bassnett, Venutti, Aaltonen, Edney, Zuber, etj., kanë frymëzuar punën e përditshme të shumë prej përkthyesve të teatrit. Këta studiues jo vetëm që 'predikojnë' se si duhet të bëhen më së miri gjërat, por edhe sjellin disa argumente mjaft të vlefshme mbi nevojën e herëpashershme të ndryshimit të kornizave të ngurta të teorisë së përkthimit, duke dhënë këshilla të vlefshme e praktike mbi rastet e thyerjes së rregullave të lojës, duke lënë të lirë pasionin dhe talentin, atë lloj 'shpendi shtegtar' brenda nesh që të ndjekë shtegtimin e vet në botën e teatrit, duke lejuar që përkthyesi ndonjëherë të bëhet tradhtar.

Sfidat dhe praktika bashkekzistojnë në përkthim. Në rastin e përkthimit për teatrin çështja është më e ndërlikuar sesa thjesht përkthimi. Përkthyesi i teatrit duhet të imaginojë dramën si të vënë në skenë dhe duhet të mendojë për çdo hollësi të mundshme. Përkthyesi i teatrit njihet me punën në prapaskenë dhe në njëfarë mënyre stërvitet se si të punojë me grupin realizues. Përvoja e përkthyesve të teatrit është e paçmuar. Një numër i

konsiderueshëm i ish-aktorëve të mëparshëm të skenës së teatrit apo dramaturgët, madje edhe regjisorët e skenës së teatrit mund të përkthejnë dramën shumë mirë. Ky nuk është pohim absolut, sepse gjithçka vjen me përvojën dhe në fakt studimet e ofruara nga këta studiues tregojnë se bota e teatrit përfundimisht ka nevojë për përkthyes të talentuar të cilët janë ekspertë të vërtetë në këtë disiplinë. Sidoqoftë, rekomandohet që ata të marrin këshilla të vlefshme nga profesionistët si edhe të ndjekin talentin e tyre të lindur.

Përkthimi për teatrin është një disiplinë e re, një përvojë e re për ata përkthyes që e provojnë. Përkthyesit duhet të dallojnë ndërmjet shenjave verbale dhe jo-verbale. Sipas qasjes së semiologut francez Patrice Pavis, teksti i teatrit përshkruhet si një tekst 'i cili shkrihet sipas një modeli të dendur të shenjave sinkronike' dhe 'vënia në skenë e një teksti të shkruar' barazonte 'mizanskenën me mizanshenjën' (Pavis, 1992). Teksti i shkruar dramatik i destinuar për t'u kumtuar nga aktorët në skenë, ai i cili përfaqëson 'tekstin verbal' (Bassnett-McGuire, 1980) nuk është i tërësishëm. Gjuha jo-verbale është më shumë e ndërlikuar dhe ajo nuk përfshin vetëm gjestet, mimikën apo shprehjen e fytyrës. Ajo përmban edhe elementë të tjerë si intonacioni, ritmi, tempo-ritmika, cilësia e zërit, si edhe largësia e aktorit në lidhje me aktorët e tjerë si edhe lëvizjet e tij në skenë. Regjisorët e skenës së teatrit mund të jenë striktë dhe energjikë dhe sigurisht ata dinë sesi të drejtojnë në mënyrë mjaft sportive. Ashtu siç e kujton edhe përkthyesja dhe ish-aktorja britanike e skenës së teatrit, Kate Eaton, një nga regjisorët e saj në teatër teksa thoshte 'Kjo është lojë, eja ta luajmë!' (Eaton, 2008), arrihet në rezultatin se praktika e vazhdueshme gjatë provave është pikërisht ajo që vendos rregullat për të gjithë ata që merren me performancën, apo shfaqjen teatrorë.

Përfundime

Puna e shumë përkthyesve të teatrit është më shumë se letrare. Praktika e tyre përmirësohet çdo ditë. 'Ndërmjet tekstit të përkthyer dhe vënies së tij në skenë, a ka hapësirë për të matur gjenialitetin e përkthyesit përmes zbatimit të teorisë, apo teoria është ajo çka duhet zbatuar më vonë, për të analizuar përkthimin sapo shenjat në tekst dhe shenjat në skenë kanë gjetur (apo humbur) qëllimin e tyre?' (Eaton, 2008). 'Shumë përkthyes të teatrit janë tërësisht të dhënë pas artit të tyre,' (Zatlin,

2005). Përkthimi i teatrit është padyshim art në formën e tij artistike ashtu siç është teatri institucion artistik në formën e tij artistike. Përkthyesit janë artistë të cilët bëjnë mrekullira me tekstet skenike. Ata duhet të përgëzohen për punën e tyre mjaft kërkuese. Ata janë kontakti i parë me tekstin e burimit dhe dekodojnë çdo temë apo ide të nënkuptuar. Ata gjithashtu dekodojnë çdo lojë fjalësh dhe çdo shenjë teatrorë. Ata përgatisin tekstin e përkthyer për aktorët të cilët ndihen të ndërvarur pikërisht për atë që i shërben qëllimit të tyre. Përkthyesit shqetësohen nëse vargu në dramë nuk rimon mirë në gjuhën e përkthimit. Ata bëjnë ndryshime të menjëhershme, si dhe presin apo shtojnë pjesë. Ata na bëjnë ne të udhëtojmë në një periudhë tjetër duke zgjedhur me kujdes ngjarjet, kostumet dhe dekorin. Ata na bëjnë të qajmë, ata na bëjnë të qeshim. Eaton përmbyll artikullin e saj mbi përkthimin e teatrit në këtë mënyrë: 'Mua më pëlqen t'i referohem këtyre përkthimeve si 'të gatshme për performancë', si pula të gatshme për në furrë, ato thjesht sa duhet të merren nga rafti apo të nxirren nga frigoriferi apo të gatohen apo të pihen në mikrovalë në nivelin e një shfaqjeje të përsosur' (Eaton, 2008). Pikërisht publiku gjykon shijen e këtij ushqimi të shijshëm.

Në botën e teatrit, regjisorët dhe përkthyesit priren të lënë pas dore kornizat e ngurta të teorisë dhe parapëlqejnë të ndjekin instinktin apo përvojën e tyre për të praktikuar aftësitë dhe për të treguar talentin dhe suksesin e tyre. Teoria është pjesa tjetër e punës, e cila shumë shpesh bie ndesh me mënyrën e tyre të produksionit apo praktikës. Ajo është gjysma tjetër e dualitetit të tyre nëse duhet t'i qëndrojnë besnik tekstit në origjinal apo ta tradhëtojnë atë disi. Teoria është diçka të cilën duan ta mbajnë larg, por në të njëjtën kohë duan edhe ta përqafojnë. Ajo është çështje dominimi, por aspak çështje shpërfilljeje. Praktika vjen me provat. Kërkesat e skenës vendosen nga regjisorët dhe aktorët. Duke pasur parasysh rëndësinë e shfaqjeve cilësore, të cilat përmbushin shijet dhe nevojat e publikut, profesionistët e teatrit, i pozicionojnë qëndrimet e tyre sipas mënyrës se si dramën duhet të përkthehen për skenën. Gjithsesi, ka padyshim, edhe pikëpamje dhe argumentime të tjera nga teoricienët e përkthimit, të cilët sugjerojnë se praktika varet shumë nga teoria.

BIBLIOGRAFI

- Bassnett-McGuire, S (1980). *Translation Studies*. London and New York: Methuen, p. 117.
Brockett Oscar G. "History of the Theatre". 4th ed. Boston: Allyn and Bacon, 1982, p.353.
Chiaro, Delia (1992). *The Language of Jokes: Analysing Verbal Play*. London and New York: Routledge, p. 83.

Eaton, Kate. "You Always Forget Something: Can Practice Make Theory?" *With/out Theory: the Role of Theory in Translation Studies Research*. UCL, UK, April 2008, p. 56.

Edney, D. "Moliere in North America: Problems of Translation and adaptation". *Modern Drama* 41.1. Spring 1998 p. 67.

Freedman Samuel J. "Who's to Say Whether a Playwright Is Wronged?" *New York Times*, December 23, 1984 E6.

Hodge Francis (1988). *Play Directing*. 3d ed. Englewood Cliffs, N.J.: Prentice-Hall, p.10.

Landers (2001), p. 105.

Link, F. H (1980). *Translation, Adaptation and Interpretation of Dramatic Texts*. Oxford and New York: Pergamon Press, p. 29.

Marinetti, Cristina. "The Limits of the Play Text: Translating Comedy". *New Voices in Translation Studies* 1. UCL, UK, 2005. p. 39.

Meyer. M, "Twentieth Century Studies".

Newmark. P (1988). *A Textbook of Translation*, Prentice Hall, London, p.172.

Nowra, L (1984). *Translating for the Australian Stage*. Oxford and New York: Pergamon Press, p.18.

O. Zuber, (1980). *The Languages of Theatre. Problems in the Translation and Transposition of Drama*. Oxford and New York: Pergamon Press, p. 92.

Pavis, P (1989). *Problems of Translation for the stage: Interculturalism and Post-modern Theatre*. Cambridge. Cambridge University Press, p. 27.

Pavis, Patrice (1992). *Theatre at the Crossroads of Culture*. Translated by Loren Kruger. London and NewYork: Routledge, p.138.

Zatlin, P. (2005). *Theatrical Translation and Film Adaptation*. Cromwell Press Ltd. UK p. 68.

TIPARE TË TEORISË SË DRAMËS DHE TEATRIT BREHTIAN

MARSELA LIKAJ

DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

TIRANË

Përmbledhje

Në këtë artikull paraqiten tiparet kryesore të dramës brehtiane ndërthurur këto me elementet e teatrit epik. Drama brehtiane analizohet në këtë shkrim në ballafaqimin e saj me dramën tradicionale, duke u evidentuar qartazi si një dramë antiaristoteliane. Elementet e distancimit dhe tjetërsimit, që përdoren në vënien në skenë të këtyre dramave shihen në këndvështrimin e efektit edukues që synon të arrijë ky lloj teatri te publiku. Nëpërmjet një analize të shkurtër të disa prej tyre synohet të theksohet produktiviteti i kësaj drame në fushën e letërsisë dhe të teatrit.

Fjalë çelës: drama joaristoteliane, drama epike, teatri epik, distancimi, efekti tjetërsues, aspekti edukues.

Abstract

In this article are presented the main features of epic drama combined these with elements of epic theatre. Epic drama is analyzed in its confrontation with traditional drama, being clearly identified as an anti-Aristotelian drama. The elements of distance and alienation used in stage of these plays are seen in the perspective of educational effect that aims to achieve this kind of theatre to the public. Through a brief analysis of some of them it is intended to emphasize the productivity of this drama in literature and theatre.

Keywords: non-Aristotelian drama, epic drama, epic theatre, distance, alienating effect, educational aspect.

1. Brehti si teoricien dhe dramaturg

Bertolt Breht është një prej dramaturgëve gjermanë më në zë të shekullit XX. Ajo që bie në sy në krijimtarinë e tij është lidhja e shkrimit të pjesëve me vënien e tyre në skenë. Në këtë pikëpamje ai mund të krahasohet me klasikët grekë, Shekspirin apo Molerin.

Brehti si teoricien ishte po aq i njohur dhe i rëndësishëm sa edhe si vënës në skenë i dramave, si njeri i teatrit. Grim e cilëson atë si të pakrahasueshëm në kombinimin e këtyre të dyjave, së paku ndër dramaturgët e shekullit XX: *“Wer (...) käme ihm darin gleich? Weder Antonin Artaud noch Erwin Piscator, weder Konstantin Stanislavskij noch George Bernard Shaw oder Samuel Beckett können sich im Sinne einer solchen doppelten Personalunion – Theoretiker und Praktiker des Dramas und Bühne – mit dem Augsburger messen. Allenfalls August Strindberg kommt ihm einigermaßen nahe./ Kush (...) do të krahasohej me të? As Antonin Arto e as Ervin Piskatori, as Konstantin Stanislavski e as Xhorxh Bernard Shou apo Samuel Beket mund të maten me shkrimtarin nga Augsburgu në kuptimin e një personaliteti të dyfishtë – teoricien dhe realizues i dramës në skenë.”* [Grimm, Reinhold: *„Der katholische Einstein: Grungzüge der Brechtschen Dramen- und Theatertheorie“*, Reclam, 1995, f. 11]

Ai ishte një krijues i suksesshëm në të gjitha format e shprehjes. Kujtojmë këtu bashkëpunimet në krijimin e pjesëve teatrale të shoqëruara me muzikë dhe këngë, në krijimin e operës apo baletit. Kështu, për shembull, mund të përmendim teatrin

muzikor *“Opera për tre grosh”*, operën *“Ngritja dhe rënia e qytetit Mahagoni”*, baletin satirik *“Shtatë mëkatet e pafalshme”* etj. Për këto pjesë ai pati bashkëpunime të suksesshme me kompozitorët: Kurt Vajl, Hans Ajsler dhe Paul Deso.

Brehti ishte i vetëdijshëm për mbështetjen në idetë e tij te pararendësit e teatrit. Ai e pranonte afërsinë me teatrin e lashtë aziatik, teatrin klasik spanjoll, indian dhe anglez si edhe me teatrin e jezuitëve. Të gjithë këta pararendës i dhanë Brehtit ngacmime, të cilat i përdori në teorinë dhe praktikën e tij teatrore. Edhe pse është mbështetur në krijimtarinë e përmendura më lart, duke rimarrë shpeshherë fabulat e tyre, nga mënyra se si i ka trajtuar ato Brehti mbetet unikal. Ai ka ditur t'i shkrijë ngacmimet e marra, në një rikrijim, i cili mbart një qëndrim kritik shoqëror. Gjithsesi, teoria e tij kishte risitë e saj. Ai hapi një shteg të ri në rrugën e teatrit. Po aq unikal është edhe kontributi i tij në fushën e teorisë së dramës dhe dramaturgjisë, duke e pasuruar teatrin “joaristotelian” me “teatrin epik”, “dialektik”, apo me “teatrin e tjetërsimit”. Të gjithë këta janë emra të përdorur prej tij për formën e re teatrore që propozonte në teorinë e tij mbi teatrin, të cilin ai e quante në mënyrë të përsëritur “teatër të epokës së shkencës”. Impulset që dha ky teatër në të gjithë teatrin botëror janë të dukshme.

2. Tipare të teorisë së dramës dhe teatrit brehtian

Dy veprat që shquhen për konceptimin e tyre teorik *“Organon i vogël për teatrin”* dhe *“Messingkauf”* janë shkrimet kryesore që japin

mundësinë për të kuptuar veprën e tij. Krahas tyre edhe një sërë artikujsh relativisht më të shkurtër si për shembull *“Shënime për operën: Ngritja dhe rënia e qytetit Mahagoni”*, shkrim i vitit 1930, shkrimet e periudhës së mërgimit në Skandinavi, si: *“Teatër argëtues apo edukativ?”*, *“Efektet tjetërsuese në artin teatror kinez”*, *“Skena e rrugës – Model bazë i një skene të teatrit epik”* dhe *“Mbi teatrin eksperimental”* [*“Vepra e përmbledhur në 20 vëllime”, botuar nga Suhrkamp Verlag & Elisabeth Hauptmann, Frankfurt a. M. 1967*].

Shënimet për Mahagonin janë formulime të hershme të tij për teatrin dhe cilësohen edhe si më radikale, ndërsa teksti *“Mbi teatrin eksperimental”* është një referat i mbajtur në vitin 1939/1940, një hyrje koncize në teorinë e tij. Paraqitja më e mirë dhe më e njohur e teorisë së tij teatrore është padyshim *“Organoni i vogël”* i vitit 1948. Lidhja që i bën Brehti teorisë me praktikën teatrore ka të bëjë me atë që ai e quan *“Praktizierbarkeit des Wissens”/“Praktikueshmëria e dijes”*, pra me faktin se sa e realizueshme në praktikën teatrore është teoria e tij.

Koncepti i Brehtit për *“dramën joaristoteliane”* përmban një kritikë të trefishtë ndaj *“poetikës së Aristotelit”*. Në radhë të parë refuzohet koncepti aristotelian i *“katharsis”-it*, të cilin autori e cilëson si një përvojë paralizuese të spektatorit, që nuk e lë apo nuk i jep mundësinë atij të bëhet aktiv. Për këtë arsye, ai thekson në teorinë e tij vendosjen e një distance kritike midis spektatorit dhe shfaqjes, në mënyrë që ai të mund të analizojë dhe të mbajë një qëndrim aktiv. Elementi i dytë që kritikon Brehti është konceptimi i një vepre arti si një *“tërësi organike”*, të cilës ai i kundërvë konceptimin si një vepër tekniko-konstruktive që të jetë artificiale dhe artistike njëkohësisht, ku bashkimi i elementeve heterogjene të zëvendësojë rritjen e një *“organizmi homogjen”*. Aspekti i tretë i kritikës së Brehtit ka të bëjë me strukturën e ngurtë dhe të mbyllur të dramës, ku pjesët të jenë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, siç paraqiten në skemën piramidale të Gustav Frajttagut të *“Teknika e Dramës”* (1863). Në vend të saj Brehti propozon një strukturë të lirshme, me një radhitje të pavarur të skenave, ku secila të qëndrojë si një pjesëz e së tërës dhe ku secila skenë të mund të ndryshojë vend, të zvogëlohet apo të zgjerohet sipas dëshirës apo rastit. Pra, e thënë në vija të përgjithshme, ngjarjet e paraqitura nga Brehti pasojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën, jo si një zhvillim logjik që i vendos në lidhjen e përcaktuar në poetikën aristoteliane ku njëra skenë i paraprin tjetrës dhe e dyta vjen si rrjedhë logjike e së parës, e kështu me radhë. Kjo skemë e propozuar nga Brehti i hap udhë paraqitjeve biografike dhe kronike, për shembull paraqitjen e gjithë jetës së një individi apo

një grupi të caktuar, që veprojnë si protagonistë apo si antagonistë. Roli i kundërshtarit i atribuohet më tepër një force shoqërore të caktuar, një institucioni apo dhe historisë, si për shembull kisha si institucion në veprën *“Jeta e Galileit”*, ose *“Lufta 30-vjeçare”* (1618-1648, konflikt për hegjemoni në trojet gjermane nën Perandorinë Romake dhe në Evropë, si edhe luftë fetare midis Ligës Katolike dhe Unionit Protestant) në veprën *“Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj”*.

Vetëm një tezë të poetikës aristoteliane Brehti e mbështet tërësisht dhe e cilëson si të përbashkët, atë që thotë se thelbi i punës për shkrimin apo inskenimin e një pjese është *“fabula”*. Ajo është *“shpirti i dramës”* dhe *“zemra e një shfaqje teatrale”*.

Ndryshe nga pasuesit e Shekspirit, përfaqësuesit e lëvizjes *“Stuhi dhe vrull”*, dhe të *“Natyralizmit”*, siç është Gerhart Hauptman, drama e Brehtit është e mbështetur në radhë të parë në historinë që tregohet, në lojën e personazheve, në ballafaqimin e këtyre personazheve me njëri-tjetrin. Në të nuk i kushtohet rëndësi botës së brendshme të njerëzve, por i kushtohet rëndësi marrëdhënieve ndërmjet njerëzve. Tensionet shoqërore dhe historike që përcillen nëpërmjet ngjarjes janë ato që kanë një përparësi të dukshme në dramën brehtiane, karshi detajeve e ngacmimeve shpirtërore të individit. Këto tensione nuk zbuten dhe harmonizohen në ndërveprimin e personazheve, por paraqiten të mprehta nëpërmjet figurash të dyzuara. Kështu, për shembull Kurajo është e ndarë në nënën e dhembshur dhe tregtaren e ftohtë, apo Galilei midis shkencëtarit që ngulmon drejt së vërtetës dhe njeriut që, për të mos duruar dhimbje, heq dorë përkohësisht prej së vërtetës, etj.

Koncepti bazë i teorisë së Brehtit është ai i teatrit epik. Ky koncept mbështetet në një lojë aktoriale epike, në vend të asaj dramatike. Pikërisht në këtë pikë teatri epik bie ndesh me konceptin e *“katharsis”-it* në dramën aristoteliane. Aktori nuk duhet të paraqitet përpara publikut si personazhi të cilin sjell në skenë, të mos identifikohet me të dhe të mos provokojë iluzionin tek spektatori. Aktori paraqitet në skenë në dy forma, si vetja e tij dhe si personazhi, të cilin sjell përpara publikut. Në *“Organonin e vogël për teatrin”* autori thotë: *“Dies, daß der Schauspieler in zweifacher Gestalt auf der Bühne steht, als Laughton und als Galilei, daß der zeigende Laughton nicht verschwindet in dem gezeigten Galilei, was dieser Spielweise auch den Namen “die epische” gegeben hat./ Fakti që aktori qëndron në skenë në formë të dyfishtë, si Loutën (Charles Laughton, aktori që interpretoi Galilein në premierën amerikane)dhe si Galilei, që Loutën nuk*

shndërrohet në Galilein e shfaqur, kjo i ka dhënë kësaj mënyre interpretimi emrin “epike”. [Brecht, B.: „Schriften zum Theater“, Suhrkamp, Frankfurt a. M. 2000, f. 155]

Autori e shpreh qartë, se koncepti i tij për “dramën joaristoteliane” i referohet kryesisht ndërtimit të pjesës, ndërsa koncepti i “teatrit epik” i referohet në radhë të parë realizimit të pjesës, vënies në skenë, lojës aktoriale. Epiciteti i një teksti “joaristotelian” është kusht për një “inskenim epik”, i cili nga ana e tij mundëson një perceptim “joaristotelian” të veprës në tërësi nga publiku. Të gjitha i shërbejnë një qëllimi të vetëm, që historia që paraqet pjesa të tregohet në atë mënyrë që të ndikojë dhe të lërë një përshtypje sa më të fortë te publiku. Për këtë arsye merr kuptim dalja në skenë e tregimtarit epiko-dramatik, i cili e njeh të gjithë historinë. Megjithëse, secili rast është një shembull më vete, mund të themi se rasti më i suksesshëm i kësaj paraqitje është në dramën “Rrethi kaukazian prej teleshiri”, në të cilën ky tregimtar epik shfaqet në skenë së bashku me muzikantët shoqërues, shpaloset si një tregimtar romani auktorial, si njeriu që di gjithçka, si një instancë që qëndron mbi të gjithë të tjerët, thuajse në lartësinë e zotit, që parathotë të ardhmen dhe i kthehet në retrospektivë të shkUARës.

Ai i njeh deri në detaje edhe ndjenjat e pashprehura të personazheve, edhe vendimet që ata do të marrin dhe i shpreh ato duke iu kthyer herë njëherë rrjedhë të veprimit të ngjarjes e herë rrjedhës tjetër, në një mënyrë të harmonizuar. Kjo mënyrë të treguari shfaqet e theksuar në disa lloje inskenimesh të teatrit epik, duke shfrytëzuar dhe zgjeruar mundësitë që jep struktura tregimtare auktoriale. Në “Organonin e vogël për teatrin”, Brehti e thekson diapazonin e mundësive që krijon kjo mënyrë të treguari teksta thotë: “Kurz: es sind viele Erzählungsarten denkbar, bekannte und noch zu erfindende./ Shkurt: ka shumë mënyra të mundshme të të treguarit, të njohura dhe të tjera që duhen zbuluar” [Brecht, B.: „Schriften zum Theater“, Suhrkamp, Frankfurt a.M. 2000, f. 167].

Brehti shfrytëzon çdo aspekt të “shfaqjes teatrale”, çdo lloj mjeti apo efekti skenik, qoftë i vjetër apo i ri, dhe e përdor atë në realizimin skenik. Të gjitha këto mjete, si për shembull: pllakate, projeksione, pjesë filmike, apo edhe këngë, komente në vargje apo prozë, kore, prolog, intermexo, epilog e të tjera, ndihmojnë secila në mënyrë të ndryshme për njëfarë lëvizshmërie brenda përbrenda skenës, duke i krijuar më shumë mundësi autorit në paraqitjen e historive, sjelljeve dhe marrëdhënieve njerëzore.

Koncepti më i vështirë, më i diskutuar dhe i debatuar më gjatë i teorisë së Brehtit është “efekti tjetërsues”, ose “tëhuajtës”. Duke theksuar shumëllojshmërinë e mjeteve skenike të teatrit epik, autori nënvizon epërsinë e teatrit epik ndaj strukturës së “dramës joaristoteliane”. Po në “Organonin e vogël për teatrin” ai shprehet në mënyrë përmbledhëse: “Die Auslegung der Fabel und ihre Vermittlung durch geeignete Verfremdungen ist das Hauptgeschäft des Theaters./ Zbërthimi i fabulës dhe transmetimi i saj nëpërmjet tjetërsimeve të përshtatëshme është detyra kryesore e teatrit.” [Brecht, B.: “Schriften zum Theater“, Suhrkamp, Frankfurt a.M. 2000, f. 169].

Siç kuptohet edhe nga ky formulim i Brehtit në “Organonin e vogël për teatrin” apo edhe në formulime të tjera në tekstin “Messingkauf”, koncepti i “tjetërsimit” zë një vend kryesor në teorinë e tij. Thelbi i tjetërsimit mbështetet në pikëpamjen e Brehtit se jeta dhe bota, dhe në mënyrë të veçantë proceset historiko-shoqërore në to janë aq të njohura për ne njerëzit, sa është vështirë të thuash se mund t’i dallojmë dhe t’i kuptojmë ato. Ne i marrim shumë gjëra si të gatshme, të vetëkuptueshme dhe nuk shtrojmë, ose nuk shtrojmë mjaftueshëm pyetje mbi to. Ajo çka na nevojitet, sipas Brehtit, është një mënyrë të pari me sy tjetër, një metodë, e cila na fut në një proces të njohjes dhe të kuptimit. Për ta arritur këtë qëllim, Brehti mbështetet në konceptin e dialektikës. Atë çka është krejtësisht e njohur ai e paraqet si të huaj, e largon dhe e bën vërtetë të panjohuratë çka deri më parë na dukej e vetëkuptueshme, duke e bërë kështu të duket e çuditshme dhe të ketë nevojë për shpjegim dhe kuptim. Në këtë mënyrë ne kishim menduar fillimisht në mënyrë naive se e kuptonim, pastaj mësuam nëpërmjet një shoku të papritur se ishte e panjohur dhe nuk kuptonim asgjë nga kjo dhe më pas, duke i lidhur të dy qëndrimet apo përvojat me njëra-tjetrën dhe duke i krahasuar me sy kritik mbërrimë sërish në kuptimin e saj, por tashmë në një kuptim të ri e të vërtetë. Në tekstin “Teknikë e re e artit teatror” [Brecht, B.: “Neue Technik der Schauspielkunst“, Vepra e plotë vëll. 15] autori e cilëson këtë si “Häufung der Unverständlichkeiten, bis Verständnis eintritt./Shtim i pakuptueshmërisë deri në momentin kur fillon të kuptuarit” [Brecht, B.: “Neue Technik der Schauspielkunst“, Vepra e plotë vëll. 15, f. 360]. Ajo që ndodh gjatë tjetërsimit është një “trihapsh dialektik”, ku teza, antiteza dhe sinteza përmbyllëse qëndrojnë bashkë, por sinteza përmbyllëse ngrihet mbi dy të tjerat.

Më tepër në aspektin e përmbajtjes sesa në atë të formës, tjetërsimi lidhet me “kundërshtitë” që

sjell autori në drama. Në atë që ai e quan *"Uniteti i kundërshtive"*, tjetërsimi shfaqet si dialektikë e mbulimit dhe zbulimit të kundërshtive të shprehura në marrëdhëniet njerëzore, në histori, shoqëri apo kundërshtive që përmban vetë bota.

Për sa i përket origjinës së tjetërsimit mund të thuhet se ka rrënjë të ndryshme. Në analizën që i bën Rajnhold Grim tjetërsimit si element i teatrit epik të Brehtit, theksohet një lidhje e trefishtë. *"Erstens ist diese Brechtsche Vorstellung aus der Hegelschen Philosophie, zweitens aus der marxistischen Soziologie, drittens aus – und parallel zu – den Funden und Forderungen der russischen Formalisten erwachsen./ Kjo ide e Brehtit vjen së pari nga filozofia e Hegelit, së dyti nga sociologjia marksiste, së tretifrymëzohet dhe zhvillohet paralelisht me gjetjet e formalistëve rusë."*[Grimm, Reinhold: *Der katholische Einstein: Grunzüge der Brechtschen Dramen- und Theatertheorie*, Reclam 1995, f. 22] Për të mbështetur këtë pohim, Grim mbështetet në parathënien e veprës së parë kryesore të Hegelit, "Fenomenologjia e shpirtit, ku ai thotë: *"Das Bekannte ist darum, weil es bekannt ist, nicht erkannt./E njohura nuk vihet re pikërisht se është e njohur"* [Hegel: *"Phänomenologie des Geistes"*, hrsg. Johannes Hoffmeister, Hamburg, 1952, f. 28].

Sipas Gritit, kjo fjali përbën bazën filozofike dhe thelbin ku mbështetet tjetërsimi i teatrit brehtian. Ndikimi i Brehtit nga filozofi Hegel është theksuar edhe nga studiues të tjerë, sikundër është i njohur edhe inspirimi i tij nga teoritë e Marksit, që sipas Gritit është burimi tjetër nga e ka origjinën tjetërsimi i tij. Tëhuajtja si koncept i sociologjisë është përdorur për kuptimin e historisë nga këndvështrimi marksist, ku sipas tij ky koncept ka dalë në pah nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste dhe që duhet ndryshuar në mënyrë revolucionare.

Disi më i koklavitur duket ndikimi i formalizmit rus në tjetërsimin brehtian. Griti përmend kritikun formalist Viktor Sklovskij, në teorinë e metaforës tjetërsuese të të cilit ai gjen përputhje si me konceptin e Hegelit për tjetërsimin, në atë të Marksit dhe veçanërisht në tjetërsimin e Brehtit. Sklovskij e ka përdorur një term të ngjashëm në esenë "Arti si proces", në vitin 1916, pothuajse tri dekada përpara se Brehti të zhvillonte konceptin e tij të tjetërsimit. "[Krahaso: Šklovskij, Viktor: *"Die Kunst als Verfahren. Russischer Formalismus. Texte zur allgemeinen Literaturtheorie und zur Theorie der Prosa."*, München 1994]

Te Brehti "tjetërsimi" përmendet për herë të parë në vitin 1935. Gjithsesi duhet thënë, se teoria e Sklovskijit është një teori e mirëfilltë estetike dhe

kufizohet vetëm në fushën e estetikës dhe të poetikës. Pra, duket qartë se si këto degë tjetërsimi janë gërshtuar me njëra-tjetrën në një unitet të vetëm në teorinë dhe praktikën teatrorë të Brehtit. Sipas Gritit vlen postulati se: *"Brechtsche Verfremdung ist ein ästhetischer Kunstgriff, der es gestattet, mit Hilfe einer philosophischen Methode eine gesellschaftlich-geschichtliche Lage ins Bewußtsein zu heben./ Tjetërsimi brehtian është një mjeshtëri estetike, e cila lejon që me anë të një metode filozofike të sjellë në ndërgjegje një situatë historiko-shoqërore"* [Grimm, Reinhold: *Der katholische Einstein: Grunzüge der Brechtschen Dramen- und Theatertheorie*, Reclam 1995, f.23]. Ai vijon më tej: *"Brechts Verfremdung weder pures "Kunstmittel" ist oder sein soll noch auch bloße "soziale Maßnahme", sondern stets beides zugleich..."* [Poaty, f. 23].

3. Distancimi dhe tjetërsimi si elemente të teatrit epik

Duhet thënë se autori e ka nisur ta zhvillojë konceptin e distancimit dhe tjetërsimit më herët se viti 1935. Për të mbështetur këtë pohim mund të marrim si shembull pjesën "Die Ausnahme und die Regel" / "Përrjashtimi dhe rregulli" të vitit 1930, ku aktorët i drejtohen publikut me vargje të tilla si: *"Betrachtet genau das Verhalten dieser Leute: / Findet es befremdend, wenn auch nicht fremd / Unerklärlich, wenn auch gewöhnlich / Unverständlich, wenn auch die Regel.../ Vëreni me vëmendje sjelljen e këtyre njerëzve: / Ju duket e habitshme edhe nëse jo panjohur/ e pashpjegueshme edhe nëse është e zakonshme / e pakuptueshme edhe nëse ndodh rëndom..."* [Brecht, B.: *Gesammelte Werke 2*, f. 793].

Nga shembuj të tillë ne mund të themi pa frikë se teoria e njohur e Brehtit nuk është zhvilluar e pavarur nga tezat që e frymëzuan, por është në thelb një kontribut individual i autorit. Elementet që ai gjeti te formalistët rusë, te Hegeli apo te Marksi ishin në fakt veçse formula teorike e asaj që ai kërkonte dhe realizonte në praktikën dramaturgjike. Me pak fjalë, dialektika dhe tjetërsimi ishin brenda shkrintarit dhe mendimitarit Breht që në fillimet e krijimitarisë së tij. Përjetimi i "efekteve tjetërsuese në artin kinez të aktrimit" që e tërhoqi dhe madje e mrekulloi autorin ishte për faktin se ai pa në një demonstrim artistik të përkryer zbatueshmërinë e teorisë së tij të tjetërsimit. Nëse në teatrin e Mei Lan-fang, dramaturgut më të madh kinez të shekullit XX, tjetërsimi kufizohet vetëm në lojën aktoriale, Brehti vërtetoi me veprën e tij se mundësitë dhe efekti i tjetërsimit nuk qëndron vetëm në fushën e paraqitjes skenike, regjisë, lojës aktoriale, por edhe në fushën e ndërtimit të dramës, pra edhe në

rrafshin gjuhësor. Principi tjetërsues depërton në ndërtimin e një drame brehtiane madje e organizon atë, që nga shënimet e para e deri në strukturën artistike përfundimtare të vënë në skenë.

Nëse analizojmë tjetërsimin si në dramën e Brehtit vëmë re se ai realizohet në tri rrafshë në formë shtresëzimi. Rrafshi i parë, në të cilin mbështeten edhe dy të tjerët, është ai i tekstit letrar, që ka të bëjë me formën gjuhësore dhe strukturën e tekstit. Procesi i tjetërsimit i jep një ngjyrim tjetër gjuhës së Brehtit, që nga fjalë të veçanta e deri në shenja të ndryshme pikësimi. Le të përmendim këtu një shembull nga drama “Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj”, ku në “këngën e kapitullimit” të kënduar nga Kurajo në refren ajo thotë: *“Der Mensch denkt: Gott lenkt - / Keine Red davon! / Njeriu mendon: Zoti drejton - / Asnjë s’e diskuton!”* ku vetëm nga një ndryshim shumë i vogël, duke vendosur dy pika në vend të presjes, fjala e urtë që shpreh besimin te zoti kthehet në një shprehje të së kundërtës, duke përfutur efektin e një ironie therëse. Duhet të theksoj këtu se formulimet e Brehtit nuk janë asnjëherë të rastësishme, por të zgjedhura me një synim të qartë. Shembujt mitikë, ndër të cilët autori cilëson edhe biblën, shërbejnë gjithashtu si një element tjetërsues.

Ashtu sikundër përdorimi i tjetërsuar i gjuhës vihet re dhe tjetërsimi në strukturën e dramës dhe në inskenimin e saj. Kështu, për shembull radha e dialogjeve, skenografia, muzika, koreografia, kostumografia, maskat, ndriçimi, pra i gjithë bashkëpunimi regjisor, kompozitor, skenograf dhe aktor është në funksion të tjetërsimit. *“So seien all die Schwesterkünste der Schauspielkunst hier eingeladen, nicht um ein “Gesamtkunstwerk” herzustellen, in dem sich alle aufgeben und verlieren, sondern sie sollen, zusammen mit der Schauspielkunst, die gemeinsame Aufgabe in ihrer verschiedenen Weise fördern, und ihr Verkehr miteinander besteht darin, daß sie sich gegenseitig verfremden.”* Të gjitha llojet simotra të artit të aktrimit ftohen jo për të krijuar një vepër të përbashkët ku të gjithë japin dhe humbasin, por ato duhet që së bashku me aktrimin ta nxisin punën e përbashkët në mënyra të ndryshme dhe marrëdhënia e tyre me njëri-tjetrin konsiston në tjetërsimin e ndërsjelltë” [Brecht, B.: *Schriften zum Theater, Suhrkamp, Frankfurt a.M. 2000, f. 171*].

Në këtë pohim të autorit në “Organonin e vogël për teatrin” vihet re citimi i konceptit të Vagnerit për veprën e artit si një unitet artistik, (“Gesamtkunstwerk”), në të cilin theksohen elementet tekst - figurë – zë. Pikërisht në mënyrën e konceptimit të ndërthurjes tekst-figurë-zë shohim një kundërshti me konceptin e Vagnerit mbi veprën

artistike. Ndërsa te Vagneri këto tri elemente janë të shkrira me njëra-tjetrën në synimin për të krijuar një unitet artistik, te Brehti ato shfaqen si elemente të demonstrimit të një eksperimenti me funksion didaktik, ku spektatori ka mundësi të vërejë proceset dhe rezultatet. Uniteti i veprës artistike konsiston në faktin që ajo i sjell bashkë këto elemente në funksion të një ideje, ndërsa mjete i përdorur është tjetërsimi i gjinive artistike. Kjo formë e re teatri ndryshon dukshëm edhe nga natyralizmi mbarëevropian, i cili kërkonte iluzionin skenik pa thyerje dhe kundërshti, sikurse ndryshon edhe nga anti-iluzionizmi i ekspresionizmit të evropës qendrore, rrymë kjo së cilës ai ju përkushtua në fillimet e tij (Baal). Teatri brehtian, ashtu si dhe ai i natyralizmit kërkon të japë një pasqyrim të realitetit: *“Das Theater muß sich in Wirklichkeit engagieren, um wirkungsvolle Abbilder der Wirklichkeit herstellen zu können./ Teatri duhet të angazhohet që të mund të krijojë pasqyrime të efektshme të vërtetësisë”,* dhe në ngjashmëri me ekspresionizmin përdor mjete skenike të guximshme që shkojnë deri në groteske, por ai nuk është as natyralist dhe as ekspresionist. Në këtë pikë unë bashkohem me mendimin e Grimmit, i cili e quan këtë teatër në tërësi kuptimin e fjalës “teatër realist” [Grimm, Reinhold: *„Der katholische Einstein: Grungzüge der Brechtschen Dramen- und Theatertheorie“*, Reclam 1995, f. 29].

4. Aspekti edukativ i dramave të Brehtit

Në shkrimin e tij teorik “Organon i vogël për teatrin” (1949) Brehti hedh bazat e vizionit të tij të ri mbi botën, të frymëzuar nga teoria marksiste. Në këtë tekst ai përshkruan edhe funksionin e ri të teatrit në kushtet e riorganizimit shoqëror. Sipas Brehtit, dramaturgu epik i përdor ngjarjet dhe situatat e ndryshme të shkëputura nga vendi dhe koha, duke i vënë në një kontekst të caktuar për spektatorin. Ai bën të mundur paraqitjen e ngjarjeve në simultanitetin e tyre, duke pasur të mundur përsëritjen e veprimit dhe të parët nga një tjetër këndvështrim, ndërprerjen dhe komentimin e ngjarjes. Pikërisht, kjo lirshmëri përkundrejt materialit që trajton, mundësia që krijon për të komentuar e bën më të përshtatshme dramaturgjinë epike për teatrin e ri vizionar.

Në shënimet për operën “Ngritja dhe rënia e qytetit Mahagoni” Brehti vendos përballë njëra-tjetrës dramatiken dhe epiken, ku siç thekson ai: *“Dieses Schema zeigt nicht absolute Gegensätze, sondern lediglich Akzentverschiebungen. / Kjo skemë nuk tregon kundërshti absolute, por vetëm zhvendosje të theksit.”* [Brecht, B.: *Schriften zum Theater, Suhrkamp, Frankfurt/M 2000, f. 19*].

Kjo vënie përballë njëra-tjetrës ka të bëjë më tepër me mënyrën e paraqitjes së ngjarjeve. Lidhur me kundërvënien “ndjenjë - arsye”, e cila ka ngjallur edhe një numër të madh diskutimesh, Brehti sqaron se nuk bëhet fjalë për heqje dorë nga emocionet. Unë mendoj se kjo kundërvënie duhet parë dhe analizuar ndoshta e lidhur me qëllimet e teatrit brehtian.

Filozofi gjerman Ernst Bloh thekson në shkrimet e tij se drama e Brehtit është një dramë edukative, ndërsa teatri brehtian një “institucion paradigmatic”. Kështu, që do të ishte e gabuar ta interpretosh si një lloj drame primitive shkollore, përkundrazi ky lloj teatri edukativ është më tepër një teatër filozofik dhe iluminues. [Krahaso: Bloch, Ernst: *Das Prinzip Hoffnung, Berlin 1953, Bd. 1, f. 441*]. Bloh thekson se teatri brehtian nuk i vë publikut përpara përgjigje dhe shembuj të gatshëm. Publiku e sheh teatrin brehtian më tepër si një “provë” mbi një shembull prej të cilit mund të mësojë. Dramat e Brehtit ndjekin rrugë nga më të ndryshmet, ato ngrenë për diskutim raste të veçanta, duke shërbyer si një “laborator i kombinimit të teorisë me praktikën, ku një eksperiment ndodh pa pasojat dramatike, ku jepen vazhdimisht alternativa të mundshme”, vetëm se është qëndrimi marksist ai që përcakton drejtimin e eksperimentit.

Në “Organonin e vogël për teatrin” Brehti e përshkruan këtë teatër si një lloj “punishteje në të cilën praktikohet skicimi i shoqërisë, duke qenë në gjendje të influencosh në të”. Veç kësaj, teatri brehtian shërben për të nxitur dhe ushtruar procesin e “të menduarit”. Shumë prej dramave brehtiane ngrenë probleme, por nuk japin zgjidhje, ajo i lihet në dorë publikut, gjë që e ka bërë objekt të kritikës staliniste. Kështu, për shembull drama “Njeriu i mirë i Secuanit” ndërpritet pikërisht në momentin kulmor të konfliktit, figura kryesore del përpara publikut duke pyetur për zgjidhjen. Po kështu, edhe nëna Kurajë nuk ndërgjegjësohet në fund të dramës për gabimet e saj dhe pjesa nuk i tregon publikut zgjidhje, por në korrespondencën me dramaturgun Fridrih Volf Brehti shpreh mendimin se “(...)wenn jedoch die Courage weiter nichts lernt – das Publikum kann, meiner Ansicht nach, dennoch etwas lernen, sie betrachtend... / nëse Kurajo vazhdon të mos mësojë gjë, atëherë, sipas pikëpamjes sime, mundet që publiku të mësojë diçka duke e kundruar.”

Duket qartë që Brehti synon të japë nxitje në drejtim të të menduarit. Pjesët e tij i shërbejnë zhvillimit të ndërgjegjes. “Opera për tri grosh” (1928) dhe “Ngritja dhe rënia e qytetit Mahagoni” (1928/29) qenë përballjet e para të Brehtit me

dramaturgjinë epike, dhe konkretisht në këto dy pjesë edhe me “Operën epike”. Fillimisht pati një hendek midis qëllimeve të autorit dhe perceptimit të publikut. Kjo gjë tregoi qartë që teatri i Brehtit kërkon një publik të përgatitur që ta perceptojë pjesën në atë mënyrë që dëshiron dhe ka paramenduar autori. Në shfaqjen e parë të “Operës për tri grosh” publiku, i mësuar me shfaqje të një natyre tjetër, nuk e mori ngacmimin e duhur për të analizuar ngjarjen e paraqitur, por e mori atë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parodia është mjeti kryesor që përdor Brehti në të. Duke vendosur në gojën e kriminelëve teza dhe shprehje të një karakteri qytetar dhe të krishterë, autori i tjetëron këto teza. Zhvillimin epik të veprimit ai e thekson nëpërmjet shkrimeve ironizuese, të cilat realizohen me anë të tabelave, projeksioneve etj. Stili epik kishte një efekt qesharak dhe provokativ, por nuk theksonte aspektin ideologjik, gjë që nuk përmbushte synimin e autorit dhe për këtë arsye drama iu nënshtrua disa përpunimeve.

Në operën “Ngritja dhe rënia e qytetit Mahagoni” Brehti paraqet modelin e një utopie negative të shoqërisë kapitaliste. Ngjarjet zhvillohen në Mahagoni, një qytet i trilluar në Amerikën e Veriut në fillim të shekullit XX. Gjatë rrugës për në bregun ku do të gjenin ar, tre mashtrues mbeten të bllokuar në një zonë të shkretë, ku vendosin të ngrenë një qytet argëtimi, të quajtur Mahagoni, ku të pasurit do të shijonin baret dhe bordelet dhe në këmbim do të linin këtu paratë e tyre. Në këtë qytet duhej të mbretëronte qetësia dhe harmonia. Qyteti josh me “shtatë ditë pa punuar”, me “Gin dhe Whisky”, me “vajza dhe djem”, ndërkohë që jeta kudo është ndryshe: “Überall gibt es Mühe und Arbeit / Aber hier gibt es Spaß. / Kudo ka punë dhe mundim / Këtu ka argëtim.” [Brecht, B.: *Aufstieg und Fall der Stadt Mahagonny, Suhrkamp Frankfurt; Berlin 2013, f. 19*]. Viktima të mashtrimit bëhen të gjithë ata që nuk e pëlqejnë jetën në qytetet e mëdha, “të pakënaqurit e kontinenteve” që duan të jetojnë në “qytetin e parajsës”. Por, personazhi Paul harron ligjin e famshëm, kufizimin e vetëm të lirisë pa kufij: “lejohet gjithçka vetëm kur ke para”. Një ditë, kur nuk ka më para për të paguar, ai gjendet para gjyqit dhe nuk ka më as mbështetjen e miqve dhe të të dashurës. Ai shpallet fajtor për “krimin e madh” të “mungesës së parave” dhe dënohet me vdekje. Opera mbyllet me zhytjen e Mahagonit në kaos. Ndërsa qyteti digjet, nëpër rrugë demonstrojnë ata që nuk e kanë pësuar ende, të papërgatitur për idealet e tyre dhe përparimin e “epokës së parasë”, dhe askush nuk mund të shpëtohet. Si finale të veprës, duke dashur të theksojë se e gjitha është një lojë, Brehti ka zgjedhur

fjalët: *“Denn Mahagonny das gibt es nicht. Denn Mahagonny das ist kein Ort. Denn Mahagonny ist nur ein erfundenes Wort.”* [Brecht, B.: *Aufstieg und Fall der Stadt Mahagonny, Suhrkamp Frankfurt; Berlin 2013*].

Në paraqitjen e Mahagonit Brehti niset nga një situatë politike konkrete, e cila paraqitet si një anarki që vjen nga defektet që ka kjo shoqëri dhe që e bëjnë kaq të prekshme nga kriza. Bota e paraqitur në Mahagoni është pasqyrë e botës kapitaliste që shihte autori në fillim të shekullit XX. Qyteti duhej t'i ngjante jetës. Në Mahagoni sundon ligji i parasë që përcakton marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Ligji i ri ishte anarkia, vjedhja, vrasja, tradhtia, të gjitha këto lejohen në Mahagoni.

Nga pikëpamja formale, Brehti mbështetet në dramaturgjinë epike dhe përdor sërish të njëjtat mjete epizuese si në *“Operën për tri grosh”*, pra titujt, projektionet, këngët etj. Vepra u krijua si bashkëpunim i Brehtit me kompozitorin Kurt Weil dhe që menduar si një polemikë ndaj operës tradicionale.

Me qëllim Brehti përdor operën, e cila cilësohet si gjinia që nuk ka lidhje me arsyen, për të kritikuar dhe parodizuar rendin shoqëror të paarsyeshëm të një shoqërie si ajo e paraqitur në qytetin Mahagoni. *“Also sollte etwas Unvernünftiges, Unwirkliches und Unernstes, an die rechte Stelle gesetzt, sich selbst aufheben in doppelter Bedeutung. / E pra duhej vënë diçka e paarsyeshme, joreale, e pavërtetë, në vendin e duhur, që të dilte në pah në kuptim të dyfishtë.”*, thotë Brehti në shënimet e tij mbi pjesën. [Krahaso: Brecht, B.: *Gesammelte Werke, Anmerkungen zur Oper “Aufstieg und Fall der Stadt Mahagonny”, vëll. 4, Suhrkamp 1991, f. 74 e në vijim.*]

Një mënyrë e ngjashme përdoret edhe në *“Operën për tri grosh”* apo edhe në pjesë të tjera të autorit, ku realiteti parodizohet, duke i marrë parasysh në mënyrë të vetëdijshme dëshirat e “paarsyeshme” të publikut, duke i plotësuar deri në absurditet dhe pastaj duke i korrigjuar dhe vënë në vendin e duhur në parodi. Është e pak a shumë e njëjta gjë që kemi parë te Pirandelo, ku maska paraqitet si maskë dhe në këtë mënyrë edhe demaskohet si maskë.

Në drama të tjera Brehti shfaqet edhe më i drejtpërdrejtë dhe provokator. Ai tenton drejt një teatri që ushtron ndikim të drejtpërdrejtë tek amatorët e artit, në mënyrë që të ushtrorë edhe efektin edukativ të kërkuar prej tij. Publiku që ka nevojë për këtë lloj teatri, sipas Brehtit, ishin punëtorët dhe nxënësit, të cilët ai i cilëson si ajo pjesë e shoqërisë e cila duhet edukuar edhe

nëpërmjet artit. Me këtë teori Brehti pretendon ta kthejë artin në një disiplinë pedagogjike.

Duke dashur t'i japim përgjigje pyetjes se përse Brehti e quan teatrin e tij “teatër i epokës së shkencës” duhet nënvizuar fakti që autori ka shfaqur gjithnjë interes të madh për fillimin e kohës së re, rreth viteve 1600, për të ashtuquajturin revolucion shkencor dhe figurat e asaj epoke, si: Francis Bacon dhe Galileo Galilei. Përsa i përket anglezit Bacon, të cilit autori i ka kushtuar edhe anekdotën *“Eksperimenti”*, duhet thënë se i ka dhënë idenë për emërtimin e tekstit *“Organon i vogël për teatrin”*, kam parasysh këtu traktatin e tij të vitit 1620, *“Novum Organum scientiarum”*, të cilin mund ta citojmë pa frikë si një udhëzues anti-aristotelian. Për sa i përket italianit Galileo Galilei, mund të themi që dha ngacmime për *“Organonin”*, por edhe për tekstin tjetër teorik *“Messingkauf”*. Autori ia detyron atij një prej shembujve më domethënës për principin e tjetërsimit. Kam parasysh këtu anekdotën e famshme të llambadarit lëkundës të Katedrales së Pizës, këqyrja e së cilit, siç dihet, e frymëzoi Galilein për zbulimin e ligjit të tij të famshëm të gravitetit. Brehti pohon me krenari: *“Diesen Blick, so schwierig wie produktiv, muß das Theater [...] provozieren./ Këtë vështrim sa të vështirë aq edhe produktiv duhet të provokojë teatri...”*, dhe vijon: *“Es muß sein Publikum wundern machen, und dies geschieht vermittelt einer Technik der Verfremdung des Vertrauten./ Ai duhet ta bëjë publikun të çuditet dhe kjo ndodh nëpërmjet një teknike të tjetërsimit të së njohurës.”* [Brecht, B.: *Gesammelte Werke, vëllimi 16, f.681*].

Brehti synon që këtë koncept tjetërsimi, të bazuar dhe të huazuar nga shkencat natyrore, ta përdorë në aspektin shoqëror. Duke e lidhur kënaqësinë me të dobishmen, mësimin me të mësuarit njëkohësisht, ato veçse pasurojnë njëra-tjetrën. Didaktika ashtu si edhe dialektika ishin për këtë autor një përvojë estetike që i dhuronin kënaqësi. Ai shijonte përfundimin e dijeve të reja, mendimeve të reja gjithnjë në ndryshim e transformim. Ai e përjetonte gjithçka si të përkohshme, të ndryshueshme, në një proces të vazhdueshëm ndryshimi. E vetmja gjë që vijon është rrjedha e ngjarjeve. Kjo dëshirë e tij për ndryshim e bën këtë autor të mos mbetet i lidhur fort në kufij ideologjikë, por të tentojë t'i kapërcejë këta kufij. Brehti ishte padyshim një artist marksist, por ai ishte njëkohësisht edhe një heretik. Disa kritikë janë përpjekur ta bindin që pjesët dhe teoritë e tij vlenin vetëm për një shoqëri kapitaliste, pasi në një shoqëri socialiste atyre u humbiste kuptimi dhe funksioni. Kësaj kritike Brehtit i përgjigjej:

“Diese Herren können offenbar nicht dialektisch denken. Meine Stücke und Theorien gelten fürs Bürgertum und unterm Kapitalismus; sie gelten für eine sozialistische, eine kommunistische, eine klassenlose Gesellschaft – und für alle darauf folgenden Gesellschaftsformen./Këta zotërinj nuk mund të mendojnë në mënyrë dialektike. Pjesët e mia vlejné për borgjezinë dh kapitalizmin; ato vlejné për një shoqëri socialiste, komuniste, pa klasa – dhe për të gjitha format shoqërore që vijnë më pas.” [Cituar sipas Grimm, Reinhold: „Der katholische Einstein: Grungzüge der Brechtschen Dramen- und Theatertheorie“, Reclam 1995, f. 31]. Dhe është pikërisht koha ajo që tregon vërtetësinë e kësaj shprehje profetike të tij. Fakti që vepra e tij vazhdon të ngjallë interes dëshmon vlerat e saj produktive në fushën e letërsisë dhe të teatrit. Në shënimet për vëllimin e dytë të librit “Drama moderne” autori Menemajer nënvijëzon interesimin për këtë autor dhe vlerat aktuale të veprës së tij:

“Der Hauptgrund für die Hervorhebung Brechts [...] ist das unverändert starke Interesse insbesondere unserer kritischen, politisch interessierten Studenten an diesem Autor. Brechts Aktualität wird durch die augenfälligen Schwierigkeiten, die es bereitet, seine Prinzipien auf dem Theater der Bundesrepublik schöpferisch anzuwenden, nicht wesentlich gemindert. Daß sich jede dramaturgische Grundsatzdiskussion heute, sei es zustimmend, sei es ablehnend, auf Brecht

edhe në kohët e sotme, gjë që dëshmon vlerat e tij produktive në fushën e letërsisë dhe të teatrit.

zurückbezieht, bezeugt dessen ungebrochene produktive Lebendigkeit./Arsyeja kryesore e theksimit të Brehtit [...] është interesimi gjithmonë i madh për këtë autor veçanërisht i studentëve tanë kritikë, me interes për politikën. Aktualiteti i Brehtit nuk zvogëlohet nga vështirësitë e dukshme që shfaq për zbatimin krijues të principeve të tij në teatrin e RFGJ-së. Fakti që çdo diskutim bazë mbi dramaturgjinë sot, qoftë aprovues qoftë refuzues i referohet Brehtit dëshmon ekzistencën produktive të pandërprerë.” [Modernes deutsches Drama, vëllimi i dytë, UTB München 1975, f.10].

5. PËRFUNDIME

Koncepti i teatrit epik është pandashmërisht i lidhur me emrin e Bertolt Brehtit. Falë ndikimit të tij përcaktues teatri i shekullit XX u rikonceptua dhe u zhvillua në një formë të re me synimin për të qenë më emancipues, iluminues dhe revolucionar. Teatri epik është një teatër që nuk i drejtohet ndjenjave të spektatorit por arsyes së tij. Ai tenton drejt një teatri që ushtron ndikim të drejtpërdrejtë tek amatorët e artit, në mënyrë që të ushtrojë edhe efektin edukativ të kërkuar prej tij. Ky teatër nuk synon të ndikojë publikun duke e bindur, por duke dhënë arsye.

Duke e lidhur kënaqësinë me të dobishmen, mësimin me të mësuarit njëkohësisht, ato veçse pasurojnë njëra-tjetrën. Ky lloj teatri vazhdon të ngjallë interes

BIBLIOGRAFI

- Bloch, E. 1953, Das Prinzip Hoffnung, Berlin, Bd. 1.
 Brecht, B. 1970, Der Jasager. Der Neinsager, Suhrkamp Verlag, Frankfurt/M.
 Brecht, B. 2000, Schriften zum Theater, Suhrkamp, Frankfurt a. M..
 Brecht, B. 2013, Aufstieg und Fall der Stadt Mahagonny, Suhrkamp Frankfurt; Berlin.
 Brecht, B., Neue Technik der Schauspielkunst, GW 15.
 Brecht, B.1967,Gesammelte Werke (“Vepra e përmbledhur në 20 vëllime”), SuhrkampVerlag & Elisabeth Hauptmann, Frankfurt a. M..
 Freytag, G. 1863, Technik des Dramas.
 Grimm, R.1995,Der katholische Einstein: Grungzüge der Brechtschen Dramen- und Theatertheorie, Reclam.
 Hegel, G. W. F. 1952,“Phänomenologie des Geistes“, hrsg. Johannes Hoffmeister, Hamburg.
 Mennemeier, F. N. 1975, Modernes deutsches Drama, vëllimi i dytë, UTB München.
 Piscator, E. 1929, Das politische Theater, Berlin.
 Šklovskij, V. 1994, Die Kunst als Verfahren. Russischer Formalismus. Texte zur allgemeinen Literaturtheorie und zur Theorie der Prosa. Hrsg. Von Jurij Striedter. 5. Auflage. München.
 Szondi, P. 1978, Theorie des modernen Dramas, Frankfurt a.M.

DRANJA, "ORA" E DASHUR E CAMAJT

ORNELA DOMI

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Përmbledhje

"Dranja", "Monalizë letrare", emër luleje, për një breshkë, simbiotikë faune dhe flore për të simbolizuar dheun, mëmëdheun, atdheun...një grua, femër, që pret djalin e saj në emigrim. Dranja paraqet alteregon e autorit të saj, ku paralelizmi gjendet tek fati i përbashkët, odiseja e një ikanaku, veti të përbashkëta dhe modele sjellje e jete të përbashkëta. Breshka si rikrijim i autorit totem pagan antik, i përdorur nga banorët mbi lumin Drin për lahuta të hershme, besoj se përbën një emblemë besimi dhe adhurimi duke parë në të veti të ngjashme me ato të natyrës, psikologjisë së malësorit dhe vete Camajt. Alegoria nëpërmjet energjisë simbolike dhe semiotike për rrjedhojë, ngulmon për idenë e zhguallit, gurit, si simbol fortese, kulle, shtëpie, dheu, nostalgjia, dashuria për gurët e mëmëdheut(sokakut), jo më kot Dranja quhet "tharm toke dhe orë guri". Dranja, vepra e artit në madrigale, me veshjen simbolike dhe semiotike, pra si kryeshenjë, arrin qëllimin ideoartistik të autorit, për të patur atdheun me vete, ngado që këmba e tij shkel, ajo realizon një ëndërr, totemi i ri i rikodifikuar "breshka" kënaq një dëshirë të Camajt dhe të çdo mërgimtari. Modelet e sjelljes së breshkës, temperamenti, vetitë, janë përfaqësuese të etnisë, të karakteristikave që autori i sheh tek vetja dhe tek "fisi i panjoftun", fisi i baballarëve, etërve, trashëgimi e pavetëdijes kolektive, të geneve, që trashgohen brez pas brezi, e që vështirë se metamorfozohen, prandaj dhe e kam quajtur totem i rikodifikuar arketipik. Dranja tregon ngjashmëritë dhe analogjitë midis antikitetit të ilirëve dhe grekëve dhe kulturave të dy vendeve fqinje. Vepra është shkruar në një stil idilik, duke u nisur që nga emri i breshkës, mbizotërohet nga përshkrimi, dhe ka thyerje të ligjeve të hapësirës dhe kohës, autori bën lidhje në kohë dhe pakohë, ku boshtet kohore priten sipas qëllimeve ideoartistike në një fabul interesante madrigalesh poetike. Në vepër jepen nocionet e vdekjes, ritet, ceremonitë e varrimit, kuptimet, filozofike të rilindjes, siç hapet një gropëz për një drandofille...Camaj gjithmonë i referohet natyrës, luleve, reptilit të ndërmjetëm e të papërsosun breshkë, e parë si arketip, pasardhëse e familjes së dinosurve, ashtu si Camaj pasardhës i një fisi, që jeton me të edhe jasht kufijve në emigrim. Dranja, breshka, mishëron simbolikisht edhe konservimin e dialektit dhe nëndialektit geg, me pasuritë e pashtershme gjuhësore në të gjithë prizmat e mundshëm.

Fjalë çelës: Monalizë, alterego, arketip, totem, fosil, rikodifikim, mit, emblemë, hajmali, fisi, alegori, simbol, semiotikë, besim pagan, antikitet grek, idilik, kanun, pakohë, mëmëdhe, gur, zhguall, kullë, malësor, gjarpër, simbiotikë, odise.

Abstract

"Dranja", "a Literary Monalis", the name of a flower, a tortoise; flora and fauna to symbolize the soil, the motherland, the fatherland, a woman that awaits the return of her son from emigration. Dranja represents an alter ego of the author, with the parallel lying on the similar destiny, the odyssey of a migrant, common properties and common behaviour and life patterns. The tortoise as a recreation of the ancient pagan totem used by inhabitants of Drin upper bank for old lute songs is, in my opinion, an emblem of faith and adoration, since it manifests characteristics that are similar to those of the nature and psychology of highlanders and of Camaj himself. The allegory, through the semiotic and symbolic energy, resultantly persists with the idea of the tortoise shell, the stone as a symbol of a fortress, tower, house, earth, nostalgia, and love for the stones of motherland. Consequently, Dranja is referred to as "a ferment of earth and stone watch". *Dranja*, the madrigal literary work, in the semiotic and symbolic aspect, thus as a keystone sign, achieves the artistic goals of the author to have motherland with him wherever he goes; it makes a dream come true: the coded totem, the tortoise, gratifies a desire of Camaj, which is the same with that of every immigrant.

The patterns of the tortoise behaviour, the temperament, the characteristics are representatives of the ethic, the properties that the author sees in himself and in the "unknown kin", the kinsmen of his father, his ancestors, the inheritance of collective unconsciousness, of the genes inherited from one generation into another, and that hardly metamorphose, which is the reason why I have named it a coded totem. Dranja demonstrates the similarities and analogies between the Illyrian and Ancient Greek antiquity and the cultures of the two neighbouring countries. The work is written in an idyllic style which starts from the choice of the name of the tortoise, description is dominant and there are disruptions of the laws of space and time. The author draws connections through time and timelessness, with the time axes meeting in accordance with the artistic objectives in an interesting plot of poetic madrigals.

The notions of death, the rites, the funeral ceremonies, the meanings, and the philosophy of rebirth are depicted in the work, like the planting of a rose... Camaj always refers to nature, to the flowers, to the intermediary and imperfect reptile of the tortoise seen as an archetype, a descendant of the dinosaur family, similar to Camaj, the successor of a tribe, which now lives with it even on foreign land, in immigration. Dranja, the tortoise, symbolically embodies the preservation of the geg dialect and sub dialects with the inexhaustible linguistic riches in all the possible points of view.

Key words: Monalisa, alter ego, totemic, archetype, fossil, myth, emblem, tribe talisman, allegory, symbol, semiotic, pagan religion, Greek Antiquity, idyllic, canon, timelessness, motherland, stone, tortoise shell, tower, highlander, snake, symbiosis, odyssey.

Hyrje

Studimi për Dranjan, ka për qëllim të sjellë hulumtore të reja për këtë kryevepër të Camajt ; breshkën, si dhe alterego e shkrimtarit, të para nga kënvështrime të reja psikokritike. Kryesisht zbërthimi i figurës simbolike, alegorisë, është ndihmuar nga psikoanalitikë si Jung, por edhe nga kritika shqiptare si Sinani, Shllaku etj.... Objektivi më sprovues, ka qenë expliciti i rikodifikimit i mitit tradicional dhe zbulesa guximtare të reja të tipareve kanunore, etnike, traditave, modelet e sjelljeve të malësorit të mishëruara tek breshka Dranje dhe pse ajo është e përzgjedhura si emblemë?

Dranja totem

Dranja, një emër gruaje, derivon nga origjinali "drandofille", trëndafil, një emër i përdorur femre në trevat veriore. Një emër me konotacion idilik, një emër luleje, për një breshkë, dhe bëhet fjalë njëkohësisht edhe për një grua, femër dhe emri është në gjininë femërore, mendoj se simbolizon njëkohësisht edhe dheun, mëmëdheun, vendlindjen, pasi breshka është gjallesë që jeton edhe nën dhe' dhe mbi të dhe edhe trëndafili jeton nën dhe dhe mbi të, përforcim dyfish simbolik dhe simbiotik. Kjo gjallesë, ka madrigale ku jepet edhe në tiparet e një gruaje, e cila end, thur me fijet, ashtu si merimanga, (bashkëthurje me dijet)mendimet e nje gruaje të mençur, e cila mendoj se pret djalin, të dashurin, i cili ka ikur larg, në emigrim. Dranja, këtu më kujton Penelopën, në mitologjinë greke e cila thur dhe pret Uliksin në Itakë, ngjashmëritë janë vërtetë domethënëse me mitologjinë greke. Dranjan e shikoj të ngjashme me Uliksin apo "Odisean" e Homerit :

1.Në të dyja veprat ka një kompozicion të një udhëtimi, rrugëtim të dy heronjve, të ndarë në pjesë...2.Vështirësitë, përplasjet me rreziqet, armiqësitë, grabitqarët, përpjekjet për t'i mbijetuar rrethanave dhe ambientit. "Dranja ", për vetë autorin, i larguar tashmë në "dhena t'hueja", jasht Shqipërisë, bëhet nyje e fortë lidhëse, imazh i cili mban gjallë nostalgjinë, mallin për mëmëdheun, rikthimin."..... ishte fryma e dheut tim në atë dhe një emër gruaje, Dranja.(Camaj, 1996, fq.17) Tek "Miqësi e ligshtë"lexojmë:"Si vajzë që rritet shpejt dhe shpejt don me i qitë fat vetes e me dalë nuse, ajo më lëshoi një shikim të shkrihtë".(Camaj,1996, fq.35) Dranjen e shikoj si një simbol të ngjashëm me pikturën e famshme të "Monalizës "të Leonardo Da Vinçit, ku thuhet se, mistikja dhe magjikja që transmeton kjo vepër, jep tipare të një femre dhe herë-herë ato të alteregos të vetë Leonardos, të një mashkulli, pra tipare të dyzuara. Tek "Dranja ", si vepër letrare, paralelizmi dhe alteregoja, pra lidhja me krijuesin, Martin Camajn, gjendet tek odiseja, fati i përbashkët i një ikanaku, ngjarjet, vetitë e

breshkës, pozitive si natyrë dhe modelet e sjelljes. Nga ana tjetër ajo është frymor i ndërmjetëm, "i papërsosun" gjinia femërore, si figurë mitike pagane, dua të besoj se përfaqëson besimin, adhurimin e banorëve mbi lumin Drin ndaj breshkës dhe të zonave malësisë përreth Dukagjinit, ku disa prej lahutave të hershme kanë kafkullin e saj, siç ka hedhur një dritë të rëndësishme mbi "Dranjan" dhe Prof.Dr.Shaban Sinani tek monografia e tij për autorin:" A mund të ketë qenë pikërisht kujtimi i lahutës që e ka nxitur shkrimtarin të transferojë totemin prej gjarprit tek breshka. Ndoshta po, nëse do të përshkruanim një lahutë primitive ajo do të kishte kafkullin e breshkës, bishtin e lahutës dhe kryet, që ka qenë pikërisht një totem tjetër i vërtetë i shqiptarëve, brirët e dhisë. Në viset mbi Drin deri vonë kishte lahuta të tilla, me kafkullin e breshkës për krye, gjarprin si zburimore në bishtin e lahutës dhe kryet e dhisë apo të sorkadhes."(Sinani, 2011, fq.230) Duke qenë se është, hajmali, mishërimi i besimit të banorëve të Temalit tek breshka, autori e rikrijon atë në alegori për funksion simbolik për të arritur te dheu, mëmëdheu, ndërsa zhgualli, që përbëhet nga një material shumë i fortë, të transmeton idenë e fortesës e ngjashme me gurin. Sinani në studimin e tij të plotë për veprën shpjegon mënyrën e rikodifikimit të miteve:"Ai animizon, antropomorfizon, ai krijon totemi të reja mbi bazën e bartjes së funksioneve nga një shenjë tek tjetra, metamorfizon, krijon simbioza.....Ajo e tejkalon shenjën vetë, për të zbritur në një shkallë të kryehershme të mundësive njerëzore para së gjithash të mendësisë së popullit të gjuhës së vet. (Sinani, 2011,fq 221) Tek "Dranja", shikoj edhe ngjashmëri fonetike edhe me emrin Drin: Dran/Drin, lumit që derdhet e kalon në ato vise. Breshka është një frymor i ndërmjetëm, një figurë mitologjike popullore, nga autori është përzgjedhur këtu si heroinë pozitive, si përfaqësim i pavetëdijes kolektive, por e bërë e vetëdijshme nëpërmjet veprës artistike, ajo nuk është përfaqësuese vetëm për Camajn, por për tërë banorët e viseve të vendlindjes së tij, mbi lumin Drin, pllaja dhe kodrinat e Temalit, pjesë e Dukagjinit. Autori me vetëdijen e tij e përpunon dhe shkruan fatin e saj, historinë e Dranjas, Monalizës camajane, si alterego, duke e kanalizuar energjinë krijuese drejt simbolikës së saj dhe duke e trajtuar si heroinë të veprës së vet artistike, në madrigal të një lloji "camajan", pra prozë poetike. Hans Joakim Lanksch, studiuesi i zellitë i Martinit, tek kujtimet e tij shkruan se: "Në dhomën e tij të punës, në tryezën e tij të shkrimit kishte një koleksion të madh breshkash.ku thekson ndjeshmërinë e tyre të hollë me të cilën i parandjen shkundullimat. Deri diku me natyrën e tij

paqësore që nuk ishte në gjendje me ia ba ndonjit keqe kurrkuj, me një rrasht të fortë që mbron ndjeshmëninë e tij të jashtëzakonshme lëndimesh nga jasht, njeriu Camaj i ngjante kafshës së tij të preferume, breshkës."(Lanksch, 2006, fq.243) Madrigali është lloji i prozës poetike, i pari i lëvruar mjeshtërisht në letërsinë tonë nga Camaj. Camaj është inspiruar me figurat mitologjike, breshka, gjarpri, figura të cilat, sipas psikologut Carl Gustav Jung, ekzistojnë në pavetëdijen kolektive(të fisit), ku breshka në këtë rast, figurë simbolike, është përfaqësuese e rrëfimit të besimit (simvolon=rrëfim i besimit), figura alegorizuese që përpunohen me mjeshtëri të një fantazie krijuese me anë të një retorike tejet origjinale të koinës të gegënishtes në këtë vepër. Vetë Camaj thotë për përzgjedhjen e simbolit si mjet kryesor thotë se, marrja e simbolit si mjet përçues idesh është vetë semiotika.(Alimani,2006, fq. 262-267) Ardian Klosi në studimin e tij serioz për veprën që po shqyrtojmë thekson:"Dranja është me të vërtetë një himn për shqipen e veriut, për sensualitetin e tingujve të saj prej guri, diçka e ngjashme me himnet e poetëve Elitis, Seferis për greqishten e tyre dhe sensualitetin e tingujve të detit, kësaj gjuhe poeti i gëzohet si fëmijë, sepse ajo i jep mundësi të jetojë edhe një herë jetën e humbur në viset përmbi Drin, gjithë aromën e fëmijërisë, rinisë,të shohë edhe një herë të gjithë ngjyrat që digjen në ajër, t'i shkelë edhe një herë ato anë jo vetëm në hapësirë, por edhe në kohë...."(Klosi, 1996,fq. 36-37) Breshka në veprën e Camajt, fiton dhe "vesh" një kuptim të ri simbolik, një përpunim emblemantik të psikologjisë së banorëve mbi lumin Drin. Në dilemën e madhe timen për ta kanalizuar Dranjan dhe simbolikën e saj si burim mitologjik arkaik apo klasik, i mëshoj me shumë drejtimit arkaik dhe pagan të besimit popullor të trevës, psikikës të së cilës, i referohet autori dhe pikërisht, ky është dhe qëllimi ideoartistik i tij, të artistikojë kodin nëpërmjet rikodifikimit të totemit, simbolit të parëve të tij me anë të kësaj vepre të veçantë për letërsinë shqiptare. Dranja jep në shtyllat kryesore përmbajtësore me anë të stilit idilik, romantik: patriotizmin, kujtimet e fëmijërisë dhe rinisë të vetë autorit, blatimit të një idhulli siç është atdheu dhe një dashurie të përzjarrtë për të. Primo Shllaku në studimin e tij për Camajn shkruan: "Vegimi i Camajt asht dinamik, ikanak. Për një çast kujtesa e Martinit banon dhe diku tjetër. Ligji universal i kohës dhe hapsirës rrëzohet. I njëjti send ndodhet njëkohësisht në dy vende: në letër e në pasqyrat e poetit."(Shllaku, 2006, fq.105) Një nga armët artistike të poetit është edhe thyerja e ligjeve të kohës së hapësirës dhe vendit, Martini nuk është fizikisht në Temal, por është aty mendërisht, kujtesa

punon, mbresa për visin është e fuqishme, ajo thërret kudo që Martini shkon dhe ajo thirrja e saj bëhet aq e fortë, sa koka kthen gjithnjë mbrapa atje mbi Drin, sa energjia e simbolit tek breshka shkon për të realizuar ëndrrën, dëshirën, mallin, kënaq dëshirën e bëhet qëllim në vete për t'u "derdhë" si vepër arti.

Breshka, dhe totemistika arketipike

Në studim do të vrojtohen dhe hulumutohen paralelizma sipas dy shtyllave kryesore :

a.tiparet e breshkës, ato fiziologjike,temperamenti (në pamje të parë biologjike, por për nga rëndësia shkojnë përtej....)b.modelet e sjelljes, zberthimi i simbolit, rikodifikimi i mitit arkaik duke bërë lidhjen se pse, kur breshkës i mprehen shqisat, ajo është quajtur nga banorët që jetojnë mbi Drin "tharm toke dhe ora e gurit"?

Breshkën, si figurë në mitologjinë tonë popullore, vetë autori e zberthen në vepër në hyrje, e cila në përralla të tjera ka nam të keq. Breshka quhet ndryshe "pula dreqit", shpjegon autori "me shtrigën kaluer mbi shpinë", (Camaj,1996, fq.64)...por edhe mosmikpritëse ndaj miqve. Në vepër na intereson për të ndriçuar tezën studimore të lokalizojmë vetitë e breshkës, të cilat janë tipare të ngjashme me njerëzit (fisin) dhe se si breshka përbën besim ndaj saj nga Camaj dhe banorët mbi lumin Drin, vendlindjen e autorit si dhe rrethanat e këtyre odiseve(të breshkës dhe Camajt), të ngjashme. Më sipër lexuam "tharm toke dhe orë guri", breshka në mitologjinë shqiptare konsiderohet si ndjellëse e shiut, pra uji është jeta e dheut, ku banon breshka, orë guri, pasi zhguallin e shpjeguam si ngjashmëri metonimike me gurët e mëmëdheut, fortesën, kullën, kalanë, shtëpinë, kodrinën, malin, por dhe pazgjidhshmërisht lahutën. Vetë hija e saj në diell, për të cilën aludon autori, sipas mendimit tim, është simbolizim i formës së malit të Temalit, visoreve aty ku derdhet Drini, e transmeton imazhin e ruajtjes, konservimit të dheut për pasojë i ndjenjave të forta për atdheun, për këdo që largohet nga trolli i vet, do ta ketë ndonjë breshkë që thërret si orë bjeshkësh, dheu e guri. Jungu teksa flet për arketipet shkruan;"....është plotësisht e drejtë të flasim për modelin e mënyrës së sjelljes, si një gjurmë arkaike akoma ekzistuese brenda nesh."(Jung, 2002, fq.125) Kështu modelet e mënyrës së sjelljes së breshkës, janë edhe gjurmët etnike që autori i sheh tek vetja, tek "fisi i panjoftun", prandaj dhe ai bashkë me fisin kanë përdorur kafkullin e saj për lahutat e tyre, e kjo është filozofia e çdo totemi mitik e në fakt, Camaj e ngriti breshkën në pedestalin e një miti.....: "...roje frymëmirë e dheut të rrëpijtë pranë Lumit të madh,

prore në naltësinë e shputës, kudo që shkova.”(Camaj, 1996, fq.14) Klosi për identifikimin e autorit me heroinën thotë: "Dranja ka në thelb një gjetje gjeniale: breshka në qendër të saj nga objekt vrojtimi kthehet në objekt identifikimi dhe subjekt poetik: veti të saj si papërsosmëria, lidhja e lashtë me dheun, sensualizmi, ndershmëria, naiviteti, mirësia, pacifizmi, deheroikja, ankthi ndaj botës së akullt janë njëkohësisht mishërim i vetive të poetit."(Klosi, 1996, fq.37) Breshka është cilësuar nga Camaj "e papërsosun", është e përzgjedhura ndër kafshë, pasi ajo jeton edhe nën dhe', siç e përmendëm edhe më sipër, pra "dhease", autoktone e atyre viseve. Shllaku thotë : "Zhgualli i Dranjes që bahet subjekti i madrigaleve të fundit mbas vdekjes së breshkës, sjell idenë e autoktonisë dhe të tanësisë së atyne konotacioneve që përbajnë psikosintezën shqiptare diku në shekullin e fundit të zhvillimeve divergjente e në prag të një epoke që projektohet si ajo e integriteteve dhe e globalizimit."(Shllaku, 2006, fq.39) Madrigali "Në tempullin e Afroditës", ku flitet për "rrënojat e kulturës dorike", "tempull zoteshe", ka një figurë breshke në "iterin e flijimeve", arketipi është aty në tempull, ngjashmëritë përkohë se ajo është "dhease", vendase. Do doja të ndalesha me shumë kënaqësi në këtë madrigal ku, tregohet se, simboli breshkës është i pranishëm në kulturën pagane dhe në rrënojat e periudhës dorike, stile arkitekturore që vërehen edhe tek ilirët, ashtu si tek grekët e lashtë, sërish tempulli i Afroditës, mitologjia greke dhe ajo e ilirëve përkohë ngjashmëritë dhe analogjitë e tyre. Gjithashtu në këtë rrëfim, duken qartë kuptimet dhe nocionet e vdekjes, thanatosit, ceremonitë tipike ballkanike shqiptare të varrimit(kafet e idhta), por edhe të rilindjes. Tek "Një gropëz për një drandofille", shikojmë një varg homerian gati dramatik, camajan, që të kujton betejat e Akilit me Hektorin : "Njëra si me qen tue më nxjerrë dikush mun prej parzmit kuptimin e vdekjes ." (Camaj, 1996, fq.19) Edhe tek "Murimi", një nga legjendat më të hershme shqiptare, Camaj vë breshkanin, të shoqin e breshkës si flijë: "Asht doke e lashtë me ther një berr e koka t'i ndryhet posa e preme në mur përndryshe shtëpia vështirë se qëndron në kambë." (Camaj, 1996, fq.57)

Projektimi i arketipit të fisit, në mit

Cili është korrelacioni interesant mistik, i Camajt, kodi i të cilit po mundohemi të zbërthejmë dhe të gjejmë zgjidhjen e ekuacionit? Është lidhja e ngjashmërisë, se përse banorët i besojnë asaj, breshkës, shikojnë tek ajo modele sjelljeje dhe mënyrës së tyre të jetuarit, zakonet, një analogji. Më ndihmoi për këtë edhe Jungu, kur shpjegon modelet e sjelljes dhe arketipet : "Në fakt nuk ka instikte

amorfë, pasi çdo instikt bart në vete modelin e situatës së tij, përmbush gjithmonë një imazh të caktuar, që zotëron nga ana e vet krejtësisht cilësi të caktuara. Psh. Instikti i milingonës, që bren, copëton gjethen, përkon me imazhin e milingonës, pemës, gjethes, prerjes, transportit dhe kalasë së vogël të milingonës. Njëri nga këto kushte të ndërpritet, ndërpritet instikti, nuk funksionon. E njëjta gjë ndodh edhe me njeriun, edhe ai zotëron në vetvete këto tipare, instikte apriori, që sigurojnë modelin e sjelljes dhe aktivitetin e tij."(Jung, 2012, fq.12) Bëra këtë lidhje me Jungun, pasi breshkën këtu e shoh si arketip, (arketipi, pasardhëse e dinosaurve, familja reptile) i cili ndihmon për të integruar personalitetin, si model "fosil", pasi në zinxhirin e kafshëve ngeli e ndërmjetme, "e papërsosun", e cila me instiktet e saj karakteristike(jeton nën dhe', zhgualli prej guri, simbol i qëndresës së malësorit, nuk bën miqësi lehtë me çdokënd, urtësia, deheroikja, e përçmuara ashtu si malësori, i cili shpesh shihet si qenie per t 'u vënë në muze, përçmimi ndaj breshkës, si krijesë e ndërmjetme, e papërsosun, po ashtu dhe malësori, i cili nuk "përsos" gjuhën, përmbush një imazh të caktuar totemik, po ashtu si dhe vetë autori si dhe fisi prej nga e ka origjinën ai. Sinani shpjegon shenjën e breshkës, kodin e saj në librin e tij prurës për Camajn: "Pjesa aksiomatike dhe pjesa e teoremës, kjo ka të bëjë me raportin tekst i shqiptuar (eksplicit)-tekst i fshehur (implicit) nëse do t'u përmbahemi termave të vetë autorit. Tek breshka, me vetëdije autori ka brendësuar funksionet e një totemi etnik."(Sinani, 2011, fq.225) Tek parimi i "Fisit të panjoftun", Camaj simbolizon temperamentin e fisit, shprehur në kolore artistike, këtu tentojmë të them se i afrohem edhe kanunit, breshka mishëron sjellje kanunore, edhe pse të duket çudi, por në fakt thëllë në tipare të saj shikoj ngjashmëri me sjelljet dhe natyrën e malësorit, prandaj dhe është përzgjedhur si totemi i preferuar nga Camaj. Kështu, Jungu tek flet për trashëgiminë e paraardhësve thotë "Mendja si një parim aktiv në trashëgimi, shfaqet kështu si shumë e mendjeve të paraardhësve, e atyre baballarëve të padukshëm", autoriteti i të cilëve lind rishtazi bashkë me fëmijën."(Jung, 2002, fq. 67-71) Camaj ka të projektuar në mendjen e tij modelet e babait, gjyshit, fisit: "Me qenë gur i latuem përgjysëm për mos me hy kurrë në shtylla madhështore për të mëkambë ndonjë tempull dhe fjala e tij vetëm tingull ndër dhambë të thyem, por të mos lanë kund hije në rrasë, as në pergamen."(Camaj, 1996, fq.20) Fisi simbolizohet me gurin e "latuem përgjysëm", (sërish bëj analogji me gur/ zhguall breshke, dhe përgjysëm/të ndërmjetëm), duke qëndruar vetëm

në ato vise, larg nga qytetërimi dhe dukuritë e tij me ndryshimet të rrethanave, kështu fisi ruan me fanatizëm gjuhën, dialektin e vet original verior geg, ashtu siç ia kanë lënë të parët, stërgjyshërit e tyre.

Odise të përbashkëta

Prëfhehet një odise, një udhëtim, ose më saktë janë në fakt dy të tillë paralele, që shpesh kryqëzohen, ku heronjtë e seicilës janë breshka "Dranje" dhe udhëtimi i autorit larg atdheut, i cili jo rrallëherë, e përdor breshkën për të hyrë në "lëkurën" dhe të fatit të saj. Kuptohet se udhëtimi i frymorit, imagjinohet dhe kompozohet si fabul e çuditshme dhe e veçantë në këtë mënyrë jo pa qëllim, dhe ky përbën dhe qëllimin ideoartistik të Camajt. Floresha Dado thotë në teorinë e saj për Dranjan: "Kjo mënyrë konceptimi të subjektit me disa shtresa buron në thelb nga kompozimi alegorik, gjithë përmbajtja e veprës, nga një strukturim original, i cili nuk përfill sa duhet renditjen e zakonshme me raportet kronologjike apo shkaktasojë të episodeve." (Dado, 2003, fq.130) Mendoj se, bëhet fjalë për kohën kur Camaj shkon për studime në Beograd, Itali dhe përfundimisht në landin e Bavarisë, Gjermani, ndërsa Dranja eksploron paralelisht relieve të reja. Cilësorët "frymor i ndërmjetëm" dhe "i papërsosun", mendoj se janë janë plotësisht të njëri-tjetrit, autori i shpreh me vetëdije të plotë vetitë reale pozitive të Dranjes. Këto veti duan të thonë se, ajo nuk ndryshon kollaj autencitetin e vet, natyrën origjinale, prejardhjen, zakonet e veta kahmoti, dhe mesazhi është i qartë : kudo që udhëton malësori si dhe Camaj, biri i Temalit, Dukagjinit, ai e ka shumë të vështirë të metamorfozohet, pasi thelbi mbetet i njëjtë dhe do të trashëgohen breznit mbas breznie vlerat etnologjike, ashtu si Dranja, e cila është e patjetërsueshme. Një arësye tjetër që argumenton përse banorët përdorin kafkullin e breshkës, si hajmali, dhe përfaqësohen sipas kodifikimit të Camajt me mitin e breshkës është se, breshka transmeton urtësi, stoicizëm, e mbajtje fjale(besë), sipas përshkrimit të natyrës së saj. Ndërsa për sa i përket termit "i papërsosun", doja të thoja se këtu jemi në simbolikë e semiotikë, ku na çon tek tipari i kompleksit inferior të personalitetit të autorit, deheroizmi. Breshka, besoj e keni kuptuar se është gjallesë e butë, e urtë dhe shumë stoike nga natyra, simbol i edukimit me virtyte paqësore siç e vë re autori me syun e vet studiues të sjelljeve të saj : "...janë shlye edhe në mue plot vese si paduresa e vrulle irluese të paprituna." (Camaj, 1996, fq.36) Do ta lexoja këtë ndjenjë inferioriteti tek Camaj edhe si një si një zhgënjim, një nënvlerësim që iu bë jo vetëm atij, po vetë dialektit geg, mohimeve jo vetëm ndaj formave, por dhe ideve letrare e shumë

shkrimtarëve të tjerë nga veriu në atë kohë. Tek madrigali "Udha e breshkave" jepet koha e vështirë, vuajtja, dhimbja, drama, tragjika që përjetoi autori dhe shumë artistë si ai: "...me besimin e ngultë të gdhendun në asht, se kurrë nuk do t'u humbas raca." (Camaj, 1996, fq. 62) Jung thotë: Çdo përparim në kulturë është psikologjikisht një rritje e vetëdijes që mund të ndodhë vetëm nëpërmjet diskriminimit. Prandaj përparimi fillon me individin, që do të thotë me individualizmin, vetëdije e izolimit të tij, duke hapur një rrugë të re përmes një territori deri tash të pashkelur." (Jung, 2002, fq.75) Ndërsa Shllaku e sheh breshkën si "...metonimi të fatit të njeriut shqiptar dhe rikodifikim të shenjës tradicionale të trashëgimisë shpirtërore të popullit të tij duke bartur funksione totemistike rituale dhe magjike nga simboli i gatshëm te simboli që krijon ai vetë. Zhvendosja bëhet duke ruajtur të njëjtën shkallë sekretimi si në traditën popullore prej breshkës - gjarpër." (Shllaku, 2006, fq. 241)

Metamorfozë a jo ???

Në madrigalin "Në vapën e ditës ", "Dranja" dhe Camaj gjenden në të njëjtin vend, pas një udhëtimi në "dhena të hueja" tashmë me përvoja të reja dhe shqisat janë mprehur nga rrethana të tjera, por më të fortë se dikur : "...ndëgjoni si gungallat e digjonin kohën tonë pa dhimbë..." (Camaj, 1996, fq. 68) Në rastet kur breshka tenton prej halli të përshtatet "n'dhena të tjera", ajo dëmton veten fiziologjikisht dhe psikologjikisht, kjo përcjell edhe një herë idenë e mosndryshimit, idenë e natyrës gjysëm "të latueme", siç shprehet Camaj. Infiltrimi i simbolit dhe imazheve që ai prodhon me anë të energjisë pozitive, jepet edhe në marrëdhënien me figurën tjetër mitike, gjarpurin. Tiparet e individualitetit shqiptar, siç janë edhe figurat e mitologjisë popullore i japin origjinalitetin, ilir e ballkanas "Dranjas". Në rrëfimin e të riut malësor në fillim të veprës : "...rrashtën e breshkës e mbi atë gjarpurin dredha-dredha, gjithçka të bamun gur! Mirë –thanë ata-ne e dimë qëmoti se nëma e Orëve ndrron në shkamb çdo gja edhe bariun me tufë përpara, po puna asht: Si erdhi breshka deri këtu, kaq nalt? Breshka –tha ai- e pruni deri në shpinë gjarpurin. Shikoni si janë të ngrimë më një si të mos ishin dy frymorë, si pela ime, Dranja, e un mbi të kaluer." (Camaj, 1996, fq.12) Arshi Pipa tek parathënia interesante për "Dranjan" në lidhje me fosilin e gjetur nga malësori, gjarpri është e shprehur ndaj breshkës, pra sipas tij është : "...ikonë e marrëdhënies seksuale. Gjarpri që i ngjitet breshkës të kujton Evën që joshet nga djalli. Miti biblik është dhënë në një version natyralist, i afërm me kultin pagan të malësorëve, për diellin në pamjen e gjarpurit totemistik." (Pipa, 2012) Por në këtë rast, breshka

me gjarprin janë bërë njësh, në një afrimetet idilik. Në fakt, edhe breshka e ujit ka një ngjashmëri shumë të madhe me gjarprin, nga forma e kokës, pra ata bashkohen në një marrëdhënie intime në këtë madrigal hyrës. Sinani teksa bën krahasimin me totemin e gjarprit shpjegon analogjitë: "Ashtu si totemi i vërtetë breshka njih dy stinë dhe ka dy jetë: nëntokë dhe mbitorë. Ashtu si totemi i vërtetë " ama e votrës mbrojtësi i fatit të kullës, breshka është reptile që riprodhohet me vezë. Ashtu si totemi i vërtetë, breshka ka dhe kushurirën e vet të ujit ." (Sinani, 2011, fq.230) Në fakt, breshka është gjithnjë e mbrojtur nga çdo armik nga zhgualli, apo rrashta, siç i thonë në nëndialektin e Camajt. Martini kujton për visin e egër : "Prej përjetimeve atje mbas të 7-tit vjet deri në të dhjetin më kujtohej prekja e gjarprit të fshehën në fier, ndjesi e të ftohtit të një lëkure të lëmuet. Mandej më çuen në shkollë, pasi më kishte hy në palcë kjo ndjenjë." (Alimani, 2006, fq. 273) Kur takohen breshka me gjarprin tek madriali "Mes stinëve si Vena" jepet një vërvitje e gjarprit për t'iu afruar, sulmuar, por breshka ka sensorë mjaftueshëm për të parandjerë rrezikun. Breshka injoron gjarprin në këtë madrigal duke jashtëqitë mbi të: " I bani lak tue ardhë rreth vetes si tanks dhe kur breva i shkoi për shteg, ia derdhi, mbarë qelbësinë e barkut të vet mbi krye". Simboli, sipas psikoanalistit Jung, në "Mbi psikikën njerëzore ", jepet si një proces burimi energjie, i cili prodhon dhe provokon ndjesi estetike, duke na transmetuar emocionet e së bukurës. Po të merreshim me rrëfimin e fatit të një breshke të thjeshtë, Dranja do të dukej si një përrallë fëmijësh, dhe Camaj si një kronikan i rëndomtë, i cili po përdor një breshkë për të treguar fatin e tij, në një ditar dhe deri këtu leximi do të ishte shumë i thjeshtë. Duke shpjeguar simbolikën dhe imazhet që ajo jep përtej breshkës së zakonshme që ju ka rastisur të shihni, veli mistik e kthen atë gati në totem. Mesazhet janë padyshim edhe te trashëgimia e zakoneve, dokeve, etnisë dhe madje edhe tek Kanuni i Lekë Dukagjinit, i cili

ravijëzohet lehtë dhe tërthorazi me kodet e tij, për natyrën e malësorit, janë norma që lëvrijnë ndër deje, të cilat nuk zhduken, apo denatyrohen, breshka e malit as nuk e merr mundimin të ndryshojë, të përsoset (Dranja është frymor i ndërmjetëm dhe nuk ndryshon për përmirësim edhe pas përvojave në dhena të reja, ndërsa Camaj po, ky është dhe ndryshimi ndër syresh). Pandryshueshmëria, konservatorizmi fanatik qëndon edhe tek forma, tek gjuha, dialekti verior dhe i krahinës mbi lumin Drin. Francesco Solano për "Dranjan" shkruan: "Domethënë se është aq i njësuar gjuha me mendimin, sa është vështirë ta shprehësh në gjuhë tjetër." "Dranja", është një visar i pashtershëm, e shkruajtur në dialektin geg, besnik ndaj të cilit Camaj i qëndroi në natyralitetin më të madh të mundshëm të koinesë e gegërishtes dhe nëndialektit në të gjitha planet e gjuhës : fonetike, sintaksë, morfologji, leksikologji. Estetika e gjuhës ' ka të sosur sidomos me leksikon e pasur, me fjalë të tëra origjinale, autentike të dialektit. Disa fjalë origjinale nuk gjenden as në shqipen zyrtare, ku disa ndër syresh janë edhe të dialektit të zonës, vendlindjes së autorit. Në madrigale nuk ka dialog në përgjithësi dhe mbizotëron stili i përshkrimit idilik, e rrëfimi është baza, ku shpesh ka edhe analizë psikologjike. Një tipar të thurjes artistike të një gjuhe origjinale e përbën të shkruajturit në dialektin e të parëve geg, një visar dhe arsenal i tërë i një fjalori të pasur të koinesë së veriut, kjo i jep autencitet dhe e bën Dranjan akoma më shumë kryevepër të Camajt. Shllaku për gjuhën thotë : "Poezia e tij do të fitojë një fluiditet e një sublimitet, ku kasnecët e mesazheve do të jenë ma tepër shenjat sesa kuptimet e verbit të tij poetik." (Shllaku, 2006, fq.192) Tek "Parandjenjë largimi" duket përroi i ndërgjegjes, ku jepet një moment i vështirë, ku vetë autori jep nota trishtimi ikjeje, largimi nga vendlindja dhe notat nostalgjike, malli jepen : "Vetëdija është një shkëputje e dhemb si ndamja e mishit prej ashtit."

Bibliografia

- Alimani, F, MehrLicht, nr.29,nëntor 2006, "50 pyetje prof.dr.Martin Camajt",fq.262-272
 Camaj. M, Fan Noli, Tiranë 1996, "Dranja", fq.17
 Dado. F, SHBLU, Tiranë 2003,"Teoria e veprës letrare, Poetika" fq.130
 Jung. C.G, Plejad, Tiranë 2002, 'Mbi psikikën njerëzore', fq.125
 Klosi. A, Fan Noli, Tiranë 1996,"Vepra 1", Parathënia, fq.36-37
 Lanksch. H.J, MehrLicht,nr.29,Nëntor 2006,"Kujtime për Camajn" fq.243
 Shllaku. P, Gjergj Fishta,Tiranë 2006, "Nji Uliks që s 'u kthye kurrë në Itakë", fq.39
 Shllaku. P, MehrLicht, Tiranë 2006, nr.29,nëntor 2006,fq.105
 Sinani. Sh, Q.S.A, Tiranë 2011, "Camaj i paskajuar" fq.230

METODIKË, PSIKOLOGJI, SOCIOLOGJI

NDARJA E OBJEKTIVAVE DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT ME NXËNËSIT: SI FAKTORË MOTIVUES NË PËRVETËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

ANITA MUHO

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Përmbledhje

Ky studim synon të trajtojë ndarjen e objektivave mësimore dhe kriterëve të vlerësimit me nxënësit me qëllim nxitjen e motivimit të tyre. Së pari kemi përzgjedhur të trajtojmë objektivat mësimore dhe kriteret e vlerësimit si koncepte, duke nxjerr në pah rëndësinë e tyre gjatë procesit mësimor dhe vlerësimit në veçanti. Shqyrtimi i literaturës përkatëse do të na ndihmojë të krijojmë sfondin teorik të këtij studimi, i cili do të evidentojë edhe variablat përkatëse të ndarjes së objektivave mësimore, kriterëve të vlerësimit dhe motivimit për të nxënë. Në pjesën e dytë, do të trajtojmë metodologjinë e përdorur në këtë studim, e cila do të përgjigjet pyetjeve kërkimore, të cilat janë: 1) Si ndikon ndarja e objektivave mësimore në motivimin e nxënësve? 2) Si ndikon ndarja e kriterëve të vlerësimit në motivimin e nxënësve? 3) Si të nxitim motivimin për të nxënë tek nxënësit? Në këtë studim janë përdorur metodat sasore të kërkimit, të cilat do të mbledhin dhe do të përpunojnë të dhënat e mbledhura, për të arritur në konkluzionet e këtij studimi. Pjesa e tretë do të përmbajë rekomandime në lidhje me rezultatet e këtij studimi, të cilat do t'i vijjnë në ndihmë mësuesve gjatë mësimdhënies.

Fjalët kyçe: ndarja, objektivat, kriteret, vlerësimi, motivimi, nxënë.

Abstract

This study aims to identify the importance of sharing the learning targets and assessment criteria with students in order to foster their motivation. Firstly, we have chosen to deal with learning targets and assessment criteria as concepts, highlighting their importance in the learning and assessment process. The literature review will help us to identify the theoretical background of this study, which will identify the relevant variables of learning targets, assessment criteria and motivation to learn. Secondly, the methodology which consists in quantitative methods of research will try to answer the research questions of this study: 1) How does sharing the learning targets with students influence their motivation to learn? 2) How does sharing the assessment criteria with students influence their motivation to learn? 3) How to foster student motivation to learn? Finally, the last part will give recommendations regarding the results of this study, which will help second language teachers in their teaching process

Key words: sharing, targets, criteria, assessment, motivation, student.

HYRJE

Nxitja e motivimit për të nxënë është një çështje shqetësuese për mësuesit dhe studiuesit. Në Shqipëri, mësuesit ndeshen çdo ditë me një nivel të ulët të motivimit të nxënësve. Nxënësit tregojnë rënie të interesit dhe si rrjedhojë vështirësi në nxënie.

Ky studim do të trajtojë ndarjen e objektivave mësimore dhe kriterëve të vlerësimit si faktorë, të cilët nxisin motivimin e nxënësve gjatë përvetësimit të gjuhës së dytë. Sipas Gregory et al, (1997), bashkëpunimi në zhvillimin e kriterëve i ndihmon nxënësit dhe mësuesit të arrijnë një kuptim të përbashkët të kriterëve në bazë të së cilave do të gjykohet performanca e tyre.

Duke përfshirë drejtpërdrejtë nxënësit në zhvillimin e kriterëve, mësuesit i ndihmojnë ata të thellojnë të kuptuarit drejt suksesit.

Kur nxënësit kuptojnë kriteret me të cilat puna e tyre do të vlerësohet, ata gjithashtu e kanë nën kontroll atë dhe janë të gatshëm të jenë vetë-organizatorë strategjikë të të nxënës, por duhet që nxënësit njëkohësisht të kuptojnë objektivat e të

nxënësit dhe kriteret e vlerësimit për të nxitur vetë-efikasitetin dhe vetë-organizimin e të nxënësit.

2. Sfondi teorik

2.1. Ndarja e objektivave mësimore me nxënësit

Vlerësimi është më efektiv kur nxënësit kanë të qartë se çfarë mësuesit presin prej tyre. Stiggins (2005, 2007), vë në dukje se kur nxënësit kanë objektiva të qarta mësimore dhe modele të punës së mire apo të dobët, kur feedback-u është i vazhdueshëm, ata kanë një bazë që i ndihmon të kuptojnë se çfarë po mësojnë, si të përcaktojnë objektivat dhe si të vetë vlerësohen. Këto praktika formuese të vlerësimit inkurajojnë nxënësit dhe u japin atyre një ndjenjë më të madhe përgjegjësie në aktivitetet mësimore. Nxënësit mund të vendosin standarde apo pritshmërinë e tyre të një pune të mirë, (Bruce 2001).

Mësuesit mund të përmirësojnë qartësinë e objektivave mësimore duke ofruar shembuj të punës së dobët dhe asaj cilësore, (Sadler 1989; Chappuis 2005; Stiggins 2008). Shembujt janë të rëndësishëm, pasi u mundësojnë nxënësve të kuptojnë ku ata

duhet të arrijnë dhe përse mësuesit u japin feedback.

Nga një këndvështrim i zotërimit të qëllimit, objektivat mësimore u mundësojnë nxënësve të përcaktojnë objektivat e punës së tyre, të cilat fokusohen në arritjen e standardeve të të nxënësve, në krahasim me qëllimin e performancës, e cila përqendrohet në mënyrën se si ata krahasohen me nxënësit e tjerë. Evidentimi i objektivave mësimore përmirëson motivimin e brendshëm të nxënësve, i cili kur kombinohet me praktikën e tjera të vlerësimit formues, gjithashtu mbështet zotërimin e objektivave. Procesi i të nxënësve është më i lehtë kur nxënësit kuptojnë se çfarë objektivi ata po përpiqen të arrijnë, arsyen e arritjes së objektivit dhe atributet specifike të suksesit, (Chappuis & Stiggins, 2002)

Shumë mësues të cilët janë përpjekur të zhvillojnë aftësitë e vetë-vlerësimit tek nxënësit kanë gjetur se detyra e parë dhe më e vështirë është, tu mundësojnë nxënësve të mendojnë për punën e tyre në drejtim të objektivave, (Black et al, 2004)

Objektivat mësimore dhe kriteret e suksesit janë pjesë kritike e informacionit për nxënësit për të qenë të suksesshëm. Hattie dhe Timperley (2007) evidentojnë tri pyetje që udhëheqin të nxënësit:

- Ku duhet të arrij?
- Si po eci ?
- Ku do të shkoj më pas ?

2.2 Ndarja e kriterëve të vlerësimit me nxënësit

Kriteret e vlerësimit janë karakteristika apotribute të punës së nxënësve që tregojnë shkallën në të cilën ai ka arritur pritshmërinë. Kriteret e suksesit përshkruajnë karakteristikat apotribute në një mënyrë të kuptueshme për nxënësit. Në vlerësimin e cilësisë së punës apo të performancës së nxënësve, mësuesit duhet të zotërojnë një koncept të cilësisë së duhur për detyrën dhe të gjykojnë punën e nxënësve në lidhje me këtë koncept, (Sadler, 1989) .

Së pari, kur nxënësit marrin pjesë në zhvillimin e kriterëve, ata kuptojnë më mirë çfarë pritet prej tyre për të kryer detyrën me sukses. *Së dyti*, nëse nxënësit janë në gjendje të përdorin kriteret për t'u vetë-vlerësuar dhe përmirësuar procesin e të nxënësve, ata duhet të kuptojnë qartë kriteret. Në fakt, sa më shumë ata ndajnë një kuptim të përbashkët të kriterëve me mësuesin, aq më të aftë janë ata për të monitoruar dhe drejtuar të mësuarit, (Gregory, Cameron, & Davies, 1997).

Arter dhe Spandel, (1992) gjithashtu theksojnë se zhvillimi i kriterëve i fton nxënësit të ndajnë idetë e tyre fillestare dhe të kuptuarit në lidhje me

karakteristikat e performancës së suksesshme. Në vazhdimësi, mësuesit udhëzojnë nxënësit në eksplorimin dhe rafinimin e të kuptuarit të kriterëve dhe vazhdimisht të reflektojnë dhe të zbatojnë kriteret, si pjesë e aktiviteteve mësimore. Si rrjedhojë nxënësit arrijnë të dallojnë performancën cilësore, të identifikojnë problematikat në performancën e dobët dhe të përdorin kriteret për të ndryshuar dhe përmirësuar performancën.

Nicol dhe MacFarlane-Dick (2006) argumentojnë, se nxënësit kanë nevojë të ndihmohen të kuptojnë se cilat janë objektivat mësimore, të kuptojnë kriteret e përdorur për të vlerësuar punën e tyre. Pra, një praktikë e mirë në kriteret e vlerësimit do të thotë kriteret e qarta vlerësimi dhe të kuptueshme për nxënësit. Krahas kësaj, Sadler (2005) argumenton se kriteret e qarta dhe të pandryshueshme duhen të diskutohen me qëllim që nxënësit ti kuptojnë ato.

Nxënësit të cilët kanë një panoramë të qartë të objektivave mësimore dhe të kriterëve për sukses, kuptojnë mjaft mirë se çfarë duhet të bëjnë për të arritur këto objektiva dhe kriteret. Objektivat e qarta mësimore në mënyrë të drejtpërdrejtë drejtojnë si mësuesit dhe nxënësit drejt objektivave të tyre specifike. Nxënësit mund të përbushin objektivat vetëm nëse ata punojnë në drejtim të tyre por ata nuk mund të punojnë në drejtim të tyre nëse ata nuk kuptojnë objektivat mësimore.

Kur nxënësit kuptojnë ku ata duhet të arrijnë, ata kanë më shumë gjasa të ndjehen të suksesshëm dhe të arrijnë qëllimin. Besimi i nxënësve që ata të mund të jetë të suksesshëm në një detyrë quhet vetë-efikasitet (Bandura, 1997). Nxënësit të cilët kanë vetë-efikasitet vazhdojnë punën e tyre dhe përballen me sfida, (Pajares, 1996).

2.3. Kuptimi dhe rëndësia e motivimit për të nxënës

Termi *motivim* vjen nga rrënja e fjalës *motiv*, që do të thotë "diçka që nxit dikë të veprojë". Duke përdorur këtë rrënjë, ne mund të përcaktojmë motivimin si diçka që drejton dhe orienton sjelljen drejt një qëllimi. Një tjetër mënyrë për të shprehur këtë është se motivimi është një sjellje me një qëllim të drejtuar, i kombinuar me përpjekjet për të punuar drejt një qëllimi. Në një mënyrë shumë reale, motivimi orienton të nxënësit, i orienton nxënësit në drejtimin e duhur dhe i mban ata të angazhuar.

Motivimi është një konstrukt kompleks dhe shumë dimensional ndikimi i të cilit është si i brendshëm dhe i jashtëm, Williams dhe Burden (1997) i ndajnë komponentët e motivimit në dy kategori të mëdha: ndikime të brendshme dhe të jashtme, ku secila kategori ndahet në nënkomponentët përkatës.

2.3.1 Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm

Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm janë kushtet kyçe për të kuptuar më shumë dimensionin psikologjik të motivimit. Përkufizimet dhe përdorimi i tyre janë të lidhura me shumë elemente të tjerë të motivimit të cilët do të trajtojmë më poshtë. “I brendshëm” do të thotë diçka ekzistuese brenda nesh, e cila nuk vjen nga jashtë. Nolen dhe Nicholls (1993) përcaktuan motivimin si “një shtytje e brendshme për t’u angazhuar apo për të kryer një detyrë”, (Nolen & Nicholls, 1993, cituar në Murphy & Alexander, 2000, fq. 10).

Artelt (2005) identifikoi dy format e motivimit brendshëm, të cilat kanë në qendër individin dhe veprimin, duke provuar se “nxënësit mund të studiojnë kryesisht për shkak se ata dëshirojnë të fitojnë njohuri të caktuara, apo pasi ata janë të interesuar në një temë të veçantë”, (fq. 233-234). Deci dhe Ryan (1985) gjithashtu argumentojnë se “motivimi i brendshëm do të jetë veprues kur veprimi është përjetuar si autonomë dhe konteksti mbështetës i të nxënësit dhe vetëbesimi sigurojnë kushtet për zhvillimin e motivimit të brendshëm”, (fq. 29).

Motivim “i jashtëm” do të thotë diçka që vjen nga jashtë. Sipas Artelt (2005), motivimi i jashtëm i referohet stimujve të jashtëm të të nxënësit, bazuar në nocionin bihejviorist të përforcimit. Nëse nxënësit kanë motivim të jashtëm, ata angazhohen në një sjellje të caktuar pasi “përgjigjet e parashikuara kënaqin nevojat e tyre (nevojat kryesore), apo janë një formë e modifikuar shoqërore për të kënaqur nevojat kryesore (p.sh. prestigji-nevojë dytësore)”, (fq. 233).

Maehr dhe Stallings (1972) kanë studiuar nxënësit që kryejnë detyra të lehta dhe të vështira nën ndikimin e motivimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ata gjetën se nxënësit të cilët kishin punuar në kushte të motivimit të brendshëm vazhdonin të ishin të interesuar të punonin në detyra të vështira, ndërsa nxënësit të cilët kishin punuar në kushte të motivimit të jashtëm kishin humbur interesin e përpjekjeve drejt detyrave të vështira, duke preferuar të bënin vetëm ato më lehta, (Hughes, Sullivan & Mosley, 1985).

Condry dhe Chambers (1978) kanë gjetur se nxënësit në grupin e motivimit të jashtëm ishin më shumë të orientuar për të dhënë përgjigje të dëshiruara, ndërsa nxënësit në grupin e motivimit të brendshëm ishin të pirur të përdornin qasjet më kuptimplote për të kuptuar detyrat.

Artelt (2005) gjithashtu thekson rëndësinë e forcave të jashtme të tilla si shpërblime apo dënime. Kjo nënkupton ndikim e faktorëve të jashtëm në kontekstin shkollor. Për shembull, mësuesit janë

zakonisht ata të cilët japin shpërblime dhe ndëshkime kur shokët e klasës studiojnë dhe krahasohen me ta. Harter & Jackson (1992) konfirmojnë rëndësinë e ndikimit nga të tjerët, veçanërisht nga mësuesit, sipas tyre motivimi i jashtëm është “Orientimi, kur nxënësi është i motivuar nga dëshira për të marrë nota të larta, për të fituar miratimin e mësuesve, pra, për të përmbushur kërkesat e jashtme të sistemit shkollor”, (Harter & Jackson, 1992, cituar në Murphy & Alexander, 2000, fq. 13).

Pintrich (2003) e ndan motivimin e jashtëm në katër kategori: (a) i jashtëm, i cili kontrollohet nga të tjerët ose nga kufizimet e jashtme të tilla si shpërblimet; (b) ndikimi i të tjerëve, kontrolli perceptohet si i jashtëm pasi individi kërkon miratimin e të tjerëve; (c) identifikues, ku ka më shumë kontroll të brendshëm dhe vetë mbështetje të vlerave dhe qëllimeve; (d) integruar, i cili pasqyron kontroll të lartë të brendshëm dhe harmoni midis vetes, vlerave dhe qëllimeve”, (fq. 673).

Pintrich (2003) ka prezantuar një nocion të rëndësishëm të idesë së “vazhdimësisë” në kuptimin e motivimit të brendshëm dhe të jashtëm duke argumentuar se këta faktorë motivimi të jashtëm formojnë një vazhdimësi nga kontrolli i jashtëm te kontrolli i brendshëm dhe vetëbesimi.

3. Metodologjia

3.1 Vendndodhja dhe pjesëmarrësit

Ky studim u realizua në katër shkolla të mesme të qytetit të Durrësit dhe morën pjesë 400 nxënës të përzgjedhur në mënyrë rastësore nga katër shkollat e përzgjedhura.

3.2 Instrumenti për mbledhjen e të dhënave

Metoda e përzgjedhur për këtë studim është ajo sasiore dhe instrumenti matës i përdorur është një pyetësor me vetë raportim, i cili është plotësuar nga nxënësit e shkollave të mesme dhe përdoret për të matur ndikimin e ndarjes së objektivave mësimore dhe kritereve të vlerësimit në motivimin e nxënësve. Qëllimi i instrumentit është të mbledhë informacion sesi nxënësit e perceptojnë ndarjen e objektivave mësimore dhe kritereve të vlerësimit dhe të zbulojë ndikimin e tyre në motivimin e nxënësve gjatë përvetësimit të gjuhës së huaj.

Pyetësori përbëhet nga katër rubrika kryesore: (a) Rubrika e të dhënave të përgjithshme, (b) rubrika e ndarjes së objektivave mësimore, (c) rubrika e ndarjes së kritereve të vlerësimit dhe (d) rubrika e komponentëve të motivimit. Rubrikat e objektivave dhe kritereve të vlerësimit janë ndërtuar duke u bazuar në teoritë të ndryshme rreth ndarjes së objektivave mësimore dhe kritereve të vlerësimit, duke përdorur pyetje dikotomike dhe shkallën

Linkert të pajtueshmërisë, me 5 nivele, ndërsa rubrika e motivimit është marrë nga pyetësi i motivimit MSLQ, i ndërtuar nga Pintrich & Garcia (1991).


Pyetësi plotëson kriterin e vlefshmërisë së brendshme dhe të konstruktit. Plotëson kriterin e vlefshmërisë së brendshme pasi mbulon të gjithë karakteristikat e komponentëve të motivimit dhe plotëson kriterin e vlefshmërisë së konstruktit pasi instrumenti bazohet në teori dhe konceptime të qarta të motivimit.

3.3 Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga pyetësi u përpunuan në programin statistikor SPSS 16 për ti përgjigjur pyetjeve kërkimore.

3.3.1 Si ndikon ndarja e objektivave mësimore në motivimin e nxënësve?


Analiza e të dhënave përse i përket artikujve të rubrikës së ndikimit të ndarjes së objektivave mësimore me nxënësit në vetëbesimin dhe rregullimin e tyre dëshmuon se 40 % e nxënësve ishin plotësisht dakord me pohimin se njohja e objektivave mësimore i bën ata të pavarur në organizimin e të nxënësve, 22% ishin dakord, 18% ishin të pavendosur, ndërsa 10 % ishin pjesërisht dakord, ndërsa 6 % nuk ishin aspak dakord.



3.3.2 Si ndikon ndarja e kriterëve të vlerësimit në motivimin e nxënësve?

Pyetja e dytë kërkimore përkon me rubrikën e tretë të pyetësorit dhe rubrikën e motivimit. Analiza e të dhënave dëshmoi se 52 % e nxënësve ishin


plotësisht dakord me pohimin se njohja me kriteret e vlerësimit i bën ata pavarur dhe vetë organizatorë të të nxënësve, 32% ishin dakord, 10% ishin të pavendosur, 4 % ishin pjesërisht dakord, ndërsa 2 % nuk ishin aspak dakord.



3.3.3 Si të nxitim motivimin për të nxënë tek nxënësit?

Përsa i përket nxitjes së motivimit, nxënësit duhet ti përgjigjeshin pyetjeve në lidhje me disa mënyra vlerësimi, të cilat ndikojnë në motivimin e tyre. Analiza e të dhënave për këtë rubrikë dëshmoji se 40 % e nxënësve mendonin se feedback i mësuesit i nxit ata për të mësuar, 24% mendonin se

vetëvlerësimi i nxit ata, 20% mendonin se ndarja e objektivave dhe kriterëve të vlerësimit në fillim të mësimit i nxit ata për të mësuar më shumë, 10 % mendonin se vlerësimi i njeri tjetrit i nxishte ata për të mësuar më shumë, ndërsa 6 % mendonin se strategjia e mësuesve gjatë pyetjeve me gojë ishte një faktor nxitës për ta.



4. PËRFUNDIME

Ndarja e objektivave mësimore me nxënësit i angazhon dhe i fuqizon ata gjatë procesit të nxënies. Ata janë në gjendje të krahasojnë ku ata janë dhe ku ata duhet të arrijnë, të vendosin objektivat e punës së tyre, për të arritur objektivat mësimore, të zgjedhin strategji efektive për të arritur këto objektiva dhe të vlerësojnë dhe të organizojnë ecurinë e tyre drejt arritjes së objektivave mësimore.

Nxënësit të cilët zotërojnë të nxëniet e tyre, atribuojnë suksesin vendimeve dhe punës së tyre. Këta faktorë jo vetëm që rrisin aftësinë e nxënësve për të vlerësuar dhe për të organizuar të mësuarin por edhe nxisin motivimin e tyre për të nxënë, pasi ata e konsiderojnë veten më të sigurt dhe më të kompetentë.

Kur nxënësit kuptojnë kriteret me të cilat puna e tyre do të vlerësohet, ata gjithashtu e kanë nën kontroll atë dhe janë të gatshëm të jenë vetë-rregullatorë strategjikë. Por duhet që nxënësit njëkohësisht të kuptojnë objektivat e të nxëniet dhe kriteret e vlerësimit për të nxitur vetë-efikasitetin dhe vetë-rregullimin. Nëse nxënësit kuptojnë objektivat e të nxëniet por nuk njohin kriteret e vlerësimit, ka shumë gjasa që ata të dekurajohen.

5. REKOMANDIME

Pyetjet e mësuesve janë një strategji për të komunikuar objektivat mësimore. Strategjitë mund të jetë të thjeshta ose të përpunuara, në varësi të nxënësve dhe përmbajtjes. Ndonjëherë gjithçka që

nevojitet është që mësuesi të pyesë nxënësit nëse ata kanë pyetje në lidhje me mësimin. Pyetjet i sigurojnë mësuesit informacione në lidhje me atë që nxënësit kanë nxënë.

Një variacion i pyetjeve të thjeshta si një strategji për të komunikuar objektivat mësimore është përshkrimi nga mësuesi i objektivave mësimore dhe një detyrë ose veprimtari që ilustron atë dhe më pas t'u kërkojë nxënësve që të përsërisin atë që mësuesi tha me fjalët e tyre. Pasi të shprehurit me fjalët e tyre është një aktivitet klasik i të kuptuarit. Nxënësit do të dëshmojnë se ata e kanë kuptuar çfarë mësuesi kërkon që ata të arrijnë në fund të mësimit.

Një version pak më kompleks i kësaj strategjie është ndarja e një detyrë për dy nxënës. Mësuesi i ndan nxënësit në grupe me nga dy nxënës dhe u kërkon atyre, (1) të shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë mendojnë se do të mësojnë, (2) të argumentojnë pse ata mendojnë se është e rëndësishme, dhe (3) të lidhin objektivin mësimor me një temë të mëparshme mësimore. Në diskutimin me gjithë klasën, palët ndajnë përgjigjet e tyre dhe arrijnë një konsensus për tre pyetjet (Çfarë do të mësoni? Pse është e rëndësishme? Me cilin mësim të mëparshëm lidhet ky objektivi mësimor?) Qëllimi i pyetjes së tretë është të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se ata po ndërtojnë njohuri dhe aftësi të bazuara në njohuritë e mëparshme.

BIBLIOGRAFI

- Arter, J. A., & Spandel, V. (1992). Using portfolios of student work in instruction and assessment. *Educational Measurement: Issues and Practice*, 11, 36-44.
- Bandura, A. (1977). Self-efficacy: toward a unifying theory of behavioral change. *Psychological Review*, 84 , 191-215.
- Black, P., Harrison, C., Lee, C., Marshall, B. & Wiliam, D. (2004). Working inside the black box: assessment for learning in the classroom. *Phi Delta Kappan*, 86 (1), 9-22.
- Bruce, B. C. (2001). The Inquiry Page: A collaboratory for curricular innovation. *Learning Technology*, 3(1).
- Chappuis, S. (2005). Is formative assessment losing its meaning? . *Education Week*, 24(44), 38.
- Chappuis, S., & Stiggins, R. J. (2002). Classroom assessment for learning . *Educational Leadership*, 60(1), 40–43.
- Condry, J., & Chambers, J. (1978). *Intrinsic motivation and the process of learning*. In M. Lepper & D. Greene (Eds.). *The hidden costs of rewards* (pp. 61-84). Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, Inc.
- Deci, E. L. & Ryan, R. M. (2000). Intrinsic and extrinsic motivations: Classic definitions and new directions. , 25. *Contemporary Educational Psychology*, 54-67.
- Gregory, K., Cameron, C. & Davies, A. (1997). *Setting and Using Criteria*. Merville: BC: Connections Publishing.
- Harter, S. & Jackson, B. J. (1992). Trait vs. nontrait conceptualizations of intrinsic/extrinsic motivational orientation. *Motivation and Emotion* 16, 209–230.
- Hattie, J., & Timperley, H. (2007). The power of feedback. *Review of Educational Research*, 77.
- Maehr, M. L., & Stallings, W. M. (1972). Freedom from external evaluation. *Child Development*, 43, 177–185.
- Murphy, P. K. & Alexander, P. A. (2000). A motivated exploration of motivation terminology. *Contemporary Educational Psychology*, 25, 3-53.
- Nicol, D. J Macfarlane-Dick, D. (2006). Formative assessment and self-regulated learning: A model and seven principles of good feedback practice. . *Studies in Higher Education*, 31 (2), 199-218.
- Nolen, S. B. & Nicholls, J. G. (1993). Elementary school pupils' beliefs about practices for motivating pupils in mathematics. *British Journal of Educational Psychology*, 63, 414–430.
- Pajares, F. (1996). Self-efficacy beliefs in academic settings. *Review of Educational Research*, 66(4), 543–578.
- Pintrich, P. R. (2003). A motivational science perspective on the role of student motivation in learning and teaching contexts. *Journal of Educational Psychology*, 95 (4), 667-686.
- Sadler, D. R. (1989). Formative assessment and the design of instructional systems. *Instructional Science*, 18, 119-144.
- Stiggins, R. (2008). *Assessment Manifesto: A Call for the Development of Balance Assessment Systems*. ETS Assessment Training Institute. Portland, Oregon.
- Stiggins, R. J. (2005). From formative assessment to assessment FOR learning: a path to success in standards-based schools. 324-328.
- Williams, M. & Burden, R. (1997). *Psychology for language teachers*. Cambridge: Cambridge University Press.

LUMTURIA, PSIKOLOGJIA DHE PSIKOTERAPIA POZITIVE PËR TRAJTIMIN E DEPRESIONIT

ANDI PETRO

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PEDAGOGJISË
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Ky artikull është orientuar tek problematika e veçantë e depresionit dhe rëndësisë së lumturisë. Sot gjithmonë e më shumë po konstatojmë shenja dhe nivele në rritje të depresionit dhe ulje të shenjave dhe niveleve të lumturisë. Duke dashur t'i diagnostikojmë këto vështirësi kemi shqyrtuar disa aspekte të implikimit të lumturisë si antipolaritet i depresionit, me qëllim që të parashtrojmë një pistë analize të mëtejshme. Veçoritë dalluese të impaktit që ka psikologjia dhe psikoterapia pozitive në trajtimin e depresionit dhe në arritjen e lumturisë janë esenciale në të kuptuarit e vështirësive si dhe problemit të ngritur për shqyrtim në këtë artikull, duke bërë një paralelizëm që nga filozofia e antikitetit grek, deri te psikologjia e ditëve tona.

Fjalë çelës: *depresioni, implikimi i lumturisë, impakti i psikologjisë dhe psikoterapisë pozitive.*

Abstract

This article is oriented toward special problematic concept of depression and the importance of happiness. These days we are observing increasing signs and levels of depression and decreasing signs and levels of happiness. With the desire to diagnose these difficulties we have treated some aspects of the implication of happiness as antipolarity of depression, in order to present additional analysis. The obvious features of the impact that the psychology and the positive psychotherapy have on the treatment of depression and in the achievement of happiness are essential in understanding the difficulties and the main issue of this article, making a parallelism between the philosophies of the Greek antiquity, to the psychology of these days.

Key words: *depression, implication of happiness, impact of psychology and the positive psychotherapy.*

HYRJE

Duke hulumtuar nga antikiteti grek, evidentojmë fakte të rëndësishme përsa i përket themeleve të lumturisë dhe arsyeve që bëjnë të mundur humbjen e ekuilibrit të lumturisë, duke shkaktuar pakënaqësi tek individit dhe duke devijuar më pas te depresioni, një faktor kyç në shkaktimin e një gjendje të ngurtë që të mundon dhe kthehet në problematikë vazhdimësie. Më pas duke vazhduar me kalimin e viteve, psikologjia, një fushë e rëndësishme në trajtimin e problematikave, krijoi mundësinë e përfshirjes së një sfere të madhe mundësish trajtimi edhe për trajtimin e depresionit dhe arritjen e lumturisë së individit.

Psikologjia pozitive është katalizatori më efikas që bën të mundur evidentimin më të qartë drejt arritjes së këtij emocioni, në nivele optimale dhe praktikisht psikoterapia pozitive implikon në mënyrë të drejtpërdrejtë menaxhimin e emocioneve negative siç janë edhe ato të depresionit, duke e zëvendësuar më së miri me emocione pozitive siç janë ato të lumturisë. Kjo pikëpamje është ajo që duhet vënë në prioritet për t'u zbatuar sot në mënyrë masive, sepse përgjithësisht në vendin tonë, përdoren mënyra të tjera analoge që janë më pak efikase drejt optimalizimit.

1. Lumturia në optikën e filozofëve të antikitetit grek

Çfarë është lumturia? Kjo ka qenë dhe pa dyshim vazhdon të jetë një nga pyetjet më intriguese e cila ka shqetësuar dhe vazhdon të shqetësojë mendjet e njerëzve të thjeshtë, por edhe atyre të cilët merren me kultivimin dhe zgjerimin e kapacitetit intelektual.

1.1 Pikëpamja e Platonit për lumturinë

Platoni besonte se drejtësia është në interes të atyre që janë të drejtë. Sipas tij, drejtësia është një komponent i jetës së lumtur. Nëse virtytet ishin një mjet instrumental dhe i dobishëm i lumturisë atëherë ato mund të dështonin në arritjen drejt lumturisë në rrethana të tjera. Dikush mund të jetë i aftë për të arritur lumturinë, më thjeshtë virtytin në vetvete. *"Nëse virtyti është përbërës suprem i lumturisë atëherë dikush nuk do të jetë i lumtur pa qenë vërtetë i virtytshëm dhe dikush nuk mund të jetë i virtytshëm pa qenë i lumtur"*, (Ancient Philosophy Prof. Sally Haslanger October 25, 2004, Platon on Happiness, "The Republic's answer to Thrasyachus").

Në veprën "Republika", Platoni e ndante shpirtin në tre pjesë: arsye, shpirt dhe oreks. Ai e përcakton njeriun e drejtë si një individ i cili performon në mënyrë të natyrshme secilën prej këtyre pjesëve shpirtërore dhe ezoterike. Një person

psikologjikisht i drejtë është ai person, shpirti i të cilit është në funksionimin e duhur psikologjik. Planoni argumenton se personi i drejtë me një shpirt të drejtë ka një jetë më të lumtur se shpirti i një personi i cili nuk është i drejtë. Një person me një shpirt tërësisht të pa drejtë, një shpirt me çrregullime dhe konflikte është tërësisht në vuajtje dhe mjerim më vetveten. Kjo tregon lidhjen e Platonit midis drejtësisë psikike dhe lumturisë. Sa jemi ne të lidhur me drejtësinë sociale dhe lumturinë? Ne pranojmë që një person është më i lumtur për aq sa shpirti i tij është i drejtë dhe një person është i pa lumtur për aq sa shpirti i tij është në konflikt, ne duhet të konkludojmë se një person që vepron në përputhje me kërkesat publike të moralit do të jetë në gjendje të garantojë drejtësi psikike dhe lumturi? Platoni nuk është plotësisht i qartë mbi lidhjet midis drejtësisë sociale, psikike dhe lumturisë.

Platoni përmend disa lloje të lumturisë dhe i rendit ato në një shkallë nga më e mira te më e keqja. Secili prej nesh është i aftë të ketë një lloj të caktuar të lumturisë e cila i korrespondon tipit tonë psikologjik.

1.2 Pikëpamja e Aristotelit

Përpara se sa t'i jepte një përgjigje u mundua të bënte një diferencim të dy pyetjeve fundamentale: 1- Pyetja e tij e parë ishte "*Çfarë nënkupton lumturi ose ekuivalentja e saj siç njihet në Greqinë e lashtë Eudaimonia?*", 2- "*Ku mund të gjendet lumturi?*". Që do të thotë: çfarë është ajo që na bën ne vërtet të lumtur? Përgjigja e tij ishte: "*është e kotë të përpiqemi t'i japim një përgjigje pyetjes së dytë pa pasur një përgjigje për pyetjen e parë*".

Përkufizimi i tij ishte që lumturi është një cilësi supreme e natyrës njerëzore e cila furnizon qëllimin dhe mat vlerat e gjithë aktivitetit të qenies njerëzore, ai shkruante: "*që ne bëjmë ç'do gjë tjetër që dimë të bëjmë*", (Aristotel, 2002, fq 3). Ai mendon të kesh një plan në jetë është një formë shumë themelore dhe prioritare për njeriun, qëllimi i të cilit do të tregojë se çfarë ju do të ndërmerri për të bërë një jetë të vlefshme. Në pikëpamjen e tij, ne mund të ofrojmë "*jetë domethënëse dhe të vlefshme*". Si një mënyrë e përshtatshme e fjalës së tij "*Eudaimonia*". Ju mund të gjeni, që ndoshta të qenit i gëzuar, iu ndihmon që të fitoni lekë dhe për këtë arsye adoptoni një koncept të gëzueshëm në mendje.

Nuk mund të jemi të lumtur në qoftë se ka diçka që mungon, e cila është një ingredient themelor i vlefshëm i ekzistencës. Lumturi duhet të ketë prioritetin e pavarësisë dhe stabilitetit. Në bazë të këtyre tipareve për përkufizimin e lumturisë,

Aristoteli ishte në një pozicion për t'u marrë me pyetjen e dytë të tij: "*ku konsiston lumturi?*", çfarë version i jetës është aktualisht më shumë i vlefshëm? Ka disa dukuri në jetë si sëmundja (depresioni) dhe dhimbja të cilat bëjnë që njerëzit duan të heqin dorë nga jeta, qartësisht këto nuk na lejojnë të kemi një jetë të vlefshme. Ka gëzime dhe aventura të fëmijërisë, por këto nuk janë zgjedhjet më të dobishme të gjërave në jetë, "*askush nuk do të zgjedhë të jetë një fëmijë më shumë se një herë*", (Aristotel, "*The Philosophy of Happiness*" fq. 15). Në moshën e rritur ka gjëra të cilat ne i bëjmë vetëm si mjet për një fund si: ne shkojmë në luftë në përpjekje për të sjellë paqen.

Përkufizimi i Aristotelit derivon nga një konsideratë e funksionimit apo aktivitetit karakteristik (ergon) të qenieve njerëzore. Njeriu i mirë do të ketë një funksionim të mirë në jetë, domethënë aktivitetin e shpirtit të tij në realizimin e virtytit, (Aristotle, 2002, fq. 16). Dallimi midis tyre është në realizimin e këtyre virtyteve. Aristoteli shpjegon se ka shumë lloje të ndryshme të virtytit apo përsosmërisë: ka virtyte morale që shfaqen në jetë të tilla si: guximi dhe vetëkontrolli, ka edhe aftësi intelektuale të tilla si: zgjuarsia dhe të kuptuarit të cilat janë tipike për mendimin shkencor.

1.3 Pikëpamja Epikuriane

Për Epikurin, kënaqësia dhe lumturi është fundi final i jetës dhe kriteret e mirësisë në zgjedhje.

Kënaqësia është pika jonë e nisjes sa herë që ne zgjedhim dhe shmangim ndonjë gjë, ne realizojmë qëllimet tona duke përdorur ndjenjat si kriter nga të cilat ne gjykojmë ç'do gjë të mirë, (Diogenes Laertius, 1972, fq. 128–129).

Kjo nuk do të thotë që Epikuri bën politikën e tij për të ndjekur ç'do kënaqësi që ai ofron vetë. Nëse kënaqësia është e mira më e madhe, dhimbja është e keqja më e madhe dhe kjo është mënyra më e mirë për të arritur drejt një kënaqësie, nëse ajo do të çojë drejt një vuajtje afatgjatë. Të gjitha këto mënyra tregojnë që hedonizmi i Epikurit nuk është shumë i ngjashëm me hedonizmin si qasje e filozofisë së glorifikimit të kënaqësisë, por përkundrazi ai fut dhe ndërthur elemente më jetike dhe konotative të ekzistencës njerëzore. "*As të pirit dhe as marrëdhënia interaktive mes djemve dhe vajzave është e mjaftueshme për të prodhuar një jetë të lumtur, por serioziteti, nderi, drejtësia dhe dituria janë rrugë të mira për të shkuar drejt saj*", (Epicurus, "*The Philosophy of Happiness*", fq.18).

Epikuri prezanton një kombinim të hedonizmit teorik me asketizmin praktik duke dhënë pikëpamjen e tij për kënaqësinë si të qenurit esencialisht i kënaqur me dëshirat, dëshira më e fortë dhe fundamentale është dëshira për të larguar

dhimbjen. Prandaj mungesa e dhimbjes është një kënaqësi fundamentale. Midis dëshirave tona disa janë natyrale dhe disa janë të kota, dëshirat e natyrshme janë më të rëndësishmet për arritjen e kënaqësisë. Ne kemi dëshira natyrore për të larguar dhimbjen e urisë, të etjes dhe të ftohtit dhe kënaqësia e këtyre dëshirave është natyrisht e këndshme. Në kuadrin e termave teknike, Epikuri përmend dy lloje të ndryshme të kënaqësisë: 1- kënaqësia kinetike e shuarjes së etjes së dikujt dhe 2- kënaqësia statike kur etja e dikujt ka qenë e shuar. Të dyja këto kënaqësi janë natyrale, (Epicurus, "The Philosophy of Happiness", fq. 19)

1.4 Pikëpamjet Stoike

Kundërshtarët e mendimit botëror në antikitetin Grek ishin Stoikët. Stoikët nuk ishin dakord me filozofinë e Arsitotelit që virtytet ishin thjesht një mjet i sigurimit të kënaqësisë. Në realitet sipas Stoikëve, lumturia konsistonte në asgjë tjetër veçse virtytit në vetvete, (Stoics, "The Philosophy of Happiness", fq 19). Dobësia e pozicionit të Stoikëve është refuzimi për termat e brishtësisë së lumturisë, këmbënguljen që lumturia nuk mund të krijohet nga ndonjë kontigjent i mirë i cili është i aftë për të qenë i humbur. Duke pasur parasysh brishtësinë dhe natyrën vulnerabël të qenies njerëzore, ashtu si ne e njohim veten, mohimi që kontigjentet e mira mund të krijojnë lumturinë është i barazvlefshëm me pretendimin që vetëm qeniet mbi njerëzore mund të jenë të lumtur. Konkluzioni i stoikëve ishte në idealizimin e njeriut të zgjuar. Lumturia është e lidhur me virtytet, nuk ka shkallë të virtytit. Virtyti më perfekt është zgjuarsia, dhe njeriu i zgjuar ka të gjitha virtytet. Njeriu i zgjuar është totalisht i lirë nga pasioni dhe posedon të gjitha dijet e vlefshme, (Long and Sedley, 1987, fq 61- 63).

2. Definicioni i lumturisë nën këndvështrimin e psikologjisë pozitive

Çfarë është lumturia? Shumë fjalë janë shkruar në lidhje me këtë pyetje të madhe filozofike-psikologjike, më shumë se ndoshta për ndonjë gjë tjetër. Shkenca është munduar shumë për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje se sa pyetjeve të tjera klasike filozofike, të tilla si "Cili është kuptimi i jetës?". Por shkenca mund të ndriçojë komponentët e lumturisë dhe të hetojë në mënyrë empirike rrugët që të çojnë drejt këtyre komponentëve. Në shqyrtim të literaturës identifikohen tre përbërësit e lumturisë: (a) emocion pozitiv dhe kënaqësi (jeta e këndshme); (b) angazhimi (angazhimi në jetë); dhe (c) kuptimi (kuptimi i jetës), (Seligman 2002).

Rruga e parë për të arritur lumturinë është ajo hedonike, rritje e emocioneve pozitive. Kur njerëzit i referohen një bisede të rastit se si ata mund t'ia arrijnë për të qenë të lumtur, ata shpesh i referohen

kësaj rruge, pra rrugës së kënaqësisë. Brenda kufijve, ne mund të rrisim emocionet tona pozitive në lidhje me emocionet tona pozitive për të tashmen (p.sh. duke kultivuar mirënjohjen dhe falje) dhe emocionet tona pozitive për të ardhmen (p.sh. duke ndërtuar shpresë dhe optimizëm). Ne mund t'i ndiejmë emocionet brenda këtij kufiri kohor duke lënë pas të shkuarën e cila nuk përbën asgjë për botën tonë të brendshme. Megjithatë, ndryshe nga dy rrugë të tjera për lumturinë, rruga duke u mbështetur në emocione pozitive ka kufijtë e saj të qartë. Efektiviteti pozitiv është i trashëgueshëm dhe ne spekulojnë se për arsye të rëndësishme evolucionare, emocionet tona luhaten brenda një game të përcaktuar gjenetiksht. Për fat të mirë, emocion i pozitiv nuk është përcaktuesi i vetëm i lumturisë, qëllimi ynë është të ketë një përcaktim më të gjerë, për sa i përket definicionit të lumturisë, (Seligman 2002).

Një rrugë e dytë për lumturinë përfshin ndjekjen e "kënaqësisë". Karakteristika kryesore e një kënaqësie është se ajo na angazhon plotësisht. Individët mund të gjejnë kënaqësi duke marrë pjesë në një bisedë të madhe, xhiro me një biçikletë, duke lexuar një libër të mirë, mësimin e një fëmije, duke luajtur në kitarë apo kryerjen e një detyre të vështirë në punë. Ne mund të marrim shkurt kënaqësi edhe nga p.sh.: (të ngrënit akullore, të bërit një masazh etj). Ne duhet të përfshijmë veten plotësisht në përjetimin e momentit dhe të marrim më të mirën nga ajo që na ofrohet dhe ndjekja e qëllimeve tona, na bën që të nxjerrim karakterin e fortë si: kreativiteti, inteligjencën sociale, sensin e humorit, këmbënguljen, një vlerësim të bukurisë dhe përsosmëri.

Në të vërtetë, ndjekja e kënaqësisë mund të jetë, shumë e gjatë në kohë. Konsiderojeni veten, për shembull: në një kënaqësi që vjen nga trajnimi për një ngjarje të tillë si një maratonë. Kjo mund të jetë rraskapitëse, edhe garuesi mund të dekurajohet ose të lodhet nga dhimbjet fizike, por në fund fare çdokush mund të përshkruajë përvojën e përgjithshme si intensive. Lumturia në vetvete është një emocion pozitiv. Gjë që është objektivi në këtë artikull, ti jepet kuptimi i duhur emocioneve pozitive, të kuptohet se sa të fuqishme janë ato në brendësinë e tyre, emocion i pozitiv vetëm sa transmeton energji, nxit ide dhe na mundëson një jetë sa më aktive. Pra, duke u angazhuar, ne marrim kënaqësi dhe emocione pozitive.

Rruga e tretë që i jep kuptim jetës. Ajo plotëson një dëshirë për qëllim në jetë dhe është antidot për një "rrugëtim deri sa të vdesim", (Peterson et al. 2005). Qëllimi është gjithnjë një ndjenjë pozitive pasi na mundëson të fiksohemi pas

diçkaje, e të jemi në kërkim të saj. Ndjenja e besimit është shumë e fuqishme brenda aparatit tonë interpretues. Ne e quajmë një prirje për të ndjekur lumturinë duke nxitur emocione pozitive, "jeta e këndshme", tendenca për të ndjekur lumturinë nëpërmjet kënaqësive e një, "jetë të mirë", dhe tendenca për të ndjekur lumturinë me anë të përdorimit të pikave të forta tona drejt diçkaje më të madhe se veten, pra një jetë kuptimplotë. Një person i cili përdor të tre rrugët për lumturinë çon në kuptimin e jetës ose ndryshe siç quhet "jeta e të plotë" dhe provat empirike të kohëve të fundit tregojnë se ata të cilët jetojnë në një jetë të plotë kanë shumë kënaqësi, ose ndryshe marrin kënaqësitë më të mëdha të jetës. Këto pika janë edhe një përkufizim se si mund të konsiderohet lumturia, (Peterson et al. 2005).

Qëllimi përfundimtar i psikologjisë pozitive është që të bëjë njerëzit të lumtur me të kuptuarit dhe ndërtimin e emocione pozitive, kënaqësi dhe kuptim. Bota e parë në aspektin pozitiv është një botë e cila ju fal juve paqen e brendshme dhe transmeton vetëm emocione pozitive. Lumturia është shumë pranë nesh vetëm se ne duhet të jemi të vetëdijshëm se ç'është gjë mund të arrihet nëse ne funksionojmë si njerëz me emocione pozitive duke lënë ç'është gjë tjetër pas, qoftë edhe depresionin, (Peterson, C., Park, N., & Seligman, M. E. P. (2005). Assessment of character strengths. In G. P. Koocher, J. C. Norcross, & S. S. Hill III (Eds.), *Psychologists' deskreference* (2nd ed., pp. 93–98). New York: Oxford University Press.)

2.1 Kush e përcakton nivelin individual të lumturisë?

Studimet kanë treguar se niveli i qëndrueshëm i lumturisë (H) është përcaktuar nga pikët e caktuara që ne marrim për lumturinë (S), rrethanat e jetës (C), (e influencuar nga temperamentit dhe karakteri, të tilla si: depresioni dhe kualiteti i gjumit) dhe nga aktivitetet e qëllimshme dhe vullnetare (V). Martin Seligman, i cili është një nga figurat më unikalë në fushën e psikologjisë, themelues i psikologjisë pozitive, propozoi një ekuacion për lumturinë: $H = S + C + V$. Për më tepër Sonja Lyubomirsky, një studiuese e njohur në fushën e lumturisë dhe autore *"The How of Happiness"*, sugjeroi që pikët tona për nivelet e lumturisë përcaktohen nga lindja apo gjenetika e cila përbën 50% të saj kurse situatat të tjera si statusi martesor, të ardhurat përbëjnë 10 % të lumturisë dhe pjesa e mbetur e lumturisë varet nga aktivitetet apo gjërat e qëllimshme që ne mund të bëjmë për të ndryshuar nivelin e saj, (Lyubomirsky, S. (2013). *The myths of happiness: What should make you happy, but doesn't, what*

shouldn't make you happy, but does (X, Trans.). Beijing, China: Cheers Books.)

2.2 Kuptimi dhe shpjegimi kulturor i lumturisë

Psikologu amerikan Ed Diener nga Unioversiteti i Illinois, ka pyetur njerëz nga kultura të ndryshme, se si e ndjejnë ata lumturinë. Ai ka qenë në shumë vende, që nga Massai në Kenia deri në banorët e lagjeve të varfra të Kalkutës. Dr. Diener ka arritur në përfundimin se: *"lumturia varet edhe nga kultura përkatëse dhe nga shoqëria"*, (Diener, E. 1984). Kjo jep një pasqyrim se vende të ndryshme i japin shpjegime të ndryshme konceptit të lumturisë, por ndryshimet kulturore vënë edhe më tej. Studiuesit e Universitetit Stanford në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara, shtrojnë pyetjen: *"nëse njerëz nga kultura të ndryshme thonë se janë të lumtur, a e ndjejnë ata te ajo gjë diçka të krahueshme?"*. Rezultati i papritur është se amerikanët dhe evropianoperëndimorët kuptojnë me lumturi një gjendje ngacmuese. Kurse kinezët kuptojnë me të një gjendje të qetë, paqësore dhe krejtësisht të ç'tensionuar të shpirtit.. gjë që nënkupton se njerëzit i japin vet- rëndësi asaj që ndërtojnë. Raporti me veten është diçka thelbësore që të lejon, në një farë mënyre, që ti edhe mund të gesh një kontakt me të dhe të jesh në harmoni me veten, e rëndësishme është të kesh një imazh për veten. Gjë që nënkupton se individë të ndryshëm nga vende të ndryshme e mendojnë nga këndvështrime të ndryshme paqen e tyre shpirtërore, por ajo që është e rëndësishme ka lidhje me ne dhe të tjerët që janë pjesa jonë e pandashme.

Në shumë këndvështrime, realiteti i vetëm është ai që ndodhet brenda vetes tonë, që nënkupton se të arrish në një gjendje të qetë e të mirë, nevojitet që të mos ia komplikosh jetën vetes. Lumturia mund të arrihet shumë thjeshtë nëse vendos që të vlerësosh ato gjëra që ke pranë dhe merr më të mirën nga to. Është me shumë rëndësi që të vendosim të mendojmë pozitivisht, të jeni të sigurt se brenda nesh do depërtojnë emocione pozitive. Prandaj, jeni të detyruar t'i kontrolloni mendimet tuaja, për të qenë të sigurt se nuk ankoheni, nuk ofendoni, nuk kritikoni, prandaj për këtë edhe është e një rëndësie të veçantë që të shoqërohesh me njerëz që mendojnë pozitivisht, ashtu që së bashku mund të ndani përgjegjësinë që t'ia përkujtoni njëri-tjetrit që të thoni vetëm pohime pozitive. Mbani mend: *"çdo mendim negativ krijon realitet negativ"*. Sado që ju të mendoni se mendimet tuaja negative janë *"të arsyeshme"*, kur të ankoheni, kur të kritikoni apo të gjykoni, ju për këtë arsye, mos thoni asgjë për dikë apo për diçka që nuk dëshironi, që ajo të jetë vërtetë përgjithmonë! Vetëm dorëzohuni asaj ç'ka është realitet, duke e

mbajtur mend se ju, me mendimet tuaja të së kaluarës, e keni krijuar atë realitet dhe se ju me mendime të reja mund ta krijoni përsëri. Kur të dëshironi që përsëri të ndërtoni realitetin (të krijoni realitet të ri), të kontraktoni kushte të reja të krijimit, vetëm dilni jashtë atij realiteti me afirmimin i cili bën gjërat ashtu siç dëshironi të jeni.

2.3 Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë tek lumturia

Bota e brendshme është e njëjtë për të gjithë, ç'është gjë varet nga interpretimi që ne i bëjmë. Gjithçka që është përreth nesh, zona personale jo personale, formon realitetin tonë. Njeriu e percepton këtë realitet, krijon një mendim, një kuptim për të, pastaj përjeton në përshtatje me kuptimin që ka krijuar dhe në fund vepron. Një njeri është pikë për pikë ajo ç'ka ai mendon për vetveten, sepse karakteri është shuma e plotë e të gjitha mendimeve të tij. Ne nuk mund ta konceptojmë jetën si të vetëm e në këtë mënyrë ne bashkëveprojmë me të tjerët. Ellis theksonte se ç'është individ ka "zonën personale" ai ka familje, shokë e miq të cilët i do dhe i duan, por t'i injorosh ose shash ata, personi nuk do ndihet i qetë madje do të dalë në mbrojtje të tyre, që do të thotë se ne shpesh e vendosim veten në dispozicion të të tjerëve, duke dëmtuar veten tonë, ne lejojmë persona të tjerë të na dhunojnë zonën personale, shpesh ndodh me ne që ndërsa po krijojmë miqësi të reja, lejojmë shpesh që të na dhunojnë zonën tonë, këta individ nuk bëjnë gjë tjetër veçse "futini hundët" kudo dhe nuk na lejon të kemi një panoramë sa më të qartë të gjërave. Nën trysinë mbizotëruese të ambientit ne shpesh marrim vendime, të cilat kthehen në veprime që janë fryti i mendimit, dhe gëzimi dhe vuajtja janë frytet e tij, "Mendimi në mendje na ka bërë ne", (Ellis, Albert. 1957. "Rational Psychotherapy and Individual Psychology." Journal of Individual Psychology 13: 11-44.)

Faktorët e jashtëm që na rrethojnë, kanë peshën e caktuar mbi gjendjen tonë emocionale, por rëndësia dhe këndvështrimi që ne interpretojmë është baza e ç'është gjëje. "Aron Beck". Sepse kur vendosim të interpretojmë një ngjarje, aty fillojmë e krijojmë kuptime të caktuara. Pas interpretimeve të përsëritura me anën e kuptimeve, (Beck, A.T. 1975).

Lumturia është temë me një fushë të gjerë studimi. Çdo njeri i pasur apo i varfër, i arsimuar apo i paarsimuar, i vogël apo i madh nga ç'është cep i botës, mendon rreth lumturisë, rreth arritjes së saj, madje shumë persona mendojnë se lumturia përbën qëllimin e jetës.

Për lumturinë janë bërë studime nga më të ndryshmet, nga studiues të ndryshëm. Një nga studimet lidhet me Psikologun e Universitetit të

Illinoisit, Eduart Diener. Diener ka realizuar disa studime mbi temën se, "Çfarë i bën njerëzit të lumtur", duke iu referuar studentëve të Universitetit të tij, si grup kampionimi. Nga këto studime ai ka arritur të nxjerrë disa konkluzione. Disa prej tyre, sipas Diener, janë: *Paraja nuk i bën njerëzit të lumtur*. Nëse njeriu i ka plotësuar nevojat bazë, ai nuk ka nevojë për shtesa në para për të qenë i lumtur. Rinia nuk është mosha ose periudha jetësore ku njerëzit arrijnë lumturinë, pasi nga studimet në SHBA, ka rezultuar se, njerëzit më të vjetër në moshë janë më të kënaqur nga jeta se sa të rinjtë. Martesa, sipas Diener ndikon në lumturi, por ajo nuk është një faktor thelbësor në arritjen e lumturisë, tek amerikanët, pasi shumë njerëz kanë qenë të lumtur para se të martoheshin. Besimi, ndikon shumë në qetësinë shpirtërore dhe lumturinë e amerikanëve, pasi për këtë ndikon fryma komunitare dhe sociale. Të shkuarit në faltore dhe besimi në Zot, sipas Diener, i siguron njerëzve mbështetje.

Miqësia ose shoqëria është një faktor thelbësor që ndikon në lumturinë. Nga studimet e Diener ne Universitetin e Illinoisit u shënuan nivele shumë të larta të lumturisë te studentët si pasojë lidhjeve të forta miqësore, sociale dhe familjare, (Diener, E., & Seligman, M. E. P. (2004). Beyond money: Toward an economy of well-being. *Psychological Science in the Public Interest*, 5, 1-31.)

Pra, faktorët thelbësorë, sipas Diener, që ndikojnë në lumturi janë:

A- Besimi, B- Miqësia dhe lidhjet shoqërore, C- Familja. Sipas Diener njerëzit e arrijnë lumturinë në moshën e rritur të vonë ose në pleqëri.

3. Çfarë është depresioni?

Depresioni (latinisht- *depressere, depressus: i ngjeshur, shtypur poshtë*) është një nocion kompleks për simptoma të shumëllojshme. Depresioni përfshin: emocionet, kognicionin, motorikën, motivacionin si dhe gjendjen vegetative. Depresioni është gjendje sëmundjeje, gjatë të cilës vjen deri tek një mërzë e pikëlluar e lidhur me gjendje frike, shqetësim i brendshëm si dhe pengesa në të menduarit edhe në gjumë. Të menduarit është i ngadalësuar dhe silltet (fiksohet) kryesisht rreth një teme. Zakonisht rreth temës së shikimit të ç'është gjëje nga ana negative, pra domethënë rreth asaj, se sa keq është, se sa e dëshpërueshme është situata e tanishme, në të cilën gjendet një person dhe sa e pashpresë është e ardhmja. Shumë persona depresivë kanë ndjenja faji dhe mendime negative, ide të mëkatimit, të cilat mund të ngrihen deri në gjendje deluzive. Flasin edhe për mendime të brengosjes, sepse detyrimisht mendohet përherë rreth mendimeve të njëjta negative. Pengesat në

gjumë, në njërin anë, shprehen në vështirësi për të fjetur, në një sjellje të penguar të fjetjes pa ndërprerje me zgjime të përsëritura dhe në anën tjetër, me zgjime të hershme. Për këtë arsye gjumi përjetohet si i pamjaftueshëm dhe shumë sipërfaqësor dhe në mëngjes nuk sjell freskim, e as ç'lodhje. Madje, mëngjesi është shpesh koha më e keqe për individët depresivë, pasi kryesisht në mëngjes ata ndihen veçanërisht shumë keq. Në vazhdimësi dreka, gjendja mund të përmirësohet dhe në mbrëmje të jetë relativisht e durueshme. Kjo ndjenjë veçanërisht e mjerueshme në mëngjes pas zgjimit, psikologët e quajnë "ulje e mëngjesit".

Tiparet kyçe të këtij çrregullimi janë simptomat depresive që prekin sferën afektive (të ndjenjave), sferën e të menduarit, të sjelljes dhe atë fizike:

A. *Ndryshimet më të dukshme në sferën afektive i referohen:*

1- **Humoriti.** Individët e përshkruajnë veten si depresiv, të trishtuar dhe të pashpresë. Ata raportojnë një gjendje mungese lumturie, vetmie, trishtimi ose mërzie.

2- **Mungesë interesi dhe humbje kënaqësie.** Kjo njihet si anhedonia, mungesa e kënaqësisë dhe interesit për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme.

3- **Ankthi.** Klientët manifestojnë simptoma të pastra të ankthit. Ata ndihen në ankth edhe për gjërat më të vogla.

4- **Ndjenja pavlefshmërie dhe faji.** Vetëfajësimi mund të marrë dhe përmasa delirante.

B. *Ndryshimet më të dukshme në sferën e të menduarit u referohet:*

5- **Mendimeve negative.** Kemi mendimet negative që i referohen të tashmes, së ardhmes dhe së shkuarës. Klientët prirën të përqendrohen më shumë në aspektet negative të së kaluarës, dhe së tashmes pa qenë të aftë të kujtojnë ngjarje pozitive.

C. *Ndryshimet më të dukshme në sferën e sjelljes i referohen:*

Tërheqjes nga akitvitetet sociale dhe tentativa për vetëvrasje.

D. *Ndryshime më të dukshme në sferën somatike i referohen:*

Axhitim ose vonesës psikomotore, shqetësime lidhur me dëshirën për të kryer marrëdhënie seksuale, shfaqin shqetësime të gjumit, rënia ose shtimi në peshë për shkak të ndryshimeve të oreksit, kanë ankesa të vazhdueshme për shqetësime trupore. Simptomat e depresionit gjenerohen dhe mbahen si pasojë e kushteve të vështira dhe shfaqjes së shtrembërimeve mendore dhe skemash të hershme të keqpërshtatura të personit që vuan me këtë çrregullim. (Pango, Y. "Psikoterapia e njohjes dhe e sjelljes", Ilar, Tiranë 2004)

Disa nga simptomat specifike të depresionit vijnë më poshtë pra, personat që vuajnë nga depresioni mund:

- të ndjehen keq shpirtërisht në shumicën e kohës
- të kenë mërzë, ndjenjë urrejtje, të jenë gjithmonë nën tension
- ndjenjë e të qenurit të pavlerë dhe të padobishëm
- të kenë mungesë të vetësigurisë
- të jenë të angazhuar me mendime negative / pesimiste
- të ndjehen të ngurosur, ndjenjë zbrazëtie dhe të dëshpëruar
- të fajësojnë vetveten dhe të ndjehen fajtor për gjëra pa nevojë
- kanë vështirësi të koncentrohen apo të marrin vendime
- të jenë jashtëzakonisht të zemëruar dhe të padurueshëm
- ndryshim në zakonet e fjetjes, si p.sh.: vështirësia për të fjetur, zgjimi herët, ose fjetja e tejzgatur
- ndryshim në mënyrën e ngrënies: kanë shumë dhe shtojnë peshë ose nuk kanë mirë dhe humbin peshë
- nuk kënaqen me aktivitete
- të humbin interesimin për marrëdhënie seksuale
- pinë më shumë se zakonisht cigare, alkool dhe përdorin droga të tjera
- kanë zvogëlim të energjisë (kanë ndjenjë të humbjes së energjisë)
- ulje ose humbje e interesit në aktivitetet normale të përditshme
- kanë ndjenjë e të qenit të lodhur gjithmonë
- shkëputen nga të tjerët (vetë-izolohen), në vend që të kërkojnë ndihmë dhe përkrahje
- kanë mendime pesimiste
- kanë ose kryejnë akte të vetëlëndimit apo vetëvrasjes (suicid)

4. Psikologjia dhe psikoterapia pozitive për trajtimin e depresionit dhe risjelljen e lumturisë

Fjala si element terapeutik: Kur e nisim debatin për rëndësinë e fjalës në radhë të parë duhet të kuptojmë peshën e saj, të mirat dhe të këqijat që vijnë si pasojë e përdorimit të saj.

Lumturia realizohet me fjalë. Njeriu nuk është esencë e fiksuar, si krijesat e tjera, prandaj posedon mjetin më të rëndësishëm për realizim të synimit jetësor që quhet fjalë, kjo e fundit bën që ne shpesh të na vrasë ndërgjegjja, të jemi njerëzit më të lumtur, të jemi të trishtuar, të jemi të prekshëm, të jemi qenie humane, ç'do gjë e arrijmë përmes komunikimit dhe mjetit kryesor të saj e cila është

fjala. Përmes saj në çojmë shumë mesazhe tek individit siç mund të jenë, shpresë, kurajo, vetëbesim, pozitivitet etj. **Psikoterapia pozitive**, kur i referohet pozitives para së gjithash, ka parasysh të gjithë mirë funksionimin e individit, ajo nuk është e orientuar që të asgjësohet një simptomë e caktuar ose një çrregullim, siç është edhe depresioni, por përpiqet së pari për të dalluar kuptimin e depresionit dhe për t'ja bërë të qartë klientit këtë gjë, në përgjithësi të gjitha shkollat në këtë drejtim fokusohen. **Psikologjia pozitive** e shikon si një element të domosdoshëm elementin shpresë brenda psikoterapisë së tyre, ata theksojnë se nuk janë vetëm problemet dhe konfliktet në të cilat përfshihet një person, por edhe aftësia për t'u lidhur me këto konflikte, për të mësuar nga to dhe për t'u shëruar apo për të përballuar edhe depresionin me sukses. Depresioni paraqet gjithmonë një përpjekje për vetë-normalizim të njeriut, që është më shumë ose më pak e suksesshme. Pasi individët nuk vuajnë vetëm nga depresioni dhe çrregullimet e tij, por edhe nga mungesa e shpresës, që u transmetohet atyre, psikoterapia pozitive e shikon klientin (individin) e saj në të gjithë tërësinë e tij dhe përpiqet t'i japë një këndvështrim sa më humanist.

Psikoterapia pozitive nis nga parimi se njeriu është një modelues aktiv i ekzistencës së tij, që në mënyrë të vetëdijshme apo të pa vetëdijshme orientohet drejt vlerave të caktuara, përpiqet ta mbushë jetën e vetë me kuptim dhe që vetë centralizimi mund të arrihet vetëm në shkëmbim të vazhdueshëm me mjedisin social.

Të vepruarit pozitiv, në *psikoterapinë pozitive* rezulton nga imazhi pozitiv i individit, që bazohet mbi pohimin se ç'do njeri nga natyra e vetë, posedon dy aftësi themelore: aftësinë e dashurisë dhe aftësinë e njohjes. Të dyja aftësitë i përkasin thelbit të ç'do njeriu dhe gjenden te individit që prej lindjes. Në varësi të mjedisit të tij (edukimi, arsimit dhe kultura) dhe kohës në të cilën jeton (fryma e kohës) këto aftësi themelore mund të diferencohen dhe të çojnë deri te një strukturë të pangatrueshme karakteristikash, që më vonë përbëjnë karakterin dhe thelbin e individit. Kjo sjell një ulje të konsiderueshme të shenjave dhe niveleve të depresionit.

Për Psikoterapinë Pozitive individit në thelbin e tij është i mirë, "*i mirë nga thelbi*" do të thotë që ç'do njeri është i pajisur me një mori aftësish, të cilat duhen zhvilluar si mundësitë e fshehura në një "*kokrrizë fare*". Në praktikën e tyre profesionale ata i venë në pah këto aftësi klientit të tyre për të luftuar mendimet e tyre mbi veten, imazhi pozitiv pikë së pari do të thotë se: ne duhet ta pranojmë veten ashtu siç jemi, por që shohim edhe atë që mund të

bëhemi. Kjo do të thotë se personin në fjalë e pranojmë me problemet e tij si njeri për të lidhur kontakte, pastaj me aftësitë e tij ende të pa njohura, të fshehura dhe të mbuluara nga problematikat e depresionit.

Kështu, çrregullimet e depresionit konsiderohen si një lloj aftësie për të reaguar ndaj një konflikti në një mënyrë të caktuar dhe jo ndryshe. Në këtë kuptim interpretohen sëmundjet dhe çrregullimet në Psikoterapinë Pozitive. Parimi i shpresës na ndihmon që të kujtojmë vlerën tonë të brendshme edhe në situatat më të vështira dhe na jep besimin që një ndryshim është i mundur dhe unë mund të arrij të përballoj gjendjen e tanishme. Dhe pikërisht kjo shpresë liron forca dhe energji që janë të nevojshme për luftën që ndodh brenda individit. Ajo që është kryesore për ç'do terapi ka të bëjë me fjalën, me komunikimin, me mënyrën si e transmeton mesazhin të klientit, ai është aty me shpresën më të madhe për ta ndihmuar, prandaj edhe psikoterapia e shikon elementin shpresë si një vlerë më shumë se pozitive në terapi, pasi klientët në përgjithësi kanë nevojë për tu mbështetur te diçka. (Akhtar, M. (2012). Positive Psychology Interventions with Depression. Positive Psychology News Daily, March 15, 2012.)

Fjala që transmeton psikoterapia pozitive te klienti (individit) është pak a shumë si efekt "*placebo*", pasi ai ilaç në vetvete nuk ka asnjë vlerë kurative, por njerëzit kanë shpresë kanë besim se te ai ilaç do të gjejnë shpëtim dhe në këtë mënyrë ai ka ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen emocionale, kognitive tek individit dhe jep pritshmëritë e duhura, duke reduktuar apo eliminuar shenjat dhe nivelet e depresionit dhe duke kthyer lumturinë.

5. PËRFUNDIME

1. Nisur nga përcaktimi i lumturisë që në antikitet vërejmë që ka një rëndësi të spikatur, e cila kthehet në një nevojë të domosdoshme për arritjen e saj deri në nivele optimale. Duke vërejtur se në ditët e sotme, depresioni dhe nivelet e tij, kanë qenë në rritje dhe tepër shqetësuese për individët, lind nevoja për të përdorur një mjet efikas në realizimin e arritjes së objektivit të lumturisë.

2. Duke dashur t'i diagnostikojmë këto vështirësi duke shqyrtuar disa aspekte të implikimit të lumturisë si polari i kundërt i depresionit, këtë evidencë nuk mund ta bëjë asnjë psikologji dhe psikoterapi, si ajo pozitive. Gjithmonë jemi mësuar të vërejmë një përdorim masiv të terapive të ndryshme si: Kognitive-Bihejviorale, Humaniste etj, aq më tepër në trajtim të depresionit, por kur çështja shtrohet për përjetime si emocionit i lumturisë, apo mendime pozitive, tepër efikase do të rezultonte Psikoterapia Pozitive.

3. Psikologë të spikatur kanë argumentuar se fuqia e psikoterapisë pozitive është fjala. Ajo ka impakt të drejtpërdrejtë në gjendjen emocionale,

kognitive tek individit dhe jep pritshmëritë e duhura, duke reduktuar apo eliminuar shenjat dhe nivelet e depresionit dhe duke i kthyer lumturinë individit.

BIBLIOGRAFI

- Akhtar, M. (2012). [Positive Psychology Interventions with Depression](#). Positive Psychology News Daily, March 15, 2012.
- Beck, A.T. (1975). Cognitive therapy and the emotional disorders. Madison, CT: International Universities Press, Inc. ISBN 0-8236-0990-1
- Diener, E. (1984). Subjective well-being. Psychological Bulletin ,95 , 542-575. An early review of the research literature and theoretical approaches to happiness
- Diener, E., & Seligman, M. E. P. (2004). Beyond money: Toward an economy of well-being. *Psychological Science in the Public Interest*, 5, 1-31.
- Diener, E., & Suh, E. M. (Eds.). (2000). Culture and subjective well-being Cambridge, MA: MIT Press. An edited book with chapters on various aspects of subjective well-being across nations.
- Ellis, Albert. 1957. "Rational Psychotherapy and Individual Psychology." Journal of Individual Psychology 13: 11-44.
- Epicurus, "The Philosophy of Happiness", page18, Chapter 1
<http://positivepsychologynews.com/news/laura-lc-johnson/2012032621575>
<http://www.psikologjia.com/?p=123>
<http://www.psychology.illinois.edu/people/ediener>
- Pango, Y. "Psikoterapia e njohjes dhe e sjelljes", Ilar, Tiranë 2004
- Pavot, W., & Diener, (1993). Review of the Satisfaction with Life Scale. Personality Assessment ,5, 164-172. A review of the Satisfaction with Life Scale, and its validity and reliability
- Peterson, C., Park, N., & Seligman, M. E. P. (2005). Assessment of character strengths. In G. P. Koocher, J. C. Norcross, & S. S. Hill III (Eds.), *Psychologists' deskreference* (2nd ed., pp. 93–98). New York: Oxford University Press.
- Seligman, M. E. P., Steen, T. A., Park, N. & Peterson, C. (2005). Positive psychology progress: Empirical validation of interventions. *American Psychologist*, 60(5), 410-421.
- Ancient Philosophy Prof. Sally Haslanger October 25, 2004, Platon on Happiness, "The Republic's answer to Thrasymachus"

FORMIMI I NDËRGJUHËS GJATË MËSIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA DHE RRUGËT PËR SHMANGIEN E INTERFERENCAVE GJUHËSORE

ANILA PANGO

ALEANCA FRANCEZE E TIRANËS

Përmbledhje

Ky artikull propozon studimin e fenomeneve që lidhen me të mësuarin e gjuhës frënge nga nxënësit shqipfolës, të cilët kanë përvetësuar më parë një tjetër gjuhë të huaja. Ne do të trajtojmë transferimet ndërgjuhësore në procesin e mësimnxënies së gjuhëve të huaja. Në mjaft raste, këto transferime janë burimi i gabimeve, të cilat ne po përpqemi t'i vëmë në dukje. Pikërisht, trajtimi i këtyre gabimeve do të ndihmojë në përmirësimin e performancës gjuhësore në frëngjisht të shqipfolësve. Analiza jonë synon të shpjegojë arsyet e gabimeve të nxënësve gjatë nxënies së frëngjishtes dhe t'u përgjigjet disa pyetjeve, të cilat shtrohen shpesh nga mësuesit dhe nxënësit. Korrigjimi i këtyre gabimeve nuk mund të mjaftohet thjesht me evidentimin e tyre, por kërkon një strategji të studiuar mirë nga ana e mësuesve, që të përpqen të gjejnë zgjidhjen e këtyre problemeve.

Fjalë çelës: *gjuhë e huaj, mësimnxënie, tranferime, gabime, të shprehurit me shkrim.*

Abstract

This article aims to study the phenomena associated with learning French language from the Albanians who have previously taken linguistic knowledge from another foreign language. We will treat the transfers in the process of foreign language learning. In many cases, these transfers are the source of errors which we try to highlight. It's just the treatment of these errors that will help to improve the linguistic performance of the French language to Albanian language speakers.

Our analysis aims to explain the reasons for errors made by learners of French and to respond to some questions that are often raised by teachers and students. Remediation cannot be reduced simply by the identification of errors but it requires a well-developed strategy by the teachers to try to find the solution of these problems.

Key words: *foreign language, learning, transfer, errors, written tests.*

HYRJE

Ndikimi i gjuhës amtare, apo një gjuhe të huaj të mësuar më parë, në mësimin e një tjetër gjuhe të huaj është i pashmangshëm. Ky ndikim mund të jetë pozitiv, duke i ndihmuar nxënësit ta mësojnë gjuhën e huaj më lehtë dhe më shpejt. Në këtë rast flitet për transferime ndërgjuhësore pozitive. Por, ky ndikim mund të jetë negativ, nëse nxënësi përdor forma të gabuara në rrafshin leksikor, morfo-sintaksor apo fonetik e në këtë rast flitet për transferime negative ose interferenca. Sipas Herdina dhe Jessner (2002; 28-29), transferimet ndërgjuhësore janë të parashikueshme, kurse interferencat lidhen më tepër me trajtimin sesa me strukturat e gjuhës, ndaj nuk mund të parashikohen. Megjithatë, nuk është e lehtë të parashikohen të gjitha gabimet dhe të realizohet një klasifikim i atyre që vijnë nga transferimet, sepse ato mund të interpretohen në mënyra të ndryshme.

Kërkimi ynë është bërë pranë Aleancës Franceze të Tiranës. Korpusi i teksteve që ne analizuam përbëhej nga kopje të teksteve të shkruara prej nxënësve të nivelit A1, A2, dhe B1, sipas niveleve të përcaktuara nga Kuadri i përbashkët evropian i referencave për gjuhët. Korpusi ynë përbëhet nga 25 nxënës. Ata janë të moshave nga 16 deri në 30 vjeç, pra adoleshentë dhe të rritur, femra dhe meshkuj, gjuha amtare e të cilëve është shqipja. Ata janë nxënës gjimnazi, studentë dhe punonjës, të cilët mësojnë frëngjisht

me qëllime studimi ose punësimi në Francë, apo në një vend tjetër frëngjishtfolës. Motivimi i tyre është i madh, prandaj punojnë seriozisht. Pjesa më e madhe e tyre kanë studiuar më parë gjuhën angleze dhe përgjithësisht, kontakti i tyre me frëngjishten është i kufizuar vetëm brenda klasës, me mësuesin ose me nxënësit e tjerë.

1. Analizë të dhënash

Synimi ynë në analizën e gabimeve është t'i identifikojmë, t'i klasifikojmë dhe t'i interpretojmë ato. Kjo na ndihmon të kuptojmë më mirë transferimet gjuhësore tek nxënësit shqipfolës. Gabimet që nuk përsëriten janë transferime ndërgjuhësore, kurse ato që përsëriten sistematikisht janë transferime brendagjuhësore. Gabimet ndërgjuhësore vijnë në përgjithësi nga interferencat, pra transferimet negative që nxënësi bën nga gjuha amtare në gjuhën që po mëson. Me ndërgjuhë kuptojmë variantin gjuhësor që fomohet te një nxënës, i cili nuk përputhet plotësisht me gjuhën që po mësohet. Në formimin e ndërgjuhës hyjnë gjuha amtare dhe gjuhë të tjera të huaja të mësuara më parë, si dhe gjuha e huaj që po mësohet. Sipas teorive të para të analizës së krahasuar, sa më i madh të jetë ndryshimi midis dy gjuhëve, aq më shumë transferime negative do të ketë midis tyre. Gabimet brendagjuhësore janë ato që lidhen drejtpërdrejt me përvetësimin e gjuhës së huaj. Nëse nxënësi nuk i njeh rregullat e funksionimit të gjuhës që është duke mësuar, është

e sigurt se ai do të bëjë gabime. Për shembull, nëse ai nuk di të zgjedhë një folje në një kohë të caktuar, do të përdorë një formë tjetër të ngjashme me të, pra do të përdorë analogjinë. Studimi ynë ka si objekt kryesor, të gjejë dhe të analizojë gjurmët e gjuhëve të tjera në ndërgjuhën e nxënësve shqiptare gjatë mësimit të frëngjishtes.

2. Transferimet ndërgjuhësore

Çdo njeri gjatë kohës që mëson një gjuhë të huaj shpesh i drejtohet gjuhës amtare. Ndodh që një nxënës, ta fillojë një fjali në gjuhën që po studion dhe ta vazhdojë atë në gjuhën amtare, duke mos dashur ta lërë pa përfunduar. Në lidhje me këtë, K.Vogel (1995:183-184) shpjegon: mund të mendojmë se sa herë që nxënësi nuk arrin të shprehet me ndihmën e ndërgjuhës, do të kërkojë ndihmë në gjuhën amtare, për të gjetur aty struktura dhe mjete shprehjeje të cilat i njeh mire, me qëllim që të plotësojë boshllëqet në gjuhë të huaj dhe të ruajë komunikimin. Përveç kësaj, ai shton: që të ketë transferime gjuhësore, nxënësi duhet të gjejë ngjashmëri midis gjuhës amtare dhe asaj që po mëson. Shkrimi është forma më e rëndësishme me anë të së cilës zbulohen gabimet, të cilat mund të ndahen në dy grupe.

- Gabimet e performancës, ato që quhen lapsus, që mund të vijnë nga përdorimi jo i saktë i nje rregulle, që studenti ka mësuar, dhe për pasojë, ai është në gjendje të vetëkorrigjohet (H. Besse et R. Porquier, 1991: 209).

- Gabimet e kompetencës, të cilat studenti nuk mund t'i vetëkorrigjojë. Këto vijnë për shkak të nivelit të njohurive në gjuhën që po studiohet, në një moment të caktuar. Duke qenë sistematike këto gabime mund të parashikohen.

Le të kalojmë tek identifikimi i gabimeve dhe i natyrës së tyre. Gabimet mund të klasifikohen sipas tipologjisë klasike: leksikore dhe gramatikore. Analiza e kopjeve të të shprehurit me shkrim mundëson zbulimin e gabimeve nga burime dhe natyra të ndryshme, ndër të cilët ne jemi përpjekur të pasqyrojmë ato që janë më sistematike.

3. Interferenca nga gjuha shqipe

➤ Gabime leksikore dhe gramatikore.

Transferimet leksikore kanë të bëjnë me zgjedhjen e formave leksikore. Kjo tregon një përpjekje për të formuluar në gjuhën e huaj, por që për ta arritur këtë është aktivizuar gjuha amtare. Për shembull:

- *Il a perdu le bus = Ai humbi autobusin.*

Në vend të: *Il a raté le bus.*

- *J'ai choisi la rue la plus facile = Zgjedha rrugën më të lehtë.*

Në vend të fjalës **voie** kane zgjedhur fjalën **rue**.

- *Ca provoquerait la **falimentation** de la boutique = Kjo do shkaktonte **falimentimin** e dyqanit.*

Fjalës shqip i është shtuar prapashtesa **tion** duke krijuar një fjalë që nuk egziston në frëngjisht.

Emrat në frëngjisht si dhe në shqip dallojnë gjini dhe numër. Por, përcaktimi i gjinisë së emrave jo frymorë në frëngjisht është arbitrar, ndërsa në shqip, ai bëhet nga mbaresa e emrit në numrin njëjës, trajta e shquar, rasa emërore. Nëse gjinitë e emrave në të dyja gjuhët përputhen, kemi të bëjmë me transfertë pozitive p.sh *la table/tavolina* (f), *la fleur/lulja* (f), *le livre/libri* (m), *le stylo/stilolapsi* (m), etc. Në të kundërt, ndeshim transfertë gramatikore të gabuara për shembull: *sac*, *arbre*, *robe*, etj, kanë gjini të kundërta në shqip e në frëngjisht dhe ne gjejmë përdorime të tilla si: *la sac* (në vend të *le sac* = çanta), *la média* (në vend të *le média* = media), *la jour* (në vend të *le jour* = dita), *le robe* (në vend të *la robe* = fustani) *le décision* (në vend të *la décision* = vendimi), etj.

Një nga gabimet më të përsëritshme dhe që korrigjohet me vështirësi gjatë të mësuarit të frëngjishtes nga shqiptarët është mospërdorimi i *article partitif* (nyja që përdoret para emrave për të treguar një sasi të pacaktuar).

- *J'ai mangé poisson et frites = Unë hëngram peshk dhe patate.*

Përdorimi i saktë do të ishte: *J'ai mangé **du** poisson et **des** frites.*

- *Les élèves font bruit = Nxënësit bëjnë zhurmë.*

Në vend të: *Les élèves font **du** bruit.*

Këto gabime bëhen sepse kjo nyje nuk ka korrespondente në shqip.

➤ Gabime morfologjike

Tendeca për të përdorur në gjuhën e huaj rregullat e gramatikës së gjuhës amtare si për shembull: për të formuar kohën e kryer – *le passé composé*, përdoret folja ndihmëse kam (*avoir*) në vend të jam (*être*):

- *J'ai sorti*, në vend të: *Je **suis** sorti* (Kam dalë),

- *J'ai allé*, në vend të: *Je **suis** allé* (Kam shkuar).

➤ Gabime sintaksore

Vendosja e ndajfoljeve pas foljeve në kohët e përbëra:

- *J'ai travaillé **beaucoup**.*

Në vend të: *J'ai **beaucoup** travaillé* = Kam punuar **shumë**.

Përdorimi i përemrave lidhorë *qui/que*. Meqënëse në shqip në vend të të dy përemrave mund të përdoret një i vetëm **që**, vihet re një përdorim i gabuar i tyre.

- *C'est moi, Albert **que** t'écrits = Jam unë Alberti **që** të shkruaj.*

Në vend të: *C'est moi, Albert **qui** t'écrits.*

- *J'habite à Tirana **qu'**est la plus grande ville du pays = Banoj në Tirane, **që***

është qyteti më i madh i vendit.

Në vend të: *J'habite à Tirana, **qui** est la plus grande ville du pays.*

- *Un ami **que** souffre = Një mik **që** vuan.*

Në vend të: un ami **qui** souffre.

- *Les magasins **qui** nous trouvons dans la ville = Dyqanet **që** gjejmë në qytet.*

Në vend të: Les magasins **que** nous trouvons dans la ville.

Nën ndikimin e shqipes, mund të përdoren fjali ku kryefjala nuk është e shprehur, ndërkohë që në frëngjisht ajo është e domosdoshme para foljes si për shembull:

- *Je pense que **sera** plus utile. = Unë mendoj se **do jetë** më e dobishme.*

Në vend të: Je pense que **ce sera** plus utile.

- *Un jour **m'ont téléphoné** pour me dire... = një ditë **më telefonuan** për të më*

*thënë... Në vend të: Un jour, **ils m'ont téléphoné** pour me dire ...*

Gjithashtu, përdorimi i gabuar i parafjalëve, duke përdorur parafjalën korrespondente në gjuhën shqipe, si:

- *Nous ne sommes pas d'accord **pour** cette décision. = Nuk jemi dakort **për** këtë vendim.*

Në vend të: Nous ne sommes pas d'accord **avec** cette décision.

- *Il y a beaucoup de choses **pour** faire. = Ka shumë gjëra **për** të bërë.*

Në vend të: Il y a beaucoup de choses **à** faire.

Gjatë procesit të nxënies, nxënësit përdorin kalke semantike ose përkthim fjalë për fjalë nga shqipja në frëngjisht duke formuluar fjali të tipit:

- ***J'ai un an** que je travaille = **Kam nje vit** që punoj.*

Në vend të: **Ça fait un an** que je travaille.

- ***Il a trourné** la maison dans un hôpital. = **Ai e ka kthyer** shtëpinë në spital.*

Duke përdorur foljen *tourner* në vend të foljes *transformer*.

- ***Il m'a raconté** pour le film = **Ai më tregoi** për filmin.*

Në vend të: ***Il m'a raconté** le film.*

4. Interferencat nga një gjuhë e huaj e mësuar më parë (anglisht)

Ajo që bie në sy, gjatë analizës së gabimeve të studentëve shqiptarë në planin morfosintaksor, është fakti që anglishtja, e cila në të shumtën e rasteve është gjuha e huaj e parë, pavarësisht se ata mund të kenë mësuar edhe gjuhë të tjera të huaja,

bëhet burimi kryesor i interferencave gjuhësore. Shprehitë gjuhësore në anglisht janë më rezistente se ato në frëngjisht. Kështu, fjali anglisht ndërhyr shpesh gjatë mësimin të frëngjishtes. Ky është një fenomen të cilin mësuesit e frëngjishtes duhet ta marrin parasysh në të ardhmen.

▪ Nga njëra anë mund të kemi transferta pozitive të cilat do ta ndihmojnë mësimdhënie/nxënien e frëngjishtes. Fjalët transparente, fjalët që janë ose identike në të dyja gjuhët si: site, service, machine, ose të aftërta: acces / access ; adresse / address ; exemple / example.

▪ Nga ana tjetër ndeshim edhe transferta negative në fjalor si:

- përdorimi i gabuar i foljes *supporter* në vend të foljes *soutenir* (mbështes).

Mes parents **me supportent**.

Në vend të: Mes parents **me soutiennent** = Prindërit më mbështesin.

Në shqip ashtu si edhe në frëngjisht, mbiemri përshtatet me emrin në gjini dhe numur. Ndërsa në anglisht ai është i pandryshueshëm dhe nën ndikimin e anglishtes nxënësit nuk e bëjnë këtë përshtatje. Për shembull:

- Je connais une fille **intelligent**.

Në vend të: Je connais une fille **intelligente**.

- Une **vrai** histoire.

Në vend të: une **vraie** histoire.

Mendohet që studentët duhet të ndjekin intuitën gjuhësore të gjuhës amtare dhe të bëjnë transferime pozitive, midis gjuhës shqipe dhe frëngjishtes. Sipas modelit shqip duhet të gjejmë fjali si:

- Elle achète une robe **rouge** = Ajo blen një fustan të kuq.

- Je parle avec un journaliste **italien** = Unë flas me një gazetar italian.

Por, shpesh korrigjimi i të shprehurit me shkrim tregon se nxënësit u drejtohen strukturave të anglishtes si:

- une **rouge** robe

- un **italien** journaliste.

Rregulla e anglishtes dominon mbi atë të shqipes, sepse nxënësi e ka mësuar atë në mënyrë të ndërgjegjshme, kurse rregulla shqipe përdoret në mënyrë të pandërgjegjshme. Kështu ndodh edhe me përdorimin e ndajfoljeve *toujours* apo *souvent*:

Elle **souvent** va au parc.

Në vend të: Elle va **souvent** au parc,

Nën ndikimin e anglishtes, te nxënësit ndeshim edhe interferenca ortografike, si: dinner/ diner, apartment/appartement,

gouvernement/gouvernement, development/developpement, environment/ environnement, etj.

Në rrafshin morfologjik është e lehtë të identifkohet influenca e anglishtes ose e shqipës në përshtatjen e përemrit pronor me pronarin dhe jo me objektin, si:

- Elle rentre dans **sa pays** / Il rentre dans **son pays**.

Në vend të: Elle rentre dans **son pays** / Il rentre dans **son pays**.

Ky përdorim mund të ndikohet nga shqipja: ajo - vendi i saj/ ai – vendi i tij.

Por mund të ketë ardhur edhe nga anglishtja: she – her country / he – his country.

Por ndeshim edhe rastin, kur duhet të përdorim dy apo më shumë përemra pronorë në të njëjtën fjali. Vihet re, se përemri i parë përdoret saktë dhe i dyti jo. Për shembull:

- Je prends **ma** veste et **ma** portable.

Në vend të: Je prends **ma** veste et **mon** portable.

Ky gabim mund të vijë ose për shkak të mosnjohjes së gjinisë së fjalës *portable*, ose për shkak të përdorimit të formave identike të përemrit pronor, meqë janë dy fjalë shumë afër njëra-tjetrës, në të njëjtën fjali.

- Gabimi i përhershëm: *Je suis 20 ans*. Përdorimi i foljes *être* në vend të foljes *avoir*. Ky gabim shpjegohet me influencën, qoftë të shqipës, qoftë të anglishtes, sepse në të dyja gjuhët përdoret folja *être* / *jam* dhe kuptohet që ky gabim vjen nga pakujdesia.

-Edhe folja *manquer* / mungoj, përdoret në forma të ndryshme si: *Moi, me manque beaucoup ma famille* - transferim nga shqipja: Mua, më mungon shumë familja. Po ashtu: *Je te manque*, në vend të: *Tu me manques*, nisur nga anglishtja: I miss you.

5. REKOMANDIME

Nisur nga përvoja jonë si mësues i një gjuhe të huaj, mund të themi se çdo mësues mund t'u paraprijë disa gabimeve që ndeshen shpesh tek nxënësit. Gjithashtu, nuk duhet të mjaftohemi thjesht në paraprirjen e gabimeve, por duhet një strategji e studiuar mirë nga ana e mësuesve, që të përpiqen të gjejnë zgjidhjen e këtij problemi. Duke qenë pjesë e të mësuarit, gabimi është i pashmangshëm, por edhe i korrigjueshëm. Pra, mësuesi dhe nxënësi duke i parë gabimet pozitivisht duhet të përfitojnë prej tyre. Për nxënësin, kjo gjë është një mënyrë për të ecur përpara dhe për mësuesin, është një burim informacioni, analizë nevojash individuale, ose kolektive, me qëllim përzgjedhjen e aktiviteteve të mësimdhënies. Duke u nisur nga gabimet e bëra, zbulohen shkaqet e

vështirësive të nxënësve dhe krijohet besimi se gabimi është i natyrshëm (Tagliante C.1994:34).

Kërkimet në lidhje me trajtimin e gabimeve në didaktikën e gjuhëve të huaja vazhdojnë të zënë një vend të rëndësishëm, por ende nuk ekziston një përgjigje e qartë dhe e prerë, prandaj nuk mund të japim një zgjidhje përfundimtare. J.M. Hendrickson (1979:357-364) propozon një klasifikim bazuar në nivelin e aftësive të nxënësit, i cili e ndihmon mësuesin të zgjedhë gabimet që duhen korrigjuar:

- Në nivelin fillestar, që i korrespondon nivelit A1, A2 të Kuadrit të përgjithshëm evropian të referencave për gjuhët, duhet të korrigjohen ato gabime, që pengojnë komunikimin me shkrim.

- Në nivelin mesatar, që i përket nivelit B1 e B2, duhen korrigjuar gabimet që përsëriten më shumë.

- Në nivelin e përparuar, duhet të korrigjohen gabimet që ndikojnë negativisht në të kuptuarin e mesazhit.

Së fundi, duke u mbështetur në përvojën tonë si mësues i frëngjishtes prej shumë vitesh, mund të propozojmë disa strategji për riparimin e gabimeve, Disa nga ushtrimet tip, që mund të propozohen në lidhje me korrigjimin e këtyre gabimeve, mund të jenë ushtrimet strukturore ose ushtrimet kundër interferencave.

- Për shembull, në lidhje me mospërdorimin e *article partitif*, që nxënësit të mësohen t'i përdorin normalisht, mund të propozohen ushtrime për përdorimin e këtyre nyjeve në formën pohore dhe mohore.

Nëpërmjet këtyre ushtrimeve, dhe duke insistuar në vëzhgimin, krahasimin, analizën e strukturave gjuhësore korrekte, të cilat mund të imitohen, mësuesi nxit shpirtin kritik në procesin e të mësuarit. Nxënësi drejtohet tek vetëkorrigjimi. Pasi gabimet janë nënvizuar nga mësuesi, korrigjohen nga nxënësi. Nëse i njëjti gabim ndeshet në pjesën më të madhe të detyrave në klasë, mund të propozohet një korrigjim në grup dhe ushtrime për të gjithë nxënësit. Gabimet duhet të korrigjohen në klasë dhe shpesh mund të përdoret edhe metoda e korrigjimit reciprok.

Për gabimet sistematike, duhet të përdoren strategji të rishkrimit si për shembull:

- Plotësoni, zëvendësoni, zhvendosni, etj.
- Nxënësit duhet të nxiten të vetëkorrigjohen dhe të vetëvlerësohen. Propozohen ushtrime, që përmbajnë shprehje dhe struktura të veçanta të gjuhës, që e bëjnë nxënësin të reflektojë mbi ngjashmëritë dhe ndryshimet midis sistemit të gjuhës amtare dhe asaj të huaj, me qëllim që të shmangen transferimet ndër-gjuhësore.
- Po ashtu, mund të punohet edhe me përkthime:

- Përkthim i fjalive të shkurtra, që përmbajnë shprehjet ku ndeshen gabimet sistematike. Ky lloj ushtrimi ndihmon në zgjerimin e fjalorit dhe aftësi gjuhësore të nxënësit.

- Përkthim i paragrafëve.

PËRFUNDIME

Edhe pse trajtimi i këtyre problemeve si nga ana teorike ashtu edhe nga ajo praktike nuk është i lehtë, ne mendojmë se ky punim ndonëse i kufizuar, mund të shërbejë si bazë për një punim të mëvonshëm më të thelluar. Interferenca i mundëson mësuesit të zbulojë nevojat ose prirshmëritë e nxënësit, me qëllim që të parashikojë seancat e tjera të kursit. Nisur nga përvoja personale, mund të themi se referimi në gjuhën amtare i mundëson nxënësit, jo vetëm të realizojë

komunikimin, kur aftësia gjuhësore nuk është e mjaftueshme, por edhe të zbulojë analogjitë dhe ndryshimet midis dy gjuhëve. Sipas Françoise Cormon (1991 : 31-77) gjuha amtare e nxënësit nuk duhet të ndihet si një pengesë në mësimnxënien e gjuhës së huaj, por duhet të konsiderohet si një faktor progresi. Ndërkohë që përvetësohet ndërgjuha e nxënësit, gabimet që lidhen me transferimet nga gjuha shqipe, janë më të shumta, po ashtu edhe transferimet nga një gjuhë e huaj si në rastin tonë anglisht. Në mjaft raste, këto transferime gjuhësore janë burimi i gabimeve, të cilat ne u përpoqëm t'i vëmë në dukje. Pikërisht trajtimi i këtyre gabimeve do të ndihmonte në përmirësimin e performancës gjuhësore të nxënësve shqipfolës në frëngjisht.

BIBLIOGRAFI

Besse H, Porquier R. (1991) *Grammaire et didactique des langues*, CREDIF, HATIER/Didier.

Conseil de la coopération culturelle (2001). *Un cadre européen commun de référence pour les langues : apprendre, enseigner, évaluer*, Strasbourg, Didier.

Cormon, F. (1992). *L'enseignement des langues : théorie et exercices pratiques*, Lyon: Chronique sociale, DEBYSER, F., *La linguistique contrastive et les interférences*, dans *Langue français n°8*, décembre 1970, pp.31-61.

Gass, S. *Integrating research areas: A framework for second language studies*. *Applied Linguistics* 9, 1988, 197-217

Hendrickson, J. M., *Evaluating spontaneous communication through systematic error analysis*. *Foreign Language Annals*, 12 (5), 1979, 357-364

Herdina, P. & U. Jessner (2002) *A dynamic model of multilingualism: Perspectives of change in psycholinguistics*. Clevedon.

Tagliante, C. (1994) *La classe de la langue*, Paris, CLE Internationale.

Vogel, K. (1995) *L'interlangue la langue de l'apprenant*. Traduit de l'allemand par Jean-Sébastien Roux et Patrick Bonin. Toulouse: Presses Universitaires du Mirail II.

PËRSIATJE RRETH NOCIONIT TË QYTETARISË, IDENTITETIT KOMBËTAR DHE MARRËDHËNIA NDËRMJET TYRE NË KUADRIN E GLOBALIZMIT

DENISA TITILI

MARIA DOJÇE

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Të gjitha vendet përballen me sfida të reja në lidhje me mënyrën sesi ne e kuptojmë sot identitetin kombëtar, dhe rëndësia që merr identiteti kombëtar në kontekstin e qytetarisë globale. Konfliktet ndërmjet grupeve të ndryshme dhe marrëdhëniet e pushtetit, që dominojmë ato, disa prej të cilave gjenden në baza kombëtare, janë pjesë e realitetit të përditshëm të të gjitha vendeve. Proceset e integritit rajonal dhe global po na udhëheqin në drejt rikonceptimit të pozicioneve të identitetit individual dhe kolektiv. Çështja e qytetarisë përbën një problem madhor, i cili bëhet i tillë dita-ditës, ndërkohë që teoricienët reflektojnë mbi krizat e shumta që po e bëjnë qytetarinë gjithnjë e më tepër problematike. Nisur nga rëndësia që merr debati mbi qytetarinë dhe identitetin kombëtar, ne synojmë që të bëjmë një trajtim të raportit mes tyre duke u përpjekur të argumentojmë nëse zhvillimi i qytetarisë në kuadrin e globalizmit dhe kërkesës për multikulturalizëm, mund të qëndrojë në themelet e kombësisë.

Fjalët çelës: *qytetaria, identiteti kombëtar, qytetaria globale, globalizmi, qytetaria kozmopolite.*

Abstract:

All countries face new challenges about the way we understand national identity now days, and the importance of national identity in the context of global citizenship. Conflicts between different groups and relations of power that dominate them- some of which are found in national base - are part of the everyday reality of all countries. Regional and global integration processes lead us toward redesigning the positions of individual and collective identity. The issue of citizenship is a serious problem, which becomes even more problematic day by day, while theorists reflect on the multiple crises that are making citizenship increasingly problematic.

Due to the importance of the debate over citizenship and national identity, this paper aims to highlight the relationship between them trying to argue whether the development of citizenship in the context of globalization and demand for multiculturalism, can stand on the foundations of nationality.

Key words: *Citizenship, National Identity, Global Citizenship, Globalization, Cosmopolitan Citizenship*

1. Kuptimi mbi qytetarinë

Qytetaria mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme. Në antikitet dhe mesjetë qytetaria nënkuptonte të drejtën e pjesëmarrjes në procesin e vetëqeverisjes së popullit, ndërsa në botën moderne qytetaria i referohet statusit ligjor. Qytetarë janë të gjithë njerëzit të cilët janë anëtarë të komunitetit politik sovran (Smith M. R, 2002: 105).

Pavarësisht se, kuptimi i qytetarisë moderne është i ndryshëm prej qytetarisë antike dhe mesjetare, përsëri nocioni i qytetarisë vazhdon të ruajë diçka nga kuptimi i mëparshëm: rëndësia e statusit politik për mirëqenien, jo vetëm të atyre që e gëzojnë këtë status, por edhe të atyre që nuk e gëzojnë. Zhvillimet që karakterizuan shekullin XXI shtruan nevojën për një rikonceptim të nocionit të qytetarisë. Kështu, grupe të ndryshme të marginalizuara të cilat kishin qenë të përjashtuara nga qytetaria moderne (grupe etnike, racore, seksuale) filluan të kërkojnë të drejtat e tyre.

Në literaturën akademike nocioni i qytetarisë merr kuptime të ndryshme. Kështu, liberalët e shohin si një status legal bazuar te kombësia, në termat e shtetit të lindjes/origjinës dhe të drejtat dhe detyrimet në lidhje me këtë shtet. Në

konceptimin republikan qytetaria shihet si mundësi për pjesëmarrje politike, që nënkupton procesin formal të votimit, pra aktet e qytetarisë dhe mobilitetit politik në një shoqëri civile.

Pavarësisht këtyre përkufizimeve, qytetaria lidhet me identitetin kombëtar. Qytetarët i përkasin një komuniteti ekskluziv politik dhe ndajnë një histori të përbashkët dhe të ardhmen prospektive.

Megjithatë, duhet theksuar se sot marrëdhënia mes qytetarisë dhe kombit po vihet në diskutim (Nash. K, 2009:1067-1068). Proceset e globalizimit, migrimi në shkallë të gjerë, vendosja e individëve në vende të cilat ishin homogjene nga përbërja raciale e kulturore, duket se po çon drejt idesë se statusi i qytetarit, të drejtat dhe identiteti po bëhen gjithnjë e më tepër pa lidhje me njëra-tjetrën. Në kuptimin më të ngushtë qytetaria përcaktohet si marrëdhënia juridike mes individit dhe shtetit, (Sassen S, 2002:278).

Weber ishte sociologu i parë që trajtoi origjinën e qytetarisë moderne. Themelet e qytetarisë demokratike sipas argumentit weberian konsistojnë në ndarjen mes qytetit (në kuptimin weberian) dhe Zotit, që karakterizoi shoqëritë perëndimore, (Turner S. B, 2002:260).

Aktualisht, tri teoritë kryesore të cilat na ndihmojnë të kuptojmë konceptin e qytetarisë janë: liberalizmi, komunitarizmi, dhe qasja republikane mbi qytetarinë.

Qasja liberale e konsideron qytetarinë si një grup i të drejtave të veçanta që i janë dhënë individit nga ana e shtet-kombit. Individu ka të drejtë të zgjedhë se kur dhe nëse do të ushtrojë këtë të drejtë. Kritikët argumentojnë se përkufizimi i qytetarisë liberale ka një konceptim të kufizuar të të drejtave të grupit.

Përkundër pikëpamjes liberale, qasja komunitariste thekson nocionin e komunitetit dhe kërkon të vendosë individin brenda grupit. Edhe pse komunitarizmi nuk e kundërshton konceptimin liberal mbi të drejtat individuale, ajo thekson rëndësinë e të drejtave individuale brenda kontekstit të interesave të grupit, pasi individ nuk është i izoluar prej komunitetit të tij.

Ndryshe nga liberalizmi dhe komunitarizmi, qasja republikane nuk vë në plan të parë as individin as komunitetin. Në vend të kësaj, ajo vë një theks të fortë në idenë e "identitetit qytetar", që ndajnë të gjithë qytetarët në ndjekje të interesave të përbashkëta të cilat nuk pengojnë qëllimet individuale.

Seyla Benhabib hedh argumentin se qytetaria, sot, po bëhet kozmopolite përmes zhvillimit në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut, veçanërisht brenda Evropës (Nash K, 2009:1068).

Koncepti i kozmopolitizmit u zhvillua nga shekulli i 18-të (Kanti, Ruso etj), një paradigmë sqaruese që ka në thelbin e vet supozimin themelor se të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejta të barabarta si anëtarë të një njerëzimi të vetëm. Imagjinata kozmopolite e koncepton komunitetin global si kozmopolit. Kjo thirrje përbën në thelb një "angazhim ndaj parimeve dhe normave humaniste, një supozim i barazisë njerëzore, me një njohje të ndryshueshmërive, dhe një festë e diversitetit". Në këtë kuptim kozmopolitarizmi është i lidhur ngushtë me konceptin e të drejtave të njeriut, të cilat janë themeluar mbi të njëjtat supozime të barazisë, universalitetit dhe dinjitetit të të gjitha qenieve njerëzore.

2. Identiteti kombëtar dhe qytetaria

Të kuptuarit drejt të këtij raporti, problem që në fakt karakterizohet nga ambiguiteti, kërkon një qartësim edhe të nocionit të identitetit përgjithësisht dhe atij kombëtar veçanërisht. Amin Maluof (2006) argumenton se identiteti i një personi përcaktohet nga një grup elementësh. Të gjithë njerëzit i përkasin një tradite të caktuar fetare, një kombësie, nganjëherë dy kombësive, një grupi etnik, apo gjuhësor, një tradite kulturore, një familje, një

grupi social, një institucioni, një shoqate, një partie, një komunitet njerëzish. Identiteti përbëhet nga një shumëpërkatësi, por është një, dhe ne e jetojmë si të vetme.

Identiteti im kombëtar, fetar, kulturor më integron mua brenda komunitetit tim kombëtar, fetar, kulturor. Asnjë përkatësi nuk mund të mbizotërojë në mënyrë absolute. Në çdo kohë ekziston midis elementeve që përcaktojnë identitetin e secilit, një lloj hirearkie e cila nuk është e pandryshueshme. Ajo ndërron me kalimin e kohës dhe modifikon thellësisht qëndrimet tona. Nëse na kërcënohet kombi është përkatësia kombëtare ajo që zgjohet mbi të tjerat, nëse na kërcënohet feja është përkatësia fetare ajo me të cilin individ përfordon lidhjet e tij.

Sot, ajo që qëndron në krye të hirearkisë është përkatësia kulturore. Por, edhe identiteti kulturor nuk është aspak një fakt i dhënë njëherë e përgjithmonë, identiteti kulturor është një kontinuum në ndryshim. Kultura mbart të kaluarën por është edhe treguesi i shndërrimit dhe manipulimit të tipareve të fituara.

Identiteti kulturor i përbashkët për një bashkësi njerëzish, qoftë që rrjedh ky nga një organizim fisnor, një organizim fetar ose shtetëror, bashkë me trashëgiminë e gjuhës e mendësisë, është vetëm një nga elementet që përbëjnë tërësinë e qenies njerëzore (Klosi A, 2007:71).

Çështja e identitetit ka ngërthyer një sërë debatesh, polemikash e argumentesh mes akademikëve, opinionistëve dhe njerëzve të mendimit. Kështu në polemikën ndaj Kadaresë, Qose (2006) mohon tezën se identiteti është diçka e ngurtë dhe e përcaktuar njëherë e mirë nga gjeografia, historia, kultura, raca etj dhe si i tillë ai nuk duhet të pësojë ndryshime gjatë rrjedhës së kohës dhe ngjarjeve (vepër e cituar: Sulstarova E, 2012:392).

Në të njëjtën linjë argumentimi qëndron edhe studiuesi Enis Sulstarova (2012) kur thekson se identitetet nuk janë të dhënë në mënyrë përfundimtare nga biologjia e historia, por janë të ndërtueshëm nga vetë aktorët në rrethanat shoqërore ku ata ndodhen.

Pra, nëse do të pyesnim nëse identitetet janë të dhëna apo të konstruara, përgjigja do të ishte: identitetet janë të konstruara dhe të ndryshueshme në ambientin social.

Për më tepër sot në epokën e përbotëzimit, në këtë përzierje të vullshme që na ka përfshirë të gjithëve po na imponohet një koncept i ri i identitetit. Zhvillimi i sotëm mund të favorizojë daljen e një përcaktimi të ri të nocionit të identitetit, i cili duhet të kuptohet si një bashkësi e të gjitha

përkatësive tona, ku në qendër të të cilave do të ishte përkatësia ndaj komunitetit njerëzor, si më e rëndësishmja, por pa fshirë përkatësitë tona të shumëfishta e të veçanta.

Njeriu nuk është aspak nga të gjitha kohët e nga të gjitha vendet, por çdo periudhë historike dhe çdo komb të rruzullit tokësor i përgjigjet një tip njerëzor specifik (Finkelkraut A, 1999:10).

Sipas Fystel dhe Kulanzhi "Ajo që i dallon kombet nuk është as raca, as gjuha. Njerëzit ndjenjë në zemrën e tyre se janë një popull i vetëm kur kanë një përbashkësi idesh, interesash, afeksionesh e kujtimeve. Ja se çfarë është atdheu... atdheu është ai që ne duam" (Finkelkraut A, 1999:30).

Pra, përkufizimi "unik" mbi kombin si bashkësi e lindur në procesin e ndarjes së punës në epokën e kapitalizmit, mbi baza të gjuhës së përbashkët, territorit, kulturës dhe afërsisë së përbashkët etnike, nëse mund të vlejë për disa kombe europëroëndomore nuk mund të jetë teori universale (Hasani I, 2001:41).

Ndjenja kombëtare nuk buron nga një determinim i pavetëdijshëm, por nga një zgjedhje e lirë. Pra ne luhatemi mes një identiteti kombëtar dhe një identiteti planetar.

Identiteti lind nga një marrëdhënie e re me kohën dhe hapësirën (Malouf A, 2006).

Urs Altermatt (2002) thekson se çdo organizëm multietnik përshkon periudha në të cilat qytetarët e tij e vlerësojnë ndryshe shtetin, kombin, etnicitetin, kulturën, pasi njerëzit gjatë jetës së tyre edhe mund t'i ndryshojnë identifikimet e tyre.

Problemi i identitetit bëhet edhe më kompleks kur është fjala për identitetin etnik dhe raportet e minoriteteve etnike me popullsinë kombëtare. Identitetet etnike janë të trashëguara, pra duket se identiteti etnik mbetet i pandryshueshëm, ndërsa identiteti kombëtar është një proces fluid në negociatave të vazhdueshme me grupet e tij përbërëse. Identitetet singulare nuk mund të formohen në kurriz të identiteteve të përbashkëta kombëtare, edhe pse kjo duhet të përpunohet përmes negociatave e jo imponimit të karakteristikave të përbashkëta dhe fatit të përbashkët. Fuqia e identitetit mbetet e fortë. Kjo është fuqia e lidhjes me një grup minoritar, i cili u jep kurajo për të kërkuar të drejtat, ose për të sfiduar shumicën në praktikave të veçanta, të pandjeshme dhe diskriminuese.

Çështja që shtrohet sot në kuadrin e globalizimit dhe shndërrimit të shteteve në komunitete multikulturore është: A përbën ende identiteti kombëtar një komponent kyç të qytetarisë?

Shumica e qëndrimeve mbi qytetarinë pohojnë një lidhje të nevojshme me shtetin kombëtar. Sot po bëhet gjithnjë e më tepër evidente që institucioni i qytetarisë ka dimensione të shumëfishta, disa prej të cilave mund të lidhen pazgjidhshmërisht me shtetin kombëtar (Sassen S, 2002:277).

Koncepti i qytetarisë ka një gamë të gjerë të kuptimeve që shtrihen përtej thelbit të saj si një status ligjor. Në literaturën akademike, qytetaria presupozon ekzistencën e institucioneve demokratike të qeverisjes dhe i referohet një tërësie të të drejtave ligjore apo morale dhe detyrimeve, apo formave individuale dhe kolektive të pjesëmarrjes në sferën publike. Pavarësisht se ne e njohim rëndësinë e lidhjes së qytetarisë si një status ligjor me debatet e gjera sociologjike dhe normative, ne e kufizojnë përdorimin tonë të konceptit në kuptimin thelbësor ligjor. Pra e thënë ndryshe qytetaria dhe shtetësia i referohen statusit ligjor të një individi si pjesëtar i një shteti.

Qytetaria përfaqëson një nocion politik, që rrjedh nga marrëdhënia e individit me shtetin, ndërsa kombi i referohet me tepër aspektit kulturor.

Kombi është një koncept kulturor, që i bashkon njerëzit në bazë të një identiteti të përbashkët, si bashkësi e imagjinuar (Baliqi B, 2009:14).

Ajo që synohet sot është të ofrohen mënyra të reja për të konceptualizuar qytetarinë, për të ofruar një një model të ri të qytetarisë që do të sfidojë vlerat kulturore dhe interesat dominante, i cili do të ofrojë mundësi të barabarta për të gjitha grupet për të marrë pjesë në sferën politike dhe për të legjitimuar dallimet midis grupeve.

Qytetaria nuk nënkupton heqjen dorë nga identiteti nacional. Nocioni i qytetarisë nënkupton të jetuarit si një bashkësi, respektimin e ndryshueshmërisë së tjetrit, respektimin e demokracisë dhe lirive e të drejtave, respektimin e historisë dhe trashëgimisë kulturore.

Nocioni i qytetarisë nuk e cenon identitetin kombëtar dhe aq më pak e rrezikon atë.

Nacionalizmi nuk do të zhduket por modeli i qytetarisë kombëtare, dhe kuptimin i "kombit" do të ndryshojnë (Tambini. D, 2001:207).

3. Migrimi- kombësia- qytetaria

Nocioni i qytetarisë përbën një koncept të vonë, i lidhur ngushtë me proceset e migrimit dhe globalizimit. Nisur nga kjo e gjej me vend të theksoj se ka nevojë për një konceptualizim të ri të qytetarisë, lidhur me mënyrën sesi grupet ndërtojnë përkatësinë e tyre, si edhe lidhur me fluiditetin e identitetit grupor në kontekstin e globalizimit dhe ndërkombëtarizimit.

Mobiliteti i punës ka çuar në rritjen e diversitetit kulturor dhe kompleksitetit të shumë

shoqërive. Dukuria e migracionit nuk përbën diçka të re, por tani ndodh në një kontekst të ri. Mobiliteti në shkallë të gjerë dhe dukuritë migratore kanë bërë që emigrantët sot të sjellin me vete kulturën e tyre, duke çuar kështu gradualisht drejt krijimit të shteteve shumëkulturore. Në një kontekst të tillë, shtet-kombet nuk duhet të qeverisin përmes kulturës. Kjo nuk ka kuptimin që institucionet kombëtare do të zhduken papritur.

Termi "komb" mbetet i vlefshëm si një burim i legjitimitetit pavarësisht ndryshimeve që iu referohemi, ndërsa kuptimi dhe institucionet e e qytetarisë kombëtare do të vazhdojnë të ndryshojnë.

Politikat shtetërore të migracionit janë projektuar rreth dy qëllimeve kryesore: të përcaktojnë se cilët mund të hyjnë në vend dhe mund të bëhen shtetas të tij. Çdo shtet-komb zhvillon lidhjet dhe rregullat e veta për ata që shteti i njuh si shtetas të tij dhe për ata që janë imigrantë. Qytetaria përcaktohet nga studiuesit si një tërësi e praktikave ekonomike dhe kulturore, tërësi e të drejtave politike dhe civile dhe detyrimet që karakterizojnë anëtarët e një sistemi shtetëror të veçantë. Sipas këtij përcaktimi ata të cilët nuk posedojnë të drejtat politike dhe sociale nuk konsiderohen si qytetarë të shtetit dhe në këtë mënyrë janë të përjashtuara nga ushtrimi i këtyre të drejtave. Pra qytetaria përkufizohet si një tërësi e të drejtave ekonomike, politike e civile, si edhe praktikave kulturore, së bashku me detyrimet që kanë individët brenda komunitetit politik, anëtarë të të cilit ata janë. Pra qytetaria përfaqëson, në këtë kuptim status dhe praktikë.

Ka një konfuzion terminologjik në studimin e statusit të qytetarit dhe ligjeve. Në disa shtete, bëhet një dallim mes kombësisë si një status i pavarur prej qëndrimit/rezidencës dhe qytetarisë, si një paketë e të drejtave të dhëna vetëm për shtetasit që banojnë në territorin e shtetit përkatës. Në shumicën e gjuhëve evropiane, termi kombësi gjithashtu mund t'i referohet të qenit anëtar i një kombi, në kuptimin e një bashkësie kulturore, etnike dhe historike më tepër sesa një entiteti juridik. Ndonjëherë, nacionaliteti është në kontrast edhe me kombin, në rastet kur grupet kombëtare dominante veçohen nga pakicat kombëtare.

Termi qytetar rrjedh nga fjala qytet, edhe pse është përdorur fillimisht për të dalluar banorët e qytetit nga të tjerët, termi qytetar tani përdoret zakonisht për të përshkruar të gjitha subjektet juridike të shtetit. Në terminologjinë juridike shqiptare, kombësia është përdorur për të përcaktuar përkatësisë kombëtare të një personi, duke iu referuar vetëm përkatësisë etnike e

gjuhësore dhe jo të lidhjeve ligjore. Termi "komb" është përdorur për të përshkruar një komb si një e tërë, pavarësisht gjendjes së banimit.

Sot, endencat globalizuese dhe përpjekjet për unifikimin e legjisllacionit dhe politikave ndërmjet shteteve-komb si edhe përparësia e së drejtës ndërkombëtare ka çuar drejt njohjes, respektimit dhe garantimit të të drejtave për të gjithë personat e pranishëm në një shtet, përfshi edhe imigrantët pavarësisht nga statusi i tyre ligjor apo kohëzgjatja e qëndrimit (Ikonomi L, 2009: 28). Qëllimi është që politikat e ndjekura nga shtetet të jenë të përshtatshme jo vetëm me kushtet dhe traditat kombëtare, por të respektojnë parimin e trajtimit të barabartë për migrantin si në vendin e origjinës edhe në atë të destinacionit.

4. Nevoja për një qytetari globale

Qytetaria globale është bërë një koncept i rëndësishëm, i nxitur nga edukimi global, por pavarësisht se është përdorur vazhdimisht, shpesh mbetet i padefinuar dhe abstrakt. Ndërsa koncepti i qytetarisë është i lidhur tradicionalisht me një nivel kombëtar dhe shtetëror, ka një sfidë në rritje për të adresuar perspektivën globale në qytetari.

Edukimi global synon të na ofrojë një kuptim më të mirë të problemeve globale dhe të na furnizojë me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që na duhen si qytetarë të botës në mënyrë që të përballen me sfidat globale. Proceset globalizuese dhe praktikave të shumëkulturalizmit kanë një impakt të pashmangshëm edhe mbi qytetarinë (Kymlica W, 2010:106).

Shfaqja e konceptit të qytetarisë globale shkaktonte debat në lidhje me identitetin kombëtar në kontekstin global, pasi ai ridefinon mënyrën se si ne e kuptojmë rolin e shtet-kombit, mënyrën se si ne imagjinojmë identitetin (kombëtar) dhe mënyrën se si ne e konceptualizojmë qytetarinë. Kjo vë në pikëpyetje rolin e qytetarit (pra kush është një qytetar global?) dhe atë se çfarë është një komunitet global qytetarësh. Edhe pse qytetaria globale pretendon të shkojë përtej shtet-kombit, ky supozim është vënë në pikëpyetje kur ne mendojmë për rëndësinë që ende luan shtet-kombi në botën e globalizuar. Procesi i globalizimit i ka kthyer shqetësimet e djeshme lokale (ekonomike, mjedisore...) në shqetësime globale. Numri i sfidave është në rritje dhe kështu është edhe diversiteti i tyre.

Koncepti i qytetarisë globale vë në pikëpyetje pikëpamjet që mbizotërojnë rreth identiteteve tona, të tilla si, për shembull, identiteti kombëtar. Çështja e identitetit kombëtar është e lidhur ngushtë me çështjen e qytetarisë globale, pasi qytetaria mendohet më shpesh në kuadër të shteteve

kombëtare. Por, çështja që shtrohet është a e kundërshtojnë njëra-tjetrën ideja e qytetarisë globale dhe identiteti global, apo ato përfaqësojnë dy anë të të njëjtës monedhe? Në një botë gjithnjë e më të ndërvarur, ndërtimi i identitetit mbi bazë të racës, kombësisë, fesë etj është pengesë për një botë më të qetë, të drejtë dhe të qëndrueshme apo ato janë pjesë e saj gjithëpërfshirëse? Ideja e qytetarisë globale nxit idenë e identitetit global, të komunitetit dhe solidaritetit global apo jo?

Ndërrime strukturore të tilla si globalizimi dhe lëvizshmëria në rritje e kapitalit mendohet gjerësisht se kërcënojnë qëndrueshmërinë e kombeve si njësi politike dhe sociale. Në këtë kontekst, një copëtim i ri është shfaqur në teorinë politike dhe sociale. Teoricienët e qytetarisë post-nacionale përshkruajnë mënyrat në të cilat format e reja të të drejtave, pjesëmarrja dhe përkatësia po e zhvendosin qytetarinë kombëtare, veçanërisht në Evropë.

Kundërshtarët e kësaj pikëpamje argumentojnë se forma të tilla emergjente do të minojnë format e veprimit dhe solidaritetit mbi të cilin varet komuniteti politik: ata argumentojnë se kombi është një parakusht i qytetarit pjesëmarrës dhe prandaj duhet të mbrohet. Qytetaria kufizohet kryesisht në dimensionin kombëtar, ndërsa kombësia i referohet një dimensionit ligjor ndërkombëtar në kontekstin e një sistemi ndërshtetëror. (Sassen S, 2002:278).

Studiues të ndryshëm argumentojnë se zhvillimi i ekonomisë ndërkombëtare, transportit dhe sistemeve të komunikacionit, në kuadrin e të ashtuquajturit “globalizëm” po e bëjnë të pavlefshëm nocionin tradicional të qytetarisë kombëtare.

Teoricienët argumentojnë se kthimi në qytetarinë kombëtare nuk është i realizueshëm në kushtet bashkëkohore, dhe se një projekt më i dobishëm do të ishte përpjekja për të kuptuar se si institucionet e shtetësisë, të drejtave, pjesëmarrjes dhe përkatësisë mund të transformohen nga proceset aktuale (Tambini. D, 2001:195).

Proceset globalizuese kanë një ndikim të dyfishtë te qytetaria. Nga njëra anë rritja globale e rrjedhjes së kapitalit, punës, ideve, imazheve etj, ka bërë që burimi i autoritetit mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë të zgjerohet nga shteti-komb drejt organizmave ndërkombëtare. Nga ana tjetër dominimi i qyteteve kozmopolite ka sfiduar parimet sovraane të shtet –kombeve (Isin F.E, 2002: 123).

Ajo që kërkohet sot në erën globale nuk është ta nxitim kombin të përqafojë e të dhurojë vetveten duke iu kundërvënë të tjerëve me gjuhën, artin, filozofinë, më “kulturën” e tij. E gjitha kjo duhet të kuptohet si një përpjekje për të theksuar nevojën

për të kuptuar qytetarët si qenie komplekse me identitete të shumëfishta. Në këtë kuadër politikat postmoderne po e vënë theksin tek nocioni i qytetarisë globale si njohje dhe plotësim i kërkesave të ndryshme e deri të kundërta. Kuptimi i sotëm për qytetarinë në botën postmoderne i referohet të gjithë atyre që i përkasin shoqërisë njerëzore, qoftë ky komunitet politik, apo ndonjë grup tjetër.

Duke përfunduar këtë parashtrim teorik mbi nocionin e qytetarisë dhe identitetit kombëtar dhe raportin ndërmjet tyre, veçanërisht në shoqërinë bashkëkohore vlen të theksojmë, se ka një nevojë të theksuar për njohjen dhe qartësimin e termave të qytetarisë dhe nocionit tejet të diskutueshëm të identitetit me qëllim që të kuptohet drejt marrëdhëniet mes tyre. Kjo njohje do të jetë e vlefshme për të shmangur keqpërdorimet e nocioneve dhe keqkuptimet të cilat çojnë drejt përshtypjeve të gabuara se zhvillimi i qytetarisë dhe edukimi me vlerat e qytetarisë bëhet në kurriz të identitetit kombëtar dhe se identiteti kombëtar nga ana tjetër pengon zhvillimin e qytetarisë.

Vitet e fundit ka një rritje të interesit mbi çështje të qytetarisë. Çdo përpjekje për të reflektuar mbi këtë temë teorikisht duhet të adresojë në një sërë pyetjesh që kanë të bëjnë me dallimin ndërmjet “vendasve” dhe “të huajve” me qëllim që të sigurohet për të gjithë individët brenda një shoqërie politike një ndjenjë e anëtarësimit të plotë në jetën shoqërore e politike. Nevoja për të rishqyrtuar çështjen e qytetarisë lidhet në mënyrë të veçantë me shpërthimet e vazhdueshme të nacionalizmit modern dhe përplasjeve etnike, duke përfshirë edhe sfidat lokale dhe globale për integritetin e shtetit modern.

Shumica e qëndrimeve mbi qytetarinë pohojnë një lidhje të nevojshme me shtetin kombëtar. Kjo ka kuptimin se derisa qytetaria nënkupton një tërësi të të drejtave të veçanta që i janë dhënë individit nga ana e shtet –kombit, atëherë është pikërisht shtet-kombi ai që siguron e garanton këto të drejta për qytetarët e vet. Pra ka një qasje që e sheh qytetarinë si pjesë të identitetit kombëtar, pasi është shteti ai që shpërndan të drejtat dhe detyrimet ndaj individëve.

Por, ndërsa qytetaria, sipas këtij përcaktimi, mbetet e kufizuar brenda dimensionit kombëtar, shtetësia i referohet një dimensionit ligjor ndërkombëtar, në kuadrin e një sistemi ndërshtetëror. E drejta ndërkombëtare pohon që secili shtet përcakton se cili do të quhet shtetas dhe cili jo. Në këtë mënyrë ligjet e brendshme lidhur me përcaktimin e shtetasve variojnë nga një shtet në një tjetër dhe në këtë mënyrë ndryshon edhe përcaktimi mbi qytetarinë. Për më tepër format e

reja të modernizimit dhe industrializimit si edhe migrimi në shkallë të gjerë shtrojnë nevojën për një kuptim të ri të identitetit. Proceset e integritit rajonal dhe global po na udhëheqin drejt rikonceptimit të pozicioneve të identitetit individual dhe kolektiv.

Për këtë arsye identiteti kombëtar duket se nuk përbën më nocionin kyç të qytetarisë.

Sot, po bëhet gjithnjë e më tepër evidente se përtej të qenit unik, *institucioni i qytetarisë* ka një

dimension të shumëfishtë, vetëm një pjesë e vogël e të cilave janë të lidhura pazgjidhshmërisht me shtetin kombëtar. Dukuritë e reja po spostojnë perspektivat e vjetra, duke hapur perspektiva të reja për të ardhmen dhe për t'i parë në mënyrë alternative zhvillimet e reja. Në këtë mënyrë debatet e sotme shtrojnë nevojën për një denacionalizim të qytetarisë dhe vendosjen e qytetarisë përtej kufijve të shtetit kombëtar. Qytetarizmi duhet të jetë unitar dhe i padiferencuar.

BIBLIOGRAFI

Altermatt Urs., *Etnonacionalizmi në Evropë*, Tiranë 2002, Phoenix

Baliqi Bekim., *Teoritë mbi identitetin kombëtar dhe shtetëror*, 2009, www.scribd.com

Discourses and practices of Citizenship, *Social and Legal Studies*, Vol. 8 No. 4, 457-483, SAGE Publications, 1999.

European Perspective, *Cultural Sociology*, 6(1), 113-128, Sage Publication 2012

Finkelkraut Alain., *Disfata e mendimit*, Tiranë, Shtëpia Botuese "Marin Barleti, (Përkthim), 1999.

Hasani Ismail., *Vetëdija fetare dhe kombëtare tek shqiptarët*, Universiteti i Prishtinës, 2001

Isin F. Engin & Turner S. Bryan., *Handbook of Citizen Studies*, SAGE Publications, 2002

Kymlica Will., The rise and fall of multiculturalism? New debates on inclusion and accomodation in diverse societies, *International Social Science Journal*, 199, 97-112, Sage Publication, 2010.

Malouf Amin., *Identitete vrastare*, Tiranë, Onufri, (botimi i dytë), 2006.

Nash Kate., *Between Citizenship and human rights*, Volume 43(6), 1067-1083, Sage Publication, 2009.

Purvis Trevor & Hunt Alan., *Identity versus Citizenship: Transformations in the*

Stevenson Nick., *Cosmopolitan education and cultural citizenship: A Critical*

Sulstarova Enis., *Jam Evropë- Intelektualët dhe ideja e Evropës në vitet 1918-1939 dhe 1989-2006*, Shtëpia Botuese Logos-A, 2012.

Susa, R & Vodopivec B., *National identity in the context of global citizenship*, SLOGA, Slovenia, 2011.

KUPTIMI I GJITHËPËRFSHIRJES SË NXËNËSVE NË KLASA NORMALE

DONIKA DARDHA

MARIELA BURDA

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Arsimi gjithëpërfshirës është përfshirja e të gjithë fëmijëve në shkolla të zakonshme ku jepet arsim sipas nevojave. Arsimi gjithëpërfshirës është një proces i nisur në vitet '80-të të shekullit të kaluar dhe po përparon me ritme të shpejta. Arsimi gjithëpërfshirës i mirëpret ndryshimet që kanë nxënësit në të mësuar dhe krijojnë një mjedis mikpritës për të gjithë fëmijët, duke krijuar tek ata ndjesinë se i përkasin shkollës. Fëmijët me nevoja të veçanta edukimi janë fëmijë si gjithë të tjerët, për këtë arsye duhet të edukohen në të njëjtat shkolla dhe klasa me mbështetjen që iu nevojitet. Përfshirja është përkatësi dhe do të thotë se nxënësit me nevoja të veçanta i përkasin bashkësisë së nxënësve të shkollës, marrin pjesë emocionalisht në këtë bashkësi dhe pranohen prej të tjerëve si të barabartë. Arsimi gjithëpërfshirës varet shumë prej punës së mësuesve në klasa, prej mënyrës se si e organizon shkolla programin edukativ dhe prej faktorëve të tjerë jashtë shkollës si familja dhe komuniteti.

Fjalë çelës: *arsimi gjithëpërfshirës, plan individual, praninë në klasa normale, integrim, nxënës me nevoja të veçanta edukimi.*

HYRJE

Zhvillimet e vrullshme kulturore të shekullit XXI, në mënyrë progresive dhe të gjithanshme kërkojnë kontributin e të gjithë anëtarëve të shoqërisë globale. Proceset e edukimit luajnë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e brezave të aftë për Shekullin e Ri. Nuk mund të arrihen objektivat për një shoqëri shumëkulturore, të teknologjisë dhe informacionit pa u kujdesur për edukimin e brezave të rinj me profesionalizëm dhe pasion. Uk mund të ndërtohet një botë të denjë për të gjithë anëtarët e saj, po qe se nuk kujdesesh për mirëqenien, zhvillimin dhe përparimin e përgjithshëm të tyre.

Për më shumë, nuk mund të garantosh jetëgjatësinë e këtyre zhvillimeve pa u përkushtuar për fëmijët, për aftësitë dhe paaftësitë e tyre, për nevojat, dëshirat dhe pasionet e tyre.

Shoqëritë dallohen nga njëra-tjetra para së gjithash nga mënyra se si i rritin, edukojnë dhe përkujdesin të gjithë fëmijët pa përjashtim.

Në shoqërinë globale një miliard njerëz jetojnë me një paaftësi, që përfshin pothuajse 15% të popullsisë së botës. Nga këta 93 milion janë fëmijë me një paaftësi të moderuar ose të ashpër; ata janë 1 ndër 20 fëmijë të moshës 0-14 vjeç.

Në shumicën e vendeve me të ardhura të ulëta ose mesatare këta fëmijë kanë më shumë mundësi të jenë jashtë shkolle se sa grupe të tjera. Në disa vende, të paturit e një paaftësie dyfishon shansin e një fëmije për të braktisur shkollën. Të drejtat e miliona fëmijëve me paaftësi nuk janë realizuar ende; është jetësore që shtetet të sigurojnë kushtet për realizimin e të drejtës për një edukim cilësor dhe të barabartë

Shembuj të pafund nga jeta e njerëzve të zakonshëm dhe nga njerëz të shquar, dëshmojnë se paaftësitë në fusha të caktuara nuk mund të pengojnë zhvillimin e aftësive, talenteve dhe pasioneve të mëdha. Kështu mund të përmendim: G. Washington, W. Wilson, P. Roosevelt, W. Churchill, Beethoven, Mozart, V. Gogh, Walt Disney, Edison, A. Einstein, S. Hawking, Goya, Cher, T. Cruise, W. Goldberg, Ch. Dickens, Alexandër the Great, Paganini etj., të cilët kanë patur vështirësi në të nxënë, në të folur e shkruar, ADHD, disleksi, etj, por historia njihet dhe kontributet e tyre e të çmuara.

Në klasat tona gjejmë fëmijë të tillë, të niveleve të ndryshme, që duhen ndihmuar dhe mbështetur fuqishëm me qëllim që të mos pengojmë "mendje të ndritura". Është në nderin dhe në detyrimin e shoqërisë njerëzore për t'i kushtuar një vemendje të posaçme zhvillimeve edukative, kështu historia do të njihte kontributin tonë.

Gjithëpërfshirja, çështje idesh dhe vizionesh

Në kushtet e një diversiteti social-kulturor, çdo individ është një kombinim unik i një sërë faktorësh biologjikë dhe social-kulturorë. "Zhvillimi dhe të nxënë është produkt i bashkëveprimit të këtyre faktorëve. Kuptimi, shpjegimi dhe interpretimi i tij duhet të shmangë çdo këndvështrim, përjashtues, pa rënë në kurthin e alternativave përjashtuese" (Woolfolk, 2011, fq 28) .

Njerëzit zhvillohen me ritme të ndryshme; në klasat tona gjenden nxënës me aftësi , prirje, kufizime, nevoja, ritme të ndryshme të nxëni dhe motivimi.

Disa nxënës më shpejt, kanë njohuri më shumë, të tjerë nxënës me ngadalë, kanë vështirësi në të kuptuar, vepruar dhe koordinuar veprimet, kanë

nevoja të veçanta. Përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e zakonshme është sfidë e edukimit gjithëpërfshirës. Në kuptimin e përgjithshëm, fjala 'përfshirje' nënkupton gjendjen e të qenurit i përfshirë. Në këndvështrimin leksikor, ky term vjen nga latinishtja "inclusion" dhe i referohet inkorporimit të një elementi në një mjedis të një natyre tjetër, është antonim i konceptit të "përrjashtimit" (Richards, 2008).

Ky koncept aplikohet edhe në shkollë duke nënkuptuar pranimin, akomodimin e çdo fëmije, pavarësisht aftësive dhe paaftësive të tyre, në dallim nga filozofitë arsimore tradicionale që detyrojnë nxënësin të vetintegrohet sipas kërkesave të shkollës.

"Arsimi gjithëpërfshirës" është një proces i nisur në vitet '80 të shekullit XX dhe po zëvendëson me ritme të shpejta arsimin tradicional që përfaqësonte një sistem binar të ndarë në dy komponentë: në arsim të zakonshëm dhe në arsim special. Ky sistem i ka mbajtur fëmijët në dy forma të veçanta edukimi duke kontribuar në përjashtimin shoqëror të fëmijëve më aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta" (Save the children, 2010).

Që prej vitit 1920, sistemi i veçuar i arsimit special ka ardhur duke u zgjeruar dhe fuqizuar deri në fund të viteve '70 të shekullit XX. (Meije, Pijl dhe Hegarty, 1997, p.1).

Megjithë kujdesin e treguar në shkollat speciale nga mësues të specializuar me shprehje profesionale për të plotësuar nevojat e veçanta të fëmijëve në kushte më të veçanta të shkollës, pritshmëritë e tyre nuk përbushnin respektimin e të drejtave themelore të qenieve njerëzore për t'u arsimuar dhe për të jetuar si gjithë të tjerët, sepse këta fëmijë janë si gjithë të tjerët.

"Do të vijë dita kur vendet nuk do t'i çmojnë sipas fuqisë së tyre ushtarake apo ekonomike, as sipas shkëlqimit të kryeqyteteve dhe ndërtesave publike të tyre, por sipas begatisë së popujve të tyre; sipas ndihmës që u ofrohet atyre që janë të rrezikuar dhe në pozita të palakmueshme dhe sipas nivelit të sigurisë përkatëse për zhvillimin fizik dhe psikik të fëmijve të tyre" (Unicef, 2000).

Ligji publik 94-102 në Amerikë i vitit 1975, vendosi futjen e këtyre fëmijëve në klasa kolektive të përbashkëta me nxënësit normalë duke bërë realitet idenë e njerit prej presidentëve të Amerikës, Xh. Washington : *"Të respektosh të drejtat e invalidit është dëshmi e kulturës së një kombi dhe politikës së një shteti"*.

Në fushën e paaftësive janë hedhur hapa të rëndësishme nëpërmjet prezantimit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit, Paaftësive dhe Shëndetit, i njohur ndryshe si modeli biopsikologjik.

Ky model u promovua nga OBSH (Organizata botërore e shëndetësisë 2001) dhe çoi drejt heqjes dorë përfundimisht nga pikëpamjet tradicionale që përqendroheshin në mangësitë, vështirësitë dhe paaftësitë për të bërë një jetë të pavarur. Po kështu, ky model bëri të braktiseshin përfundimisht qasjet tradicionale të ligjëruara për t'u marrë me problemet e njerëzve me vështirësi (Mitra, 2006; Hughes, 2009).

Booth & Ainscow (2002), shpjegojnë, sipas "treguesit të përfshirjes", se një shkollë përfshirëse duhet të luftojë për t'u kthyer në një shkollë demokratike që i pranon të gjithë nxënësit.

Armstrong (2005), thekson "se përfshirja nuk nënkupton vetëm pranimin e nxënësve me paaftësi, por edhe atyre nxënësve me rrezik marginalizimi për arsye sociale, ekonomike dhe politike" (Richards, 2008).

Edukimi përfshirës është i lidhur ngushtë me kontekstin. Zhvillimi dhe të nxënësve shihet si një bashkësi kontekstesh bashkëvepruese duke filluar nga strukturat dhe proceset e brendshme biologjike që ndikojnë mbi zhvillimin si genet, qelizat, ushqimi dhe sëmundjet, e duke mbaruar tek faktorët e jashtëm si familjet, lagjet, marrëdhëniet shoqërore, institucionet arsimore e shëndetësore, periudhat kohore, ngjarjet historike e kështu me rradhë (Woolfolk, 2011).

Arsimi gjithëpërfshirës njihet dhe mirëpret të gjitha ndryshimet individuale të nxënësve si qenie njerëzore unike, që gëzojnë të drejta të barabarta edhe në fushën e edukimit. Është detyrim i shkollës që të krijojë mjedise social- pedagogjike e psikologjike që mbështesin ndjesinë e të qenit pjesë e natyrshme e saj.

Në praktikën shkollëre përdoren termat integrim, përfshirje për të materializuar prirjen që ka shoqëria e sotme demokratike, për t'i vlerësuar e konsideruar qytetarët e saj, para së gjithash fëmijët me qëndrime të barabarta, që kanë në thelb parimet dhe normat e drejtësisë sociale.

Për t'i shprehur më qartë dhe më saktë këto vlera njerëzore, këto dy terma duhen përdorur me profesionalizëm nga mësuesit dhe drejtuesit e arsimit. Përfshirja është një koncept më i gjerë se integrimi dhe pse ky i fundit të çon drejt përfshirjes.

Autorë të ndryshëm Soder (1991), Jordan dhe Poell (1994), Meijer, Pijl dhe Hegarty (1997), vënë në dukje se integrimi kryhet pas veçimit, si një mënyrë për shmangien e tij. Integrimi mund të rezultojë në përshtatjen e programit të përgjithshëm shkollor, për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të nxënësve, por kjo nuk mjafton për përfshirjen. Në variantin më të keq, integrimi çon vetëm në prani fizike të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e

zakonshme dhe në përgatitjen e një versioni të "holluar", të programit shkollor (Save the Children, 2010).

" Por integrimi nuk duhet të jetë thjesht zhvendosje e nxënësve nga shkollat speciale në shkollat e zakonshme dhe as përshtatje e nxënësve me nevoja të veçanta ndaj shkollës, por përshtatje e shkollës ndaj nevojave të të gjithë nxënësve" (Meijer, Pijl dhe Hegarty, 1997, p. 2).

Ky koncept i integritimit i përafrohet përfshirjes, jo thjesht si prani fizike, por si përkatësi në një bashkësi individësh me të drejta të njëjta, 'në shkollë', ku përjetohet procesi i të nxënësve si një ndryshim individual, si rezultat i përvojave të shumta e specifike. Përfshirja nënkupton dëgjimin e të gjithë zërave të fëmijëve dhe, jo vetëm ato më të artikuluar qartësisht dhe socialisht më të besueshme (Richards, 2008). Çdo fëmijë gëzon të drejtat e njeriut, ka personalitetin e tij dhe meriton mundësi zhvillimi të barabarta për t'iu njohur dhe vlerësuar aftësitë e tij, sado të pakta të jenë ato. Kjo është një nga rrugët kryesore të përfshirjes dhe të integritimit në jetën normale.

Për t'u integruar dhe përfshirë në jetën normale, ata kanë nevojë:

- Të trajtohen si individë
- T'u vlerësohen nevojat e tyre
- Të inkuadrohen sa të jetë e mundur në jetën e përditshme
- T'u mësohen gjërat ngadalë, me gjuhë të qartë dhe të thjeshtë
- Të përfshihen në veprimtari e të nxiten të veprojnë vetëm.

Pavarësisht problemeve dhe vështirësive që ata kanë në këto klasa, ajo që vlen është mundësia që u jepet atyre për të bashkëvepruar, komunikuar me të tjerët dhe, për t'u nxitur në veprimtari të jetësore.

" Mendja e fëmijës së mitur ndryshon nga mendja jonë... Kur ne e pranojmë kufizimin tonë për ta arsimuar atë me anë të mësimave gojore, atëherë i tërë koncepti i arsimit ndryshon. Ai kthehet në një çështje për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe jo për të ngulur me forcë në veshët e fëmijës fjalët tona" (Maria Montessori).

Vetë fëmijët dhe prindërit e tyre janë të kënaqur nga përfshirja në klasa normale, sepse ndihen të vlerësuar.

P.sh. A. Xh., nëna e fëmijës Y. Xh., me shikim ekstremisht të kufizuar që vazhdon shkollën e mesme me rezultate të mira, vlerëson pozitivisht mësuesët dhe shokët. Ndërsa një prind tjetër, B.L. shpreh: " kur fëmija im ishte në shkollën speciale dhe mua më duhej të shkoja atje, zemra më pushonte nga ankthi. Ndërsa tani që fëmija ka 2 vjet

në shkollën normale, unë jam shumë e gëzuar për zhvillimin dhe përparimin e tij, ai është kompetent, më social dhe me një vetëbesim të lartë". (Ky fëmijë me prapambetje të lehtë sot vazhdon klasën e nëntë).

Koncepti i edukimit të integruar përfshin edukimin dhe aktualitetin i cili i referohet procesit të vendosjes së studentëve me nevoja të veçanta edukimi në shkolla të zakonshme. Ndërkohë që, si edukimi i integruar dhe edukimi gjithëpërfshirës janë të lidhur me aktualitetin, ato ndryshojnë në qasjen e edukimit për nxënësit me nevoja të veçanta edukimi (NVE). Edukimi i integruar përqendrohet në përshtatjen e nxënësve NVE në shkollat e zakonshme (Hall,1997), ndërsa edukimi gjithëpërfshirës përqendrohet në ndërtimin e klasave të veçanta që krijojnë kushte për NVE, përfshirjen e tyre në klasa të zakonshme, pa marrë në konsideratë ndryshimet individuale apo vështirësitë, duke u krijuar nxënësve me paaftësi mundësi të barabarta mësimi dhe edukimi larg diskriminimit të tyre. Ideologjia e 'edukimit gjithëpërfshirës' është më e parapëlqyera për prindërit, mësuesit, nxënësit dhe ka pritshmëri të mirë; ndërgjegjëson më shumë publikun dhe rrit llojshmërinë e paaftësive në të mësuar, të pranuar në shkollat e zakonshme. Përgjatë viteve, edukimi i integruar dhe gjithëpërfshirës ka ardhur duke u zgjeruar për të mbuluar paaftësitë duke përfshirë ADHD (mungesë përqendrimi dhe çrregullim të hiperaktivitetit), ASD (spektri i çrregullimeve të autikëve), vështirësi të komunikimit, vështirësi të të folurit dhe sjelljes, vështirësi të të mësuarit , aftësi fizike të kufizuara, shurdhëri dhe verbëri e pjesshme.

Një rrjet i gjerë strukturash sociale janë të interesuara dhe mbështesin shkollat, të tilla si legjislacioni shqiptar, MAS, universitetet me kurrikulat e tyre që përgatisin studentë-mësues, prindërit, OJF-të, specialistët e edukimit dhe psikologët shkollorë. Nëse këto burime mbështetëse bashkohen me realizimin e qëllimeve të 'Arsimit gjithëpërfshirës' në shekullin XXI, pritshmëritë e tyre janë të larta dhe mund të përmirësojnë edukimin e nxënësve NVE.

Praktika të edukimit gjithëpërfshirës në vende të ndryshme të botës

Legjislacioni dhe politika në SH.B.A

Në SHBA ka patur përmirësime të vazhdueshme në drejtim të arsimit të fëmijëve me NVEqë nga ligji 94-142 i vitit 1975 (Ligji për Arsimin e Personave me Probleme). Ligji që tani quhet IDEA (Ligji për Arsimin e Personave me Paaftësi) i përmirësuar në vitet 1990,1997 dhe 2004 siguron arsim publik falas dhe të përshtatshëm për

të gjithë nxënësit që trajtohen në kuadrin e arsimimit të veçantë pa asnjë përjashtim. Shpenzimet për mbulimin e nevojave të veçanta të këtyre nxënësve, konsiderohen si përgjegjësi publike.

Përkufizimi i paaftësisë nga IDEA është i veçantë. Në të përfshihen rreth 13 kategori të paaftësisë së fëmijëve nga mosha 6-21 vjeç. Shumica e këtyre nxënësve kalojnë një pjesë të ditës në klasat për të gjithë. Ligji (IDEA) përmban tri pika me interes të madh për prindërit dhe mësuesit: konceptin e mjedisit sa më pak kufizues, programe individuale të arsimit (PIE) dhe mbrojtjen e të drejtave, si të fëmijëve me paaftësi, ashtu edhe të prindërve të tyre.

1. Mjedisit me sa më pak kufizime nënkupton krijimin e kushteve që janë sa më pranë klasave normale. Kjo kërkesë e ligjit ka ndryshuar gjatë viteve, që nga përpjekja për të mos i veçuar (futja e NVE në disa orë normale), tek integrimi (futja e NVE në klasa normale) e deri tek gjithëpërfshirja (ristrukturimin e sistemit arsimor që çdo NVE të ndihet në vendin e vet) (Avremidis, Bayliss & Burden, 2000).

2. Programet e individualizuara mësimore, për nxënës me nevoja të veçanta, hartohen nga mësuesit, prindërit, psikologu dhe vetë nxënësi (kur është e mundur, detajojnë nivelin aktual të arritjeve, objektivat dhe strategjitë që do të ndiqen në të ardhmen).

3. Të drejtat e nxënësve dhe familjeve të tyre. IDEA përmban një numër dispozitash që mbrojnë të drejtat e nxënësve dhe familjeve të tyre, që ruajnë konfidencialitetin e rezultateve të nxënësve. Testimet nuk duhet të kenë dallime për nxënës që vijnë nga kontekste kulturore të ndryshme. Prindërit kanë të drejtë të njihen me të gjithë dokumentacionin shkollor dhe të marrin pjesë në hartimin e planit individual.

Prindërit kanë të drejtë të mos e pranojnë programin e hartuar, kanë të drejtë për një proces të drejtë gjyqësor.

Seksioni 504-Masat mbrojtëse

Jo të gjithë nxënësit që kanë nevojë për trajtim të veçantë në shkollë përfitojnë nga IDEA. Seksioni 504 është pjesë e ligjit (Ligji i Rehabilitimit profesional, 1973) për të drejtat civile që ndalon diskriminimin e njerëzve me paaftësi dhe u jep mundësi të përfshihen në programe mësimore që financohen nga fonde federale në shkolla publike.

Legjislacioni dhe politika në Mbretërinë e Bashkuar

-Akti i edukimit (1980), në Mbretërinë e Bashkuar, përcakton që të gjithë nxënësit me NVE, duhet të vendosen në shkolla të zakonshme.

-Akti për diskriminimin e paaftësisë (1995), i kaluar në Parlament, vendos direktiva kundër diskriminimit të njerëzve me paaftësi nga organizatorët e edukimit.

-Akti i paaftësive (2001) dhe Nevojave të Edukimit të Veçantë, përcakton që nxënësit me NVE duhet të kenë mundësi të barabarta mësimi, ashtu si nxënësit normalë përgjatë edukimit të tyre.

-Akti i Barazisë (2010), seksioni VI, shprehet që çdo vepër diskriminimi gjatë procesit të pranimit ose trajtimit të nxënësve nga organizatorët e edukimit do të konsiderohet si shkelje e ligjit.

Zbatimi dhe vështirësitë dhe sfidat e hasura

Qeveria britanike ka përcaktuar fonde të shumta për të zhvilluar edukimin gjithëpërfshirës. Ligji i edukimit gjithëpërfshirës shpreh që autoritetet profesionale do të bashkëpunojnë me organizatorët e trajnimit të nxënësve për të zhvilluar programe trajnimi të nxënësve.

Sipas Aktit të Edukimit, prindërit e nxënësve NVE kanë një sërë të drejtash për të marrë pjesë në edukimin përfshirës të fëmijëve të tyre.

Kërkimet e fundit kanë treguar se trajtimet e mësuesve për edukimin e veçantë në Angli janë tepër të pamjaftueshme. Gjysma e kurseve janë kryesisht teorike dhe pjesëmarrja e prindërve në edukimin gjithëpërfshirës duket se është pamjaftueshme.

a. Legjislacioni dhe praktika në Australi

Akti për Diskriminimin e Paaftësisë (1992), ka për qëllim të nxitë edukimin gjithëpërfshirës për nxënësit me NVE.

Standardet e Paaftësive në Edukim (2005), theksojnë që njerëzit me paaftësi kanë mundësi dhe zgjedhje të barabarta ashtu si dhe njerëzit normalë për të përfituar edukim.

Diskriminimi dhe ngacmimi i nxënësve me NVE duhet të hiqet nga procesi mësimor ose gjatë pranimit në institucione, në hartimin e kurrikulave dhe në shërbimet mbështetëse për nxënësit.

Zbatimi, vështirësitë dhe sfidat e hasura

-16 universitete kanë përfshirë në programet e tyre kurrikula të edukimit të veçantë e gjithëpërfshirës.

-Qeveria australiane ka siguruar fonde për "Programin e Cilësisë për Mësuesit" në mënyrë që të sigurojë trajtimin lidhur me edukimin gjithëpërfshirës.

Nuk është bërë një vlerësim i vazhduar i zbatimit të këtyre programeve në Universitete.

Legjislacioni dhe politika në Japoni

Në 2007 qeveria japoneze ka ndryshuar terminologjinë nga edukimi i veçantë në edukim të nevojave të veçanta, në artikujt ligjorë lidhur me edukimin e nxënësve me NVE.

-Akti i Edukimit në Shkollë (2009) shprehet, që shkollat speciale duhet të sigurojnë mundësi edukimi për lloje të ndryshme të nxënësve NVE.

Zbatimi, vështirësitë dhe sfidat e hasura.

Qeveria japoneze ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të :

- a) Për të zhvilluar skema edukimi individuale, mbështetëse, shërbime ndaj nxënësve sipas nevojave të tyre.
- b) Për të rekrutuar specialistë të koordinimit të nevojave speciale të edukimit, për të ndihmuar kontaktin mes aktorëve brenda dhe jashtë shkollës.
- c) Për të ndërtuar një departament disiplinor të quajtur “Këshilli për Mbështetje Speciale” në çdo rajon.

Qeveria japoneze ka marrë parasysh rolin e prindërve në procesin e të nxënësve me NVE.

Për momentin nuk ka kritere dhe udhëzime të qarta se cilat lloje të nxënësve me NVE janë të përshtatshëm për të mësuar në shkolla normale, rrjedhimisht nuk ka rregullatorë specifikë që përcaktojnë lehtësitë dhe shërbimet me të cilat duhet të pajisen shkollat që t’u shërbejnë nxënësve me NVE

Legjislacioni dhe politika në Kinë

Ligji i Republikës Popullore të Kinës mbi mbrojtjen e personave të paaftë u vu në fuqi në vitin 1990. Ky ligj ka për qëllim të mbrojë personat me paaftësi dhe të kujdeset për nevojat e tyre.

Ligji për Edukimin e Detyrueshëm i shpallur nga Qeveria Kineze në 2004, përcakton që shkollat duhet të pranojnë si nxënësit normalë ashtu edhe ata me NVE dhe kërkon që të gjithë nxënësit të kryejnë arsimin e detyruar 9-vjeçar duke filluar nga mosha 6 vjeç.

Zbatimi, vështirësitë dhe sfidat e hasura

Skema e ‘të mësuarit në klasa normale’ e nxënësve me paaftësi të dëgjimit, u zbatua në qytetin e Hajlunit të Provincës Heilongjiang në vitin 1989.

Nga viti 1989 deri në vitin 1994 projekti i ‘të mësuarit në klasa normale’ u promovua në 8 provinca të Kinës. Megjithatë ajo u aplikua vetëm për nxënësit me paaftësi pamore, dëgjimore dhe vështirësi intelektuale.

Ka një pamjaftueshmëri të psikologëve shkollorë, që të kenë kualifikimin e duhur profesional për të kryer vlerësime të ndryshme të nxënësve me NVE.

Nuk ka programe vlerësuese që të mbikqyrin dhe vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies të nxënësve me NVE në projektin e ‘të mësuarit në klasa normale’.

Mësuesit që japin mësim dhe kujdesen për nxënësit me NVE në klasat përfshirëse, janë të pakualifikuar sipas standardeve profesionale.

Legjislacioni dhe politika në Hong Kong Zbatimi, vështirësitë dhe sfidat e hasura

Zhvillimi i arsimit gjithëpërfshirës në Hong Kong është promovuar nëpërmjet politikave rehabilituese, shërbimeve dhe qëllimeve arsimore dhe “urdhëresës mbi diskriminimin e paaftësive”, kodi i praktikës mbi edukimin.

Hong Kongu duhet të vlerësojë masat e marra rregullisht në mënyrë që të mbrojë të drejtat dhe zhvillimin e nxënësve me çrregullime sipas sistemit të integruar arsimor.

Qeveria duhet të rishikojë politikat në mënyrë që të njohë dhe sigurojë të drejtat ligjore për prindërit. Kërkesat e bëra nga prindërit dhe organizatat, kanë formuar lirinë për të kërkuar më shumë burime nga qeveria.

Pjesëmarrja dhe vendimet e marra nga nxënësit me NVE dhe prindërit e tyre janë thelbësore.

Janë hartuar disa marrëveshje arsimore për nxënësit me NVE, përfshirjen e tyre në klasa të qëndrueshme, klasa mbi programin e burimeve, mësues që mundësojnë mbështetje mbi shërbimet, shkollimin në shtëpi dhe klasa të rregullta me shërbime special edukimi.

Në Hong Kong pikëpamjet e zakonshme kanë të bëjnë me miratimin e një qasjeje paralele të zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës dhe edukimit special.

Ka opinione të ndryshme që sugjerojnë krijimin e shkollave të specializuara për nxënësit me NVE dhe lejimin për shkollat që të zgjedhin lloje të veçanta të nxënësve me NVE. Nxënësve me NVE, me kapacitet më të vogël, duhet t’u ofrohet mundësi mësimi pas shkollës, kualifikim profesional si dhe arsimim të vazhdueshëm.

“Dritëhije” të sistemit të shkollës përfshirëse në Itali.

Fenomeni i përjashtimit të nxënësve me paaftësi në të mësuar

Fenomeni i gjithëpërfshirjes së nxënësve me paaftësi në të mësuar është një realitet i përhapur në sistemin shkollor të shumicës së vendeve në botë (siç e kemi theksuar në disa vende përfaqësuese), si një mundësi e domosdoshme e përmbushjes së nevojave dhe të drejtave të të gjithë fëmijëve.

Nga ana tjetër procesi i realizimit të kësaj mundësie në praktikën shkollore krahas arritjeve edhe pse shpeshherë të pamjaftueshme apo më të dukshme vetëm në aspektin social, në drejtim të komunikimit dhe të lidhjeve sociale dhe më pak të shprehura në arritjet shkollore, është shoqëruar në

vite me probleme, mosarritje, deri në shfaqjen e “mikropërrjashtimit”, përjashtim brenda shkollës gjithëpërfshirëse.

Në Itali ky debat është aktual dhe tenton të analizojë fenomenin duke “skanuar” sistemin arsimor në vend dhe duke evidentuar “dritëhijet” e tij.

Në një sërë kërkimesh në këtë fushë si përgjigje ndaj pyetjeve të shtruar nga Giangreco etj. (në vitin 2012), trajtohen dy çështje të rëndësishme në lidhje me problemin e gjithëpërfshirjes:

1.Studime që tregojnë fenomenin e përjashtimit të nxënësve me paaftësi në të mësuar.

2.Ligjet e mëvonshme italiane për edukimin përfshirës.

Prania e këtyre fenomeneve përjashtuese dëshmon për një prirje të rrezikshme brenda shkollave gjithëpërfshirëse, megjithëse studimet shkencore në këtë fushë nuk plotësojnë sa dhe si duhet nevojat e njohjes, analizës dhe vlerësimit të kësaj prirjeje të zhvillimit të fenomenit. Kjo situatë është shumë e ngjashme si fenomen me realitetin e shkollave shqiptare, por me ndryshime të dukshme përsa i përket debatit rreth kësaj çështjeje, studimeve shkencore pothuajse të munguara dhe pamjaftueshmërisë së kushteve reale në shkolla për të realizuar gjithëpërfshirjen .

Në lidhje me ligjet e reja italiane për edukimin gjithëpërfshirës, është vënë re një zgjerim i kategorisë së nxënësve që kanë të drejtën e të mësuarit, duke filluar që nga ata me paaftësi deri në një konceptim më të gjerë të nevojave për edukim të veçantë.

Që nga vitet '60, në Itali, pati një lëvizje të theksuar për deinstitutionalizimin e fëmijëve me paaftësi, sëmundje mendore dhe fëmijëve pa familje. Pavarësisht vështirësive fillestare procesi u karakterizua nga entuziazmi, dialogu dhe qëndrimi konstruktiv duke e prezantuar çështjen e integritimit të fëmijëve me paaftësi në shkollat normale si një vlerë të padiskutueshme.

“Kultura pedagogjike italiane nuk e ka në traditë kërkimin empirik dhe vetëm tani vonë janë kryer diskutime me baza të dukshme, të matshme. Në të vërtetë, nuk ka pasur pakësim të diskutimeve lidhur me integrimin në shkolla, por ato kanë qenë të orientuara kryesisht në respektimin e të drejtave të nxënësve për të sugjeruar, dokumentuar dhe zbatuar në mënyrën më të vlefshme integrimin” (lanes, Zambotti & Demo, 2013).

Por, disa nga aspektet strukturore të sistemit italian të integritimit u quajtën të paprekshme, si nevoja për diagnozë mjekësore përpara se të vendoset se cilat ambiente të veçanta të shkollës

duhet t’u ofrohen nxënësve dhe roli i padiskutueshëm i mësuesit ndihmës, numri i të cilëve sa vjen dhe ulet. Gjithnjë e më tepër kërkohet specializim i mësuesit të zakonshëm që do të realizojë gjithëpërfshirjen.

Studimet, me gjithë rëndësinë që kanë, fokusohen kryesisht tek aspektet zyrtare dhe procedurale të sistemit dhe nuk analizojnë sa duhet në detaje se çfarë ndodh realisht çdo ditë në klasë, që në të vërtetë përbën aspektin kryesor të përfshirjes.

Nga kërkimet vërehet që nxënësit me paaftësi në të mësuar shpenzojnë pak kohë me bashkëmoshatarët e tyre në klasë dhe më shumë kohë me mësuesit ndihmës.

Këto konkluzione të përgjithshme janë të ngjashme edhe në realitetin gjithëpërfshirës të arsimit shqiptar me ndryshimin që mësuesit mbështetës janë të paktë ose mungojnë fare në shkollat tona. Në qytetin e Korçës kemi një mësues ndihmës në shkollën “Demokracia”.

Një studim i kryer (Canevaro, d’Alonzo, Lanes, 2009), me pyetësorë të plotësuar nga 1877 familje të nxënësve me paaftësi ose nga vetë nxënësit me paaftësi, pati gjetje shqetësuese në lidhje me fenomenin e përjashtimit. Në publikimet e mëvonshme (Lanes, Demo & Zambotti, 2010; Canevaro, d’Alonzo, Lanes, 2011; Lanes & Demo, 2013) rreth 55% e nxënësve me paaftësi e kalojnë një pjesë të kohës së mësimi jashtë mureve të klasës, 40% janë gjithmonë në klasë, 6% qëndrojnë “vetëm” jashtë klase.

Nga analiza e qëndrimeve dhe perceptimeve të 3230 mësuesve, u siguroa informacion që e pohonte fenomenin e “mikropërrjashtimit”. Në këto analiza u studiuua lidhja e “përjashtimit” me llojin dhe ashpërsinë e paaftësisë, me kategorinë e shkollave në studim, me profesionistët dhe me shokët e klasës, me metodat e përdorura. Përfundimet më të qarta tregojnë se nxënësit me paaftësi kalonin më shumë kohë në klasë, kur mësuesit përdornin metoda didaktike aktive e bashkëpunuese.

Gjithashtu, këta nxënës që shpenzojnë më shumë kohë në klasë, kanë dhe rezultate më të mira në mësim dhe marrëdhënie më të mira me shokët (40% e nxënësve me NVE kanë dëshirë të kalojnë më shumë kohë në klasë me shokët e tjerë të klasës).

Historik i shkurtër i arsimit special në Shqipëri

Pas trajtimeve përçmuese e mëshiruese e deri rreth viteve '60-'70, ndër praktikën që kanë mbizotëruar në vende të ndryshme të botës, kanë qenë ato të përkujdesjes në institucione të veçanta, trajtimi i veçuar i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla apo në institucione speciale.

Argumentet kryesore që kanë mbështetur këto praktika lidhen me arsyetimin se me këtë mënyrë, puna bëhet më e organizuar, në grupe të vogla e homogjene, krijohen kushte për një trajtim më efikas, etj. Nga ana tjetër, në adresë të këtyre institucioneve, nuk kanë munguar edhe kritika të shumta për kushtet artificiale dhe izolimin që krijojnë, përgatitjen e pamjaftueshme shoqërore të fëmijëve për të përballuar jetën reale, mungesa e modeleve pozitive dhe motivet e pakta, ulja e kërkesave nga ana e personelit për shkak të përshtatjes, efektet stigmatizuese, etj.

Të ndodhur përballë kundërshtive të shumta dhe në përpjekje për të respektuar të drejtat e fëmijëve, një pjesë e madhe e institucioneve speciale janë mbyllur, jo pak janë rinovuar. Është fakt, edhe sot, në mjaft vende të përparura, për larminë e problemeve që lindin me fëmijë të veçantë dhe sidomos për fëmijë më të rënduar e me komplikacione të ndryshme, këto struktura konsiderohen akoma të vlefshme e të nevojshme. Ato kanë akoma hapësira të shumta ku mund të përmirësohen, pa mohuar edhe kombinimet e ndryshme që mund të bëhen, apo variantet e reja që mund të krijohen.

Politika përfshirëse të nxënësve me nevoja të veçanta

Që nga deklarata e Salamanca në 1994: "Qeveritë duhet të përvetësojnë parimin e arsimit përfshirës, duke i regjistruar të tërë fëmijët në shkolla normale, përveçse në raste kur ka arsye detyruese për të vepruar ndryshe" (UNESCO, 1994, p. 44).

Përpjekjet e para për praktika të mirëfillta integruese në Shqipëri lidhen me vitet '90. Në 10-vjeçarit e fundit në kuadrin e shndërrimeve të shumta demokratike, për arsye të ndryshme, prindërit gjithmonë e më shpesh nuk pranojnë që fëmijët e tyre të përfshihen në institucione speciale. Ata janë të ndërgjegjshëm për mundësitë e fëmijëve të tyre dhe kanë rritur kërkesat dhe pretendimet për

një trajtim dhe shkollim më të mirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadrin e shkollave të zakonshme duke e konsideruar këtë jo si një privilegj, por si një të drejtë njerëzore që duhet ta gëzojnë të gjithë.

Në vitin 1996 për herë të parë në Dispozitat Normative të Arsimit Publik theksohet se "integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në kuadrin e shkollave të zakonshme konsiderohet si një proces i domosdoshëm bashkëkohor" pa specifikuar zgjedhjet e nevojshme.

Dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar (MAS, 2013). (Kapitulli XV-Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Neni 97) theksojnë rolin e mësuesit ndihmës, mësuesit të lëndës në institucionet arsimore të zakonshme dhe bashkëpunimin me prindërit.

1-Sipas normës të përcaktuar nga ministria dhe vlerësimit nga komisioni pranë DAR/ZA-ve në klasat e zakonshme që kanë edhe nxënës me aftësi të kufizuara, punojnë mësues ndihmës. Mësuesi ndihmës duhet të ketë diplomën e nivelit arsimor përkatës, të përcaktuar në nenin 57 të LAPU-s dhe specializim të përshtatshëm në fushën e arsimit të nxënësve me aftësi të kufizuara.

2-Mësuesi ndihmës në bashkëpunim me mësuesit lëndorë dhe prindërit, hartojnë dhe vënë në jetë PEI-n e fëmijës. PEI bazohet në dokumentet zyrtare të kurrikulës dhe përmban edhe objektiva për aftësitë e vetëndihmës dhe aftësi të tjera sociale, që nxënësi duhet të arrijë, sipas udhëzimeve të komisionit të DAR/ZA-së.

7-Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur gjykojnë se fëmija

nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

8-Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit në mënyrë që veprimtaritë që zhvillohen në institucionin arsimor dhe në shtëpi të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën

BIBLIOGRAFI

- BOOTH, T. & AINSCOW, M. (2002). *Index for Inclusion: Developing Learning and Participation in Schools*. 2nd ed. Manchester, UK:
- Booth, T., & Ainscow, M. (2011). *The index for inclusion: Developing learning and participation in school*. Bristol: CSIE.
- Bureau., E. a. (2004). *Catering for student difference: Indicators for inclusion, A tool for school self-evaluation and school development*. Hong Kong: Author.
- Children, S. t. (2003). *Pra, Ju doni të konsultoheni me fëmijët?* Tiranë: International Save the Children Alliance.
- Children, S. t. (2010). *Arsimi gjithëpërfshirëse-Kërkesë e mijëvjeçarit të ri*.
- EBERSOLD, S. (2009). Autour des mots: l'inclusion. *Recherche et formation (INRP)*. N° 61. pp. 71-83. Retrieved on September 9, 2010 from: http://www.inrp.fr/publications/edition-electronique/recherche-et-formation/INRP_RR061_5.pdf

- Employment, D. f. (1981). *Education Act 1981*. London: HMSO.
- Government, C. (1992). *Disability Discrimination Act*. Canberra: Author.
- Hapur, S. d. (2006). *Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe Protokollin opsional*. Tiranë: SOROS dhe Instituti i Shoqërisë së Hapur.
- lanes, D., Demo, H., & Zambotti, F. (2013). Integration in Italian schools: teachers' perceptions regarding day-to-day practice and its effectiveness. *International Journal of Inclusive Education*, 1-28
- Ikonomi, E., Musai, B., & Sotirofski, K. (2009). *Planifikimi i politikave dhe praktikave të përgatitjes së mësuesve për një arsim gjithpërfshirës në kontekstin e diversitetit social dhe kulturor - Raporti vendor për Shqipërinë*. Bolonjë
- Koka, Z., Haxhiymeri, V., Flagker, M.N., & Bezati, F. (2005). *Analizë e kuadrit ligjor që garanton edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kushtet e arsimit gjithpërfshirës – Raport studimor*. Tiranë.
- Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, Tetor, 2003.
- Lansdaun, G. (2009). Kapitulli i parë dhe i dytë. In G. Lansdaun, *Më shiko, më dëgjo (Udhëzues i OKB për përdorimin e KDPAK)* (pp. 13-23). Tiranë: Save the Children.
- MASH. (2010, Dhjetor 8). Retrieved from MASH Ëeb site: <http://www.mash.gov.al:8443/faqe.php?id1=38id2=153>
- MASH, & DARK. (2008). Rekomandime. In MASH, & DARK, *Jo braktisjes së shkollës* (pp. 73-80). Tiranë: UNICEF.
- McNamara, S., & Moreton, G. (2003). *Të kuptuarit ndryshe*. Londër: David Fulton Publisher.
- Nota, L., Soresi, S., & Ferrari, L. (in press). School inclusion in Italy: Emerging trends and future directions. In J. McLeskey, N. L. Waldron, F. Spooner, & B. Algozzine (Eds.), *Handbook of research and practice for effective inclusive schools*. London: Routledge Publishers.
- Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar (Tiranë, 2005).
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004-2015.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013 (Tiranë, Korrik 2009).
- UNESCO. (1994). *The Salamanca statement and framework for action on special needs education*. Paris: UNESCO.
- UNESCO. (2001). *Të kuptojmë dhe t'u Përgjigjemi Nevojave të Fëmijëve në Klasat Gjithpërfshirëse*. Retrieved from <http://ëëë.unesco.org/education/educprog/sne>
- Xhamo, M., Ndrio, M., Poni, M., Goci, R., & Cela, R. (2010). *Një shkollë për të gjithë*. Tiranë: Save the children.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË MJEDISËT E SHKOLLAVE DHE SIGURIA E NXËNËSVE NË BOTËN VIRTUALE

ELDA TARTARI

FAKULTETI I EDUKIMIT

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Përmbledhje

Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në të gjitha fushat e jetës është kthyer në një domosdoshmëri jetike në gjithë botën e zhvilluar. Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe të nxënësve është i paevitueshëm në fushën e edukimit. Prania e kësaj teknologjie në klasë rrit potencialin për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënies, ofron përfitime të mëdha për nxënësit, rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të nxënësve gjatë orës së mësimi duke lehtësuar procesin e të nxënësve. Qëllimi i këtij studimi është të bëjë një pasqyrim të situatës aktuale të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mjediset e shkollave si dhe të paraqesë masat e ndërmarra nga insitucionet përkatëse për sigurinë e nxënësve në botën virtuale. Punimi është mbështetur kryesisht në dokumente, në raporte të insitucioneve të ndryshme dhe intervista të bëra enkas për këtë studim.

Fjalët çelës: *Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, shkollë, nxënës, siguri.*

Abstract

The use of Information and Communication Technology (ICT) in all fields of life has become a necessity in the developed world. The use of ICT in teaching and learning is inevitable in the field of education. The presence of this technology in the classroom increases the potential to transform teaching professional environment and offers great benefits for students, enhances students with conceptual and perceptual skills to facilitate the learning process. The purpose of this study is to make a reflection of the current situation of information and communication technology in school and to present the measures that should be taken by the relevant institutions for the safety of students in the virtual world. The paper is based mainly on documents in various institutions reports and interviews conducted specifically for this study.

Key words: *Information and Communication Technology, schools, student, safety*

HYRJE

Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në të gjitha fushat e jetës është kthyer në një domosdoshmëri jetike në gjithë botën e zhvilluar. Teknologjitë e informimit dhe komunikimit janë bërë tipar përcaktues i kohës sonë, duke e bërë jetën tonë në mënyrë të dukshme ndryshe nga ajo që ka qenë dikur (Dearnley & Feather, 2001, Robins & Webster, 1999). Në studimin e tij DiNicola thekson se kjo teknologji po ndryshon mënyrën sesi individët socializohen, studiojnë, punojnë, harxhojnë kohën e tyre të lirë (DiNicola.M.D. 2004). Hapësirat e internetit, që veçanërisht përdoren nga të rinjtë, po ndryshojnë në mënyrë shumë të shpejtë. Adoloshentët shfrytëzojnë potencialin e teknologjive për të lehtësuar lidhjet brenda kontekstit social me qëllim arritjen e detyrave të zhvillimit. Ata përdorin lojërat elektronike dhe informacionet "online" si burim për të ndërvepruar dhe biseduar mes moshatarësh (Orleans & Laney 2000).

Rrjedhimisht edhe në arsim përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka sjellë ndryshime në zhvillimin e të nxënësve. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duke u mbështetur dhe në modelet evropiane për arsim futi integrimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënësve (MASH, IZHA, 2011). Prania e TIK-ut në klasë ofron përfitime të mëdha

për nxënësit, rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të nxënësve gjatë orës së mësimi duke lehtësuar të nxënësve. Kjo mundësi sjell dinamizëm në mësimdhënie e nxënësve, i vendos nxënësit në kontroll për të nxënësve e tyre duke krijuar progreszhvillimi të pavarur (MASH, IZHA. 2011). Sipas Paryono & Quito, integrimi i TIK-ut nuk është vetëm një mundësi, por edhe një domosdoshmëri për të bërë procesin e edukimit më tërheqës (Paryono & Quito, 2010). Nga ana tjetër, nxënësit janë dhe autodidakt të mësimi të kësaj teknologjie. Krahasuar me gjithë pjesën tjetër të shoqërisë, nxënësit dhe kryesisht nxënësit që i përkasin moshës së adoleshencës janë adoptuesit e hershëm të botës virtuale, nuk kanë nevojë për udhëzime apo manuale, për shpjegime se si të përdorin një telefon celular, një aparat dixhital, pra, ata nuk mund ta kuptojnë jetën e tyre pa internet.

Edhe në arsim, si në çdo fushë të jetës TIK-u i bën njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit. TIK-u, si aftësi funksionale e lexim-shkrimit digjital, nxit dhe zhvillon te nxënësit një sërë aftësish të tjera, të tilla si: aftësi matematikore, aftësi komunikuese, aftësi të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, aftësi për të punuar në grup, aftësi për të përdorur shumëllojshmëri burimesh e instrumentesh etj. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit e

panë të nevojshëm hartimin e standardeve të TIK-ut në mësimdhënie/nxënie për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave dhe iu erdhi në ndihmë atyre nëpërmjet hartimit të drafteve (MASH, IZHA, 2011).

2. TIK-u në shkollat shqiptare dhe çështje aktuale të tij

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit janë grupe të ndryshme mjetesesh dhe burimesh teknologjike që përdoren për të komunikuar, për të krijuar, për të shpërndarë, për të ruajtur dhe për të menaxhuar informacionin (Blurton, 2002). Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në mësimdhënie dhe të nxënësve është i paevitueshëm në fushën e edukimit. Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (2009-2013) ishte “garantimi i një sistemi arsimor kombëtar modern, i cili nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rrit konkurrueshmërinë në rajon dhe më gjerë dhe konsolidon demokracinë” (MASH, 2009). Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit janë mjete për përpunimin e informacionit, me të cilat gjeneratat e reja duhet të bëhen kompetentë në përdorimin e tyre, duhet të fitojnë shkathtësitë e nevojshme, dhe për këtë arsye duhet të kenë akses në kompjuter dhe rrjete kompjuterike gjatë shkollës dhe gjatë jetës së tyre (Samiti Botëror, 2003).

2.1. Shkolla me laborator kompjuterash dhe internet

A janë paisur të gjitha shkollat në rang vendi me laborator kompjuterash?

Teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese për fëmijët dhe të rinjtë në ditët e sotme. Për t’iu përshtatur këtyre ndryshimeve të kohës lindi nevoja e integritit të TIK-ut në arsimin shqiptar. Programi “E-School” është nisur zyrtarisht në dhjetor të vitit 2005 (Insituti Shqiptar i Medias). Implementimi i tij filloi në periudhën qershor-korrik të 2006 dhe përfundoi në vitin 2009. Objektivi kryesor i programit “E-School” ishte të lidhte të gjitha shkollat publike, fillore dhe të mesme në nivel kombëtar me internet. Interneti në shkollat tona është futur për herë të parë në mënyrë masive në vitin 2010 (Vejsiu, 2012). 2100 shkolla publike të sistemit parauniversitar zotërojnë tashmë laborator kompjuterash. Ndërkohë, 2000 shkolla në të gjithë vendin janë të lidhura me internet. (MASH, 2011). Sigurisht mbetet për tu theksuar se sektori i arsimit privat, ka qenë i pari në sjelljen e këtyre teknologjive në vendin tonë që nga viti 1993.

Një problem tjetër që haset është numri i lartë i nxënësve në një klasë dhe kjo bën vështirësi që secili nxënës të ketë akses në kompjuterin e tij në orën e mësimit të informatikës. Në të gjitha shkollat shqiptare ka minimumi 8 ose 12 kompjutera në një klasë dhe një kompjuter të lidhur me videoprojektor

që përdoret nga mësuesi. Sot, kemi 1 kompjuter për 21 nxënës në rang republike” (Vejsiu 2012). Në raportin e bërë nga Juana M. Sancho-Gil për TIK në arsimin shqiptar u raportua nga vëzhgimi i bërë në një klasë me 40 nxënës dhe 16 kompjutera se mësimi në orën e informatikës zhvillohej në të njëjtën kohë në këtë mënyrë: disa nxënës studionin librin dhe disa të tjerë praktikoheshin me kompjutera. Videoprojektori përdorej nga mësuesi për të shpjeguar dhe nga nxënësit për të bërë prezantimet e tyre (Juana M. Sancho-Gil, 2013). Synimi kryesor i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (2009- 2013) ishte arritja e treguesit “ 1 kompjuter për 10 nxënës”. Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2014-2020) do të zhvillohet një kurrikul bashkohore në fushën e TIK-ut e cila do të shoqërohet me përmirësimin e infrastrukturës teknologjike (MAS, 2014). Është e nevojshme që nxënësit duhet të kenë kompjuterin e tyre në shkollë të lidhur me internet në mënyrë që të maksimizojnë vlerën e orëve mësimore. Madje, një praktikë e tillë nuk vlen vetëm për orët e informatikës, por edhe për lëndë të tjera, dija për të cilat mund të gjendet lehtësisht në internet.

2.2. Aftësitë e mësuesve në zbatimin e programit të TIK-ut

Teknologjia ka fuqinë dhe potencialin për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënies. Ajo ndikon mësimdhënien e suksesshme dhe u krijon mundësi mësuesve për të përthithur risitë dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve e përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta pedagogjike. Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit të cilat mësuesi duhet t’i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj. Mësuesit e sotëm duhet të jenë të përgatitur për të përdorur teknologjinë, sepse zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe shtimi i informacionit digjital bën që mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës, por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe të nxënësit. Gjithashtu, mësuesi duhet t’u komunikojnë nxënësve çfarë avantazhesh sjell ajo dhe të dinë se si teknologjia mbështet mësimdhënien. Po ashtu, ata duhet të dinë edhe anët negative që sjell teknologjia, siç janë: vartësia ndaj saj, ndikimet e internetit, sigurinë e nxënësve dhe të rinjve në përgjithësi si dhe ekspozimin ndaj faqeve me përmbajtje të papërshtatshme për moshën dhe psikologjinë e fëmijëve. Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore, mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërregjigjësuere,

enciklopeditë, softwari elektronik në funksion të të nxënësit, studimet shkencore me fokus te teknologjia dhe TIK-u, etj., (MAS, 2014).

A kanë mësuesit qasje të lehtë në burimet e TIK në klasë?

Laboratorët e kompjuterit kanë e pakta një kompjuter me videoprojektor i cili përdoret nga mësuesi (MASH. 2009). Në kohën që jetojmë, mësuesit e kësaj fushe do të ishte mirë të zotëronin të gjithë teknologjinë e fundit, si kompjuter tavoline (në shkollë), mundësisht kompjuter të lëvizshëm (laptop) apo edhe kompjutera tabletë. Prania e laboratorëve kompjuterikë, sigurisht që, ka ndryshuar tërësisht pamjen teknologjike të shkollave tona. Këta laboratorë, megjithatë vështirësitë në funksionim, janë një shtytës për nxënësit drejt dijeve kompjuterike. Nga ana tjetër, mendohet se kjo e shtyn nxënësin që të mbushë boshllëkun e dijeve të tij duke kërkuar nga prindi që të pajiset me kompjuter dhe internet në shtëpi.

A kanë mësuesit një vizion të qartë për qëllimet e mësimin të TIK?

Mësuesit e informatikës zotërojnë gjithë librat dhe kurrikulën për secilin nivel. Programi mësimor është mbështetur kryesisht në emërtimet e pajisjeve kompjuterike, në paketën "Microsoft Office" dhe "Internet Explorer Browser". Kualifikime të vazhdueshme janë ndërmarrë në shkallë të gjerë në të gjithë vendin nga MASH-i në këtë drejtim. Drejtoritë Arsimore, paraqesin një kurrikul të konsiderueshme në programet e organizuara prej tyre apo edhe në ato që merren nga burime të jashtme. Sipas MASH-it (2011) mësuesit duhet të kenë aftësi dhe njohuri teknologjike të burimeve të nevojshme të web-ve për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie, si dhe për të thelluar njohuritë e tyre pedagogjike në mbështetje të zhvillimit profesional të tyre

Gjithsesi, duke parë me sy të zhveshur dhe pa u futur në thellësi të ecurisë së përditshme të teknologjisë, duhet të themi se trajnimet konstante të mësuesve janë jetike për lëndën e TIK-ut në shkollat tona. Në vitet e fundit, kompania amerikane Microsoft ka bërë revolucion me programin e ri "Windows 8". Ky program ndryshon nga programet e mëparshëm të "Windows" që mbeten baza e gjuhës kompjuterike. Po ashtu, kompania tjetër "Apple" nga ana tjetër, po gjen përditë e më shumë vend me produktet e saj (iMac, MacBook, MacBook Air etj) të cilat përdorin sistemin IOS. Ky sistem thuhet është i panjohur në shkallë të gjerë në vendin tonë. Një tjetër program që sot operon në 75 për qind të pajisjeve të botës është Android-i i kompanisë amerikane "Google", njëherazi motor kërkimi dhe ofrues i postës elektronike. Ndonëse nuk gjendet në

kompjutera të tavolinës apo në "laptop-ë", ky program është në shumicën e pajisjeve tablete dhe celulare.

Mësuesit tanë duhet të njihen me këto tre sisteme bazë të operimit kompjuterik në botë, përmes së cilave ndërtohet edhe komunikimi dhe informimi. Ato ndërthuren në përditshmërinë e nxënësve dhe krijojnë konfuzion me ndryshimet që paraqesin.

A kanë mësuesit mbështetje profesionale?

Të gjithë mësuesit e TIK-ut janë të trajnuar. Vitet e fundit janë trajnuar në total 4484 mësues të arsimit parauniversitar, në përdorimin: TIK-ut; integrimin në mësimdhënie; zhvillim përmbajtje digjitale. Janë trajnuar 500 drejtues shkollash në module, të fokusuar në njohjen dhe përdorimin e TIK-ut, mbështetja e politikave të TIK-ut në shkolla (MASH. 2013).

Drejtoritë e Metodologjisë dhe Teknologjisë në Mësimdhënie ka ardhur në ndihmë të mësuesit dhe administratorit në arsim me disa drafte (IZHA, 2011).

- Standardet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësuesit;

- Standardet e mësuesit për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shkollë;

- Standardet e administratorit në arsim;

- Integrimi i TIK-ut për një mësimdhënie gjithëpërfshirëse.

3. Paketa këshilluese për sigurinë e nxënësve në internet

Në dekadën e fundit ndikimi i teknologjisë është bërë i pashmangshëm. Shpejtësia e përhapjes së saj e ka bërë pjesë të pandarë të jetës së adoleshentëve. Teknologjitë e reja, jo vetëm që janë bërë një mjet i rëndësishëm që lidhin adoleshentët me shokët e tyre (Subrahmanyam & Greenfi eld, 2008), por ndikimi i tyre po reflektohet në mënyrën e zhvillimit dhe të sjelljes në adoleshencë. Kudo, ku lëvizin adoleshentët e sotëm, në shtëpi, në shkollë janë të rrethuar nga teknologjitë dixhitale, të tilla: si kompjuterë, internet, lojëra elektronike, telefona celularë, dhe pajisje të tjera (Roberts & Foehr 2008). Adoleshentët kanë nivelin më të lartë të përdorimit të internetit krahasuar me çdo grup-moshe tjetër. Rrjetet sociale, lojërat "online", sitet e internetit që shpërndajnë video të ndryshme dhe pajisje të tilla si "iPods" dhe telefonat celular, janë bërë tashmë pjesë e pandarë e kulturës së të rinjve. Duke qenë se kjo moshë e përdor gjerësisht internetin lind nevoja për krijimin e një mjedisi "online" të sigurt.

Qeveria shqiptare ka hartuar një kuadër ligjor dhe institucional në mbrojtje të interesit më të lartë të të miturit. Por, në mënyrë specifike në këtë legjislacion ne gjejmë shumë pak përsa i përket

sigurisë së fëmijëve, mirëqenies së tyre dhe rreziqeve që mund t'iu sjell ekspozimi ndaj teknologjive të reja (internetit, rrjeteve sociale etj). Zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit dhe shtrirja e përdorimit të tyre në vendin tonë pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, bënë evidente kërkesën për shërbime të sigurta dhe të besueshme për të gjithë kategoritë e shoqërisë dhe veçanërisht për fëmijët. Zhvillimi i shoqërisë së informacionit ka kërkuar njëkohësisht dhe thellimin e reformës legjislative dhe institucionale, për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët. Shifrat dhe faktet tregojnë se penetrimi i rrjeteve të shërbimeve të telefonisë fikse, celulare dhe aksesit broadband në Republikën e Shqipërisë, krahasuar edhe me vendet e tjera, është i konsiderueshëm.

Doracak për TIK-un "Siguria në internet" është një material i publikuar në faqen zyrtare të MASH (www.mash.gov.al), i cili prezanton mundësitë që ekzistojnë për t'iu siguruar fëmijëve internet të sigurt. Ky material synon t'i ndihmojnë fëmijët në mbrojtjen nga rreziqet potenciale të internetit, njëkohësisht u tregon atyre për përmbajtjen dhe shërbimet që mund të jenë të dobishme. Githashtu, një tjetër material që iu vjen në ndihmë mësuesve dhe prindërve për të ndërgjegjësuar fëmijët për rreziqet që mund tu vijnë nga përdorimi i internetit është materiali "Siguria", i cili është i publikuar në faqen zyrtare të MASH (www.mash.gov.al) në këtë matërijal prezantohen rregullat e sigurisë në internet në arsimin bazë, rregullat e sigurisë në botën reale, rregullat e sigurisë në internet në arsimin e mesëm. Në kuadrin e ofrimit të "internetit të sigurt" Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka vënë në dispozicion të publikut në faqen e saj zyrtare linke të faqeve të ndryshme nga bota që përmbajnë lojëra dhe materiale të tjera interaktive mbi sigurinë e fëmijëve në internet. KMDP- Në faqen e saj zyrtare (www.kmdp.al) ka vënë në dispozicion paketa këshilluese mbi privatësinë online dhe përdorimin e rrjeteve sociale. AKSHI në faqen e saj zyrtare

(www.akshi.gov.al) ka vënë në dispozicion materiale për një përdorim të sigurt të internetit.

PËRFUNDIME

Në këto vitet e fundit Shqipëria ka punuar në mënyrë sistematike në implementimin e TIK-ut në rang vendi në arsim. Ajo ka realizuar një sërë hapash, por mendoj që duhet akoma punë për të realizuar plotësisht objektivat e vetëpërcaktuara nga autoritetet shqiptare, MAS dhe Këshilli i Ministrave. Por, nga ana tjetër, një element shtytës janë edhe kriteret për tu integruar plotësisht në Bashkimin Evropian. Mungesa e pajisjeve kompjuterike bën të vështirë që mësuesit dhe nxënësit t'i praktikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Nga një vëzhgim i përgjithshëm vihet re qartë se duhet të shtohet numri i laboratorëve në shkolla dhe numri i kompjuterave në të gjitha shkollat e vendit, ndonëse kjo kërkon një buxhet të konsiderueshëm. Siç u tha më lartë, mësuesit e kësaj lënde mendoj që ende kanë nevojë për trajnime të tjera në shkallë vendi. Risitë e përditshme në këtë fushë, "vjetrojnë" me shpejtësi të madhe dijet e mësuesve. Asnjë nga fushat e tjera të mësimdhënies nuk përballlet me një hap kaq të shpejtë risish sa kjo fushë.

Nga ana tjetër, kemi mësues dhe nxënës që janë autodidakt në dijet kompjuterike. Të gjitha këto pengojnë realizimin me sukses të aftësive komunikuese, aftësive matematikore, aftësive për të punuar në grup, aftësive për të përdorur shumëllojshmëri burimesh dhe instrumentesh si të nxënësit dhe të mësuesit.

Si përfundim, mësuesit e TIK-ut dhe shkolla në tërësi, duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht për sigurinë e nxënësve, për internetin e sigurt. Vetëm nëpërmjet internetit të sigurt mund të garantohet siguria e nxënësve dhe përdorimi i drejtë dhe i duhur i kësaj teknologjie. Palët duhet të bashkëpunojnë në këtë proces që nuk mund ta bëjë e vetme asnjëra palë. Dhe, padyshim, duhet të bashkërendojnë punën edhe me ofruesit e internetit, me kompanitë e internetit fikse dhe atij të lëvizshëm (celular) etj.

BIBLIOGRAFI

- Blurton, C. (2002). *New Directions of ICT-Use in Education*. <http://www.unesco.org/education/educprog/lwf/dl/edict.pdf>; accessed.
- Boteror, S. (2003). *Mbi Shoqërinë e Informacionit*. Gjeneve: <http://www.wsisgeneva2003.org/home.html>.
- Dearnley, J. and Feather, J. (2001). *The Wired World: An Introduction to the Theory and Practice of Information Society*. London: Library Association Publishing.
- DiNicola, M. D. (2004). Pathological Internet use among college students: The prevalence of pathological Internet use and its correlates. *Dissertation Abstracts International*, 65 (05), 1675. Retrieved January 18, 2010, from ProQuest Digital Dissertations database (UMI No. AAT 3133723).

- Juana M. Sancho-Gil. (2013). *The current impact of ICT in the teaching and learning process. Education Excellence and Equity Project F/P 1570*. . : Centre for the Study of Change in Culture and Education Scientific Park of Barcelona University of Barcelona.
- Medias, Insitut. S. (2011). *Njw sondazh i opinionit të fëmijeve dhe të rinjeve për përdorimin dhe besueshmërinë e medias*.
<http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/femijet%20dhe%20media%20shqip%20per%20shtyp.pdf>.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencws, Instituti i Zhvillimit nw Arsim. (2011). *Standardet Administratorit në Arsim*.
http://www.izha.edu.al/files/standartet/Standardet_Administratorit_BR.pdf.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencws, Instituti i Zhvillimit nw Arsim. (2011). *Standardet e mësuesit për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shkollë*.
http://www.izha.edu.al/files/standartet/Standarde_mesuesi_TIK.pdf
- Ministria Arsimit dhe Sportit, (2014). *Programi i lëndës së TIK*.
http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/kurrikula/Programi_TIK_shkalla_3.pdf.
- Orleans, M., & Laney, M. C. (2000). Children's computer use in the home: Isolation or sociation? . *Social Science Computer Review*, 8(1), 56–72.
- Paryono & Quito, BG,. (2010). *Meta-analysis of ict Integration in Vocational and Technical, Education in Southeast Asia*. Seavern.: Research Report 2009/2010.
- Roberts, D. F., & Foehr, U. G. (2008). Trends in media use. *The Future of Children*, 18, 11–37.
- Robins, K. and Webster, F. (1999). *Times of the Technoculture: From the Information tion Society to Virtual Life*. London: Routledge.
- Fatmir Vejsiu. (2013). Drejtor i Arsimit Parauniversitar, MASH. Intervistuar më 21 Shkurt 2013.
- Subrahmanyam, K., & Greenfield, P. M. . (2008). Virtual worlds in development: Implications of social networking sites. *Journal of Applied Developmental Psychology* 29 (2008), 417–419.

SHKENCAT E SHOQËRISË DHE PROBLEMET SOCIALE

ENILA CENKO
FATOS TARIFA

Përmbledhje

Sociologjia ka provuar se është një përpjekje intelektuale e veçantë, e cila është gjithashtu sfiduese në një mënyrë të veçantë. Ajo është njëherësh një fushë studimesh shkencore dhe humanistike—herë një shkencë teorike e pastër, herë një disiplinë e aplikuar; e përkushtuar neutralitetit ideologjik por edhe thellësisht e angazhuar në betejat ideologjike të kohës sonë. Ky artikull analizon lidhjen organike që ekziston midis studimit sociologjik të probleme sociale dhe të drejtave të njeriut, duke vlerësuar se këto të fundit përbëjnë një ndër subjektet më interesante dhe më të rëndësishme për sociologjinë dhe për shkencën sociale në përgjithësi në shekullin XXI dhe që ndoshta do të stimulojë debatin më efektiv mbi realitetin e sotëm shoqëror në shkallë globale.

Abstract

Sociology has proved to be a unique challenging intellectual undertaking. It is a scientific and human field of study; it is sometimes a pure theoretical science and at times an applied discipline, committed to ideological neutrality yet deeply engaged in ideological struggles of our times. This article examines the organic relationship between the sociological study of social problems and human rights, arguing that the later constitute one of the most interesting and important subjects of sociology—and of social science in general—in the twenty first century, and which will probably inspire the most effective debate on social reality on a global scale.

Key words: *social problems, sociology, human rights, objectivity.*

HYRJE

Preokupimi për problemet sociale dhe zgjidhjen e tyre nuk është një dukuri e re. Prej kohësh studiuesit e jetës shoqërore u kanë kushtuar vëmendje problemeve të shoqërisë duke u munduar të shpjegojnë natyrën dhe shkaqet e tyre, si edhe të gjejnë rrugë e mënyra për zgjidhjen e tyre. Në fakt, vetë lindja e sociologjisë si një fushë e re studimesh në gjysmën e parë të shekullit të 19-të dhe zhvillimi i saj si një disiplinë akademike, prej së cilës më vonë u diferencuan si nënfusha më vete sociologjia e së drejtës, psikologjia sociale, kriminologjia etj., kanë pasur dhe kanë si premisë dhe funksion kryesor shpjegimin dhe zgjidhjen e problemeve të shoqërisë.

Mendimi shoqëror dhe problemet sociale

Qysh në shekullin e 18-të dhe gjatë gjysmës së parë të shekullit të 19-të, mendimtarë të ndryshëm, filozofë, ekonomistë, juristë apo historianë: si, Montesquieu, Adam Smith, Adam Ferguson, Edmund Burke, Thomas Pain, Jeremy Bentham, Joseph De Maistre, Mary Wollstonecraft, Saint-Simon, Harriet Martineau, Alexis de Tocqueville, John Stuart Mill, etj., ishin të preokupuar për ndryshimet e thella sociale që po kryheshin në Europën e asaj kohe dhe u përpoqën t'u jepnin shpjegim shkaqeve të tyre, si edhe të parashikonin tendencat e zhvillimit të ardhshëm shoqëror. Kjo ishte periudha kur në Angli dhe më pas në vende të tjera të kontinentit evropian dhe në Shtetet e Bashkuara, si rezultat i revolucionit industrial, masa gjithnjë e më të mëdha njerëzish po zhvendoseshin në qytete, duke u punësuar në industrinë që po

ngriheshin. Ky proces i shpejtë industrializimi dhe urbanizimi u shoqërua, pothuajse kudo, me një varg problemesh sociale, siç ishin mbipopullimi i qyteteve, kushtet shumë të vështira të strehimit dhe të jetesës për miliona njerëz, të cilët, duke u punësuar në fabrika, iu shtuan klasës së proletariatit industrial që po formohej, shfrytëzimi i punës së të miturve, papunësia dhe varfëria ekstreme, shtimi i aktivitetit kriminal, etj. Si rezultat i transformimeve dramatike që po kryheshin në jetën e shoqërisë, probleme sociale të tilla si, kushtet e mjerueshme të strehimit, varfëria dhe krimi, u bënë pjesë e pandarë e skenës së jetës urbane.

Ndryshimet e mësipërme në jetën e shoqërisë evropiane bënë që shumë mendimtarë në atë kohë t'u kushtonin vëmendje të veçantë problemeve sociale që po krijoheshin. Një ndër të parët që shprehu shqetësimin e tij mbi rrjedhojat e padëshiruara edhe pse të paevitueshme, të zhvillimit shoqëror në trajtën e problemeve sociale ishte Auguste Comte. Sipas tij, për shkak të kaosit dhe të problemeve sociale të shumta dhe gjithnjë e më të mprehta, shoqëria po dekompozohet dhe rendi shoqëror po vihej në rrezik. Për të ruajtur harmoninë sociale dhe bazat e rendit ekzistues, Comte sugjeroi se ishte e nevojshme që problemet e shoqërisë të studioheshin shkencërisht nga një shkencë e veçantë, siç është sociologjia.

Në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, mendimtarë të tjerë e përqendruan vëmendjen e tyre në ligjësitë e përgjithshme të zhvillimit shoqëror dhe, më

konkretisht, në problemet sociale që ishin bërë dukuri të zakonshme të jetës ekonomike e shoqërore. Marks dhe Engelsi, fjala vjen, u kushtuan vëmendje të veçantë problemeve të varfërisë dhe të pabarazisë ekonomike e sociale në shoqërinë kapitaliste. Në një prej studimeve të para të mirëfillta sociologjike, titulluar *Gjendja e klasës punëtore në Angli*, Engelsi ([1845] 2009) dha një pasqyrë shumë realiste të kushteve të punës dhe të jetesës së proletariatit anglez dhe të problemeve sociale që karakterizonin Anglinë në mesin e shekullit të 19-të.

Në kushtet kur monarkitë evropiane po binin njëra pas tjetrës dhe kur roli i fesë dhe format tradicionale të organizimit shoqëror dhe të mënyrës së jetesës po dobësoheshin gjithnjë e më shumë, Émile Durkheim, nga ana e tij, u përpoq të shpjegonte sesi shoqëria moderne mund të ruante një sens rregull dhe solidariteti ndërmjet anëtarëve të saj. Në një sërë studimesh të rëndësishme, Durkheimi u përqendrua, përveç problemeve të fesë, edhe në probleme të tilla, si ndarja shoqërore e punës, krimi si një dukuri shoqërore universale, vetëvraska dhe aspekte të tjera të jetës së shoqërisë. Në të njëjtën kohë me të, Georg Simmel ([1903] 1971) analizoi dallimet midis jetës urbane dhe asaj rurale, si edhe efektet e jetës së qytetit në psikologjinë dhe në veprimtarinë e individëve të veçantë. Simmel formuloi për herë të parë, veç të tjerash, konceptin e strukturës sociale dhe atë të rrjetit shoqëror. Bashkëkohësi i tyre, Max Weber, nga ana e tij, i përqendroi interesimet e tij akademike në problemet sociale që kanë të bëjnë me organizimin burokratik dhe racionalizimin e shoqërisë moderne, si edhe në pushtetin që ka ky organizim burokratik mbi çdo anëtar të shoqërisë.

Qysh nga krijimi i sociologjisë si një fushë e veçantë, kjo shkencë është fokusuar në studimin e problemeve sociale dhe në mënyrat sesi mund të zgjidhen ato. Ky mbetet fokusi i interesimeve dhe i veprimtarisë studimore edhe për sociologët e sotëm, të cilët, ashtu si themeluesit e kësaj disipline dhe sociologë të tjerë të shquar të shekullit të 20-të, janë të interesuar të shpjegojnë sesi funksionon shoqëria e sotme, se si kushte të caktuara shoqërore krijojnë probleme sociale në shkallë lokale, kombëtare apo globale dhe se si mund të ndryshohen këto kushte shoqërore për të ndihmuar zgjidhjen e problemeve sociale që burojnë prej tyre.

Ç'janë problemet sociale?

Cilat probleme konsiderohen probleme sociale? Nëse do të jepnim një përkufizim tepër të përgjithshëm se ç'është një problem social, mund të mjaftoheshim të thoshim se një problem *social* është i ndryshëm nga një problem *personal*, të cilin

nuk e përjetojnë individë të tjerë përveç nesh. C. Wright Mills ([1959] 2000) vinte në dukje, sidoqoftë, se një problem personal mund të jetë gjithashtu edhe një problem social, nëse kushte të caktuara shoqërore bëjnë që edhe individë të tjerë ta përjetojnë atë si një problem personal të tyre. Për shembull, shumë individë apo familje e përjetojnë varfërinë ekonomike si një problem personal apo familjar, por të gjithë ata janë pjesë e një mënyre organizimi ekonomik të shoqërisë dhe e një strukture sociale që krijojnë papunësi (*ibid.*). Prej këtej rrjedh se, për të gjykuar nëse një dukuri e caktuar përbën apo jo një problem social, duhet vlerësuar në se *problemet personale të njerëzve* janë të lidhura me, dhe të kushtëzuara nga, *kushtet e përgjithshme objektive të shoqërisë*.

Sociologët amerikanë Richard Fuller dhe Richard Myers, në një artikull ndër më të cituarit, i titulluar "Historia natyrore e një problemi social", botuar në *American Sociological Review* rreth 70 vjet më parë, vinin në dukje se "problemet sociale kanë në vetvete elemente objektive" (Fuller & Myers 1941: 320). Kjo, sipas tyre, do të thotë se problemet sociale mund të evidentohen dhe të "maten" empirikisht. Për shembull, nëse të dhënat empirike tregojnë se familje ose shtresa të varfra të popullsisë kanë të ardhura të pakta, kushte strehimi të pakënaqshme dhe një cilësi jetese më të ulët, krahasuar me familjet apo shtresat jo të varfra, kjo do të thotë se një problem i tillë social, siç është varfëria, përveç elementit subjektiv, të shprehur në perceptimet dhe përjetimet tona individuale, përmban në vetvete edhe një element objektiv.

Shumë probleme sociale konsiderohen të tilla, pra probleme për shoqërinë në përgjithësi: fjala vjen, papunësia, varfëria ekonomike, diskriminimi racia, etnik apo fetar, pabarazia gjinore, krimi, etj. Kjo, sidoqoftë, nuk do të thotë se vetëm ato dukuri, të cilat konsiderohen si probleme sociale nga e gjithë shoqëria, janë probleme sociale. Në çdo shoqëri të dhënë ekzistojnë kushte të caktuara shoqërore, të cilat *subjektivizohen* dhe *përjetoohen* si probleme sociale nga grupe shoqërore, ose nga komunitete të caktuara. Pra, problemet sociale presupozojnë ekzistencën e dy faktorëve: (a) të një faktori *objektiv*, me çka kuptojmë një aspekt të jetës shoqërore që ekziston pavarësisht dëshirave tona dhe që mund të vlerësohet dhe "matet" empirikisht dhe, (b) të një faktori *subjektiv*, me çka kuptojmë preokupimin e një mase të konsiderueshme njerëzish për atë aspekt të jetës shoqërore dhe dëshirën e tyre për ta ndryshuar atë (Henslin 2008: 6). Identifikimi i kushteve të caktuara shoqërore si një problem social ka të bëjë, pra, me faktin që ne, si

individë të veçantë, gjykojmë se diçka nuk shkon mirë në shoqëri dhe prandaj duhet ndryshuar.

Kur flasim për probleme sociale, me këtë kuptojmë, së pari, se *kushte të caktuara shoqërore shkaktojnë probleme personale* për anëtarë të caktuar të shoqërisë; së dyti, se problemet sociale mund të jenë *lokale*, pra mund të ndeshen në një komunitet të caktuar, por ato mund të jenë edhe *kombëtare* ose *globale* dhe, së treti, se problemet sociale nënkuptojnë si *perceptimet subjektive* të njerëzve, ashtu edhe *evidencën objektive* mbi ekzistencën e tyre. James Crone e sintetizon këtë ide si më poshtë:

Një problem social ekziston atëherë kur njerëzit perceptojnë subjektivisht dhe kanë të dhëna objektive që provojnë se kushte të caktuara shoqërore, të kombinuara në nivel lokal, kombëtar apo global, shkaktojnë probleme personale (Crone 2007: 2).

Autorë të tjerë ofrojnë përkufizime të ndryshme mbi atë se ç'përfaqëson një problem social. Sociologët Daniel Curran dhe Claire Renzetti, fjala vjen, shkruajnë se:

Një problem social është një rrethanë shoqërore e shkaktuar nga faktorë që janë pjesë inherente e strukturës sociale të një shoqërie të dhënë, e cila, në mënyrë sistematike, krijon kushte disavantazhi, ose diskriminon një segment të caktuar të popullsisë apo një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të saj (Curran & Renzetti 2002: 3).

Kornblum dhe Joseph Julian, nga ana e tyre, argumentojnë se një problem social ekziston atëherë "kur pjesa më e madhe e popullsisë në një shoqëri të dhënë është e mendimit se ekziston një *rrethanë shoqërore*, e cila kërcënon cilësinë e jetës së tyre dhe vlerat e tyre themelore dhe se diçka duhet bërë për ta ndryshuar atë rrethanë" (Kornblum & Julian 2001: 4). Sociologët Mooney, Knox dhe Schact (2002: 3), në librin e tyre *Të kuptuarit e problemeve sociale*, ofrojnë një përkufizim të ngjashëm. Sipas tyre, "një problem social është një rrethanë shoqërore, të cilën një pjesë e shoqërisë e sheh si të dëmshme për anëtarët e saj dhe prandaj kërkon që ajo të ndryshohet". John Palen, në librin e tij *Probleme sociale për shekullin e 21-të*, shpreh një mendim të ngjashëm kur shkruan se "problemet sociale janë dukuri, të cilat një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë gjykon se janë në kundërshtim me normat shoqërore dhe, për këtë arsye, diçka mund dhe duhet bërë për t'i ndryshuar ato" (Palen 2001: 10).

Një tjetër sociolog amerikan, Vincent Parrillo, në librin e tij *Probleme sociale bashkëkohore*,

argumenton se problemet sociale përmbajnë në vetvete 4 komponentë:

(1) Ato *shkaktojnë dëme fizike apo mendore* tek individë të veçantë, ose në mbarë shoqërinë; (2) Ato *janë në kundërshtim me vlerat dhe standartet morale* të grupeve të caktuara shoqërore; (3) Ato *ekzistojnë për një periudhë relativisht të gjatë*; dhe (4) Ato *gjenerojnë propozime konkurruese për zgjidhje* si rezultat i vlerësimeve të ndryshme që u bëjnë këtyre problemeve grupe të ndryshme shoqërore, të cilat zënë pozita të caktuara në shoqëri, çka e vështirëson dhe e vonon arritjen e një konsensusi mbi mënyrën sesi duhet zgjidhur një problem [i caktuar] (Parrillo 2002: 4-5).

Në procesin e zhvillimit shoqëror ndryshojnë si *kushtet objektive* të jetës së shoqërisë, ashtu edhe *preokupimet subjektive* të njerëzve. Kjo do të thotë se problemet sociale duhen vlerësuar në *dinamikën* e tyre. Një aspekt i caktuar i jetës shoqërore, i cili më parë nuk përbënte një problem social, mund të bëhet i tillë me ndryshimin e kushteve objektive të shoqërisë dhe të perceptimeve subjektive të njerëzve. Fjala vjen, në kushtet kur lëvizja e popullsisë nga zonat rurale në qytete ishte rreptësisht e kontrolluar nga shteti socialist, braktisja e fshatit dhe mbipopullimi i qyteteve kryesore të vendit nuk përbënin një preokupim shoqëror, pra as nuk ishin një problem social në Shqipëri. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për emigrimin masiv, ose për dukurinë e "largimit të trurit", të cilat, pas ndryshimit të kushteve politike dhe ekonomike në shoqërinë shqiptare, janë bërë probleme të mprehta sociale për vendin tonë.

Problemet sociale janë jo vetëm dinamike, ato janë gjithashtu *relative*. Ajo çka njerëz të ndryshëm e konsiderojnë një problem social varet nga *sistemi i vlerave* të tyre. Fjala vjen, ekzistenca e prostitucionit, pornografia apo aborti mund të konsiderohen probleme sociale nga shumë njerëz, por mund të mos konsiderohen të tilla nga shumë të tjerë. Përveç kësaj, në një botë pluraliste, si kjo në të cilën jetojmë, një aspekt shoqëror që konsiderohet problem social në një shoqëri të dhënë mund të mos konsiderohet i tillë në një shoqëri tjetër. Fjala vjen, përdorimi i marijuanës përbën një problem social në Shtetet e Bashkuara dhe në çdo vend evropian, por nuk konsiderohet i tillë në Holandë. Madje, edhe në vetë Shtetet e Bashkuara, përdorimi i marijuanës nuk përbënte një problem social deri në vitin 1937, kur me aktin ligjor mbi taksën për marijuanën Kongresi amerikan e nxori këtë substancë (deri atëherë të ligjshme) jashtë ligjit (Helmer 1975). Nga ana tjetër, një referendum i mbajtur në shtetin e Kolorados në nëntor të vitit 2012 e bëri përdorimin e

marijuanës në këtë shtet të Shteteve të Bashkuara përsëri një veprim të ligjshëm.

Vëzhgues “objektivë” pasivë të problemeve sociale apo faktorë aktivë në zgjidhjen e tyre?

Ç’rol luan sociologjia në zgjidhjen e problemeve sociale? Si një shkencë që studion kushtet e jetës së shoqërisë, strukturën dhe institucionet e saj, si edhe marrëdhëniet mes individëve dhe grupeve shoqërore, sociologjia ka potencialisht një avantazh më të madh se çdo disiplinë tjetër shoqërore për të ndihmuar në njohjen dhe në zgjidhjen e problemeve sociale. Sidoqoftë, studimi i problemeve sociale përbën një dilemë për sociologët. Kjo dilemë nuk ka të bëjë me dhe nuk shfaqet në momentin kur një sociologu i duhet të zgjedhë subjektin e studimit të tij, as me procesin e mbledhjes së të dhënave apo me metodën që ai përdor për mbledhjen e tyre. Kjo dilemë nuk shfaqet as në momentin kur një sociolog zbulon shkaqet e një problemi social apo vë re pasojat e tij për shoqërinë. Sociologët, në përgjithësi, synojnë të identifikojnë shkaqet e dukurive dhe të problemeve sociale si edhe të parashikojnë pasojat e pritura dhe ato të padëshiruara të tyre.

Dilema me të cilën ndeshet një sociolog ka të bëjë me aspektin e *zgjidhjes* së problemeve sociale. Me fjalë të tjera, ç’duhet të thotë një sociolog për zgjidhjen e një problemi shoqëror dhe a duhet ai, në fund të fundit, të shprehet për zgjidhjen e tij? A duhet që një grup sociologësh të shprehen kolektivisht se çfarë duhet bërë për zgjidhjen e një problem social? A mundet që një sociolog të mbetet objektiv (nëse me këtë kuptojmë që ai të mos mbajë një qëndrim të caktuar mbi atë se ç’duhet bërë) dhe, përsëri, në një farë mënyre, të mund të kontribuojë në atë se çfarë dimë ne për zgjidhjen e një problemi?

Shumë sociologë i përmbahen pikëpamjes se *detyra* dhe *rol* i një sociologu është thjesht të pohojë atë që vëzhgon, me fjalë të tjera, të studiojë vetëm atë që ndodh realisht në jetë, duke u fokusuar në përshkrimin e dukurisë apo të problemit, në shkaqet dhe në pasojat e tij, si edhe në parashikimin e tendencave të tij, pa thënë se çfarë duhet bërë për zgjidhjen e tij. Sociologët që i përmbahen kësaj pikëpamjeje i referohen njërit prej themeluesve të sociologjisë, Max Weberit, i cili, argumentonte se sociologët duhet të mbeten sa më objektivë që të jetë e mundur për aq kohë sa ata “mbajnë kapelën” e sociologut. Kur ata nuk janë në rolin e sociologut, por janë, fjala vjen, qytetarë që marrin pjesë në votime apo që bëjnë pjesë në një parti politike të dhënë, e cila ka një qëndrim të caktuar mbi çështjet, ata mundet dhe duhet të

shprehin pikëpamjet e tyre (Weber [1920] 1946). Weber shkruante:

Politika nuk ka vend në sallën e leksionit...Të mbash një qëndrim politik praktik është një gjë dhe të analizosh strukturat politike dhe qëndrimet e partisë është një gjë tjetër. Kur flet në një takim politik mbi demokracinë dikush nuk e fsheh qëndrimin e tij personal; është detyra e tij që të shprehet qartë dhe të bëjë të njohur qëndrimin e tij. Fjalët që përdor dikush në një takim të tillë nuk janë mjet i analizës shkencore, por shërbejnë për të marrë vota dhe për të fituar ndaj të tjerëve...fjalë të tilla janë armë. Nëse fjalë të tilla do të përdroreshin...në një sallë leksioni, ato do të ishin irrituese...Të kuptuarit e plotë të fakteve merr fund kurdoherë që një studiues shpreh gjykimet e tij personale, të cilat kanë për bazë vlerat në të cilat beson ai vetë (Weber [1920] 1946: 145-146).

Po kështu, në esenë e tij “Objektiviteti” në shkencën sociale dhe në politikën sociale”, Weberi vinte ne dukje se “një shkencë empirike nuk mund t’i thotë askujt se çfarë *duhet* të bëjë ai, por vetëm se çfarë *mund* të bëjë ai” (Weber 1949: 54).

Ata sociologë që i përmbahen pikëpamjes weberiane vihen në vështirësi kur vjen puna për të diskutuar rreth zgjidhjeve që mund t’u jepen problemeve të ndryshme sociale, pasi duke sugjeruar zgjidhje për këto probleme ata gjykojnë se i largohen rolit të tyre si sociologë dhe detyrimit për të qenë objektivë. Sipas tyre, nëse publiku i gjerë do të vinte në dyshim objektivitetin e sociologjisë si shkencë, kjo disiplinë do të humbiste kredibilitetin e saj. Në këtë rast, sociologët do të shiheshin thjesht si një tjetër grup interesi që kanë agjendën e tyre, në vend që të vlerësohen si studiues objektivë, tek të cilët publiku dhe institucionet publike të shoqërisë kanë besim kur ata raportojnë të dhëna të vlefshme dhe një dije objektive mbi dukuri apo probleme të caktuara shoqërore, mbi bazën e të cilave të tjerët të gjykojnë dhe të vendosin se çfarë duhet bërë për t’u dhënë zgjidhje këtyre problemeve. Nisur nga një arsyetim i tillë, ka sociologë, të cilët mendojnë se, në vend që të vënë në rrezik kredibilitetin e tyre si një burim objektiv të dhënash dhe njohjeje, është më mirë t’u qëndrojnë larg zgjidhjes së problemeve. Zgjidhja e problemeve, sipas tyre, u duhet lënë parlamentit dhe qeverisë, ndërsa sociologët duhet vetëm të fokusohen në përshkrimin e dukurive e të problemeve sociale, në zbulimin e shkaqeve dhe në parashikimin e pasojave të tyre.

Sociologë të tjerë mendojnë se roli dhe detyra e tyre, si studiues, nuk është thjesht të pohojnë atë që *është* dhe të përshkruajnë atë që *ndodh*, por edhe të shprehin pikëpamjet e tyre të informuara mbi atë se *si duhet të jetë*. Unë bëj pjesë në këtë

grup të dytë sociologësh. Unë besoj se objektiviteti në studimin shkencor të realitetit shoqëror nuk mund të jetë kurrë absolut; *objektiviteti është gjithnjë relativ*. Asnjë studiues nuk mund të gjykojë për ngjarje ose për dukuri shoqërore i zhveshur tërësisht nga vlerat e tij politike e morale. Edhe pse studiuesit e shkencave sociale, pothuajse pa përjashtim, shpallin se ata, në çdo rast, i ndajnë vlerat nga faktet, ose origjinën e një teze nga vlefshmëria e saj, unë mendoj se kërkimi në shkencat sociale influencohet pothuajse gjithnjë edhe pse jo gjithnjë në të njëjtën masë nga personaliteti, nga formimi kulturor, nga vlerat dhe nga interesat e vetë studiuesit (Tarifa 2013).

Ndarja e plotë e fakteve nga vlerat individuale është diçka thujtë e pamundur në shkencat sociale, përderisa *cilësitë e tyre humane*, si individë njerëzorë, janë ndër mjetet e studimit që përdorin si sociologët, ashtu edhe antropologët, historianët, studiuesit e shkencave politike etj. Unë i përmbahem tezës se *vlerat janë funksionale për studiuesin e shkencave sociale dhe për historianin, ashtu siç ato janë të tilla edhe për individët e tjerë që ata studiojnë (ibid.)*. Kjo është e vërtetë jo vetëm në sociologji, në antropologji, në histori dhe në shkencën politike, por edhe në psikologji, pasi edhe kjo e fundit influencohet, në një masë të dhënë, nga personaliteti i vetë psikologëve. Shumica e studimeve historike, sociologjike, politike, antropologjike dhe psikologjike orientohen dhe ndikohen në *presupozimet*, në *metodat*, në *problemet* dhe në *konceptet* e tyre nga filozofitë sociale dhe politike të vetë autorëve të tyre, të cilët, sado që të përpiqen, nuk mund të mbeten spektatorë, ose studiues neutralë të ngjarjeve apo të dukurive.

Një “shkencë e kulluar”, e cila, siç besojnë ata historianë dhe ata studiues të shkencave sociale që frymëzohen nga imazhi Njutonian, do t’i ngjante fizikës, vështirë se është e mundur në shkencat sociale dhe në historiografi. Pavarësisht kësaj, studiuesit e shkencave sociale dhe historianët kanë *detyrimin* që të jenë sa më objektivë që është e mundur—d.m.th. që të mbështeten në kritere ndërsobjektivist të *verifikueshme*, për të konfirmuar përgjithësimet që ata bëjnë kurdoherë që kjo është e mundur duke mos lejuar *shtrembërimin e qëllimshëm të fakteve*. Kjo, madje, nuk është në kundërshtim me standardin weberian. Për Weberin, studiuesi i shkencave sociale nuk duhet të heqë dorë tërësisht nga përkushtimi i tij ndaj vlerave....Çështja është që *në rolin e tij si studiues*, duhet të ekzistojë një sistem i veçantë nënvlerash, i cili të ketë përparësi tek ai; kjo do të thotë që qartësia konceptuale, konsistenca dhe

përgjithësimi, nga njëra anë, dhe saktësia empirike dhe verifikueshmëria, nga ana tjetër, janë produkt i çmuar i kërkimit....Në të njëjtën kohë, kjo nënkupton të hequrit dorë nga e drejta që studiuesi, si studiues, të flasë nga pozitat e vlerave të caktuara, të cilat kanë më shumë rëndësi sociale dhe historike sesa ato të shkencës së tij (cituar në Parsons 1971: 33).

Idenë se shkencat sociale duhet të ketë për mision jo vetëm *shpjegimin* e botës, por edhe *transformimin* e saj, e ka artikuluar për herë të parë Karl Marksi. Ndryshe nga çdo mendimtar tjetër social para tij apo bashkëkohës të tij, Marksi bëri qendrore në teorinë e tij tezën se njerëzit janë autorë të kushteve të tyre sociale dhe, për këtë arsye, ata mund t’i transformojnë këto kushte. Në formën e saj klasike, Marksi e formuloi këtë ide në *Tezat mbi Fojebahun* (1845), duke ardhur në formulimin e famshëm se “Deri më sot, të gjithë filozofët vetëm janë mjaftuar ta shpjegojnë botën; çështja është sesi ta ndryshosh atë” (Marx [1845] 1972: 107). Duhet thënë se jo të gjithë sociologët që i përmbahen kësaj pikëpamjeje janë markistë. Shumë prej tyre mendojnë se studimi i marrëdhënieve dhe i dukurive shoqërore përmes mbledhjes dhe hulumtimit të të dhënave, zbulimit dhe krahasimit të marrëdhënieve korrelative midis aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore dhe parashikimi i zhvillimeve të ardhshme nuk janë qëllim në vetvete dhe nuk do të bënin kuptim nëse, si sociologë, ata nuk do të bënin asnjë përpjekje për të sjellë ndryshime pozitive në jetën e shoqërisë. Sipas tyre, kush më shumë se sociologët, të cilët i studiojnë dhe janë të përgatitur t’i kuptojnë më mirë se kushdo tjetër dukuritë shoqërore dhe problemet sociale, do të duhej të bënin diçka për zgjidhjen e këtyre problemeve?

Në këtë pikë, dëshiroj të hap një parantezë: Çështja e objektivitetit të sociologjisë, apo çështja nëse sociologjia është kryesisht *shkencë* apo kryesisht *joshkencë*, ka qenë dhe mbetet një çështje shumë e debatuar midis studiuesve të shkencave sociale. Në këtë debat, dy kanë qenë dhe mbeten pozicionet kryesore: njëri është ai që e konsideron sociologjinë një disiplinë *humane*, ndërsa tjetri ai që e konsideron atë një disiplinë *shkencore*.

Përkrahësit e pikëpamjes së parë nisen nga dy argumente bazë: Së pari, ashtu si edhe me disiplina të tjera humane (letërsia, filozofia, historia, antropologjia), subjekti i të cilave janë *simbolet*, edhe sociologjia ka për subjekt të saj simbolet, përderisa realiteti shoqëror konsiston në simbole. Përkrahësit e këtij argumenti përmendin si shembuj koncepte-simbole të tilla si “rol”, “publik”, “aktor”, “vendim”, “zgjedhje”, “karizëm”, “dominim”, etj. Ata

theksojnë, pra, vetëm përmbajtjen humaniste të sociologjisë dhe afërsinë e saj “gjinore” me letërsinë dhe me kritikën letrare. Sipas tyre, madje edhe përdorimi i metodave statistikore në sociologji nuk bën gjë tjetër veçse e kondenson informacionin sociologjik “për të thënë më shumë me sa më pak fjalë” dhe në një mënyrë më “precize”. Siç pohon sociologu amerikan Jay Weinstein:

Që nga koha e krijimit të saj dhe deri më sot, sociologjia ka provuar se është një përpjekje intelektuale e veçantë, e cila është gjithashtu sfiduese në një mënyrë të veçantë. Ajo është njëherësh një fushë studimesh shkencore dhe humaniste, herë një shkencë teorike e pastër, herë një disiplinë e aplikuar; e përkushtuar neutralitetit ideologjik por edhe thellësisht e angazhuar në betejat ideologjike të kohës sonë (Weinstein 2008: 11-12).

Së dyti, arsimimi sociologjik, gjithashtu, ndjek një model humaniste, për shkak se ai mbështetet në leximin e klasikëve të mendimit shoqëror për të stimuluar mendimin bashkëkohor mbi shoqërinë dhe si burim i parë për të transmetuar dijen sociologjike. Robert K. Merton (1949) vinte në dukje se çdo sociolog bashkëkohës, i cili pretendon se ka haber nga sociologjia, ka pasur kontakte të drejtpërdrejta dhe të përsëritura me veprat e themeluesve të sociologjisë: Comte, Spencer, Marx, Simmel, Tönnies, Pareto, Durkheim, Weber, etj. Sipas tij, nuk mund të ndodhë që ndonjë sociolog bashkëkohës të dëshirojë të heqë dorë nga mbështetja në veprat klasike të sociologjisë, ç’ka është pjesë integrale e eksperiencës sonë si sociologë.

Nga ana tjetër, përkrahësit e tezës se sociologjia është një disiplinë shkencore argumentojnë se, pavarësisht arsimimit humanist dhe përmbajtjes humaniste të fushës së tyre, kërkimi sociologjik, i cili ka për objekt simbolet shoqërorë dhe marrëdhëniet shoqërore, presupozon të njëjtën mënyrë të përgjithshme reflektimi që gjejmë edhe në shkencat natyrore, të cilat kanë për subjekt të tyre natyrën fizike apo botën e gjallë.

Kur Weberi shkruante mbi “kërkimin e vërtetë empirik sociologjik”, në gjykimin e tij një kërkim i tillë fillon me pyetjen: Çfarë i motivon individët, si anëtarë të një komuniteti, të sillen në një mënyrë të tillë që, para së gjithash, bën të mundur vetë krijimin dhe ekzistencën e këtij komuniteti? Vetë Weberi dhe bashkëkohësi i tij Georg Simmel kanë dhënë një shembull të shkëlqyer sesi mund të arrihet në përgjithësim sociologjike duke vëzhguar me kujdes veprimet dhe marrëdhëniet sociale të individëve në shoqëri. Weberi argumentonte se sociologjia duhet të synojë të formulojë koncepte “ideale tip”

(*Idealtyp*) dhe uniformiteti të përgjithësuar të proceseve empirike, çka është në të vërtetë ajo që bëjnë edhe shkencat fizike apo ato natyrore. Është pikërisht kjo që e dallon sociologjinë dhe dijen e saj *nomotetike* (*nomothetic knowledge*), tipike për shkencat natyrore, nga historia, dija e së cilës është përshkruese, apo *ideografike* (*ideographic knowledge*). Weber theksonte se jeta shoqërore mund të studiohet jo vetëm ideografikisht (siç bën historia), por edhe nomotetikisht, duke pasur për synim zbulimin e ligjeve të përgjithshme që rregullojnë jetën sociale.

Qeniet njerëzore, në veprimtarinë e tyre, motivohen nga vlera të caktuara humane, morale, kulturore, politike dhe, për këtë arsye, studimi i tyre me objektivitet nuk është njëloj si studimi i fenomeneve fizike të natyrës. Megjithatë, sociologët kanë imagjinatën, kapacitetin shkencor dhe mjetet e nevojshme për të kuptuar dhe për të shpjeguar botën shoqërore *me po aq objektivitet* sa edhe natyralistët kuptojnë dhe shpjegojnë fenomenet e botës fizike. Robert K. Merton (1949), George Homans ([1950] 1991; 1961) dhe sociologë të tjerë të shquar para tyre (Durkheim, Weber, Parsons) kanë provuar se kërkimi sociologjik mundet që, përsa i përket logjistikës së teorizimit, të jetë po aq rigoroz dhe shkencor sa edhe në shkencat natyrore. Merton, për shembull, argumentonte se sociologjia adopton atë orientim dhe praktikë që gjejmë edhe në shkencat natyrore: edhe këtu, kërkimi realizohet duke u nisur nga kufijtë që ka avancuar akumulimi i dijes nga brezat e mëparshëm. Sidoqoftë, sociologjia ruan lidhjet e saj “gjinore” me disiplinat humane. Edhe pse kjo mund të duket se e bën sociologjinë “më pak shkencore”, sociologjia, përsëri, është kryesisht shkencë (Tarifa 2014).

Le t’i përmbledh mendimet e shprehura më sipër si më poshtë. Pa nënvleftësuar aspak nevojën për të qenë objektivë në studimin e jetës së shoqërisë, unë mendoj se do të ishte një shpërdorim i madh i atij arsenali të konsiderueshëm dhe shumë të dobishëm njohurish mbi shoqërinë që akumulojnë dhe përpunojnë sociologët nëse ata nuk do të angazhoheshin, në një mënyrë ose në një tjetër, në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë. Çështja mund të shtrohet në këtë mënyrë: a mundet që sociologët të studiojnë problemet sociale me qëllim zgjidhjen e tyre duke mbetur objektivë dhe duke ruajtur kredibilitetin e tyre? Unë mendoj se kjo është tërësisht e mundur në disa aspekte.

Një aspekt ka të bëjë me atë se çfarë *dinë* apo *mësojnë* sociologët (përmes studimeve të tyre) në lidhje me këto probleme dhe për format e shfaqjes apo tendencat e tyre dhe si mund të ndihmojnë

njohuritë e tyre për zgjidhjen e problemeve të sotme sociale.

Sociologët, gjithashtu, mund të aplikojnë *imagjinatën sociologjike* (Mills [1959] 2000), çka do të thotë se ata mund t'i vlerësojnë dhe trajtojnë problemet sociale në një kontekst më të gjerë shoqëror. Me "imagjinatë sociologjike" Mills ([1959] 2000) kuptonte atë "aftësi të mendjes", e cila na mundëson të kuptojnë mënyrat sesi biografia e një individi ndërthuret me rrjedhën e zhvillimeve historike dhe sesi ne mund t'i shohim *shqetësimet tona personale si pjesë të problemeve më të gjëra të shoqërisë në të cilën jetojmë*. Tehu kritik i një perspektive të tillë, siç vë në dukje Weinstein është:

[...] të kuptuarit e faktit sesi kultura bashkëkohore, duke nxitur individualizmin dhe duke u fokusuar në problemet e individit, injoron apo minimizon faktin që, si "kafshë shoqërore", ne të gjithë jemi të varur nga familja, nga shokët, nga sistemet politike, nga korporatat, nga grupe të gjera shoqërore dhe nga institucionet në të cilat bëjmë pjesë për shkak të personaliteteve tona gjoja "unikë" dhe të preokupimeve tona "private". Faktin që ne jemi njëherësh individualë dhe socialë, unikë dhe të zakonshëm, privatë dhe publikë, na ndihmon ta kuptojmë pikërisht imagjinata sociologjike (Weinstein 2008: 13).

Fjala vjen, problemi i abortit është i lidhur me pikëpamjet dhe qëndrimet që ekzistojnë në një shoqëri të dhënë lidhur me natyrën private të marrëdhënieve seksuale, me besimet që kanë njerëzit për atë se ç'përfaqëson jeta njerëzore, kur nis dhe ku mbaron ajo, me rolin e institucioneve fetare dhe të botëkuptimit fetar në një shoqëri pluraliste, etj. Ky problem është i lidhur ngushtë, gjithashtu, me idetë mbi lirinë e individit *vis-à-vis* përgjegjësisë ndaj grupit shoqëror në të cilin ai bën pjesë, mbi atë se çfarë konsiderohet e moralshme apo e pamoralshme në një shoqëri të dhënë etj. (Lerner et al. 1990).

Një tjetër mënyrë sesi sociologët mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve sociale duke mos rënë në pozita subjektive është që ata të studiojnë ata aspekte të një problemi të dhënë social, të cilat e pengojnë zgjidhjen e tij. Duke i njohur këto aspekte, sociologët mund ta fokusojnë veprimtarinë e tyre studimore në to.

Një mënyrë tjetër sesi sociologët, duke ruajtur objektivitetin e tyre, mund të kontribuojnë për zgjidhjen e problemeve sociale është që ata të studiojnë empirikisht raste kur problemet sociale në

të kaluarën, ose në vende të tjera, janë zgjidhur apo janë vënë në rrugën e zgjidhjes, duke reflektuar sesi zgjidhjet e gjetura në të kaluarën—apo nga të tjerë—mund të aplikohen për t'u dhënë zgjidhje problemeve aktuale të shoqërisë sonë. Pavarësisht kuptimeve dhe qëndrimeve të ndryshme që mund të kenë, sociologët janë në gjendje të bëjnë parashikime mbi probleme të reja që potencialisht mund të krijohen në shoqëri, ose mbi probleme sociale që eventualisht mund të zgjidhen si rezultat i politikave të caktuara sociale dhe i përpjekjeve për t'i zgjidhur ato. Parashikimet e tyre mund të jenë shumë të dobishme për ato institucione apo organizma shtetërore që hartojnë politika sociale. Për shembull, sociologët mund të vlerësojnë sesi një politikë sociale e propozuar lidhur me abortin mund të ndikojë në nivelin e lindshmërisë, në shkallën e rritjes së popullsisë dhe në shpenzimet publike për arsimin apo për ndihmën sociale.

Së fundi, sociologët kanë mundësinë të sugjerojnë zgjidhje të ndryshme për problemet sociale si edhe të parashikojnë efektet e këtyre zgjidhjeve për individë, grupe të caktuara shoqërore, ose për shoqërinë në tërësi. Detyra e sociologut nuk është që të imponojë zgjidhjen e tij të preferuar për një problem të dhënë social, por që të parashikojë zgjidhjet e mundshme për atë problem, në mënyrë që hartuesit e politikave sociale të njohin mirë dhe të krijojnë një kuptim të qartë mbi opsionet që ekzistojnë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të shoqërisë.

Në përfundim dëshiroj të theksoj se ndryshimet që ndodhin në shoqëri nuk janë rezultat i veprimeve të robotëve, por të njerëzve që kanë njohuri, një botëkuptim, një moral, interesa dhe qëllime të caktuara. Për sa i përket njohurive tona mbi shoqërinë, ato përveçse ofrojnë një kuptim më të mirë të botës shoqërore, luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm edhe për të krijuar hapësirat dhe oportunitetet e nevojshme për të sjellë ndryshime sociale në shoqëri, për të krijuar një shoqëri më të mirë se e sotmja. Ç'vlerë do te kishte shkencë, përfshirë këtu edhe shkencat natyrore, diturinë e të cilave e konsiderojmë "më objektive", nëse njohuritë që ofron ajo nuk i shërbejnë progresit të racës humane? Si studiues të shkencave shoqërore ne s'do të kishim asnjë vlerë dhe aktiviteti ynë s'do të kishte asnjë dobi nëse përpjekjet tona nuk do të synonin, nga njëra anë, të kuptuarit më të mirë të shoqërisë dhe, nga ana tjetër, progresin e vazhdueshëm të saj?

BIBLIOGRAFI

Crone, James. 2007. *How Can We Solve Our Social Problems?* Thousand Oaks, CA: Pine Forge Press.
Curran, Daniel J. & Claire M. Renzetti. 2000. *Social Problems: Society in Crisis* (5th ed.). Boston: Allyn & Bacon.

- Engels, Friedrich. [1845] 2009. *The Condition of the Working Class in England*. Oxford: Oxford University Press.
- Fuller, Richard C. & Richard R. Myers. 1941. "The Natural History of a Social Problem", *American Sociological Review*, Vol. 6, ff. 320-328.
- Helmer, John. 1975. *Drugs and Minority Oppression*. New York: Seabury.
- Henslin, James K. 2008. *Social Problems: A Down-to-Earth Approach* (8th ed.). Boston: Allen & Bacon.
- Homans, George C. [1950] 1991. *The Human Group*. Transaction Publishers.
- Homans, George C. 1961. *Social Behavior: Its Elementary Forms*. New York: Harcourt Brace.
- Kornblum, William & Joseph Julian. 2001. *Social Problems* (10th ed.). Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall.
- Lerner, Robert, Althea K. Nagai & Stanley Rothman. 1990. "Abortion and Social Change in America", *Society*, Vol. 2, No. 27, ff. 8-15.
- Marx, Karl. [1845] 1972. "Theses on Feuerbach", në Robert C. Tucker (ed.), *The Marx-Engels Reader*. New York: Norton.
- Merton, Robert K. 1949. *Social Theory and Social Structure*. Glencoe: Free Press.
- Mills, C. Wright. [1959] 2000. *The Sociological Imagination*. New York: Oxford University Press.
- Mooney, Linda A, David Knox & Caroline Schact. 2002. *Understanding Social Problems*. Belmont, CA: Wadsworth/Thomas Learning.
- Palen, J. John. 2001. *Social Problems for the Twenty-First Century*. Boston, MA: McGraw-Hill.
- Parrillo, Vincent N. 2002. *Contemporary Social Problems* (5th ed.). Boston, MA: Allyn & Bacon.
- Parsons, Talcot. 1971. "Value-Freedom and Objectivity", në Otto Stammer (ed.), *Max Weber and Sociology Today*. New York: Harper Torchbooks.
- Simmel, Georg. [1903] 1971. *The Metropolis and Mental Life*. Në Donald Levine (ed.), *Simmel: On individuality and Social Forms*. Chicago, IL: The University of Chicago Press.
- Tarifa, Fatos. 2013. "Social Science Research and the Social Policy Making Process", *The International Journal of Interdisciplinary Social and Community Studies*, Vol. 7, No. 1, pp. 77-86.
- Tarifa, Fatos. 2014. *Imagjinata sociologjike dhe bota jonë sociale*. Tiran: Onufri.
- Weber, Max. [1920] 1946. "The Protestant Sects and the Spirit of Capitalism", ff. 302-322 në H. H. Gerth and C. Wright Mills (eds.), *From Max Weber*. New York: Oxford University Press.
- Weber, Max. 1949. "'Objectivity' in Social Science and Social Policy", në *The Methodology of the Social Sciences* (ff. 49-112). New York: Free Press.
- Weinstein, Jay. 2008. "Parathënie", ff. 11-17, në Fatos Tarifa, *Ftesë në Sociologji: Imagjinata sociologjike dhe jeta e përditshme*. Tiranë: Ombra GVG.

HISTORIKU I MËSIMDHËNIES SË GJUHËS GJERMANE NË HAPËSIRAT SHQIPTARE

ERIGYS PRIFTI

MIHALLAQ ZILEXHIU

DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Zhvillimi historik i të mësuarit të gjuhës gjermane në hapësirat shqiptare përfshin: mësimdhënien dhe të nxënit. Në pamje të parë ato mund të merren si një çështje, por në të vërtetë ato kanë specifikat e veta. Nëpërmjet trajtimit të një vështrimi historik do të përpiqemi të paraqesim të mësuarit në vite të gjuhës gjermane në Shqipëri, si dhe interesimin e albanologëve të ndryshëm gjermanofolës për gjuhën shqipe dhe studimet rreth saj, duke u ndalur në disa nga treguesit më kryesorë.

Fjalët çelës: gjuha gjermane, hapësirat shqiptare, albanolog, nxënie

Abstract

The historic development of German language learning in Albanian speaking territories includes both teaching and learning aspects. Eventhough they seem interchangeable integrated, they reflect their own specifications in the Albanian educational context. Through this historical overview we will try to present the history of the learning of German language in Albania, as well the interest of various German Albanologists for the Albanian language, focusing on some of the main findings of the linguistics studies.

Key words: German language, Albanian territories, albanologist, learning process

Hyrje

Marrëdhëniet e shqiptarëve me popujt evropianë dhe më gjerë janë të hershme. Ato kanë pasur karakter ekonomik, politik, shoqëror e kulturor. Këto marrëdhënie kanë bërë të domosdoshme njohjen nga të dyja palët e mjeteve të komunikimit, pra të gjuhës, si mjeti kryesor në realizimin e këtij komunikimi. Ka pasur edhe shqiptarë, që e kanë njohur, madje në mënyrë shumë serioze gjuhën gjermane, qoftë atë të folur apo të shkruar, të cilën e kanë shoqëruar edhe me botime në këtë fushë. Kjo dukuri është njohur që nga thellësitë e viteve, dekadave, madje edhe shekujve e deri në ditët tona, ku profesoret dhe profesorët shqiptarë mbajnë leksione në gjuhë të huaja, madje edhe në gjuhën gjermane, deri edhe në auditore universitetesh e në institucione gjermane, pa folur për punonjës të niveleve të ulta, të cilët, si të parët, e ushtrojnë këtë veprimtari brenda dhe jashtë hapësirave shqiptare, e deri në qendra të rëndësishme gjermane. Vendi që zenë gjuhët në shkollë është i lidhur me ardhmërinë gjuhësore të shoqërisë shqiptare, e cila gradualisht po shkon drejt vendit të saj në Komunitetin Europian, një komunitet shumëgjuhësh e shumëkulturash. Përfshirja e mësimdhënies së gjuhëve të huaja në shkollat në hapësirat shqiptare ka qenë dhe është e lidhur fort me faktorë jashtëgjuhësore, sidomos me faktorë politikë, ekonomikë etj, që i kanë shoqëruar shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre në ish-Jugosllavi, në Maqedoni por edhe brenda kufijve,

veçanërisht për disa dekada, duke u zbatuar një politikë e mbyllur, e cila përcaktonte objektivat e të mësuarit të këtyre gjuhëve, ku të lexuarit (të kuptuarit me shkrim) fitonte prioritet të padiskutueshëm.

Mësimi i gjuhës gjermane në hapësirat shqipfolëse

Të mësuarit e gjuhës së huaj, si në të kaluarën ashtu edhe sot, ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e kurrikulës së shkollave tona; për vetë marrëdhëniet tradicionale, të hershme e të reja, që kemi pasur dhe kemi aktualisht, aq më shumë për perspektivën, po zë vend gjithnjë e më të rëndësishëm. Jo pak herë është gabuar duke i përcaktuar shkollat dhe mësuesit, që kanë zhvilluar gjuhë të huaja, “shkolla e parë” këtu, “shkolla e parë” apo “mësuesi i parë” atje. Këto gabime janë bërë më dukshëm për shkollat në gjuhën tonë amtare duke ngatërruar karakterin e tyre, çka mund të ndihet edhe me dukshëm për shkolla të tjera, sidomos në aspektin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja.

Të mësuarit e gjuhës gjermane në hapësirat shqiptare nuk ka ecur në mënyrën e vet klasike, por ka patur specifikat e veta. Urat e para të ndërldhjes i kanë bërë personalitete të shkollës dhe arsimit tonë, të cilët së bashku me albanologë në Gjermani, Austri etj, kanë punuar për botimin e fjalorëve gjermanisht-shqip ose shqip-gjermanisht; këto vepra të para janë kthyer tashmë në rrugë ndërldhjeje dhe miqësie midis popujve. Në këtë kuadër ndeshim edhe individë të viseve të ndryshme shqiptare, që

kanë mësuar në mënyrë autodidakte gjuhën gjermane, si dhe gjuhë të tjera. Ata i ka ndihmuar edhe ndonjë kontakt që kanë pasur me të huaj. Sa i përket të mësuarit të gjuhës gjermane nga shqiptarët, të dhënat mund të çojnë në thellësi të shekujve, si për shqiptarët, ashtu edhe për gjermanët ndaj gjuhës sonë. Por intensiteti i kësaj veprimtarie ndihet më shumë në shekullin e kaluar dhe në shekullin që po mbyllim.

Dihet tashmë, që përhapja e gjuhës shqipe si në kushtet e pushtimit Osman dhe më vonë, është inkurajuar dhe mbështetur nga Perandoria Austro-Hungareze, sepse popujt jogjermane që ishin nën të si: çekët, sllovakët etj, kishin mundur të fitonin me kohë të drejtën e mësimdhënies në gjuhën amtare. Në Kushtetutën e vitit 1876 thuhet se: “Gjithë popujt e Imperatorisë kanë të njëjtat të drejta dhe secili prej tyre ka të drejtën e paprekshme për ruajtjen dhe zhvillimin e Komisionit të gjuhës së vet”. Prandaj, jo vetëm përpara, por edhe më vonë, në kushtet e pushtimit Austro-Hungarez nuk është treguar ndonjë zell i madh për të informuar përhapjen e gjermanishtes. Është kjo arsyeja që, ndryshe nga ndonjë gjuhë tjetër e përhapur në Shqipëri, për gjuhën gjermane nuk është treguar ndonjë nxitim apo tendencë për përhapjen e saj. Përveç të mësuarit individual nga studiues autodidaktë të ndryshëm, gjuha gjermane është mësuar në mënyrë të organizuar në Kolegjin Saverian në Shkodër në vitet 1877-1888, duke u zhvilluar si lëndë më vete. Kolegji Saverian u hap në vitin 1877 me kërkesën e qytetarëve katolike dhe me ndihmesën e tyre ekonomike. Shkolla Saveriane është e mbështetur në traditën europiane, ku u kushtohet kujdes gjuhëve të huaja, duke vlerësuar njëkohësisht edhe gjuhën amtare. Në një dëftesë shkollore të vitit 1908 (Kazazi, 1992, fq.96) lexojmë këto lëndë: katekizëm; italisht; frëngjisht; gjermanisht; shqip; turqisht; algjebër; arithmetikë; gjeometri; histori natyre; histori të përgjithshme; kaligrafi.

Më pas këtë gjuhë e shohim të zhvilluar si lëndë fakultative në gjimnazin e Manastirit, ku është zhvilluar veprimtaria e theksuar e Qiriazëve. Në projektin e Parashqevi Qiriazit për shkollën e mesme parashikohet në etapën e parë: përvetësimi i gjuhës me gramatikë, hartim dhe letërsi, gjeografi, matematikë, algjebër, gjeometri, gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) etj. Ndërsa në etapën e dytë, e cila përmbledh katër vitet e fundit të shkollës së mesme propozon: retorikë dhe hartim, letërsi dhe histori e filozofisë, gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht), gjuhë klasike (greqishte e vjetër ose latinisht), algjebër, gjeometri, trigonometri, fizikë, kimi etj.

Hulumtimet e albanologëve gjermanë dhe kontributi i tyre për gjuhën shqipe

Albanologët e shquar Gustav Maier, Maksimilian Lamberg dhe personaliteti i shquar Norbert Jokli (1887-1942) kishin njohuri të thella në gjuhësinë krahasuese indoeuropiane. Nobert Jokli ishte nga gjuhëtarët indoeuropianë, që ia kushtoi tërë jetën e tij studimit të gjuhës shqipe. Lëvroi fusha të ndryshme të gjuhësisë shqipe, në radhë të parë studimet etimologjike e fjalëformimin historik të saj. Për një çerek shekulli mbajti rubrikën e bibliografisë për gjuhën shqipe në organin vjetor ndërkombëtar “Indogermanisches Jahrbuch”. Studimet e tij kanë rëndësi jo vetëm për studiuesit tanë, por kanë zenë vend në gjuhësinë indoeuropiane dhe në veprat e përgjithshme kushtuar kësaj gjuhësie. Ai dhe albanologu tjetër i njohur Franc Bop e përcaktuan shqipen si gjuhë indoeuropiane. Gustav Majer shkruan fjalorin etimologjik por pati mendime, se ai ishte mbështetur më tepër në gjuhën e librave sesa në leksikonin e gojës së popullit (Kastrati, 1967, fq.10). Ndre Mjeda, që u formua si gjuhëtar nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Majerit dhe dëshironte të formonte në Shkodër një shkollë, ku të përdorej gramatika për të komunikuar më mirë me Veriun, i dërgon 12 letra albanologut Gustav Majer gjatë viteve 1892-1893. Atje del se Mjeda i ka njohur dhe i ka studiuar veprat e albanologut të madh, ndërmjet të tjerash edhe “Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe”, që u botua nga Majeri në Strasburg, në vitin 1891 dhe e vlerëson lart atë. Por Mjeda duke e ditur se Majeri nuk i shfrytëzoi mjaft botime të Shkodrës mundohet t’ia plotësojë bibliotekën duke i botuar disa botime, nëpërmjet të cilave Majeri mund të njihnte më mirë dialektin e Veriut, veçanërisht atë të Shkodrës. Shtypi i kohës trajton edhe probleme të mëdha si: “Shqipja dhe shqiptarët mbështetur në mendimet e Majerit” duke dhënë pamje të tezave kryesore për etnogjenezën, gjenezën e gjuhës shqipe dhe disa konkordanca të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera indoeuropiane, huazimet latine shqip etj.

Fusha e veprimit të Maksimilian Lambergit përfshinte sa gjuhësinë ashtu edhe gjuhësinë krahasuese, duke e krahasuar gjuhën shqipe si gjuhë indoeuropiane dhe duke bërë krahasime në fushën e emrave, numërorëve dhe të disa fojeve të gjuhës shqipe me disa gjuhë të tjera indoeuropiane. Nga ana tjetër ai trajton problemin e ilirëve: “Gjendja e sotme e çështjes së ilirëve” dhe paraqet në shtyp (Vajgand, 1918, fq. 30-32) edhe shënime bibliografike për albanologun G. Vajgand, profesor i filozofisë krahasuese në Universitetin e Lajpsigut.

Lidhur me gjuhën letrare shqipe, shkruhet se Vajgandi ka shfaqur mendimin se duhet të jetë në bazë të elbaskanishtes. Ndërsa “Lajmet e Komisionit Letraro” (Lamberc, 1918, nr. f.30-32) shkruajnë për një raport të M. Lambercit në mbledhjen e Komisionit Letraro të Shkodrës mbajtur mbi rezultatet e kërkimeve të tij në fushën e studimit të dialektit të Shqipërisë së Mesme.

Studiuesi ynë i njohur, profesor Kristaq Cipo, nën pseudonimin “Scampensis” shkruan për studime etimologjike të krahasuar me katër gjuhë të tjera, ku njëra prej tyre është gjermanishtja.

Holger Petersen boton një artikull në një të përkohshme gjermane, në të cilën analizon fletoret shqipe, që i daton me 1896, 1897, 1898. Gjithashtu Pedersenin parashtron pikpamjet e tij në lidhje me alfabetin e shqipes. Mes të tjerash ai shkruan, se nuk do të jetë e largët koha, që edhe shqiptarët të kenë një sistem të vetëm të alfabetit, duke qenë i bindur se alfabeti i zgjedhur nuk do të jetë as grek, as sllav, as arab, por latin (jo italian), duke shprehur edhe mendimet e veta për kapërcimin e disa vështirësive (Petersen, 1902, fq.202). Në vitin 1899 Dr. Holger Pedersen botoi në “Albania” një studim prej 60 faqesh me titull: “Grykoret në gjuhën shqipe” (Die Guturale im Albanischen). Ky studim u botua në revistën gjermane “Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiet der indogermanischen Sprachen”. Po për Pedersenin shkruan edhe Faik Konica në Albania, duke nënvizuar bibliografinë shqipe të viteve 1902-1903 duke shënuar 36 vepra, shënime, fletore të shtypura në shqip e gjuhë të huaja mbi Shqipërinë. I njëjti organ njofton se Pedersen kishte botuar në revistën gjermane “Romanischer Jahresbericht” bibliografinë shqipe për vitet 1899-1901.

Interesimet e studiuesve gjermanë për gjuhën shqipe rriten. Dr. Kurt Hassert, profesor i universitetit Tybingen në Vyrtemberg do të vizitojë koloninë shqiptare të Italisë për qëllime studimi të gjuhës, duke vazhduar kështu atë punë që e kishte filluar po në udhëtime të tilla 20 vjet më parë, për të plotësuar vizionet e tij të reja mbi një libër për shqiptarët.

Shtypi vazhdon të paraqesë materiale mbi veprimtarinë me albanologët shqiptarë, ku ata gjermanë marrin pjesë, duke u përfaqësuar. Botohen edhe shkrime mbi jetën e personaliteteve shqiptarë dhe gjermanë, si Nelko Kristoforidhi, Emile Legrand, Gustav Majer dhe Holger Pedersen (Albania, 1899, fq.152).

Gazeta “La Nazione Albanese” njoftonte më 30 nëntor 1905 se një princ perandorak i Gjermanisë ishte student për gjuhën shqipe.

Në vitin 1909 arrin në Shqipëri albanologu Dr. Gustav Vajgand, profesor i universitetit të Lajpsigut. Ai vjen për të mësuar sa më mirë gjuhën shqipe, siç kishte qenë në këtë vend edhe para 20 vjetëve, duke qëndruar në Korçë, Elbasan etj. Mësohet nga organi i shkollës teknike në Tiranë “Laboremus”, se Dr. Gustav Vajgandi i dërgoi nga Lajpsigu Bibliotekës Kombëtare në Tiranë disa libra, në mes të të cilave edhe dorëshkrimet e gjermanit Dr. C. Rajnhold mbi gjuhën e shqiptareve të Greqisë (1855-1858).

Ardhja e studentëve diplomantë nga Austria i dha një shtytje përpara të mësuarit të gjuhës gjermane. Me hapjen e gjimnazit të Shkodrës, në vitin 1922, gjuha gjermane zhvillohet si gjuhët e tjera të huaja të mëdha, duke u dhënë gradualisht nga mësuesit L. Shantoja, N. Bushati, S. Bushati, K. Ljarja etj. Diplomimi i disa të rinjve shqiptarë në shkollën Austriake, si në Normalen Oberhollabruni etj, si dhe emërimi i tyre si mësues në Ushtrimoren e Elbasanit i dha një përhapje të ndjeshme gjuhës gjermane në hapësirat shqiptare. Gjithashtu fëmijë të tjerë që kaluan në kolegje austriake, nga qyteti dhe fshati, mësuan gjuhën gjermane. Një fshatar nga fshati Lisen në rrethin e Shkodrës, Pal Lisna, fliste rrjedhshëm gjuhën gjermane, të cilën e kishte mësuar në kolegjin austriak në fëmijëri. Të tillë, ndonëse të rrallë, janë gjetur edhe në zona të tjera të hapësirave shqiptare. Rustem Dege Osmanaj, fshati Degë, Tropojë (vdekur në vitet ‘30) kishte mësuar në mënyrë autodidakte gjermanisht, serbisht dhe frëngjisht.

Botimet bibliografike kanë patur efikasitetin dhe rrezatimet e tyre në fushën e studimeve. Burimet e studiuesve gjermanë për problemet tona të gjuhës kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve shqiptarë. Kështu ishin p.sh.: “Linguistische-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen” shkruar nga Norbert Jokli, Berlin dhe Lajpsig, 1923, dhe “Dituria gjuhore indogjermane” nga Hofrat Dr. Paul Kremcer, përkthyer nga Karl Gurakuqi. I njëjti autor përktheu nga gjuha gjermane edhe “Dituria gjuhore indogjermane” të Dr. Karl Kremcer, profesor në universitetin e Vjenës.

Kurse dhe shkolla të gjuhës shqipe u hapën në shumë qendra europiane, në Amerikë, Argjentinë, Turqi etj. Katedra e gjuhës shqipe ose qendra albanologjike funksionuan në disa universitete dhe institute të larta të Europës, ku zotëronte gjuha gjermane, si në Lajpsig, Berlin, Vjenë etj.

Në periudhën gjatë Luftës së Parë Botërore në zonën e pushtimit austro-hungarez, për arsye të njohura politike, Mbretërisë Apostolike të Austrisë i

interesonte individualiteti i Kombit Shqiptar. Në të gjithë zonën e pushtimit austro-hungarez punonin me devotshmëri në fushën e arsimit dhe të shkollës shqipe Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Sali Nivica, Mati Logoreci etj. Prandaj mori hov edhe veprimtaria arsimore në gjuhën shqipe përfshirë një lloj përhapjeje edhe të gjuhës gjermane. Kuptohet, këtu ndikuan faktorë jashtëgjuhësorë, p.sh. aktet e rëndësishme në pikpamjet e organizimit të shkollës dhe të drejtimit të politikës arsimore dilnin me emër të Komandës së Lartë në formë shpalljesh, urdhërësash, rregulloresh të botuara në dy gjuhë: shqip e gjermanisht. Në një dokument shkollor (dëftesë) e vitit 1917, pas sjelljes, besimit, shkrimit, gramatikës dhe gjuhës amtare vinte dhe gjuha gjermane (AQSH, 1920, fq.668). Programi mësimor u bë në përshtatje me shkollat fillore të Monarkisë Austro-Hungareze, duke e përdorur gjuhën gjermane si gjuhë e dytë, përpos gjuhës amtare. Gjuha e huaj zhvillohej në klasën IV dhe të V. Atë kohë nuk bëhej fjalë për një sistem arsimor unik, por për hapje urgjente të shkollave në gjuhën amtare shqipe. Ndërsa në programet e klasës gatimore, gjuha gjermane ishte gjuhë e dytë pas asaj amtare.

Veprimtaria gjuhësore u ngrit në nivele të reja me botimin dhe hartimin e fjalorëve gjermanisht-shqip dhe u vazhdua puna për botimin e një fjalori tjetër dy-vëllimesh shqip-gjermanisht. Ndërsa qeveria shqiptare e asaj kohe e inkurajoi një veprimtari të tillë duke ndihmuar me një shumë të hollash (800 franga ari) baroneshën Godin për botimin e fjalorit të saj gjermanisht-shqip. Shtypi ynë i bën jehonë botimit të fjalorit shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip nga Marie Amelie Frerin (Hylli i Dritës, 1930, fq.690-691), për pjesën e parë të vëllimit të fjalorit gjermanisht-shqip, si ngjarje të rëndësishme gjuhësore, duke dhënë njoftime mbi përmbajtjen e tij, si dhe mbi autoren e fjalorit.

Qeveria shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Arsimit krijon një komision arsimor "Për gjuhën shkollore", në mes të vitit 1930, i cili me anë të një qarkoreje dërguar të gjitha shkollave të mesme dhe fillore në qytete, në të cilën jep porosi që secili arsimtar të paraqesë në Ministri një listë të plotë të termave shqipe për lëndët e ndryshme shkollore me përkthim në gjermanisht, italisht ose frëngjisht. Në fund thuhet, se kjo përmbledhje e termave do t'i shërbejë një komisioni pranë ministrisë për të vendosur një gjuhë (terminologji) të përgjithshme për të gjitha shkollat.

Shtypi trajtoi bashkë me një përmbledhje mbi përhapjen e vendbanimeve të shqiptarëve brenda e jashtë ishujve gjuhësorë, edhe një njoftim mbi përdorimin e termave indoeuropiane, siç trajtoi mes të tjerash edhe "Dituria gjuhësore indogjermane"

nga Hofrat Dr.Paul Krecmer. Ky libër prej 77 faqesh është botuar në Kostancë (Rumani) dhe në Shtypshkronjën "Shqipëria e Re" në Tiranë.

Gjuha shqipe vazhdoi të tërheqë vëmendjen e mjaft studiuesve seriozë në vende të ndryshme, përfshirë edhe personalitete gjermane dhe austriake, të cilët e bënë objekt të veprimtarisë së tyre në katedrat e gjuhës shqipe, ku Lajpcigu zë vendin e vet. Këtë problem e trajton Mithat Frashëri në organin "Dituria" në Tiranë, në marsin e vitit 1927, duke përcaktuar disa nga qendrat më në zë në këtë fushë. Bashkëpunimi dhe marrdhëniet profesionale mes studiuesve tanë dhe atyre gjermanë forcohen. Kjo e bën të nevojshme dhe shkëmbimin e përvojës dhe ndihmën e tyre në organizma të veçantë studimorë, siç bëri Aleksandër Xhuvani në vitin 1928, i cili për riorganizimin dhe ringritjen e Koisisë Letrare pas asaj të Shkodrës, propozon edhe dietarin N. Jokli, G. Vajgandi ose ndonjë tjetër, madje edhe për në kryesi të Koisisë.

Interesimet shkencore shkojnë edhe më tej. Lëvrimi i gjuhës shqipe arrin edhe në gjuhë të mëdha, përfshirë edhe lëvrimin e gjuhës shqipe ndër gjermanofolësit. Madje në Vjenë themelohet shoqëria "Austriako-Shqiptare" me kryetar Dr.Fridrih Valish e nënkryetar Dr.Gjergj Pekmezini. Në programin e kësaj shoqërie përfshihej edhe punimi i gjuhës shqipe. Marrdhëniet e ngrohta dhe shumë miqësore të studiuesve tanë me albanologë gjermanë, nuk e penguan asnjëherë palë për të zhvilluar debatin, argumentin shkencor për çështje të caktuara, jo vetëm në korrespondencat e tyre miqësore, në takimet e punës, por edhe në shtyp, duke tërhequr edhe vëmendjen e opinionit shkencor për këto probleme. Kështu p.sh. Mati Logoreci, studiues i apasionuar ndaj problemeve gjuhësore, historike dhe didaktike, i njohur edhe si polemist me kolegë e miq të tij, si A. Xhuvani, N. Mjeda etj, polemizojnë me albanologun e shquar gjerman G. Majer për një çështje të caktuar. Në shkrimin e tij "Gustav Majeri, i madhi albanolog e gjuha shqipe" të botuar në Illyria, në mars të 1934, vë në dyshim tezën e Majerit, se fjala "shqip" rrjedh nga latinishtja "exipere". Një muaj më pas, në një artikull tjetër tek "Çështje gjuhësore", botuar në të njëjtin organ shkruan se, në kundërshtim me tezën e G. Majerit, sipas së cilës prejardhja e fjalës "shqyp" vjen nga "shqiptoj" (exipere) autori prejardhjen e kësaj fjale e shpjegon ndryshe.

Edhe studjues shqiptarë hulumtojnë dhe thellohen në fushat e tyre dhe disa botojnë edhe në gjermanisht. I tillë ishte edhe albanologu i njohur shqiptar Egerem Çabej, i cili para mëse 60 vjetësh botoi disa studime të vetat në gjermanisht. Gjuha shqipe tërheq vëmendjen e institucioneve të

rëndësishme. Studimet ballkanike, ku zë vend edhe shqipja, tërheqin vëmendjen e universitetit të Lajpcigut, për ngritje institutesh të posatshme pranë atij universiteti.

Në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, me pushtimin e Austrisë nga Ushtria naziste dhe ndjekjen e hebrenjve, një nga të cilët ishte dhe albanologu më i shquar prof. N. Jokli, intelektualët shqiptarë propozuan ta ftojnë Joklin në Shqipëri dhe ta emërojnë në krye të Institutit albanologjik (Përpyekja Shqiptare, 1938, fq.226-227), mendim që u publikua në organin "Përpyekja Shqiptare". Një propozim të tillë e mbështeti edhe gazeta e Korçës dhe burime të tjera intelektuale dhe shoqërore. Zhvillimi i mësimdhënies së gjuhës gjermane u ngrit në një nivel më të lartë në vitet e Luftës së II Botërore në të gjitha hapësirat shqiptare. Padyshim edhe në këtë rast kanë ndikuar përsëri faktorë jogjuhësorë. Madje, në disa shkolla të mesme dhe fillore filloi të zhvillohej në mënyrë të programuar, përveç iniciativave vetiake në kurse private të posaçme. Në vitet e luftës, në shkollë mësohej kryesisht si gjuhë e huaj gjuha italiane dhe gjermane. Por mungesa e kuadrit të specializuar ndihej dukshëm. Siç del nga raporti i Drejtorisë së shkollës Normale "Sami Frashëri" në Prishtinë, ndihej nevoja për mësues të gjermanishtes dhe italishtes (Rexhepagiq, Vokri, Veseli, 1997, fq. 118). Në atë shkollë e zhvillonte lëndën e gjuhës gjermane drejtori i shkollës Rexhep Krasniqi. Mungesa e përgjithshme e kuadrit për Shkollën e mesme Normale përfshinte edhe lëndën e gjuhës gjermane. Nga mungesa e kuadrit mësues, në fillim të vitit 1942-1943 kishin mbatjur pa u zëvendësuar: vizatimi, gjermanishtja, italishtja, matematika, fizika etj. Më vonë, në këtë shkollë ngarkohet për të zhvilluar gjuhën gjermane, drejtori i Normales Reuf Zajmi. Me largimin e Rexhep Krasniqit nga Prishtina, më 18.02.1943 ngarkohet Adem Selimi për të zhvilluar mësimdhënien e gjuhës gjermane. Ademi ishte inxhinier, por përballon ngarkesën e mësuesit të kësaj gjuhe për klasat e VII, VIII (dega liceale me 6 orë, krahas orëve të tjera të shqipes dhe italishtes).

Vëmendja, dashuria, mirënjohja e studjuesve dhe në tërësi e intelektualëve shqiptarë për albanologët e huaj, e sidomos ata gjermanë, ka qenë e theksuar. Kjo vihet re në artikujt e ceremonitë e ngrohta e serioze të organizuara nga ana e tyre me raste përvjetoresh, kushtuar atyre personaliteteve, në shkrime në organe shqipe brenda e jashtë hapësirave shqiptare. Studjuesi i njohur Namik Resuli, duke paraqitur një vështrim të përgjithshëm të gjuhës letrare shqipe nga studiuves vendas dhe të huaj, nga gjysma e dytë e shek. XIX e deri në vitet '40, ndalet veçanërisht në mendimet dhe gjykimet e

shprehura nga G. Hahni, Dh. Kamarda, G. Majeri, G. Vajgandi, R. Nahtigali, G. Petrola, F. Konica, L. Skëndo, Gj. Pekmezi etj duke shprehur edhe qëndrimin e tij mbi këta autorë (Resuli, 1940, fq. 17-32).

Shtypi shkencor gjerman ka vazhduar të trajtojë probleme të gjuhës sonë shqipe, në fusha komplekse, shpeshherë edhe të diskutueshme e me alternativa. Kështu studjuesi J.Shmec shkroi në të përkohshmen "Zeitschrift für Namenforschung", B.XIV, Heft 3, Berlin 1938, duke bërë klasifikimin e gjuhëve indoeuropiane në grupet e gjuhëve "satem" (ku bën pjesë edhe shqipja) dhe "kentum", duke e shtruar problemin që në titull: "A kje ilirishtja një gjuhë kentum apo një gjuhë satem?". Sipas mendimit të tij ilirishtja i përket gjuhëve të grupit kentum (Hylli i Drites, 1940, fq. 216-219).

Në vitin 1943 i bëhet jehonë albanologut Johan Georg Von Hahn mbi "Studimet shqiptare" (Albanische Studien)(1853). Jepet një pasqyrë e përmbajtjes së tre vëllimeve të kësaj vepre. Ndër të tjera shënohen edhe këta kapituj: në vëll.I, kap.IV (fq.211-226) trajtohet tema: "Sind die Albaner autochthon?" (A janë shqiptarët autoktonë), në kap.V (fq. 280-300) flitet për alfabetin shqip; në vëll.II (fq. 1-120) trajtohet një gramatikë shqipe dhe disa poezi popullore të Shqipërisë së Jugut e të Veriut. (fq. 123-163); vëll III përmban një fjalor shqip-gjermanisht (fq.1-149) dhe një fjalor gjermanisht-shqip (fq. 150-341).

Për personalitetin e shquar prof. Norbert Joklin janë botuar dhjetëra shkrime nga studiuvesit tanë më seriozë e kompetentë. Kështu me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Tij, më 1927, u botuan artikuj nga prof. Eqerem Çabej në organin "Drita", "Shqipëria e Re" me titull: "Norbert Jokli - albanologu i madh".

Edhe vetë studiuvesit e huaj kanë dhënë ndihmesën e tyre për njohjen e veprave të Norbert Joklit si albanolog. Hernaun Olberg jep treguesin e shkrimeve të Joklit "Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl", Innsbruck 1977, fq. 67-74. Po ky autor boton edhe mendimet e tij mbi autonominë shqiptare.

Përfshirja e kurrikulës së gjuhës gjermane në shkollat shqiptare

Gjuha gjermane, siç e kemi parë edhe më sipër, bëhet pjesë e programit mësues që në shekullin e kaluar, por në periudhën e pushtimit, gjatë Luftës së parë dhe të dytë Botërore u shtri mjaft, sidomos në shkollat e mesme dhe në publikun e gjerë. Në këtë kohë, gjatë Luftës së dytë Botërore, qarkullonin edhe fjalorë-xhepi për orientimin në gjuhën gjermane, si fjalori: "100 fjalë gjermane" etj.

Pas Çlirimit të vendit, nisur nga motive të ngushta politike, u bë një ndërprerje e mësimdhënies së disa gjuhëve të huaja, si anglisht, gjermanisht, frëngjisht etj, duke dominuar në dy-tre vitet e para gjuha jugosllave (serbo-kroate) dhe pas prishjes së marrdhënieve me Jugosllavinë doli në plan të parë gjuha ruse. Më vonë, sidomos pas viteve '60, u hapën shkolla të mesme të gjuhëve të huaja dhe kurse të ndryshme të gjuhëve të huaja, duke filluar mësimi i gjuhës angleze, franceze dhe vite më vonë i gjuhës italiane dhe gjermane. Në Shkodër kishte filluar mësimi i gjuhës gjermane pas viteve '60 në shkollën e mesme "Xheladin Fishta" dhe më pas edhe në ndonjë tjetër. Mësues i gjuhës gjermane ishte Karlo Ljarja, i cili kishte studjuar në një Shkollë Normale në Austri.

Aktualisht në Tiranë ka vite që funksionon dega e gjuhës gjermane në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja, nga dalin diplomantët e kësaj fushe, duke u dërguar kontigjente më të përgatitura në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, ku funksionon Katedra e Gjuhës Gjermane. Një katedër e tillë është ngritur edhe në qytetin e Elbasanit dhe të Shkodrës, e paraprirë nga mësimdhënia e gjermanishtes në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja në këto qytete. Tani shkollat e mesme të gjuhëve të huaja me degë të gjermanishtes ka edhe në Elbasan, Shkodër, si dhe ka projekte për shtrirjen e tyre në Korçë e Vlorë.

Në Universitetin e Tiranës u bënë vite që diplomohen studentët e gjuhës gjermane, disa prej të cilëve kanë shkuar për studime në Gjermani, Austri etj.

Në Universitetin e Prishtinës funksionon Katedra e Gjuhës Gjermane dhe interesimi për këtë gjuhë është i lartë. Kjo është shoqëruar edhe me kurse gjuhe dhe klasa të veçanta në shkollat e mesme, ku mësohet gjuha gjermane. Ky interesim i lartë është nxitur edhe nga emigrimi i madh i shqiptarëve nga Kosova në vise të ndryshme të Gjermanisë, në Zvicër etj.

Në Universitetin e Tetovës, është ngritur gjithashtu që në themelimin e tij edhe Katedra e Gjuhës Gjermane, ku bën jetën shkencore dhe pedagogjike edhe Rektori i atij Universiteti, prof.dr. Fadil Sulejmani, i cili për studentët e asaj dege ka botuar librat "Phonetik der deutschen Sprache" (Fonetika e gjuhës gjermane) dhe "Morphologie der deutschen Sprache" (Morfologjia e gjuhës gjermane), Tetove 1995.

Pranë Fakulteteve të gjuhëve të huaja, sidomos në Tiranë është ngritur një bibliotekë e pasur me literaturë gjermane nga të gjitha fushat. Kohët e fundit, me ndryshimet që u bënë në legjislativin shtetëror u hapën edhe shkolla private, në disa prej

të cilave në Tiranë, Elbasan dhe Shkodër mësohet gjuha gjermane. Në këto shkolla duken disa përparësi të arsimit privat në drejtim të sigurimit të bazës materiale, të kuadrit arsimor, i literaturës së nevojshme etj.

Në fushën e letërsisë janë përkthyer shumë autorë gjermanë të traditës, klasike dhe bashkëkohore, por shfrytëzimi i literaturës në origjinal është shumë simbolik.

Botime të autorëve shqiptarë në gjuhën gjermane

Si rrjedhojë e komunikimit më të lirë e më të dendur sidomos të rritjes së emigracionit në dekadën e fundit të transformimeve demokratike e në një farë mase edhe të bashkëpunimit ekonomik e kulturor midis dy vendeve ka lindur nevoja për metoda të të mësuarit të gjuhës gjermane, për fjalorë të ndryshëm, ku edhe kanë filluar të bëhen disa përpjekje të kënaqshme. Metoda të të mësuarit të gjuhës gjermane pa mësues me perkthim në gjuhën shqipe, ndonëse janë shumë të rralla, kanë depërtuar në hapësirat shqiptare. Është botuar "Metodë për mësimin e gjermanishtes" në vitin 1996, të autorëve Isuf dhe Monika Kalo. Në vitin 1997 është botuar "Gjermanishtja për të gjithë" me autorë Lola Qirici e Alfred Sejdiu. Në vitin 1998 u botua fjalori frazeologjik gjermanisht-shqip, me përmbledhje frazeologjizmesh të autorit Skender Doku. Një fjalor gjermanisht-shqip është botuar vite më parë nga Zef Simoni. Prof. Ali Dhrimo dhe prof. Hamlet Bezhani botuan në Gjermani fjalorin voluminoz me mbi 82000 fjalë gjermanisht-shqip, një vepër e rrallë dhe shumë cilesore. Ndërsa në vitin 1998 prof. Ali Dhrimo botoi me shtëpinë botuese "Toena" në Tiranë, fjalorin gjermanisht-shqip me rreth 45000 fjalë, i cili u pasua më vonë nga fjalori tjetër gjermanisht-shqip. Këto vepra kanë ndihmuar në ngritjen e një ure tjetër miqësie me popullin e Hajnes, Shilerit, Gëtes. Kjo është një ndihmesë me vlera në pasurimin e mëtejshëm të teknologjisë mësimore për mësimdhënien e gjuhës gjermane në mbarë hapësirat shqiptare.

Përfundime

Qëllimi i këtij kërkimi diakronik është në radhë të parë që t'i bëjmë me dije lexuesit se zanafilla e të nxënit të gjuhës gjermane në trojet shqiptare shtrihet shumë mbrapa në kohë. Marrëdhëniet kulturore, ekonomike por edhe shoqërore midis popujve në Evropë kanë pasur ndikimin e tyre të pamohueshëm në përhapjen e gjuhës dhe kulturës gjermane në trojet shqipfolëse. Në punim shihet qartë edhe kontributi i madh që kanë dhënë albanologët gjermanë në periudha të ndryshme kohore për këkrimet gjuhësore në gjuhën shqipe. Sigurisht që nuk pretendojmë që të kemi trajtuar

shterrueshëm të gjitha çështjet që lidhen me këtë temë. Ky është vetëm një hap i parë në këtë drejtim dhe një nxitje për kërkuesit e tjerë, në mënyrë që ata të japin kontributin e tyre për zbardhjen sa më të plotë të këtyre marrëdhënieve historike midis

popujve, marrëdhënie të cilat reflektohen edhe në ditët e sotme, në përpjekjet e përbashkëta për konsolidimin dhe zgjerimin e Europës së Bashkuar, jo vetëm si një bashkësi politike, por edhe si një bashkësi kulturash, popujsh dhe traditash.

BIBLIOGRAFI

AQSH, D3, M 1-2, 1920

Daka. Palok (1883-1944), "Kontribut për bibliografinë e gjuhës shqipe"

Drita, Gjirokastër, 6 janar 1924

Gazeta Ilyria, 1934

Gazeta e Korçës, Korçë, 17 qershor 1930

Hylli i Dritës, Shkodër, 1930, viti II, nr.XII

Hylli i Dritës, Shkoder 1940, nr. 5-6

Kastrati Jup (1967), "Dymbëdhjetë letra të Ndre Mjedes", Arsimi Popullor, I

Kazazi. Njazi (1992), Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër

Kushtetuta turke, 1976

Lamerc. Maksimilian (1917): "Die albanische Sprache" (Posta e Shqypnisë, Shkodër, II Kallnuer)

Përpjekja Shqiptare, Tiranë, prill 1938, nr.16

Qarkore e Ministrisë së Arsimit, 1930

Shkolla, kultura, demokracia (2000), Elbasan 1998

Resuli. N., Shkëndija, tetor 1940, nr. 4

Rexhepagiq. Jashar, Vokri. Abdulla, Abdylhaziz. Veseli; `Shkolla Normale "Sami Frashëri", Prishtinë, 1941-1944`, Prishtinë 1997, fq. 118

Shpresa e atdheut (1922), Romë, nr.I,

Vajgand. Gustav (1918), "Posta e Shqypnis", Shkodër, nr.I

Vullneti i popullit, 25 prill 1930

Zëri i Korçës, 21 janar 1930, viti II, nr. 468

VLERËSIMI I SISTEMIT ARSIMOR DHE MONITORIMI I STANDARDEVE ARSIMORE

IRENA KALLCO

FAKULTETI I BUJQËSISË

UNIVERSITETI FAN.S.NOLI KORÇË.

EVA PJETRI

DREJTORE, SHKOLLA E MESME E PËRGJITHSHME POGRADEC.

Përmbledhje

Objekti i studimit ka të bëjë me monitorimin e standardeve arsimore, me çështjet konceptuale të monitorimit të standardeve, si dhe procedurat e realizimit të monitorimit të këtyre standardeve.

Synimi i këtij studimi konsiston në një qëllim shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me: sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit të mësimeve për domosdoshmërinë e monitorimit të standardeve arsimore. Gjithashtu synon të tregojë përvojën e sotme në monitorimin e standardeve arsimore, të paraqesë vizionin për implementimin e monitorimit të standardeve arsimore në nivel kombëtar. Për këtë studim është shfrytëzuar përvoja teorike dhe praktike bashkëkohore e monitorimit të standardeve në vende të ndryshme si dhe materialet e standardeve të përmbajtjes së disa lëndëve mësimore.

Konstatohet se çështjet konceptuale të monitorimit të standardeve arsimore dhe vlerësimi i saj është një fushë në zhvillim. Teoria dhe praktika ende nuk janë njehsuar, për t'u përdorur në të njëjtën formë nga të gjithë. Megjithatë po ecet drejt një marrëveshjeje në mënyrë që të mos krijohen pështjellime nga e cila vuan gjithë shoqëria.

Fjalë kyç: *monitorim, standarte, vlerësim, zhvillim arsimor, shanse të barabarta në arsim.*

Abstract

The object of this study has to do with monitoring of educational standards, conceptual issues of standards monitoring, and procedures for monitoring the implementation of these standards. The aim of this study consists in raising the awareness and conscience of teachers about the necessity of monitoring the educational standards. It also aims to indicate today's experience in monitoring the educational standards, to present a vision for the implementation of monitoring of educational standards at the national level. In this study it is used the contemporary theoretical and practical experience of standards monitoring in different countries as well as materials from several subject curricula.

As a conclusion the conceptual issues of monitoring educational standards and its assessment is a developing issue. Theory and practice are not yet estimated, to be used in the same way by all. However we are progressing towards an agreement in order not to create problems from which the whole society suffers.

Key words: *monitoring, standarts, evaluation, educational development, equal opportunities in education.*

Monitorimi i standardeve mesimore

Do ndaleshim në përkufizimin operacional të disa koncepteve kryesore që përdoren në këtë shkrim. Çfarë do të kuptojmë me monitorim?

Në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës monitorim do të thotë vëzhgim i vazhdueshëm për diçka, regjistrim ose testim, ndjekje me vëmendje e me kujdes të një pune, të një veprimtarie duke ndjekur se si kryhet diçka, si impementohet diçka e re në këndvështrimin e specialistit.

Monitorimi në arsim i referohet zakonisht një procedure sistematike dhe të rregullt për të mbledhur të dhëna rreth aspekteve të rëndësishme arsimore në nivel institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar. Një veprimtari monitoruese përfshin zakonisht grumbullimin e të dhënave për vlerësim. Monitorimi kryhet nëpërmjet një sistemi marrëveshjeje.

Ekzistojnë kuptime të ndryshme për monitorimin:

1. Sipas një drejtimi, thelbi i monitorimit është vlerësimi i rregullt i arritjeve të nxënësve në një

lëndë të caktuar ose i aftësive të quajtura të rëndësishme. Studimet kombëtare në SHBA në kuadrin e NAEP-it (National Assessment of Achievement programe) i përbahen këtij kuptimi. Ka një sistem të ngjashëm në Irlandë, ku studiuuesit punojnë për zhvillimin e një programi monitorimi.

2. Sipas një drejtimi tjetër monitorimi i arritjeve të nxënësve ka një funksion diagnostikues. Në Holandë është ndërtuar një sistem i vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e tetë vlerësohen në bazë të testeve të standardizuara një herë ose dy herë në vit, dhe rezultatet e tyre interpretohen me synimin për të ndikuar në planifikimin dhe të nxënësve individual të nxënësve.

3. Drejtimi i tretë për interpretimin e monitorimit është ai që quhet studimi i treguesve. Interpretimi i frytshmërisë së një sistemi arsimor është gjithashtu i mundshëm nëpërmjet monitorimit dhe analizës që mbështetet në bazën e të dhënave të mara nga monitorimi i vazhdueshëm i implementimit të një projekti të ri..

Po ç'është standardi në vetvehte?

Standardi është një qëllim objektiv, ose një kriter arsimor i shprehur numerikisht si një mesatare statistikore ose filozofikisht si një ideal i përsosmërisë, sipas të cilit gjykohe dhe vlerësohen gjërat. Pra themi se standardet janë një mjet që përdoren për të gjykuar cilësinë e programeve, cilësitë e testeve, cilësinë e përparimit të nxënësve, arritjet e nxënësve, arritjet e mësuesve, dhe arritjet e shkollave. Në këtë kontekst ekzistojnë një shumëllojshmëri standarde që janë:

- *Standardet per programet dhe për tekstet mësimore.* Në këtë pikë përfshihen kriteret shkencore, psikologjike, pedagogjike, mbi bazën e të cilave hartohen programet dhe tekstet mësimore.

- *Standardet për nxënësit* janë kritere që përcaktojnë se ç'duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit. Ato përcaktojnë nivelin e arritjeve që priten nga ata. Pra standardet e nxënësit përfshijnë standardet e përmbajtjes dhe standardet e arritjeve.

- a. *Standardet e përmbajtjes* përcaktojnë se ç'duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë nxënësi, në një lëndë të caktuar psh. kimi, biologji, matematikë etj.

- b. *Standardet e arritjeve* përcaktojnë nivelin e përmbushjes së standardeve të përmbajtjes nga nxënësit. Ato mund të përdoren për të vlerësuar përparimin e nxënësit ose arritjet e tij në lidhje me standardet e caktuar të përmbajtjes.

- *Standardet për mësuesit ose kompetencat e mësuesit.* Janë kriteret që përcaktojnë cilësitë që duhet të zotërojë mësuesi në mënyrë që t'i ndihmojë nxënësit që të arrijnë standardet e përmbajtjes dhe të arritjeve. Këto standarde përfshijnë nivelin e mjaftueshëm të përgatitjes akademike për lëndën përkatëse, aftësitë e nevojshme pedagogjike, për të zhvilluar lëndën përkatëse mësimore dhe cilësitë e profesionit.

- *Standardet për shkollat.* Këto standarde synojnë të garantojnë sigurimin e një mjedisi mësimor të tillë që t'u krijojë mundësi për të mësuar të gjithë nxënësve.

- *Standardet për institucionet dhe agjencitë arsimore kombëtare dhe lokale* janë kriteret për gjykimin e suksesit të këtyre organizmave.

Lind pyetja ? Pse duhet të vendosen standardet e cilësisë për programet dhe tekstet, për nxënësit, dhe mësuesit, për shkollat, për agjencitë kombëtare dhe lokale ?

Standardet vendosen sepse besohet që nëpërmjet tyre motivohen më mirë nxënësit, mësuesit, shkollat. Nëpërmjet monitorimit këqyret nëse standardet janë shumë të larta, shumë të ulëta apo të përshtatshme.

Nëse ato janë shumë të ulëta, ato nuk do të kenë efektin e duhur për të përmirësuar motivimin. Nëse standardet janë më të larta, nxënësve, mësuesve, shkollave do tu duhet më tepër kohë dhe mbështetje për t'i përmbushur ato. Monitorimi është i lidhur ngushtë me *vlerësimin* dhe *inspektimin*. Shpesh këto terma përdoren në vend të njëri tjetrit por ata nuk kanë të njëjtën përmbajtje.

Vlerësimi. Megjithëse monitorimi dhe vlerësimi janë të lidhur dukshëm, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet tyre. **Monitorimi** përfshin krijimin sistematik të evidencës për përmbushjen e standardeve arsimore. **Vlerësimi** nënkupton vendosjen e vlerave nëpërmjet gjyimit të të dhënave të mbledhura nga monitorimi.

Inspektimi është ekzaminimi zyrtar i kryer për një apo disa aspekte të veprimtarisë së shkollës, zakonisht për qëllime të njohjes së gjendjes me synim përmirësimi dhe klasifikimi.

Nevoja e monitorimit të standardeve

Ekzistojnë një sërë arsyesh që e nxjerrin në rend të ditës monitorimin e standardeve arsimore. Presioni social dhe politik për shkollimin vazhdon të rritet. Ai nuk ka qenë ndonjëherë më kërkues, më i shumëllojshëm, më konfliktual se sa sot. Kërkohe përgjegjësi në të gjitha nivelet: institucional, lokal, kombëtar, madje edhe ndërkombëtar. Prirja për decentralizimin po e përqendron vëmendjen në përgjegjësinë lokale.

Monitorimi mund të ndryshojë nga një sistem arsimor në një tjetër, në vartësi të faktorëve të tillë si: pjekuria e sistemit, kushtet financiare, cilësia e përgatitjes së mësuesve, kënaqja e komunitetit me rezultatet e arritura, përcaktimi i problemeve dhe tradita në këtë fushë.

Sipas *Livingstone* në vendet pak të zhvilluara ekzistojnë një sërë çështjesh që lidhen me monitorimin e standartve si:

- *Ekziston një nevojë* e shprehur për të pasur informacion themelor për nivelet e arritjeve, përkundrejt të cilave do të matet efektshmëria e planeve kombëtare të zhvillimit në të ardhmen.

- *Ekziston një dëshirë* për të përmirësuar kurrikulat shkollore dhe kjo kërkon të dhëna për arritjet në mënyrë që hartuesit e kurrikulës të mund të parashikojnë me saktësi se ç'duhet të mësojnë nxënësit.

- *Presioni për të krijuar shanse të barabarta në arsim* i ka bërë autoritetet qendrore të arsimit të interesuara për njohjen e niveleve, të arritura në rajone të ndryshme të vendit, për ndryshimet sipas zonave (urbane- rurale), sipas përkatësisë etnike me qëllim për të bërë një shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore dhe financiare.

• *Nevojitet një informacion tërësor për efektet e arritjeve* me qëllim që të futet një politikë e re gjuhësore në sistemin shkollor.

Në vendet e zhvilluara paraqiten arsye të tjera për përdorimin e procedurave të monitorimit.

a. Në vendet ku sistemi arsimor është i decentralizuar, autoritetet arsimore ndeshin në kërkesën për përgjegjësi të shprehur nga ata që e mbështesin sistemin nëpërmjet taksave. Kjo është më tipike në periudha të vështirësive ekonomike. Për të dëshmuar përgjegjësinë kryhet monitorimi i cili siguron të dhëna për lëndët bazë dhe veçanërisht matematikë, gjuhë, lexim. Meqenëse një pjesë e mirë e buxhetit shkon për arsimin parapëlqehet që monitorimin e standardeve të mos e bëjë shteti, por ta kryejnë agjenci të pavarura.

b. Në vendet e zhvilluara kërkesa për përgjegjësi në lëndët bazë është përmbushur

nëpërmjet provimeve të kryera nga jashtë dhe nëpërmjet inspektimit të rregullt nga dikasteret e arsimit. Këto forma janë në procesin e ndryshimit në shumë vende. Lloje të ndryshme të vlerësimit të brendshëm janë përdorur për arsye diplomimi dhe roli i inspektorit po shndërrohet në rolin e këshilluesit për rritjen e profesionalizmit. Por kjo e detyron publikun të paraqesë kërkesën për gjetjen e mënyrave më objektive të matjes së rezultateve të sistemit shkollor. Reformat e ndryshme të kurrikulave, siç ndodhi në shumë vende në vitet 60, kërkuan një evidencë më të plotë dhe më të përshtatshme për të mbështetur dhe për të drejtuar ndryshimet. Në këtë kuadër u kërkuar një vlerësim i gjerë në bazë vendi, meqenëse reforma e kurrikulave pritet të jetë e centralizuar. Në vendet me një kurrikulum kombëtar të arsimit të hartuar nga autoritete qendrore, ekziston një nevojë për të njohur se sa mirë i plotëson sistemi arsimor qëllimet dhe standardet. Autoritetet kombëtare, lokale, drejtuesit e shkollave, mësuesit, duhet t'u përgjigjen publikut dhe përdoruesve të shërbimeve arsimore për rezultatet që kanë arritur.

c. Në vendet e zhvilluara egziston prirja për të monitoruar standardet e kurrikulumit dhe po

vihet theksi që të monitorohen programet e hartuara nga autoritetet arsimore, kurrikulumi i zbatuar nga mësuesit dhe kurrikulumi i realizuar, *dëshmuar nga arritjet e nxënësve.*

d. Problemet e shkaktuara nga emigrimi janë një arsye tjetër në favor të monitorimit kombëtar.

Monitorimi i standardeve në shqipëri

Monitorimi i standardeve të cilësisë në Shqipëri diktohet nga këto arsye:

I. *Shqipëria ndodhet në fazën e marrjes së vendimeve të rëndësishme për zhvillim arsimor.*

Është ndërmarrë një reformë arsimore, e cila ka nevojë për informacion për të përcaktuar saktë drejtimit e zhvillimit të ardhshëm të sistemit arsimor. Lëvizjet e popullsisë kanë krijuar zona të reja banimi me probleme të shumta arsimore e cila kërkon që të përcaktohen strategjitë e zhvillimit të arsimit në këto zona. Këtu le për të dëshiruar mungesa e hapjes së shkollave të reja konform rritjes së popullsisë .

Ka filluar të ndryshojë mënyra e marrjes së vendimeve , duke i lënë më tepër vënd arsyetimit dhe argumentimit shkencor

II. *Arsimi shqiptar po kalon një fazë ndryshimesh*

Ka pasur ndryshime kurrikulumi shkollor, janë ndryshuar programet mësimore, ka filluar të përmirësohet metodologjia e mësimdhënies, janë futur teknologji të reja në shkollë, por nuk njihet se si kanë ndikuar këto në arritjet e nxënësve.

Shoqëria, prindërit, donatorët e arsimit janë të interesuar të dinë se cila është cilësia e formimit të nxënësve në këtë periudhë tranzicioni

Janë hartuar standardet për disa lëndë mësimore me synim për t'i vënë në përdorim. Lindin kërkesa për të matur ndikimin dhe vlefshmërinë e tyre në arritjet e nxënësve.

Vendosja e sistemit të monitorimit të standardeve diktohet edhe nga kërkesa e fortë për të ndryshuar sistemin e vlerësimit të nxënësit i shoqëruar me një sërë dukurish negative për shoqërinë, nxënësit, mësuesin dhe shkollën.

III. Integrimi i Shqipërisë në botën e zhvilluar

Integrimi kërkon plotësimin e standardeve të caktuara. Krijimi i një sistemi standardesh kombëtare dhe monitorimi i tyre do të ishte një hap që do të mundësonte njohjen e nivelit të arsimit shqiptar, për ta krahasuar me arsimin e vendeve të tjera, dhe për ta zhvilluar atë më tej sipas kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare.

Monitorimi i standardeve mund të bëhet për qëllime të vlerësimit formues të efektshmërisë së mësimdhënies dhe të të nxënësit për qëllime diagnostikimi si dhe për qëllime të vlerësimit përmbledhës, të përparimit dhe të arritjeve të nxënësit e studentit. Një arsye e rëndësishme për monitorimin e standardeve është dallimi i prirjeve në arsim.

Nga të gjitha llojet e standardeve të përmendura më lart në shumë vende monitorimi i standardeve të arritjeve dhe i standardeve për shkollat është aplikuar më tepër duke shkuar drejt konsolidimit.

Monitorimi i standardeve të arritjeve akademike të nxënësve siguron informacion të

vlefshëm për politikanët, hartuesit e politikës arsimore dhe për publikun.

Cilat janë procedurat e monitorimit të standardeve

Monitorimi është një proces që ka nisur të përdoret gjerësisht, në formën që paraqitet sot, gjatë viteve 70-të të shekullit të kaluar në vendet e zhvilluara.

Në SH.B.A që nga viti 1969 përdoret programi kombëtar. N.A.E.P (National Assessment of Educational Progresi) për vlerësimin e arritjeve të nxënësve që nga vitet 1983 monitorohen nga një program i ngjashëm me ata të SHBA-së dhe **në Skoci** ku A.A.P (Assessment of Achievement Programe) një program vlerësimi i Ministrisë Skoceze të Arsimit, ka ndihmuar në marrjen e vendimeve në fushën e arsimit. Kërkesa për monitorimin erdhi si një nevojë për të mbështetur vendimet arsimore.

Një program vlerësimi i quajtur S.A.I.P (School Achievement Indicators Program) ka filluar të përdoret **në Kanada** që nga viti 1993. Ai teston nxënësit e moshës 13-16 vjeçare.

Në fillim të viteve 90 kërkesat për monitorimin e progresit arsimor ishin shtruar në një sërë vendesh, ndërmjet të cilave” **Australi, Kanada, Francë, Irlandë, Suedi, Holandë** etj.

Aktualisht një sërë forumesh ndërkombëtare kanë treguar një interes të madh për të monitoruar standardet e arritjeve. UNESCO ka organizuar projekte ndërkombëtare për të kualifikuar specialistë nga vendet në zhvillim që të aftësohen të projektojnë, të organizojnë dhe të kryejnë vëzhgime kombëtare për arritjet e nxënësve dhe t’i përdorin të dhënat për politikën arsimore.

Këshilli Britanik ka kryer seminare ndërkombëtare të titulluar “ Vlerësimi i nxënësit në Evropë” kushtuar arritjeve në lexim, që të njohë përvojat e ndryshme për vlerësimin e nxënësve dhe për ndryshimet e bëra ndër vite.

Ndërmjet programit TIMSS (Thirr Internacional Student Atady) dhe PISA (Program KON International Student Assessment) ka monitoruar arritjet e nxënësve në vendet anëtare (të OECD), dhe jo anëtare. PISA synon monitorimin e njohurive dhe të aftësive të nxënësve 15 vjeçare në shekullin e ri.

Grumbullimi sistematik i të dhënave dhe analizat e tyre janë parakushte të rëndësishme për zhvillimin e arsimit. Ngritja e funksionimi i një sistemi monitorimi dhe mbledhja e të dhënave në nivel ndërkombëtar shihet si një bazë informimi për të bërë krahasime dhe për të formuar hipotezat rreth stabilitetit dhe ndryshimeve në arsim.

Ekziston një shumëllojshmëri modelesh për të kryer monitorime të standardeve kombëtare. Sipas

një modeli, komiteti i mësuesve, këshilluesit e kurrikulave, punëdhënësit e të tjerë, përfitojnë një listë me njohuritë, aftësitë, qëndrimet që (sipas tyre) përbëjnë nivelin minimal të formimit për një pjesëmarrje të efektshme në shoqërinë e të rriturve dhe në punë. Këtë listë e marrin specialistët që përgatisin testet, dhe instrumentet e tjera nëpërmjet të cilave dëshmohet sesa nxënësit i përmbushin standardet dhe sa nuk i përmbushin. Si shembull më i mirë merret programi i monitorimit NAEP. Ai vepron si më poshtë:

a) Komitetet e mësuesve dhe të nxënësve të ndryshëm përcaktojnë objektivat mësimore në 10 lëndë: lexim, shkrim, letërsi, matematikë, shkenca natyrore, shkenca sociale, muzikë, art, qytetari, zhvillim profesional.

b) Testet përgatiten nga specialistët duke mbajtur parasysh objektivat dhe përdoren në një kampion të caktuar p.sh:

- Çdo vit testet e dy apo tre lëndëve u jepen nxënësve të moshës 9, 13, 17 – vjeçare
- Afërsisht 30.000 nxënës testohen çdo vit. Testimi i një kampioni bëhet me qëllim që të ruhet anonimati i nxënësve dhe i shkollave.

- Rezultatet e testimit nuk i jepen publikut derisa të kryhet plotësisht studimi.

Ky model monitorimi është i kushtueshëm. Për të kryer monitorimin kërkojnë përgjigje tre pyetje:

Ç’lloj informacioni do të mblidhet

Cili është burimi i informacionit

Ç’lloj metodash do të përdoren për të mbledhur informacion

Kur konceptualizohet, përkufizohet dhe mblidhet informacion për standardet, **fjala kyç** është **shumë e shumëllojshme**: përmbajtje e shumëllojshme, burime të shumëllojshme, metoda të shumëllojshme.

Monitorimi kryhet rregullisht në kohë të caktuar, por ai mund të kryhet edhe në raste kur dalin probleme. Proçesi i monitorimit përmbledh disa funksione si: Përgjegjësia, Iluminizmi, Marrja e vendimeve, Përparimi i shkencës, dhe Inspektimi.

1. **Përgjegjësia**: Nëpërmjet përgjegjësive pasurohet diskutimi publik pasi raportohet për statusin e përgjithshëm, anët e forta dhe të dobëta të arsimit.

2. **Iluminizmi**: Ndihehet në përmirësimin e të kuptuarit të funksioneve të arsimit, kuptohen ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vendeve, zonave, shkollave.

3. **Marrja e vendimeve**: Sillet informacion për përmirësimin e drejtimit dhe të administrimit të arsimit duke përcaktuar dobësitë e sistemit.

4. *Parashikimi i shkencës*: Mbështetja e teorieve dhe metodave të përshtatshme për matjen e rezultateve në shumë aspekte.

5. *Inspektimi*: Kontrolli administrativ mbështetet në bankën e të dhënave.

Procedurat e monitorimit të standardeve kushtëzohen nga fakti se si janë hartuar ato. Ekzistojnë dy drejtime:

1. Dikasteri i arsimit ose disa grupe ekspertësh hartojnë standardet para se të kryhet monitorimi. Ky drejtim quhet apriori. Sipas këtij drejtimi besohet se standardet që përcaktohen do të arrihen.

2. Standardet përcaktohen pasi janë mbledhur të dhënat, pasi është mbikqyrur dukuria ose shkolla. Ky drejtim quhet posteriori. Standardi vendoset mbi bazën e arritjeve të drejtimeve. Drejtimi më i përhapur dhe më i zakonshmi është i pari. Ai është përdorur edhe në Shqipëri (rastin tonë). Po dihet që mënyra të ndryshme sjellin përfundime të ndryshme.

Kush duhet të kryej monitorimin e standardeve ?

Ekzistojnë përvoja të shumta. Në vendet e zhvilluara dikasteri i arsimit pajton institucione të ndryshme për të kryer monitorimin. Në vendet në zhvillim zakonisht ky dikaster e përmbush vetë këtë detyrë. Në listën e institucioneve që pajtohen për të kryer monitorimin përfshihen:

- Byroja kombëtare e statistikave ose institute të statistikave.

- Institute kërkimore të pavarura ose gjysmë të pavarura.

- Njësi universitare (departamente të specializuara për kërkime)

- Agjenci të organizatave joqeveritare

Cilët janë përdoruesit e përfundimeve të monitorimit ?

Përdoruesit e përfundimit të monitorimeve janë:

- Politikanët dhe hartuesit e politikës arsimore

- Administratorët dhe planifikuesit e arsimit

- Opinioni publik

- Praktikantët e sistemit arsimor, drejtuesit të shkollave, mësuesit.

- Komuniteti i studiuësve

Duke qenë se monitorimi i standardeve është një çështje e shtruar dhe në Shqipëri trajtimi dhe zhvillimi i tij duhet të jenë në qendër të interesit dhe strategjisë së zhvillimit arsimor. Vendosja e sistemit të monitorimit të standardeve kombëtare parashikohet të ketë një ndikim të shumanshëm. Së pari do t'ju japë përgjigje një sërë pyetjesh që lidhen:

- Me efektshmërinë e arsimit

- Me përgatitjen e nxënësve për të përballuar sfidat e së ardhmes

- Me ndikimin e burimeve njerëzore dhe materialeve në arritjet e nxënësve.

- Do të zhvillojë sistemin e testeve të standardizuara.

- Do të ndikojë në përmirësimin e arsimitë

- Do të përfshijë Shqipërinë në rrjetin ndërkombëtar të monitorimit

- Do të mundësojë krahasimin e arsimit shqiptar, me arsimin e vendeve të tjera

- Do të mundësojë kryerjen e studimeve shkencore në këtë fushë të re.

Vlerësimi i kurrikulave

Vlerësimi i kurrikulave duhet t'i referohet procesit të studimit të meritës apo vlerës së një kurrikule si një e tërë. Objektivat e vlerësimit të një kurrikule mund të përfshijnë kurrikulën, nevojat e nxënësit, studentit etj; hartimin e kurrikulës, proceset e mësimdhënies, materialet e përdorura gjatë mësimdhënies, objektivat për rezultatet, përparimin e nxënësit apo studentit në krejt kurrikulat, efektshmërinë e mësuesit, mjedisin e të nxënësve, rezultatet e mësimin.

Teoria dhe praktika e vlerësimit të kurrikulave ka ndjekur deri në vitet 60 zhvillimin e psikologjisë së edukimit si fushë studimi (Clifford 1973).

Në SHBA përjashtim bënë zhvillimet e lëvizjes për akreditimet e shkollave, e kolegjeve në fund të viteve 1800 si dhe studimi i Ralph Tylor për arsimin 8 – vjeçar në vitet 1930 (Smith dhe Tylor 1942). Lëvizja për akreditim çoi në një proces periodik, të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit nga ekipe jashtë institucioneve arsimore. Studimi për arsimin 8-vjeçar gjeneroi një model për studimin e arritjeve të objektivave të kurrikulave që ndikoi në praktikën e vlerësimit të kurrikulave deri në ditët e sotme. Zgjerimi apo më mirë të themi rritja e interesit për vlerësimin e kurrikulimit dhe zhvillimi i mendimit për të, ishte i lidhur me dy dukuri të asaj periudhe: së pari lulëzimi i reformës së kurrikulimit, veçanërisht në shkenca dhe në matematikë i nxitur nga dëshira për përgatitjen teknike të nxënësve amerikanë. Së dyti rritja e ndjeshme e të ardhurave të caktuara për arsimin nga Qeveria Federale me mandate shoqërues “PËR VLERËSIMIN E KURIKULAVE”, “ Akti për mbrojtjen e Arsimit Kombëtar” në vitin 1959 dhe “ Akti për arsimin fillor dhe të mesëm në vitin 1965 futën miliona dollarë në arsimin amerikan me qëllim zhvillimin, rinovimin dhe reformimin e kurrikulave.

“ Akti për arsimin fillor dhe të mesëm ” solli me vete edhe mandatet legjislative për vlerësimin e risive dhe të reformave.

Arsimtarët shpejt e kuptuan se të menduarit e dikurshëm për vlerësimin e kurikulave tashmë ishte i papërshtatshëm për tu shërbyer kërkesave të reja për përgjegjësinë dhe përmirësimin e kurikulave. U caktuan specialistët e kurikulave të cilët u ftuan të përgatisnin procedura të reja për të plotësuar kërkesat e kohës: nevoja për metoda më të mira në vlerësimin e kurikulave çoi në pasurimin e literaturës për vlerësimin e kurikulave.

Shumë pak arsimtarë do të besonin se cilësia e kurikulave nuk është e rëndësishme në procesin e edukimit. Për më tepër disa mendonin se nuk ka vend për përmirësim në çdo lloj kurikule.

Interesimi për tu informuar për cilësinë e kurikulave i kapërcen kufijtë nga një shkollë e vetme në nivel vendi. Arsimi përgatit gjeneratat e ardhshme për të marrë role të caktuara në shoqëri. Vlerësimi i kurrikulave që monitoron dhe raporton cilësinë e arsimit u shërben hartuesve të politikës arsimore dhe vendimmarrësve që të ndikojnë në nivelet e ndryshme të arsimit.

Identifikimi i aspekteve përmirësuar në një kurikul dhe më pas marrja e vendimeve për përmirësimin e tyre është një rol tjetër i vlerësimit të kurrikulave.

Arsimtarët profesionistë e ngarkojnë veten e tyre me përgjegjësinë e ndryshimit të përmbajtjes së kurrikulave, të metodave të mësimdhënies, të mjeteve të mësimdhënies, të zgjedhjes së personelit, të përcaktimit të objektivave për rezultatet e nxënësit ndërkohë që janë identifikuar nevojat e nxënësve e të shoqërisë.

Kjo gjë kërkon një proces të vazhdueshëm për studimin e kurikulave lokale dhe përmirësimin e tij nga personeli i shkollës. Ky lloj vlerësimi quhet vlerësim formues.

Ky rol i pare i vlerësimit të kurrikulave u shërben nevojave të hartuesve të politikës, administratorëve dhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë duke u ofruar informacion për sistemin arsimor që do të ndihmonte ata të marrin vendime që do të ndikojnë në kurikul. Roli i dytë i vlerësimit të kurrikulës i shërben nevojave të mësuesve, specialistëve të kurrikulave, administrative të shkollës dhe individëve të tjerë që janë përgjegjës për zhvillimin e kurrikulave.

Kush duhet të vlerësojë kurikulat?

Dhënia e kësaj përgjegjësie varet shumë nga qëllimet e vlerësimit të kurrikulës, nga mundësia për të gjetur vlerësues profesionistë të hartimit të kurikulave, besueshmëria e një individ ose e grupit që bën vlerësimin për ata që do t'u shërbejë vlerësimi i kurikulave, marrja parasysh e konfliktit të interesit që mund të ketë vlerësuesi, si dhe pozicioni i vlerësuesit brenda dhe jashtë sistemit

arsimor. Rrethanat ndryshojnë nga një vlerësim në tjetrin dhe vendimet për të përcaktuar autoritetin dhe përgjegjësitë për vlerësimin e kurrikulës duhet ti përgjigjen kontekstit të vlerësimit të kurrikulës.

Nëse qëllimi i vlerësimit është përmbledhës (që do të thotë raport për publikun, ose një bazë për të marrë vendim për të hequr pjesën më të madhe të kurrikulës ose për të bërë rishikime të rëndësishme të kurrikulës) vlerësuesi është mirë të zgjidhet nga kandidatë që janë të pavarur dhe të pandikuar nga objekti i vlerësimit. Zakonisht ky është një individ ose një grup jashtë sistemit arsimor ku kryhet vlerësimi.

Nëse qëllimi i vlerësimit është formues (që do të thotë: për të nxitur zhvillimin e kurrikulës, për të identifikuar dobësitë dhe nevojat e kurrikulimit dhe të nxënësve, për të monitoruar proceset e kurrikulës, për të bërë ndryshimet e nevojshme) vlerësuesi zgjidhet nga kandidatët që janë më pranë objektit të vlerësimit dhe që kanë njohuritë e domosdoshme rreth kontekstit ku ai zbatohet. Zakonisht ky është një individ brenda sistemit arsimor ku kryhet vlerësimi.

Sipas Poyne (1974) fushat në të cilat vlerësuesi duhet të jetë kompetent janë:

të specifikojë nevojat për informacion dhe të planifikojë në programin e vlerësimit.

të hartojë planin e vlerësimit të një kurrikule të caktuar.

të lokalizojë, të studiojë dhe të integrojë literaturën përkatëse nga fusha e kërkimit, matjes dhe vlerësimit.

të specifikojë objektivat e vlerësimit dhe kërkesat për bankën e të dhënave në formatet e përshtatshme.

të vlerësojë në mënyrë kritike një model ose një studim vlerësimi të dhënë.

të realizojë lidhjen ndërmjet modeleve teorike të vlerësimit dhe kërkesave praktike.

të diferencojë avantazhet dhe disavantazhet e studimeve ndërsektoriale dhe afatgjata.

të realizojë analiza për sistemin , funksione dhe detyra.

të hartojë një sistem vlerësimi duke u nisur nga disa sisteme.

të përshkruajë në terma programi kompjuterik ose përpunim të dhënash projektin e vlerësimit dhe kërkesat e analizës.

të specifikojë kriteret për përzgjedhjen ose përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit.

të zbatojë procedura të përshtatshme për grumbullimin e të dhënave.

të përdorë informacionin e vlerësimit për të marrë vendime për ndërhyrje në kurikul.

të administrojë veprimtaritë e njësisë së vlerësimit.

të hartojë një sistem të dhënash që përshkruan formatin, përgjegjësinë procedurat, përfituesit dhe afatet.

të rishikojë dhe të përmirësojë metodat e vlerësimit kur kjo bëhet e domosdoshme.

Kjo liste mund të plotësohet me kompetencat e më poshtme të identifikuara nga Sanders (1979)

1. Të përshkruajë objektin e vlerësimit duke mbajtur parasysh se çfarë po vlerësohet, cilat janë kufizimet e tij, cilat janë karakteristikat e rëndësishme të tij e të jetë në gjendje të transmetojë thelbin e objektit tek të tjerët.

2. Të përshkruajë kontekstin e vlerësimit duke mbajtur parasysh se cilët faktorë që e shoqërojnë vlerësimin janë të rëndësishëm për efektin që ata kanë ose mund të kenë mbi objektin që do të vlerësohet ose mbi vlerësimin në tërësi.

3. Të konceptojë qëllime të përshtatshme për vlerësimin duke qenë i aftë të prezantojë qartë qëllimet si një mënyrë për të drejtuar vlerësimin.

4. Të përcaktojë vlerat e objektit të vlerësimit duke qenë në gjendje të identifikojë dhe të përligjë kriteret që do të përdoren për të gjykuar dhe për të vlerësuar objektin e vlerësimit dhe më pas t'i zbatojë ato sistematikisht.

5. Të respektojë standardet etike, duke demonstruar njohuri për sjelljen e përshtatshme profesionale.

Një konsideratë e rëndësishme për zgjedhjen e vlerësuesit të kurikulës është që individi ose grupi duhet të jetë i besueshëm për ata që vlerësohen " Standardet për vlerësimin e programeve , projekteve dhe materialeve mësimore sugjerojnë që një vlerësues duhet:

të trajnohet për vlerësimin e kurikulave, të ketë kompetenca teknike, të ketë njohuri për objektin që do të vlerësohet, të ketë përvojë të ketë integritet, të zotërojë aftësi të mardhënieve me publikun, dhe të ketë karakteristika të tjera të quajtura të domosdoshme nga ata që do të përdorin rezultatet e vlerësimit.

Konsiderata tjetër ka të bëjë me mospasjen e konfliktit të interesit nga ana e vlerësuesit. Personat që bëjnë vlerësimin nuk duhet të kenë interesa vetjake që mund të preken nga vlerësimi ose që mund të ndikojë në vlerësim. Këto interesa vetjake mund të përfshijnë pikëpamje filozofike, teorike ose politike që mund të ndikojnë në rezultatet e vlerësimit, sigurimin e vendit të punës ose zhvillimin e karrierës që mund të ndikohen nga rezultatet e vlerësimit.

Së fundi pozicioni i vlerësuesit të kurikulës, që do të vlerësohet brenda ose jashtë sistemit është

një faktor që duhet mbajtur parasysh. Ndikimi që do të ketë vlerësimi i kurikulave varet pjesërisht edhe nga autoriteti dhe ndikimi që vlerësuesi ka për sistemin.

Niveli i autoritetit ose ndikimi varet nga pozicioni i vlerësuesit brenda strukturës organizative (që do të thotë lidhje e drejtpërdrejtë me drejtorin ekzekutiv) dhe ndikon në nivelin e bashkëpunimit dhe të qëndrimit të personelit që do të përfshihet në vlerësim.

Organizimi i vlerësimit të kurrikulave.

Organizimi i vlerësimit të kurrikulave mund të bëhet ose nga brenda sistemit ose nga jashtë sistemit në vartësi të konsideratave të shprehura në seksionin e mëparshëm . Burimet , struktura organizative e sistemit arsimor , numri i projekteve të vecanta të kurrikulumit , kërkesat për vlerësimin e kurrikulumit sipas politikave arsimore ose sipas ligjit janë të gjithë faktorë që ndikojnë në mënyrën sesi do të bëhet organizimi nga brenda i vlerësimit të kurrikulumit . Mundësia për të siguruar ekspertizën , kërkesat kontraktuale, ritmin e kontrollit dhe nevojat për pavarësi , janë faktorë që ndikojnë në mënyrën e organizimit të vlerësimit nga jashtë . Përgjithësisht , organizimi nga brenda i vlerësimit të një kurrikulumi mund të realizohet mbi baza të organizimit të centralizuar ose të decentralizuar. Format e centralizuara do të kërkojnë ngritjen e një njësie , zyre vlerësimi ose vlerësim nga brenda sistemit që do të përmbushë kërkesat e vlerësimit të kurrikulumit (Stufflebeam etj., 1971).

Një formë e decentralizuar mund të jetë si më poshtë:

Individë brenda sistemit , persona që kanë ekspertizën e nevojshme për vlerësimin dhe për kurrikulumin egzistojnë gjithmonë brenda sistemit dhe atyre mund tu jepet një ngarkesë pune e reduktuar që ata të kenë mundësi të marrin përgjegjësinë e vlerësimit . Rolet si mësues /vlerësues apo specialist i **kurrikulumit/vlerësues** mund të përcaktohen dhe të përdoren si mjete për ta përfshirë vlerësimin e kurrikulumit në veprimtarinë e përditëshme të sistemit shkollor.

Grupet ad-hoc brenda sistemit . Grupe me konfiguracione të caktuara ekspertize mund të ndërmarrin përgjegjësi afatshkurtra dhe me hapësirë të kufizuar për vlerësimin e kurrikulumit .

Grupet egzistuese permanente brenda sistemit . Vlerësimi i kurrikulumit të organizohet në mënyrë që të realizohet nga departamentet ose nga personeli sipas klasave ose sipas disa formave të tjera organizative ekzistuese.

Grupe të reja, që veprojnë në vijimësi brenda sistemit. Një grup njerëzish mund të krijohet për tu përqëndruar në vijimësi të disa objekte të vlerësimit

të kurrikulave (ngritja e një zyre që do të monitorojë përparimin e nxënësve nga niveli parashkollor deri në klasën e 12^{-të}, si dhe të raportojë për dobësitë e kurrikulës të identifikuar gjatë procesit të monitorimit.)

Organizimi i vlerësimit nga jashtë mund të përfshijë :

Individe jashtë sistemit . Persona me ekspertizë në vlerësimin dhe në kurrikulum që mund të shërbejnë si konsulentë për vlerësimin e kurrikulumit.

Grupe ose agjensi egzistuese jashtë sistemit .

Nje bashkim (konsorcium) i institucioneve arsimore. Sisteme arsimore që janë bashkuar për të ndarë ekspertizën për nevoja të vlerësimit të kurrikulumit të institucioneve anëtare.

Kufizimet e vlerësimit të kurrikulumit

Vlerësimi i kurrikulumit shpesh varet nga bashkëpunimi i individëve brënda mjedisit të të nxënërit, mësuesve, drejtuesve të shkollave , lektorëve, tutorëve, koordinatorëve dhe specialistët e kurrikulave, personelit të projektit të kurrikulumit e të tjera. Pa bashkëpunimin e tyre në hartimin dhe zbatimin e vlerësimit , do të ketë shumë pak mundësi për sukses. Një pjesë e këtij bashkëpunimi është mundësia që të tjerët të shohin punën e vlerësuesve ; një pjesë është kontributi me ide dhe identifikimi i çështjeve dhe i problemeve të kurrikulumit që nevojitet të studjohen ; një pjesë është grumbullimi i të dhënave dhe përgatitja e informacionit të kërkuar dhe një pjesë tjetër është rishikimi dhe redaktimi i projekt raporteve të vlerësimit . Vlerësimi i kurrikulave do të jetë aq i suksesshëm , sa ka qënë shkalla e bashkëpunimit .

Vlerësimi i kurrikulës mund të kufizohet nga kompleksiteti i matjes ose i përshkrimit të disa sjelljeve ose ngjarjeve . Kështu psh. Proceset në klasë dhe përvojat mësimore kanë kuptime të ndryshme për nxënësit të ndryshëm. Shpesh është shumë e vështirë të vlerësosh se si është përvetësuar një përvojë nga nxënësit dhe në rastin

më të mirë vlerësuesit e kurrikulave kufizohen në treguesit e ndryshimit të nxënësit në periudha të gjata kohe.

Vlerësuesit e kurrikulave kufizohen nga koha dhe nga mundësia për të kontaktuar nxënësit. Rezultatet e reformave të kurrikulave mund të mos vihen re edhe për vite e dekada pasi ato të jenë kryer . Rezultatet e ndryshimit të kurrikulave mund të jenë edhe një çështje personale që vetëm raportet personale të nxënësve mund ta nxjerrin në pah dhe në këtë rast vlefshmëria e të dhënave të tilla duhet të merren me rezervë.

Vendimet për kurrikulat shpesh mbështeten në faktorë ose informacione që nuk janë pjesë e një studimi të vlerësimit të kurrikulumit dhe në këtë rast dobia e vlerësimit të kurrikulumit vihet në pikpyetje. Vlerësuesit e kurrikullës duhet të jenë të ndërgjegjshëm se ata janë pjesë e procesit të vendimarrjes , por se roli i tyre është i kufizuar .

Kriteret për vlerësimin e kurrikulumit ose të aspekteve specifike të kurrikulumit varen nga arsytimi dhe pritshmeritë . Këto të fundit varen nga teoritë . Shumillogjshmëria e teorive të kurrikulumit , pritshmërive dhe të arsytimeve që egzistojnë , krijojnë probleme për vlerësimin e kurrikulave. Vlerësuesi duhet të zgjedhë disa kriteret të caktuara mbi të cilat të mbështesë vlerësimin (në mënyrë që vlerësimi të jetë i besueshëm) dhe ndërkohë të marrë sinjale nga përfitues të ligjshëm të rezultateve të vlerësimit. Kështu , është e nevojshme që të përcaktohen kufijtë e vlerësimit të kurrikulave.

Vlerësimi i kurrikulave është kompleks , por edhe një ndërmarje kritike për sistemin arsimor . Sa më shumë që ai të integrohet në proceset rutine të kurrikulumit , aq më shumë do të ketë ai mundësi të ndikojë mbi zgjedhjet, vendimet dhe praktikën. Ky është një funksion që është i domozdoshëm për zhvillimin dhe përtëritjen në lëmin e arsimit të cdo shoqërie.(Vazhdon nr. tjetër)

BIBLIOGRAFI

Alexander, R. (1991). *Primary Education in Leeds. Twelfth and final report from the Primary Needs Independent Evaluation Project* (12): University of Leeds.

Alexander, R. (1992). *Policy and Practice in Primary Education*. London: Routledge.

Alexander, R. (2000). *Culture & Pedagogy: international comparisons in primary education*. Oxford: Blackwell Publishers Ltd.

Assesment in Transition: Learning. Monitoring and Selection in International perspective, Edited by Angela Little and Alison Pergaman 1999

Bennett, N., & Dunne, E. (1992). *Managing Classroom Groups*. Hemel Hempstead: Simon & Schuster.

Beyond educational reform: USA 1997

Blatchford, P., & Kutnick, P. (1999). *The Nature and Use of Classroom groups in Primary schools. Final report* (R000237255): Economic and Social Research Council.

Croll, P. (1996a). Teacher-Pupil Interaction in the Classroom. In P. Croll & N. Hastings (Eds.), *Effective Primary Teaching: research-based classroom strategies*. London: David Fulton Publishers.

Galton, M., & Patrick, H. (1990). *Curriculum Provision in Small Schools*. London: Routledge.

Galton, M., Hargreaves, L., & Comber, C. (1998). Classroom Practice and the National Curriculum in Small Rural Primary Schools. *British Educational Research Journal*, 24(1), 43-61.

Gray, John Wilcon Brain: Good school, bad school, USA 1998

Hastings, N., & Wood, K. C. (2002). *Reorganizing Primary Classroom Learning*. Buckingham: Open University Press.

Kutnick, P., & Manson, I. (2000). Enabling Children to Learn in Groups. In D. Whitebread (Ed.), *The Psychology of Teaching and Learning in the Primary School*. London: RoutledgeFalmer.

McPake, J., Harlen, W., Powney, J., & Davidson, J. (1999). *Teachers' and Pupils' Days in the Primary Classroom* (SCRE Research Report No 93). Edinburgh: The Scottish Council for research in Education.

Monitoring the standards of. Education, Edited by Tujiman Postleth Waite Pergamon 1994

Mortimore Peter. The road to improvement reflections on school effectiveness GB 1998

National Standards for Civics and Government, USA 1994

Nevo, David: school based evaluation, Pergamon, 1995

Osborn, M. (2001). PACE classroom observation data .

Planning the Quality of Education, edited by Ross Kenneth N Mahlek. Lars Pergamon 1990

Standart në lëndë shkollore Ribotim 2002

The international Encyclopedia of Educational Evaluation, Edited by H. J. Walberg G.D Haertel, Series: AJE. Volume 10, Pergamon 1990

The International Encyclopio of Educatioal Evalution , Pergaman 1990 f. 163-166 / 69-90

Tucker, S. Marc Codding B. judy. Standarts for our school, san Francisco. 1998

Vari, Peter: The assessment of student achievement in Hungary and abroad Budapest 1997

ACCESS TO SCHOOL: A VIEW TO EDUCATIONAL AND INTELLECTUAL ENGAGEMENT OF RESISTANT YOUTH

JULIANA ZAHARIA
UNIVERSITETI I TIRANËS

Përmbledhje

Metodat e kërkimit dhe të analizës të studimit të rastit janë përqendruar në dallimin e kërkesës për aplikimin e modeleve bashkëkohore të edukimit dhe angazhimit intelektual në proceset e arsimit, duke vendosur një theks të veçantë mbi përfshirjen e nxënësve/të rinjve rezistentë. Të dhënat e kërkimit analizojnë vendin ku qëndrojnë aktualisht nxënësit rezistentë në proceset e mësimi, dhe mënyrën se si modelet që përdoren për njohjen e nevojave të tyre për njohuri nga shkolla, si një mjedis edukimi, por edhe si një institucion që ndërton dhe forcon potencialet e të rinjve, nxiten nga konceptet e reja të përfshirjes dhe të angazhimit.

Artikulli analizon rolin e stafeve drejtuese dhe të mësuesve, marrjen në konsideratë të këtyre afrimeve të reja në arsim, dhe ndikimin e tyre në ndihmë të krijimit të një baze të fortë të edukimit nëpërmjet aktivizimit dhe dhënies së rëndësishme, kundër përjashtimit dhe nënvlerësimit të rezistencës, një karakteristikë kjo e përbashkët e nxënësve që ju përkasin grupeve në risk. Një element i rëndësishëm i kërkimit është analiza e konstruktivizmit, si një teori që kërkon si nga stafet drejtuese, mësuesit, ashtu edhe nga stafet mbështetës të shkollave: punonjës socialë, psikologë, këshillues, të ndihmojnë modele të përfshirjeve të reja në edukim, si mjete të shprehjes dhe të ndërtimit të personalitetit.

Artikulli nënvizon nevojën për një shikim të ri mbi politikën e arsimit, në nxitje të aksesit të të rinjve rezistentë drejt njohurisë.

Fjalët kyçe: *të rinjtë rezistentë, edukimi, angazhimi intelektual.*

Abstract

Research and analyzing methods of this *case study* have been focused in highlighting the request for the application of contemporaneous patterns of education and intellectual engagement inside education processes, with a specific view to the involvement of resistant youth. Research data analyze where resistant students stand within learning processes, and how the patterns deal, connect and assess the needs of students for knowledge from school, which is not only a teaching environment, but a strengths-building institution, where can be placed new concepts of involvement and engagement.

The article refers to the role of secondary schools managers, directors and teachers, in considering important these new approaches to education, in order to lead toward a solid base of education through activating and counting and not through rejection and underestimation of resistance, which is a commune characteristic for students that belong to highly risk groups.

One of most important elements of the research is the view to constructivism, as a theory which requires not only from the professional staff, but even from the supportive staff such as social workers, psychologists, counselors, to assist new involvement patterns in education as tools of expression and personality building.

The article concludes by calling for a new conceptual view to education policies, which will stimulate access of resistant youth toward knowledge.

Key words: *resistant youth, education, intellectual engagement.*

I. INTRODUCTION

Intellectual engagement and involvement inside learning process are fundamental for accentuating roles of youth to education and learning processes. Researchers stress the build of clear opportunities for students to be active in sharing learning processes, in order to emphasize a major role of youth through intellectual engagement and counting. New and different instruments of involvement, decision-sharing and understanding, are those parts of contemporaneous education, which need to be highlighted in all possible ways inside educational institutions of Albania, where still, these instruments remain underestimated and where the number of resistant students and vulnerable youth is high.

The research refers as resistant youth to:

- Building interactions with teachers.
- Youth that belong to families with one parent, orphans, youngest Roma and Egyptian communities' members.
- Teen/young girls – victims and in risk from being involved in gender crimes and human trafficking.
- Alcohol and drugs addicted subjects.
- Poor young people, homeless-often subjects of illegal gambling.

The purpose of the article is to view the specific theoretical base, where the concept of intellectual engagement grounds.

Short and long-term educational policies in Albania continuously call for new instruments that

need to better challenge the education that produce *alternative solutions* to school abandon or juvenile crime. These *alternative solutions* need to follow delivering of a specific methodology regarding school-based approach that will consider the role of students among those roles that need to decide the education and enhance their thinking skills and contributes to their ability to participate effectively in society.

Identification of the level of application of education, learning and intellectual engagement of resistant youth, with the aim fulfillment of the basic right to education and involvement into education processes, has ensured data that will assist further researches and recommendations to education policies, and to youth policies making in Albania.

II. METHODOLOGY

The analysis of primary and secondary data of the case-study has been concentrated into an overall review of the literature, elaboration of the questionnaire and interviews with focus-groups.

Finding the most exhaustive data that link with examination of the level of intellectual engagement and involvement of youth inside secondary education processes in Albania, has been the leading goal for research methods selection.

The research emphasizes the questions:

1. How resistant youth “*get involved*” in education and learning processes?
2. In which way those groups can make their voice to be heard in deciding the processes of knowledge acquisition?

A sensitive part of primary and secondary data analyses, has been finding the main theories that call for new educational patterns following a direct role of youth inside education hours and formats of methodology. Also, finding the place those social science experts and in particular: youth social workers and psychologists have to youth engagement, has been considered important during the application of research methods.

The questionnaire has been applied to 370 respondents, who have been randomly selected among a population (N=740) of students (14-18 years old) of 14 secondary schools of Shkodra, Tirana, Durrës and Kruja; teachers, high schools directors, and activists of organizations of civil society, who work point is youth integration.

The questionnaire has been designed according to the formats of exploratory questionnaire.

Case study findings will help youth workers to be aware that they have a role to play in expanding the intellectual engagement patterns inside educational institutions.

III. Directing involvement and intellectual engagement at school: Grounds to constructivism paradigm.

Analyzing intellectual engagement inside learning and educational processes links with defining youth education surrounded from a strong context of resistance and negatively affected living conditions from risk and vulnerability. As widely indicated, the process of learning is one process defined in short terms of school learning, and in long term of education defined in reference to the whole process extended during the years of education of a student.

Learning process has been centered from developmental psychology and social psychology. Constructivism is a paradigm that characterizes learning as a process of actively constructing knowledge. Inside the paragraphs of Mussen and Carmichael (1983:103-125), the authors refer to Piaget’s Theory, which underline that children do not simply mimic everything that is part of the external environment, but rather that developing and learning is an ongoing process and interchange between individuals and their surroundings. According to O’Donnell, Reeve, & Smith (2012:254-289), constructivism encapsulates how a learner constructs knowledge via different concepts: complex, cognition, scaffolding, vicarious experiences, modeling, and observational learning. This makes students, teachers, the environment and anyone or anything else in which the student has interaction, and become active participants in their learning.

Anchors of constructivism *assist* involvement, role and engagement, with a specific reference to education processes of youth. This theory is based on observation and scientific study about how people learn. It says that people construct their own understanding and knowledge of the world, through experiencing things and reflecting upon those experiences.

Inside the classroom, the constructivist view of learning can points towards a number of different teaching practices. In the most general sense, it usually means encouraging students to use active techniques (experiments, real-world problem solving) to create more knowledge and then to reflect on and talk about what they are doing and how their understanding is changing. For the social constructionist, the relationship between language and things in the world are indeterminate, that is, no necessary connection between objects, actions, and states and what they are called. Rather than reflecting the world, language generates it. (Witkin 1999; 5)

Zastrow (1996:311-333) in analyzing problems that have been countered by what the author refer as *school-support personnel*: social workers, psychologists and councilors, the typical problems inside school environment have been defined as: (a) those associated with learning disabilities, difficulty in learning to read, in retaining information, in comprehending it; (b) problems associated with poor attention span or distractibility; (c) behavior concerns, from passive withdraw to noncompliant, physically aggressive behaviors; (d) problems associated with some degree of emotional disturbance; for example the depressed and/or suicidal adolescent, or the child with serious pathology associated with inability to sort out the real world from the fantasized one, and (e) the problems of developmentally delayed child; that is, the child who has some significant delay in intellectual, social, emotional, and physical development.

Follow the grounds and elements of constructivism paradigm, stopping or ejecting youth from being part of learning, does not mean not assisting the education for students who do not belong to the first rows or for students who life and daily reality is deeply affected from social problems and dramas. To respond to this issue, teachers, as youth workers: psychologists, social workers, need to start readapting intellectual engagement patterns, which are used in developed societies with the requests of societies in development.

On this regard, shaping the patterns of a new involvement of youth in learning need to be focused on real and intensive interventions delivered from a close view to education and knowledge.

IV. Intellectual engagement patterns – New methods to expanded the knowledge.

According to the analysis of recent debates on new reforms in administration of the secondary education as a public good, the active involvement of learners (youth/students) inside the general discussion has been referred as poor.

The *case study* elaborated data which aimed to identify the place that occupy the intellectual engagement of students of the 2nd and 3rd grades inside learning practices of 14 high schools of Shkodra, Tirana, Durres and Kruja. Data gathered from questionnaires and interviews with putting in focus groups of students have shown the reflections of students in relation to:

- Understanding the level of application of intellectual engagement patterns inside their classrooms.

- Comprehending what is the concept of “a more active role” in deciding the learning processes and methods of knowledge delivery.

When asked explaining engagement follow the sense of decisions sharing in daily learning processes within the school, around 53% of respondents lack a response.

47% of respondents consider decisions sharing in learning linked with:

- Building interactions with teachers,
- Dealing through friendly communication about the issues of teaching and learning,
- Clarifications of situations.

To the question on regard of practices and tools necessary to be used in order to involve students within school, the second group of respondents referred to:

- Sharing information in creating of a friendly teaching-learning environment,
- Enhancement of motivation,
- Friendly talk and informal conversations.

The research has been leaded by the need to discover how the schools involved in the research, consider directing priorities and creating the space, through which students/youth with learning issues (who usually sit at the last rows of the classrooms), may express entirely their ideas during hours of learning. Also, identification the role and spaces of social workers, psychologists and other activists of youth organizations, who work within youth education, in supporting this specific *expression*, has been inserted inside important parts of questionnaires and focus groups questions.

Considering activating and intellectual engagement of resistant students as an instrument for leading an increased sharing of benefits and decision-making in analyzing curricula and teaching methodology, a frequent question addressed to teachers during the processes of interviewing has been: “In which way do you look for a close interaction with students, based in intellectual engagement?”

Data analyses show that most part of respondents (77%) consider important the intellectual engagement and direct involvement of students, and a connective element with issues of learning and teaching.

The rest of respondents (23%) explained their points of view, follow which “resistant students make impossible their involvement inside learning processes”, as justifiable to their skepticism.

Research data also showed that efforts for expanding participative strategies at touchable levels remain deeply conditioned from the absence of the training and access to contemporaneous

methodology, which evaluate and stimulate a stronger feedback between teachers and students during teaching-learning processes. Lack of this access has been referred from 62% of respondents linked with the need to advance knowledge, tools and new instruments of education through workshops and training sessions for accessing:

- Patterns of decision-sharing during learning process.
- Articulating more updated curricula through cross-disciplinary collaboration.
- Discarding of intimidation/imposing/force in human relations.
- Sharing management inside classrooms with participation of students and parents.

In order to evaluate the perception of intellectual engagement notion, as an instrument which assist decision and establishing of teaching-learning formats and methods, and that facilitate assessment of knowledge gained with a view to resistant students, respondents gave positive responses.

To the question: "How you define the engagement and the involvement of students?" the responses have been the following:

- A method for facilitating human exchanging and smoothing resistances (64%).
- A tool for better knowing the differences of each personality (21%).
- A tool for measuring the efficiency of curricula introduced (15%).

Approaches from school support-personnel: (more often) social workers, psychologists, (and quite never) counselors, toward assisting education and the whole process of interaction among school and resistant students, has been referred as poor.

There is a quite sensitive awareness about a clear role of school social workers and psychologists in identifying, advancing and involving of resistant youth in education, which has been expressed from most part of respondents (97%).

The level of expectations from school social workers and psychologists for a greater role in assisting both teachers and students being part of specific links that will produce higher understanding of difficulties and more access to knowledge, is high. Expectations have been specifically referred with a regard to:

- Smoothing students' resistances/aggressiveness/stress.
- Focusing students to reflect over the human development.
- Facilitating sharing decision-making during learning process.

- Realization of programs, trainings and discussions-based professional formats to ensure preparation and updating.

V. Conclusions

Contemporaneous patterns and methods for expanding an innovative engagement of resistant students/youth inside learning processes need to be introduced as a prerogative of well functioning of education.

Accessing school and education through new patterns of involvement requires going over many barriers that divide these groups from the knowledge, that mostly link with their status of being part of resistant groups or groups in risk. In Albanian society, as in major part of Western Balkans, still, the absence of the awareness for the need of participatory and engagement patterns in learning start from the processes of conception of education policies. Carry on with this absence will cause a permanent damage to knowledge acquisition and to processes of building and enforcing psychological development of resistant youth.

Focusing to awareness for the new patterns of knowledge delivering, the methods of implementation need to be based in specifying intellectual engagement as a tool which requires flexibility and process-orientation. Youth involvement, and in particular resistant youth interacting, can successfully take place inside classrooms where there will be carefully avoided the sense of *authority* and *imposition*.

In front of the social and cultural changes, where *authority* and *imposition* are concepts deeply modified within a classroom, educational institutions need to update their role, and to follow a scientific methodology, distant from improvisation and risk of other similar mistakes.

Cognitive and intellectual investment need to be considered as a complex process expanded in the whole process of learning and based in co-operation, critical thinking, creativity, decision making and goals setting as other elements which make concrete involvement and engagement.

Teachers and students need to decide how they gather knowledge throughout the learning process and how to use it. School managers, team of directors and teachers, need to update teaching curricula, not by underestimating problems, but by emphasizing the right for equal education and access to school for all the students.

Knowing the methodology of learners' (students/youth) involvement, in decision sharing,

needs to be a priority, where school social workers and psychologists should have a specific role to play.

Resistant students learn best when they are involved.

This concept of positive learning for groups of social workers and psychologists is that part of the daily work within school that tends to be over passed.

Directing counseling and social support toward advocacy programs in benefit of specific groups of

youth in risk, accessing new patterns and practices of training on regard of the advance of intellectual engagement of students that belong to vulnerable groups and taking responsibilities for school and educational issues, will reduce gaps of education and respect the fundamental rights to access an equal instruction to all groups.

BIBLIOGRAPHY

Donnell, A. M., Reeve, J., & Smith, J. K. (2009). *Social Learning Theory, Complex Cognition, and Social Constructivism. Educational psychology: reflection for action* (3rd ed., pp. 254-289). Hoboken, NJ: John Wiley & Sons.

European Commission. (2010). *White Paper Policy: A new impetus for European Youth*. Brussels: European Commission. Brussels: European Commission.

Mussen, P. H., & Carmichael, L. (1983). *Piaget's Theory. Handbook of child psychology: formerly Carmichael's Manual of child psychology* (4th ed., pp. 103-128). New York: Wiley.

The State of Queensland (*The Office of the Queensland School Curriculum Council*) (2000). Years 1 to 10 Studies of Society and Environment Syllabus.

Theory of constructivism resource: <http://www.thirteen.org/edonline/concept2class/constructivism/>

United Nations. (1991). *United Nations Convention on the Rights of the Child*. New York: United Nations.

United Nations. (2000). *Global Program for Youth Action to the Year 2000 and Beyond*. New York: United Nations.

Witkin, S. L. (1999). *Constructing Our Future. (Editorial). Social Work*, 44, 5-8.

ZASTROW, CH. (1996). *Introduction to Social Welfare Institutions. Social Problems, Services, and Current Issues* (3rd ed., pp. 311-323). Chicago, Illinois: The Dorsey Press.

DREJTIMI PËR NDRYSHIM DHE SFIDAT REFORMUESE TË SHKOLLËS SË DITËVE TË SOTME

MAGDALINI VAMPA

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE,
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Në ndryshimet e shpejta të mjedisit rrethues, drejtimi për ndryshim është një sipërmarrje komplekse. Të drejtosh ndryshimin në shkollë do të thotë të përpiqesh për të gjetur rrugë drejt vendimarrjeve në koherencë me domethënien e saj, për anëtarët e stafit, nxënësit dhe vetë drejtuesit.

Në këtë punim, unë jam përpjekur të shoh "botën e ndryshimit" të shkollës nga perspektiva e drejtuesit të saj.

Së pari, jam përpjekur të marr në shqyrtim disa ndryshime esenciale të shoqërisë të cilat influencojnë shkollën. Këto ndryshime, kërkojnë drejtues shkolle që sigurojnë ecurinë dhe qëndrueshmërinë e të nxënësve, ndërkohë që u duhet të menaxhojnë shpejtësinë e ndryshimit të vazhdueshëm.

Së dyti, ndryshimet e shfaqura dhe vetë forcat e ndryshimit, afektojnë shkollën në veçanti. Roli i drejtuesit si një "kapacitet ndërtues", është thelbësor në zhvillimin e të nxënësve në botën e ndryshimeve komplekse.

Analiza e ndryshimit identifikon disa aspekte të drejtuesit me aftësi koordinuese, të cilat kanë implikime në pikpamjen humane përsa i përket rolit të drejtuesit. Ky punim synon të analizojë disa çështje në një këndvështrim më të gjerë referuar disa studiuve europiane, me përvojë në këtë fushë. Të gjitha këto janë përpjekur të paraqiten në kontekstin e njohur, familjar të shkollës shqiptare.

Fjalë kyç: drejtues i shkollës, drejtimi për ndryshim, dimensione të drejtuesit, organizma të të nxënësve, etj.

Abstract

In a rapidly changing environment, leadership for change is a complex undertaking. To lead the changes in schools means finding ways to connect the decisions coherently in order to make them meaningful, to staff members, students as well as to leaders themselves.

In this paper, we look at the changing world of school from the perspective of school leaders.

First, we consider fundamental societal changes that are influencing schools. These changes require school leaders to promote ongoing and sustainable learning in order to deal with challenges of rapid and continuous change.

Secondly, the political changes that have occurred, often in response to these change forces, affect school in particular. The role of the leader as a "capacity builder" is fundamental to developing learning in a complex, changing world.

The analysis of change identifies some aspects or dimensions of capacity-oriented leadership.

The proposed dimensions highlight the implications for the human side of the leader.

The paper aims to provide a summary of the issues from an international scope of reference and the illustration are drawn from the contexts with which Albanian school is more familiar.

Key words: school leader, leading for change, dimensions of leaders, organizational learning, etc.

Hyrje

Shoqëritë tona, në shumë mënyra, janë thellësisht të ndryshme nga njëqind vjet më parë. Gjatë kësaj kohe ka qarkulluar shumë mënyra të ndryshme të përshkrimit të forcave të ndryshimit sa ka ndryshime vetë. Këto ndryshime të shfaqura herw si revolucione, (Dalin&Rast,1996) megatrend-e, (Naisbett&Aburdene, 1990) herw si forca të ndryshimit (Fullan, 1993&1990) kanë një gjë të përbashkët, ndikimi i tyre në dhe për arsimin, është shumë i thellë.

Papert, S (1996) paraqet se si tre forca të veçanta ushtrojnë ndikimin e vet mbi shkollën.

Së pari, sektori industrial dhe teknologjia në zhvillim, e sheh arsimin si një treg, për produktet e veta teknologjike. Përmendim industrinë e telekomunikimit e cila përdor ekspertizën e saj për

të zhvilluar të nxënësve në distancë, komunikimin mes shkollave apo dhe agjensive të tjera.

Së dyti, të kuptuarit e teorive të inteligjencës dhe të natyrës së të nxënësve, nxitin vetëdijën mbi nevojat për qasje të reja të të nxënësve. Të dish se si të mëson është esenca e aftësive të jetës. Dija e ofruar nëpërmjet teknologjisë në shtëpi, në biblioteka, në ambiente të edukimit joformal, po i zbeh shkollës së ditëve të sotme kontrollin, mbi "kodin e pranuar të dijes".

Së treti, po identifikohet fuqia e fëmijës si një nga forcat më të fuqishme për ndryshim. Në botën e zhvilluar, është dukshme që fëmijët po shfaqin një konsideratë në rënie për arsimimin në shkolla, kur këto i qëndrojnë mbrapa shoqërisë së cilës i shërbejnë. Disa vëzhgime dhe studime në Britani, kanë rezultuar se rreth një e katërta e të gjithë studentëve janë të pakënaqur me atë që ofron

shkolla e tyre (Mçall, J., Smith, I., Stoll, L., Thomas, S., Sammons, P., MacBeath, J., Boyd, B., & Macgilchrist, B., 2001, p. 74-101). Një pjesë janë tërësisht të paafektuar me shkollën dhe një pjesë deklarojnë se do të kishin dashur të "zhdukeshin" nga sistemi formal i edukimit.

Por të gjithë këto tendenca çojnë drejt një erozioni mbi respektin për të rriturit. Normat sociale që kërkonin natyrshëm autoritet, tashmë nuk egzistojnë në shumë nga vendet e zhvilluara. Kjo do të thotë se jeta sociale dhe profesionale është shumë më e hapur se më parë. Këto janë disa imperativa por, nuk janë të vetmet forca shtytëse që hasin drejtuesit e shkollës.

Ndryshimet aktuale dhe drejtuesit.

Gjithnjë e më shumë, drejtuesit e shkollës punojnë në një kontekst politik në të cilin ndryshimet e "reformuara" janë inicuar në rang kombëtar, shtetëror dhe autoritetet lokal. Ristrukturimi shpesh prezantohet si një mënyrë e rritjes së standarteve të arritjes në përgjigje të kërkesës së konkurrencës ekonomike. Në nivelin lokal, reformimi çorodit drejtuesit e shkollës: si të menaxhojë zbatimin e ndryshimeve të jashtme dhe të shpejta që tensionojnë shkollën dhe nga ana tjetër, natyrshëm, të sigurojnë progres të shkollës, si organizëm i të nxënësve.

Detyra për të menaxhuar këtë axhendë të dyfishtë ndryshimi është e nevojshme jo vetëm në situatën e shkollës por dhe në reformat specifike kombëtare. Për shembull në shumë vende, qeveritë decentralizojnë menaxhimin e shkollës deri në nivel lokal dhe në raste të rralla dhe në nivel shkollë (përmendim Australinë dhe disa shtete të Amerikës). Për kontrast, në Angli dhe Hungari ndiqet një tjetër qasje drejt ristrukturimit të arsimit. Në këto të fundit, kërkohet të rritet konkurimi mes shkollave me besimin se mekanizmat e tregut do të sigurojnë përmirësim të cilësisë. Kur politikëbërësit kërkojnë të përdorin forcat e tregut në procesin e arsimit, evidencat sugjerojnë se shpesh shfaqet rritje e polarizimit midis shkollave (Stoll, Bollam & Collarbone, 2002). Madje kjo mund të drejtojë në performancë në rënie në shkollat me numër të madh nxënësish për klasë apo aty ku ka shumë minoritete etnike me arritje të ulta. Është e dukshme se në Ballkan, ndryshimet politike në kontekstin e drejtimit të shkollës derivojnë sfida të veçanta për drejtuesit e shkollave.

Pamjaftueshmëria e qasjeve aktuale të drejtimit të shkollës.

Literature voluminoze e drejtimit në arsim përshkruan një tërësi modelesh të drejtimit. Shumë nga këto janë ndërtuar të jenë të duhurat për kohën në të cilën modeli zhvillohet si dhe për vitet e

ardhshme dhe mjafton të themi se vetëm pak vite më parë egzistonin 850 definicione.

Studiuesit Leithood, Jantzi & Steinbach (1991), mendojnë se identifikimi i mënyrave të tjera të drejtimit do të jetë duke u rritur ndjeshëm gjatë 10 apo 20 vjetëve të ardhshëm.

Referuar Hay Group (1998, 2000), drejtuesit e shkollës demonstrojnë gjashtë stile të drejtimit: detyruar, autoritativë, bashkëpunues, demokratik, paqëberës dhe këshillues. Por, ata nuk operojnë në, dhe me një stil të vetëm, në fakt kombinojnë stilet, varësisht me situatën dhe nevojat. Është e vështirë të arrihet një kategorizim i prerë i drejtuesve në bazë të stilit sepse kompleksiteti dhe tërësia e sfidave që një drejtues përball në shkollë, në qendër të disa ambienteve (kolegë, nxënës, prindër, instruktorë, etj) është kaq e paparashkueshme. Në thelb, nuk mund të vendosim një model të drejtuesit, që në mënyrë të mjaftueshme të zotërojë gjerësinë dhe kompleksitetin e drejtimit në arsim bashkëkohor.

Dimensione të drejtuesit për ndryshimin

Kërkesat për ndryshim do të thotë se si një drejtues ka mundësi dhe gatishmëri për të fokusuar punën e tij në mënyra e dimensione të ndryshme. Në njërin anë duhet të udhëheqin stafin në arritjen e qëllimit, vizionit të përbashkët, dhe nga ana tjetër ata duhet të testojnë, vlerësojnë kërkesat që vijnë nga jashtë dhe t'i integrojnë ku dhe kur është momenti i duhur.

Qëllimi primar i shkollës është të rritë të nxënësve e studentëve, por në këtë proces, jo të gjitha shkollat kanë kapacitete të brendshme të njëjta.

Në këtë punim, bazuar dhe në mendimin e disa autoriteteve të fushës, sugjerohet se ndërtimi i kapacitetit është thelbi i drejtimit, që orienton ndryshimin tek komuniteti i tij. Katër dimensione janë thelbësore në ndërtimin e kapacitetit të drejtimit dhe që kontrollojnë implikimet për anën humane të drejtuesit: sigurimi i të nxënësve në të gjithë nivelet, nxitja e kërkimit, zgjerimi i komunitetit, krijimi i urave lidhëse midis shkollës dhe komunitetit.

a. sigurimi i të nxënësve në të gjithë nivelet

Të nxënësve është në zemër të natyrës, egzistencës së shkollës. Shkolla ka një destinacion: përgatitjen e studentit në përballje të botës që ndryshon.

Raporti i Komisionit Ndërkombëtar të Edukimit për shekullin e 21-të, të UNESCO-s (1996) argumentoi katër "shtyllat e dijes": të mësosh për të ditur, të mësosh për të bërë, të mësosh për të jetuar dhe të mësosh që të jesh, të egzistosh (to be).

Për stafin e mësuesve, të nxënësve, është gjithashtu esencial. Disa argumentojnë se detyra

qëndrore e drejtimit në arsim është të ushqejë, të kujdeset dhe më pas të mbështesë të nxënësit efektiv si në studentët dhe mësuesit(Laë. S&Glover. D, 2000). Të garantosh të nxënësit në të gjitha nivelet do të thotë të fokusohesh në të nxënësit e studentëve, të mësuesve e të drejtuesve, si dhe të nxënësit në gjithë organizmin(shkollën).

b. të nxënësit e nxënësve (studentëve)

Të nxënësit është ende duke u perceptuar si nga politikë bërësit dhe nga arsimtarët në kuptimin e rezultatit të të nxënësit. Drejtuesit e një shkolle duan të përfshihen dhe të fokusohen në monitorimin e klasës drejt arritjes dhe progresit të nxënësve, se sa në pedagogji (Southworth, 1999). Rreth 30 vitet e fundit, kërkimet kanë gjeneruar koncepte të reja të të nxënësit. Kjo ka sjellë implikacione në pesë zona të veçanta: (1)memorizim dhe strukturë të njohurisë, (2)analizim të zgjidhjes së problemeve dhe arsytim, (3)themele fillestare të njohurisë, (4)procese metakognitive dhe kapacitete vetë-rregullatore, (5)eksperienca kulturore dhe përfshirje të komunitetit në procesin e arsimimit.

Faktorët që influencojnë të nxënësit sipas Shoqatës së Psikologëve Amerikanë(1995) përmbledhen në katër kategori: faktorë konjitive dhe metakognitive, faktorë motivacionale dhe afektivë, faktorë të zhvillimit dhe ata social, dhe së katërti faktorët e diferencave sociale.

Këto zhvillime në konceptimin e të nxënësit, sjellin implikacione për drejtuesit e shkollës. Atyre u duhet të kuptojnë se ç'është të nxënësit efektiv dhe çdo të thotë kjo për mësuesin, hartimin e kurrikulës dhe vlerësimin.

c. edukimi i vazhduar i mësuesve dhe drejtuesve

Është gjerësisht e pranuar se zhvillimi profesional i mësuesve është një kusht i nevojshëm për përmirësimin e shkollës dhe menaxhimin efektiv të ndryshimit. Shumë Qeveri të shteteve pjesëmarrëse të OECD-së, kanë suportuar si edukimin e vazhduar profesional të mësuesve dhe drejtuesve, por edhe përpjekjet për rritjen e standarteve dhe përmirësimin e shkollës(Halasz, 2000).

Dallojmë dy nocione: I pari, është trajtimi i shkollës si një organizatë e të nxënësit, ku mësuesit dhe studentët janë nxënës, që kontribuojnë së bashku në procesin e vazhduar të përmirësimit të shkollës. I dyti, lidhet më të nxënësit profesional, i bazuar në zhvillimin personal, në lidhje me interesat e punës.

Drejtuesit e shkollave janë në një proces të vazhdueshëm për të rritur aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të realizuar detyrat e përditëshme si dhe të përqëndrojnë fokusin në promovim të të nxënësit

profesional të mësuesve, si fundamental në procesin e ndryshimit. Drejtuesit mund të realizojnë sa më sipër duke: ndihmuar mësuesit të ndajnë një vision të përbashkët, të angazhohen në vetë-diagnostikim, të ndërtojnë vetë-efikasitetit, të zhvillojnë një kulturë bashkëpunuese, të ndajnë përgjegjësitë e zhvillimit të mësuesve përmes vendit të punës, siguruar fonde të duhura nga burime të mundshme, (Leithood, K., Chapman, J., 1996, p.160).

Pa të nxënë nuk ka ndryshim. Kjo aplikohet dhe ka vlerë dhe për drejtuesit vetë. Të drejtosh të nxënësit kërkon të modelosh një qasje të përqëndruar tek të nxënësit dhe jo të orientuar drejt autoritetit (Senge, 2000). Ka pasur disa lëvizje në Angli në lidhje me promovimin e rrugëve më shumë reflektive të lidershit. Një shembull i tillë është dhe Leadership Programme for Serving Headteachers (LPSH). Në këtë program drejtorët e shkollës në mënyrë sistematike zhvillojnë një sjellje vetë-reflektive bazuar në feedback-un e detajuar të kolegëve të tyre, në lidhje me komunikimin dhe qëndrimin e tyre në këtë post.

d. organizatat e të nxënësit

Në botën e ndryshimeve të shpejta, kur kompleksiteti dhe sfidat rriten, të gjithë organizatat duhet të jenë të afta për të nxënë, për tu zhvilluar dhe krijuese. Në këtë kontekst është e pamjaftueshmë që shkollat vetëm të artikulojnë qartë qëllimet dhe objektivat. Sfidat për organizatat nuk është vetëm përbushja e detyrave të rrjedhura nga qëllimet e përcaktuara, por ristrukturimi i qëllimeve dhe ripërcaktimi i detyrave dhe objektivave përballë mjedisit që ndryshon.

Edhe pse të nxënësit është individual kjo nuk do të thotë se të nxënësit kolektiv të organizatës nuk mund të funksionojë. Ajo që e dallon të nxënësit individual me atë kolektiv qëndron në "fuqinë" dhe kreativitetin e dijes kolektive, që do të thotë se : "asnjë mësues i vetëm nuk di ose mund të dijë totalin e njohurive që një gjithë stafi profesional i një shkolle mund të dijë" (Hargreaves,, D.H, 1999.)

Çelësi për një organizatë të të nxënësit në terma afatgjatë, varet nga shfrytëzimi që drejtuesit i bëjnë katër proceseve: të punojnë aktivisht brenda kontekstit, mbështetje e kolegëve gjatë aktivitetit mësimor duke krijuar dhe përdorur dije strategjike, të zhvillojnë të nxënësit e orientuar sipas normave të kulturës dhe përfshirjen në sistemin(rrjetin) e të menduarit.

Schein(1985)thekson se gjëja më e rëndësishme që duhet të bëjnë drejtuesit është të krijojnë dhe menaxhojnë kulturën. Një kulturë që rrit të nxënësit dhe balancon disa interesa të shoqërisë, që fokusohet në njerëzit më shumë se tek sistemet, i bën individët të besojnë se ata mund ta

ndryshojnë mjedisin e tyre, krijojnë kohë për të nxënë, inkurojnë komunikimin e hapur, beson në bashkëpunimi dhe ka liderat e duhur.

Studiues dhe kërkues të ndryshëm propozojnë terma të tillë si shkolla mendimtare (school or systems thinking) me të cilën kuptojnë lidhjen midis shkollës si një e tërë, detyrave të stafit dhe marrëdhënien me mjedisin e vet. (Eheatley, M., 1994). Ky sistem ndihmon në rritjen e: "sensit të të punuarit së bashku si një pjesë e sistemit, ku çdo pjesë e këtij sistemi ndikohet nga të tjerët dhe ku e tëra është më e madhe se shuma e pjesëve" (Senge, P. 1997, p. 129).

Përdorimi i evidencës në nxitjen e kërkimit

Është tërësisht e pranuar se kërkimi mund dhe siguron informacionin e nevojshëm në procesin e vazhduar të ndryshimit të shkollës. Informacioni i marrë nga praktika gjen mbështetje në një varg perspektivash teorike, duke përfshirë dhe teorinë e vetë-rregullimit. Kjo teori thekson feedback-un dhe monitorimin si një proces kyç në të nxënë efektiv, në eficientë e mësuesve dhe në cilësinë e menaxhimit dhe drejtimit.

Mendojmë se tre janë mënyrat që një drejtues i orientuar drejt kërkimit vlerëson në përpjekjet për përmirësimin e shkollës: (1) promovon kërkimin dhe atë vlerësues në gjithë shkollën, në departamente dhe me mësuesit në klasat e tyre, (2) adopton mënyra gjithnjë e më sistematike në rruajtjen, analizën dhe përdorimin e të dhënave, siç janë raportet e jashtme në lidhje me shkollën, në vite, (3) kërkon dhe përdor kërkime aplikative të krijuara dhe të realizuara dhe nga specialistë të jashtëm.

Ndërtimi i zgjerimit të komunitetit

Një shkollë është një komunitet social brenda të cilit janë disa komunitete të mëdha: komuniteti lokal, komuniteti arsimor dhe një komunitet më i gjerë. Për drejtuesit e shkollës sfida është të ushqejnë dhe ndërtojnë sensin e komunitetit, ndërsa në të njëjtën kohë lidhin hendekun e krijuar ndërmjet komunitetit të brendshëm të shkollës dhe komunitetit "rrethues".

Të përmirësosh të nxënë dhe rezultatet e një numri domethënës individësh kërkon pjesëmarrje të gjerë bashkëpunuese që nuk do të thotë vetëm kolegjalitet stafi. Intervistat me studentë të kryera nga Projekti Përmirësimi i Efektivitetit të Shkollës në Skoci (MacBeath & Mortimore, 2001) venë në dukje se shumë studentë i quajnë mësuesit e tyre të gjithëditshëm, por korrelacioni i kësaj cilësie nuk është pozitiv në lidhje me respektin për ta. Respekti rezervohet më së shumti për mësuesit që i dëgjojnë dhe "i lejojnë të thonë diçka". Këto të dhëna po i drejtojnë studiuesit (në Britani) për të zhvilluar

kërkime në lidhje me përfshirjen e trajtimit më demokratik të studentëve në sistemin arsimor.

Prindërit kanë treguar se janë duke influencuar fuqishëm efektshmërinë dhe përmirësimin e shkollës. Në vitet e fundit ka pasur një lëvizje thujse globale për të vendosur një partneritet ndërmjet shkollës dhe prindërve në terma më formale.

Një aspekt i rëndësishëm është zgjerimi i komunitetit në lidhje me rrjetin e shkollave në rajon dhe më gjerë. Drejtuesit duhet të vlerësojnë se të punojnë bashkë është më mirë se të jenë individualist dhe më pas të përfitojnë nga përvojat e njëri tjetrit.

Krijimi i urës ndërmjet shkollës dhe komunitetit

Një tjetër sfidë që buron nga komuniteti është konflikti i perceptimeve që prindërit kanë për shkollën dhe natyrën e shkollimit. Drejtuesit duhet të menaxhojnë këtë situatë duke i ndihmuar prindërit të kuptojnë se është e rëndësishme për të përgatitur fëmijët, për të pritur të nesërmen dhe për të shkuarën e tyre.

Sfida po i kërkon që ata zhvillojnë si inteligjencën kontekstuale dhe atë strategjike. Drejtuesit posmodernistë të shkollës nuk mundet vetëm të jenë avokatë të së tashmes, por ata kanë obligimin moral, për të siguruar dhe asistuar në ndërtimin e të ardhmes së suksesshme.

Është e dukshme veçanërisht në Ballkan se shkollat janë në kërkim të të bërit për vete me zemër dhe me mendje të komunitetit local (capturing hearts). Stafet pedagogjike janë të vetëditshëm se kjo kërkon shpirt gjeneros dhe të dëgjuar empatik. Drejtuesit duhet të jenë më të hapur dhe të sinqertë, t'i transmetojnë më qartë komunitetit, ndryshimet pedagogjike pozitive dhe implikimet për teoritë e reja të të kuptuarit.

Implikime në lidhje me anën humane të drejtuesit të shkollës.

Drejtimi për ndryshim është një ndërmarrje humane shumë intensive. Drejtuesit janë në vazhdimësi duke u përballur me nevojat e të tjerëve për ndihmë, duke shqyrtuar arsyet për ndryshim, duke menaxhuar atë brenda shkollës apo dhe duke kontrolluar aktivisht përgjatë tij. Ka një kosto emocionale të veçantë në këto përballje, sidomos për drejtuesit me dëshirë dhe motiv për të përmirësuar shkollën. Ndryshimi është një proces shumë personal dhe i mbështetur në eksperiencë zakonisht të vështirë. Vetëdija, vetë menaxhimi, vetëdija sociale dhe aftësitë sociale janë të rëndësishëm për drejtuesit. Të dhënat empirike të studimeve në shumë vende të botës gjatë dekadës së fundit, nxjerrin në pah inteligjencën emocionale si një pjesë legjitime të drejtuesit efektiv (Day, C.,

2000, 178). Studimet e këtij autori përgjatë viteve 2000 realizuar në 12 shkolla në Britani, konkludojnë: drejtuesi efektiv në shekullin e 21-të do të jenë thellësisht të interesuar për adoptimin e strategjive dhe taktikave për të adresuar komunitetin drejt eventit të papritur dhe kërkesave të reja (Day.C., 2000, p.170). Vlerat që do të shoqërojnë drejtuesin e këtyre kohëve mund të përmbledhen: vlera dhe vision, integritet, kontekst, zhvillimi i vazhduar profesional dhe reflektimi.

Esencialisht ana humane e drejtuesit, thekson natyrën morale të drejtimit në vëmendjen e këtij procesi, drejt vlerave dhe besimeve, që drejtuesit dhe komuniteti i shkollës së tyre i sjellin orvatjet e ndryshimit.

Konkluzione

Diskutimi ynë u fokusua në katër dimensionet e drejtuesit të shkollës:

- të siguruarit e të nxëniet në gjithë nivelet e tij
- përdorimi i informacionit, evidencës në nxitjen e kërkimit
- zgjerimin e komunitetit
- krijimin e urës lidhëse midis komunitetit dhe shkollës

BIBLIOGRAFI

- American Psychological association Board of Educational Affairs.(1995). *Learner-centered principles: A framework for school redesign and reform*. <http://www.apa.org/ed/lcp.html>
- Dalin.P., Rust.V.D., (1996) *Towards schooling for the twenty-first century*. London: Cassell.
- Day, C. (2000) *Leading schools in times of change*. Buckingham, Open University Press.
- Fullan.M.(1993) *Change forces: Probing the depths of educational reform*. London: Falmer Press.
- Halasz,G. (2000). *System regulation changes in education and their implications for management development*. September 23, Tilburg University, The Netherlands.
- Hargreaves,, D.H, (1999). *The Knowledge-creating school*. British Journal of Education Studies, nr. 47(2), p.124.
- Hay Group, 1998,2000 cited from Stoll, Bollam& Collarbone, *Building Capacity for Learning*, Second International Handbook of Educational Leadership and Administration, p.46
- Law.S&Glover. D,(2000). *Educational Leadership and Learning, Practice, policy and research*. Buckingham: Open University Press, p.161.
- Leithwood, Jantzi & Steinbach, (1998) *Organizational learning in schools*. The Netherlands: Swets&Zeitlinger.
- Leithwood, Jantzi & Steinbach, (1999). *Changing leadership for changing times*. Buckingham, Open University Press
- Leithwood, K., Chapman, J., 1996. *International Handbook of Educational Leadership and Administration*, Dordrecht, The Netherlands: Kluwer Academic Press. p.160
- MacBeath,J.&Mortimore, P. (2001). *Improving school effectiveness*. Buckingham, UK: open University Press.
- Mçall, J.,Smith, I.,Stoll, L.,Thomas, S., Sammons, P., MacBeath, J.,Boyd,B.,&Macgilchrist,B.2001Improving school effectiveness, fq.74-101. Buckingham:Open University Press
- Naisbett,J.& Aburdene,P. (1990). *Megatrends 2000: Ten new Directions for the 1990's*. New York: William Morrow.
- Papert, S. (1996). *The Connected family: Bridging the digital Generation Gap*. Atlanta: Lonstreet Press.
- Schein, E. (1985). *Organizational Culture and leadership*. San Francisco, Jossey Bass.
- Senge, P. (1997). *Through the eye of the needle*. Gibson Edition, London, p.129.
- Senge, P. (2000). *School that learn*. London
- Stoll, Bollam& Collarbone. (2002) *Building Capacity for Learning*, Second International Handbook of Educational Leadership and Administration, Kluwer Academic Publishers, Great Britain.
- Wheatley, M. (1994). *Leadership and the new science*. San Francisco: Berrett-Koehler.

Gjithashtu në këtë punim theksohen disa implikime mbi anën humane të drejtimit për ndryshim.

Punimi u përpoq të reflektojë mbi disa pyetjeve kërkimore si:

A kanë të gjithë drejtuesit të njëjtën iniciative të brendshme drejt menaxhimit të ndryshimit?

Si ndihmojnë kolegët dhe komunitetin e shkollës drejt rikonceptualizimit të të nxëniet dhe mësimdhënies?

Si mund të sigurojnë një ekuilibër mes drejtimit, motivimit të vartësve dhe zhvillimit të tyre personal?

A përmbajnë trajnimet profesionale të drejtuesit edhe mbështetje emocionale(përveç asaj teknike) për të ndihmuar ata në anën humane, përgjatë drejtimit për ndryshim?

Drejtimi për ndryshim synon në krijimin e një fushë në të cilën njerëzit vazhdojnë të thellojnë të kuptuarit e tyre për realitetin dhe i bën më të aftë në njohjen më të thellë të botës. Drejtuesit janë të gatshëm për të punuar me, dhe nëpërmjet të gjithë komunitetit të të nxëniet për të zhvilluar këto realitete të reja.

FITNESI FIZIK, ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE KONTROLLI I PUNËS NË INDIVIDËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE

MARIELA BURDA
DONIKA DARDHA
ALEKSANDRA PILURI

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË.

Përmbledhje

Qëllimi i këtij studimi është të hartojë dhe zbatojë një program stërvitor për personat me aftësi të kufizuara fizike, të përshtatur sipas nivelit të aftësive të tyre.

Për hartimin e programit stërvitor të përshtatur u mbështetëm tek parimet e përgjithëshme të stërvitjes dhe të dhënat specifike të çdo personi, të cilat na ndihmuan për të bërë modifikimet e nevojshme.

Programi stërvitor u zbatua tek personat me paralizë cerebrale në qendrën e përfitimit fizik Korçë, në të cilën punon mjeku sportiv Jusuf Salice. Në studim u përfshinë 34 individë, prej të cilave 11 femra dhe 23 meshkuj. Ata i përkisnin moshës 13-20 vjeç dhe kishin nivele të ndryshme të paralizës cerebrale, por të gjithë ishin në gjendje të lëviznin vetë.

Programi u zbatua 5 herë në javë për një periudhë 1 vjeçare..

Individët që merrnin pjesë në trajnim ishin të përkushtuar dhe mungonin rrallë në stërvitje për të mos thënë fare. Ata i përkisnin klasës C5-C8.

Për të matur efikasitetin e programit stërvitor u mbështetëm tek testet e hartuara nga Departamenti i Edukimit në Universitetin e Nju Yorkut.

Përfundimi: Hartimi i programit stërvitor tek individët me paralizë cerebrale rezultoi i sukseshëm në disa drejtime. Zbatimi i tij përmirësoi forcën muskulare, kapacitetin aerobik, zhvilloi aftësitë koordinative, përmirësoi cilësinë e jetës dhe të shëndetit, por nuk solli ndryshime të rëndësishme në indeksin e masës trupore. Kjo si rezultat i paaftësisë që kufizonte përdorimin e mjeteve të edukimit fizik.

Fjalë kyçe: fitnesi fizik, paaftësi fizike, program stërvitor i përshtatur, paralizë cerebrale, teste fizike, standarte specifike

Abstract

The main aim of this study is to develop and implement a training program for persons with physical disabilities, adapted according to their skill level.

The training program is designed based on general training principles and specific details of each person, which helped us to make the necessary modifications. The training program was implemented to persons with cerebral palsy in the Korça physical center, in which doctor Jusuf Salice works. The study included 34 individuals, of which 11 female and 23 males. They were from 13-20 years old and had different levels of cerebral palsy, but all of them were able to walk.

The program was implemented five times a week for a period of 1 year.

Individuals participating in the training were devoted and rarely lacked an exercise. They belonged to the class C5-C8.

To measure the effectiveness of the training program we relied on tests developed by the Department of Education at the New York University.

Develop training program to individuals with cerebral palsy was successful in some respects.

Its implementation improved muscular strength, aerobic capacity, developed coordination skills, improved quality of life and health, but did not bring significant changes in body mass index. This as a result of the inability that limited the use of physical education tools.

Key words: physical fitness, physical disability, adapted training program, cerebral palsy, physical tests, specific standards

Fitnesi fizik dhe përbërësit e tij

Gjatë dekadës së fundit promovimi i fitnesit fizik si një përfitim i madh për mbajtjen e shëndetit ka fituar një popullaritet të madh. Një sërë studjuesish janë fokusuar në rolin e madh që luan fitnesi fizik për shëndetin e individit në përgjithsi dhe individit me aftësi të kufizuara në veçanti. Niveli i fitnesit është i lidhur me sëmundjet e zemrës, goditjet, diabetin e tipit 2, presionin e lartë të gjakut dhe

kancerin e kolonës (Rimmer, 2001) Përfshirja e individëve me paaftësi intelektuale në programe trajnimi me ushtrime fizike përmirëson komponentët e fitnesit fizik (Angelos Chaniias, 1998) Personat me paaftësi fizike do të përfitojnë më shumë prej pjesmarrjes në programe trajnimi dhe do të kenë mundësi më të mëdha në mbajtjen e funksione fizike dhe pavarësisë së tyre (M. Elaine Cress, 1999) Fitnesi fizik, i lidhur me shëndetin, u

referohet atyre përbërësve të përshtatshmërisë, të cilat janë ndikuar nga aktivitete fizike të zakonshme dhe të lidhura me statusin shëndetsor (Pate, 1988).

Fitnesi i lidhur me shëndetin është përkufizuar si një gjendje që karakterizohet nga :


- Një aftësi për të performuar ose për të ruajtur aktivitetet ditore.
- Demonstrimi i shenjave ose kapaciteteve që shoqërohen me një risk të ulët të zhvillimit

prematuro të sëmundjeve dhe kushteve që lidhen me lëvizjen.

Komponentët përbërës të fitnesit fizik të lidhur me shëndetin (Winnick & Short, 1999) janë :

- ✚ funksioni aerobik
- ✚ përbërja trupore
- ✚ funksioni muskuloskeletor.

Skema e fitnesit fizik



Përfitimet e ushtrimeve fizike sipas një studimi të kryer nga Departamenti i Shëndetit dhe Shoqata e Fitnesit Fizik të Hong Kongut në Kinë janë të shumta (Leisure And Cultural Services Department, 2000) Në aspektin funksional ushtrimet fizike ndikojnë në disa drejtime si:

- 1.-Forcimi i funksioneve kardiopulmonare
- 2.-Kontrolli i peshës trupore, përmirësimi i presionit të gjakut dhe ulja e nivelit të lipideve në gjak.
- 3.-Kontroll të mirë të diabetit.
- 4.-Parandalim i osteoporozës
- 5.-Parandalimi i sëmundjeve koronare apo i hemorragjisë cerebrale.
- 6.-Siguron pavarësi funksionale në rritje.
- 7.-Shtim të punës muskulare.

Kurse përfitimet në aspektin psikologjik janë:

- 1.Gjallëron mendjen dhe lehtëson streset e shqetësimet e tjera.
- 2.-Zgjeron rrethin shoqëror.

3.-Përmirëson imazhin vetiak, etj.

Një program trajnimi ushtrimesh të fitnesit fizik i modifikuar përmirëson nivelin dhe cilësinë e jetës në personat me paralizë cerebrale (Ketelaar, Gorter, Helder, Uiterwaal, & Takken, 2007). Duke pasur parasysh përfitimet e shumta që ka kryerja në mënyrë të rregullt e ushtrimeve fizike, persona të shumtë me paaftësi marrin pjesë në programe të ndryshme riaftësimi që zhvillohen në qendra rehabilitimi ose i kryejnë ato në mënyrë individuale në shtëpi.

Për të analizuar efikasitetin e një programi stërvitor të përshtatur për personat me paralizë cerebrale ndërmora një studim në qendrën e përfitimit fizik Korçë, në të cilën punon mjeku sportiv Isuf Saliqe. Në studim u përfshinë 34 individë., prej të cilave 11 femra dhe 23 meshkuj

Ata varionin nga mosha 13-20 vjeç dhe kishin nivele të ndryshme të paralizës cerebrale , por të gjithë ishin në gjendje të lëviznin vete.

Programi i hartuar u zbatua 5 herë në javë për një periudhë 1 vjeçare..

Individët që merrnin pjesë në trajnim ishin të përkushtuar dhe mungonin rrallë në stërvitje për të

mos thënë fare. Ata i përkisnin klasës C5-C8.(Tabela 1). Kjo edhe për shkak të hapësirës të kufizuar të qendrës, e cila nuk ofronte mundësi për përfshirjen në programin stërvitor të personave të cilët përdornin karrige me rrota.

Klasifikimi i personave me paralizë cerebrale.

Tabela 1

Klasifikimi	Parametrat e klasifikimit	Femra Nr.11	Meshkuj Nr.23
1	Përdorin karrige me rrota me motor.Vështirësi të mëdha në lëvizjen e katër gjymtyrëve	-	-
2	Vënë në lëvizje karrigen me rrota duke përdorur këmbët/ ose shumë ngadalë nëpërmjet krahëve. Vështirësi në përdorimin e 5të katër gjymtyrëve.	-	-
3	Drejtojnë karrigen me rrota me lëvizje të shkurtëra. Përmirësim I dukshëm në përdorimin e tre- katër gjymtyrëve dhe trungut.	-	-
4	Drejtimi I karriges me shtytje të forta dhe të vazhdueshme të krahëve. Forcë e mire në trung dhe në gjymtyrët e sipërme. Janë përfshirë në dëmtim vetëm gjymtyrët e poshtme.	-	-
5	Përdorin mjete ndihmëse si paterica,bastun,etj. Zbutje/moderim I hemiplegjisë spastike ose paraplegjisë.	2	5
6	Nuk përdorin mjete ndihmëse por kanë vështirësi të dukshme në mbajtjen e ekuilibrit dhe koordinimit. Përpiqen për përfshirjen e 3 ose 4 gjymtyrëve në aktivitet.	4	4
7	Gjendje e mire e personit, porçalon pak. Zbutje e mëtejshme e hemiplegjisë spastike ose paraplegjisë.	3	5
8	Vrapon dhe kërcen lirisht me një çalim të lehtë që s'bie në sy. Shfaq ndonëse minimale probleme të dukshme koordinimi.	2	9

Qëllimi, dhe detyrat e. stërvitjes.

Mbi bazë të përshkrimit, tipareve dhe karakteristikave të paaftësisë të paraqitur, përcaktuam qëllimin, dhe detyrat e.stërvitjes që personat do të kryenin.

Kështu, i gjithë aktiviteti stërvitor kishte si qëllim përmirësimin e gjendjes së përgjithëshme të personave (përmirësim të treguesve të fitnesit fizik), rruajtjen e funksionit për një kohë sa më të gjatë dhe vendosjen e një ekuilibri fiziko-psiqik.

Arritja e këtij objekti kërkonte ndërgjegjësimin e plotë të personave që të kryenin me sukses, me këmbëngulje, por edhe më dashuri detyrat e mëposhtëme:

- ✚ Punë sistematike me ushtrime të karakterit të përgjithshëm gjithmonë duke iu referuar mundësive të çdo individi.

- ✚ Pune sistematike me përzgjedhje ushtrimesh specifike që përcaktohen nga lloji i paaftësisë së individit.

Në përputhje me qëllimin, dhe detyrat e stërvitjes realizuam një planifikim objektiv të saj.mbështetur në standartet e përgjithshme dhe specifike të hartuara për personat me aftësi të kufizuar (Winnick & Short, 1999) Mbështetur tek këto standarte hartuam planin mujor e javor që do të zbatohet prej tyre i cili do të modifikohet pas çdo muaji sipas reagimeve të secilit person. Për hartimin e planit mujor është e nevojshme të kombinojmë parimet e përgjithëshme të stërvitjes me të dhëna specifike për personin me paaftësi fizike si psh: nivelin fillestar të gjendjes trupore, gjendjen e mëparëshme shëndetësore, aftësitë fizike, tiparet e karakterit dhe qëllimet personale (Fiogoni, Lockette, & Sursburg, 1995; David, Pyfer, & Huetting, 2001).

Në tabelën nr.2 dhe 3 po japim një plan-tim mujor dhe javor për personat me paaftësi

Tabela 2. Plan-tip mujor per stervitjen tek personat me paaftesi

Javet e ditet Permbajtja	Detyra stervitore mujore (shuma)	Java I Detyra stervitore	Java II	Java III	Java IV
1.Ushtrime strecingu	20	5	5	5	5
2.Vrapim aerobik(ecje rendje ne palester)	8	2	2	2	2
3.Vrapim ne pisten rrotulluese	6	1	2	1	2
4.Ushtrime kordinative	4	1	1	1	1
5.Ushtrime ekuilibri	4	1	1	1	1
6.Ushtrime me pesha	11	2	3	3	3
7.Ecje midis mjetesh(me ndihme)	3	1	1	1	-
8.Lojsra te ndryshme	4	1	1	1	1
Shuma e detyrave mujore	59	14	15	15	15

Tabela 3. Plan-tip javor per stervitjen tek personat me paaftesi

Javet e ditet Permbajtja	Shuma mujore e detyruar	Java I					Java II					Java III					Java IV				
		1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5
1.Ushtrime strecingu	20	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2.Vrapim aerobik(ecje rendje ne palester)	7	1				1			1			1		1				1	1		
3.Vrapim ne pisten rrot	6			1			1				1					1	1				1
4.Ushtrime kordinative	4	1						1					1					1			
5.Ushtrime ekuilibri	4					1				1					1						1
6.Ushtrime me pesha	11		1		1		1		1		1	1		1		1	1		1		1
7.Ecje midis mjetesh(me ndihme)	3		1					1							1						
8.Lojsra te ndryshme	4				1					1			1								1
Shuma e detyrave ditore		3	3	2	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Shuma e detyrave mujore	59	14					15					15					15				

Zbërthimi i metodologjisë stërvitore.

Metodologjia stërvitore nënkupton zbërthimin analitik të mjeteve dhe metodave stërvitore që japin ndikim të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e detyrave stërvitore (Jorgoni, 2005). Ky proces për personat me paaftesi fizike orientohet veçanërisht nga shkalla e kufizimit të lëvizshmërisë funksionale si dhe nga mundësia që kanë këta individë për të përdorur mjetet e edukimit fizik në procesin stërvitor (Leisure And Cultural Services Department, 2000). Mjetet kryesore stërvitore që u përdorën me këta individë janë

Vrapimi aerobik Në stërvitjen e individëve me aftësi të kufizuara zhvillimi i qendrueshmërisë kardiorespiratore merr një rëndësi të veçantë. Seanca stërvitore ka si mjet kryesor dhe të sigurt vrapimin (ose ecjen sipas paafhtësisë).

Metodat më të rëndësishme janë “ecje-rendje” dhe e vazhduar. Kohëzgjatja e njësisë stërvitore është 20-30 minuta, 3-5 herë në javë. Seanca stërvitore mund të fillojë me vlera nga 5-10 minuta e të rritet gradualisht deri në 30 minuta. Gjatë seancës stërvitore mund të përdorim dhe alternime të tilla si 15 minuta ecje-rendje, dhe 15 minuta dans-imitim i vidiove të ndryshme etj.

Ushtrime me rëndesa Ushtrimet me rëndesa zhvillohen me mjete të tilla didaktike si: topa të mbushur, gira, llastika, etj.

Në këtë grup përfshihen dhe ushtrimet me trenazherë të cilët ndikojnë në ushtrimin e forcës dhe lëvizshmërisë. Seanca stërvitore zgjat 15 – 20 minuta dhe zhvillohet 3 herë në javë.

Përcaktimi drejtë i peshës së rëndesës apo fortësia e llastikave (amortizatorëve) shmang uljen e

funksionit pas përdorimit. Ato duhen përcaktuar nga veçoritë individuale të individëve me aftësi të kufizuara, nga shkalla e kufizimit të lëvizjes dhe niveli i përgatitjes individuale.

Ushtrimet kordinative Individët me aftësi të kufizuara kanë vështirësi në kordinimin e lëvizjeve. Për këtë arsye stërvitja me ushtrime kordinative merr një rëndësi të veçantë. Kohëzgjatja e një seance stërvitore arrin deri 10 minuta dhe kryhen 4-6 ushtrime. Metoda kryesore është ajo rrethore stacionare me ndalesë. Ushtrimet kryhen me ose pa ndihmë.

Përgatitja me lojrat Përgatitja me lojra zhvillohet me lojra lëvizore dhe qëllimore. Kohëzgjatja e seancës stërvitore është 15-20 minuta.

Ushtrimet e streçingut Përdoren për ngrohjen dhe ftohjen e organizmit, si dhe për zhvillimin e fleksibilitetit. Kjo përcaktohet nga kohëzgjatja e çdo streçi. Seancat stërvitore zgjatin 10-15 minuta dhe sipas paaftësive streçingu kryhet për ditë madje në disa raste si tek individët me PC edhe 2 herë në ditë.

Testet që u përdorën gjatë studimit.

Për ta matur efektivitetin e programit stërvitor u mbështetëm tek testet e hartuara nga Departamenti

Formular1

Formular që u përdor për mbledhjen e të dhënave para dhe pas testimit.

Emri i Sindi Sh _____ sex F vjec 14
 Gjatesia 157 pesha 52kg Date 03.09.2006
 Klasifikimi - paralize cerebrale Klasifikimi I vogël C7

Perberesit e testit	Njesia e mases	Vlera	Standarti specifik	Standarti i pergjithshem	
				Minimal	Preferuar
Funksioni aerobik					
Kapaciteti aerobik	ml/kg ⁻¹ /min ⁻¹	15	18	35	
Sjellja aerobike					
TAMT	Min	9	15		
Perberja trupore					
Skinfold					
IMT					
Funksioni muskuloskeletal					
Forca dhe qendrushmeria					
Dinamometri	Kg	14		26	
Fleksibiliteti					
Testi Tomas	nivele	1	2		3
Shtrirja e kyçit të dorës	gradë	40	60		70
Tërheqje e shpatullës	gradë	130	165		170

Interpretimi :

Nivel të ulët të sjelljes aerobike. Amplitudë e vogël e lëvizjes së kyçeve, muskuj të kontraktuar, niveli i ulët i forces dhe qendrushmërisë.

i Edukimit në Universitetin e Nju Jorkut. Testet e përdorura na dhanë informacion për tre komponentët e fitnesit fizik të lidhur me shëndetin: funksionin aerobik, përbërjen trupore dhe funksionin muskuloskeletal.

Testet që u përdorën ishin::

Testi i lëvizjes aerobike të planifikuar (TAMT)

Dinamometri

Testi i tërheqjes së shpatullës.

Testi i zgjatimit të kyçit të dorës

Testi i modifikuar i Tomasit.

IMT (indeksi i masës trupore)

Testimi u krye në dy periudha Sipas llojit të paaftësisë secilit test i'u bënë modifikimet përkatëse Modifikimi i ushtrimeve duhet të kryhet në mënyrë të vashdueshme në varësi të reagimit që ka secili ndaj programit të stërvitjes. (Fiogoni, Lockette, & Sursburg, 1995)

Në periudhën fillestare testi u krye përpara se të fillonte zbatimi i programit dhe matja e dytë u krye pas një periudhe 1 vjeçare, gjatë secilës pjesëmarrësit u ushtruan 5 ditë në javë.

Të dhënat e mbledhura u hodhën për secilin individ në formularin 1 dhe i'u nënshtruar përpunimit të tyre .

Nevojat

- 1.-Rritje e kapacitetit aerobik.
- 2.-Zhvillim i forces dhe qendrushmërisë.
- 3.-Rritje e fleksibilitetit të lëvizjes.

Pas mbushjes së formularëve në përfundim të vitit u hartuan tabelat përmbledhëse dhe u bë përpunimi statistikor i tyre. Përfundimet e këtyre përpunimeve ne do ti diskutojmë më poshtë.

Diskutimi

Për përpunimin e të dhënave të mbledhura para dhe pas zbatimit të programit stërvitor të hartuar dhe zbatuar përdorëm testin Fisher Student, Rezultatet e dala u krahasuan me standartet specifike për të rinjtë me paaftësi fizike të rekomanduara nga Instituti Cooper për kërkime në fushën e aerobisë (Winnick & Short, 1999)

Sipas të dhënave të dala nga përpunimi statistikor i vlerave të arritura nga personat me aftësi të kufizuara në testin për tërheqjen e shpatullës (shoulder abduction) koeficienti t është 10.76 që tregon se përmirësimi është shumë i madh. Ndryshimi më i madh ka ndodhur në grupin C7-C8 ku personat me paaftësi i janë afruar shumë vlerave normale. Kurse tek grupi C5,C6 pavarësisht përmirësimeve që patën lëvizja e tyre është e kufizuar dhe larg vlerave të personave normalë. Kjo tregon që programimi i përditshëm i ushtrimeve të streçingut për këta persona ka qënë i domosdoshëm. Si rezultat i zbatimit të këtij programi 50% e personave kanë arritur ose janë shumë afër nivelit të dytë që është një tërheqje e shpatullës për 165°, 47% kanë arritur nivelin e parë prej 120° dhe vetëm 3% janë poshtë nivelit të parë.

Nga analiza e të dhënave të nxjerra nga zbatimi i testit të forcës u vu re se pjesmarrësit arritën vlera të mira të forcës dhe qëndrueshmërisë duke i'u afruar vlerave të personave normalë.

Për matjet e forces dhe përpunimin e të dhënave personat me paaftësi i ndamë në disa grupime duke pasur parasysh moshën dhe gjininë e tyre. Grupet ishin 10-13 vjeç, 14-18 vjeç për femra dhe 10-13 vjeç, 14-18 vjeç dhe deri 20 vjeç për meshkuj.

Koeficienti $t_{(F)} = 7.48$ dhe $t_{(M)} = 2.06$. Arritja e niveleve optimale të forcës dhe qëndrueshmërisë në personat me PC kanë një rëndësi të madhe për të rritur aftësitë e tyre për t'u kujdesur për veten, ose për tu përfshirë në veprimtari të ndryshme në komunitet.

Testin Tomas e zbatuam për të vlerësuar fleksibilitetin e gjymtyrëve të poshtme.

Koeficienti $t = 7.87$ është shumë i madh që tregon se përmirësimi nga zbatimi i programit të hartuar ka qënë i shumë i madh. Standarti specifik që duhej të arrinin këta persona ishte 2. Llogaritjet tregojnë se në grupin C5 43% e personave arritën standartin specifik, në grupin C6 37.5%, në grupin C7 50% dhe në grupin C8 63%. Përqindja më e madhe e individëve me paaftësi që kanë arritur standartin specifik është në grupin C8 që tregon edhe njëherë

ndikimin e paaftësisë në zbatimin e programit. Programi ndikoi pozitivisht në ndryshimin e fleksibilitetit të gjymtyrëve të poshtme, por ky ndryshim nuk është i njëjtë tek të gjithë personat, ajo varet nga niveli i lëvizshmërisë funksionale të personit dhe kushteve të tjera dytësore (spasticitet..etj).

Përpunimi i të dhënave për matjen e sjelljes aerobike tregon se përmirësimi që personat me paaftësi patën është shumë i madh $t = 10.91$. 67.5% e personave me paaftësi kapën standartin minimal prej 15 minutash. Përmirësim patën edhe personat e tjerë pavarësisht se ata nuk arritën të kapnin standartin minimal, por vlerat e tyre fillestare ishin shumë të ulta dhe paaftësia e tyre kushtëzonte mjaft zbatimin e programit.

Përpunimi i të dhënave të tabelës për shtrirjen e kyçit të dorës treguan se koeficienti 9.55 ishte shumë i madh dhe përmirësimi shumë i madh. Lëvizja e kyçit u përmirësua, amplituda e lëvizjes së tij u rrit, por kyçi i dorës mbeti i përkulur dhe gishtërinjtë e mbyllur. Asnjë prej individëve nuk arriti nivelin e dytë të vlerave të rekomanduara (60°), 73.5% e tyre arritën nivelin e parë (30°) dhe 26.5% e tyre ishin poshtë nivelit të parë (30°) të vlerave të rekomanduara.

Për përcaktimin e indeksit të masës trupore përdorëm formulën e mëposhtme:

Pesha(kg)

IMT=-----

Lartësia² (m)

IMT- indeksi i masës trupore

Indeksi i masës trupore tek këta persona nuk pati asnjë ndryshim, sepse paaftësia e tyre kushtëzonte mjaft përdorimin e mjeteve të edukimit fizik të cilat do të sillnin ndryshime në peshën e tyre e si rrjedhim edhe në indeksin e masës trupore

Përfundime dhe rekomandime

Hartimi i programit stërvitor tek individët me paralizë cerebrale rezultoi i suksesshëm në disa drejtime. Zbatimi i tij, përmirësoi forcën muskulare, kapacitetin aerobik, zhvilloi aftësitë koordinative, përmirësoi cilësinë e jetës dhe të shëndetit, por nuk solli ndryshime të rëndësishme në indeksin e masës trupore. Kjo si rezultat i paaftësisë që kufizonte përdorimin e mjeteve të edukimit fizik.

Është e pamundur hartimi dhe rekomandimi i planeve model për shkak se zbatimi i tyre varet nga reagimet e personave me paaftësi. Në varësi të tij programeve stërvitore i'u bënë modifikimet individuale në lidhje me intensitetin, kohëzgjatjen e shpeshtësinë.

Është e domosdoshme që gjatë projektimit të qëndrave të mbahen parasysh kërkesat e individëve për një hapësirë ku të lëvizin sa më

lirshëm dhe modelimin e pajisjeve të cilat mundësojnë lëvizjen e individëve ndërmjet veglave. Programi u zbatua tek individët të cilët i përkisnin grupit C5-C8 të cilët lëviznin pa karroca. Kjo për arsyes se qendra në të cilën ne punuam(e vetmja) nuk mundësonte stërvitjen e grupit C1-C4 të cilët përdorin karrige me rrota

Të organizohen trajnime të ndryshme ku të jepet informacion për teknikat specifike dhe strategjitë që duhet të përdoren nga instruktorët e edukimit fizik për të modifikuar programet e fitnesit për individët me paaftësi

BIBLIOGRAFI

- Angelos Chanas, G. R. (1998). Exercise Effects on Health-Related Physical Fitness of Individuals With an Intellectual Disability. *APAQ*, 119-140.
- Auxter, D., Pyfer, J., & Huetting. (2001). Teaching to Meet Learners' Needs. In D. Auxter, J. Pyfer, & C. Huetting, *Principles and methods of physical education and recreation* (pp. 118-151). New York: McGraw-Hill.
- Cress, M. E., Buchner, D. M., Questad, K. A., Esselman, P. C., deLateur, B. J., & Schwartz, R. S. (1999). Exercise: Effects on Physical Functional Performance in Independent Older Adults. *The Journals of Gerontology*, 54A (5), 242-248.
- Fiogoni, S. F., Lockette, K. F., & Sursburg, P. R. (1995). Exercise Prescription: Adapting Principles of Conditioning. In P. D. Miller, *Fitness Programming and Physical Disability* (pp. 67-76). USA: Disabled Sports USA.
- Jorgoni, A. (2005). *Teoria dhe metodologjia e stërvitjes sportive*. Tiranë: Shblu.
- Ketelaar, M., Gorter, J. W., Helden, P. J., Uiterwaal, C. S., & Takken, T. (2007, November). Exercise training program in children and adolescents with cerebral palsy: a randomized controlled trial. USA: National Center for Biotechnology Information (.)
- LEISURE AND CULTURAL SERVICES DEPARTMENT. (2000). *Healthy Exercise for All Camping*. Hong Kong: LEISURE AND CULTURAL SERVICES DEPARTMENT.
- Pate, R. R. (1988). The evolving definition of physical fitness. *Quest*, 40 (3), 174-179.
- Rimmer, J. H. (2001). Physical fitness levels of persons with cerebral palsy. *Developmental Medicine & Child Neurology*, 43 (3), 208-212.
- Winnick, J. P., & Short, F. X. (1999). *The Brockport Physical Fitness Test Manual: A Health Related Test for Youths with Physical and Mental Disabilities*. Champaign (Illinois, Estados Unidos): Human Kinetics.

THE IMPACT OF SCHOOL CONTEXTS ON STUDENT OUTCOMES AND ON CURRICULUM EVALUATION IN HIGH SCHOOLS OF KORÇA REGION

(Comparative study of the State Matura results and the internal assessment of high school students in the region of Korça)

NIKOLIN GËRMENJI

Përmbledhje

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve ndërvepron me vlerësimin e kurrikulës shkollore. Ky është një nga përbërësit e kurrikulës që ka një ndikim të madh në rezultatet e studentëve. Studimi përpiqet të debatohet rreth ndikimit të karakteristikave të ndryshme të shkollave të arsimit të mesëm të lartë në vlerësimin e nxënësve krahasuar me rezultatet e tyre në provimet e maturës shtetërore. Analiza ANOVA e rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm, paraqet një aspekt të ndikimit të kontekstit shkolror mbi rezultatet e maturantëve. Analiza tregon se gjimnazet publike në zonat urbane kanë vlerësimin e brendshëm më të qëndrueshëm, në krahasim me gjimnazin jo-publik në zonat urbane dhe me shkollat e mesme me më pak se 100 nxënës. Rezultatet e studimit mund të përdoren për të ristrukturuar sistemin e shkollës së arsimit të mesëm të lartë bazuar në nevojat dhe mundësitë e komunitetit të shkollës.

Fjalët çelës: *vlerësimi studentëve, provimet e Maturës Shtetërore, vlerësimi i kurrikulës, shkollat e mesme, Korçë.*

Abstract

Assessment of students' achievements interacts with the evaluation of the school curriculum. It is one of the curricula's components that has a great influence on student outcomes. The survey tries to debate the impact of assessment in gymnasiums with different characteristics in the results of Matura exams. ANOVA analysis of the effects of internal and external assessment presents one aspect of the impact of school context on student outcomes.

The analysis concludes that public urban Gymnasiums have the more sustainable internal assessment compared with public non-urban Gymnasium and high schools with fewer than 100 pupils.

The results of the survey can be used to restructure the high school system based on the needs and possibilities of the school's community.

Key words: *Student assessment, State Matura exams, curriculum evaluation, high schools, Korça region.*

THEORETICAL FRAMEWORK

The assessment is one of the most important school curriculum components that has a great influence on student achievement. Assessment has three roles or functions (Nagy, 2000). The role with the longest history is that of gatekeeping (National Commission on Testing and Public Policy, 1990), in which assessment determines who is given a privilege such as admission or graduation. This function has recently been added the role of ensuring accountability (Darling-Hammond & Ascher, 1991), in which assessment is used to determine if schools are functioning well.

The third role is that of instructional diagnosis (Levesque, Bradby, & Rossi, 1996), in which assessment is used to determine what students do and do not know, and what to do about it. These three functions have not simply replaced each other; rather, additional requirements have gradually been added to the expectations held for external assessment.

Assessment as instructional diagnosis

Mehrens (1998) notes that most writing on effects of assessments is data-free rhetoric. He further points out the difficulties of doing research that would examine the effects of assessment on instruction.

Based on limited evidence, he concludes that if the stakes are high enough and teachers see the material assessed to be appropriate, they will shift instruction to cover test content. If not, the impact of the assessment will not be obvious.

There are reasons why it is difficult to apply large-scale assessment results to instructional diagnosis. Serafini (2001) argues from a constructivist viewpoint that top-down accountability is so fundamentally different from providing data for instructional diagnosis that educators should not expect any classroom effects. He continues to advocate replacing large scale assessment with "assessment as inquiry", much in line with Darling-Hammond and Ascher's views (Darling-Hammond & Ascher, 1991). Such assessment would be done in the classroom and would focus on determining specific reasons for student misunderstanding or lack of skill. He argues as if teachers had some say in whether they engage in top down accountability practices; in a climate of top-down accountability, this is not the case.

Relationship of external assessment of the curriculum evaluation

Curriculum evaluation is an attempt to toss lightly on two questions: Do planned courses, programs, activities and learning opportunities actually

produce desired results? How can the curriculum offerings best be improved?

Evaluation is comparing the achievement of a student with other students or with a set of criteria. Effective assessment and evaluation are incorporated into all facets of the curriculum, providing both teachers and students with relevant and useful data to gauge progress and determine the effectiveness of materials and processes. We can define the curriculum evaluation as the judgment of the merit and worth of a program of studies, a field of study, or a course of study. (Guba and Lincoln, 1981)

The evaluation of the written curriculum and its effectiveness has been ever more dependent on the taught curriculum. To be effective, the written curriculum needs to be the "taught curriculum".

Pre-university education system in Albania, performs external assessment of student achievements through examinations agency NAE

(National Agency of Examination) (Regulation, 2013).

NAE provides measurement and certification of high school student achievements through mature exams called the State Matura (SM). State Matura is a system regarding final exams that young adults (aged 18 or 19) take at the end of their secondary education in Albania. State Matura consists of two required exams (written Mathematics and written Literature) and two other exams. These last two exams are chosen by the student from a pool of subjects (Chemistry, Biology, Physics, English, History-Geography and Sociology-Economy-Philosophy). (Law, Nr. 69/12, 2012)

According to the new pre-university education Law, the high school system in Albania consists of various high school profiles.

The following table shows the statistics for the distribution of secondary education institutions in the district of Korca, in academic year 2012 – 2013

Table 1.0

Type of high school	Number of students	Nr. of institutions	Number of students	Percentage %	Number of high school graduates	Percentage %
Public Gymnasium/urban areas	Until 100	0	1802	34	667	44
	100 – 300	2				
	300 – 600	1				
	Over 600	2				
Public Gymnasium/rural areas	Until 100	6	1111	21	349	23
	100 – 300	4				
	300 – 600	0				
	Over 600	0				
Non public Gymnasium	Until 100	1	512	10	151	10
	100 – 300	2				
Part-time Gymnasium	100 – 300	2	540	10	106	7
Vocational high school	Until 100	1	1260	25	222	16
	100 – 300	3				
	300 – 600	2				
Total		25	5225	100	1495	100

SOURCE: Statistical Office of the Regional Education Directorate Korca, 2013

Objectives:

In this context, the study aims to describe how the specific conditions of schools affect school curriculum evaluation, and specifically the assessment of student achievement.

The goal is to answer the following questions:

- Does the school context impact in students' achievements, the school's context?
- How does the school size affects students' assessment?
- Is there any difference between the assessment high school students of rural and urban areas?

Method

Participants

The study focuses on the relationship between the internal assessment as a component of curriculum evaluation in high school (gymnasium) and the results of Matura exams. The participants in the study are high school graduate students in academic year 2012 - 2013 that are assessed on the exams of State Matura. To realize this study will be used the results of Matura exams of high school students in Korca district 2013 and the results scores of students in high school in subject-matter: Albanian language and Mathematics, as well as the average score of students in high school. Albanian Language and Literature and Mathematics are

assessed as compulsory exams to Matura. (Instruction Nr. 35, 2013)

The tables below show the statistics of the results of internal evaluation of students in the school and external assessment of their state exams. (Book of transparency, 2013)

Table 2.1

	N	SCORES		Mean		Std. Deviation	Variance
	Statistic	Minimum	Maximum	Statistic	Std. Error	Statistic	Statistic
D1	1495	4,50	10,00	6,6752	,04422	1,70977	2,923
D2	1495	4,50	10,00	6,2931	,04434	1,71424	2,939
AAS	1495	4,52	10,90	7,1074	,04176	1,61458	2,607
Valid N (listwise)	1495						

INTERNAL ASSESSMENT

Annual Score (Albanian Language and the Literature) (D1)

Annual Score (Mathematics) (D2)

Annual Average Score (AAS)

EXTERNAL ASSESSMENT (SM)

SM exam score - Albanian Languages and the Literature (D1)

Maths exam score (D2)

The average score of the SM exam (including Z1 + Z2)

Table 2.2

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Variance
Exam scores D1	1495	4,00	10,00	6,9905	1,46455	2,145
Exam scores D2	1495	4,00	10,00	6,0242	1,54079	2,374
Average Score Exam (ASE)	1495	4,00	9,93	6,6511	1,25556	1,576
Valid N (listwise)	1495					

Procedure

The study aims at comparing the differences of average student scores in subjects D1 and D2 and the average scores of Matura exams, as well as annual average scores of students with average scores of the exams (D1 + D2 + Z1 + Z2¹).

ANOVA statistical analysis is used to compare these results.

-Internal assessment of students (is made by teachers in school - Annual Score (Albanian Language and the Literature) (D1); Annual Score (Mathematics) (D2); Annual average score (AAS);

- **External assessment** (is realized by NAE, (Regulation, 2013) which organizes the State Matura exams – State Matura exam score - Albanian Languages and the Literature (D1); State Matura Maths exam score (D2); and the average score of the State Matura exam (including Z1 + Z2).

Analysis of these indicators is based on the instruction and the regulation of Matura. This regulation defines the compulsory exams and the optional exams.

Results

Through ANOVA analysis test Oneway, It's observed the difference in means of compulsory

Matura exams (D1 and D2) and the annual assessment of respective subject-matters, depending on the type of high school and number of students of the school.

Oneway analysis of variance test the equality of population means and allow us to examine differences among means using multiple comparisons. Multiple comparisons of means allow you to examine which means are different and to estimate by how much they are different.

Although there is no a categorization of schools according to their numbers, in many studies, it is defined on various categories. Ornstein (1990), categorized small schools from 495 to 1280, whereas in Lee's 2000 study, the small school category included only schools under 300 students and Johnson's 2006 study classified such as being below 200 students. In our study, schools are divided by the number of students in four categories, based on instruction 21, for labor rates and the number of students in class. (Instruction Nr. 21, 2010)

- Less than 100 students
- From 100 to 300 students
- More than 300 students

Through Oneway analysis were observed differences between 3 groups:

¹ Z1 and Z2 are the optional exams of State Matura

a) Public Gymnasium / urban area and Public Gymnasium / rural area

b) Public Gymnasium / urban area and Nonpublic Gymnasium

c) High Schools with fewer than 100 students and High schools with 300-600 student

Why ANOVA and not T-test?

1.Comparing 3 groups using t-tests would require that 3 t-tests be conducted. Group a vs. Group b, Group a vs. Group c, and Group b vs. Group c. This increases the chances of making a type I error. Only a single ANOVA is required to determine if there are differences between multiple groups.

2.The t-test does not make use of all of the available information from which the samples were drawn. For example, in a comparison of Group a vs. Group b, the information from Group c is neglected. An ANOVA makes use of the entire data set.

3.The ANOVA is a statistical technique which compares different sources of variance within a data set. The purpose of the comparison is to determine if significant differences exist between two or more groups.

Oneway ANOVA can be used when the data can be partitioned into more than two groups, additional comparisons can be made. This might involve one aspect or dimension, for example four groups each representing a region of the country. Or the groups might vary along several dimensions, for example eight groups each composed of a gender (two categories) by region (four categories) combination. In this latter case, we can ask additional questions:

- (1) Is there a gender difference?
- (2) Is there a region difference?
- (3) Do gender and region interact?

Analysis

ANOVA analysis results through one way test indicates that the differences between the averages of internal evaluation (exam scores the subjects of Albanian Language and the Literature (D1) and Mathematics (D2)), and the external evaluation of students (compulsory exam scores to Matura), are significant.

-Public gymnasium in urban areas has a smaller difference in relative value between the internal assessment and the external assessment. Public gymnasium in urban areas has a positive difference compared with the external assessment of internal evaluation.

This shows that the scores of students in the exam have higher relative value compared with the scores of students assessed by teachers in school. The highest difference is in the case of D1 (Albanian Language and the Literature), respectively ($\alpha = + 0.8376$)

-Public gymnasium in rural areas has a greater difference in the relative value between the internal assessment and the external assessment. This indicates that the score of students in examinations is lower in relative value compared with the outcomes of students judged by the school. The difference appears higher in mathematics (D2 - Exam scores - Annual scores), ($\alpha = - 0.5963$).

-Nonpublic gymnasium has a negative difference between the external assessment and the internal assessment.

D1 (Exam score - Annual Score) $\alpha = - 0.3553$

D2 (Exam score - Annual Score) $\alpha = - 0.2397$

Nonpublic gymnasium has the highest positive difference between the internal assessment and the external assessment:

(Average score exams & Annual Average Score $\alpha = + 0.9962$)

Table 3.1 - Differences between external assessment and internal assessment of students

Type of High School	Exam score – Annual Score		Annual Average score – Exam Score		Annual Average Score – Average Exam Score	
	D1	D2	D1	D2		
Urban public High school	0,8376 ↑	0,0669 ↑	-0,1372 ↑	0,8529 ↓	0,3452 ↓	
Rural Public High school	-0,0159 ↓	-0,5963 ↓	0,3123 ↓	1,4376 ↓	0,7485 ↓	
Nonpublic High School	-0,3553 ↓	-0,2397 ↓	0,7551 ↓	1,3074 ↓	0,9962 ↓	

The findings of the study, according to the number of students are as follows:

1.Schools with the number of students up to 100, have negative difference between external evaluation and internal evaluation. The Alpha 1-indicator for differences between the annual

average scores and the average exam scores is ($\alpha = - 0,9461$)

Schools with the number of students from 300 to 600, have relatively sustainable difference. Alpha

index is smaller compared to the number of students in schools with more or less than interval 300-600. The smaller alpha indicator is the D2 difference (Exam scores - Annual Score).

2.Schools with the number of students over 600 have positive difference between the external

evaluation and the internal evaluation of field of Albanian language and the literature and Mathematics. Comparison of average annual values scores with average exam scores shows that internal assessment is higher in relative value compared with the external evaluation is ($\alpha = +0,4228$).

Table 3.2 - Differences between external assessment and internal assessment of students

Size of High School	Exam score – Annual Score		Annual Average score – Exam Score		Annual Average Score – Average Exam Score
	D1	D2	D1	D2	
Less than 100 students	-0,3335	-0,8047	0,6144	1,6611	0,9461
From 100 – 300	0,0799	-0,3713	0,1732	1,2101	0,6011
More than 300 students	0,4897	0,1089	-0,311	0,5090	0,4228

Discussion:

Assessment date is helpful to the extent that they provide relevant, valid, timely, and useful information about how much individual students are learning and how well schools are attending them. Oakes (1989) notes that school context indicators can provide clues about why schools achieve the outcomes they get along. According of another study, one of the great dangers of indicators of school context is the ease with which they can be misunderstood. One way to create fair comparison is to develop longitudinal measures of student progress or to compare schools with "like" schools. (Darling-Hammond & Ascher, 1991)

However, analysis of the difference between external evaluation and internal evaluation, of high school student achievements, shows a general trend of how has developed the curriculum on school and especially how it can affect on the assessment of students the school-specific conditions, such as location, the number of students and the type of school.

Analysis of test results through one-way, showed that there is a relation between the type of school and student achievement on standardized assessment tests.

Students of public schools in urban areas, have external assessment indicators approximately or with very little change in the relative value compared with internal assessment.

Students of public high school in rural areas and nonpublic high schools have external assessment index lower compared to internal assessment.

The analysis demonstrates that school size (number of students at school) effects on student achievements. Schools with less than 100 students have lower scores of students in exams compared

with the results of internal evaluation. Schools with the number of students with more than 300 students (300-600 students), have indicators of external evaluation in generally more sustainable and higher than indicators of internal assessment.

Considering the data in Table 1.0, we see that 60% of high schools in urban areas have over 300 students, while 60% of high school less than 100 students, are situated in rural areas. Similarly, all non-public high schools have fewer than 300 pupils.

Considerable research has been conducted on the relationship between the size of high schools and students' performance on standardized tests.

Lindalh & Cain (2012), in their study showed a relationship between student achievement and school size. The correlations in that study between high school size and student performance on standardized tests were higher for students from higher socioeconomic backgrounds. (Cannel, 1988) database has concluded that students in high schools with between 600 and 900 students scored better in both reading and math. In smaller schools, students performed less well;

Gardner, Ritblatt, and Beatty in their study of large and small high schools in California, found that larger, high schools have higher academic achievement on the Scholastic Aptitude Test than do smaller high schools. Lee's (2000) national survey concluded that school size makes a bigger difference in schools enrolling students of low socioeconomic status than I those serving students of higher socioeconomic status.

The study showed that high schools in urban areas with more than 300 students have higher scores on exams and a positive difference between external evaluation and internal assessment; high schools in rural areas with less than 100 students

have a negative difference, hence the non-public high schools.

The survey indicates that internal assessment on Albanian Languages and the Literature and Mathematics is higher in high schools in rural and non-public high schools.

In high schools in urban areas, internal assessment is lower and scores of students in exams are higher. These results show that in rural schools, teachers are more "generous" in their assessment and as it says Nagy (1984) is used to maximize the student 'chances of producing something of their lives.

The results of the national assessment of students show two tendencies:

a) In high schools in urban areas, teachers are "stingy" in evaluation of students. This phenomenon appears in the lower results of this assessment compared with the values the State Matura results.

b) In high schools in rural areas, teachers are more "permissive". Values of internal assessment results are higher than the values of the Matura exam results.

One factor that affects this phenomenon has to do with the "pressure" that exert national exams in school programs (Goodlad, 1984), especially in high schools in urban areas, where the number of students is greater and the competition is great for high achievement.

Another factor has to do with other aspects of the school context, such as access to knowledge and professional level of teachers. (Oakes, 1989).

Another interpretation of this event is that the increased breadth of curriculum offerings in

larger schools allows a higher part of teachers to remain teaching exclusively in their fields of certification, whereas in smaller high schools, there may not be enough sections needed in a given discipline are to occupy the teacher full-time, forcing that teacher to teach in another area in which he or she is not "highly qualified". (Lindahl & Cain, 2012)

Conclusions:

As a conclusion, it can be sad that the context of the school and its number of students, have an impact on student achievement.

In high schools in urban areas with a number of students over 300, students are assessed in the most correct way, compared with High school students in rural areas and nonpublic schools.

In high schools in rural areas, with a number less than 100 pupils, students are assessed ineffectively and unfairly. Their results graduation exams have significant differences compared with the results of internal assessment.

The results of the study suggest that it is necessary to consider the context of the school (their location and the number of the students) to organize and manage the high schools in the district of Korca.

High schools in rural areas with less than 100 students, are not effective in achieving the school curriculum. Scores of students and their achievements are affected by the conditions of the school and a number of students. Organizing schools to institutions with a number of 300-600 students appear to be more effective.

BIBLIOGRAPHY

- Cannell, J. J. (1988), Nationally Normed Elementary Achievement Testing in America's Public Schools: How All 50 States Are Above the National Average. *Educational Measurement: Issues and Practice*, 7: 5-9. doi: 10.1111/j.1745-3992.1988.tb00424.x
- Darling-Hammond, L., & Ascher, C. (1991). *Creating accountability in big city schools* (Urban Diversity Series No. 102). New York: National Center for Restructuring Education, Schools, and Teaching. (ERIC Document Reproduction Service No. ED334339) Retrieved October 10, 2013 from <http://files.eric.ed.gov/fulltext/ED334339.pdf>
- Gardner, P. W., Ritblatt, S. N., & Beatty, J. R. (2000). *Academic achievement and parental school involvement as a function of high school size*. *High School Journal*, 83(2), 21-27.
- Goodlad, John I.(1984). *A place called school*. New York: McGraw-Hill
- Guba, E. & Lincoln, Y. (1981). *Effective evaluation*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Johnson, J. (2006). *More doesn't mean better*. Randolph, VT: The Rural School and Community Trust Policy Program.
- Lee, V.E., Smerdon, B. A., Alfeld-Liro, C., & Brown, S.L.(2000). *Inside large and small high schools: Curriculum and social relations*. *Educational Evaluation and Policy Analysis*, 22(2).
- Levesque, K., Bradby, D., & Rossi, K. (1996). Using data for program improvement: How do we encourage schools to do it? *CenterFocus*, 12. In: Nagy, Ph. *The three roles of assessment : Gatekeeping, Accountability and Instructional Diagnosis* (Canadian Journal of Education 25, 4 (2000)

Retrieved October 2, 2013 from <http://ncrve.berkeley.edu/CenterFocus/CF12.html>

Mehrens, W. A. (1998). Consequences of assessment: What is the evidence? Educational Policy Analysis Archives, 6(13).

Retrieved October 2, 2013 from <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1745-3992.1989.tb00304.x/pdf>

MoES (2013) Book of transparency 2013

Retrieved November 30, 2013 from <http://arkiva.mash.gov.al/File/matura/2013/libri-transparences/publikimi-l-t-2013.pdf>
<http://arkiva.mash.gov.al/File/matura/2013/libri-transparences/KORCE.pdf>

MoES (2010). *Instruction Nr. 10, date 23.07.2010, For labor rates and the number of students in class*

MoES (2012). *Instruction Nr. 35, date 27.11.2012, For Development of the State Matura exams 2013*

MoES (2012). *Law nr. 69 21.06.2012 for Pre_University Education System*

MoES (2013). *The regulation for the process of State Matura 2013 in the Republic of Albania*. Tirana, 07.01.2013

Nagy, P. (1984). *An examination of differences in high school graduation standards*. (Canadian Journal of Education, 9, 276-297.)

Nagy, Ph. (2000) *The three roles of assessment : Gatekeeping, Accountability and Instructional Diagnosis* (Canadian Journal of Education 25, 4 (2000)

Retrieved October 2, 2013 from <http://ncrve.berkeley.edu/CenterFocus/CF12.html>

National Commission on Testing and Public Policy. (1990). *From gatekeeper to gateway: Transforming testing in America*. Boston: Boston College, National Commission on Testing and Public Policy.

Oakes, J. (1989). *What educational indicators? The case for assessing the school context*. (Educational Evaluation and Policy Analysis, 11(2), 189-199).

Retrieved November 23, 2013 from http://gse.buffalo.edu/fas/yerrick/ubscience/UB_Science_Education_Goes_to_School/21C_Literature_files/Oakes,%201989.pdf

Ornstein, A. C. (1990). *How BIG should schools and districts be?* Education Digest, 56(2), 44-47.

Serafini. F. (2001). *Three paragim of assessment: Measurement, procedure, and inquiry*. (The Reading Teacher, 54, 384-393.)

Retrieved December, 14, 2013 from <http://www.frankserafini.com/publications/serafini-3-parad-assess.pdf>

WEBIBLIOGRAPHY

“Assessment & Evaluation”<http://www.teachervision.fen.com/assessment/new-teacher/48353.html>

Curriculum audit<http://www.pdkintl.org/curriculum/curriculumAudits.html>

Curriculum evaluationwww.mcrel.org; www.ascd.org

National Center for Evaluation Statistics; <http://nces.ef.gov>

American Educational Research Association; <http://www.jstore.org>

PAOLO MARTENA
ITALI

Përmbledhje

Në pjesën e parë të këtij artikulli, është përshkruar kuptimi pedagogjik i konceptit të kompetencës dhe evolucionit historik i tij. Rëndësia e rinovimit të shkollës dhe shoqërisë në mënyrë që të gjithë qytetarët të fitojnë aftësitë kryesore është theksuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe është përfaqësuar plotësisht nga Bashkimi Evropian. Te punosh për zhvillimin e aftësive, për mësuesin, do të thotë të vendosësh nxënësin përballë situatash sfiduese, të marra nga bota reale.

Për t'u bërë ballë këtyre problemeve, çdo fëmijë është i detyruar të përdorë të gjitha burimet e tij, njohuritë të brendshme dhe të jashtme, aftësitë, entuziazmin dhe motivimin, mjetet dhe objektet dhe, mbi të gjitha, bashkëpunimin e shokëve. Për këtë arsye, mund të pohojmë me bindje se ky është një model edukimi shumë përfshirës.

Në pjesën e dytë të këtij artikulli, është përshkruar një praktikë e duhur për aftësitë e mësimdhënies, e realizuar në shkollën 8-vjecare italiane.

Metodologjia e përdorur është mësimi për projektin i cili është në përputhje të plotë me mësimin e aftësive; klasat janë ftuar për të ndërtuar një produkt të prekshëm në mënyrë që të mobilizojë njohuritë e të gjithë nxënësve dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre.

Fjalë çelës: didaktikë, kompetencë, aftësi, produkt, njohuri

Abstract

Nella prima parte di questo articolo, è stato descritto il significato pedagogico del concetto di *competenza* e la sua evoluzione storica.

L'importanza del rinnovamento della scuola e della società in modo che tutti i cittadini acquisiscano le competenze chiave è stata rimarcata dalla WHO (*World Health Organization*) ed è stata abbracciata totalmente dall'Unione Europea.

Lavorare per lo sviluppo delle competenze significa, per il docente, mettere gli alunni di fronte a situazioni sfidanti, attinte dal mondo reale.

Per far fronte a questi problemi da risolvere, ogni ragazzo è spinto a utilizzare tutte le proprie risorse, interiori ed esterne: conoscenze, abilità, entusiasmo e motivazione, strumenti e artefatti e, soprattutto, la collaborazione dei compagni.

Per questa ragione, si può affermare con certezza che si tratta di un modello didattico altamente inclusivo.

Nella seconda parte di questo articolo è descritta una buona pratica di didattica per competenze, realizzata in una Scuola Secondaria di I grado italiana.

La metodologia usata è la *didattica per progetto* che è in pieno accordo con la didattica per competenze: le classi vengono invitate a costruire un prodotto tangibile in modo da mobilitare le conoscenze di tutti gli alunni e di incrementarne le competenze.

1

1. Introduzione

1.1 La didattica per competenze: genesi e significato

È consueto per noi insegnanti ed educatori in generale distinguere gli alunni che hanno un buon rendimento scolastico da quelli che hanno un rendimento discreto o addirittura mediocre, ma che manifestano le loro abilità e la loro creatività solo nella vita quotidiana.

Ciò fa pensare che esista una profonda frattura, già evidenziata da Resnick (1995), tra la scuola e il mondo reale.

Ma da cosa è causata questa discontinuità?

Catoldi, in accordo con Camoglio, ricerca la causa nella tipologia d'insegnamento tradizionale. Egli distingue tra due macromodelli d'insegnamento:

1. *Il modello diretto o trasmissivo (insegnamento muro):* in cui l'allievo è considerato solo un recettore passivo di una conoscenza inerte, frutto della semplificazione della realtà;
2. *Il modello indiretto (insegnamento ponte):* in cui l'alunno è al centro della didattica e il ruolo

dell'insegnante è solo quello di creare situazioni ad hoc che consentano un apprendimento realmente efficace e spendibile nel mondo reale.

Questa nuova idea di insegnamento è al centro della moderna **Didattica per competenze**, di matrice costruttivista.

Il **concetto di competenza** è molto complesso e ha avuto una lunga evoluzione nel corso del tempo.

I comportamentisti credevano che essere alunni meritevoli significasse riuscire a "restituire" (*output*) quanto l'educatore aveva "dato" (*input*), mediante una prestazione osservabile e valutabile.

Già i cognitivisti, negli anni successivi, avevano spostato l'attenzione della ricerca pedagogica sui processi interni al soggetto: l'apprendimento era considerato una rielaborazione critica delle conoscenze pregresse.

Negli ultimi dieci – quindici anni hanno preso avvio, come prosecuzione del cognitivismo, i filoni di studio pedagogico del costruttivismo e del socio – costruttivismo.

Secondo queste teorie, il processo di apprendimento è efficace solo se ha come principale caratteristica quella di essere *costruttivo*, cioè di “ricostruire” ciò che il soggetto già possiede: tutti gli stimoli recepiti dall'esterno entrano nella mente dell'individuo e si allacciano a conoscenze pregresse per costruire nuova conoscenza.

Bruner (1986) sottolinea la necessità di un *apprendimento a spirale* che possiede tre principali caratteristiche:

Costruttivo;

Socioculturale: il contesto relazionale e socioculturale sono fondamentali per la creazione della conoscenza;

Situato: ovvero legato a una situazione attinta dalla realtà.

Da queste teorie psico – pedagogiche nasce il concetto di **competenza**.

Le prime definizioni di competenza richiamano una visione comportamentista, secondo la quale essa si identifica con una prestazione del soggetto osservabile e misurabile. In pratica si faceva coincidere il concetto di *competenza* con quello di *abilità*.

Negli anni seguenti, si assiste a un'articolazione progressiva del concetto di competenza che Le Boterf (1994) riassume in modo efficace nel passaggio dal *sapere*, al *saper essere*, al *saper agire*, inteso come *sintesi tra il saper fare e il saper essere, mobilitati in funzione di una situazione problematica*.

1.2 Le competenze e le Organizzazioni internazionali

Anche le linee programmatiche delle Organizzazioni Internazionali spingono verso questa rivoluzione dell'istruzione, della formazione e dell'educazione che metta al centro l'acquisizione di competenze.

Già nel 1993, la WHO (World Health Organization) invitava le agenzie formative a farsi carico di una formazione spendibile dai giovani, sia nella vita quotidiana che nel mondo del lavoro. Questo invito è stato accolto dalla Commissione Europea mediante i *Libri Bianchi*. Il secondo *Libro Bianco* (Cresson Flynn, 1995), in particolare, fa riferimento a una “*società conoscitiva*”, cioè dotata di quei saperi organizzati di cui ciascuno dispone per “muoversi nel mondo”.

Il “*Key Competencies for a Successful Life and a Well-Functioning Society, Rapporto finale della Ricerca DE.SE.CO, 2003*”, definisce le competenze come una costellazione e ricerca le competenze chiave, valide per ogni settore della conoscenza. Individua sostanzialmente tre competenze: interagire in gruppi sociali eterogenei; agire autonomamente;

usare strumenti in modo interattivo.

Nel documento “*Raccomandazione 2006/962/CE del Parlamento europeo e del Consiglio, del 18 dicembre 2006, relativa a competenze chiave per l'apprendimento permanente*” [Gazzetta ufficiale L 394 del 30.12.2006, pag. 10] si individuano otto competenze chiave.

Le competenze chiave per l'apprendimento permanente sono una combinazione di conoscenze, abilità e attitudini, necessarie per la crescita umana e professionale, l'inclusione sociale e l'occupazione di ciascun individuo. Solo mediante l'acquisizione delle competenze chiave, i cittadini riusciranno a muoversi in un mondo che richiede flessibilità e capacità di creare relazioni sane e fruttuose, ottenendo equilibrio psicologico e appagamento sociale. Le competenze chiave dovrebbero essere acquisite:

dai giovani alla fine del loro ciclo di istruzione obbligatoria e formazione, preparandoli alla vita adulta, soprattutto alla vita lavorativa, formando allo stesso tempo una base per l'apprendimento futuro;

dagli adulti in tutto l'arco della loro vita, attraverso un processo di sviluppo e aggiornamento delle loro abilità.

Le competenze chiave individuate sono:

la comunicazione nella madrelingua;

la comunicazione nelle lingue straniere;

la competenza matematica e le competenze di base in campo scientifico e tecnologico;

la competenza digitale;

imparare ad imparare;

le competenze sociali e civiche;

il senso di iniziativa e di imprenditorialità;

consapevolezza ed espressioni culturali;

1.3 Ruolo dell'insegnante nella didattica per competenze

Nella didattica per competenze l'insegnante non è più il protagonista dell'azione didattica, ma diventa solo un regista che crea situazioni, osserva, corregge, valuta ed è un vero punto di riferimento per il gruppo classe.

I suoi principali incarichi sono:

Osservare il sistema classe;

Progettare con i colleghi le attività mirate all'acquisizione delle competenze. Queste attività devono essere situazioni sfidanti, attinte dalla realtà; Proporre le attività ai ragazzi e osservarli durante il lavoro, annotare le sue riflessioni;

Fare in modo che gli alunni condividano con i compagni di classe quello che hanno appreso e guidare questa condivisione, correggendo eventuali errori, motivando e stimolando gli studenti;

5. Valutare l'acquisizione delle competenze. Prima dell'inizio delle attività l'insegnante stabilisce i criteri di valutazione e stila una *rubrica valutativa*. La valutazione deve tener conto, non solo dei risultati ottenuti, ma anche della motivazione, dell'approccio alla situazione problema e della capacità di lavorare in gruppo.

E' necessario che il docente crei situazioni sfidanti *ad hoc*, in modo che ogni alunno si senta coinvolto e possa apportare il suo personale contributo, in quell'ottica inclusiva di cui la scuola e la società contemporanea non possono fare a meno.

2. Il Progetto E.A.T. (Essere Amati Trasforma): un esempio di didattica per competenze

2.1 Introduzione

Riporto, di seguito, un esempio di buona pratica didattica, in sintonia con il modello di insegnamento descritto.

Sono stato l'ideatore di questa sperimentazione che mi ha dato molte soddisfazioni professionali.

Il progetto è stato svolto interamente durante l'orario scolastico e non ha richiesto spese aggiuntive per la scuola.

Sono certo che questa rivoluzione culturale parta dal lavoro nelle classi, e non dai documenti ufficiali che forniscono solo linee guida ed utili spunti.

Ho presentato la stessa sperimentazione anche durante l'esame di Stato per l'abilitazione all'insegnamento, proprio per il suo alto valore didattico.

Nella descrizione pongo in particolare risalto le attività svolte durante le lezioni di Scienze e di Matematica, fulcro del progetto. Ritengo indispensabile, infatti, che i ragazzi comprendano l'utilità pratica di queste discipline, per incrementare la loro motivazione.

Negli anni successivi ho realizzato molte sperimentazioni analoghe calandole nei diversi contesti di lavoro.

2.2 Contesto

Durante l'anno scolastico 2012-2013 ho coordinato, in qualità di insegnante di matematica e scienze, un progetto di educazione alimentare intitolato "E.A.T. – Essere Amati Trasforma".

Il progetto è stato realizzato presso la scuola secondaria di I grado dell'Istituto Comprensivo di Livorno Ferraris, Vercelli, Italia e ha coinvolto due classi seconde di venti alunni ciascuna.

1. Livorno F.is è un paese di 4500 abitanti circa, nella regione Piemonte, in provincia di Vercelli, dove non esistono gravi problemi o squilibri sociali e dove, negli ultimi anni, si è registrata una massiccia immigrazione.

5. Nelle classi erano presenti anche: 4 alunni disabili, 3 nella classe IIA e uno nella classe IIB. In IIB era

presente anche un alunno dislessico. Alcuni alunni stranieri erano inclusi in queste classi: un'alunna marocchina, 2 alunne croate e un alunno somalo in IIA, 3 alunni argentini, un alunno cileno e un alunno marocchino in IIB.

2.3 La descrizione del progetto

Il progetto ha previsto una programmazione iniziale molto seria e attenta da parte dei Consigli di Classe delle classi coinvolte, mirata allo sviluppo di molteplici competenze. E' stata indispensabile la collaborazione con i colleghi e l'ausilio della psicologa della scuola per una programmazione organica e una realizzazione fruttuosa.

La metodologia usata è stata la didattica per progetti che è in piena sintonia con il modello di insegnamento per competenze.

I vantaggi della didattica per progetti possono essere così riassunti:

- partecipazione attiva dello studente nelle scelte e le decisioni rispetto a contenuti, procedure e valutazione;
- negoiazione di contenuti e procedure; senso di appartenenza verso il prodotto;
- interazione con il mondo "di fuori" durante la realizzazione.

Le tematiche trattate sono state attinte dalle Scienze degli Alimenti e della Nutrizione. La programmazione della maggior parte degli Istituti secondari di primo grado prevede, per le classi seconde, lo studio dell'anatomia e della fisiologia umane e l'educazione alla salute. Gli insegnanti, solitamente, si dedicano in modo particolare all'educazione alimentare. Si tratta, infatti, di argomenti trasversali, molto utili allo sviluppo dei ragazzi, soprattutto nella pre – adolescenza e nell'adolescenza. Il nostro progetto è nato proprio dalla necessità di fornire agli alunni, non solo una serie di contenuti, ma anche una vera e propria forma di educazione, indispensabile per la vita quotidiana.

E' stato richiesto agli alunni di produrre un testo di educazione alimentare da diffondere. La competenza focus su cui è stato strutturato il progetto è stata: lo spirito di iniziativa e di imprenditorialità.

Ad essa si accompagnano le seguenti competenze accessorie:

- la comunicazione nella madrelingua;
- la comunicazione nelle lingue straniere;
- la competenza matematica e le competenze di base in campo scientifico e tecnologico;
- la competenza digitale;
- imparare ad imparare;
- le competenze sociali e civiche;
- consapevolezza ed espressioni culturali.

Oltre allo sviluppo di queste competenze, il progetto è partito per rispondere alle seguenti esigenze formative:

Necessità di una corretta alimentazione;
Necessità di valutare oggettivamente il proprio stato nutrizionale e di comprendere che l'immagine che abbiamo di noi stessi dipende dalle nostre emozioni;
Coinvolgimento in un progetto di valenza divulgativa;
Valorizzazione delle diversità;
Utilizzo delle conoscenze scolastiche in modo significativo e realisticamente valutabile;
Collegamento e rafforzamento della collaborazione fra scuola, famiglie e comunità locale.

Il progetto descritto ha coinvolto molti docenti che hanno, in parte, modificato la loro programmazione annuale. Il tempo impiegato a questo scopo è stato di un intero quadrimestre. Per quanto riguarda la matematica e le scienze, le ore impiegate sono state circa 20, le altre discipline coinvolte hanno dedicato al progetto un numero di ore più esiguo.

Le discipline coinvolte sono state: scienze, italiano, tecnologia, lingue straniere, matematica, musica.

Durante le lezioni di scienze gli alunni sono stati invitati a produrre testi e immagini per rispondere, facoltativamente, a uno dei due quesiti seguenti:

Qual è il tuo rapporto con il cibo?

Qual è il tuo rapporto con lo specchio?

Da queste domande è scaturita un'accesa discussione in classe. Lo scopo era quello di motivare i ragazzi nei confronti del progetto.

Sono seguiti una serie di lezioni frontali e di laboratori riguardanti la fisiologia e l'anatomia dell'apparato digerente, il bilancio energetico, la valutazione dello stato nutrizionale e le linee guida per una sana alimentazione.

I laboratori proposti stati: la produzione dello yogurt e la plicometria.

I ragazzi sono stati, inoltre, invitati a portare in classe tutte le loro ricette di famiglia. Ogni singolo alunno doveva commentare la propria ricetta da un punto di vista sia affettivo che antropologico. Le ricette sono state distribuite a piccoli gruppi di lavoro che hanno avuto l'incarico di calcolarne l'apporto calorico e nutrizionale.

Questa attività è stata molto inclusiva perchè 1ha offerto ai ragazzi di conoscersi meglio e 2.di apprezzarsi reciprocamente nelle loro differenze sociali e culturali.

4.

Infine, si è affrontato il tema della stesura organica del testo divulgativo.

6.

Durante le lezioni delle altre materie sono state svolte attività correlate e finalizzate alla crescita umana e culturale degli alunni e, contemporaneamente, alla stesura del libro.

In particolare: durante le ore di lettere sono stati letti e commentati alcuni testi inerenti il rapporto con il cibo e l'immagine corporea, durante le lezioni di tecnologia si sono studiati i metodi di conservazione degli alimenti e la loro etichettatura e si sono prodotti testi e immagini per il libro di divulgativo che costituiva la finalità del progetto. Gli insegnanti di lingue straniere, invece, hanno approfondito con gli alunni il lessico specifico e li hanno guidati nella produzione di questionari alimentari da sottoporre alle famiglie. I questionari sono stati tradotti in inglese e francese.

Le lezioni di matematica hanno permesso di elaborare i dati provenienti dalla somministrazione dei questionari alimentari alle famiglie, mediante istogrammi ed areogrammi in *windows excel*. I ragazzi hanno lavorato in gruppi di quattro persone. Ogni gruppo aveva il compito di rilevare i dati per quesito che gli era stato assegnato e di elaborarli. I risultati sono stati successivamente analizzati e discussi in classe, mediante una discussione di bilancio guidata dall'insegnante.

Particolarmente interessante risulta l'attività proposta dalla collega di musica che ha fatto ascoltare ai ragazzi due brani molto diversi (musicaclassica e hardrock) e ha chiesto loro di esprimere liberamente le loro sensazioni con il corpo, durante l'ascolto, e, successivamente, di produrre dei disegni per il loro libro. A questa lezione particolare è seguita una discussione di un'ora con la psicologa in cui i ragazzi hanno elaborato le loro sensazioni.

2.4 Il testo divulgativo prodotto

Il testo divulgativo prodotto rappresenta il prodotto tangibile di mesi di lavoro. Esso rende e riproducibile il progetto in altre sedi e documenta quanto svolto, favorendo un'analisi a posteriori.

E' stato distribuito distribuito alle famiglie e alle associazioni mediante cd-rom.

Il titolo E.A.T. (Essere Amati Trasforma) è stato scelto dagli alunni che hanno compreso la strettissima relazione che sussiste tra i sentimenti e l'alimentazione.

Il libro è formato da novantasette pagine ed è suddiviso in un'introduzione e sei capitoli:

Educazione alimentare;

Le nostre attività didattiche;

La spesa e le confezioni;

La conservazione dei cibi;

Etichette e additivi;

Le nostre ricette di famiglia.

Le immagini e i testi presenti sono interamente prodotti dagli alunni coinvolti nel progetto.

2.4 Valutazione

Tutti gli insegnanti delle discipline coinvolte nel progetto hanno valutato gli alunni, sia *in itinere*, mediante verifiche formative, che al termine del percorso, mediante verifiche sommative.

In qualità di creatore e coordinatore del progetto, avrei dovuto avere cura di creare una rubrica

valutativa a inizio percorso che mi permettesse di osservare l'evoluzione dei singoli alunni e il raggiungimento degli obiettivi di competenza relativi alla competenza focus prescelta. Riporto (*tab.1*) un esempio di rubrica valutativa che ho utilizzato, negli anni successivi, per progetti simili.

	Parziale	Accettabile	Intermedio	Avanzato
Comprensione del compito	Ha bisogno di essere guidato per cogliere il senso e gli obiettivi dell'azione progettata.	Ha chiaro il senso complessivo dell'azione progettata e gli obiettivi essenziali.	Ha chiaro il senso e gli obiettivi dell'azione progettata.	Ha chiaro il senso e gli obiettivi dell'azione progettata e si prefigura l'iter progettuale.
Pianificazione delle strategie d'azione	Fatica a individuare le tappe fondamentali dell'iter progettuale e a orientare l'azione.	Individua le tappe fondamentali dell'iter progettuale.	Individua le tappe dell'iter progettuale e orienta la propria azione e le proprie strategie in funzione della loro realizzazione.	Individua e pianifica autonomamente le tappe dell'iter progettuale e orienta la propria azione e le proprie strategie in funzione della loro realizzazione.
Controllo/regolazione dell'iter progettuale	Fatica a tenere sotto controllo i passaggi dell'iter progettuale e a rivedere il percorso.	E' disponibile e in grado di monitorare e tenere sotto controllo i passaggi essenziali dell'iter progettuale.	E' disponibile e in grado di monitorare e tenere sotto controllo l'iter progettuale, ri-orientando, se necessario, il percorso.	E' disponibile e in grado di monitorare e tenere sotto controllo l'iter progettuale, verificandone la coerenza con gli obiettivi e ri-orientando, se necessario, il percorso.
Interazione sociale	Ha bisogno di essere motivato e sollecitato a partecipare alle attività e a impegnarsi in iniziative e progetti comuni.	Partecipa alle attività, ma fatica ad assumere un ruolo propositivo e ad assumere iniziative.	Partecipa alle attività con atteggiamento costruttivo e spirito di iniziativa e disponibilità alla ricerca e all'azione.	E' motivato e partecipa alle attività con spirito costruttivo, spirito di iniziativa e disponibilità alla ricerca e all'azione. E' aperto al dialogo, al confronto e alla condivisione di conoscenze, competenze e risorse per la realizzazione di progetti comuni.
Sensibilità al contesto	Deve essere stimolato a ricercare e ad analizzare informazioni utili alla conoscenza e alla comprensione del contesto d'azione e ad utilizzarle.	Ricerca e analizza informazioni utili alla conoscenza e alla comprensione del contesto d'azione e funzionali.	Ricerca e analizza informazioni utili alla conoscenza e alla comprensione del contesto d'azione, utilizzandole per definire obiettivi e linee d'azione.	Ricerca e analizza criticamente informazioni utili alla conoscenza e alla comprensione del contesto d'azione, utilizzandole per definire obiettivi significativi e linee d'azione funzionali.

Tab.1

Concludo riportando fedelmente il testo prodotto da un' alunna con sostegno per la prova sommativa di verifica.

La prova è stata strutturata con quesiti strutturati, semi - strutturati e aperti, come quello che riporto di seguito. Tutti gli alunni hanno svolto la stessa prova: non sono state previste verifiche differenziate per ragazzi con bisogni speciali.

La consegna era la seguente:

"Il tuo amico Bob ha 18 anni, pesa 90Kg ed è alto 1,76. Ti scrive una mail in cui si confida con te riguardo alla sua incapacità di relazionarsi con gli altri e al suo pessimo rapporto con lo specchio. Ti confida che odia fare sport e che è molto ansioso e che questa ansia lo fa mangiare continuamente. Dopo aver valutato il suo stato nutrizionale, rispondi alla mail dandogli alcuni consigli"

La ragazza di IIB, coadiuvata dall'insegnante di sostegno,, ha risposto così:

"Bob è troppo grasso, cioè è quasi obeso. Il suo BMI è di 29, ma forse è meglio non dirglielo o ci resta troppo male, poveretto.

Io gli scrivo.

Caro Bob,

alla fine il peso non è tutto. Sei un ragazzo intelligente, simpatico e gentile e anche carino. A me piacciono quelli magrissimi, ma sono gusti. Alla mia amica piacciono quelli cicciottelli. Fai sport, mangia frutta e verdura e divertiti che la vita è bella. Se cominci a andare in palestra e a uscire magari incontri tanta gente e poi trovi pure l'amore e ti dimentichi di mangiare.

Senti a me non farti troppi problemi. Ti mando il libro che abbiamo scritto con il Prof Martena, magari ti torna utile. Ti voglio molto, molto bene. Non farti strane idee, però che a me piace un altro."

Il risultato di questa prova documenta l'alto coinvolgimento di tutti gli alunni. Importantissimo è

stato il ruolo degli insegnanti di sostegno che sono stati un vero "collante" tra le diverse discipline.

3. Conclusioni

La didattica per competenze sembra avere un forte valore educativo e formativo perché sana la frattura esistente fra il mondo scolastico e il mondo reale. Essa, inoltre, mette al centro dell'azione didattica l'intenzionalità degli educatori e la capacità di lavorare in equipe di insegnanti e alunni.

Tuttavia, si ritiene necessario abbinare a questo modello di insegnamento una didattica tradizionale che permetta a tutti di acquisire conoscenze e abilità di base.

Il progetto E.A.T. è un esempio di buona pratica altamente inclusiva: esso ha avuto alto valore istruttivo, formativo ed educativo e ha trattato una tematica molto importante, strettamente correlata allo sviluppo psico – fisico degli alunni di questa fascia d'età. Il nome stesso del progetto : "E.A.T. (Essere Amati Trasforma)" è stato scelto dagli alunni che hanno compreso la profonda correlazione tra alimentazione e psiche.

Per attuare una didattica moderna ed innovativa, gli educatori devono prendere coscienza dell'importanza del ruolo e programmare in modo coerente, intelligente, praticabile ed equo, tenendo, cioè, in considerazione gli interessi degli alunni, le loro inclinazioni e il contesto.

Solo così potremo raggiungere l'obiettivo indicato dalla Strategia di Lisbona (2000) che mira a trasformare l'Europa nell' "economia basata sulla conoscenza più competitiva e dinamica del mondo". La regione balcanica, origine della cultura europea e mondiale deve essere protagonista attiva di questa rivoluzione.

BIBLIOGRAPHICAL REFERENCES

Bruner, J., "Actual Minds, Possible Worlds". Cambridge, MA: Harvard University Press, 1986.

Commission of the European Communities, "White Paper on Education and Training & teaching and learning towards the learning society", November 29 th 1995.

European Parliament and of the Suggestion , "Recommendations related to the key competence", Recommendation 2006/962/CE , December 18 th 2006, [official Gazette L 394 of the 30.12.2006, pag. 10

L.B Resnick, "To Learn inside and out the school", in C. Pontecorvo-A.M. Ajello-C. Zuccheromaglio (edited by), the social contexts of the learning, Milan, LED, 1995, pp. 61-70.

Le Boterues, "De the compétence, Essai sur un attracteur étrange", Paris, Les Editions of organisation, 1994, p. 43.

M. Castoldi, "Teaching wall and bridge", the educator, n° 1, '08/'09 .

M. Castoldi, "Didattica Generale, Mondadori Università, Milano, 2010

M. Pellerey, Her individual competences and the Portfolio, Florence, You New Italia, 2004

Ministero dell' Istruzione, dell' Università e della Ricerca scientifica italiano, "Indicazioni nazionali per il curriculum della scuola dell'infanzia e del primo ciclo d'istruzione", settembre 2012

Unione Matematici Italiana, "Materiale per un nuovo curriculum di matematica", 2001

World Health Organization – Division of Mental Health, , *“Life skills educations for children and adolescents in school”*, April 22th 1993

Siti consultati:

<http://www.strategiadilisbonalazio.it/>

www.eduscuola.it

PROBLEMET EMOCIONALE TEK FËMIJËT: FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN DHE RUAJTJEN E ANKTHIT

VALMIRA SKËNDI

ÇILJETA SIMAKU

VALBONA ALIKAJ

SHËRBIMI PSIKIATRIK QSU "NËNË TEREZA", TIRANË
QENDRA KOMUNITARE E SHËNDETIT MENDOR, KORCË

Përmbledhje

Çrregullimet e ankthit janë klasat e çrregullimeve psikologjike me te përhapura te fëmijët, adoleshentet dhe te rriturit. Kjo mund te duket surprizuese, duke qene se çrregullimet e tjera emocionale qe janë me të dukshme ne klasa apo ne grupe te ndryshme tërheqin me tepër vëmendjen e familjareve, mesuesve dhe mediave. Ky artikull përbën një pjesë të studimit të literaturës mbi një studim më të gjerë me temë "Stilet e Prindërimit dhe Çrregullimet e Ankthit tek Fëmijët dhe Adoloshentët". Objektivi i këtij artikulli është të paraqesë shkaqet e mundshme të ankthit, faktorët bio-psiko-socialë të cilët ndikojnë në lindjen, zhvillimin dhe ruajtjen e ankthit. Metodologjia e përdorur në këtë studim konsistoi në hulumtimin në literaturën teorike ekzistuese nëpërmjet sigurimit të artikujve për studimin aktual, me anë të kërkim elektronik në databazat e publikimeve akademike të Medline, PsycInfo, PubMed. Termat e kërkimit: "anxiety disorders*", adolescent*, child*, prevalence, u përdorën për të gjetur artikuj ekzistues. Për disa artikuj kërkimi u krye duke u nisur nga citimi. Disa publikime të tjera të njohura nga autori janë cituar gjithashtu. Kërkimi u krye vetëm për artikujt e shkruar në gjuhën angleze. Konkluzion: studime mbi etiologjinë e ankthit bazohen në modelin shumë faktorial, dhe jo vetëm në një shkak të vetëm. Këto teori, vënë theksin mbi identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen tek faktorët të cilët ndikojnë në ruajtjen dhe përshkallëzimin e ankthit (Waldinger R., 1997).

Fjalët kyçe: ankthi, fëmijë, etiologjia e ankthit, trashëgimi, gjenetik, prindërim, atashim, modelim i ankthit.

Abstract

Anxiety disorders are among most frequent psychological disorders in children/adolescents and adults. This may sound very surprising, seeing that other noticeable emotional disorders attract attention of family members, teachers or other important field actors. This article is part of the theoretical review of a broader study on "Parenting Styles and Anxiety Disorders in Children/Adolescents".

Objective: to present possible causes of anxiety, bio-psycho-social factors that influence the development and preservation of anxiety. **Method:** literature review was conducted on existing articles in databases of academic publications through electronic search in Medline, Psych-Info, Pub-Med. The search items such as: "anxiety disorders*", adolescent*, child*, prevalence, were used to find existing articles. **Conclusion:** different studies on anxiety etiology are based on a multi-factorial model and not to a single cause. These theories put emphasis on the early identification, prevention and intervention on factors that affect anxiety cause, development, preservation and exacerbation (Waldinger R., 1997).

Key words: anxiety, child/adolescent, etiology of anxiety, heredity, genetics, parenting, attachment, modeling of anxiety

A njihen çrregullimet e ankthit?

Nga përkufizimi ankthi është i brendshëm dhe nuk dallohet menjëherë së jashtmi. Prindërit dhe mësuesit zakonisht e vënë re ankthin e fëmijëve, sepse ata nuk tregojnë për shqetësimet e tyre, ose sepse ata ndihen çuditërisht të ndryshëm nga bashkëmoshatarët. Fëmijët dhe adoleshentet me problem ankthi përshkruhen sit e ndjeshëm. Megjithatë, disa here fëmijët me nivel të lartë frike dhe shqetësimi mund të reagojnë me nervozizëm dhe agresivitet, zakonisht jashtë kontrollit, si pasojë e lodhjes mendore. Çrregullimet e ankthit tek fëmijët dhe adoleshentet janë lehtësisht të neglizhuara dhe të perceptuara si më pak të rëndësishme.

Çrregullimet e ankthit

Secili prej nesh ka përjetuar ankth, madje mund të themi se epoka jonë quhet koha e ankthit. Është e vështirë që termit t'i jepet një përcaktim i

saktë, ndërkohë që përdoret një gamë e tërë përgjigjesh emocionale. (Waldinger R., 1997)

Frika është një reaktion normal ndaj një burimi të jashtëm rreziku, i njohur nga vetëdija jonë. Ajo është në përshtatje me burimin e rrezikut, si për sa i përket intensitetit ashtu edhe kohëzgjatjes, dhe shpërndahet kur shkaktari largohet ose shmanget. Frika përfshin ndjenjat subjektive të shqetësimit si dhe të ndryshimit fiziologjik objektiv, në të cilat si rregull futen: rrahjet e shpeshta të zemrës, shpejtimi i frymëmarrjes, dridhjet muskulare, dhe rishpërndarja e gjakut nga lëkura dhe organet e brendshme në grupet e muskujve të mëdhenj. Këto ndryshime e përgatisin trupin për veprimtari muskulare violente ("luftim ose fluturim"), që mund të jenë të domosdoshme në përgjigje të kërcënimit. (Waldinger R., 1997)

Ankthi ka tension, shqetësim, madje edhe tmerr, por në kundërshtim me frikën ankthi rrjedh nga burime që nuk janë të dukshme nga personi që e përjeton, ose që duken të parëndësishëm në krahasim me reaksionin intensiv emocional të tij /ose të saj. Ashtu si edhe frika, ankthi lidhet me rritjen e aktivitetit të sistemit nervor simpatic, i cili manifestohet me shenja fizike të tilla si: djersitje, rrahje të shpejta të zemrës, tremor, frymëmarrje të shpejtuar dhe shqetësim gastrointestinal. Ankthi është i zakonshëm dhe në shumicën e rasteve karakterizohet nga një reagim i tepruar ndaj ngjarjeve të lehta stresante (psh.: shqetësim i tepërt ndaj një ekzaminimi relativisht të parëndësishëm). Ne e konsiderojmë ankthin patologjik, kur ai ndërhyr në veprimtarinë ditore, në arritjen e qëllimeve të dëshiruara ose në rehatinë e arsyeshme emocionale. (Waldinger R., 1997).

Ankthi situacional shfaqet në përgjigje të një stresori specifik dhe përfundon menjëherë me largimin e tij. *Ankthi përmblytës i lirë* përkundrazi formohet nga shqetësimi që nuk lidhet dukshëm me një situatë specifike. Sistemi i DSM-IV-ës (Shoqata Psikiatrike Amerikane 1994) për klasifikimin e çrregullimeve të ankthit mund të përmbledhet në pemën vendimore (Figura 8-1). (Waldinger R., 1997).

Çrregullimet e ankthit janë sëmundjet psikiatrike më të zakonshme në popullatën e përgjithshme. Fobitë specifike janë më të zakonshmet, por shpesh njerëzit me këto çrregullime nuk kërkojnë mjekim. Ndërmjet atyre që paraqiten për mjekim, çrregullimet e ankthit që takohen më shpesh janë çrregullimi i panikut dhe çrregullimi obsesivo-kompulsiv (OCD). (Waldinger R., 1997).

A ka një shkak ankthi?

Gjenetik apo i fituar? A është e përcaktuar nga gjenet tona apo mjedisi luan një rol domethënës? Një përgjigje e thjeshtë për këtë pyetje komplekse është, *te dyja*. Një ndërthurje e ndërlikuar e faktorëve gjenetike dhe mjedisore që bashkohen për të na bërë ne kështu si jemi. Siç do të shohim, një bashkëveprim midis faktorëve gjenetike dhe mjedisor ndikojnë në mënyrën sesi ne mendojmë, zhvillohemi dhe jetojmë jetën.

Ky artikull panoramik do të japë një përshkrim të faktorëve që ndikojnë në shfaqjen e ankthit, si p.sh. rolin e gjenetikës, rolin e faktorëve të zhvillimit, duke përfshirë dhe pa-efektshmërinë prindërore dhe stresin traumatik. Do të diskutojmë gjithashtu rolin e temperamentit të lindur dhe sesi ndikon ai në rikthimin e stresit. Faktorët rrethor që mund të acarojnë, ankthin, duke përfshirë stresin kronik, gjendjen mjekësore dhe abuzimi me medikamentet

mjekësore, përbëjnë elemente të mundshëm etiologjik që nuk mund të neglizhohen.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë studim konsistoi në hulumtimin në literaturën teorike ekzistuese nëpërmjet sigurimit të artikujve për studimin aktual, me anë të kërkim elektronik në databazat e publikimeve akademike të Medline, PsycInfo, PubMed.

Termet e kërkimit: “anxiety disorders*, adolescent*, child*, prevalencë, u përdorën për të gjetur artikujt. Për disa artikuj kërkimi u krye duke u nisur nga citimi. Disa publikime të tjera të njohura nga autori janë cituar gjithashtu. Kërkimi u krye vetëm për artikujt e shkruar në gjuhën angleze.

Pse gjenetika është kaq e rëndësishme?

Roli që luan gjenetika në zhvillimin e çrregullimeve të ankthit është i ndërlikuar dhe është i ndërthurur me faktorë mjedisore, që do të diskutohen me vonë në këtë artikull. Tashme është e qarte që materiali ynë gjenetik ndikon në personalitet dhe dobësinë emocionale. Studime të kryera brenda familjes dhe të binjaket identike kanë treguar se çrregullimet e ankthit janë të ndikuara nga faktorët gjenetik (Barlow 2002). Kërkimet aktuale tregojnë se gjenet tendencioze të trashëguara luajnë një rol në përcaktimin e niveleve të tensionit dhe ankthit (Eysenck, 1967; Gray & McNaughton, 1996; Leonardo & Hon, 2006; Middel, Cath, Van Dyck & Boomsma, 2005). David Barlow, psikolog klinik dhe një ekspert i njohur në çrregullimet e ankthit, ka thënë, “Ndikimi i fort biologjik që mbartim, i cili vjen si pasoje e trashëgimisë gjenetike, krijon një tendencë për dobësi e cila kalon me pas në shfaqjen e ankthit”. Kjo do të thotë se për shkak të strukturës gjenetike, disa persona janë me të prirur për të përjetuar ankth në shkallë të lartë ose të kenë një temperament emocional se të tjerët. Gjithashtu disa persona janë gjenetiksht më të prekshëm për zhvillimin e çrregullimeve të ankthit sesa të tjerët.

Në këtë fazë, shkencëtarët po zbulojnë se është vetëm një rastësi dhe është e pasaktë t’ia adresosh zhvillimin e ankthit apo çrregullimeve të temperamentit, një gjeni të vetëm. Kërkimet mbështesin teorinë se kontributi i disa gjeneve varet në rritjen e ndjeshmërisë individuale gjenetike (Barlow, 2002). Kjo është quajtur *transmetimi poligjenik* që do të thotë se disa gjene kontribuojnë në shprehjen e një tipari. Një shembull i një tipari poligjenik do të ishte ngjyra e lëkurës. Disa gjene të ndryshme nga secili prind kombinohen për të krijuar finesën dhe nuancën e lëkurës, që e bën atë unike në çdo fëmijë. Dhe njësoj si me shprehjen e ankthit, tonaliteti i lëkurës mund të ndryshojë me kohën,

duke u errësuar apo hapur ne varësi te përvojave të jetës.

Meqenëse tipet dhe simptomat e ankthit janë te shumëllojshme, dallohen ndikime te ndryshme te gjeneve, ne zhvillimin e tipave te ndryshme të çrregullimeve te ankthit. Kjo teori mbështetet nga kërkimet qe demonstrojnë se disa çrregullime si për shembull paniku, kane ndikim gjenetik me te forte se të tjerët (National Institute of Health , 2009). E vetmja gjë qe dihet me siguri për ndikimin e gjeneve ne zhvillimin e ankthit është kompleksiteti i këtij ndikimi. Ndërveprimi dinamik midis përvojës dhe gjeneve është çelësi për të kuptuar ndjeshmërinë ndaj ankthit.

Si ndërvepron gjenetika me mjedisin

Kompleksiteti i transmetimit poligjenik mund të kuptohet më lehtë me ane te nje shembulli te ndikimit te qarte gjenetik, transmetimi monogjenik i gjatësisë. Me shikim te pare,shprehja e gjatësisë duket gjenetikisht precize. Nëse të dy prindërit e tu janë te gjate, ka shume mundësi qe ti te arrish një gjatësi mbi mesatare. Nëse ke motra dhe vëllezër ata mund te arrijnë një shtat te larte gjithashtu. Ne s'mund te parashikojmë gjatësinë ekzakte qe një individ mund te arrije,dhe gjatësitë jote ose e vëllezërve dhe motrave te tua sigurisht qe nuk do te jene te njëjta por fale njohurive tona ne fushën e gjenetikes, ti mund te shqyrtosh shtatin e prindërve të tu dhe të kesh një ide se sa i gjate do te jesh.

Gjithsesi, ne disa raste ndërveprimet mjedisore ushtrojnë një force te mjaftueshme për tu alternuar me prirjet gjenetike. Për shembull, të shohim nje ndukim mjedisor qe mund te ndodhe për një periudhe kohore te gjate; nëse gjate fëmijërisë tënde ti do të ushqehesh vetëm me çokollata,do te pengohet zhvillimi yt. Nuk do ta arrije gjatësinë e parashikuar gjenetikisht per shkak te kequshqyerjes. Ky është një shembull Ky është një shembull i ndikimit te zhvillimit ne shprehjen gjenetike.

Ndonjëherë, gjithsesi,nje incident i vetëm mund te sjelle ndryshime të rëndësishme në shprehjen gjenetike. Ndryshe nga ndikimi ne zhvillim,i cili duhet te ndodhe vazhdimisht ne nje periudhe kohore te gjate qe te beje ndryshime te rëndësishme gjenetike, një incident i vetëm akut mund te jete mjaft i fuqishëm për të ndryshuar shprehjen gjenetike nëpërmjet intensitetit te tij. Çrregullimet e ankthit nuk kane vetëm baza poligjenike, ato gjithashtu mund te ndikohen nga faktorët mjedisore. Për ta ndërlikuar me tepër çështjen, ka një dëshmi ne rritje për ekzistencën e periudhave kritike gjate ciklit jetësor gjate te cilave ne jemi te prekshëm nga çrregullimet e ankthit (Leonardo & Hen,2006; Leonardo & Hen, 2008). Mendohet se gjate këtyre 'dritareve kritike' truri

është veçanërisht i ndjeshëm ndaj stresoreve mjedisore, si nga stresorët akute edhe nga ata qe janë me pak te ashpër por te te zgjatur. Ne pjesën tjetër te këtij artikulli do të ekzaminojmë disa nga stresorët mjedisore, qe mund te kontribuojnë ne zhvillimin e çrregullimeve te ankthit.

Mjedisi brenda mitrës

Ne mund te ndikohemi nga stresi i nënës qe kur jemi ne mitër. Nena dhe fetusu qe është duke u zhvilluar ndajnë te njëjtin gjak dhe hormone te stresit te prodhuara nga nena e kalojnë barrierën e gjakut placentar. Ne këtë mënyrë stresi i një nene shtatzënë mund te këtë një ndikim e tille:stresi dhe eksperiencat e nënës mund te transmetohen drejtpërdrejt ne trupin e fëmijës ne zhvillim nëpërmjet rritjes se sasisë se hormoneve te stresit. Sigurisht, tek gruaja shtatzënë, stresi që rezulton nga këto reflektohet psikologjikisht. Nivelet e moderuara te stresit janë te zakonshme de nuk e dëmtojnë zhvillimin e fëmijës brenda mitrës. Gjithsesi,nivelet e larta te stresit ne një periudhe te gjate kohore do te bënte qe sistemi nervor i nënës te mbante një sasi shtese te hormoneve te stresit,qe vërshojnë ne sistemin nervor te bebes,duke e çuar atë në një gjendje stresi kronik. (Tanemura K., e bp., 2009)

Studiuesit kane ngritur teorinë se një mbingarkese e hormoneve te stresit faktikisht pengon aftësinë e sistemit nervor te bebes qe te ndryshoje ne përgjigje te stresit,duke u bere shume i ndjeshëm ndaj stimujve mjedisore:shtigjet nervore janë krijuar qe te lehtësojnë çlirimin e sasive tepër te mëdha të hormoneve te stresit qe mbahet për periudha tepër te gjata kohore ne përgjigje te një stresori. Sipas disa studiuesve, nenat qe kalojnë një stres te konsiderueshëm gjate shtatëzanisë kanë pasur foshnja me simptomat e një sistemi nervor të mbingarkuar. Nga temperamentit te zhvillimet motore, nivelet e stresit brenda mitrës bëjnë diferencën. Shtatëzanitë me ankth te larte priren te prodhojnë bebe me ankth. Kështu, emocionet e një nene shtatzëne dhe mjedisi brenda mitrës lidhen me gjendjen psikologjike dhe emocionale te foshnjës.

Foshnjëria dhe fëmijëria e hershme

Truri i foshnjës mund të kuptohet si një rrjet i gjerë mundësish. Në kohën kur fëmija arrin moshën prej tetë muajsh, llogaritet që truri i saj te ketë rreth një mijë trilion lidhje sinaptike, rreth dyfishin e lidhjeve që posedon truri i një të rrituri (Kotulak, 1996). Në qoftë se truri do të ishte një autostradë informacioni, neuronet do të përfaqësonin dyshtemenë qe ndërton rrugën. Neuronet lidhen me njëra tjetrën nëpërmjet sinapseve, si binaret e një hekurudhe gjigande e cila hapet në çdo drejtim, me rrugica me shume te ndërthurura se rrugicat ne hartat e cdo qyteti. është si pasojë e tepricës të

drejtimeve tek të cilat një rrugë mund të të çojë, që bën që disa rrugë zgjaten dhe përforcohen ndërsa disa të tjera lihen të shkatërrohen për shkak se nuk përdoren më.

Përvojat jetësore përcaktojnë se cilat rrugë përforcohen dhe cilat shkatërrohen. Ky proces, fillimisht zhvillohet në dymbëdhjetë vitet e para të jetës, por tri vitet e para të jetës përfaqësojnë pjesën më kritike të këtij procesi (Kotulak, 1996). Për shembull, gjatë kohës që një foshnjë tenton të shtrëngojë një top plastik, lidhjet nervore që lehtësojnë shtrëngimin përforcohen. Në të njëjtën mënyrë në qoftë se në të gjitha rastet kur një fëmijë qan, si shkëmbim merr ngrohtësi dhe përkuqdesje nga të afërmit, atëherë një sjellje e tillë hap një rrugë të caktuar. Në rast të kundërt, pra kur fëmija në vend të përkuqdesjes si shkëmbim merr një sjellje të vrazhdë, truri i fëmijës pritet të hapë një rrugë krejtësisht të ndryshme. Pra një i rritur ka gjysmën e lidhjeve nervore të një fëmije 8 muajsh sepse gjatë jetës shumë rrugë janë hapur dhe shumë të tjera janë shkatëruar në mënyrë selektive.

Ky proces influencohet shumë nga marrëdhënia e foshnjës me prindërit e vet. Informacioni që fëmija merr në lidhje me botën vjen prej atyre personave të cilët përkuqdesen për këtë fëmijë. Pra përkuqdesja ndaj foshnjës ndikon në hapjen fillestare të shumë rrugëve nervore. Foshnja është e varur nga këto marrëdhënie në mënyrë që të plotësohen nevojat e saj më themelore. Në këtë mënyrë në qoftë se ekziston një carje në këtë marrëdhënie, kjo sigurisht që do të ndikojë në rrugët nervore që do të ndodhin. Fatkeqësisht, foshnjat që përjetojnë stres apo trauma përshtaten në mënyrë të tillë që të prodhojnë hormone stresi mbi normën edhe në situata që normalisht për fëmijët e tjerë nuk do të ishin kërcënuese. Edhe njëherë shihet se përvoja i jep ngjyrë shprehjes së gjeneve. Por cilat karakteristika të cilat mendohet se janë të lindura i rezistojnë më tepër ngjyrosjes së përvojës? Temperamenti është një prej tyre.

Sa i rëndësishëm është temperamenti në lindjen dhe ruajtjen e ankthit?

Është e qartë se fëmijët lindin me temperamente të ndryshme. Shumë prindër të cilët shpesh raportojnë për ndryshime të dukshme në personalitetet e fëmijëve të tyre e përforcojnë akoma më tepër idenë e temperamenteve të lindura.

Kërkimet nga fusha e psikologjisë së zhvillimit i përforcojnë akoma më tepër vëzhgimet informale të prindërve. Temperamenti është një komponent i personalitetit dhe si i tillë qëndron i pandryshuar me kalimin e kohës. Aaron Beck (2005), një psikiatër i mirënjohur për trajtimin kundër ankthit dhe

depressionit, zbuloi se ndryshimet në temperament ndikojnë në reagime të ndryshme ndaj stresit ose në mënyrën se si një individ e përjeton stresin. Jeffrey Young, psikolog dhe autor i librit “Terapia Skematike” mundi të identifikojë veçori të lindura të temperamentit tek foshnjat të tilla si : **anksioz kundrejt i qetë dhe i irritueshëm kundrejt stabil.**

Jerome Kagan, një studiues në psikologjinë e zhvillimit, zbuloi se rreth 15-20% e fëmijëve amerikanë dhe europianë lindnin me një “temperament me sjellje të frenuar”. Me fjalë të tjera disa foshnja zakonisht ishin në ankth kur vendoseshin në situata të reja dhe këtë e shprehnin me përgjigje psikologjike si: përshpejtim të rrahjeve të zemrës dhe nivele të larta të hormoneve të stresit. Ai gjithashtu zbuloi se “bebet meshkuj të frenuar” me vonë bëheshin djem të turpshëm, ndërsa bebet vajza me të njëjtat simptoma bëheshin “vajza të vogla e të palodhura”. Nuk është e vështirë të kuptohet së në moshë madhore këta djem mund të shfaqin çrregullime të ankthit. Megjithatë, duhet theksuar se një temperament i shqetësuar në fëmijëri nuk mund të na thotë me siguri për temperamentin e individit në moshe madhore.

Megjithëse adultët me çrregullime të ankthit në shumicën e rasteve kanë shfaqur përgjigje të kufizuara në fëmijëri, jo të gjithë fëmijët më këtë temperament bëhen adultë të shqetësuar. Një fakt i tillë sugjeron se faktorë të tjerë ndikojnë në këtë rezultat. Kemi parë se si mjedisi intra-uterin, përkuqdesja foshnjore mund ti japin ngjyrë shprehjes poligjenike të ankthit. Dimë se qetësimi, përkuqdesja nga ana e familjes mund të zbusin tiparet e lindura të personalitetit. Në fëmijëri, modelimi dhe procesi i të nxënit përbëjnë pika kyçe në formimin e rrugëve neuronale dhe të “hartave” që do të formohen prej tyre.

Fëmija mund të përfitojë nga kjo në rastin kur ka një temperament të shqetësuar dhe fillon të mësojë mënyra të përshtatjes duke “kopjuar” ata që kujdesen për të. Por në sjellje e kundërt, pra kur të afërmit imponojnë një sjellje më agresive, që rrit ankthin e fëmijës, mund ta dëmtojë edhe më tepër atë.

Modelimi i ankthit

Perceptimi i një fëmije për sjelljen e prindërve të tij dhe shprehjen e ankthit ndikon në ushqyerjen dhe zhvillimin emocional të tij. Veprimet tona, fjalët, gjuha e trupit, rreziku që marrim apo shmangim komunikojnë me fëmijët tanë edhe nëse bota është vendi ku mund të rritemi, ose ku duhet të qëndrojmë në ane mbushur me frikë dhe fjalëpakë në çdo kthesë të saj.

Në fakt, një zbulim i fundit në botën e neuroshkencës është ekzistenca e asaj që ne quajmë

neurone pasqyre. Giacomo Rizzolati (2005), një neurofizilog i njohur zbuloi se shume nga neuronet e ngjashme te cilat janë aktivizuar kur nje individ kryen një aktivitet, aktivizohen gjithashtu tek individi i cili thjesht shikon ate person duke e kryer atë veprim. Prindërit, të cilët japin si shembull ankthin janë tipik tejet mbrojtës dhe besojnë se nëse nuk qëndrojnë sipër fëmijëve te tyre, ajo çfarë do te ndodh është vetëm shkatërrim. Nuk është e zakonshme qe prindërit tu kërkojnë fëmijëve te tyre ti telefonojnë sa here qe ata dalin jashtë, por mamaja e Melises e çoi këtë pritje ne ekstrem. Njerëzit me çrregullime te ankthit nënvlerësojnë aftësitë e tyre për tu përballur me sfidat, ndërkohë qe mbivlerësojnë rrezikun.

Prindërit tepër mbrojtës dëmtojnë fëmijët e tyre nëpërmjet përfshirjes se bota është një vend i pasigurt dhe fëmijët kane mungesa burimesh për t'u përballur me sfidat. Ata shpesh shpjegojnë ne detaje te shumta cfare mund tu ndodh fëmijëve te tyre ne sipërmarrjet ne bote. Ne mënyrë te pavetëdijshme për demin qe shkaktojnë, prindërit tejmbrojtës, i trajnojnë fëmijët e tyre padashur me vetëbesim të ulët dhe ndjesi të mungesës së vetefikasitetit.

Prindërimi me ankth gjithashtu dëmton fëmijët duke i shtyre rreth një mungese ndjenja se ato jo dikush tjetër, jane agjentet qe prodhojnë një rezultat te dëshiruar. Me fjale te tjera, nje student prindërit e se cilit ndërhyjnë ne detyrat e shtëpisë ne mënyrë te ngjashme, nuk do fitonin nje ndjenje te vet-agjensise ne lidhje me detyrat e shtepise dhe ne fund te fundit do dyshonin ne aftesite e tyre per te patur sukses akademik.

Ne menyre te ngjashme, prinderit teper mbrojtës pengojne zhvillimin e efikasitetit vetjak, ndjenjen se dikush ka aftesine te marre veprime efektive. Individet me efikasitet vetjak te zvogeluar jane me elastik ndaj stresit dhe nenvleresojne te mirat e tyre.

Kërkimet sugjerojnë se një përqindje e lartë e individëve ansioz kanë prindër tejet mbrojtës. Disa kane vështirësi te ndahen nga prindërit e tyre ne adoleshence dhe ne rininë e hershme. Këshilltaret e kolegjeve raportojnë nje rritje te numrit te studenteve te cilet kane frike te rrine vetem. Ata jane te mesur me ndihmen e prinderve te tyre ne marrjen e vendimeve, përgjegjësitë madje dhe detyrat e shtepise. Kur duhet te pershtaten me jeten e kolegjit këta te rinj jane ne meshire te fatit. Nga ana tjetër, femije te tjerë zhvillojne ankthin si pasoje e një lidhjeje te dobët emocionale me prindërit e tyre.

Atashimi

Dy psikologë Izraelitë ekspertë të traumave e kanë vënë re te disa nëna me ankth kishin një

kapacitet të dobët ti përgjigjeshin me ndjenja nevojave të fëmijëve ose mbi apo nën reagimin e nevojave të fëmijëve të tyre. Rezultatet treguan se kur fëmijët bëhen të shqetësuar, në vend që ti kërkojnë rehatim prindërve ata e distancojnë vetën nga prindërit. Kjo ka kuptim, fëmijët nuk patën eksperiencë me mendimin e tyre gjatë kohës që kishin nevojë kujdesin e tyre. Jo vetëm që krijuan një stilt të vetëizolimit, mos reagimit ata nuk morën përvojën e duhur që kishin kohë të mësojnë teknikat e vetëqetësimit, aftësi esenciale për ti menagjuar emocionet e tyre për gjatë jetës. Një grup tjetër fëmijësh në rrezik për shqetësime jan ata që pretendojnë rolin e kujdestarit për prindërit e tyre.

Diskutim

Çrregullimi i ankthit të përgjithësuar mund të jetë shpesh shoqëruar i çrregullimeve të tjera si çrregullimet e humorit çrregullime psikotike apo i problemeve të tjera shëndetësore, po ashtu mund të shoqërohet dhe me probleme ekonomike sociale. Zakonisht, nëse simptomat vazhdojnë për më shumë se gjashtë muaj është e mundshme që kemi të bëjmë me çrregullim ankthi të përgjithësuar.

Pa trajtim, çrregullimet e ankthit mund të vazhdojnë për një jetë, në disa raste me i butë në disa të tjera në paaftësi. Prandaj objektivi primar duhet të jetë: **Të ndërhyjmë në kohë që të mbrojmë dhe rikuperojmë shëndetin e pacientit.**

Nevoja për trajtim spitalor, kur pacienti nuk është në gjendje të menaxhojë funksionimin e tij, por sëmundja menaxhon pacientin, sjelljet e tij atëherë ndjehet nevoja e trajtimit në kushtet spitalore.

Njerëzit që vuajnë prej saj janë gjithmonë të brengosur, të shqetësuar, të tensionuar dhe kjo gjendje vazhdon me kalimin e kohës, ndërsa Sëmundjet fizike që shoqërojnë atë mund të jenë me ndërprerje. Ankthi shpesh mund të jetë i lidhur me situata familjare, pune ose paraqitet pa ndonjë shkak të vërtetë. Ankthi ndikon shume në aktivitetet e përditshme. Një në 50 njerëz zhvillojnë këtë sëmundje në një moment të jetës dhe gratë janë më të ndjeshme se meshkujt.

Pranimi është pothuajse gjëja më e vështirë që i sfidon njerëzit. Pranimi i një situatë të tillë që ka ndodhur dhe shikimi nga e ardhmja dhe jo nga ajo se “po të mos ndodhte”, edhe ashtu gjërat që kanë ndodhur nuk mund të kthehen, andaj pse të tundoni veten me të kaluarën në vend se të shikoni nga e ardhmja. Nuk ka një shkak gjendja e ankthit, por edhe në qoftë se ka janë disa faktorë që luajnë një rol të rëndësishëm:

Parandalimi i ankthit thelb përfshin një vetëdije të jetës së thekson dhe aftësinë tuaj për të

përballuar me ta. Kjo shpesh mund të jetë një detyrë e vështirë në shekullin e zënë dhe plot tension tona 21. Në thelb, ju mund të zhvillojnë përballimin mekanizma për të gjithë jetën e thekson. Strategjitë mund të përfshijnë Meditimet, relaksim ushtrime duke përfshirë marrë frymë thellë, vizualizimi, aftësitë ndërpersonale në kanë të bëjnë me njerëz të vështirë dhe situata apo aftësitë prindërore e trajnimit që kanë të bëjnë me fëmijët tuaj. Parandalimi gjithashtu përfshin dietë, ushtrime të rregullta, pjesa tjetër, dhe bazat në drejtim të kujdesit shëndetësor parandalues të mirëmbajtjes. Ushqimi është një faktor i madh. Kafeina, stimuluesve, mungesën e pushimit, dhe mungesa e ushtrimit të gjithë janë faktorë që ndikojnë ankthi.

Konkluzione

Të kuptuarit e çështjeve të ankthit të japin mundësinë të depërtosh në gjendjen tende personale dhe në atë të tjerëve. Shumica e çrregullimeve të ankthit kanë shkaqe të shumëfishta. Arritja e vlerësimit të shkaqeve të shumëfishta të ankthit, shume prej të cilave nuk vijnë për fajin tone, mund t'ju ndihmojnë të lehtësoni ndjenjën e turpërimit apo vete-ndëshkimit që mund të kenë kaluar. Fakti objektiv është që ankthi nuk është imperfeksion. Ju nuk duhet të fajësoni veten për ankthin që po kaloni. Duke pasur njohuri mbi këtë çështje ju mund të ndiqni një rrugë e cila mund të përmirësojë gjendjen tuaj.

Në literaturë dhe studime ekzistojnë të dhëna dhe informacion i gjerë mbi një shumëllojshmëri

metodash për trajtimin e çrregullimeve të ankthit. Suksesi i zbatimit të këtyre metodave nuk varet gjithmonë nga njohja e shkaqeve të ankthit. Njohja e plotë e etiologjisë apo origjinës së ankthit, mund të mbështesë trajtimin dhe përbën një themel të sigurtë nga ku mund të filloni betejat kundër ankthit

Rekomandime

Është e vështirë të gjendet origjina e ankthit. Meqënëse nuk modifikojmë dot faktorët gjenetikë, mund të përpiqemi të ndryshojmë faktorët ambientalë që ndikojnë në ruajtjen dhe përshkallëzimin e nivelit të ankthit.

✓ Mos nxitoni të zgjidhni problemet që ndeshin fëmijët. Inkurajojini të përballen me to. Mos e frenoni gjithnjë me “mos”.

✓ Fëmijët përfitojnë nga gabimet dhe testimi aftësive e fortësive nëpërmjet eksperiencave personale. Kur ata instruktohen së tepërmi humbasin vetbesimin tek aftësitë.

✓ Shmangia e zhgënjimeve, shqetësimeve, refuzimeve, dështimeve, i bën fëmijët të vulnerabël e të papërgatitur për të ardhmen.

✓ Inkurajoni fëmijën të flasë, shkruajë, vizatojë për frikërat.

✓ Identifikoni ankthet e shqetësimet tuaja. Shpesh ankthi është një reagim i mësuar.

✓ Mësojini fëmijës teknika relaksuese e autosugjестive.

BIBLIOGRAFI

- American Psychiatric Association, 1994. Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, Fourth Edition. Washington DC.
- Barlow D. 2002. Anxiety and its Disorders. The nature and treatment of anxiety and panic. Second edition. The Guilford Press. London
- Beck A. 2005. Anxiety Disorders and Phobias: A Cognitive Perspective.
- Eysck, Gray & McNaughton. 1996. The new reinforcement sensitivity theory: Implications for personality measurement.
- Kagan J, Snidman N., 2004, The Long Shadow of Temperament
- Kimura, N, Tanemura, K, Nakamura, S. 2003. Age related changes of Alzheimer's disease associated proteins in cynomolgus monkey brains. Biochem Biophys Res Commun 310: pp. 303-311
- Kotulak, Inside the brain. 1996. Revolutionary discoveries of how the mind works: Kansas City.
- Leonardo E., Hen R. 2006. Genetics of Affective and Anxiety Disorders Annual Review of Psychology. Vol. 57: 117-137.
- Leonardo E., Hen R. 2006. Genetics of affective and anxiety disorders. Annual. Review. Psychol., 57: 117–137.
- Leonardo E., Hen R. 2008. Anxiety as a Developmental Disorder.
- Manassis K., Young A. 2001. Adapting positive reinforcement systems to suit child temperament. J. Am. Acad. Child Adolescent Psychiatry.
- Middeldorp C, Cath D, Van Dyck R, Boomsma D. 2005. The co-morbidity of anxiety and depression in the perspective of genetic epidemiology. A review of twin and family studies. Psychol Med. 35(5):611-24.
- National Institute of Health. 2009. Public perceptions, anxiety, and behaviour change in relation to the swine flu outbreak: cross sectional telephone survey. BMJ 2009; 339,

Rizzolati G., 2005, What Neuroscience Tells Us about Morality.
Waldinger R. 1997. Psychiatry for Medicine Students.

A JANË TEKSTET SHKOLLORE TË GJUHËS ANGLEZE NJË BURIM I MJAFTUESHËM PËR PËRVETËSIMIN E IDIOMAVE?

VASILIKA POJANI

DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Përmbledhje

Ky studim synon të analizojë dhe të nxjerrë në pah qëndrimin e mësuesve të gjuhës angleze ndaj idiomave dhe mundësitë që tekstet shkollore të gjuhës angleze në shkollat e mesme ofrojnë për të kuptuarit, përdorimin dhe rruajtjen e idiomave në fjalorin e tyre aktiv.

Për të realizuar këtë studim u hartua një pyetësor i përbërë nga dy pjesë i cili u plotësua nga 25 mësues të gjuhës angleze në shkollat e mesme të qytetit të Korçës. Nëpërmjet tij u përpoqëm të mblidhnim të dhëna mbi qëndrimin e mësuesve të gjuhës angleze ndaj rëndësisë së mësimdhënies së idiomave, vendin që ato zenë midis aktiviteteve të aftësive gjuhësore si dhe mundësinë që tekstet shkollore ofrojnë për përvetësimin e tyre. Të konsideruara si një nga aspektet më të vështira të mësimdhënies së gjuhës angleze, u përpoqëm të mësonim shkallën e vështirësisë që të kuptuarit e idiomave paraqet për nxënësit shqiptarë si dhe teknikat e përdorura më shpesh nga mësuesit për të ndihmuar nxënësit në njohjen dhe të kuptuarit e tyre, të tilla si: kuptimi i fjalëpërfjalshëm, konteksti, fjala kyçe, hamendësimi, praktikiteti, etj. Pjesa e dytë e pyetësorit njëjtëson mënyrat e mësimdhënies së idiomave; nëse integrohen mjaftueshëm në aktivitetet gjuhësore apo trajtohen vetëm atëherë kur mësuesit i ndeshin në mënyrë të rastësishme. Gjithashtu, pyetësori ndihmoi të zbulojmë dendësinë e aktiviteteve me idiomat në tekstet shkollore dhe burimet e tjera që mësuesit shfrytëzojnë për përvetësimin e tyre.

Fjalë kyçe: përvetësimi i idiomave, aftësi gjuhësore, shpeshhtësi, kontekst, tekste shkollore

Abstract

The purpose of this study was to investigate and reveal the attitude of English language teachers to idioms and the opportunities the textbooks offer for idioms comprehension, production and retention.

A two-part questionnaire completed by 25 high-school English language teachers helped us gather information on the attitude of English language teachers on the importance of idioms teaching, the place their teaching occupy among other skills activities and how much the textbooks they are working with provide opportunities for their acquisition. Being one of the most difficult aspects of English language teaching, we have attempted to find out the level of difficulty idioms comprehension present for the students and the most frequent techniques and clues teachers use to help students recognize and comprehend them such as literal meaning, context, guessing, key word and common sense. The second part of the questionnaire reveals the ways idioms are taught; i.e. integrated with reading and listening activities; as a class totally dedicated to idiom teaching or an idiom remedial lesson where idioms are treated only when teachers incidentally encounter them. Emphasis was also given to the frequency idiom-related activities are encountered in the textbooks and the other sources teachers make use of to teach idioms besides those determined by the textbooks.

Hyrje

Përvetësimi i idiomave konsiderohet gjerësisht si një nga aspektet më të vështira në mësimin e gjuhës angleze. Sipas Cornell (1999) qoftë në gjuhësi apo përvetësimin e gjuhës, "idiomat gjithmonë kanë qënë një pjesë e nevojshme e studimit të gjuhës". Sa më të familjarizuar të jenë nxënësit me idiomat dhe përdorimin e tyre, më mirë do të përvetësojnë gjuhën angleze. Njohja dhe përdorimi i tyre në gjuhën e përditëshme përbëjnë për nxënësit "një pasuri me vlerë për përvetësimin e një gjuhe të re" (Celce-Murcia, and Larsen-Freeman, 1999). Wray (2000) ka vënë në dukje se "një komponent vendimtar në përvetësimin e suksesshëm të gjuhës është zotërimi i formave idiomatike të shprehjes ku përfshihen idiomat, bashkëlidhjet e qëndrueshme dhe gjedhet e fjalëve.

Sipas studimeve kërkimore, nga njëra anë mësuesit e gjuhës angleze pajtohen plotësisht me

rolin vendimtar që luajnë shprehjet idiomatike në përdorimin me lehtësi të gjuhës; nga ana tjetër zotërimi i tyre mbetet akoma një sfidë për ta dhe studentët e gjuhës angleze.

Por çfarë e bën të vështirë përvetësimin e idiomave?

Cooper (1999) vërejt se idiomat janë një tip (lloj) njësisht shumëfjalëshe që nuk kanë kuptim të fjalëpërfjalëshme. Grant (2007) thekson natyrën e ngrirë ose të ngulitur në sintaksën e idiomave; që do të thotë se idiomat nuk kanë përshtatje gramatikore. Sipas Simpson dhe Mendis (2003), idioma shihet si një grup fjalësh që ndodhen në një njësi pak a shumë fikse dhe kuptimi i tërësishëm i saj nuk mund të parashikohet (kapet) nga analiza e kuptimit të pjesëve përbërëse të saj. Bromley (1984) i njëjtësoi idiomat si shprehje të figurshme që parfaqësojnë një koncept për një tjetër dhe që mund të mendohet si i ngjashëm (analog). Carter

(1987) i pa idiomat si grupime të kufizuara fjalësh, kuptimi i të cilave nuk del nga analiza e fjalëpërfjalëshme e elementeve përbërës të tyre. Po kështu edhe për Huizenga (2000) idioma përkufizohet si një grup fjalësh që ka kuptim të ndryshëm nga kuptimi i pjesëve të veçanta të saj. Në të njëjtën linjë me studiuesit e mësipërm është edhe Feare (1980) i cili vuri re se idioma, në përgjithësi, është një shprehje që ka një kuptim të veçantë, i cili nuk mund të kapet plotësisht duke analizuar fjalët e veçanta në përbërje të saj.

Një problem tjetër me të cilin përballen nxënësit e gjuhës angleze është fakti që rregullat gramatikore nuk zbatohen plotësisht në to si ndodh me shprehjet e tjera. Përkthimi i tyre nuk është i fjalëpërfjalëshëm. Gjithashtu, pamjaftueshmëria në sasinë e nevojshme të fjalorit nga nxënësit e bën të vështirë analizën semantike të idiomave. Për më tepër, ndryshimi kulturor nuk i ndihmon nxënësit e gjuhës angleze të bëjnë lidhjen midis kuptimeve të figurshme dhe të drejtpërdrejta të idiomave. Kuptimi i disa idiomave të veçanta kërkon njohuri mbi origjinën e tyre, të cilat mund të jenë transferuar në situata plotësisht të reja në kohë.

Rëndësia e veçantë që paraqesin idiomat e gjuhës angleze për përvetësimin dhe përdorimin e tyre është njohur dhe pranuar nga shumë studiues dhe hulumtues, por çështja e mësimdhënies dhe mësimnxënies së tyre nuk ka marrë vëmendjen e mjaftueshme nga mësuesit dhe nxënësit e gjuhës angleze. (Liu, 2008) Idiomat vazhdojnë të shpjegohen dhe të mësohen si një aspekt i ndarë apo i veçantë i gjuhës angleze, ato nuk janë përfshirë në planet mësimore ose nuk janë parë si pjesë e aftësive dhe aktiviteteve gjuhësore aq të rëndësishme për të kuptuarit, mbajtje mend dhe përdorimin të tyre.

Tekstet shkollore të përdorura në shkollat e mesme të përfshira në këtë studim janë kryesisht të nivelit mbi-mesatar dhe në disa raste mesatar.



Tabela 2 Rëndësia, shpeshësia dhe mundësitë e përvetësimit të shprehjeve idiomatike në tekstet shkollore të gjuhës angleze

Statements	shumë efikase	efikase	mesatarisht efikase	disi efikase	joefikase
Rëndësia e mësimdhënies së idiomave në përvetësimin e gjuhës së huaj	8	16	1		
Numri i idiomave të përfshira në tekstin shkollor	jo shumë	pak	shumë	I konsiderueshëm	
	3	2	12	8	
Mundësitë e teksteve shkollore për përvetësimin e idiomave	1	13	9	2	

Listën e librave do ta gjeni në shtojcën 2 në fund të artikullit.

Analiza e të dhënave

Tabela 1. a, b Të dhëna mbi moshën dhe përvojën e mësimdhënies së mësuesve të intervistuar



Nga analiza e dy tabelave të mësipërme u vu re se 23 nga 25 mësues pjesëmarrës në studim, e thënë ndryshe, 92% janë të moshës 31 deri 40 vjet dhe 20 mësues ose 80% e tyre kanë më shumë se 10 vjet punçë, gjë që dëshmon se ata nuk janë shumë të rinj dhe që kanë një përvojë të konsiderueshme në mësimdhënie. Ky fakt tregon se gjykimet dhe mendimet kanë vlerë në këtë studim.


Shpeshtësia e shprehjeve idiomatike	Ndeshen rrallë		Në aktivitete sporadike		
	6		19		
% e mësimdhënies së idiomave midis aktiviteteve të tjera gjuhësore	aktivitete me idiomat	dëgjimi	leximi	të folurit	të shkruarit
	12.9 %	10.2%	16.6 %	12.8%	11.7%
Nga përcaktohen aktivitetet mbi idiomat	teksti shkollor			mësuesi	
	21			4	
A kanë tekstet shkollore fjalor të veçantë për shpjegimin e idiomave?	Po			Jo	
	3			22	

Duke iu referuar të dhënave të tabelës 2 shohim se pothuajse të gjithë mësuesit e anketuar (24/96%) ishin plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë që kanë idiomat në aftësimin e përgjithshëm të nxënësve në gjuhën angleze. Sipas tyre mësimdhënia e idiomave shihet si një mënyrë efikase ose shumë efikase për rritjen e kompetencës gjuhësore tek nxënësit.

Të pyetur për vendin dhe shpeshtësinë e tyre në tekst, rezultoi se 52% e mësuesve të anketuar ishin të mendimit se tekstet shkollore ofronin pak mundësi për prezantimin dhe praktikimin e idiomave. Edhe në rastet kur ndeshen në tekst, idiomat nuk integrohen në aktivitetet e aftësive gjuhësore (lexim, shkrim, dëgjim dhe në të folur) por

praktikoheshin nëpërmjet disa aktiviteteve të veçuara të përqëndruara vetëm në idiomat. Krahasuar me aktivitetet për përmirësimin e katër aftësive të tjera, ushtrimet mbi idiomat zinin vetëm 12.9 % të tyre. Përfshirja e tyre ishte përcaktuar nga vetë teksti (21 nga 25 mësues) dhe vetëm 16% e të anketuarve do të përdorin burime të tjera për përvetësimin e tyre. Përsa i përket materialeve referuese të gjendshme në tekst, të tilla si pjesë fjalori me shpjegimin e idiomave, u vu re mungesë e plotë e tyre. Kjo përgjigje mbështetet nga 88% e të anketuarve.

Tabela 3 Perceptimet e mësuesve mbi prezantimin, të kuptuarit dhe përdorimin e idiomave



Ndihmuar nga pyetjet paraqitur në tabelën 3, u përpoqëm të siguronim informacion për perceptimin mbi idiomat, shkallën e tyre të vështirësisë, teknikat dhe aktivitetet gjuhësore më të përdorura për prezantimin dhe të kuptuarit e tyre, si dhe motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve në procesin e mësimnxënies.

Duke vlerësuar përgjigjet e mësuesve, doli se shumica e nxënësve njihnin mirë termin shprehje


idiomatike dhe kishin njohuri të mëparshme për to, por 80% e mësuesve ishin të mendimit se përvetësimi i tyre përbënte një nga aspektet më të vështira në mësimin e gjuhës angleze. 21 nga 25 mësues e pranonin se i trajtonin idiomat vetëm kur ndesheshin për të lehtësuar përmbushjen e objektivave dhe detyrave të orës së mësimi. Vetëm pak subjekte (10 nga 25) do t'ia kushtonin një ore

mësimi në gjuhën angleze plotësisht prezantimit dhe përvetësimin të idiomave.

Sipas përgjigjes së 93% të anketuarve, nxënësit në përgjithësi i pëlqenin aktivitetet për mësimin e

idiomave dhe ishin të motivuar të merrnin pjesë në këtë proces, pavarësisht vështirësisë së tyre.


Tabela 4 Vështirësitë që mësuesit e gjuhës angleze ndeshin në mësimdhënien e idiomave



Përsa i përket vështirësive që ndeshin mësuesit gjatë mësimdhënies së idiomave, kompetenca e ndryshme gjuhësore tek nxënësit (60%) dhe pamundësia për të kuptuar idiomat (44%) rezultuan të ishin vështirësitë kryesore. Mungesa e materialeve për trajtimin e idiomave nuk përbënte

pengesë në këtë proces për 19 mësues (76%). Ata mendonin se mund të përdoren shumë materiale burimore jashtë teksteve bazë.


Tabela 5 Teknikat e përdorura për njohjen dhe të kuptuarit e idiomave



Për të ndihmuar nxënësit në njohjen dhe të kuptuarit e idiomave, të dhënat treguan se shumica e mësuesve (92%) përdornin kryesisht kontekstin, i cili si instrument, pasohet nga prakticiteti dhe më

pas ndiqej nga fjala kyçe. Teknikat si: kuptimi i fjalëpërfjalshëm dhe hamendësimi ishin 2 nga teknikat më pak të përdorura nga mësuesit (20% - 16%).

Tabela 6 Aktivitetet më të përdorura për përvetësimin e idiomave



Të dhënat në tabelën e mësipërme tregojnë qartë tërësinë e aktiviteteve të ndryshme që lidhen

më përvetësimin e idiomave. Rrëfimi i tregimeve, zgjedhja dhe përputhja me përkufizimin, plotësimi i

fjalisë dhe riorganizimi i fjalisë së shpërbërë u pa se ishin tipet më të përdorura të ushtrimeve nga 80 % deri 90% e mësuesve. Rrëfimi i tregimeve është një nga teknikat më të efektshme sepse ajo ju krijon nxënësve mundësinë të përdorin dhe të familjarizohen me idiomat e mësuar. Diskutimi, dramatizimi dhe krijimi i djalogjeve përdroeshin nga 60% deri 72% e të anketuarve. Ky rezultat përputhet me rezultatet e studimeve të tjera që lidhen me teknikat praktike të idiomave (Nunan 2003). Dramatizimi dhe krijimi i dialogëve besohet se janë të një rëndësie të veçantë ndër aktivitetet e përdorura, sepse ato krijojnë mënyra efikase për nxënësit të përmirësojnë aftësinë e të folurit dhe bashkëbisedimit para se të gjejnë veten në mes të botës reale (Scott & Ytreberg 2000). Llojet më pak të përdorura të aktiviteteve ishin lojërat dhe përdorimi i videove.

Përfundime

Gjetjet e pjesës së parë të kërkimit dëshmuar se mësimdhënia e idiomave në orët e mësimit të gjuhës angleze konsiderohet si një mënyrë shumë efikase për të zgjeruar fjalorin dhe për të përmirësuar kompetencën gjuhësore të nxënësve.

Bazuar në titujt e teksteve shkollore, autorët e tyre dhe shtëpitë botuese jemi të mendimit se tekstet janë të gjitha bashkëkohore, shkruar nga

autorë me përvojë, të cilët kanë njohuri të thella në mësimdhënie e gjuhës angleze në nivele të ndryshme. Ato rezultojnë të ofrojnë mësim aktiv të gjuhës angleze nëpërmjet një shumëllojshmërie tekstesh leximi autetntike dhe zhvillim sistematik të katër aftësive të domosdoshme për përvetësimin e gjuhës angleze. Por numri i diomave që ndeshen në to ishte i pakonsiderueshëm për rëndësinë që ato kanë. Kjo nuk do t'i ndihmonte mësuesit të trajtonin idiomat sistematikisht dhe sipas një plani mësimor të mirëpërcaktuar (hartuar) dhe strukturuar.

Rezultatet e pjesës së dytë konfirmuan edhe njëherë se idiomat përbëjnë një shkallë të lartë vështirësie për shkak të kompetencës së ndryshme gjuhësore dhe paaftësisë së nxënësve për t'i kuptuar ato. Midis aktiviteteve më të përdorura nga mësuesit për përvetësimin e idiomave ishin rrëfimi i tregimeve, zgjedhja dhe përputhja me përkufizimin, plotësimi i fjalisë dhe rindërtimi i fjalisë së shpërbërë.

Mbetet detyrë e mësuesve t'i përfshijnë idiomat jo vetëm në aktivitetet që lidhen me leximin dhe dëgjimin, por edhe në aftësitë e tjera gjuhësore. Kjo do t'u jepte mundësi mësuesve dhe nxënësve të praktikonin idiomat më shpesh për t'i bërë ato pjesë e fjalorit aktiv.

BIBLIOGRAFI

- Bromley, K. D. (1984). *Teaching idioms*. The Reading Teacher, 38(3), 272-276.
- Carter, R. (1987). *Vocabulary: Applied linguistic perspectives*. London, UK: Allen & Unwin.
- Celce-Murcia, M., & Larsen-Freeman, D. (1999). *The grammar book: An ESL/EFL teacher's course*. Boston, MA: Heinle & Heinle.
- Cooper, T. C. (1999). Processing of idioms by L2 learners of English. *TESOL Quarterly*, 33(2), 233-262. <http://dx.doi.org/10.2307/3587719>.
- Cornell, A. (1999). Idioms: An approach to identifying major pitfalls for learners. *IRAL*, 37(1).
- Feare, R. E. (1980). *Practice with idioms*. New York, NY: Oxford University Press.
- Grant L. E. (2007). In a manner of speaking: Assessing frequent spoken figurative idioms to assist ESL/EFL teachers. *System*, 35(2), 169-181. <http://dx.doi.org/10.1016/j.system.2006.05.004>
- Huizenga, J. (2000). *Can you believe it? Stories and idioms from real life: Book 1*. New York: NY: Oxford University Press.
- Liu, D. (2008). *Idioms: Description, comprehension, acquisition, and pedagogy*. New York, NY: Routledge.
- Nunan, D. (2003) *Practical English language teaching*. New York: McGraw Hill.
- Scott, R. C., & Ytreberg, L. H. (2000) *Teaching English to children*. New York: Longman, 1-22.
- Simpson, R., & Mendis, D. (2003). A corpus-based study of idioms in academic speech. *TESOL Quarterly*, 37(3), 419-441.
- Wray, A. (2000). Formulaic sequences in language teaching: Principle and practice. *Applied Linguistics*, 21(4), 463-489.